

V. I. LENIN
J. V. STALIN

**PËR ÇËSHTJEN
KOMBËTARE**

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1984

PARATHËNIE

Çështja kombëtare është pjesë përbërëse e çështjes së përgjithshme të luftës revolucionare të klasës punëtore për diktaturën e proletariatit dhe ka një rëndësi shumë të madhe. Ajo ka qenë dhe mbetet edhe sot një problem mjaft i mprehtë. Lufta për zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare është bërë një detyrë jetike aktuale për shumë popuj të botës.

Kuptimin e drejtë të çështjes kombëtare, si dhe kriteret shkencore e rrugët e drejta të zgjidhjes së saj i jep vetëm teoria marksiste-leniniste.

Të mbështetur fort në idetë e Marksit e të Engelsit për këtë problem, Lenini e Stalini i zhvilluan ato më tej në rrethanat e reja historike, në epokën e imperializmit dhe të revolucioneve proletare, kur lëvizja nacionalçlirimtare u bë pjesë e luftës së përgjithshme kundër imperializmit. Në veprat e Leninit dhe të Stalinit të përfshira në këtë përmbledhje gjejmë të përpunuar programin teorik dhe politikën e partisë komuniste për çështjen kombëtare, argumentimin shkencor të tezave programatike të partisë për çështjen kombëtare, si p.sh. e drejta e barabartë e kombeve, e drejta e pakicave kombëtare, të drejtat

e kombeve për vetëvendosjen deri në shkëputje, gjuhët dhe të drejtat e tyre të barabarta, kultura kombëtare dhe përmbajtja e saj klasore etj. Në to sqarohet kuptimi i çështjes kombëtare dhe prejardhja e kombeve, rrugët, format dhe mjetet për zgjidhjen e çështjes kombëtare, raporti ndërmjet çështjes punëtore dhe asaj kombëtare etj. Për të gjitha këto çështje ata u bënë një kritikë asgjësuese pikëpamjeve të oportunistëve rusë dhe ndërkombëtarë, demaskuan shovinizmin dhe nacionalizmin e tyre borgjez. Ata përpunuan kriteret shkencore historiko-konkrete e klasore në trajtimin e këtij problemi. Për ta kritere themelore janë kriteri klasor dhe kriteri historik.

Lenini e Stalini nënvizojnë domosdoshmërinë e trajtimit historiko-konkret të çështjes kombëtare, që do të thotë të kesh parasysht se në cilën epokë historike të caktuar shtrohet çështja kombëtare në një vend të caktuar, në ç'kushte zhvillimi ekonomiko-shoqëror ndodhet një vend, cila është pozita e tij ndërkombëtare, cili është raporti i forcave, niveli i lëvizjes revolucionare etj. Në këtë përmbledhje gjejmë analiza konkrete të Leninit dhe Stalinit për çështjen kombëtare, shtruarjen dhe rrugën e zgjidhjes së saj në kapitalizëm dhe zgjidhjen e saj në socializëm. Ata nënvizojnë idenë e argumentuar se vetëm në shoqërinë e vërtetë socialiste që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste çështja kombëtare mund të zgjidhet plotësisht.

Këto mësimë të Leninit dhe të Stalinit sot kanë një rëndësi të veçantë për të demaskuar teoritë e praktikat e sociologëve borgjezë e revizionistë modernë, sipas të cilave në kushtet e sotme, kur vepron varësia e përgjithshme ekonomike e kombeve, çështja kombëtare ka humbur kuptimin e vet.

Lenini e Stalini e shohin çështjen kombëtare si pjesë përbërëse të luftës së përgjithshme të klasës punëtore për të shkatërruar kapitalizmin e për të ndër-

tuar shoqërinë socialiste. Kjo kërkon që në çdo rast qëndrimet ndaj çështjes kombëtare të shihen nën prizmin e interesave klasorë të proletariatit, domethënë të interesave të tij për vendosjen e diktaturës së proletariatit me revolucion dhe ndërtimin e komunizmit.

«Në krahasim me çështjen punëtore», — shkruan Lenini, — «për Marks-in është e padiskutueshme se çështja kombëtare ka rëndësi të dorës së dytë» (shih këtë përmbledhje, f.164). Lenini e Stalini hodhën poshtë me argumente mënyrat reformiste apo thjesht juridike të shtruarjes dhe zgjidhjes së çështjes kombëtare, të cilat në thelb e shkëputnin çështjen kombëtare nga ajo e përmbysjes së imperializmit dhe e fitores së revolucionit proletar.

Ata argumentuan shkencërisht se çështja kombëtare është pjesë përbërëse e problemit të revolucionit proletar. «Çështja kombëtare», — shkruan Stalini, — «është një pjesë e çështjes së përgjithshme të revolucionit proletar, një pjesë e çështjes së diktaturës së proletariatit.» (shih këtë përmbledhje, f. 374).

Mbi bazën e një kuptimi të tillë të problemit, Lenini e Stalini shtrojnë domosdoshmërinë e përkrahjes së vendosur e aktive që duhet t'i japë proletariati i kombeve sunduese lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve të shtypur e të varur. Këtu «është fjala», — sqaron Stalini, — «për të përkrahur ato lëvizje kombëtare që synojnë në dobësimin, në përmbysjen e imperializmit dhe jo në forcimin e ruajtjen e tij.» (shih këtë përmbledhje, f. 375)

Në këtë mënyrë, «çështja e të drejtave të kombeve nuk është një çështje më vete, por një pjesë e çështjes së përgjithshme të revolucionit proletar, që i nënshtrohet së tërës dhe që duhet shqyrtuar nën prizmin e së tërës» (po aty).

Lenini e Stalini përpunojnë kuptimin shkencor revolucionar për barazinë e kombeve, parimin e vetë-

vendosjes deri në shkëputje dhe krijimin e shteteve kombëtare më vete, kuptimin shkencor mbi centralizmin demokratik që përmban vetëqeverisjen lokale e autonominë e krahinave etj. Ata argumentojnë se në periudhën e imperializmit zhvillohet shtypja kombëtare, se në kushtet e sundimit të pronës private kapitaliste nuk mund të mos ushqehen e të lulëzojnë shtypja kombëtare, pabarazia kombëtare, nacionalizmi borgjez, grindjet kombëtare etj. Për sa i përket të drejtës së kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje dhe krijimin të shteteve kombëtare më vete, Lenini e Stalini argumentojnë se klasa punëtore dhe partia e saj i përmbahen me vendosmëri këtij parimi, por ato nuk janë kurdoherë e në çdo rast për shkëputjen. Partia marksiste-leniniste e përkrah këtë dukuri vetëm kur është në interes të zhvillimit të lëvizjes revolucionare brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare.

Në këtë përmbledhje gjejmë mësimet me vlerë jashtëzakonisht të madhe për zgjidhjen e çështjes kombëtare në socializëm. Çështja kombëtare, mëson Stalini, mund të zgjidhet plotësisht vetëm në socializëm, ku prona kolektive dhe puna i afrojnë njerëzit, zhdukin përçarjen kombëtare dhe shtypjen kombëtare. Lenini e Stalini përpunojnë kërkesat, rrugët e metodat e zgjidhjes së çështjes kombëtare në socializëm. Të një rëndësie jashtëzakonisht të veçantë në këtë drejtim janë: respektimi konsekuent i parimit të vetëvendosjes së kombeve, zbatimi me konsekuencë nga shteti socialist shumëkombësh i parimit të vetëqeverisjes lokale dhe të autonomisë territoriale krahinore ose republikane të kombësive të ndryshme, zhdukja dhe moslejimi i privilegjeve e kufizimeve të ndryshme kombëtare, vendosja e barazisë së plotë të kombeve, të pakicave kombëtare dhe grupeve kombëtare. Karakteristikë themelore për një shtet është uniteti organik i barazisë juridike me atë reale në të gjitha fushat shtetërore-politike, ekonomike dhe kulturore. Në këtë

përmbledhje zbërthehen këto teza e pohime themelore për zgjidhjen e çështjes kombëtare në socializëm.

Një vend të veçantë në këtë përmbledhje zënë idetë e Leninit e Stalinit për thelbin dhe karakterin reaksionar të nacionalizmit borgjez dhe përmbajtjen e internacionalizmit proletar. Përvoja e sotme historike shërben si një provë e pakundërshtueshme e vërtetësisë së ideve leniniste-staliniane për çështjen kombëtare. Largimi i revizionistëve sovjetikë nga marksizëm-leninizmi e ka kthyer Bashkimin Sovjetik të sotëm në një burg popujsh, në një vend ku zhvillohen pabarazitë e grindjet kombëtare, ku zhvillohet shovinizmi rusomadh.

Realiteti «vetadministrues» jugosllav është një shembull tjetër i zhvillimit të pabarazisë së madhe ekonomike e shoqërore, i zhvillimit të grindjeve kombëtare e shtypjes kombëtare, i zhvillimit të shovinizmit serbomadh. Shembull flagrant i shtypjes kombëtare, i pabarazisë e diskriminimit në Jugosllavinë titiste është qëndrimi shovinist që mbahet ndaj shqiptarëve të krahinës së Kosovës e të viseve të tjera të banuara nga shqiptarët. Mbrojtja që i ka bërë dhe i bën PPSH dhe shteti ynë socialist të drejtave të vëllezërve shqiptarë në Jugosllavi, përkrahja e kërkesave të tyre të ligjshme kombëtare, dënimi i politikës shoviniste serbo-madhe, nuk janë aspak ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë, por një e drejtë e detyrë që burojnë nga ligjet e shkencës marksiste-leniniste, është qëndrim konsekuent marksist-leninist, mbrojtje e zhvillimit krijues të mësimëve leniniste-staliniane për çështjen kombëtare.

Botimi i kësaj përmbledhjeje të veçantë me pjesë të zgjedhura nga veprat e Leninit e Stalinit për problemin e rëndësishëm të çështjes kombëtare është një ndihmesë me rëndësi që i shërben drejtpërdrejt përvetësimit të thellë të ideve marksiste-leniniste për çështjen kombëtare nga komunistët e mbarë populli ynë.

V. I. LENIN

ÇËSHITJA KOMBËTARE NË PROGRAMIN TONË

Në projektprogramin e partisë ne kemi dalë me kërkesën e republikës me kushtetutë demokratike, e cila të sigurojë, midis së tjerash, «njohjen e së drejtës së vetëvendosjes për të gjitha kombet që bëjnë pjesë në shtetin tonë». Kjo kërkesë e programit shumë një-rëzve nuk u është dukur mjaft e qartë, dhe në Nr. 33, duke folur për manifestin e socialdemokratëve armenë, ne e shpjeguam kuptimin e kësaj pike në këtë mënyrë. Socialdemokracia do të luftojë gjithnjë kundër çdo orvatjeje për të ndikuar nga jashtë mbi vetëvendosjen kombëtare me anë të dhunës ose të çfarëdo padrejtësie tjetër. Por njohja pa kushte e luftës për lirinë e vetëvendosjes nuk na detyron aspak të përkrahim çfarëdo kërkesë për vetëvendosje kombëtare. Socialdemokracia, si parti e proletariatit, i vë vetes si detyrë pozitive dhe kryesore të ndihmojë vetëvendosjen jo të popujve dhe kombeve, por të proletariatit në çdo kombësi. Ne duhet të synojmë gjithnjë dhe patjetër drejt bashkimit *sa më të ngushtë* të proletariatit të të gjitha kombësive, dhe vetëm në disa raste të jashtëzakonshme mund të formulojmë dhe të përkrahim aktivisht kërkesa që synojnë në krijimin e një shteti të ri klasor ose në zëvendësimin e unitetit të

plotë politik të shtetit me një unitet federativ më të dobët etj.*

Ky interpretim i programit tonë për çështjen kombëtare shkaktoi një protestë të vendosur nga ana e Partisë Socialiste Poloneze (PSP)¹. Në artikullin: «Qëndrimi i socialdemokracisë ruse ndaj çështjes kombëtare» («Przedswit»^{**}, mars 1903) PSP-ja shpreh zemëratën e vet për këtë interpretim «të çuditshëm» dhe për «karakterin e errët» të vetëvendosjes sonë «misterioze», na akuzon edhe për doktrinarizëm edhe për pikëpamjen «anarkiste» se gjoja «punëtorit nuk i intereson asgjë, përveç zhdukjes së plotë të kapitalizmit, sepse gjuha, kombësia, kultura etj. janë vetëm shpikje të borgjezisë» etj. Ia vlen të ndalemi me hollësi të ky arsytim që nxjerr në shesh gati të gjitha keqkuptimet aq të zakonshme dhe aq të përhapura ndër socialistët për çështjen kombëtare.

Pse qenka kaq «i çuditshëm» interpretimi ynë? pse ky interpretim u duket si një largim nga kuptimi «fjalë për fjalë»? Mos vallë njohja e së drejtës së kombeve për vetëvendosje kërkon që të përkrahet çdo kërkesë e çdo kombi për të vetëvendosur? Njohja e së drejtës së të gjithë qytetarëve për të krijuar bashkime të lira nuk na detyron aspak ne, socialdemokratët, të përkrahim formimin e çfarëdo bashkimi të ri, nuk na ndalon aspak të shprehemi dhe të bëjmë agjitacion kundër idesë së krijimit të një bashkimi të tillë të ri, kur kjo ide nuk është e arsyeshme dhe nuk është me vend. Ne ua njohim edhe jezuitëve të drejtën për të bërë agjitacion të lirë, por ne luftojmë (natyrisht, jo me mënyra policore) kundër bashkimit të jezuitëve me proletarët. Prandaj, kur «Przedswit»—i thotë: «në qoftë se kjo kërkesë e vetëvendosjes së lirë duhet të kuptohet fjalë për fjalë (dhe

* Shih Veprat, bot. shqip, vëll. 6, f. 369-373. Red.

** — «Agimi». Red.

ne deri tani këtë kuptim i kemi dhënë), atëherë ajo do të na kënaqte», — është krejt e qartë se nga kuptimi fjalë për fjalë i programit largohet pikërisht PSP-ja. Mungesa e logjikës në konkluzionin e PSP-së nga ana formale është jashtë çdo dyshimi.

Por ne nuk duam të kufizohemi vetëm me një verifikim formal të interpretimit tonë. Le ta shtrojmë çështjen troç dhe në thelb: a duhet socialdemokracia ta kërkojë gjithnjë dhe në çfarëdo kushtesh pavarësinë kombëtare apo vetëm në disa kushte të caktuara dhe në ç'kushte konkretisht? PSP-ja ka thënë gjithmonë se e drejta e vetëvendosjes duhet të njihet pa kurrfarë kushtesh, prandaj nuk na habit aspak simpatia e saj për socialistët-revolucionarë rusë, të cilët kërkojnë një sistem shtetëror federativ dhe shprehen për «njohjen e plotë dhe pa kushte të së drejtës për vetëvendosje kombëtare» («Revolucionnaja Rossija» Nr. 18, artikulli «Skllavërimi kombëtar dhe socializmi revolucionar»). Mjerisht, kjo nuk është veçse një nga ato fraza demokratiko-borgjeze, të cilat na tregojnë për të qindtën dhe të mijtën herë natyrën e vërtetë të së ashtuquajturës parti të të ashtuquajturve socialistë-revolucionarë. Duke rënë në kurrizin e këtyre frazave, duke u gënjyer nga kjo zhurmë, PSP-ja nga ana e vet provon në këtë mënyrë se sa të dobëta janë në ndërgjegjen e saj teorike dhe në veprimtarinë e saj politike lidhjet me luftën klasore të proletariatit. Pikërisht interesave të kësaj lufte ne duhet t'ia nënshtrojmë kërkesën e vetëvendosjes kombëtare. Pikërisht këtu qëndron ndryshimi midis mënyrës se si e shtrojmë në çështjen kombëtare dhe mënyrës demokratiko-borgjeze të shtruarjes së saj. Demokracia borgjez (si dhe oportunisti socialist i sotëm që ecën në gjurmët e tij) mendon se demokracia e zhduk luftën e klasave, prandaj të gjitha kërkesat e veta politike i shtron në mënyrë abstrakte, pa baza, «pa kushte», nga pikëpamja e interesave të «të

gjithë popullit», ose madje nga pikëpamja e parimit moral të përjetshëm dhe absolut. Socialdemokrati e demaskon pa mëshirë këtë iluzion bongjez gjithnjë dhe kudo, qoftë kur ai shfaqet në filozofinë idealiste abstrakte, qoftë kur shfaqet në kërkesën e pavarësisë kombëtare pa kushte.

Nëse duhet ende të provojmë se marksisti nuk mund ta njohë kërkesën e pavarësisë kombëtare ndryshe, veçse me disa kushte dhe pikërisht me kushtin që treguam më sipër, do të përmendim fjalët e një shkrimtari që ka mbrojtur nga pikëpamja marksiste kërkesën e proletarëve polonezë për një Poloni të pavarur. Më 1896 në artikullin «Finis Poloniae?»* Karl Kautski shkruante: «Në qoftë se proletariati polonez do të merret me çështjen poloneze, ai nuk mund të mos shprehet për pavarësinë e Polonisë, ai nuk mund, pra, të mos përshëndesë çdo hap, i cili mund të bëhet qysh tani në këtë drejtim, përderisa një hap i tillë pajtohet përgjithësisht me interesat e klasës të proletariatit ndërkombëtar që është hedhur në luftë.

Sidoqoftë, — vazhdon Kautski, — kjo vërejtje duhet të bëhet. *Pavarësia kombëtare nuk është e lidhur në mënyrë aq të pazgjdhshme me interesat e klasës të proletariatit luftues, saqë ajo të kërkohet pa kushte dhe në çdo rrethanë***. Marksi dhe Engelsi janë shprehur me vendosmërinë më të madhe për bashkimin dhe çlirimin e Italisë, por kjo nuk i ndaloi që më 1859 të shpreheshin kundër bashkimit të Italisë me Napoleonin» («Neue Zeit» XIV, 2, S. 520***).

Ju e shihni se Kautski e hedh poshtë kategorikisht kërkesën pa kushte të pavarësisë së kombeve, kërkon kategorikisht që çështja të mos shtrohet vetëm në terrenin historik në përgjithësi, por pikërisht në terrenin klasor. Dhe në qoftë se ne marrim mënyrën

* — «Fundit i Polonisë?». *Red.*

** Kursivi është yni.

*** — «Kohët e reja» XIV, 2, f. 520. *Red.*

se si e kanë shtruar Marksii dhe Engelsii çështjen poloneze, do të shohim se pikërisht kështu e kanë shtruar edhe ata që në fillim. «Gazeta e re Renane» i kushtoi shumë vend çështjes poloneze dhe kërkonte me vendosmëri jo vetëm pavarësinë e Polonisë, por edhe një luftë të Gjermanisë kundër Rusisë për lirinë e Polonisë. Njëkohësisht edhe Marksii goditi Rugen, i cili kishte folur për lirinë e Polonisë në parlamentin e Frankfurtit dhe ishte përpjekur ta zgjidhte çështjen poloneze vetëm me fraza demokratiko-borgjeze për «padrejtësinë e turpshme», pa bërë asnjë analizë historike. Marksii nuk ishte nga ata pedantë dhe filistinë të revolucionit që më shumë se nga çdo gjë kanë frikë nga «polemika» në çastet revolucionare në histori. Marksii e mbuloi me sarkazma të pamëshirshëm qytetarin «humanist» Ruge dhe i tregoi, nga shembulli i shtypjes së Francës Jugore nga Franca Veriore, se jo çdo shtypje kombëtare dhe jo gjithnjë lind aspirata të ligjshme për pavarësi, nga pikëpamja e demokracisë dhe proletarietit. Marksii përmendi kushtet shoqërore të veçanta, për shkak të të cilave «Polonia u bë pjesë revolucionare e Rusisë, Austrisë dhe Prusisë... Edhe fisnikët polonezë, të cilët pjesërisht qëndronin ende në baza feudale, u bashkuan me vetëmohim të pashembullt me revolucionin demokratik-agrar. Polonia ishte bërë prej kohësh vatër e demokracisë evropiane, kur Gjermania vegjetonte ende në ideologjinë më banale kushtetuese dhe pseudofilozofike... Përderisa ne (gjermanët) ndihmojmë që të shtypet Polonia, përderisa ne e mbajmë të lidhur një pjesë të Polonisë pas Gjermanisë, — ne vetë mbetemi të lidhur pas Rusisë dhe pas politikës ruse, ne nuk kemi mundësi të gllirohemi plotësisht as në vendin tonë nga absolutizmi patriarkal-feudal. Krijimi i Polonisë demokratike është kushti i parë për krijimin e Gjermanisë demokratike»².

Ne i cituam këto deklaratat me kaq hollësi, sepse ato tregojnë qartë se ç'kushte historike përcaktuan

mënyrën e shtruarjes së çështjes poloneze në social-demokracinë ndërkombëtare, mënyrë që vazhdoi pothuajse gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XIX. Të mos i përfillësh kushtet që kanë ndryshuar qysh atëherë, të mbrosh zgjidhjet e vjetra të marksizmit, do të thotë t'i qëndrosh besnik gërmës e jo frymës së teorisë, do të thotë të përsëritësh përmendsh konkluzionet e vjetra, pa ditur të përdorësh metodat e trajtimit marksist për të analizuar situatën e re politike. Atëherë dhe sot, — epoka e lëvizjeve të fundit revolucionare borgjeze dhe epoka e reaksionit të tërbuar, e ndemjes në kulm të të gjitha forcave në prapun e revolucionit proletar, ndryshojnë në mënyrën më të qartë. Atëherë revolucionare ishte gjithë Polonia, jo vetëm fshatarësia, por edhe masa e fisnikëve. Traditat e luftës për çlirimin kombëtar ishin aq të forta dhe të thella, sa që pas disfatës në vendin e tyre bijtë më të mirë të Polonisë shkuan të ndihmonin kudo dhe në të katër anët klasat revolucionare; kujtimi i Dombrovskit dhe Vrublevskit³ është i lidhur pazgjidhshmërisht me lëvizjen më të madhe të proletariatit në shekullin XIX, me kryengritjen e fundit — dhe, të shprehëjmë, me dështimin e fundit — të punëtorëve të Parisit. Atëherë fitorja e plotë e demokracisë në Evropë ishte me të vërtetë e pamundur pa rimëkëmbjen e Polonisë. Atëherë Polonia ishte me të vërtetë mburoja e qytetërimit kundër carizmit, repart pararojë i demokracisë. Sot klasat sunduese të Polonisë, shlahta në Gjermani dhe Austri, manjatët industrialistë dhe financiarë në Rusi dalin si përkrahës të klasave sunduese në vendet që shtypin Poloninë, kurse krahas proletariatit polonez, i cili ka përvetësuar heroikisht traditat e mëdha të Polonisë së vjetër revolucionare, luftojnë për çlirimin e vet proletariati gjerman dhe rus. Sot përfaqësuesit pararojë të marksizmit në vendin fqinj, që ndjekin me vëmendje zhvillimin politik të Evropës dhe që ushqejnë simpati të madhe për luftën heroike të polonezëve, megjithatë,

pohojnë naptazi: «Tani Peterburgu është bërë qendër revolucionare shumë më e rëndësishme se Varshava, lëvizja revolucionare ruse ka sot një rëndësi ndërkom-bëtare më të madhe se lëvizja poloneze». Kështu u shpreh Kautski qysh më 1896, duke e njohur mundësinë për të përfshirë në programin e socialdemokra-tëve polonezë kërkesën për rimëkëmbjen e Polonisë. Dhe më 1902 Meringu, duke ndjekur evolucionin e çështjes poloneze qysh prej 1848-s gjer në ditët tona, arriti në këtë përfundim: «Sikur proletariati polonez të donte të shkruante në flamurin e vet kërkesën për rimëkëmbjen e shtetit klasor polonez, për të cilin vetë klasat sunduese as që duan të dëgjojnë, ai do të luante një komedi historike qesharake: me klasat e pasura mund të ndodhë një aventurë e tillë (siç ndodhi, për shembull, me fisnikët polonezë më 1791), por klasa pu-nëtore nuk duhet të bjerë kaq poshtë. Në qoftë se pastaj kjo utopi reaksionare nxirret në dritë me që-llim që të tërhiqen në anën e agjitacionit proletar shtresat e inteligjencies dhe të borgjezisë së vogël, ndër të cilat gjen ende njëfarë jehone agjitacioni ko-mbëtar, atëherë kjo utopi meriton dënim të dyfishtë, si shfaqje e oportunitizmit të padenjë, i cili për hir të interesave të parëndësishme dhe pa vlerë të një çasti bën flii interesat e thella të klasës punëtore.

Këto interesa urdhërojnë kategorikisht që punë-torët polonezë në të tria shtetet që e kanë ndarë Po-loninë të luftojnë krah për krah me shokët e tyre të klasës, pa asnjë prapamendim. Iku ajo kohë kur revolucioni borgjez mund të krijonte një Poloni të lirë; sot Polonia mund të ringjallet vetëm me anë të revolucionit shoqëror, kur proletariati i sotëm t'i kë-putë vargonjtë e vet».

Ne bashkohemi plotësisht me këtë përfundim që nxjerr Meringu. Le të shënojmë vetëm se ky përfun-dim mbetet krejt i drejtë edhe në qoftë se në arsyeti-min tonë ne nuk do të shkojmë aq larg sa ka shkuar Meringu. S'ka dyshim se gjendja e sotme e çështjes

poloneze ndryshon rrënjësisht nga ajo që ka qenë këtu e 50 vjet më parë. Por kjo gjendje e sotme nuk mund të quhet e përzetshme. S'ka dyshim se antagonizmi i klasave i ka shtyrë tani në plan të fundit çështjet kombëtare, por nuk mund të themi në mënyrë kategorike, në qoftë se nuk duam të biem në doktrinazëm, se është e pamundur që përkohësisht në paraskenën e dramës politike të dalë kjo apo ajo çështje kombëtare. S'ka dyshim se rimëkëmbja e Polonisë para se të shembet kapitalizmi është shumë e vështirë, por nuk mund të thuhet se ajo është krejt e pamundur, ose se nuk kanë për të dalë rrethana kur borgjezia poloneze do të marrë anën e pavarësisë etj. Dhe socialdemokracia ruse nuk ia lidh aspak duart vetes. Ajo i merr parasysh të gjitha kombinimet e mundshme, madje të gjitha kombinimet që mund të merren me mend, kur vë në programin e vet njohjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje. Ky program nuk përjashton aspak që proletariati polonez të dalë me parullën e një republike të lirë dhe të pavarur poloneze, edhe sikur mundësia që kjo të realizohet para socializmit të jetë fare e vogël. Ky program kërkon vetëm që një parti me të vërtetë socialiste të mos e prishë ndërgjegjen proletare, të mos e errësojë luftën klasore, të mos e gënjejë klasën punëtore me fraza demokratiko-borgjeze, të mos e cenojë unitetin e luftës politike të sotme të proletariatit. Pikërisht në këtë kusht, që është i vetmi kusht me të cilin ne e njohim vetëvendosjen, qëndron tërë thelbi. Më kot mundohet PSP-ja ta paraqesë çështjen sikur atë e ndan nga socialdemokratët gjermanë ose rusë fakti se ata e mendojnë të drejtën e vetëvendosjes, të drejtën për të kërkuar një republikë të lirë dhe të pavarur. Nuk është kjo, por harrimi i pikëpamjes klasore, errësimi i saj me anë të shovinizmit, prishja e unitetit të luftës politike të sotme — ja se çfarë nuk na lejon që të shohim te PSP-ja një parti socialdemokrate me të vërtetë punëtore. Ja, për shembull, si e shtron zako-

nisht çështjen PSP-ja: «...ne vetëm mund ta dobësojmë carizmin, duke e shkëputur Poloninë, kurse për ta përmbysur carizmin, këtë duhet ta bëjnë shokët rusë». Ose edhe kështu: «...pas shkatërrimit të autokracisë ne do ta përcaktonim latin tonë duke u shkëputur nga Rusia». Shihni se në ç'përfundime të përbindshme të çon kjo logjikë e përbindshme qoftë edhe nga pikëpamja e kërkesës programatike për rimëkëmbjen e Polonisë. *Megenëse* një nga pasojat e mundshme (por në kushtet e sundimit të borgjezisë ato nuk janë patjetër të siguruara) të evolucionit demokratik është rimëkëmbja e Polonisë, *për këtë arsye* proletariati polonez nuk duhet të luftojë bashkë me proletariatin rus për përmbysjen e carizmit, por «vetëm» për dobësimin e tij duke shkëputur Poloninë. *Megenëse* carizmi rus po lidh një aleancë gjithnjë më të ngushtë me borgjezinë dhe qeveritë e Gjermanisë, të Austrisë etj., *për këtë arsye* proletariati polonez duhet ta dobësojë aleancën me proletariatin rus, gjerman etj., me të cilin ai lufton tani kundër së njëjtës shtypje. Kjo nuk do të thotë tjetër veçse të bëhen fli interesat më jetësore të proletariatit për hir të kuptimit demokratiko-borgjez të pavarësisë kombëtare. Copëtimi i Rusisë, drejt të cilit synon PSP-ja *ndryshe* nga qëllimi ynë që është përmbysja e autokracisë, mbetet dhe do të mbetet frazë lloshë, derisa zhvillimi ekonomik t'i bashkojë më ngushtë pjesët e ndryshme të një të tërë politike të vetme, derisa borgjezia e të gjitha vendeve të bashkohet gjithnjë më ngushtë kundër armikut të saj të përbashkët, proletariatit, dhe për aleatin e saj të përbashkët: carin. Nga ana tjetër, *copëtimi i forcave të proletariatit*, i cili vuan tani nën shtypjen e kësaj autokracie, është realitet i hidhur, është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e gabimit të PSP-së, rrjedhojë e drejtpërdrejtë e gjunjëzimit të saj përpara formulave demokratiko-borgjeze. Që t'i mbyllë sytë përpara këtij copëtimi të proletariatit, PSP-ja detyrohet ta ulë ve-

ten deri te shovinizmi, t'i paraqesë, p.sh., pikëpamjet e socialdemokratëve rusë në këtë mënyrë: «ne (polonezët) duhet të presim revolucionin shoqëror, dhe deri atëherë ta durojmë pa bërë zë shtypjen kombëtare». Kjo është gënjeshtër. Socialdemokratët rusë jo vetëm që nuk kanë këshilluar kurrë asgjë të tillë, por, për kundrazi, ata vetë luftojnë dhe i bëjnë thirrje gjithë proletariatit rus që të luftojë kundër çdo shtypjeje kombëtare në Rusi, ata vënë në programin e tyre jo vetëm barazinë e plotë të gjuhës, të kombësisë etj., por edhe njohjen e së drejtës së çdo kombi për ta vendosur vetë fatin e vet. Dhe në qoftë se, duke e njohur këtë të drejtë, përkrahjen e kërkesave të pavarësisë kombëtare nga ana jonë ne ua nënshtrojmë interesave të luftës së proletariatit, vetëm një shovinizist mund ta shpjegojë qëndrimin tonë si mosbesim të rusëve ndaj jorusëve, sepse në të vërtetë ky qëndrim duhet të burojë medoemos nga mosbesimi i proletariatit të ndërgjegjshëm ndaj borgjezisë. Sipas PSP-së çështja kombëtare përmblihet e tëra në antitezën: «ne» (polonezët) dhe «ata» (gjermanët, rusët etj.). Kurse socialdemokrati vë në plan të parë antitezën: «ne» — proletarët dhe «ata» — borgjezia. «Ne», proletarët, e kemi parë me dhjetëra herë se si i tradhton borgjezia interesat e lirisë, të atdheut, të gjuhës dhe të kombit sa herë që i del përpara proletariati revolucionar. Ne pamë se si borgjezia franceze u shit te prusianët në çastin e shtypjes më të madhe dhe të poshtërimit më të madh të kombit francez, pamë se si qeveria e mbrojtjes kombëtare u shndërrua në qeveri të tradhtisë ndaj popullit, pamë se si borgjezia e një kombi të shtypur thirri në ndihmë ushtarët e kombit shtypës për të shtypur bashkatdhetarët e vet proletarë, që kishin guxuar të zgjatnin duart për të marrë pushtetin. Dhe ja pse, pa u turbulluar aspak nga sulmet shoviniste dhe oportuniste, ne do t'i themi gjithnjë punëtorit polonez: vetëm aleanca e plotë dhe më e ngushtë

me proletariatin rus mund t'i plotësojë kërkesat e luftës së sotme politike kundër autokracisë, vetëm një aleancë e tillë mund të jetë garanci për një çlirim politik dhe ekonomik të plotë.

Ato që thamë për çështjen poloneze vlejné tërësisht edhe për çdo çështje tjetër kombëtare. Historia e mallkuar e autokracisë na ka lënë si trashëgim një largim të madh ndër klasat punëtore të kombësive të ndryshme, të shtypura nga kjo autokraci. Ky largim është një e keqe shumë e madhe, një pengesë shumë e madhe në luftën kundër autokracisë, dhe ne nuk duhet ta ligjësojmë këtë të keqe, ta konsakrojmë këtë gjë të shëmtuar me asnjë «parim» të mëvetësisë së partive ose të «federatës» së partive. Natyrisht, është më lehtë dhe më thjesht të ndjekësh vijën e qëndresës më të vogël duke u struktur secili në këndin e vet sipas parimit: «tymi im të shkojë drejt», siç do që të bëjë tani edhe Bundi. Sa më shumë e kuptojmë nevojën e bashkimit, sa më shumë jemi të bindur për pamundësinë e një sulmi të përbashkët kundër autokracisë pa një bashkim të plotë, sa më e theksuar bëhet domosdoshmëria e organizimit centralist të luftës në kushtetona politike, — aq më pak ne mund të kënaqemi me një zgjidhje «të thjeshtë» të çështjes, e cila në të vërtetë është një zgjidhje sa për sy e faqe dhe thellësisht e rreme. Në qoftë se nuk kuptohet dëmi që sjell largimi, në qoftë se mungon dëshira për t'i dhënë fund me çdo kusht dhe përfundimisht këtij largimi në kampin e partisë proletare, — atëherë s'është nevoja as për gjethen e fikut të «federatës»; atëherë s'kemi as pse t'i përvishemi zgjidhjes së një çështjeje, të cilën njëra «anë» praktikisht nuk do që ta zgjidhë, atëherë është mirë që ta lëmë në dorë të mësimeve të vetë jetës dhe të lëvizjes reale që të na bindin se sa i nevojshëm është centralizmi për të siguruar suksesin e luftës së proletarëve të çdo kombësie, të shtypur nga

autokracia, kundër kësaj autokracie dhe kundër borgjezisë ndërkombëtare që po bashkohet gjithnjë më ngushtë.

«Iskra» Nr. 44,
15 korrik 1903

Veprat, bot. shqip, vëll. 6,
f. 523-534

Nga «NGJARJET NË BALLKAN DHE NË PERSI»

Këto kohët e fundit me ngjarjet në Ballkan është mbushur shtypi politik jo vetëm i Rosisë, por edhe i gjithë Evropës. Për njëfarë kohe rreziku i një lufte evropiane dukej fare i afërt, dhe ky rrezik edhe sot e kësaj dite — megjithëse ka shumë të ngjarë që puna të kufizohet vetëm me një bujë dhe zhurmë të madhe e të mos arrijë deri te lufta — nuk është zhdukur.

T'i hedhim një vështrim të përgjithshëm karakterit të krizës dhe detyrave që ajo vë përpara partisë punëtore ruse.

Zgjimi i popujve të Azisë për të marrë pjesë në jetën politike pati një shtytje veçanërisht të fortë nga lufta ruso-japoneze dhe nga revolucioni rus. Por ky zgjim u përhap aq ngadalë nga një vend në tjetrin, saqë në Persi rolin vendimtar e luajti dhe vazhdon ta luajë kundërrevolucioni rus, kurse revolucioni turk hasi menjëherë në koalicionin kundërrevolucionar të shteteve të tjera me Rusinë në krye. Është e vërtetë se kjo tezë e fundit, në vështrim të parë, është në kundërshtim me tonin e përgjithshëm të shtypit evropian dhe të deklaratave të diplomacisë: po t'i dëgjosh këto deklarata, po t'u zësh besë artikujve të organeve gjysmëzyrtare — të gjithë janë plot «simpati» për Turqinë e përtëritur, të gjithë nuk duan veçse forcimin

dhe zhvillimin e regjimit kushtetues në Turqi, të gjithë nuk dinë si ta lavdërojnë «maturinë» e xhonturqve borgjezë.

Por të gjitha këto fjalë janë vetëm një shembull i hipokrizisë së poshtër borgjeze të qeverive të sotme reaksionare të Evropës dhe të borgjezisë së sotme reaksionare evropiane. Në të vërtetë asnjë vend evropian që e quan veten demokratik, asnjë parti borgjeze e Evropës që quhet demokratike, përparimtare, liberale, radikale etj., nuk ka dhënë asnjë provë të dëshirës së sigurtë për ta ndihmuar revolucionin turk, për të ndihmuar fitoren dhe konsolidimin e tij. Përkundrazi, të gjithë kanë frikë nga suksesi i revolucionit turk, sepse ky sukses do të shënonte në mënyrë të pashmangshme, nga njëra anë, zhvillimin e aspiratave për autonomi dhe për një demokraci të vërtetë në gjithë popujt e Ballkanit, nga ana tjetër, fitoren e revolucionit persian, do të ishte një shtytje e re për lëvizjen demokratike në Azi, do të shënonte forcimin e luftës për pavarësinë e Indisë, krijimin e regjimeve të lira gjatë gjithë kufirit të madh rus, si pasojë, krijimin e kushteve të reja që do ta vështirësonin politikën e carizmit ultrareaksionar dhe do ta lehtësonin hovin e revolucionit në Rusi, e kështu me radhë.

Thelbi i ngjarjeve që po zhvillohen tani në Ballkan, në Turqi, në Persi është koalicioni kundërrevolucionar i fuqive të Evropës kundër demokratizmit që po rritet në Azi. Të gjitha përpjekjet e qeverive tona, tërë propaganda e gazetave «të mëdha» evropiane synojnë ta errësojnë këtë fakt për ta çorientuar opinionin publik, për ta maskuar me fjalime hipokrite dhe akrobaci diplomatike koalicionin kundërrevolucionar të të ashtuquajturave kombe të qytetëruara të Evropës kundër kombeve të Azisë, që janë më pak të qytetëruara, por që kanë më shumë etje për demokraci. Dhe gjithë thelbi i politikës së proletariatit në çastin e tanishëm është që t'ua çjerrë maskën hipokriteve borgjezë, të zbulojë përpara syve të masave më të gjera popullore

karakterin reaksionar të qeverive evropiane, të cilat nga frika e luftës proletare luajnë në vendet e tyre, dhe ndihmojnë që ta luajnë edhe të tjerët, rolin e xhandarit për revolucionin në Azi.

Rrjeti i intrigave, me të cilat Evropa ka rrethuar të gjitha ngjarjet në Turqi dhe në Ballkan, është jashtëzakonisht i dëndur, dhe publiku mikroborgjez bie në grackën e diplomatëve, të cilët mundohen ta përquendrojnë vëmendjen te vogëlsitë, te hollësitë, te anët e veçanta të ngjarjeve që po zhvillohen; mundohen ta errësojnë kuptimin e gjithë procesit në tërësi. Përkundrazi, detyra jonë, detyra e socialdemokracisë ndërkombëtare është t'i shpjegojë popullit pikërisht këtë lidhje të përgjithshme të ngjarjeve, të shpjegojë tendencën kryesore dhe prapaskenën e të gjitha ngjarjeve që po zhvillohen.

Konkurrenca e shteteve kapitaliste që duan «të rrëmbejnë thelën» dhe t'i zgjerojnë zotërimet dhe kolonitë e tyre, — pastaj frika e një lëvizjeje demokratike të pavarur ndër popujt e varur ose që janë nën «kujdestarinë» e Evropës, — ja dy forcat lëvizëse të gjithë politikës evropiane. Xhonturqit i lavdërojnë për qëndrimin e tyre të matur dhe të përmbajtur, d.m.th. revolucionin turk e lavdërojnë sepse është i dobët, sepse nuk i zgjon shtresat e ulëta të popullit, nuk ngjall iniciativën e vërtetë të masave, e lavdërojnë sepse ai mban një qëndrim armiqësor ndaj luftës proletare që po fillon në Perandorinë Otomane, — dhe njëkohësisht vazhdojnë ta grabitin Turqinë si përpara. E lavdërojnë sepse ka mundësi të vazhdojë si përpara grabitja e zotërimeve turke. I lavdërojnë xhonturqit dhe vazhdojnë një politikë që çon haptazi në copëtimin e Turqisë. Shumë drejt dhe hollë u shpreh për këtë «Gazeta popullore e Lajpcigut», organ i socialdemokratëve të vendit:

«Në maj 1791 disa burra shteti largpamës, që donin me të vërtetë të mirën e atdheut, shpallën reformën politike në

Poloni. Mbreti i Prusisë dhe perandori i Austrisë e lavdëruan kushtetutën e 3 majit, e përshëndetën atë, si një vepër «që i sjell lumturinë shtetit fqinj». Gjithë bota lavdëroi reformatorët polonezë, të cilët ndryshe nga jakobinët e tmerrshëm të Parisit u treguan «të matur» në këtë punë... Më 23 janar 1793 Prusia, Austria dhe Rusia nënshkruan marrëveshjen për copëtimin e Polonisë!

Në gusht 1908 xhonturqit shpallën një reformë politike, e cila u zbatua në mënyrë jashtëzakonisht të qetë. Gjithë bota i lavdëroi xhonturqit, të cilët ndryshe nga socialistët e tmerrshëm në Rusi u treguan «të matur» në këtë punë... Në tetor 1908 po zhvillohet një varg ngjarjesh, të cilat çojnë të gjitha në copëtimin e Turqisë».

Dhe me të vërtetë do të ishte një gabim fëmijëror sikur ndonjëri t'u zinte besë *fjalëve* të diplomatëve, pa marrë parasysh *veprat* e tyre, ndërhyrjen kolektive të shteteve kundër Turqisë revolucionare. Mjafton të krahasojmë takimin dhe bisedimet që u zhvilluan ndërmjet ministrave të Punëve të Jashtme dhe kryetarëve të disa shteteve — me ngjarjet e mëvonshme, që të zhduket si tym besimi naiv në deklaratat e diplomatëve. Në gusht dhe në shtator, pikërisht pas revolucionit xhonturk dhe përpara deklaratave të Austrisë dhe të Bullgarisë, ne shohim takimin e z. Izvolski në Karlsbad dhe Marienbad me mbretin Eduard, me kryeministrin e republikës franceze Klemanso, takimin e ministrit të Punëve të Jashtme të Austrisë fon Erental me ministrin e Punëve të Jashtme të Italisë Titoni në Saleburg, pastaj takimin e Izvolskit me Erentalin më 15 shtator në Buhloe, takimin e Ferdinandit, princit të Bullgarisë, me Franc-Josifin në Budapest, takimin e Izvolskit me fon Shenin, ministrin e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, pastaj me Titonin dhe me mbretin e Italisë.

Këto fakte flasin vetë. *Para deklaratës së Austrisë dhe Bullgarisë të gjitha gjërat kryesore* ishin diskutuar në mënyrën më konspirative dhe të drejtpërdrejtë në

takimet personale të mbretërve dhe ministrave, ndër-
mjet *gjashhtë* fuqive: Ruisë, Austrisë, Gjermanisë,
Italisë, Francës dhe Anglisë. Diskutimet që filluan
pastaj në shtyp rreth çështjes nëse Erentali kishte thë-
në të vërtetën se Italia, Gjermania dhe Rusia kishin
dhënë pëlqimin e tyre për aneksimin (bashkimin) e
Bosnjës dhe të Hercegovinës nga Austria apo jo, — të
gjitha këto janë *fund e krye komedi, janë vetëm orvat-
je për ta larguar vëmendjen*, janë një grackë në të ci-
lën mund të bien vetëm filistinët liberalë. Krerët e po-
litikës së jashtme të shteteve evropiane, Izvoiskët,
Erentalët dhe gjithë banda e kusarëve me kurorë bash-
kë me ministrat e tyre, ia hodhën me qëllim këtë
kockë shtypit: hami kokën midis jush, zotërinj, sa të
lodheni për të gjetur se kush gënjeu dhe kush u gë-
nnye dhe kush ia hëngri hakun tjetrit, Austria Ruisë,
Bullgaria Austrisë etj., kush e grisi «i pari» Traktatin
e Berlinit⁴, çfarë qëndrimi mban njëri dhe tjetri ndaj
planit për një konferencë të fuqive të tjera të këtij
lloji. Urdhëroni, tërhiqeni opinionin publik me këto çë-
shtje interesante dhe të rëndësishme — o! jashtëzako-
nisht të rëndësishme! Përkërisht këtë duam ne, që të
fshihet *thelbi kryesor* i çështjes: fakti se është arritur
marrëveshja qysh më parë për gjërat themelore,
d.m.th. për të ndërhyrë kundër revolucionit xhonturk,
për hapat e mëtejshëm në lidhje me copëtimin e Tur-
qisë, për të rishikuar në këtë ose atë formë çështjen
e Dardaneleve, për t'i lejuar carit ultrareaksionar rus
që të shtypë revolucionin persian. Ja ku qëndron gjithë
thelbi, ja për çfarë ne, udhëheqësit e borgjezisë reak-
sionare të gjithë Evropës, kemi me të vërtetë nevojë
dhe ja se çfarë po bëjmë. Dhe budallenjtë liberalë le
të llomotitin në shtyp dhe në parlamentet rreth çësht-
jes se si filloi kjo mesele dhe çfarë tha njëri e tjetri
dhe ç'formë duhet të marrë përfundimisht, si duhet
të nënshkruhet dhe t'i paraqitet gjithë botës politika
e grabitjeve koloniale dhe e shtypjes së lëvizjeve de-
mokratike.

Shtypi liberal i të gjitha shteteve më të mëdha të Evropës — me përjashtim të Austrisë, që është më «e ngopur» në çastin e tanishëm — sot nuk bën tjetër veçse akuzon qeverinë e vet se nuk i respekton sa duhet interesat e veta kombëtare. Liberalët e çdo vendi e paraqesin vendin e tyre, qeverinë e tyre si më të pazonjën, si viktimë të gënjyer, që ka ditur të «përfitojë» më pak se të gjithë nga gjendja etj. Pikërisht këtë politikë ndjekin edhe kadetët tanë, të cilët kanë arritur prej kohësh të thonë se sukseset e Austrisë ngjallin «zili» midis tyre (kështu u shpreh fjalë për fjalë z. Miliukov). Gjithë kjo politikë e borgjezëve liberalë në përgjithësi, dhe politika e kadetëve tanë në mënyrë të veçantë, është hipokrizia më e neveritshme, është tradhtia më e poshtër që u bëhet interesave të vërteta të përparimit dhe të lirisë. Sepse një politikë e tillë, së pari, e errëson ndërgjegjen demokratike të masave popullore, duke e lënë në heshtje komplotin e qeverive reaksionare; së dyti, ajo shtyn çdo vend në rrugën e së ashtuquajturës politikë të jashtme aktive, d.m.th. miraton sistemin e grabitjeve koloniale dhe të ndërhyrjes së shteteve të tjera në çështjet e Gadishullit Ballkanik, ndërhyrje që është gjithnjë reaksionare; së treti, kjo politikë bën haptazi lojën e reaksionit, duke ngjallur ndër popujt interes për pjesën që do të marrim «ne», për pjesën që do të «na» takojë kur të bëhet ndarja, për pjesën që «ne» do të përfitojmë. Qeveritë reaksionare pikërisht në çastin e tanishëm, më shumë nga të gjitha, kanë nevojë pikërisht të kenë mundësi t'i referohen «opinionit publik» për t'i përforcuar pushtimet e tyre ose kërkesat për «kompensime» etj. Shikoni, duan të thonë ata, shtypi i vendit tim më akuzon se jam treguar tepër bujar, se nuk i kam mbrojtur sa duhet interesat kombëtare, se kam bërë lëshime, ai më kanoset me luftë, si pasojë, kërkesat e mia, si kërkesa nga më «elementaret dhe të drejta», duhet të plotësohen deri në fund!

Politika e kadetëve rusë, si dhe politika e borgje-

zëve liberalë të Evropës, është servilizëm përpara qeverive reaksionare, është mbrojtje e pushtimeve koloniale, e grabitjeve dhe e ndërhyrjeve në punët e huaja. Politika e kadetëve është veçanërisht e dëmshme meqë bëhet nën flamurin e «opozitës», dhe si pasojë çorienton shumë e shumë njerëz, ngjall besim ndër ata që nuk kanë besim në qeverinë ruse, prish ndërgjegjen e masave. Prandaj edhe deputetët tanë në Dumë dhe të gjitha organizatat tona të partisë duhet të kenë parasysh se nuk mund të bëjmë asnjë hap serioz në punën e propagandës dhe të agjitacionit socialdemokrat për ngjarjet në Ballkan, po të mos shpjegojmë edhe nga tribuna e Dumës, edhe në trakte, edhe në mbledhje, lidhjen midis politikës reaksionare të autokracisë dhe opozitës hipokrite të kadetëve. Nuk mund t'ia shpjegojmë popullit gjithë dëmin, gjithë karakterin reaksionar të politikës cariste, po nuk i shpjegojmë atij se politika e jashtme kadete në thelb është e njëjta gjë. Nuk mund të luftojmë kundër shovinizmit dhe pogromizmit në politikën e jashtme, po nuk luftojmë kundër llafeve, dredhive, frazave gjysmake dhe manovrave të kadetëve.

Ja një shembull që tregon se ku i çon socialistët pajtimi me pikëpamjen e borgjezisë liberale. Në organin e njohur të oportunistëve «Sozialistische Monatshefte» («E Përmuajshmja socialiste — ???») Maks Shipeli shkruan për krizën ballkanike: «Pothuajse gjithë anëtarët e partisë me mend në kokë do ta quanin gabim sikur të mbizotëronte mendimi që u shpreh edhe një herë para pak kohe në organin tonë qendror të Berlinit (d.m.th. në gazetën «Vorwärts»*), konkretisht: mendimi se Gjermania nuk ka se çfarë të kërkojë as në ndryshimet e tanishme, as në ndryshimet e ardhshme në Ballkan. Kuptohet se ne nuk duhet të synojmë të realizojmë pushtime territoriale... Por është e padiskutueshme se rigrupimet e mëdha të shteteve në

* — «Përpara». Red.

këtë zonë, që shërbejnë si një hallkë ndërlidhëse e rëndësishme ndërmjet Evropës, gjithë Azisë dhe një pjese të Afrikës, e prekin më drejtpërdrejt gjendjen tonë ndërkombëtare... Tani për tani nuk mund të flitet në asnjë mënyrë për një rëndësi pak a shumë vendimtare të sistemit reaksionar rus... Rusinë... ne nuk kemi arsye ta quajmë armike në çdo rast dhe me çdo kusht, siç e quante demokracia e dhjetëvjetëshit të gjashtë të shekullit të kaluar» (S. 1319).

Ky liberal idiot, që fshihet nën maskën e socialistit, nuk i ka parë intrigat reaksionare të Rosisë pra pa «kujdesit» të saj për «vëllezërit sllavë»! Duke thënë: «ne» (në emër të borgjezisë gjermane), gjendja «jonë» etj., ai nuk sheh as grushtin që iu dha revolucionit xhonturk, as hapat e Rosisë kundër revolucionit persian!

Fjalët që cituam janë botuar në numrin e 22 tetorit të revistës. Më 18 (5) tetor «Novoje Vremja» botoi një artikull të bujshëm ku thuhet se «anarkia në Tavriz arriti përpjesëtime të pabesueshme», se gjoja qyteti «është gjysmë i shkatërruar dhe i grabitur nga revolucionarët gjysmëbarbarë». Fitorja e revolucionit mbi trupat e shahut në Tavriz, siç e shihni, ngjalli menjëherë tërbimin e organit gjysmëzyrtar rus. Udhëheqësi i trupave revolucionare persiane, Satar-hani, quhet në këtë artikull «Pugaçov aderbejxhanas» (Aderbejxhani ose Azerbejxhani është një krahinë e veriut të Persisë; qyteti kryesor i kësaj krahine është Tavrizi, popullsia e kësaj krahine, sipas *Reklisë*, përbën gati 1/5 e gjithë popullsisë së Persisë). «Lind pyetja, — shkruante «Novoje Vremja», — a mund t'i durojë Rusia pa mbarim të gjitha këto gjëra të shëmtuara që e dëmtojnë tregtinë tonë në kufirin persian, tregti që arrin në miliona rubla?... Nuk duhet harruar se gjithë Transkaukazia Lindore dhe Aderbejxhani nga pikëpamja etnografike janë një e tërë e vetme... Gjysmintelektualët tatarë të Transkaukazit, duke harruar se janë shtetas rusë, treguan simpati të zjarrtë për turbullirat e Tavrizit

dhe po dërgojnë atje vullnetarët e tyre... për ne ka shumë më tepër rëndësi që Aderbejxhani, i cili ndodhet afër kufijve tanë, të qetësohet. Sado e hidhur që mund të jetë, rrethanat mund ta detyrojnë Rusinë, me gjithë dëshirën e saj për të mos bërë asnjë ndërhyrje, që ta marrë përsipër vetë këtë punë».

Më 20 tetor gazeta gjermane «Gazeta e Frankfurtit» mori një telegram nga Peterburgu ku thuhet se «si kompensim» për Rusinë parashikohet okupimi i Aderbejxhanit. Më 24 (11) tetor po kjo gazetë botoi një telegram nga Tavrizi: «*Pardje gjashtë batalione të këmbësorisë ruse bashkë me kavalerinë dhe artilerinë përkatëse kaluan kufirin persian dhe priten sot në Tavriz*».

Trupat ruse kaluan kufirin persian pikërisht atë ditë kur M. Shipeli, duke përsëritur si skllav sigurimet dhe ulërimat e shtypit liberal dhe policor, u thoshte punëtorëve gjermanë se rëndësia e Ruisë, si mburojë e reaksionit, perëndoi dhe se është gabim që ajo të quhet armike me çdo kusht.

Pritet një masakrim i ri i revolucionarëve persianë nga trupat e Nikollai Gjakësorit. Pas veprimit jozyrtar të Ljahovit vjen pushtimi zyrtar i Aderbejxhanit dhe përsëritet në Azi ajo që bëri Rusia në Evropë më 1849, kur Nikollai I dërgoi trupat kundër revolucionit hungarez. Ndër partitë borgjeze në Evropë atëherë kishte ende një demokraci të vërtetë, që ishte e zonja të luftonte për lirinë, e jo vetëm të llogotiste në mënyrë hipokrite për të, siç bëjnë në ditët tona gjithë demokratët borgjezë. Rusia duhej të luante atëherë rolin e xhandarit të Evropës të paktën kundër disa vendeve evropiane. Sot të gjitha shtetet më të mëdha të Evropës, pa përjashtuar republikën «demokratike» të Klemansoit «të kuq», të frikësuar deri në palcë nga çdo zgjerim i demokracisë në vendin e tyre, si diçka që është në dobi të proletariatit, e ndihmojnë Rusinë të luajë rolin e xhandarit të Evropës.

S'ka asnjë dyshim se në *komplotin reaksionar të*

shtatorit ndërmjet Ruisë, Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Francës dhe Anglisë është parashikuar t'i jepet «liri veprimi» Ruisë kundër revolucionit persian. Nuk ka asnjë rëndësi nëse kjo u shkrua apo jo në ndonjë dokument të fshehtë, i cili mund të botohet pas shumë vjetësh në ndonjë përmbledhje materialesh historike, apo nëse Izvolksi ua tha këtë vetëm me gojë bashkëbiseduesve të tij shumë të dashur, apo nëse vetë këta bashkëbisedues «lanë të kuptohej» se ne do të kalojmë nga «pushtimet» në «aneksimet», kurse ju, ndoshta, nga veprimet e Ljahovit në «okupimin», ose diçka tjetër, — të gjitha këto kanë fare pak rëndësi. Rëndësi ka vetëm një gjë: cilado të ketë qenë forma e komplotit kundërrevolucionar të shtatorit ndërmjet fuqive, ky komplot është fakt dhe kuptimi i tij po bëhet çdo ditë më i qartë. Ky është një komplot kundër proletariatit dhe kundër demokracisë. Ky është një komplot për shtypjen e hapët të revolucionit në Azi ose për t'i dhënë grushte të tërthorta këtij revolucioni. Ky është një komplot për vazhdimin e grabitjeve koloniale dhe të pushtimeve territoriale sot në Ballkan, nesër në Persi, pasnesër, ndoshta, në Azinë e Vogël, në Egjipt etj. etj.

Vetëm revolucioni botëror i proletariatit mund ta përmbysë këtë forcë të bashkuar të kusarëve me kurore në krye dhe të kapitalit ndërkombëtar. Detyra e ngutshme e të gjitha partive socialiste është ta forcojnë agjitacionin në masat, t'ia çjerrin maskën lojës së diplomatëve të të gjitha vendeve dhe t'i tregojnë konkretisht, qartë të gjitha faktet që dëshmojnë për rolin e poshtër të të gjitha fuqive aleate, pa dallim, si të atyre që kryejnë drejtpërsëdrejti funksionet e xhandarit, ashtu edhe të atyre që luajnë rolin e ndihmësve, të miqve dhe financierëve të këtij xhandari.

Deputetëve socialdemokratë rusë të Dumës, — ku pritët edhe deklarata e Izvolskit, edhe interpelanca kadeto-oktiabriste, — u takon tani një detyrë jashtëzakonisht e rëndë, por njëkohësisht jashtëzakonisht

e lartë dhe e madhe. Ata janë anëtarë të një institucioni që maskon politikën e fuqisë reaksionare kryesore, të komplotistit kryesor të kundërrevolucionit, dhe ata duhet të gjejnë zotësinë dhe burrërinë të *thonë gjithë të vërtetën*. Në një çast të tillë, si ai që po jetojmë sot, deputetëve socialdemokratë të Dumës ultra-reaksionare u është dhënë shumë, por edhe shumë do të kërkohet prej tyre. Sepse përveç tyre *asnjeri* në Dumë nuk mund ta ngrejë zërin kundër carizmit nga pozita *jooktjabriste-kadete*. Dhe «protesta» kadete në një kohë të tillë dhe në rrethana të tilla është më keq se hiç, sepse kjo mund të jetë vetëm një protestë e dalë nga *gjiri po i asaj* tufe ujqish kapitalistë dhe në emër të po asaj politike ujqish.

Prandaj si fraksioni ynë në Dumë, ashtu edhe të gjitha organizatat e tjera të partisë sonë le t'i përvishen punës. Agjitacioni në masat ka sot një rëndësi njëqind herë më të madhe se në kohët e zakonshme. Në gjithë agjitacionin tonë të partisë tri rrethana duhet të vihen në plan të parë. Së pari, në kundërshtim me gjithë shtypin reaksionar dhe liberal, duke filluar që nga qindëshet e zeza e deri te kadetët, socialdemokracia çjerr maskën e lojës diplomatike të konferencave, të marrëveshjeve ndërmjet fuqive, të aleancave me Anglinë kundër Austrisë ose me Austrinë kundër Gjermanisë ose të çfarëdoq aleance tjetër. Detyra jonë është të tregojmë *faktin* e komplotit reaksionar të fuqive, i cili është kurdisur prej kohësh dhe të cilin qeveritë përpigën me të gjitha forcat ta maskojnë me komedinë e bisedimeve më të hapëta. Kundër komedive diplomatike, për t'i shpjeguar popullit të vërtetën, për ta demaskuar reaksionin ndërkombëtar antiproletar! Së dyti, ne duhet të shpjegojmë frytet dhe rezultatet reale, e jo me fjalë, të këtij komploti: grushti kundër revolucionit turk — bashkëpunimi i Rusisë në shtypjen e revolucionit persian — ndërhyrja në punët e huaja dhe shkëlja e parimit themelor të demokracisë, të së drejtës së kombeve për vetëvendosje. Programi

ynë, si dhe programi i gjithë socialdemokratëve të botës, e mbron këtë të drejtë. Dhe nuk ka asgjë më reaksionare sesa kujdesi i austriakëve, nga njëra anë, dhe i ultrareaksionarëve rusë, nga ana tjetër, për «vëllezërit sllavë». Ky «kujdes» fsheh intrigat më të poshtra, për të cilat Rusia është bërë e famshme prej kohësh në Ballkan. Ky «kujdes» synon gjithnjë të godasë demokracinë e vërtetë në këto ose ato vende ballkanike. I vetmi «kujdes» i sigurtë i fuqive për vendet ballkanike mund të ishte një dhe vetëm një: të lihen të lira të vendosin vetë fatin e tyre, të mos u helmohet jeta me ndërhyrje nga jashtë, të mos futen shkopinjt në rrotat e revolucionit turk. Por, sigurisht, klasa punëtore nuk mund të presë nga borgjezia një politikë të tillë!

Të gjitha partitë borgjeze — deri te partitë më liberale dhe «demokratike» me emër, duke përfshirë edhe kadetët tanë — qëndrojnë në pikëpamjet e politikës së jashtme kapitaliste. Kjo është rrethana e tretë, të cilën socialdemokracia duhet ta vërë në dukje në mënyrë të veçantë. Liberalët dhe partia kadete në thelb duan edhe ata po atë garë ndërmjet kombeve kapitaliste, duke propozuar vetëm forma të tjera të kësaj gare, të ndryshme nga ato të qindësheve të zeza, duke kërkuar marrëveshje të tjera ndërkombëtare, të ndryshme nga ato mbi të cilat mbështetet tani qeveria. Dhe kjo luftë liberale kundër një forme të politikës së jashtme borgjeze për një formë tjetër të po kësaj politike, këto kritika liberale që i bëhen qeverisë se ajo ka mbetur prapa nga të tjerat (në punën e grabitjeve dhe të ndërhyrjeve!) ushtrojnë ndikimin më të dëmshëm mbi masat. Poshtë çdo politikë koloniale, poshtë gjithë politika e ndërhyrjeve dhe e luftës kapitaliste për tokat e huaja, për popujt e huaj, për privilegje të reja, për tregje të reja, për ngushticat etj.! Socialdemokracia nuk bashkohet me utopinë absurde mikroborgjeze të përparimit «paqësor dhe të drejtë» kapitalist. Socialdemokracia lufton kundër gjithë shoqërisë

kapitaliste, duke ditur se nuk ka në botë tjetër mbrojtës të paqes dhe të lirisë përveç proletariatit revolucionar ndërkombëtar.

«Proletari» Nr. 37,
16 (29) tetor 1908

Veprat, bot. shqip, vëll. 15,
f. 242-253

NJË LOJË KUMARI

«Novoje Vremja» po i zbulon të gjitha planet e nacionalistëve rusë. Kur e lexon këtë gazetë «me influencë» ndër qarqet e lartpërmendura si edhe ndër oktjabristët, plani që ata zbatojnë me këmbëngulje për të grabitur Turqinë del i qartë.

Si zakonisht, politika e shovinizmit dhe e pushtimit të tokave të huaja bëhet para së gjithash duke ndërsyer opinionin publik kundër Austrisë. «Popujt e Ballkanit — shkruan «Novoje Vremja», — u ngritën në luftën e shenjtë për pavarësi. Diplomacia austriake po ruan çastin më të volitshëm për t'i grabitur».

Austria rrëmbeu një thelë (Bosnjën dhe Hercegovinën), Italia rrëmbeu edhe ajo një thelë (Tripolin), tani na ka ardhur radha të përfitojmë edhe ne — kjo është politika e gazetës «Novoje Vremja». «Lufta e shenjtë për pavarësi» nuk është veçse një frazë për t'i gënjyer njerëzit e padjallëzuar, sepse te ne në Rusi askush nuk i ka marrë aq nëpër këmbë parimet me të vërtetë demokratike të pavarësisë së vërtetë të të gjithë popujve sa nacionalistët dhe oktjabristët.

Pse mendojnë nacionalistët se tani çasti është i përshtatshëm për një politikë grabitjeje? Dhe kjo shihet qartë nga «Novoje Vremja». Italia, thotë ajo, nuk do të luftojë, për Austrinë është e rrezikshme të

fillojë një luftë kundër sllavëve të Ballkanit, sepse ajo ka një popullsi prej shumë milionë banorësh të afërt me ta, as Gjermania nuk do që të rrezikojë një luftë evropiane për të shpartalluar Turqinë.

Llogaritë e nacionalistëve janë të hapëta dhe në kulm të paturpshme. Ata thonë fjalë të mëdha për «luftën e shenjtë për pavarësinë» e popujve, kurse vetë luajnë me gjakftohtësinë më të madhe me jetën e miliona njerëzve, duke i shtyrë popujt në kasaphanë për hir të fitimeve të një grushti tregtarësh dhe fabrikantësh.

Aleanca tripalëshe (Gjermani, Austri, Itali) sot për sot është dobësuar, sepse Italia ka shpenzuar 800 milionë franga për luftën kundër turqve dhe në Ballkan «interesat» e Italisë dhe të Austrisë nuk përputhen. Italia do që të rrëmbejë edhe një thelë — Shqipërinë, Austria nuk do që ta lejojë këtë. Duke i mbështetur llogaritë e veta në këtë fakt, nacionalistët tanë bëjnë një lojë kumari të dëshpëruar, duke u mbështetur në forcën dhe pasurinë e dy shteteve të marrëveshjes tripalëshe (Angli dhe Francë) dhe në faktin se «Evropa» nuk do të dojë një luftë të përgjithshme për shkak të ngushticave ose për shkak të «rrumbullakosjes» së tokave «tona» në kuriz të Turqisë aziatike.

Në shoqërinë e skllavërisë së punës me mëditje çdo tregtar, çdo pronar bën një lojë kumari; «ose do të rrënohem, ose do të pasurohem dhe do të rrënoj të tjerët». Çdo vit falimentojnë qindra kapitalistë dhe rrënohen miliona fshatarë, zejtarë shtëpiakë dhe zejtarë të tjerë. Po këtë lojë kumari bëjnë edhe shtetet kapitaliste duke luajtur me gjakun e miliona njerëzve që dërgohen herë këtu, herë aty të vriten për të pushtuar toka të huaja dhe për të grabitur fqinjët e dobët.

NJË KAPITULL I RI NË HISTORINË BOTËRORE

Edhe shtypi borgjez i gjithë Evropës, i cili për qëllime reaksionare dhe egoiste kishte mbrojtur të famshmin status quo (status kuo — gjendjen e mëparshme, të pandryshuar) në Ballkan, pohon tani njëzëri se në historinë botërore ka filluar një kapitull i ri.

Shpartallimi i Turqisë është i padiskutueshëm. Fitoret e shteteve ballkanike, të bashkuara në aleancën katërpalëshe (Serbi, Bullgari, Mal i Zi, Greqi) janë shumë të mëdha. Aleanca e këtyre katër shteteve është bërë fakt. «Ballkani u takon popujve ballkanikë» — kjo *tashmë* u arrit.

Cila është rëndësia e këtij kapitulli të ri në historinë botërore?

Në Evropën Lindore (Austri, Ballkan, Rusi) deri tani nuk janë zhdukur ende mbeturinat e fuqishme të mesjetës, të cilat e pengojnë tmerrësisht zhvillimin shoqëror dhe rritjen e proletariatit. Këto mbeturina janë: absolutizmi (pushteti i pakufizuar i monarkut), feudalizmi (prona e tokës dhe privilegjet e çifligarëve-bujkrobërues) dhe shtypja e kombësive.

Punëtorët e ndërgjegjshëm të vendeve ballkanike kanë qenë të parët që hodhën parullën e zgjidhjes demokratike konsekuente të çështjeve kombëtare në

Ballkan. Kjo parullë është: republikë federative ballkanike. Dobësia e klasave demokratike në shtetet e sotme ballkanike (proletariati është i vogël në numër, fshatarët janë të shtypur, të shpërndarë, analfabetë) ka bërë që aleanca, e domosdoshme nga pikëpamja ekonomike dhe politike, të merrte formën e një aleance ndërmjet monarkive të Ballkanit.

Çështja kombëtare në Ballkan ka bërë një hap shumë të madh përpara drejt zgjidhjes së vet. Nga gjithë Evropa Lindore sot *vetëm Rusia* ka mbetur si një shtet shumë i prapambetur.

Megjithëse në Ballkan u krijua një aleancë ndërmjet monarkive, e jo një aleancë ndërmjet republikave, — megjithëse kjo aleancë u realizua në saje të një luftime, e jo në saje të një revolucioni, — megjithëkëtë është bërë një hap i madh përpara drejt zhdukjes së mbeturinave të mesjetës në gjithë Evropën Lindore. Është shumë shpejt që të ngazëlloni, zotërinj nacionalistë! Ky hap është *kundër* jush, sepse në Rusi mbeturinat e mesjetës janë *më të shumta se kudo!*

Kurse në Evropën Perëndimore proletariati po e shpall me forcë edhe më të madhe parullën: asnjë ndërhyrje! Ballkani u takon popujve ballkanikë!

«Pravda» Nr. 149,
21 tetor 1912

Veprat, bot. shqip, vëll. 18,
f. 407-408

LUFTA BALLKANIKE DHE SHOVINIZMI BORGJEZ

Lufta ballkanike po mbaron. Marrja e Adrianopojës është një fitore vendimtare për bullgarët dhe gjithë pesha e çështjes është zhvendosur përfundimisht nga teatri i veprimeve luftarake në teatrin e grindjeve dhe të intrigave të të ashtuquajturave fuqi të mëdha.

Lufta ballkanike është një nga hallkat në zinxhirin e ngjarjeve botërore që shënon shembjen e mesjetës në Azi dhe në Evropën Lindore. Krijimi i shteteve kombëtare të bashkuara në Ballkan, përmbysja e zgjedhës së feudalëve të vendit, çlirimi përfundimtar i fshatarëve ballkanas të çdo kombësie nga zgjedha e çifligarëve, — kjo ka qenë detyra historike që qëndronte përpara popujve të Ballkanit.

Këtë detyrë popujt e Ballkanit mund ta kishin zgjidhur dhjetë herë më lehtë se sot e me sakrificë njëqind herë më të pakta duke krijuar një republikë federative ballkanike. Në kushtet e një demokratizmi të plotë dhe konsekuent nuk do të kishte mundësi as për shtypje kombëtare, as për grindje kombëtare, as për ngjalljen e dallimeve fetare. Popujve të Ballkanit do t'u qe siguruar një zhvillim me të vërtetë i shpejtë, i gjerë dhe i lirë.

Cili është shkaku historik që çështjet jetësore të

popujve të Ballkanit u zgjidhën me një luftë të udhëhequr nga interesat borgjeze dhe dinastike? Shkaku kryesor është dobësia e proletariatit të Ballkanit, e pastaj ndikimet dhe presionet reaksionare të borgjezisë së fuqishme të Evropës. Ajo ka frikë nga liria e vërtetë si në vendin e saj ashtu edhe në Ballkan, ajo synon vetëm e vetëm të pasurohet në kurriz të të tjerëve, ajo nxit shovinizmin dhe armiqësinë kombëtare për t'ia bërë vetes më të lehtë politikën e grabitjes, për t'ua bërë më të vështirë klasave të shtypura të Ballkanit zhvillimin e tyre të lirë.

Shovinizmi rus në lidhje me ngjarjet në Ballkan nuk është më pak i shëmtuar se ai i Evropës. Kurse shovinizmi i kadetëve, i maskuar, i lustruar, i stolitur me fraza liberale është edhe më i shëmtuar edhe më i dëmshëm sesa shovinizmi i hapur i gazetave ultrareaksionare. Këto gazeta nxitin haptazi kundër Austrisë — në këtë vend që është më i prapambeturi nga vendet e Evropës, popujve u është siguruar (ta themi ndër kllapa) shumë më tepër liri se në Rusi. Kurse gazeta kadete «Reç» për marrjen e Adrianopojës shkruante: «kushtet e reja i japin të gjitha mundësitë diplomacisë ruse për të qenë më këmbëngulëse»...

Ç'«demokratë» të mirë që janë këta, të cilët bëjnë sikur nuk e kuptojnë se këtu mund të bëhet fjalë vetëm për këmbëngulje në ndjekjen e qëllimeve shoviniste! Nuk është për t'u çuditur në qoftë se në drekën e shtruar nga Rodzjankoja, më 14 mars, Miliukovi dhe Efremovi, Guçkovi, Benigseni, Krupenski dhe Balashovi u bashkuan të gjithë në një kompani. Nacionalistët, oktjabristët, kadetët, të gjithë këta nuk janë veçse nuanca të ndryshme të nacionalizmit dhe shovinizmit borgjez të shëmtuar dhe armiq të betuar të lirisë!

KLASA PUNËTORE DHE ÇËSHTJA KOMBËTARE

Rusia është një vend heterogjen nga pikëpamja kombëtare. Politika e qeverisë, politika e çifligarëve, të përkrahur nga borgjezia, karakterizohet fund e krye nga nacionalizmi ultrareaksionar.

Kjo politikë drejtohet kundër shumicës së popujve të Ruisë, që përbëjnë shumicën e popullsisë së saj. E krahas kësaj ka filluar të nxjerrë veshët nacionalizmi borgjez i kombeve të tjera (polonez, çifut, ukrainas, gjeorgjian etj.), duke u munduar ta largojë klasën punëtore nga detyrat e saj të mëdha botërore me anë të luftës kombëtare ose të luftës për kulturën kombëtare.

Çështja kombëtare kërkon të shtrohet dhe të zgjidhet në mënyrë të qartë nga të gjithë punëtorët e ndërgjegjshëm.

Kur borgjezia luftonte për lirinë bashkë me popullin, bashkë me punonjësit, ajo mbronte lirinë e plotë dhe barazinë e plotë të kombeve. Vendet e përparuara, Zvicra, Belgjika, Norvegjia etj., na japin shembullin se si mund të jetojnë në paqe së bashku ose të ndahen në paqe nga njëri-tjetri kombet e lira në kushtet e një rendi me të vërtetë demokratik.

Tani borgjezia ka frikë nga punëtorët, kërkon aleancë me Purishkeviçët, me reaksionin, e tradhton

demokratizmin, mbron shtypjen ose pabarazinë e kombeve, i korrupton punëtorët me parulla *nacionaliste*.

Vetëm proletariati mbron në ditët tona lirinë e vërtetë të kombeve dhe bashkimin e punëtorëve të të gjitha kombeve.

Që kombet e ndryshme të kenë mundësi të jetojnë së bashku në liri dhe paqe ose të ndahen (kur u vjen më mirë kështu), duke formuar shtete të ndryshme, për këtë nevojitet demokratizmi i plotë, të cilin e mbron klasa punëtore. Asnjë privilegj, për asnjë komb, për asnjë gjuhë! As më e vogla shtypje, as më e vogla padrejtësi kundër pakicës kombëtare! — ja parimet e demokracisë punëtore.

Kapitalistët dhe çifligarët duan me çdo kusht t'i përçajjnë punëtorët e kombeve të ndryshme, kurse vetë ata që kanë në dorë fuqinë në këtë botë merren vesh shumë mirë midis tyre, si aksionarë të «sipërmarrjeve fitimpurëse» që u japin miliona (si minierat e Lenës) — edhe ortodoksët edhe çifutët, edhe rusët edhe gjermanët, edhe polakët edhe ukrainasit, të gjithë ata që kanë *kapital*, i shfrytëzojnë në marrëveshje të plotë punëtorët e të gjitha kombeve.

(Punëtorët e ndërgjegjshëm duan *bashkimin e plotë* të punëtorëve të të gjitha kombeve në të gjitha organizatat punëtore të çdo lloji — kulturore, profesionale, politike etj. Le ta turpërojnë veten zotërinjtë kadetë duke ua mohuar ukrainasve barazinë e të drejtave ose duke ua kufizuar këto të drejta. Le të zbavitet borgjezia e të gjitha kombeve me frazat e rreme për kulturën kombëtare, për detyrat kombëtare etj. etj.

Punëtorët nuk do të lejojnë që t'i përçajjnë me fjalët e ëmbla për kulturën kombëtare ose për «autonominë kombëtare-kulturore». Punëtorët e të gjitha kombeve mbrojnë të vëllazëruar, së bashku, në organizatat e tyre të përbashkëta lirinë e plotë dhe barazinë e plotë, që është garancia e kulturës së vërtetë.

Punëtorët po krijojnë në mbarë botën kulturën e tyre, internacionale, të cilën e kanë përgatitur prej

kohësh propaganduesit e lirisë dhe armiqtë e shtypjes. Përballë botës së vjetër, botës së shtypjes kombëtare, të grindjeve kombëtare ose të dasisë kombëtare, punëtorët vënë botën e re të bashkimit të punonjësve të të gjitha kombeve, në të cilën nuk ka vend për asnjë privilegj, për as më të voglën shtypje të njeriut prej njeriut.

«Pravda» Nr. 106,
10 maj 1913

Veprat, bot. shqip, vëll. 19,
f. 81-83

EVROPA E PRAPAMBETUR DHE AZIA E PËRPARUAR

Duket paradoks të vihen përballë njëra-tjetrës këto fjalë. Kush nuk e di se Evropa është e përparuar, kurse Azia është e prapambetur? Por fjalët që kemi përdorur si titull për këtë artikull përmbajnë një të vërtetë të hidhur.

Në Evropën e qytetëruar dhe të përparuar, me teknikën e saj të zhvilluar për mrekulli, me kulturën e saj të pasur, të shumanshme dhe kushtetutën e saj, ka filluar një periudhë e tillë historike, kur borgjezia sunduese, e trembur nga proletariati që po rritet dhe po forcohet, përkrah çdo gjë të prapambetur, të kalbur, mesjetare. Borgjezia që po vdes bashkohet me të gjitha forcat që kanë vdekur dhe që po vdesin, për ta ruajtur skllavërinë me mëditje, e cila po lëkundet.

Në Evropën e përparuar sundon borgjezia, e cila përkrah çdo gjë të prapambetur. Në ditët tona Evropa është e përparuar jo në sajë të borgjezisë, por në kundërshtim me të, sepse vetëm proletariati shton vazhdimisht ushtrinë milionëshe të luftëtarëve që luftojnë për një të ardhme më të mirë, vetëm ai ushqen dhe përhap një armiqësi të pamëshirshme kundër prapambetjes, egërsisë, privilegjeve, skllavërisë dhe poshtërrimit të njeriut prej njeriut.

Në Evropën «e përparuar» klasë e përparuar është vetëm proletariati. Kurse borgjezia ende e gjallë është gati për çdo egërsi, barbarizëm dhe krim veç ta shpëtojë skllavërinë kapitaliste që po jep shpirt.

S'ka shembull më të qartë që të tregojë këtë kalbje të të gjithë borgjezisë evropiane se përkrahja që ajo i jep reaksionit në Azi për qëllimet egoiste të afa-ristëve financiarë dhe të mashtruesve kapitalistë.

Kudo në Azi po rritet, po zgjerohet dhe po forcohet një lëvizje e fuqishme demokratike. Atje borgjezia shkon ende me popullin kundër reaksionit. Qindra milionë njerëz po hapin sytë, duke kërkuar jetë, dritë dhe liri. Çentuziazëm ngjall kjo lëvizje botërore në zemrat e gjithë punëtorëve të ndërgjegjshëm, të cilët e dinë se rruga drejt kolektivizmit kalon përmes demokracisë! sa e madhe është simpatia që ushqejnë për Azinë e re gjithë demokratët e ndërshtë!

Po Evropa «e përparuar»? Ajo po grabit Kinën dhe ndihmon armiqtë e demokracisë, armiqtë e lirisë në Kinë!

Ja një llogari e thjeshtë, por kuptimplote. Huaja e re kineze është përfunduar kundër demokracisë kineze: «Evropa» është me Juan Shi-kain, i cili po përgatit diktaturën ushtarake. Pse është ajo me të? Sepse kjo është një punë që i leverdis. Huaja është përfunduar për një shumë prej rreth 250 milionë rublash me kursin 84 për 100. Kjo do të thotë se borgjezët e «Evropës» u paguajnë kinezëve 210 milionë, kurse nga publiku ata marrin 225 milionë rubla. Ja ku del menjëherë, brenda pak javëve, një fitim i kulluar prej 15 milionë rublash! Një fitim me të vërtetë «i kulluar», apo jo?

Po sikur populli kinez të mos e njohë këtë hua? Siç dihet, Kina është republikë dhe shumica në parlament është kundër huasë.

Oh, atëherë Evropa «e përparuar» do të fillojë të çirret për «qytetërim», «rend», «kulturë» dhe «atdhe»! atëherë ajo do të vërë në lëvizje topat dhe do ta shty-

pë këtë republikë të Azisë «së prapambetur» në aleancë me aventurierin, tradhtarin dhe mikun e reaksionit Juan Shi-kain!

Gjithë Evropa sunduese, gjithë borgjezia evropiane është në aleancë me të gjitha forcat e reaksionit dhe të mesjetës në Kinë.

Por gjithë Azia e re, domethënë qindra milionë punonjës të Azisë kanë një aleat të sigurt: proletariatin e të gjitha vendeve të qytetëruara. S'ka fuqi në botë që të mund ta ndalojë fitoren e tij, e cila do të çlirojë edhe popujt e Evropës edhe popujt e Azisë.

«Pravda» Nr. 113,
18 maj 1913

Veprat, bot. shqip, vëll. 19,
f. 90-92

N g a «TEZAT PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE»

1. Paragrafi i programit tonë (për vetëvendosjen e kombeve) nuk mund të interpretohet ndryshe veçse në kuptimin e vetëvendosjes *politike*, d.m.th. të së drejtës për t'u shkëputur dhe për të formuar një shtet më vete.

2. Për socialdemokracinë e Ruisë kjo pikë e programit socialdemokrat është *krejt* e domosdoshme.

(a) si në emër të parimeve themelore të demokracisë në përgjithësi;

(b) ashtu edhe ngaqë brenda kufijve të Ruisë, dhe *pikërisht në periferinë e saj*, ka një varg kombesh me kushte ekonomike, jetese etj. shumë të ndryshme, veç asaj, këto kombe (ashtu si edhe të gjitha kombet e Ruisë, përveç rusëve) janë tmerrsisht të shtypura nga monarkia cariste;

(c) më në fund, edhe ngaqë në gjithë Evropën Lindore (Austri dhe Ballkan) dhe në Azi — d.m.th. në vendet kufitare me Rusinë — ose nuk është përfunduar ose sapo ka filluar transformimi demokratik -borgjez i shteteve, i cili ka çuar kudo në botë, ku më shumë e ku më pak, në krijimin e shteteve kombëtare të pavarura ose të shteteve me përbërje kombëtare sa më të afërt dhe të përngjashme.

..(ç) Rusia është sot vendi që ka rendin shtetëror

më të prapambetur dhe reaksionar në krahasim me të gjitha vendet që e rrethojnë, duke filluar — në Perëndim — nga Austria, ku që prej vitit 1867 janë përforcuar bazat e lirisë politike dhe të rendit kushtetues, kurse tani është vënë në zbatim edhe e drejta e përgjithshme e votës, dhe duke mbaruar — në Lindje — me Kinën republikane. Prandaj socialdemokratët e Ruisisë duhet të ngulin këmbë në gjithë propagandën e tyre për të drejtën e të gjitha kombësive për të formuar një shtet të veçantë ose për të zgjedhur lirisht shtetin, në përbërjen e të cilit ato duan të hyjnë.

3. Njohja nga ana e socialdemokracisë e së drejtës së të gjitha kombësive për vetëvendosje kërkon nga socialdemokratët që ata

(a) të jenë me vendosmëri kundër çdo përdorimi të dhunës në çfarëdo forme qoftë nga ana e kombit sundues (ose që përbën shumicën e popullsisë) kundrejt kombit që dëshiron të shkëputet nga pikëpamja shtetërore;

(b) të kërkojnë që çështja për një shkëputje të tillë të vendoset vetëm e vetëm mbi bazën e votës së përgjithshme, të drejtpërdrejtë, të barabartë dhe të fshehtë nga ana e popullsisë së territorit përkatës;

(c) të luftojnë pa u lodhur si kundër partive ultra-reaksionare oktjabriste, ashtu edhe kundër partive borgjezo-liberale («progresistët», kadetët etj.) për çdo mbrojtje ose lejim nga ana e tyre të shtypjes kombëtare në përgjithësi ose të mohimit të së drejtës së kombeve për vetëvendosje në mënyrë të veçantë.

4. Njohja nga socialdemokracia e së drejtës së të gjitha kombësive për vetëvendosje nuk do të thotë aspak se socialdemokracia heq dorë nga vlerësimi i pavarur i dobisë së shkëputjes shtetërore të këtij ose atij kombi në çdo rast të veçantë. Përkundrazi, socialdemokratët duhet të japin pikërisht një vlerësim të pavarur, duke pasur parasysh si kushtet e zhvillimit të kapitalizmit dhe të shtypjes së proletarëve të kombeve të ndryshme nga ana e borgjezisë së bashkuar të

të gjitha kombësive, ashtu edhe detyrat e përgjithshme të demokracisë, e në radhë të parë dhe mbi të gjitha interesat e luftës klasore të proletariatit për socializmin.

Duke u nisur nga kjo pikëpamje duhet pasur parasysh veçanërisht kjo rrethanë. Në Rusi ka dy kombe që janë më të kulturuarat dhe më të izoluarat për shkak të një vargu të tërë kushtesh historike dhe shoqërore, të cilat më lehtë dhe në mënyrë «më të natyrshme» se çdo komb tjetër do të mund ta ushtronin të drejtën e tyre për t'u shkëputur. Këto kombe janë Finlanda dhe Polonia. Përvoja e revolucionit të 1905-s na tregoi se edhe në këto dy kombe klasat sunduese, çifligarët dhe borgjezia, e mohojnë luftën revolucionare për liri dhe kërkojnë të afrohen me klasat sunduese të Ruisë dhe me monarkinë cariste *ngaqë kanë frikë* nga proletariati revolucionar i Finlandës e i Polonisë.

Prandaj socialdemokracia duhet të bëjë çmos që ta paralajmërojë proletariatin dhe klasat punonjëse të të gjitha kombësive të ruhen nga mashtrimi i drejt-përdrejtë i tyre me parullat nacionaliste të borgjezisë «së tyre», e cila me fjalët e ëmbla dhe të zjarrta për «atdheun» mundohet ta përçajë proletariatin dhe *ta largojë vëmendjen e tij* nga manovrat e borgjezisë, e cila po hyn në aleancë, edhe ekonomike edhe politike, me borgjezinë e kombeve të tjera dhe me monarkinë cariste.

Proletariati nuk mund të luftojë për socializmin dhe t'i mbrojë interesat e tij ekonomike të përditshme pa aleancën më të ngushtë dhe më të plotë të punëtorëve të të gjitha kombeve në të gjitha organizatat punëto-re pa përjashtim.

Proletariati nuk mund ta fitojë lirinë veçse me anë të luftës revolucionare për përmbysjen e monarkisë cariste dhe për zëvendësimin e saj me republikën demokratike. Monarkia cariste e *përjashton* lirinë dhe barazinë e kombësive, duke qenë, veç asaj, mburoja kryesore e barbarizmit, egërsisë dhe reaksionit si në Evropë

pë, ashtu edhe në Azi. Dhe këtë monarki mund ta përmbysë vetëm proletariati i bashkuar i të gjitha kombeve të Rusisë, i cili do të marrë me vete elementët demokratë konsekuentë dhe të aftë për luftë revolucionare të masave punonjëse të të gjitha kombeve.

Prandaj punëtori, i cili bashkimin politik me borgjezinë e kombit «të vet» e vë mbi bashkimin e plotë me proletarët e të gjitha kombeve, vepron në kundërshtim me interesat e tij, në kundërshtim me interesat e socializmit dhe interesat e demokracisë.

5. Duke mbrojtur vendosjen e një rendi shtetëror demokratik konsekuent, socialdemokracia kërkon barazinë e plotë të kombësive dhe lufton kundër çfarëdo privilegji të një kombësie ose të disa kombësive.

Në mënyrë të veçantë, socialdemokracia e hedh poshtë nevojën e një gjuhe «zyrtare». Në Rusi një gjuhë e tillë është veçanërisht e panevojshme, sepse më shumë se shtatë të dhjetat e popullsisë së Rusisë janë fise sllave të afërta, të cilat, duke pasur një shkollë të lirë në një shtet të lirë, do ta gjenin shumë lehtë, në sajë të kërkesave të shkëmbimit ekonomik, mundësinë për t'u marrë vesh ndërmjet tyre pa qenë fare nevoja që njëres nga gjuhët t'i njihet privilegji i gjuhës «zyrtare».

Socialdemokracia kërkon që ndarjet e vjetra administrative të Rusisë, që kanë bërë çifligarët-bujkrobërorë dhe funksionarët e shtetit absolutist bujkrobëror, të zëvendësohen me ndarje të bazuara në kërkesat e jetës ekonomike të sotme dhe mundësisht në përputhje me përbërjen kombëtare të popullsisë.

Të gjitha krahinat e shtetit, që dallohen nga jeta ose përbërja kombëtare e popullsisë, duhet të kenë një vetëqeverisje dhe autonomi sa më të gjerë në institucionet e ngritura mbi bazën e votës së përgjithshme, të barabartë dhe të fshehtë.

6. Socialdemokracia kërkon të botohet një ligj për gjithë shtetin, i cili të mbrojtë të drejtat e çdo pakice kombëtare në çdo pjesë të shtetit. Në bazë të

këtij ligji çdo masë, me anë të së cilës shumica kombëtare do të orvatej t'i siguronte vetes një privilegj kombëtar ose t'i kufizonte të drejtat e një pakice kombëtare (në fushën e arsimit, të përdorimit të kësaj ose asaj gjuhe, në çështjet e buxhetit etj.), duhet të shpallet e pavlefshme, kurse zbatimi i një mase të tillë të ndalohet dhe të dënohet me ligj.

7. Socialdemokracia mban një qëndrim negativ ndaj parullës së «autonomisë kombëtare-kulturore» (ose thjesht «kombëtare») dhe ndaj projekteve për realizimin e një autonomie të tillë, sepse kjo parullë (1) është në kundërshtim të hapët me internacionalizmin e luftës së klasës të proletarietit, — (2) bën më të lehtë që proletariati dhe masat punonjëse të bien në sferën e ndikimit të ideve të nacionalizmit borgjez, — (3) mund ta largojë vëmendjen nga detyra e transformimeve demokratike konsekuente në gjithë shtetin, të cilat mund të sigurojnë (në atë masë që është përgjithësisht e mundshme në kapitalizëm) paqen kombëtare.

...Parullat e demokratizmit konsekuent *shkrijnë* në një bashkim të vetëm proletariatin dhe demokracinë pararojë të të gjitha kombeve (elementët të cilëve u duhet jo veçimi, por bashkimi i elementëve demokratë të kombeve në të gjitha çështjet, duke përfshirë edhe çështjen e shkollës), — kurse parulla e autonomisë kombëtare-kulturore e *përçan* proletariatin e kombeve të ndryshme, duke e lidhur atë me elementët reaksionarë dhe borgjezë të kombeve të ndryshme.

Parullat e demokratizmit konsekuent shikohen me armiqësi të papajtueshme edhe nga reaksionarët, edhe nga borgjezia kundërrevolucionare e të gjitha kombeve, — kurse parulla e autonomisë kombëtare-kulturore është plotësisht e pranueshme për reaksionarët dhe borgjezët kundërrevolucionarë të disa kombeve.

8. Të gjitha kushtet ekonomike dhe politike të Rusisë në tërësinë e tyre kërkojnë në këtë mënyrë që socialdemokracia të luftojë medoemos për *bashkimin* e

punëtorëve të të gjitha kombësive në të gjitha organizatat proletare pa përjashtim (politike, profesionale, kooperativiste, kulturore etj. etj.). Jo federatë në ndërtimin e partisë dhe as formim grupesh socialdemokrate kombëtare, por bashkim i proletarëve të të gjitha kombeve të një vendi duke zhvilluar propagandën dhe agjitacionin në të gjitha gjuhët e proletariatit të vendit, duke luftuar së bashku punëtorët e të gjitha kombeve kundër çdo privilegji kombëtar, duke siguruar autonominë e organizatave lokale dhe krahinore të Partisë.

9. Përvoja më shumë se dhjetëvjeçare e historisë së PPSDR-së i vërteton tezat e mësipërme. Partia lindi më 1898, si parti «e Ruisë», d.m.th. parti e proletariatit të të gjitha kombësive të Ruisë. Partia mbeti parti «e Ruisë» kur Bundi⁵ më 1903 doli nga partia, pasi kongresi i partisë nuk e pranoi kërkesën e Bunit për ta njohur atë si të vetmin përfaqësues të proletariatit çifut. Në vjetët 1906-1907 jeta tregoi më së miri se kjo kërkesë ishte e pathemeltë dhe një varg i tërë proletarësh çifutë vazhduan në mënyrë të harmonishme punën e përbashkët socialdemokrate në një varg organizatash lokale, dhe Bundi u kthye në parti. Kongresi i Stokholmit (1906) bashkoi edhe socialdemokratët polonezë edhe socialdemokratët letonë që qëndronin mbi bazat e autonomisë territoriale, por kongresi nuk e pranoi parimin e federatës dhe kërkoi që socialdemokratët e të gjitha kombësive të bashkoeshin në organizatat lokale. Ky parim u zbatua për shumë vjet në Kaukaz, u zbatua në Varshavë (punëtorët polonezë dhe ushtarët rusë), në Vilno (punëtorët polonezë, letonë, çifutë, lituanë), në Rigë, në të tria qendrat e fundit u zbatua kundër Bunit që ishte veçuar në mënyrë separatiste. Në dhjetor 1908 PPSDR-ja në konferencën e saj pranoi një rezolucion të posaçëm, ku ripohohej kërkesa që punëtorët e të gjitha kombësive të bashkohen jo mbi bazën e parimit të federatës. Moszbatimi përçarës i vendimit të partisë nga

ana e separatistëve bundistë çoi në dështimin e gjithë kësaj «federate të tipit më të keq»⁶ — i afroi separatistët bundistë me separatistët çekë dhe anasjelltas (shih Kosovskin në «Nasha Zarja» dhe organin e separatistëve çekë, «Der čechoslawische Socialdemokrat»*, 1913, Nr. 3, për Kosovskin) — dhe, më në fund, në konferencën e gushtit (1912) të likuidatorëve bëri që separatistët bundistë dhe likuidatorët bashkë me një pjesë të likuidatorëve kaukazianë të orvateshin të futnin *tinëzisht* në programin e partisë «autonominë kombëtaro-kulturore» *pa e mbrojtur atë në thelb!*

Punëtorët socialdemokratë revolucionarë edhe të Polonisë, edhe të Letonisë, edhe të Kaukazit vazhdojnë të qëndrojnë, si më parë, në pikëpamjen e autonomisë territoriale dhe të *bashkimit* të punëtorëve socialdemokratë të të gjitha kombeve. Shkëputja likuidatoriste e Bundit dhe aleanca e Bundit me josocialdemokratët në Varshavë vuri në rendin e ditës përpara gjithë socialdemokratëve gjithë çështjen kombëtare, edhe për sa i përket anës së saj teorike, edhe për sa i përket ndërtimit të partisë.

Zgjidhjet me karakter kompromisi u prishën pikërisht nga ata që i kishin zbatuar kundër vullnetit të partisë, dhe kërkesa për bashkimin e punëtorëve socialdemokratë të të gjitha kombësive buçet më e fortë se kurrë.

10. Nacionalizmi agresiv brutal dhe ultrareaksionar i monarkisë cariste, pastaj gjallërimi i nacionalizmit *borgjez* — edhe rus (zoti Struve, «Russkaja Mollva», «progresistët» etj.), edhe ukrainas, edhe polonez (antisemitizmi i «demokracisë» popullore⁷), edhe gjeorgjian, edhe armen etj., — të gjitha këto kërkojnë me këmbëngulje të vecantë nga organizatat socialdemokrate në të katër anët e Ruisë që t'i kushtojnë vëmendje më të madhe se më parë çështjes kombëtare dhe të përpunojnë një zgjidhje marksiste konseku-

* — «Socialdemokrati çekoslovak». *Red.*

ente të saj në frymën e internacionalizmit konsekuent dhe të bashkimit të proletarëve të të gjitha kombeve.

(β) Përjetësimi i ndarjes kombëtare dhe përhapja e nacionalizmit të stërholluar — bashkimi, afrimi, përzierja e kombeve dhe shprehja e parimeve të një kulture *tjetër*, të një kulture internacionaliste.

(γ) Dëshpërimi i borgjezit të vogël (lufta pa shpresë kundër grindjeve kombëtare) dhe frika e transformimeve demokratike radikale dhe e lëvizjes socialiste — vetëm transformimet demokratike rrënjësore mund të sjellin paqen kombëtare në shtetet kapitaliste dhe vetëm socializmi mund t'u japë fund grindjeve kombëtare.

(δ) Kuritë kombëtare në fushën e arsimit⁸.

(ε) Çifutët.

Shkruar në qershor
1913

Veprat, bot. shqip, vëll. 19,
f. 267-271, 274-276, 276-277

Nga artikulli:

«PËR PROGRAMIN KOMBËTAR TË PPSDR-së»

Në çështjen kombëtare «Iskra» e vjetër, e cila më 1901-1903 punoi për përgatitjen e programit të PPSDR-së dhe e përgatiti krahas me argumentimin e parë dhe rrënjësor të marksizmit në teorinë dhe praktikën e lëvizjes punëtore të Ruisisë, ka luftuar, ashtu si edhe në çështjet e tjera, kundër oportunitizmit mikroborgjez. Ai është shprehur në tendencat ose lëkundjet nacionaliste të Bundit në radhë të parë. Kundër nacionalizmit të Bundit «Iskra» e vjetër ka luftuar me këmbëngulje, dhe ta harrosh këtë luftë do të thotë të veprosh si një harraq, do të thotë ta shkëputësh veten nga baza historike dhe ideologjike e gjithë lëvizjes punëtore socialdemokrate të Ruisisë.

Nga ana tjetër, kur programi i PPSDR-së u miratua përfundimisht në gusht 1903, në Kongresin e dytë u zhvillua një luftë për të cilën nuk flitet në protokollet e kongresit, sepse ajo kufizohej në *komisionin e programit*, të cilin e vizitonin pothuajse gjithë pjesëmarrësit e kongresit, — lufta kundër orvatjes

së pagoditur të disa socialdemokratëve polonezë për ta vënë në dyshim «të drejtën e kombeve për vetëvendosje», d.m.th. për të rënë në oportunizëm dhe nacionalizëm nga ana krejt e kundërt.

Dhe sot, pas dhjetë vjetësh, lufta zhvillohet po në ato dy drejtime themelore, dhe kjo provon gjithashtu lidhjen e thellë ndërmjet kësaj lufte dhe të gjitha kushteve objektive të çështjes kombëtare në Rusi.

...Por ka një rast kur marksistët e kanë për detyrë, në qoftë se ata nuk duan ta tradhtojnë demokracinë dhe proletariatin, të mbrojnë një kërkesë të posaçme në çështjen kombëtare, dhe pikërisht: të drejtën e kombeve për vetëvendosje (§ 9 i programit të PPSDR-së), d.m.th. të drejtën për shpëtim politik. Rezolucioni i mbledhjes e shpjegon dhe e argumenton në mënyrë aq të hollësishme këtë kërkesë, saqë nuk lë shteg për asnjë keqkuptim.

Prandaj do të ndalemi vetëm shkurtimisht te karakterizimi i atyre vërejtjeve çuditërisht vulgare dhe oportuniste që bëhen kundër kësaj pike të programit. Do të vërejmë me këtë rast se gjatë 10 vjetëve që ekziston programi asnjë pjesë e PPSDR-së, asnjë organizatë kombëtare, asnjë konferencë krahinore, asnjë komitet lokal, asnjë delegat në kongres ose konferencë nuk është munduar të ngrejë çështjen e ndryshimit ose të heqjes së § 9!!

Kjo duhet pasur parasysh. Kjo na tregon menjëherë nëse ka qoftë edhe një thërrime serioziteti dhe partishmërie në vërejtjet që bëhen kundër kësaj pike.

Ja z. Semkovski nga gazeta e likuidatorëve. Ai, me mendjelehtësinë e një njeriu që e ka likuiduar partinë, deklaroi: «për disa arsye ne nuk bashkohemi me propozimin e Roza Luksemburgut që të hiqet fare § 9 nga programi» (Nr. 71 i «Novaja Raboçaja Gazetës»).

Arsye të fshehta! Dhe si të mos mbahen «të fshehta» kur tregohet një injorancë e tillë për historinë e programit tonë? Si të mos mbahen «të fshehta» kur po ai zoti Semkovski, që s'e ka shokun për mendje-

lehtësinë e tij (ç'rëndësi ka partia dhe programi!), bën përjashtim për Finlandën?

«Si t'ia bëjmë... në qoftë se proletariati polonez do të dojë të bëjë në kuadrin e një shteti të vetëm një luftë të përbashkët me tërë proletariatin rus, kurse klasat reaksionare të shoqërisë poloneze, përkundrazi, do të duan ta ndajnë Poloninë nga Rusia dhe do të fitojnë me anë të një referendumi (duke e pyetur gjithë popullsinë) shumicën e votave në dobi të tyre: a do të duhet në këtë rast që ne, socialdemokratët rusë, të votojmë në parlamentin qendror bashkë me shokët tanë polonezë *kundër* shkëputjes apo, për të mos e shkelur «të drejtën për vetëvendosje», të votojmë *për* shkëputjen?»

Si t'ia bëjmë, me të vërtetë, kur bëhen pyetje kaq naive, kaq tmerrsisht të ngatërruara?

E drejta për vetëvendosje, shumë i nderuari zoti likuidator, është zgjidhja e çështjes pikërisht jo nga parlamenti qendror, por nga parlamenti, nga sejmii, me anë të referendumit të *pakicës që shkëputet*. Kur Norvegjia u shkëput (më 1905) nga Suedia, këtë e vendosi *vetëm* Norvegjia (e cila është dy herë më e vogël se Suedia).

Edhe një fëmijë e sheh se z. Semkovski ngatërrohet tmerrsisht.

«E drejta për vetëvendosje» tregon ekzistencën e një rendi demokratik të *tillë*, ku jo vetëm të ketë demokraci në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë të *mos mund të ketë një zgjidhje jodemokratike* të çështjes së shkëputjes. Demokracia, në përgjithësi, mund të ekzistojë krahas nacionalizmit agresiv dhe shtypës. Proletariati kërkon një demokraci, e cila ta *përjashtojë* mbajtjen me dhunë të një kombi brenda kufijve të një shteti. Prandaj, «që të mos shkelet e drejta për vetëvendosje», ne duhet jo «të votojmë për shkëputjen», siç mendon i zgjuari z. Semkovski, por të

votojmë që krahinës që dëshiron të shkëputet t'i jepet mundësia ta zgjidhë vetë këtë çështje.

Mund të mendohet se edhe me aftësitë mendore të z. Semkovski nuk është vështirë ta kuptosh se «e drejta për ndarje» nuk kërkon që të votohet për ndarjen! Por i tillë është fati i atyre që kritikojnë § 9: ata harrojnë edhe abecenë e logjikës.

Kur Norvegjia u nda nga Suedia, proletariati suedez, në qoftë se ai nuk donte t'u shkonte pas nacionalistëve mikroborgjezë, e kishte për detyrë të votonte dhe të bënte agjitacion kundër aneksimit të Norvegjisë me dhunë, gjë që kërkonin priftërinjtë dhe gifligarët e Suedisë. Kjo është e qartë dhe nuk paraqet ndonjë vështirësi për t'u kuptuar. Demokracia nacionaliste suedeze mund të mos bënte atë agjitacion që e kërkon nga proletariati i kombeve sunduese shtypëse parimi i së drejtës për vetëvendosje.

«Si t'ia bëjmë, në qoftë se reaksionarët janë në shumicë» — pyet z. Semkovski. Kjo pyetje është e denjë për një gjimnazist të klasës së 3-të. E si t'ia bëjmë me kushtetutën ruse, në qoftë se votimi demokratik do t'ua japë reaksionarëve shumicën? Zoti Semkovski bën një pyetje të kotë, të zbrazët, që nuk ka lidhje me çështjen — një nga ato pyetje, për të cilat thuhet se shtatë budallenj mund të bëjnë më shumë pyetje sesa përgjigjet që mund të japin 70 të mençëm.

Kur në kushtet e votimeve demokratike reaksionarët përbëjnë shumicën, atëherë përgjithësisht ndodh dhe mund të ndodhë një nga të dyja: ose vendimi i reaksionarëve vihet në jetë, dhe pasojat e dëmshme të tij i largojnë pak a shumë shpejt masat duke i hedhur në anën e demokracisë kundër reaksionarëve; ose konflikti ndërmjet demokracisë dhe reaksionarëve zgjidhet me rrugën e luftës civile ose të një lufte tjetër, e cila është e mundshme (edhe njerëzit si Semkovski, me siguri, do ta kenë dëgjuar këtë) edhe në kushtet e demokracisë.

Njohja e së drejtës për vetëvendosje «i shërben» «nacionalizmit borgjez më të tërbuar», na siguron z. Semkovski. Këto janë marrëzi fëmijërore, sepse njohja e kësaj së drejte nuk e përjashton aspak as propagandën as agjitacionin kundër shkëputjes, nuk përjashton as demaskimin e nacionalizmit borgjez. Nga ana tjetër, është krejt e padiskutueshme se mohimi i së drejtës për shkëputje «i shërben» nacionalizmit më të tërbuar ultrareaksionar rusomadhi!

Pikërisht këtu qëndron thelbi i gabimit qesharak të Roza Luksemburgut, për të cilin atë e kanë tallur me kohë si në socialdemokracinë gjermane ashtu edhe në socialdemokracinë ruse (gusht 1903), sepse nga frika se mos i shërbejnë nacionalizmit borgjez të kombeve të shtypura njerëzit i shërbejnë jo vetëm nacionalizmit borgjez, por edhe nacionalizmit ultrareaksionar të kombit shtypës.

Sikur z. Semkovski të mos ishte aq naiv në çështjet e historisë së partisë dhe të programit të partisë, ai do ta kishte kuptuar detyrën e tij për t'i hedhur poshtë fjalët e Plehanovit, i cili këtu e 11 vjet më parë në revistën «Zarja», duke mbrojtur projektprogramin (që u bë program që prej vitit 1903) e PPSDR-së, e nënvizoi në mënyrë të veçantë (f. 38) njohjen e së drejtës për vetëvendosje dhe për të shkruante:

«Kjo kërkesë, që nuk është e detyrueshme për demokratët borgjezë as në teori, është e detyrueshme për ne, si socialdemokratë. Sikur ne ta harronim ose të mos guxonim ta formulonim atë, duke pasur frikë se mos prekim paragjykimet kombëtare të bashkatdhetarëve tanë të fisit rus, atëherë kushtrimi luftarak i socialdemokracisë ndërkombëtare: «proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!» do të ishte një gënjeshtër e turpshme».

Që në kohën e revistës «Zarja» Plehanovi formulon argumentin themelor që u zhvillua në mënyrë të

hollësishme në rezolucionin e mbledhjes, — argument të cilin gjatë 11 vjetëve zotërinjtë Semkovskë nuk kanë dashur ta marrin parasysh. Në Rusi 43% të popullsisë janë rusë, por nacionalizmi rusomadh sundon mbi 57% të popullsisë dhe shtyp të gjitha kombet. Te ne me nacional-reaksionarët janë bashkuar edhe nacional-liberalët (Struve e K°, progresistët etj.) dhe kanë filluar të duken «dallëndyshet e para» të nacional-demokratizmit (kujtoni thirrjen e z. Peshehonov në gusht të 1906-s për të treguar kujdes në lidhje me paragjykimet nacionaliste të muzhikut) .

Në Rusi vetëm likuidatorët e quajnë të përfunduar revolucionin demokratik-borgjez, kurse shoqëruese të një revolucioni të tillë kudo në botë kanë qenë dhe janë lëvizjet kombëtare. Në Rusi pikërisht në një varg të tërë krahinash periferike ne shohim kombe të shtypura, të cilat në shtetet fqinje gëzojnë një liri më të madhe. Carizmi është më reaksionar se shtetet fqinje, duke qenë pengesa më e madhe për zhvillimin e lirë ekonomik dhe duke ndezur me të gjitha forcat nacionalizmin rusomadh. Sigurisht, për një marksist, duke qenë të barabarta të gjitha kushtet e tjera, janë gjithnjë më të preferueshme shtetet e mëdha sesa të voglat. Por është qesharake dhe reaksionare qoftë edhe vetëm të mendosh se kushtet në kuadrin e monarkisë cariste janë baras me kushtet e të gjitha vendeve evropiane dhe të shumicës së vendeve aziatike.

Mohimi i së drejtës së kombeve për vetëvendosje në Rusinë e sotme është prandaj oportunizëm i padiskutueshëm dhe mohim i luftës kundër nacionalizmit ultrareaksionar rusomadh, që deri sot është i gjithëfuqishëm.

SHËNIME KRITIKE PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Që çështja kombëtare ka zënë sot një vend të rëndësishëm në vargun e çështjeve të tjera të jetës shoqërore të Rosisë, kjo është e qartë. Edhe nacionalizmi luftarak i reaksionit, edhe kalimi i liberalizmit kundërrevolucionar, borgjez në nacionalizëm (sidomos rus, e pastaj edhe polonez, çifut, ukrainas etj.), edhe, më në fund, shtimi i lëkundjeve nacionaliste në radhët e socialdemokracive të ndryshme «kombëtare» (d.m.th. joruse), që ka arritur deri në shkeljen e programit të partisë, — të gjitha këto na detyrojnë patjetër t'i kushtojmë çështjes kombëtare një vëmendje më të madhe se përpara.

Ky artikull ka një qëllim të caktuar: t'i analizojë në lidhjen e tyre të përgjithshme pikërisht këto lëkundje programatike të marksistëve dhe të të ashtuquajturve marksistë në çështjen kombëtare. Në Nr. 29 të gazetës «Severnaja Pravda» (5 shtator 1913 «Liberalët dhe demokratët për çështjen e gjuhëve») pata rast të flisja për oportunizmin e liberalëve në çështjen kombëtare; këtë artikull e kritikoi gazeta oportuniste çifute «Cajt» me një artikull të z. F. Libman. Nga ana tjetër, një kritikë të programit të marksistëve rusë për çështjen kombëtare e botoi edhe oportunisti

ukrainas z. Lev Jurkeviç («Dzvin». 1913, Nr. Nr. 7-8). Që të dy këta publicistë kanë prekur aq shumë çështje, saqë për t'u dhënë një përgjigje duhet të prekim anët më të ndryshme të temës sonë. Dhe, mendoj unë, më e mira do të jetë të fillojmë duke rishtypur artikullin e botuar në gazetën «Severnaja Pravda».

1. LIBERALËT DHE DEMOKRATËT PËR ÇËSHTJEN E GJUHËVE

Gazetat kanë folur më shumë se një herë për raportin e paraqitur nga mëkëmbësi i Kaukazit që shquhet jo për frymën e tij ultrareaksionare, por për një «liberalizëm» të druajtur. Ndër të tjera, mëkëmbësi shprehet kundër rusifikimit artificial, d.m.th. kundër rusifikimit të kombësive joruse. Në Kaukaz përfaqësuesit e kombësive joruse përpiqen vetë t'u mësojnë fëmijëve rusishten, për shembull, në shkollat kishtare armene, ku mësimi i gjuhës ruse nuk është i detyrueshëm.

Duke vënë në dukje këtë, njëra nga gazetatat liberale më të përhapura në Rusi — «Russkoe Silovo» (Nr. 198) — nxjerr përfundimin e drejtë se qëndrimi armiqësor ndaj gjuhës ruse në Rusi «është vetëm e vetëm» pasojë e përhapjes «artificiale» (do të duhej thënë: me dhunë) të gjuhës ruse.

«S'ka pse të shqetësohemi për fatin e gjuhës ruse. Ajo vetë do të arrijë të përhapet në gjithë Rusinë» — shkruan gazeta. Dhe kjo është e drejtë, sepse nevojat e shkëmbimit ekonomik do t'i detyrojnë gjithnjë kombësitë që jetojnë në një shtet (përderisa ato do të duan të jetojnë së bashku) të mësojnë gjuhën e shumicës. Sa më demokratik do të jetë rendi i Rusisë, aq më me forcë, aq më shpejt dhe në shkallë më të gjerë do të

zhvillohet kapitalizmi, aq më tepër nevojat e pashmangshme të shkëmbimit ekonomik do t'i detyrojnë kombësitë e ndryshme të mësojnë gjuhën që është më e përshtatshme për marrëdhëniet tregtare të përbashkëta.

Por gazeta liberale nxiton t'i hedhë poshtë fjalët që tha ajo vetë dhe të provojë qëndrimin e vet jokonsekuent që e karakterizon si gazetë liberale që është.

«Është vështirë — shkruan ajo — që të ketë ndonjë njeri, goftë edhe nga kundërshtarët e rusifikimit, që të mohojë se në një shtet kaq të madh si Rusia duhet të ketë një gjuhë të vetme zyrtare dhe se një gjuhë e tillë... mund të jetë vetëm rusishtja».

Çlogjikë e mbrapshtë! Zvicra e vogël asgjë nuk humbet, por fiton ngaqë atje nuk ka një gjuhë zyrtare të vetme, por ka plot tri gjuhë: gjermanishten, frëngjishten dhe italishten. Në Zvicër 70% e popullsisë janë gjermanë (në Rusi 43% janë rusë), 22% janë francezë (në Rusi 17% janë ukrainas), 7% janë italianë (në Rusi 6% janë polakë dhe 4,5% bjellorusë). Nëse italianët në Zvicër shumë herë flasin frëngjisht në parlamentin e përbashkët, ata nuk e bëjnë këtë sepse kanë frikë nga kërbaci i ndonjë ligji të egër policor (një ligj të tillë në Zvicër nuk ka), por vetëm e vetëm sepse qytetarët e qytetëruar të një shteti demokratik duan vetë të përdorin një gjuhë që është e kuptueshme për shumicën. Frëngjishtja nuk ngjall urrejtjen e italianëve, sepse kjo është gjuhë e një kombi të lirë, të qytetëruar, gjuhë që nuk është imponuar me masa të shëmtuara policore.

Pse atëherë Rusia «e madhe», me një larmi shumë më të theksuar, tmerrsisht e prapambetur, duhet ta frenojë zhvillimin e vet, duke i ruajtur çfarëdo privilegji njëres nga gjuhët? A nuk do të duhej të ishte e kundërta, zotërinj liberalë? A nuk do të duhej që

Rusia, në qoftë se ajo do që ta arrijë Evropën, t'u japë fund të gjitha privilegjeve të çdo lloji sa më shpejt, në mënyrë sa më të plotë dhe sa më të vendosur?

Në qoftë se do të zhduket çdo privilegj, në qoftë se do të heqim dorë nga imponimi i një gjuhe, atëherë të gjithë sllavët do të mësohen shumë lehtë dhe shpejt ta kuptojnë njëri-tjetrin dhe nuk do të tremben nga ideja «e tmerrshme» se në një parlament të përbashkët do të dëgjoen fjalime në gjuhë të ndryshme. Vetë nevojat e shkëmbimit ekonomik *do ta përcaktojnë* atë gjuhë të vendit, nga njohja e së cilës do të ketë *përfitim* shumica në marrëdhëniet tregtare. Dhe sa më vullnetar të jetë pranimi i kësaj gjuhe nga kombet e ndryshme, aq më i vendosur do të jetë ky përcaktim, ai do të bëhet aq më shpejt dhe në shkallë aq më të gjerë, sa më konsekuent do të jetë demokratizmi dhe sa më i shpejtë do të jetë në lidhje me këtë zhvillimi i kapitalizmit.

Edhe çështjen e gjuhëve, ashtu si çdo çështje politike, liberalët e shikojnë si xhambazë me dy faqe; të cilët njërin dorë ia zgjatin (haptazi) demokracisë, e tjetrën (prapa shpine) bujkrobëruesve dhe policëve. Ne jemi kundër privilegjeve — ulërin liberali, e prapa shpinës bën pazarllëqe me bujkrobëruesit për t'i siguruar vetes herë këtë, herë atë privilegj.

I tillë është çdo nacionalizëm borgjez-liberal — jo vetëm nacionalizmi rus (ai është më i keqi nga të gjithë për shkak të karakterit të tij të egër dhe të lidhjeve që ka me zotërinjtë Purishkeviçë), por edhe nacionalizmi polonez, çifut, ukrainas, gjeorgjian dhe çdo nacionalizëm tjetër. Borgjezia e të gjitha kombeve edhe në Austri edhe në Rusi nën parullën e «kulturës kombëtare» në praktikë punon për t'i përçarë punëtorët, për ta dobësuar demokracinë, për të përfunduar pazarllëqe prej tregtari të ulët me bujkrobëruesit në lidhje me shitjen e të drejtave të popullit dhe të lirisë së popullit.

Parulla e demokracisë punëtore nuk është «kultu-

rë kombëtare», por kultura internacionale e demokracizimit dhe e lëvizjes punëtore botërore. Le ta gënjejë popullin borgjezia me lloj-lloj programesh kombëtare «pozitive». Punëtori i ndërgjegjshëm do t'i përgjigjet: ka vetëm një zgjidhje të çështjes kombëtare (në masën që në përgjithësi ajo mund të zgjidhet në botën e kapitalizmit, në botën e fitimeve, të grindjeve dhe të shfrytëzimit) dhe kjo zgjidhje është demokracizimi konsekuent.

Prova: Zvicra në Evropën Perëndimore — vend me kulturë të vjetër, dhe Finlanda në Evropën Lindore — vend me kulturë të re.

Programi kombëtar i demokracisë punëtore: absolutisht asnjë privilegj për asnjë komb, për asnjë gjuhë; të zgjidhet çështja e vetëvendosjes politike të kombeve, d.m.th. e shkëputjes së tyre shtetërore, me rrugë krejt të lirë, demokratike; të botohet një ligj për gjithë shtetin, në bazë të të cilit çdo masë (nga zemst votë, nga organet e qyteteve, të organeve komunale etj. etj.) që parashikon në çfarëdo fushe privilegje për njëri nga kombësitë, që cenon barazinë e kombësive ose të drejtat e pakicës kombëtare, të shpallet e paligjshme dhe e pavlefshme — dhe t'i njihet e drejta çdo qytetari të shtetit të kërkojë anulimin e një mase të tillë, si antikushetuese, dhe ndëshkimin penal të atyre që do ta vënë në jetë.

Përballë grindjeve kombëtare të partive borgjeze të ndryshme në çështjen e gjuhës etj. demokracia punëtore vë kërkesën e mëposhtme: të arrihet uniteti absolut dhe bashkimi i plotë i punëtorëve të të gjitha kombësive në të gjitha organizatat punëtore, profesionale, kooperativiste, kulturore, të konsumit dhe në çdo organizatë tjetër, dhe kjo si kundërpeshë për çdo nacionalizëm borgjez. Vetëm një unitet dhe bashkim i tillë mund ta mbrojë demokracinë, mund të mbrojë interesat e punëtorëve kundër kapitalit, — i cili është bërë dhe po bëhet gjithnjë më shumë internacional, — të mbrojë interesat e zhvillimit të njerëzimit drejt një

rendi të ri të jetës, që të përjashtojë çdo privilegj dhe çdo shfrytëzim.

2. «KULTURA KOMBËTARE»

Siç e sheh edhe lexuesi, artikulli i botuar në gazetën «Severnaja Pravda», duke marrë një nga shembujt e shumtë, pikërisht çështjen e gjuhës zyrtare, shpjegon karakterin jokonsekuent dhe oportunizmin e borgjezisë liberale, e cila në çështjen kombëtare ua zgjat dorën bujkrobëruesve dhe policëve. Çdo njeri e kupton se përveç çështjes së gjuhës zyrtare borgjezia liberale vepron në mënyrë po aq tradhtare, hipokrite dhe të marrë (qoftë edhe nga pikëpamja e interesave të liberalizmit) për një varg të tërë çështjesh të tjera të njëllota.

Cili është përfundimi? Përfundimi është se çdo nacionalizëm borgjez liberal sjell korrumpimin më të madh në radhët e punëtorëve, i shkakton dëmin më të madh çështjes së lirisë dhe çështjes së luftës proletare të klasës. Dhe kjo është edhe më e rrezikshme, sepse tendenca borgjeze (dhe borgjeze-bujkrobërore) *maskohet* me parullën e «kulturës kombëtare». Duke u fshehur prapa kulturës kombëtare — ruse, poloneze, çifute, ukrainase etj. — qindëshet e zeza dhe klerikalët, pastaj edhe borgjezët e të gjitha kombeve, bëjnë punët e tyre të fëlliqura dhe reaksionare.

Ky është realiteti i jetës kombëtare të sotme, në qoftë se e shikojmë atë nga pozitat marksiste, d.m.th. nga pikëpamja e luftës së klasave, në qoftë se i krahasojmë parullat me interesat dhe me politikën e klasave, e jo me «parimet e përgjithshme», me deklamacionet dhe frazat e zbraçta.

Parulla e kulturës kombëtare është një gënjeshtër

e borgjezisë (dhe shumë herë edhe e klerikëve dhe e qindësheve të zeza). Parulla jonë është kultura ndër-kombëtare e demokracisë dhe e lëvizjes punëtore botërore.

Këtu bundisti z. Libman hidhet në betejë dhe më dërrmon me këtë tiradë asgjësuese:

«Kushdo që e njih pak a shumë çështjen kombëtare, e di se kultura ndërkombëtare nuk është një kulturë jokombëtare (kulturë pa formë kombëtare); kultura jokombëtare, e cila nuk duhet të jetë as ruse as çifute as poloneze, por vetëm një kulturë e kulluar, është absurditet; idetë ndërkombëtare mund të bëhen pikërisht të afërta për klasën punëtore vetëm kur ato i përshtaten gjuhës në të cilën flet punëtori, si dhe kushteve kombëtare konkrete në të cilat ai jeton; punëtori nuk duhet të jetë indiferent ndaj gjendjes dhe zhvillimit të kulturës së tij kombëtare, sepse nëpërmjet saj dhe vetëm nëpërmjet saj ai fiton mundësinë për të marrë pjesë në «kulturën ndërkombëtare të demokratizmit dhe të lëvizjes punëtore botërore». Kjo dihet prej kohësh, por V.I. as që do t'ia dijë për këto...».

Analizojeni mirë këtë arsyetim bundist tipik, i cili përpiqet, vëreni re mirë këtë, ta hedhë poshtë tezën marksiste të formuluar prej meje. Me pamjen e një njeriu jashtëzakonisht të sigurt në vetveten, si njeri «që e njih çështjen kombëtare», ky bundist na paraqet si të vërteta «të njohura prej kohësh» pikëpamjet e zakonshme borgjeze.

Po, i nderuari bundist, kultura ndërkombëtare nuk është jokombëtare. Asnjëri nuk e ka thënë një gjë të tillë. Asnjëri nuk ka folur për kulturë «të kulluar», për kulturë që nuk është as poloneze as çifute as ruse etj., kështu që koleksioni i fjalëve të zbrazëta që na keni radhitur nuk është veçse një orvatje për ta larguar vëmendjen e lexuesit dhe për ta errësuar thelbin e çështjes me zhurmën e fjalëve.

Në çdo kulturë kombëtare ka, qoftë edhe të pashvilluara, *elemente* të kulturës demokratike dhe socialiste, sepse në çdo komb ka një masë punonjëse dhe të shfrytëzuar, kushtet e jetës të së cilës lindin në mënyrë të pashmangshme ideologjinë demokratike dhe socialiste. Por çdo komb ka gjithashtu edhe kulturën borgjeze (dhe në shumicën e kombeve ka edhe një kulturë ultrareaksionare e klerikale) — dhe jo vetëm në trajtën e «elementeve», por si kulturë *sunduese*. Prandaj «kultura kombëtare» në përgjithësi është kultura e çifligarëve, e priftërinjve dhe e borgjezisë. Këtë të vërtetë themelore, elementare për një marksist, bundisti e la në hije, «e mbuloi» me koleksionin e fjalëve të tij, d.m.th. në vend që të zbulonte dhe të hidhte dritë mbi greminën klasore, ai mundohet t'ia fshehë atë lexuesit. *Praktikisht* bundisti veprimi si një borgjez, gjithë interesi i të cilit kërkon që të përhapet besimi në një kulturë kombëtare jashtë klasave.

Duke hedhur parullën e «kulturës ndërkombëtare të demokratizmit dhe të lëvizjes punëtore botërore», nga çdo kulturë kombëtare ne marrim vetëm elementet e saj demokratike dhe socialiste, i marrin ato vetëm e vetëm si elemente që qëndrojnë përballë kulturës borgjeze, nacionalizmit borgjez të çdo kombi. Asnjë demokrat, dhe aq më tepër asnjë marksist, nuk e mohon barazinë e gjuhëve ose domosdoshmërinë për të bërë polemikë në gjuhën amtare kundër borgjezisë «së vendit», për të propaganduar idetë antiklerikale ose antiborgjeze në radhët e fshatarësisë dhe të borgjezisë së vogël «të vendit» — është e tepërt të flasim për të gjitha këto, këto të vërteta të padiskutueshme bundisti i përdor për të fshehur atë që është e diskutueshme, d.m.th. thelbin e vërtetë të çështjes.

Çështja është të dimë nëse është e lejueshme për marksistët të hedhin, haptazi ose tërthorazi, parullën e kulturës kombëtare, apo nëse është e domosdoshme që kundër saj të propagandojnë në të gjitha gjuhët, «duke ua përshtatur» të gjitha veçorive lokale

dhe kombëtare, parullën e *internacionalizmit* të punëtorëve.

Kuptimi i parullës së «kulturës kombëtare» nuk përcaktohet nga premtimet ose dëshirat e mira të një intelektualit çfarëdo për ta «interpretuar» këtë parullë «në kuptimin e përhapjes nëpërmjet saj të kulturës ndërkombëtare». Ta shikosh çështjen në këtë mënyrë do të thotë të biesh në një subjektivizëm fëmijëror. Kuptimi i parullës së kulturës kombëtare përcaktohet nga raporti objektiv i të gjitha klasave të një vendi të caktuar dhe të të gjitha vendeve të botës. Kultura kombëtare e borgjezisë është një fakt (veç asaj, e përsëris, borgjezia kudo bie në marrëveshje me çifligarët dhe priftërinjtë). Nacionalizmi borgjez luftarak, që i matufos, i trulllos dhe i ndan punëtorët me qëllim që t'i lidhë pas qerres së borgjezisë, — ja fakti themelor i ditëve tona.

Kush do që t'i shërbejë proletariatit, ai duhet t'i bashkojë punëtorët e të gjitha kombeve duke luftuar pa u lodhur kundër nacionalizmit borgjez si të vendit «të tij», ashtu edhe të huaj. Kush mbron parullën e kulturës kombëtare e ka vendin në radhët e nacionalistëve mikroborgjezë, e jo në radhët e marksistëve.

Të marrim një shembull konkret. A mund ta pranojë një marksist rus parullën e kulturës kombëtare ruse? Jo. Cilindo që do ta pranonte këtë duhet ta radhitim ndër nacionalistët, e jo ndër marksistët. Detyra jonë është të luftojmë kundër kulturës kombëtare borgjeze, ultrareaksionare, sunduese të rusëve, duke zhvilluar vetëm e vetëm në frymën internacionaliste dhe në aleancën më të ngushtë me punëtorët e vendeve të tjera ata filiza që ekzistojnë edhe në historinë tonë të lëvizjes demokratike dhe punëtore. Të luftosh kundër çifligarëve dhe borgjezëve të tu rusë, kundër «kulturës» së tyre, në emër të internacionalizmit, të luftosh «duke iu përshtatur» veçorive të Purishkeviçëve dhe të Struves, — ja detyra jote, e jo të propagandosh, jo të pranosh parullën e kulturës kombëtare.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kombin më të shtypur dhe më të ndjekur, për kombin çifut. Kultura kombëtare çifute është parulla e rabinëve dhe borgjezëve është parulla e armiqve tanë. Por ka edhe elemente të tjera në kulturën çifute dhe në gjithë historinë e çifutëve. Nga të 10 500 000 çifutët që janë në gjithë botën, pak më shumë se gjysma jetojnë në Galici dhe në Rusi, vende të prapambetura, gjysmë-barbare, që i mbajnë çifutët *me dhunë* në gjendjen e një kaste. Gjysma tjetër jëton në botën e qytetëruar, dhe atje çifutët nuk janë të veçuar si kastë më vete. Atje janë shfaqur qartë tiparet e mëdha përparimtare me rëndësi botërore të kulturës çifute: internacionalizmi i saj, simpatia e saj për lëvizjet përparimtare të kohës (përçindja e çifutëve në lëvizjet demokratike dhe proletare është kudo më e lartë se përçindja e çifutëve në përbërjen e popullsisë në përgjithësi).

Kush hedh haptazi ose tërthorazi parullën e «kulturës kombëtare» çifute, ai (cilatdo qofshin qëllimet e tij të mira) është armik i proletariatit, është përkrasës i frymës së *vjetër* dhe të *kastës* ndër çifutët, është shërbëtor i rabinëve dhe i borgjezëve. Përkundrazi, ata çifutë marksistë që shkrihen në organizatat marksiste ndërkombëtare me punëtorët rusë, lituanë, ukrainas etj., duke sjellë kontributin e tyre (edhe sipas mënyrës ruse, edhe sipas mënyrës çifute) në krijimin e kulturës ndërkombëtare të lëvizjes punëtore, këta çifutë — në kundërshtim me separatizmin e Bundit — vazhdojnë traditat më të mira të çifutëve, duke luftuar kundër parullës së «kulturës kombëtare».

Nacionalizmi borgjez edhe internacionalizmi proletar janë dy parulla armiqësore të papajtueshme që u përgjigjen dy kampeve të mëdha klasore në të gjithë botën kapitaliste dhe që shprehin dy politika (veç asaj: dy botëkuptime) në çështjen kombëtare. Duke mbrojtur parullën e kulturës kombëtare, duke ndërtuar mbi këtë parullë një plan të tërë dhe programin praktik të së ashtuquajturës «autonomi kombëtaro-kulturore».

në praktikë bundistët veprojnë si përhapës të nacionalizmit borgjez në radhët e punëtorëve.

3. GOGOLI NACIONALIST I «ASIMILIMIT»

Çështja e asimilimit, d.m.th. e humbjes së veçorive kombëtare, e kalimit në një komb tjetër, na lejon t'i përfytyrojmë çartë pasojat e lëkundjeve nacionaliste të bundistëve dhe të atyre që mendojnë si ata.

Zoti Libman, duke pasqyruar dhe përsëritur me besnikëri argumentet e zakonshme, më sak, metodat e zakonshme të bundistëve, kërkesën që të bashkohen dhe të shkrihen punëtorët e të gjitha kombësive të një shteti në organizata punëtore të vetme (shih më sipër pjesën e fundit të artikullit nga «Severnaja Pravda») — e quan «përralla e vjetër e asimilimit».

«Si pasojë, — thotë z. F. Libman duke komentuar pjesën e fundit të artikullit të «Severnaja Pravdës», — pyetjes se nga ç'kombësi është, punëtori duhet t'i përgjigjet: unë jam socialdemokrat».

Kjo bundistit tonë i duket shprehja më e lartë e zgjuarësisë. Në të vërtetë me këtë zgjuarësi dhe me ulërimat e tij për «asimilimin», të drejtuara kundër parullës demokratike konsekuente dhe marksiste, ai e demaskon veten përfundimisht.

Kapitalizmi në zhvillim e sipër njeh dy tendenca historike në çështjen kombëtare. E para: zgjimi i jetës kombëtare dhe i lëvizjeve kombëtare, lufta kundër çdo shtypjeje kombëtare, krijimi i shteteve kombëtare. E dyta: zhvillimi dhe shtimi i marrëdhënieve të çdo lloji midis kombeve, heqja e ndarjeve të vjetra kombëtare, krijimi i unitetit ndërkombëtar të kapitalit, të jetës ekonomike në përgjithësi, të politikës, shkencës etj.

Të dyja këto tendenca janë një ligj botëror i ka-

pitalizmit. E para mbizotëron në fillim të zhvillimit të tij, e dyta karakterizon kapitalizmin e pjekur që është vënë në rrugën e shndërrimit në shoqëri socialiste. Programi kombëtar i marksistëve i merr parasysh të dyja këto tendenca duke mbrojtur, së pari, barazinë e kombeve dhe të gjuhëve, palejueshmërinë e çfarëdo privilegji në këtë drejtim (si dhe të drejtën e kombeve për vetëvendosje, për të cilën do të flasim në mënyrë të veçantë më poshtë), e së dyti, parimin e internacionalizmit dhe të luftës së papajtueshme kundër molepsjes së proletariatit nga nacionalizmi borgjez, qoftë ky edhe më i stërholluari.

Lind pyetja, ku e ka fjalën atëherë bundisti ynë kur çirret e ulërin kundër «asimilimit»? Ai nuk mund ta ketë pasur fjalën për dhunën kundër kombeve, për privilegjet e një kombi, sepse përgjithësisht këtu nuk shkon fjala «asimilim»; — sepse gjithë marksistët, si veç e veç, ashtu edhe si një e tërë e vetme zyrtare, e kanë dënuar me vendosmërinë më të madhe dhe pa lënë shteg për dy kuptime qoftë edhe dhunën më të vogël kombëtare, ashtu si edhe çdo shtypje dhe pabarazi; — sepse, më në fund, edhe në artikullin e gazetës «Severnaja Pravda», të cilin sulmon bundisti, kjo ide marksiste e përgjithshme është shprehur me vendosmërinë më të madhe.

Jo. Këtu nuk ka vend pa dredhi. Zoti Libman e dënon «asimilimin» pa kuptuar me këtë fjalë as dhunën as pabarazinë as privilegjet. Po a mbetet ndonjë gjë reale në kuptimin e asimilimit po të përjashtojmë prej tij çdo dhunë e çdo pabarazi?

Patjetër që po. Mbetet ajo tendencë historike botërore e kapitalizmit për heqjen e ndarjeve kombëtare, për zhdukjen e dallimeve kombëtare, për asimilimin e kombeve, e cila pas çdo dhjetëvjetëshi që kalon shfaqet me forcë gjithnjë më të madhe dhe përbën një nga forcat lëvizëse më të mëdha që e shndërrojnë kapitalizmin në socializëm.

Kush nuk e njeh dhe nuk e mbron barazinë e

kombeve e të gjuhëve, nuk lufton kundër çdo shtypjeje ose pabarazie kombëtare, ai nuk është marksist, madje ai nuk është as demokrat. Kjo është e padiskutueshme. Por është gjithashtu e padiskutueshme se ai pseudomarksist, që s'le gjë pa thënë kundër marksistit të një kombi tjetër, duke e akuzuar për «asimilim», në të vërtetë nuk është tjetër veçse *nacionalist mikroborgjez*. Në këtë kategori jo shumë të nderuar njerëzish hyjnë gjithë bundistët dhe (siç do ta shohim tani) socialnacionalistët ukrainas, si zotërinjtë L. Jurkeviç, Doncov e K°.

Që ta tregojmë konkretisht gjithë karakterin reaksionar të pikëpamjeve të këtyre nacionalistëve mikroborgjezë, do të japim tri lloje të dhënash:

Më shumë nga të gjithë kundër tendencave «asimiluese» të marksistëve ortodoksë rusë ulërijnë nacionalistët çifutë në Rusi në përgjithësi, duke përfshirë bundistët, në mënyrë të veçantë. Kurse, siç shihet nga të dhënat që paraqitëm më lart, nga të 10 500 000 çifutët që janë në gjithë botën, *rreth gjysma* jetojnë në botën e qytetëruar, në kushtet e një «asimilimi» shumë të madh, kurse vetëm çifutët fatzinj të Rusisë dhe të Galicisë, të shtypur, të zhveshur nga çdo e drejtë dhe të ndjekur nga Purishkeviçët (rusë e polonezë), jetojnë në kushtet e një «asimilimi» shumë të dobët, të një izolimi shumë të madh, që arrin deri te krijimi i «zonave të caktuara për banimin e çifutëve», te vendosja e një «përqindjeje të caktuar» për çifutët dhe bukuri të tjera purishkeviçiste.

Çifutët në botën e qytetëruar nuk janë komb, ata janë asimiluar më shumë se të gjithë, — thotë K. Kautski dhe O. Baueri. Çifutët në Galici dhe në Rusi nuk janë komb, mjerisht (dhe jo për faj të tyre, por të Purishkeviçëve), këtu ata janë ende *kastë*. Ky është mendimi i prerë i këtyre njerëzve që e njohin mirë historinë e çifutëve dhe që dinë t'i vlerësojnë faktet që përmendëm më lart.

C'na tregojnë këto fakte? Ato na tregojnë se kundër «asimilimit» mund të ulërijnë vetëm çifutët mikroborgjezë reaksionarë që duan ta kthejnë prapa rrotën e historisë, ta detyrojnë atë të silltet jo nga rendi që ekziston në Rusi e Galici në drejtim të rendit që ekziston në Paris e Nju-Jork, por në drejtimin e kundërt.

Kundër asimilimit nuk kanë ulëritur kurrë ata përfaqësues më të lirë të çifutëve që kanë fituar një famë historike botërore dhe që i kanë dhënë botës udhëheqësit pararojë të demokracisë dhe të socializmit. Kundër asimilimit ulërijnë vetëm adhuruesit dhe soditësit e «elementëve të prapambetur» në radhët e çifutëve.

Mund të formojmë një ide të përafërt për përpjesëtimet në të cilat kryhet në përgjithësi procesi i asimilimit të kombeve në kushtet e sotme të kapitalizmit të përparuar, p.sh., në bazë të të dhënave për emigracionin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës Veriore. Gjatë 10 vjetëve, 1891-1900, Evropa ka dërguar atje 3 700 000 vetë, kurse brenda 9 vjetëve, 1901-1909,— 7 200 000 vetë. Regjistrimi i vitit 1900 ka shënuar në Shtetet e Bashkuara më shumë se 10 000 000 të huaj. Shteti i Nju-Jorkut, ku në bazë të po atij regjistrimi ka pasur më shumë se 78 000 austriakë, 136 000 anglezë, 20 000 francezë, 480 000 gjermanë, 37 000 hungarezë, 425 000 irlandezë, 182 000 italianë, 70 000 polonezë, 166 000 rusë (në pjesën më të madhe çifutë), 43 000 suedezë etj., — i përngjan një mulliri të madh që i bluan të gjitha dallimet kombëtare. Dhe ajo që ndodh në përpjesëtime të mëdha, ndërkombëtare në Nju-Jork, ndodh gjithashtu në çdo qytet dhe qendër industriale të madhe.

Kush nuk është i mbytur në paragjykimet nacionaliste, ai nuk mund të mos shohë në këtë proces të asimilimit të kombeve nga kapitalizmi një përparim historik shumë të madh, shkatërrimin e ngushtësisë kombëtare të skajeve më të humbura — sidomos në vendet e prapambetura si Rusia.

Merrni Rusinë dhe marrëdhëniet ndërmjet rusëve dhe ukrainasve. Sigurisht, çdo demokrat, pa folur pastaj për marksistin, do të luftojë me vendosmëri kundër poshtërimit të pashembullt të ukrainasve dhe do të kërkojë barazinë e tyre të plotë. Por do të ishte një tradhti e hapët ndaj socializmit dhe politikë e marrë edhe nga pikëpamja «e detyrave kombëtare» borgjeze të ukrainasve — të *dobësohet* lidhja dhe aleanca e sotme, brenda kufijve të një shteti, ndërmjet proletariatit ukrainas dhe rus.

Zoti Lev Jurkeviç, që e quan veten gjithashtu «marksist» (i mjeri Marks!), na jep një shembull të kësaj politike të marrë. Më 1906, — shkruan z. Jurkeviç, — Sokolovski (Basok) dhe Lukasheviçi (Tuçapski) thoshin se proletariati ukrainas është rusifikuar fare dhe nuk ka nevojë për një organizatë të veçantë. Pa u munduar të na japë asnjë fakt për *thelbin e çështjes*, zoti Jurkeviç i sulmoi për këto fjalë që të dy dhe ulërin në mënyrë hysterike — krejt në frymën e nacionalizmit më të ulët, më të marrë dhe reaksionar — se ky është «pasivitete kombëtar», «mohim i kombit», se këta njerëz «i kanë përçarë (!) marksistët ukrainas» etj. Sot te ne, me gjithë «ngritjen e ndërgjegjes kombëtare ukrainase ndër punëtorët», vetëm një *pakicë* punëtorësh kanë «ndërgjegjen kombëtare», kurse shumica — na siguron z. Jurkeviç — «gjendet ende nën ndikimin e kulturës ruse». Dhe detyra jonë — bërtet ky nacionalist mikroborgjez — «nuk është të shkojmë pas masave, por t'u prijmë atyre, t'u shpjegojmë detyrat kombëtare (çështjen kombëtare)» («Dzvin», f. 89).

Gjithë ky arsyesim i z. Jurkeviç është fund e krye një arsyesim nacionalist-borgjez. Por edhe nga pikëpamja e nacionalistëve borgjezë, disa nga të cilët duan barazinë e plotë dhe autonominë e Ukrainës, e disa të tjerë — një shtet ukrainas të pavarur, ky arsyesim nuk i qëndron kritikës. Armike e aspiratave çlirimtare të ukrainasve është klasa e çifligarëve rusë dhe polone-

zë, pastaj borgjezia po e këtyre dy kombeve. Cila forcë shoqërore mund t'u qëndrojë këtyre klasave? Dhjetëvjetëshi i parë i shek. XX na dha një përgjigje konkrete: kjo forcë është vetëm e vetëm klasa punëtore, e cila i prin fshatarësisë demokratike. Duke dashur ta ndajë dhe në këtë mënyrë ta dobësojë forcën me të vërtetë demokratike, në kushtet e fitores të së cilës do të ishte e pamundur dhuna kombëtare, zoti Jurkeviç i tradhton interesat jo vetëm të demokracisë në përgjithësi, por edhe të atdheut të tij, Ukrainës. Në kushtet e veprimit të bashkuar të proletarëve rusë dhe ukrainas *mund të ketë një Ukrainë të lirë*, pa këtë bashkim as që mund të flitet për të.

Por marksistët nuk kufizohen me pikëpamjen nacionaliste — borgjeze. Po bëhen disa dhjetëra vjet që është përcaktuar plotësisht procesi i një zhvillimi ekonomik më të shpejtë të jugut, d.m.th. të Ukrainës, që tërheq nga Rusia dhjetëra dhe qindra mijëra fshatarë dhe punëtorë në ekonomitë kapitaliste, në minierat e në qytet. Fakti i «asimilimit» — brenda këtyre kufijve — i proletariatit rus dhe ukrainas është i padiskutueshëm. Dhe ky fakt është *patjetër* përparimtar. Muzhikun e prapambetur, të pagdhendur, të palëvizshëm dhe të egër rus ose ukrainas kapitalizmi e zëvendëson me proletarin e lëvizshëm, kushtet e jetës së të cilit e zhdukin ngushtësinë e tij posaçërisht kombëtare si ruse, ashtu edhe ukrainase. Ta zëmë se midis Rusisë dhe Ukrainës, me kalimin e kohës, do të vihet një kufi shtetëror, — edhe në këtë rast karakteri historik përparimtar i «asimilimit» të punëtorëve rusë dhe ukrainas do të jetë i padiskutueshëm, ashtu siç është përparimtare përzjerja e kombeve në Amerikë. Sa më të lira do të bëhen Ukraina dhe Rusia, aq më i gjerë dhe më i shpejtë do të jetë zhvillimi i kapitalizmit, i cili në këtë rast do t'i tërheqë edhe më shumë punëtorët e të gjitha kombeve nga të gjitha krahinat e shtetit dhe nga të gjitha shtetet fqinje (sikur Rusia të

ishte shtet fqinj me Ukrainën), do ta tërheqë edhe më shumë masën punëtore në qytet, në minierat, në uzinat.

Zoti Lev Jurkeviç vepron si një borgjez i vërtetë dhe për më tepër si një borgjez dritëshkurtër, i ngushtë, i marrë, d.m.th. si një filistin, kur interesat e marrëdhënieve, të shkrirjes dhe të asimilimit të *proletariatit* të të dy këtyre kombeve ai i flak për hir të suksesit të një çasti të çështjes kombëtare ukrainase. Çështja kombëtare — në radhë të parë, çështja proletare — në radhë të dytë, thonë nacionalistët borgjezë dhe zotërinjtë Jurkeviçë, Donovanë e pseudomarksistët e tjerë bashkë me ta. Çështja proletare në radhë të parë, themi ne, sepse ajo siguron jo vetëm interesat e qëndrueshme, rrënjësore të punës dhe interesat e njëërëzimit, por edhe interesat e demokracisë, dhe pa demokracinë nuk mund të mendohet një Ukrainë autonome dhe e pavarur.

Më në fund, në arsyetimet e z. Jurkeviç, çuditërisht të pasura me xhevahirë nacionaliste, duhet të vëmë në dukje edhe këtë. Vetëm një pakicë e punëtoreve ukrainas kanë ndërgjegje kombëtare, thotë ai, — «shumica gjendet ende nën ndikimin e kulturës ruse»*.

Kur është fjala për proletariatin, kjo orvatje për ta vënë kulturën ukrainase në tërësi përballë kulturës ruse, gjithashtu në tërësi, është tradhtia më e paturpshme e interesave të proletariatit në dobi të nacionalizmit borgjez.

Në çdo komb të sotëm ka dy kombe — u themi ne gjithë socialnacionalistëve. Në çdo kulturë kombëtare ka dy kultura kombëtare. Është kultura ruse e Purishkeviçëve, Guçkovëve dhe Struveve, — por është gjithashtu edhe kultura ruse që karakterizohet nga emrat e Çernishevskit dhe Plehanovit. *Po këto dy*

* Në origjinal fraza e fundit është shkruar ndër kllapa në gjuhën ukrainase. *Red. Përkth.*

kultura janë edhe në Ukrainë, ashtu si edhe në Gjermani, në Francë, në Angli, te çifutët etj. Në qoftë se shumica e punëtorëve ukrainas është nën ndikimin e kulturës ruse, ne e dimë fare mirë se krahas ideve të kulturës klerikale dhe borgjeze ruse këtu veprojnë edhe idetë e demokracisë dhe të socialdemokracisë ruse. Duke luftuar «kulturën» e llojit të parë, marksisti ukrainas do të dijë gjithnjë ta dallojë edhe kulturën e dytë dhe t'u thotë punëtorëve të tij: «kapeni, shfrytëzojeni dhe forconi me të gjitha forcat çdo mundësi për marrëdhënie me punëtorët e ndërgjegjshëm rusë, me letërsinë e tyre, me rrethin e ideve të tyre; këtë e kërkoni interesat rrënjësore si të lëvizjes punëtore ukrainase, ashtu edhe të lëvizjes punëtore ruse».

Në qoftë se marksisti ukrainas do të lejojë që urrejtja *krejt e ligjshme dhe e natyrshme* kundër shtypësve rusë ta verbojë deri në atë shkallë sa ai ta bartë qoftë edhe një pjesë të vogël të kësaj urrejtjeje, qoftë kjo edhe vetëm njëfarë tendence për t'u veçuar, te kultura proletare dhe çështja proletare e punëtorëve rusë, atëherë ky marksist, duke vepruar kështu, do të bjerë në batakun e nacionalizmit borgjez. Po ashtu edhe marksisti rus do të bjerë në batakun e nacionalizmit, dhe jo vetëm borgjez, por edhe ultrareaksionar, në qoftë se ai e harron qoftë edhe vetëm për një çast kërkesën e barazisë së plotë të ukrainasve ose të drejtën e tyre për të formuar një shtet të pavarur.

Punëtorët rusë dhe ukrainas duhet ta mbrojnë së bashku dhe, derisa ata jetojnë në një shtet të vetëm, në unitet e shkrirje organizative shumë të ngushtë kulturren e përbashkët ose ndërkombëtare të lëvizjes proletare, duke u treguar zemërgjerë për çështjen e gjuhës në të cilën bëhet propaganda dhe për çështjen e vlerësimit të veçantive thjesht lokale ose thjesht kombëtare në këtë propagandë. Kjo është kërkesa e padiskutueshme e marksizmit. Çdo propagandë për ndarjen e punëtorëve të një kombi nga punëtorët e një kombi tjetër, çdo sulm kundër tendencave «asimiluese» mar-

ksiste, çdo orvatje për të vënë në çështjet që kanë të bëjnë me proletariatin një kulturë kombëtare në tërësi përballë një kulture tjetër kombëtare të marrë gjithashtu gjoja në tërësi etj. është nacionalizëm borgjez, kundër të cilit duhet bërë medoemos një luftë e pamëshirshme.

4. «AUTONOMIA KOMBËTARO-KULTURORE»

Çështja e parullës së «kulturës kombëtare» ka rëndësi shumë të madhe për marksistët jo vetëm sepse ajo përcakton përmbajtjen ideologjike të gjithë propagandës dhe agjitacionit tonë për çështjen kombëtare ndryshe nga propaganda borgjeze, por gjithashtu edhe sepse një program i tërë, programi famëkeq i autonomisë kombëtare-kulturore, është ndërtuar mbi këtë parullë.

E meta kryesore, parimore e këtij programi është se ai mundohet të vërë në jetë nacionalizmin më të stërholluar dhe më absolut, të çuar deri në fund. Thelbi i këtij programi është: çdo qytetar regjistrohet në këtë ose atë komb, dhe çdo komb përbën një të tërë juridike me të drejtën e tatimit të detyruar të pjesëtarëve të vet, me parlamente (sejme) kombëtare, me «sekretarë shteti» (ministra) kombëtarë.

Kjo ide, e zbatuar në fushën e çështjes kombëtare, i përngjan idesë së Prudonit, të zbatuar për kapitalizmin. Të mos zhduket kapitalizmi dhe baza e tij — prodhimi i mallrave por të *pastrohet* kjo bazë nga shpërdorimet, nga bigorrat etj.; të mos zhduket shkëmbimi dhe vlera e shkëmbimit, por, përkundrazi, të «kushtetohet» ajo, të bëhet e përgjithshme, absolute, «e drejtë», pa lëkundje, pa kriza e shpërdorime — ja ideja e Prudonit.

Po ashtu siç është mikroborgjez Prudoni, po ashtu sikundër teoria e tij e absolutizon, e hyjnizon shkëmbimin dhe prodhimin e mallrave, po ashtu është mikroborgjezë teoria dhe programi i «autonomisë kombëtare—kulturore» që e absolutizon, e hyjnizon nacionalizmin borgjez, mundohet ta pastrojë atë nga dhuna dhe padrejtësitë etj.

Marksizmi është i papajtueshëm me nacionalizmin, qoftë ky më «i drejti», më i «kulluari», më i stërholluari dhe më i qytetëruari. Në vend të çdo nacionalizmi marksizmi vë internacionalizmin, shkriren e të gjitha kombeve në një unitet më të lartë, i cili rritet përpara syve tanë në çdo verstë udhe të hekurt që ndërtohet, me krijimin e çdo trusti ndërkombëtar, me krijimin e çdo bashkimi punëtor (ndërkombëtar në veprimtarinë e vet ekonomike, e pastaj edhe në idetë e tij, në qëllimet e tij).

Në shoqërinë borgjeze parimi i kombësisë është historikisht i pashmangshëm, dhe duke e marrë parasysh këtë shoqëri marksisti e pranon plotësisht karakterin historikisht të ligjshëm të lëvizjeve kombëtare. Por që ky pranim të mos kthehet në një apologji të nacionalizmit, duhet që ai të kufizohet vetëm e vetëm me ata elementë që janë përparimtarë në këto lëvizje,— në mënyrë që ky pranim të mos çojë në errësimin e ndërgjegjes proletare nga ideologjia borgjeze.

Është përparimtar zgjimi i masave nga gjumi feudale, lufta e tyre kundër çdo shtypjeje kombëtare, për sovranitetin e popullit, për sovranitetin e kombit. Së këtejmi lind detyra e *padiskutueshme* për një marksist që të mbrojë demokratizmin më të vendosur dhe më konsekuent në të gjitha pikat e gështjes kombëtare. Kjo është një detyrë, kryesisht, negative. Por në mbrojtjen e nacionalizmit proletariati nuk mund të shkojë më larg se kjo detyrë, sepse më tutje fillon veprimtaria «pozitive» e *borgjezisë*, që synon ta forcojë nacionalizmin.

Të përmbysë çdo zgjedhë feudale, çdo shtypje të kombeve, çdo privilegj të një kombi ose të një gjuhe, kjo është detyra e padiskutueshme e proletariatit, si forcë demokratike, ky është interesi i padiskutueshëm i luftës proletare të klasës, e cila errësohet dhe pengohet nga grindjet kombëtare. Por ta ndihmosh nacionalizmin borgjez përtej këtyre kufijve, të përcaktuar rreptësisht brenda një kuadri historik të caktuar, do të thotë ta tradhtosh proletariatin dhe të marrësh anën e borgjezisë. Këtu ka një kufi që shumë herë mezi dallohet dhe të cilin e harrojnë fare socialnacionalistët bundistë dhe ukrainas.

Luftë kundër çdo shtypjeje kombëtare — patjetër po. Luftë për çdo zhvillim kombëtar, për «kulturën kombëtare» në përgjithësi — patjetër jo. Zhvillimi ekonomik i shoqërisë kapitaliste na tregon në gjithë botën shembuj lëvizjesh kombëtare që nuk kanë arritur një zhvillim të plotë, shembuj formimi kombesh të mëdha nga një varg kombesh të vogla ose në dëm të disa kombeve të vogla, shembuj asimilimi të kombeve. Përmirësimi i nacionalizmit borgjez është zhvillimi i kombësisë në përgjithësi; së këtejmi lind ekskluziviteti i nacionalizmit borgjez, së këtejmi lind grindja e pashmangshme kombëtare. Kurse proletariati jo vetëm nuk merr përsipër të mbrojë zhvillimin kombëtar të çdo kombi, por, përkundrazi, i ruan masat nga këto iluzione, mbron lirinë më të plotë të qarkullimit kapitalist, përshëndet çdo asimilim të kombeve me përjashtim të asimilimit që bëhet me dhunë ose që mbështetet në privilegje.

Ta përforcojë nacionalizmin brenda një sfere të caktuar dhe të përkufizuar «drejt», të «kushtetojë» nacionalizmin, të vërë një ndarje të shëndoshë dhe të qëndrueshme ndërmjet gjithë kombeve me një institucion shtetëror të veçantë, — kjo është baza ideologjike dhe përmbajtja e autonomisë kombëtare—kulturore. Kjo ide është fund e krye borgjeze dhe fund e krye

e rreme. Proletariati nuk mund të përkrahë asnjë përforcim të nacionalizmit,—përkundrazi, ai përkrah çdo gjë që e ndihmon zhdukjen e dallimeve kombëtare, heqjen e ndarjeve kombëtare, çdo gjë që i bën lidhjet midis kombësive gjithnjë më të ngushta, çdo gjë që çon në shkrirjen e kombeve. Të veprosht ndryshe, do të thotë të viresh në anën e borgjezisë së vogël nacionaliste reaksionare.

Kur projekti i autonomisë kombëtare—kulturore u diskutua nga socialdemokratët austriakë në Kongresin e tyre të Brynit (më 1899), vlerësimi teorik të këtij projekti nuk iu dha pothuajse asnjë rëndësi. Por është interesante të vemë në dukje se u paraqitën këto dy argumente kundër këtij programi: 1) ai do të çonte në forcimin e klerikalizmit; 2) «rezultati i tij do të ishte përjetësimi i shovinizmit, përhapja e tij në çdo komunitet të vogël, në çdo grup të vogël» (f. 92 e protokolleve zyrtare të Kongresit të Brynit të botuara gjermanisht. Ka një përkthim rusisht të botuar nga partia nacionaliste çifute »Serp»⁹⁾.

S'ka dyshim se «kultura kombëtare» në kuptimin e zakonshëm të kësaj fjale, d.m.th. shkollat etj., sot ndodhet nën ndikimin mbizotërues të klerikalëve dhe të shovinistëve borgjezë në të gjitha vendet e botës. Kur bundistët, duke mbrojtur autonominë «kombëtare—kulturore», thanë se kushtetimi i kombeve do të bëjë që lufta e klasave në gjirin e tyre të pastrohet nga çdo element i jashtëm, ky është një sofizëm i dukshëm dhe qesharak. Lufta serioze e klasave në çdo shoqëri kapitaliste zhvillohet para së gjithash në fushën ekonomike dhe politike. Të veçosh nga kjo shkollën, së pari, është një utopi absurde, sepse nuk është e mundur të shkëputet shkolla (ashtu si dhe «kultura kombëtare» në përgjithësi) nga ekonomia dhe politika, dhe, së dyti, pikërisht jeta ekonomike dhe politike e një vendi kapitalist bën që vazhdimisht të dërmohen ndarjet dhe paragjykimet e vjetruara dhe absurde kombëtare, kur-

se vegimi i shkollës etj. pikërisht do ta ruante, do ta ashpërsonte, do ta forconte klerikalizmin «e kulluar» dhe shovinizmin «e kulluar». borgjez.

Në shoqëritë aksionare rrinë bashkë, në harmoni të plotë me njëri-tjetrin, kapitalistë nga kombe të ndryshme. Në fabrikë punojnë së bashku punëtorë nga kombe të ndryshme. Për çdo çështje politike me të vërtetë serioze dhe të thellë grupimi bëhet në bazë të klasës, e jo në bazë të kombit. «Heqja» e shkollës etj. «nga duart e shtetit» dhe kalimi i saj në duart e kombeve të veçanta është pikërisht një orvatje për të veçuar nga ekonomia, që bashkon kombet, fushën, si të thuash, më ideologjike të jetës shoqërore, ku kultura kombëtare «e kulluar» ose kultivimi kombëtar i klerikalizmit dhe i shovinizmit mund të përhapet me lehtësinë më të madhe.

Nga pikëpamja e realizimit të tij praktik, plani i autonomisë «eksterritoriale» (jashtë territorit, pa lidhje me territorin ku jeton ky ose ai komb) ose «kombëtaro—kulturore» do të kishte vetëm një kuptim: *të ndahet arsimi në bazë të kombësive*, d.m.th. të krijohen kuritë kombëtare në arsim. Mjafton ta kemi të qartë këtë kuptim *real* të planit të famshëm bundist që ta shohim gjithë karakterin e tij reaksionar qoftë edhe nga pikëpamja e demokracisë, e jo pastaj nga pikëpamja e luftës së klasës të proletariatit për socializëm.

Vetëm një shembull dhe vetëm një projekt për «kombëtarizimin» e shkollës do të na tregojnë fare qartë cili është thelbi i vërtetë i çështjes. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndarja e shteteve në shtete të veriut dhe në shtete të jugut edhe sot e kësaj dite qëndron në gjithë jetën e vendit: në të parat janë më të forta traditat e lirisë dhe të luftës kundër skllavopronarëve, në të dytat janë më të forta traditat e skllavërisë, me mbeturina të ndjekjeve kundër zezakëve, me gjendjen e tyre ekonomike të shtypur,

me prapambetjen e tyre kulturore (44% analfabetë ndër zezakët dhe 6% te popullsia e bardhë) etj. Kështu, në shtetet e veriut zezakët mësojnë bashkë me të bardhët në të njëjtat shkolla. Në jug ka shkolla të veçanta, «kombëtare» ose të racës, si të doni, për zezakët. Më duket se në praktikë ky është i vetmi shembull «kombëtarizimi» të shkollës.

Në lindje të Evropës ka një shtet, ku edhe sot e kësaj dite mund të kurdisen procese, si procesi Bejlis¹⁰, dhe ku zotërinjtë Purishkeviçë i kanë dënuar çifutët të jetojnë në një gjendje më të keqe se ajo e zezakëve. Në këtë shtet s'ka shumë kohë që qeveria përpunoi një projekt për kombëtarizimin e shkollës çifute. Për fat të mirë është vështirë që kjo utopi reaksionare të mund të realizohet, ashtu si edhe utopia e mikroborgjezëve austriakë, të cilët, pasi e humbën shpresën për mundësinë që të zbatohet një demokraci konsekuente dhe që të pushojnë grindjet kombëtare, shpikën *këllëfe* për kombet në fushën e shkollës, në mënyrë që të mos ketë grindje për shkak të ndarjes së shkollave..., por «u kushtetuan» për grindje të përjetëshme ndërmjet «kulturave kombëtare» të ndryshme.

Në Austri autonomia kombëtaro-kulturore mbeti në një pjesë të madhe ëndërr letrarësh, së cilës nuk i besuan as vetë socialdemokratët austriakë. Nga ana tjetër, të gjitha partitë borgjeze të çifutëve dhe disa elementë mikroborgjezë oportunistë të kombeve të ndryshme — për shembull, bundistët, likuidatorët në Kaukaz, konferenca e partive kombëtare ruse me tendenca narodnike të majta në Rusi e pranuan në programin e tyre. (Kjo konferencë — ta themi ndër këllapa — u zhvillua më 1907 dhe vendimi i saj u pranua me abstenimin e socialistëve-revolucionarë rusë dhe të socialpatriotëve polonezë, anëtarëve të PPS-së¹¹. Abstenimi është një mënyrë veprimi jashtëzakonisht karakteristike për qëndrimin që mbajnë ese-

rët dhe anëtarët e PPS-së në një çështje parimore shumë të rëndësishme në fushën e programit kombëtar!»

Në Austri pikërisht Oto Baueri, teoricieni kryesor i «autonomisë kombëtareo-kulturore», ka shkruar një artikull të posaçëm në librin e tij për të provuar se ky program nuk mund të zbatohet për çifutët. Kurse në Rusi, pikërisht të gjitha partitë borgjeze të çifutëve — edhe Bundi që u mban iso — e pranuan këtë program*. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë se me praktikën politike të një shteti tjetër historia ka demaskuar absurditetin e shpikjes së Bauerit, po ashtu sikundër bernshtajnistët rusë (Struveja, Tugan-Baranovski, Berdjajevi e K^o) me evolucionin e tyre të shpejtë nga marksizmi në liberalizëm kanë demaskuar përmbajtjen ideologjike reale të bernshtajniadës gjermane.

As socialdemokratët austriakë, as socialdemokratët

* Fakti që bundistët me një guxim të jashtëzakonshëm shpeshherë e mohojnë se të gjitha partitë borgjeze të çifutëve e kanë pranuar «autonominë kombëtareo-kulturore» është i kuptueshëm. Ky fakt e zbulon shumë qartë rolin e vërtetë të Bundit. Kur një nga bundistët, z. Manin, në gazetën «Lluç» provoi ta përsëriste këtë mohim, atë e demaskoi më së miri N. Skopi (shih «Prosveshenie» Nr. 3). Por kur z. Lev Jurkeviç në gazetën «Dzvin» (1913, Nr. 7-8, f. 92) citon nga revista «Prosveshenie» (Nr. 3, f. 78) frazën e N. Sk.: «Bundistët — bashkë me të gjitha partitë dhe grupet çifute borgjeze — mbrojnë prej kohësh autonominë kombëtareo-kulturore» dhe e shtrembëron këtë citat duke hequr prej tij fjalën «bundistët» dhe duke i zëvendësuar fjalët: «autonomi kombëtareo-kulturore» me fjalët «të drejta kombëtare», nuk na mbetet veçse të mbledhim supet! Zoti Lev Jurkeviç nuk është vetëm nacionalist, ai nuk tregon vetëm një padije të çuditshme për çështjet e historisë së socialdemokracisë dhe të programit të saj, por është edhe një falsifikues i drejtpërdrejtë citatesh në dobi të Bundit! Keq i kanë punët Bundi dhe zotërinjtë Jurkeviç!

rusë nuk e pranuan në programin e tyre autonominë «kombëtaro-kulturore». Por partitë borgjeze të çifutëve në vendin më të prapambetur dhe një varg grupesh pseudosocialiste mikroborgjeze e pranuan atë për të përhapur në formë të stërholluar idetë e nacionalizmit borgjez në radhët e punëtorëve. Ky fakt nuk ka nevojë për komente.

Pasi u detyruam të prekim programin austriak për çështjen kombëtare, nuk mund të mos vëmë në vend një të vërtetë, të cilën shumë herë bundistët e shtrembërojnë. Në Kongresin e Brynit u paraqit një program i kulluar i «autonomisë kombëtaro-kulturore». Ky është programi i socialdemokracisë së sllavëve të jugut, § 2 i tij thotë: «Çdo popull që jeton në Austri, pavarësisht nga territori ku janë vendosur pjesëtarët e tij, përbën një grup autonom, i cili i zgjidh në mënyrë krejt të pavarur të gjitha çështjet e tij kombëtare (të gjuhës e të kulturës)». Këtë program e mbrojti jo vetëm Kristani, por edhe Elenbogeni, njeri me influencë. Por ai u hoq, ai nuk fitoi asnjë votë. U pranua programi territorialist, domethënë një program që nuk krijon asnjë grup kombëtar «pavarësisht nga territori ku janë vendosur pjesëtarët e kombit».

Në programin që u pranua, §. 3 thotë: «Krahinat e vetëqeverisura të të njëjtit komb formojnë së bashku një bashkim të vetëm kombëtar, i cili i zgjidh në mënyrë krejt autonome çështjet e tij kombëtare» (krahaso «Prosveshenien», 1913, Nr. 4, f.28¹²). Është e qartë se edhe ky program kompromisi është i gabuar. Po e shpjegojmë me një shembull. Komuniteti i kolonistëve gjermanë në gubernën e Saratovit plus la-

gija e punëtorëve gjermanë në Rigë ose në Lodz plus një lagje gjermane të Peterburgut etj. përbëjnë një «bashkim kombëtar të vetëm» të gjermanëve në Rusi. Është e qartë se socialdemokratët nuk mund të kërkojnë një gjë të tillë, të ligjësojnë një bashkim të tillë; megjithëse ata, sigurisht, nuk e mohojnë aspak *lirinë* e çdo bashkimi, duke përfshirë edhe bashkimin e çdo komuniteti të çdo kombësie qoftë në shtetin përkatës. Vetëm priftërinjtë, borgjezët, mikroborgjezët dhe kushdo tjetër, por jo socialdemokratët, mund t'i ndajnë me ligj shtetëror gjermanët etj. të krahinave dhe klaseve të ndryshme të Rusisë në një bashkim kombëtar të vetëm gjerman.

5. BARAZIA E KOMBEVE DHE TË DREJTAT E PAKICËS KOMBËTARE

Metoda më e zakonshme që përdorin oportunistët rusë sa herë që diskutohet çështja kombëtare, është të sjellin si shembull Austrinë. Në artikullin tim, të botuar në gazetën «Severnaja Pravda»* («Prosveshenie» Nr 10, f. 96-98), i cili u sulmua nga oportunistët, (z. Semkovski në «Novaja Raboçaja Gazeta», z. Libman në «Cajt»), unë them se ka vetëm një zgjidhje të çështjes kombëtare, në atë masë që përgjithësisht një gjë e tillë është e mundur në botën e kapitalizmit, dhe kjo zgjidhje është demokratizmi konsekuent. Për ta provuar këtë, ndër të tjera, unë sjell si shembull Zvicrën.

Ky shembull nuk u pëlqen të dy oportunistëve të lartpërmendur, të cilët mundohen ta hedhin poshtë ose ta pakësojnë vlerën e tij. Kautski, sipas tyre, paska thënë se Zvicra është një përjashtim; në Zvicër paska

* Shih këtë përmbledhje, f. 63-67. Red. Përkth.

një decentralizim krejt të veçantë, një histori të veçantë, kushte gjeografike të veçanta, një shpërndarje jashtëzakonisht origjinale të popullsisë që flet gjuhë të ndryshme etj. etj.

Të gjitha këto nuk janë veçse orvatje për t'iu shmangur thelbit të çështjes. Sigurisht, Zvicra është një përjashtim në kuptimin se ajo nuk është një shtet kombëtar homogjen. Por një përjashtim i tillë (ose një rast prapambetjeje, — shton Kautski) — janë Austria dhe Rusia, Sigurisht, në Zvicër vetëm në saje të kushteve të veçanta origjinale, historike dhe shoqërore është siguruar një demokratizëm më i madh sesa në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës që janë fqinje me të.

Por ç'hyjnë të gjitha këto, derisa është fjala për një shembull, nga i cili duhet të marrim mësim? Në kushtet e sotme, në gjithë botën, ato vende ku ky ose ai institucion është realizuar mbi baza demokratike konsekuente janë një përjashtim. Po a na ndalon kjo që në programin tonë të mbrojmë demokratizmin konsekuent në të gjitha institucionet?

Veçoria e Zvicrës përbëhet nga historia e saj, nga kushtet e saj gjeografike dhe të tjera. Veçoria e Rusisë përbëhet nga një forcë e proletariatit e paparë në kohën e revolucioneve borgjeze dhe nga një prapambetje e përgjithshme e tmerrshme e vendit, e cila shkakton objektivisht domosdoshmërinë e një përparimi jashtëzakonisht të shpejtë dhe të vendosur, ndryshe është rrezik të pësojmë gjithfarë humbjesh dhe disfatash.

Ne po përpunojmë një program kombëtar nga pikëpamja e proletariatit: dhe ku është parë që të këshillohen shembujt më të këqij në vend që të merren shembujt më të mirë?

A nuk është sidoqoftë fakt i pamohueshëm dhe i padiskutueshëm se pagja kombëtare në kushtet e kapitalizmit është realizuar (në atë masë që përgjithësisht ajo mund të realizohet) vetëm e vetëm në ato vende ku ka një demokratizëm konsekuent?

Derisa kjo është e padiskutueshme, atëherë këmbëngulja e oportunistëve për të sjellë si shembull Austrinë në vend të Zvicrës mbetet një metodë fund e krye kadete, sepse kadetët kopjojnë gjithnjë kushtetutat më të këqija të Evropës, e jo më të mirat.

Në Zvicër ka tri gjuhë zyrtare, por projektligjet që i nënshtrohen referendumit botohen në pesë gjuhë, domethënë përveç tri gjuhëve zyrtare edhe në dy dialekte «romane». Në këto dy dialekte, sipas regjistrimit të vitit 1900, në Zvicër flasin 38 651 banorë nga 3 315 443, d.m.th. pak më shumë se një për qind. Në ushtri oficerëve dhe nënoficerëve «u është lënë liria më e plotë që t'u drejtohen ushtarëve në gjuhën e tyre amtare». Në kantonet e Graubundenit dhe të Valisit (në secilin prej tyre ka pak më shumë se njëqind mijë banorë) të dyja këto dialekte gëzojnë barazi të plotë*.

Lind pyetja, a duhet që ne të propagandojmë dhe të mbrojmë këtë përvojë të gjallë të një vendi të përparuar, apo të marrim hua nga austriakët disa shpikje që nuk janë provuar ende në asnjë vend të botës (dhe që nuk janë pranuar ende as nga vetë austriakët), si ajo e «autonomisë eksterritoriale»?

Të propagandosh këtë shpikje, do të thotë të propagandosh ndarjen e shkollës sipas kombësive, d.m.th. të bësh një propagandë shumë të dëmshme. Kurse përvoja e Zvicrës na tregon se në praktikë mund të sigurohet dhe është siguruar një maksimum (relativ) paqeje ndërmjet kombësive në kushtet e një demokratizmi konsekuent (gjithashtu relativ) të të gjithë shtetit.

«Në Zvicër — thonë njerëzit që e kanë studiuar këtë çështje — nuk ekziston çështja kombëtare në kuptimin që i jepet në Evropën Lindore. Madje edhe vetë kjo fjalë (çështja kombëtare) këtu nuk njihet»... «Në Zvicër lufta ndër-

* Shih René Henry: «La Suisse et la question des langues». Bern, 1907 (Rene Anri: «Zvicra dhe çështja e gjuhëve», Bernë, 1907. Red.).

mjet kombësve i përket një së kaluare të largët, vjetëve 1797-1803»*

Kjo do të thotë se epoka e Revolucionit të madh francez, që zgjidhi në mënyrën më demokratike çështjet e ngutshme të kalimit nga feudalizmi në kapitalizëm, diti «të zgjidhte» kalimthi midis së tjerash edhe çështjen kombëtare.

Dhe le të provojnë tani zotërinjtë Semkovskë, Libmanë dhe oportunistët e tjerë të thonë se kjo zgjidhje «thjesht zvicerane» është e pazbatueshme për çdo ujezd ose madje edhe pjesë të një ujezdi të Rusisë, ku në një popullatë prej vetëm 200 000 banorë vendas ka dyzet mijë që flasin *dy dialekte* dhe që duan të gëzojnë në vendin e tyre *barazi të plotë* për sa i përket gjuhës!

Propaganda e barazisë së plotë të kombeve dhe të gjuhëve ndan në çdo komb vetëm elementët demokratikë konsekuentë (d.m.th. vetëm proletarët), duke i bashkuar ata jo në bazë të kombësisë, por në bazë të aspiratave të tyre për përmirësime të thella dhe serioze të të gjithë rendit shtetëror. Përkundrazi, propaganda e «autonomisë kombëtare-kulturore», pavarësisht nga dëshirat e mira që mund të kenë individët dhe grupet e veçanta, i ndan kombet dhe afron në praktikë punëtorët e një kombi me borgjezinë e tij (pranimi i kësaj «autonomie kombëtare-kulturore» nga ana e të gjitha partive borgjeze të çifutëve).

I lidhur ngushtë me parimin e barazisë së plotë është sigurimi i të drejtave të pakicës kombëtare. Në artikullin tim, të botuar në gazetën «Severnaja Pravda», ky parim është shprehur pothuajse në të njëjtën mënyrë, siç u formulua më vonë, në mënyrë zyrtare dhe më të saktë, në vendimin e mbledhjes së marksistëve.

* Shin Ed. Blocher: «Die Nationalitäten in der Schweiz», Brl. 1910 (Ed. Bloker: «Kombësitë në Zvicër», Berlin. 1910. Red.).

Ky vendim kërkon që «të përfshihet në kushtetutë një ligj themelor, i cili të shpallë të pavlefshëm çfarëdo privilegji të një kombi dhe çfarëdo shkeljeje të të drejtave të pakicës kombëtare».

Zoti Libman mundohet të tallet me këtë formulim dhe pyet: «Dhe nga ta dimë në se shprehen të drejtat e një pakice kombëtare?» A hyn në vargun e këtyre të drejtave, thotë ai, e drejta për të pasur një «program të veçantë» në shkollat kombëtare? Sa e madhe duhet të jetë pakica kombëtare, që ajo të ketë të drejtë për të pasur gjykatësit e vet, funksionarët e vet dhe shkollat e veta në gjuhën amtare? Zoti Libman do që nga këto pyetje të nxjerrë se një program kombëtar «pozitiv» është i domosdoshëm.

Kurse në të vërtetë këto pyetje tregojnë qartë se çfarë idesh reaksionare kërkon të përhapë bundisti ynë nën maskën e një diskutimi për hollësi e veçanti gjoja të parëndësishme.

«Program i vet» në shkollën e vet kombëtare!.. Marksistët, i nderuar socialnacionalist, kanë një program shkollor të përgjithshëm, i cili kërkon, për shembull, që shkolla të jetë medoemos laike. Nga pikëpamja e marksistëve, në një shtet demokratik kurrë dhe në asnjë rast nuk është e lejueshme të bëhet përjashtim nga ky program i përgjithshëm (kurse plotësimi i tij me lëndë «lokale»; gjuhë etj. bëhet me vendimin e popullsisë vendase). Kurse nga parimi që «të hiqet» shkolla «nga duart e shtetit» dhe të lihet në duart e kombeve të ndryshme del se ne, punëtorët, i lejojmë «kombet» e ndryshme në shtetin tonë demokratik t'i prishin paratë e popullit për shkollën klerikale! Zoti Libman, pa e vënë re as vetë, na tregoi qartë karakterin reaksionar të «autonomisë kombëtare-kulturore»!

«Sa e madhe duhet të jetë pakica kombëtare?» Këtë nuk e përcakton as programi austriak që u pëlqen aq shumë bundistëve: ai thotë (në mënyrë edhe më të përmbledhur dhe më pak të qartë se në programin

tonë): — «E drejta e pakicave kombëtare mbrohet me një ligj të veçantë, i cili duhet të botohet nga parlamenti imperial» (§ 4 i programit të Brynit).

Pse asnjëri nuk u ra më qafë socialdemokratëve austriakë duke i pyetur se cili është konkretisht ky ligj? Të drejtat e cilës pakicë dhe cilat të drejta konkretisht duhet ai të sigurojë?

Sepse gjithë njerëzit me mend në kokë e kuptojnë se nuk është rasti dhe nuk është e mundur që në një program të përcaktohen hollësitë. Programi përcakton vetëm parimet themelore. Në këtë rast në programin e austriakëve parimi themelor nënkuptohet dhe në vendimin e mbledhjes së fundit të marksistëve të Rusisë ai është formuluar shprehimisht. Ky parim është: të mos lejohet asnjë privilegj kombëtar dhe asnjë pabarazi kombëtare.

Të marrim një shembull konkret për t'ia shpjeguar çështjen bundistit. Në qytetin e Peterburgut, sipas të dhënave të regjistrimit të shkollave të 18 janarit 1911, në shkollat fillore të Ministrisë së «Arsimit» Popullor ka pasur 48 076 nxënës. 396 nga këta, d.m.th. më pak se një për qind, ishin çifutë. Pastaj ka pasur 2 nxënës rumunë, 1 gjeorgjian, 3 armenë etj. A mund të hartohet një program kombëtar «pozitiv» i tillë, që ta parashikojë gjithë këtë larmi kushtesh dhe marrëdhëniesh? (Dhe Peterburgu, sigurisht, nuk është aspak qyteti më «laraman» nga pikëpamja e kombësive në Rusi). Me sa duket, as specialistët në «hollësitë» kombëtare, si bundistët, nuk do të jenë në gjendje të hartojnë një program të tillë.

Kurse po të kishte në kushtetutën e shtetit një ligj themelor që të shpallte të pavlefshme çdo masë që shkel të drejtat e pakicës, — atëherë çdo qytetar do të mund të kërkonte heqjen e një dispozite, e cila, për shembull, do të refuzonte që të paguhen nga shteti mësuat të veçantë të hebraishtes, të historisë çifute etj. ose që të caktohet një lokal shtetëror për t'u dhënë mësimet fëmijëve çifutë, armenë, rumunë, madje edhe

një nxënësi gjeorgjian. Sidoqoftë, nuk është aspak e pamundur që të kënaqen të gjitha dëshirat e drejta dhe të arsyeshme të pakicave kombëtare mbi bazën e barazisë; dhe asnjëri nuk mund të thotë se propaganda e barazisë është e dëmshme. Përkundrazi, propaganda që kërkon ndarjen e shkollës sipas kombësive, propaganda, për shembull, për krijimin e një shkolle çifute të veçantë për fëmijët çifutë në Peterburg do të ishte patjetër e dëmshme, kurse do të ishte krejt i pamundur krijimi i shkollave kombëtare për çdo pakicë kombëtare, për 1, 2, 3 nxënës.

Pastaj, në asnjë ligj shtetëror të përgjithshëm nuk është e mundur të përcaktohet se sa duhet të jetë pakica kombëtare që asaj t'i jepet e drejta të ketë një shkollë të veçantë ose mësues të veçantë lëndësh plotësuese etj.

Përkundrazi, ligji i përgjithshëm i shtetit mbi barazinë mund të përpunohet me hollësi dhe të zhvillohet në dispozita të posaçme, në urdhëresa të sejmëve të krahinave, të qyteteve, të zemstovëve, të komuneve etj.

6. CENTRALIZIMI DHE AUTONOMIA

Zoti Libman në përgjigjen e tij shkruan:

«Merrni te ne Lituaninë, krahinën e Baltikut, Poloninë, Volinjën, jugun e Rusisë etj., — kudo do të gjeni një popullsi të përzier; nuk ka asnjë qytet ku të mos ketë një pakicë kombëtare të madhe. Sado i gjerë që të jetë decentralizimi, kudo në zonat e ndryshme (sidomos në komunitetet e qyteteve) do të ketë kombësi të ndryshme që jetojnë së bashku, kurse pikërisht demokratizmi e lë pakicën kombëtare në mëshirën e shumicës kombëtare. Por, siç dihet, V. I. është armik

i një organizimi shtetëror federativ dhe i një decentralizimi të pafund, si ai i Federatës zvicerane. Lind pyetja, pse atëherë ai sjell si shembull Zvicrën?»

Pse solla si shembull Zvicrën, këtë e shpjegova më lart. Shpjegova gjithashtu se çështja e mbrojtjes së të drejtave të pakicës kombëtare mund të zgjidhet *vetëm* duke botuar një ligj të përgjithshëm shteti në një shtet demokratik konsekuent, i cili të mos bëjë përjashtime nga parimi i barazisë. Por në citatin e mësipërm z. Libman përsërit edhe një arsytim tjetër (ose vërejtje skeptike) nga më të zakonshmit (dhe më të gabuarit) që bëhen zakonisht kundër programit kombëtar marksist dhe që për këtë arsye meritojnë të analizohen.

Marksistët, sigurisht, janë armiq të federatës dhe të decentralizimit për të vetmen arsye se kapitalizmi kërkon për nevojat e zhvillimit të tij shtete sa më të mëdha dhe sa më të centralizuara. Duke mbetur të barabarta të gjitha kushtet e tjera, proletariati i ndër-gjegjshëm do të mbrojë gjithnjë krijimin e një shteti sa më të madh. Ai do të luftojë gjithnjë kundër partikularizimit mesjetar, do të përshëndesë gjithnjë bashkimin ekonomik sa më të ngushtë të territoreve të mëdha, ku të ketë mundësi të zhvillohet në shkallë të gjerë lufta e proletariatit kundër borgjezisë.

Zhvillimi i shpejtë dhe i gjerë i forcave prodhuese nga ana e kapitalizmit kërkon territore të mëdha të lidhura dhe të bashkuara në një shtet, territore që janë të vetmet ku mund të bashkohet, duke i zhdukur të gjitha ndarjet e vjetra mesjetare, të ngushta lokale, kombëtare, fetare dhe çdo ndarje tjetër, klasa e borgjezisë, — e bashkë me të edhe e kundërta e saj e pashmangshme — klasa e proletarëve.

Mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje, d.m.th. për shkëputje dhe për formimin e një shteti kombëtar të pavarur, do të flasim më vete*. Por, përderisa ko-

* Shih Veprat, bot. shqip, vëll. 20, f. 449-522. Red.

mbet e ndryshme përbëjnë një shtet të vetëm, marksistët në asnjë rast nuk do të propagandojnë as parimin e federatës, as decentralizimin. Shteti i madh i centralizuar është një hap historik shumë i madh përpara nga copëtimi mesjetar drejt bashkimit socialist të ardhshëm të të gjithë botës, dhe rrugë tjetër, përveç asaj që kalon nëpërmjet këtij shteti (të lidhur në mënyrë të pazgjydhshme me kapitalizmin), nuk ka dhe as që mund të ketë për të shkuar në socializëm.

Por do të ishte e palejueshme të harrojmë se kur mbrojmë centralizmin në mbrojmë vetëm e vetëm centralizmin *demokratik*. Në lidhje me këtë, fryma mikroborgjeze në përgjithësi dhe fryma mikroborgjeze nacionaliste (duke përfshirë të ndjerin Dragomanov¹³) e kanë ngatërruar aq shumë çështjen, sa që detyrohemi vazhdimisht të humbim kohë për ta shpjeguar.

Centralizmi demokratik jo vetëm që nuk e përjashton vetëqeverisjen lokale dhe autonominë e krahinave që dallohen për kushte ekonomike dhe shoqërore të veçanta, për një përbërje kombëtare të veçantë të popullsisë etj., por, përkundrazi, kërkon medoemos si *njerën ashtu edhe tjetrën*. Te ne centralizmin e ngatërronjë vazhdimisht me arbitrarizmin dhe burokratizmin. Historia e Rusisë, patjetër, duhej të lindte një pështjellim të fillë, por prapëseprapë ai mbetet krejt i palejueshëm për një marksist.

Të gjitha këto mund të shpjegohen fare lehtë në një shembull konkret.

Roza Luksemburgu në artikullin e saj të gjatë: «Çështja kombëtare dhe autonomia»*, ndër shumë gabime të tjera të këndshme (për të cilat do të flasim më poshtë), bën edhe këtë gabim veçanërisht të këndshëm duke kërkuar ta *kufizojë* kërkesën e autonomisë vetëm për Poloninë.

Por të shohim në fillim si e përkufizon ajo autonominë.

* «Przegląd Socjaldemokratyczny¹⁴», Krakov, 1908 dhe 1909.

Roza Luksemburgu e pranon — dhe, duke qenë marksiste, sigurisht, ajo është e detyruar të pranojë, — se të gjitha çështjet ekonomike dhe politike më të rëndësishme dhe themelore për shoqërinë kapitaliste nuk duhet të hyjnë aspak në kompetencat e sejrmeve autonome të krahinave të ndryshme, por vetëm e vetëm të parlamentit qendror, të parlamentit të gjithë shtetit. Në vargun e këtyre çështjeve hyjnë: politika doganore, legjislacioni mbi tregtinë dhe industrinë, ndërlihdja (hekurudhat, posta, telegrafi, telefoni etj.), ushtria, sistemi i tatimeve, e drejta civile* dhe penale, parimet e përgjithshme të arsimit (për shembull, ligji për krijimin e një shkolle thjesht laike, për arsimin e detyrueshëm, për programin minimal, për organizimin demokratik të shkollës etj.), legjislacioni për mbrojtjen e punës, për liritë politike (e drejta e organizimit) etj. etj.

Në kompetencat e sejrmeve autonome — në përputhje me legjislacionin e përgjithshëm shtetëror — hyjnë çështjet me rëndësi thjesht lokale, krahinore ose thjesht kombëtare. Duke e zhvilluar edhe këtë ide me shumë hollësi, për të mos thënë me hollësi të tepëruara, Roza Luksemburgu përmend, për shembull, ndërtimin e hekurudhave me rëndësi lokale (Nr. 12, f. 149), rrugët automobilistike lokale (Nr. 14-15, f. 376) etj.

Është fare e qartë se nuk mund të mendohet një shtet modern me të vërtetë demokratik pa i njohur një autonomi të tillë çdo krahine me veçori ekonomike dhe shoqërore pak a shumë të rëndësishme, me një përbërje kombëtare të veçantë të popullsisë etj. Parimi i centralizmit, që është i domosdoshëm për interesat e zhvillimit të kapitalizmit, jo vetëm që nuk cenohet nga

* Duke e zhvilluar idenë e saj Roza Luksemburgu hyn në hollësira dhe përmend, p.sh. — dhe me plot të drejtë — legjislacionin për ndarjen (Nr. 12, f. 162 e revistës së lartpërmendur).

kjo autonomi (lokale dhe krahinore), por, përkundrazi, në saje të saj vihet pikërisht në jetë, dhe vihet në mënyrë demokratike e jo burokratike. Zhvillimi i gjerë, i lirë dhe i shpejtë i kapitalizmit do të ishte i pamundur, ose të paktën do të ishte shumë i vështirë pa një autonomi të tillë, e cila lehtëson edhe koncentrimin e kapitaleve, edhe zhvillimin e forcave prodhuese, edhe bashkimin e borgjezisë dhe të proletariatit në gjithë shtetin. Sepse ndërhyrja burokratike në çështjet thjesht lokale (krahinore, kombëtare etj.) është një nga pengesat më të mëdha për zhvillimin ekonomik dhe politik në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë është një nga pengesat për centralizmin në çështjet e tij serioze, të rëndësishme dhe themelore.

Prandaj vështirë të mos e vëmë buzën në gaz kur lexojmë se si e mrekullueshmja Roza Luksemburg, me seriozitetin më të madh dhe me fjalë «thjesht marksiste», mundohet të provojë se kërkesat e autonomisë mund të zbatohen vetëm për Poloninë, vetëm si një përjashtim! Sigurisht, këtu nuk ka asnjë pikë patriotizmi për «famullinë e vet», — këtu ka vetëm arsye «praktike»... për shembull, për sa i përket Lituaniës.

Roza Luksemburgu merr katër gubernat: Vilnon, Kovnon, Grodnon dhe Suvalkin, duke i siguruar lexuesit (dhe veten) se atje jetojnë «kryesisht» lituanë, dhe duke bashkuar popullsinë e këtyre gubernave ajo nxjerr se lituanët përbëjnë 23⁰/₁₀₀ të të gjithë popullsisë, dhe po t'u shtohen lituanëve edhe zhmudët, atëherë do të kemi 31⁰/₁₀₀ — më pak se një e treta. Konkluzioni, sigurisht, është se ideja për autonominë e Lituaniës është «arbitrare dhe artificiale» (Nr. 10, f. 807).

Lexuesi që i di të metat e njohura botërisht të statistikës sonë zyrtare ruse do ta shohë menjëherë gabimin e Roza Luksemburgut. Pse të merrte ajo gjithë gubernën e Grodnos, ku lituanët përbëjnë vetëm 0,2⁰/₁₀₀ — dy të dhjetat e përqindjes? Pse të merrte ajo gjithë gubernën e Vilnos, e jo vetëm ujezdin e Trokit, ku lituanët përbëjnë shumicën e popullsisë? Pse të

merre ajo gjithë gubernën e Suvalkit, duke përcaktuar numrin e lituanëve në 52⁰/₀ të popullsisë së saj, e jo ujezdet lituane të kësaj gubernë, d.m.th. 5 ujezde nga 7, ku lituanët përbëjnë 72⁰/₀ të popullsisë?

Është qesharake të flasësh për kushtet dhe kërkesat e kapitalizmit të sotëm dhe të marrësh jo ndarjet administrative «moderne» dhe «kapitaliste», por ndarjet administrative mesjetare, bujkrobërore, burokratike të Ruisë, dhe për më tepër në formën e tyre më trashanike (gubernat, e jo ujezdet). Është e qartë si dita se as që mund të flitet për çfarëdo reforme lokale pak a shumë serioze në Rusi pa i zhdukur këto ndarje dhe pa i zëvendësuar ato me ndarje *me të vërtetë* «moderne», me ndarje që t'u përgjigjen me të vërtetë kërkesave jo të financës së shtetit, jo të burokracisë, jo të rutinës, jo të çifligarëve, jo të priftërinjve, por të kapitalizmit, — dhe në vargun e kërkesave të sotme të kapitalizmit do të jetë, patjetër, kërkesa e një uniteti sa më të madh të përbërjes kombëtare të popullsisë, sepse kombësia, gjuha e njëjtë janë një faktor i rëndësishëm për pushtimin e plotë të tregut të brendshëm dhe për lirinë e plotë të qarkullimit ekonomik.

Është e çuditshme që këtë gabim të dukshëm të Roza Luksemburgut e përsërit bundisti Medem, i cili do që të provojë jo veçoritë «specifike» të Polonisë, por se parimi i autonomisë kombëtare-territoriale është i papërshtatshëm (bundistët përkrahin idenë e autonomisë kombëtare-eksterritoriale!). Bundistët dhe likuidatorët tanë i mbledhin nga janë e nga s'janë të gjitha gabimet dhe të gjitha lëkundjet oportuniste të socialdemokratëve të vendeve dhe kombeve të ndryshme, duke marrë në bagazhin e tyre medoemos *gjërat më të këqija* nga socialdemokracia botërore: me të pretrat nga shkrimet e bundistëve dhe të likuidatorëve, duke i bashkuar të gjitha në një vend, do të mund të krijohet një *muze socialdemokrat shembullor gjërash të shëmtuara*.

Autonomia krahinore — arsyeton Medemi — vlen për një krahinë, për një «qark» e jo për rrethet letone, estone etj. që kanë një popullsi që shkon nga gjysmë milioni deri në 2 milionë njerëz dhe që zënë një territor sa një gubernë. «Kjo nuk do të ishte autonomi, por një zemstvo e zakonshme... Mbi këtë zemstvo do të duhej ndërtuar një autonomi e vërtetë»... dhe autori e dënon «prishjen» e gubernave dhe të ujezdeve të vjetra*.

Në të vërtetë, ruajtja e ndarjeve administrative mesjetare, bujkrobëruese, burokratike do të thotë «prishje» dhe shtrembërim i kushteve të kapitalizmit të sotëm. Vetëm njerëzit e mbryjtur me frymën e këtyre ndarjeve mund të mendojnë «me pamjen e të diturve dhe kompetentëve» të vënë nocionin e «zemstvos» përballë nocionit «të autonomisë» të shqetësuar nga fakti se, sipas shabllonit, «autonomia» duhet të zbatohet për krahinat e mëdha, kurse zemstvoja për të voglat. Kapitalizmi i sotëm nuk ka aspak nevojë për këto shabllone burokratike. Pse të mos ketë rrethe kombëtare autonome me një popullsi jo vetëm prej gjysmë milioni, por edhe prej 50 000 banorësh, — pse këto rrethe të mos bashkohen në mënyrat më të ndryshme me rrethet fqinje me madhësi të ndryshme në një «qark» autonom të vetëm, në qoftë se kjo mund të bëhet, në qoftë se kjo është e nevojshme për qarkullimin ekonomik, — të gjitha këto mbeten një e fshehtë e bundistit Medem.

Do të vërejmë se programi kombëtar socialdemokrat i Brynit bazohet tërësisht mbi autonominë kombëtare-territoriale, duke propozuar që Austria «në vend të tokave historike të kurorës» të ndahet në rrethe «të kufizuara në bazë të kombësisë» (§ 2 i programit të Brynit). Ne nuk do të shkonim kaq larg. S'ka dyshim se përbërja kombëtare e njëjtë e popullsisë

* V. Medem: «Për mënyrën se si shtrohet çështja kombëtare në Rusi», «Vjestnik Evropi», 1912, Nr. Nr. 8 dhe 9.

është një nga faktorët më të sigurt për një qarkullim tregtar të lirë dhe të gjerë dhe me të vërtetë modern. S'ka dyshim se asnjë marksist, dhe madje asnjë demokrat i vendosur, nuk do t'i mbrojë tokat e kurorës në Austri dhe gubernat e ujezdet në Rusi (ato nuk janë aq të këqija sa tokat e kurorës në Austri, por prapëseprapë janë shumë të këqija), nuk do ta kundërshtojë domosdoshmërinë që këto ndarje të vjetruara të zëvendësohen me ndarje të reja, mundësisht, në bazë të përbërjes kombëtare të popullsisë. S'ka dyshim, më në fund, se për zhdukjen e çdo shtypjeje kombëtare ka shumë rëndësi të krijohen rrethe autonome, qoftë edhe fare të vogla, me një përbërje kombëtare të njëjtë, homogjene, rreth të cilave do të mund të «tërhiqeshin» dhe me të cilat do të mund të vendosnin lidhje e bashkime të lira të çdo lloji pjesëtarët e kombësisë përkatëse, të shpërndarë në të katër anët e vendit ose edhe të botës. Të gjitha këto janë të padiskutueshme, të gjitha këto mund të kundërshtohen vetëm duke u nisur nga pikëpamja e ngushtë burokratike.

Por përbërja kombëtare e popullsisë është një nga faktorët ekonomikë më të rëndësishëm, por nuk është i vetmi dhe as më i rëndësishmi në vargun e gjithë faktorëve të tjerë. Qytetet, p.sh., luajnë një rol ekonomik shumë të rëndësishëm në kapitalizëm, dhe kudo qytetet — edhe në Poloni edhe në Lituanë edhe në Ukrainë edhe në Rusi etj. karakterizohen nga një larmi shumë e madhe në përbërjen kombëtare të popullsisë. Është absurde dhe e pamundur që për hir të faktorit «kombëtar» të shkëputen qytetet nga fshatrat dhe rrethet që tërhiqen ekonomikisht prej tyre. Prandaj marksistët nuk duhet të qëndrojnë tërësisht dhe krejtësisht mbi truallin e parimit «kombëtar-territorial».

Dhe ajo zgjidhje e çështjes, që është formuluar nga mbledhja e fundit e marksistëve rusë, është shumë më e drejtë se zgjidhja që i kanë dhënë austriakët. Kjo mbledhje formuloi për çështjen në fjalë këtë tezë:

... «është... e dëmosdoshme ekzistenca e një autonomie të gjerë krahinore» (sigurisht, jo vetëm për Poloninë, por për të gjitha krahinat e Rusisë) «dhe e organeve të vetëqeverisjes lokale me të vërtetë demokratike duke u caktuar kufijtë e krahinave autonome dhe që gëzojnë të drejtën e vetëqeverisjes» (jo në bazë të kufijve të gubernave, ujezdeve etj. të sotme), «por në bazë të një vlerësimi nga ana e vetë popullsisë lokale të veçorive ekonomike dhe të jetesës, të përbërjes kombëtare të popullsisë etj.»*.

Këtu përbërja kombëtare e popullsisë është vënë përmbri kushteve të tjera (në radhë të parë ekonomike, pastaj shoqërore etj.), që duhet të shërbejnë si bazë për caktimin e kufijve të rinj, të cilët t'i përgjigjen kapitalizmit të sotëm, e jo frymës burokratike dhe aziatike. Vetëm popullsia vendase mund t'i «vlerësojë» me saktësinë më të madhe të gjitha këto kushte, e në bazë të këtij vlerësimi parlamenti qendror i shtetit do të përcaktojë kufijtë e krahinave autonome dhe sferën e kompetencave të sejmëve autonome.

* *
*

Na mbetet ende të analizojmë çështjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje. Për këtë çështje një koleksion i tërë oportunistësh të të gjitha kombësive — edhe likuidatori Semkovski, edhe bundisti Libman, edhe nacional-sociali ukrainas Lev Junkeviç — është mobilizuar për të «popullarizuar» gabimet e Roza Luksemburgut. Artikullin e ardhshëm do t'ia kushtojmë kësaj çështjeje tmerrsisht të ngatërruar nga i gjithë ky «koleksion».

Shkruar në tetor—dhjetor
1913

Veprat, bot. shqip, vëll. 20,
f. 1-43

* Shih Veprat, bot. shqip, vëll. 19, f. 489. Red.

LIBERALËT ANGLEZË DHE IRLANDA

Ajo që po ndodh tani në parlamentin anglez për projektligjin mbi *homrulin* irlandez (vetëqeverisjen ose, më sakt, autonominë për Irlandën), paraqet një interes të madh si nga pikëpamja e marrëdhënieve të klasës, ashtu edhe nga pikëpamja e sqarimit të çështjes kombëtare dhe të çështjes agrare.

Për shekuj të tërë Anglia e ka skllavëruar Irlandën, i ka bërë fshatarët irlandezë të heqin mjerime të pashembullta nga uria dhe të shuhen dalngadalë prej saj, i ka dëbuar nga tokat e tyre, ka detyruar qindra mijëra dhe miliona fshatarë ta braktisin vendlindjen e tyre dhe të mërgojnë në Amerikë. Në fillim të shekullit XIX në Irlandë kishte 5 500 000 banorë, sot ka vetëm pak më shumë se 4 300 000. Irlanda është cpopulluar. Gjatë shekullit XIX më shumë se 5 milionë irlandezë mërguan në Amerikë, kështu që sot në Shtetet e Bashkuara ka më shumë irlandezë se në Irlandë.

Vuajtjet dhe mjerimet e pashembullta të fshatarëve irlandezë janë një nga shembujt mësimdhënës që na tregojnë se ku mund të arrijnë çifligarët dhe borqezët liberalë të kombit «sundues». Anglia ia detyron shumë zhvillimin e saj «të shkëlqyer» ekonomik, «julëzimin» e industrisë dhe të tregtisë së saj këtij trajtimi

të fshatarësisë irlandeze, që na kujton çifligaren ruse Saltçigja.

Anglia «lulëzonte», kurse Irlanda shfarosej dhe mbetej e pazhvilluar, gjysmë e egër, vend thjesht bujqësor, vend fshatarësh të varfër qiramarrës. Por sado e madhe që ishte dëshira e borgjezisë «së kulturuar dhe liberale» të Anglisë për ta përjetësuar skllavërinë e Irlandës dhe varfërinë e saj, prapëseprapë reforma ishte e pashmangshme. — aq më tepër se shpërthimet revolucionare të luftës së popullit irlandez për liri dhe tokë po bëheshin gjithnjë më të tmerrshme. Më 1861 u formua organizata revolucionare irlandeze e *fenive*. Irlandezët që kishin mërguar në Amerikë e ndihmonin atë me çdo mjet.

Me formimin, më 1868-s, të qeverisë së Gladstonit, të këtij heroi të borgjezëve liberalë dhe të mikroborgjezëve kokëtrashë, fillon epoka e *reformave* në Irlandë, — epokë që u zgjat me sukses të plotë deri në ditët tona, d.m.th. pothuajse për gjysmë shekulli. Po, burrat e urtë të shtetit të borgjezisë liberale dinë të «nxitojnë shumë ngadalë» «me reformat» e tyre!

Karl Marksi, i cili kishte më shumë se 15 vjet që jetonte në Londër, ndiqte me interesim dhe simpati shumë të madhe luftën e irlandezëve. Më 2 nëntor 1867 ai i shkroi Fridrih Engelsit: «Unë bëra çmos që të shpërthente një manifestim i punëtorëve anglezë në dobi të fenianizmit. Më parë mendoja se shkëputja e Irlandës nga Anglia ishte e pamundur. Tani e quaj të pashmangshme, edhe sikur pas shkëputjes të arrihet në federatë...». Në letrën e 30 nëntorit po të atij viti Marksi e prek përsëri këtë temë: ...«Lind pyetja: çfarë duhet t'u këshillojmë ne punëtorëve *anglezë*? Sipas mendimit tim, ata duhet të shënojnë në programin e tyre si një pikë të veçantë *heqjen e unionit* (me pak fjalë, *kërkesën e vitit 1873*, vetëm se të demokratizuar dhe të përshtatur pas kushteve të sotme). Kjo është e vetmja formë *legale* e çlirimit të Irlandës dhe prandaj e vetmja formë e mundshme për t'u pranuar

në programin e një partie *angleze*¹⁵. Dhe më tej Marksi provonte se ajo që u duhet irlandezëve është vetëqeverisja dhe pavarësia nga Anglia, një revolucion agrar dhe taksat doganore kundër Anglisë.

Ky ishte programi që K. Marksi u propozonte punëtorëve anglezë në interes të lirisë së Irlandës, të shpejtit të zhvillimit shoqëror dhe të lirisë së punëtorëve anglezë; sepse punëtorët anglezë nuk mund ta fitonin lirinë përderisa ndihmonin (ose madje lejonin) që të mbahej nën skllavëri një popull tjetër.

Por, mjerisht, për shkak të një vargu të tërë arsyes historike të veçanta në tridhjetë vjetët e fundit të shekullit XIX punëtorët anglezë ndodheshin nën varësinë e liberalëve dhe ishin të mbujtur me frymën e politikës punëtore liberale. Në vend që të qëndronin në krye të popujve dhe të klasave që luftonin për liri, ata u ndodhën në bisht të shërbëtorëve të urryer të qeses me para, të zotërinjve liberalë anglezë.

Dhe liberalët e zvarritën për gjysmë shekulli çlirimin e Irlandës, i cili as sot nuk ka marrë fund! Vetëm në shekullin XX fshatari irlandez filloi të shndërrohej nga qiramarrës në pronar të lirë toke, por zotërinjtë liberalë i imponuan atij një *shpengim me çmim «të arsyeshëm»!* Ai u ka paguar dhe do të vazhdojë t'u paguajë për kush e di se sa vjet miliona e miliona sterlina haraç çifligarëve anglezë si shpërblim që e grabitën për shekuj me radhë dhe e katandisën të vuajë vazhdimisht nga uria. Borgjezët liberalë anglezë i detyruan fshatarët irlandezë që t'i shpërblejnë çifligarët për këtë me para në dorë...

Sot në parlament po diskutohet ligji mbi *homru- lin* (vetëqeverisjen) e Irlandës. Por në Irlandë kemi krahinën veriore të Ulsterit (ose Ulsterit, siç e shkruajnë disa herë gabimisht); ajo banohet pjesërisht nga njerëz me origjinë angleze që janë protestantë, ndryshe nga irlandezët që janë katolikë. Dhe kështu konservatorët anglezë me në krye çifligarin ultrareaksionar Purishkeviç... ose Karson, që është e njëjta gjë,

kanë filluar të ulërijnë me tërbim kundër autonomisë së Irlandës. Sipas tyre kjo do të thotë që banorët e Ulsterit t'u nënshtrohen njerëzve të një besimi tjetër dhe të një kombësie tjetër! Lord Karsoni u kanos se do të shpërthejë kryengritjen dhe organizonte banda të armatosura ultrareaksionarësh.

Sigurisht, kjo kanosje është e kotë. As që mund të bëhet fjalë për kryengritje të një grushti vagabondësh. Dhe nuk ishte rasti të flitej as për «shtypjen» e protestantëve nga parlamenti irlandez (pushtimi i të cilit caktohet me ligj anglez).

Gjithë puna është se çifligarët ultrareaksionarë duan t'i frikësojnë liberalët.

Dhe liberalët tremben, u përuien ultrareaksionarëve, u bëjnë lëshime, propozojnë që në Ulster të organizohen votime të veçanta me pjesëmarrjen e gjithë popullit (i ashtuquajtur i referendum) dhe zbatimi i reformës në Ulster të shtyhet për gjashtë vjet!

Pazarllëqet ndërmjet liberalëve dhe ultrareaksionarëve vazhdojnë. Reforma mund të presë: siç pritën gjysmëshekulli, irlandezët mund të presin edhe pak, sepse nuk mund «t'u prishet qejfi» çifligarëve!

Sigurisht, sikur liberalët t'i drejtoheshin popullit të Anglisë, proletariatit, — banda ultrareaksionare e Karsonit do të shkrihej dhe do të zhdukej menjëherë. Liria e plotë e Irlandës do të sigurohej në mënyrë paqësore.

Po a është e mundur që borgjezët liberalë t'i kërkojnë ndihmë proletariatit kundër çifligarëve? Të mos harrojmë se edhe në Angli liberalët janë shërbëtorë të qeses me para dhe dinë vetëm të bien më gjunjë përpara Karsonëve.

BARAZIA KOMBËTARE

Në Nr. 48 (të 28 marsit) të gazetës «Put Pravdi» fraksioni i Partisë Punëtore Socialdemokrate Ruse botoi një projektligj për barazinë kombëtare ose, siç thuhet në titullin e tij zyrtar, — «Projektligjin për heqjen e të gjitha kufizimeve të të drejtave të çifutëve dhe të të gjitha kufizimeve në përgjithësi që kanë lidhje me origjinën ose me kombësinë»*.

Ndër shqetësimet e telashet që u shkakton lufta për ekzistencë, për kafshatën e gojës, punëtorët rusë nuk mund dhe nuk duhet ta harrojnë atë shtypje kombëtare, nën zgjedhën e së cilës ndodhen dhjetëra e dhjetëra milionë «njerëz me kombësi tjetër» që banojnë në Rusi. Kombësia sunduese — rusët — përbëjnë rreth 45 për qind të gjithë popullsisë së perandorisë. Në çdo 100 banorë, më shumë se 50 janë «me kombësi tjetër».

Dhe kushtet e jetës së gjithë kësaj popullsie të madhe janë edhe më çnjerëzore se ato të njeriut rus.

Politika e shtypjes së kombësive është politika e *ndarjes* së kombeve. Njëkohësisht ajo është politika e *korruptimit* sistematik të ndërgjegjes së popullit. Ultrareaksionarët të gjitha llogaritë e tyre i mbështe-

* Shih Veprat, bot. shqip, vëll. 20, f. 186, 187. Red.

tin në vënien e interesave të kombeve të ndryshme përballë njëri-tjetrit, në helmimitin e ndërgjegjes së masave të shtypura dhe të paditura. Merrni çdo fletushkë ultrareaksionare dhe do të shihni se ndjekja e «njerëzve me kombësi tjetër», ndezja e mosbesimit reciprok ndërmjet fshatarit rus, borgjezit të vogël rus e zejtarit rus, nga njëra anë dhe fshatarit, borgjezit të vogël e zejtarit çifut, finlandez, polonez, gjeorgjian, ukrainas, nga ana tjetër, është buka me të cilën ushqehet gjithë banda ultrareaksionare.

Por klasa punëtore ka nevojë jo për ndarje, por për bashkim. Nuk ka armik më të keq për të se paragjykimet dhe bestytnitë e egra që përhapin në radhët e saj të paditura armiqtë e saj. Shtypja e «njerëzve me kombësi tjetër» është një thikë me dy presa. Me njërin ai qëllon «njerinë me kombësi tjetër», me tjetrën popullin rus.

Dhe prandaj klasa punëtore duhet të shprehet me vendosmërinë më të madhe kundër çfarëdo shtypjeje të kombësive.

Përballë agjitacionit të ultrareaksionarëve, që mundohen ta përqendrojnë vëmendjen e saj te ndjekja e njerëzve me kombësi tjetër, ajo duhet të vërë bindjen e vet për domosdoshmëri e barazi të plotë, për zhdukjen e plotë dhe përfundimtare të çfarëdo privilegji të çdo kombi.

Ultrareaksionarët bëjnë një agjitacion plot urrejtje kundër çifutëve. Purihkeviçët mundohen t'ia ngarkojnë popullit çifut të gjitha mëkatet e veta.

Dhe prandaj me plot të drejtë fraksioni i PPSDR-së në projektligjin e tij vendin kryesor ia ka dhënë çështjes së mungesës së të drejtave të çifutëve.

Edhe shkolla edhe shtypi edhe tribuna e parlamentit — të gjitha, çdo gjë shfrytëzohet për të përhapur urrejtjen e errët, të egër dhe të thellë për çifutët.

Me këtë punë të fëlliqur, të ndyrë nuk merren vetëm fundërrinat ultrareaksionare, por edhe profe-

sorët, shkencëtarët, gazetarët e deputetët reaksionarë. Miliona e miliarda rubla harxhohen për ta helmuar ndërgjegjen e popullit.

Është një detyrë nderi për punëtorët rusë që projektligji i fraksionit të PPSDR-së kundër shtypjes kombëtare të përforcohet me dhjetëra mijëra nënshkrime dhe deklarata proletare... Kjo do të jetë mënyra më e mirë për të forcuar unitetin e plotë, bashkimin e gjithë punëtorëve të Ruisë pa dallim kombësie.

«Put Pravdi» Nr. 62,
16 prill 1914

Veprat, bot. shqip, vëll. 20,
f. 262-264

KORRUPTIMI I PUNËTORËVE ME ANË TË NACIONALIZMIT TË STËRHOLLUAR

Sa më shumë zhvillohet lëvizja punëtore, aq më të dëshpëruara bëhen orvatjet e borgjezisë dhe të bujkrobëruesve për ta shtypur ose për ta përçarë atë. Të dyja këto metoda, shtypja me anë të dhunës dhe përçarja me anë të ndikimit borgjez, ushtrohen vazhdimisht në gjithë botën, në të gjitha vendet, dhe partitë e ndryshme të klasave sunduese vënë në rendin e ditës dhe përdorin herë njëherë, herë tjetrën prej tyre.

Në Rusi, sidomos pas vitit 1905, kur për borgjezët më të mençur u bë e qartë se vetëm dhuna ishte e kotë, partitë dhe grupet e ndryshme «progresiste» të borgjezisë filluan të përdornin gjithnjë më shpesh metodën e *ndarjes* së punëtorëve me anë të propagandës së ideve dhe teorive të ndryshme borgjeze që e dobësojnë luftën e klasës punëtore.

Një nga këto ide është edhe nacionalizmi i stërholluar, që propagandon ndarjen dhe përçarjen e proletariatit me pretekste që paraqiten si të mira dhe tingëllojnë bukur, për shembull, me pretekstin e mbrojtjes së interesave të «kulturës kombëtare», «të autonomisë ose pavarësisë kombëtare» etj. etj.

Punëtorët e ndërgjegjshëm bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i bërë ballë çdo nacionalizmi, si naciona-

lizmit më brutal, ultrareaksionar, që imponohet me dhunë, ashtu edhe nacionalizmit më të stërholluar, që propagandon barazinë e kombeve *bashkë*. . . me *përçarjen* e çështjes punëtore, të organizatave punëtore, të lëvizjes punëtore në bazë të kombësive. Punëtorët e ndërgjegjshëm, duke vënë në jetë vendimet e mbledhjes së fundit të marksistëve (lë verës së vitit 1913), mbrojnë — ndryshe nga borgjezia nacionaliste e të gjitha nuancave — jo vetëm zbatimin më të plotë, konsekuent dhe deri në fund të parimit të *barazisë* së kombeve dhe të gjuhëve, por edhe *shkrirjen* e punëtorëve të kombësive të ndryshme në organizatat proletare *unike* të çdo lloji.

Këtu qëndron ndryshimi rrënjësor ndërmjet programit kombëtar të marksizmit dhe çfarëdo programi të borgjezisë, qoftë edhe programit më «përparimtar».

Njohja e barazisë së kombeve dhe të gjuhëve është e shtrenjtë për marksistët jo vetëm sepse ata janë demokratët më konsekuentë. Interesat e solidarësisë proletare, të unitetit shoqëror të luftës së klasës të punëtorëve kërkojnë barazinë më të plotë të kombeve për të zhdukur edhe mosbesimin më të vogël kombëtar, për të zhdukur çdo izolim, dyshim dhe armiqësi. Dhe barazia e plotë përfshin edhe zhdukjen e çdo privilegji të një gjuhe, përfshin njohjen e së drejtës për vetëvendosje për të gjitha kombet.

Por shumë herë për borgjezinë kërkesa e barazisë së kombeve në praktikë do të thotë propagandë e ekskluzivitetit kombëtar dhe e shovinizmit, shoqërohet me *propagandën* e ndarjes dhe të izolimit të kombeve. *Internacionalizmi* proletar, i cili propagandon jo vetëm *afrimin* e kombeve, por *shkrirjen* e punëtorëve të të gjitha kombësive të një shteti në organizata proletare *unike*, *patjetër* nuk mund të pajtohet me këtë. Prandaj marksistët e dënojnë me vendosmëri të ashtuquajturën «autonomi kombëtaro-kulturore»; domethënë *heqjen* e shkollës nga duart e shtetit për ta lënë në duart e kombësive të *veçanta*. Ky plan do të thotë që, për sa

u përket çështjeve të «kulturës kombëtare», shkolla të ndahet sipas kombësive të shtetit përkatës — në bashkime kombëtare, me sejmë, fonde shkollore, këshilla shkollore dhe institucione shkollore të veçanta.

Ky është një plan i nacionalizmit të stërholluar, që e korrupton dhe e ndan klasën punëtore. Përballë këtij plani (të bundistëve, të likuidatorëve, të narodnikëve, d.m.th. të grupeve të ndryshme mikroborgjeze) marksistët vënë këtë parim: barazia më e plotë e kombeve dhe gjuhëve deri te mohimi i nevojës që të ketë një gjuhë zyrtare, por njëkohësisht mbrojtja e një afrimi sa më të madh të kombeve, e unitetit të institucioneve shtetërore për të gjitha kombet, e unitetit të këshillave shkollore, e unitetit të politikës shkollore (shkolla laike!), e unitetit të punëtorëve të kombeve të ndryshme në luftën kundër nacionalizmit të çdo borgjezie kombëtare, nacionalizëm që maskohet me parullën e «kulturës kombëtare» me qëllim që të mashtrohen njerëzit naivë.

S'ka gjë në goftë se nationalistët mikroborgjezë, bundistët, likuidatorët, narodnikët, bashkëpunëtorët e gazetës «Dzvin» i mbrojnë haptazi parimet e nacionalizmit të tyre të stërholluar borgjez, kjo është një e drejtë e tyre. Por le të mos i gënjejnë punëtorët, siç bën, p.sh., zonja V.O. në Nr. 35 të «Severnaja Raboçaja Gazetës», duke u munduar t'ua mbushë mendjen lexuesve se gjoja gazeta «Za Pravdu» e mohon dhënien e mësimit në gjuhën amtare!!!

Kjo është një shpifje trashanike, sepse pravdistët jo vetëm që e njohin këtë të drejtë, por e njohin atë në mënyrë më konsekuente se kushdo tjetër. Pravdistët janë të parët në Rusi të cilët, pasi u bashkuan me mbledhjen e marksistëve që shpalli se nuk është e domosdoshme të ketë një gjuhë zyrtare të detyrueshme, i njohën tërësisht të drejtat e gjuhës amtare!

Të ngatërrosh dhënien e mësimit në gjuhën amtare me «ndarjen e shkollës në bazë të kombësive brenda kufijve të një shteti», me «autonominë kombëtareo-kul-

turore», me «heqjen e shkollës nga duart e shtetit» do të thotë të tregosh padijen më të madhe.

Në asnjë vend të botës marksistët (madje as demokratët) nuk e mohojnë dhënien e mësimit në gjuhën amtare. Dhe në asnjë vend të botës marksistët nuk e kanë pranuar programin e «autonomisë kombëtare-kulturore», — ai u propozua vetëm në Austri.

Shembulli i Finlandës, që përmend zonja V.O., kthehet kundër saj, sepse në këtë vend është njohur dhe është vënë në jetë barazia e kombeve dhe e gjuhëve (gjë që ne e njohim pa kushte dhe në mënyrë më konsekuente se kushdo tjetër), por këtu as që bëhet fjalë për «ta hequr shkollën nga duart e shtetit», për bashkime kombëtare të veçanta që ta drejtojnë gjithë punën e shkollës, për ndarjen e gjithë arsimit shtetëror me gjerdhe kombëtare etj.

«Put Pravdi» Nr. 82,
10 maj 1914

Veprat, bot. shqip, vëll. 20,
f. 323-326

Nga artikulli:

«PËR TË DREJTËN E KOMBEVE PËR VETËVENDOSJE»

Paragrafi 9 i programit të marksistëve rusë, që flet për të drejtën e kombeve për vetëvendosje, ka shkaktuar këto kohët e fundit (siç kemi treguar në «Prosveshenie»)* një fushatë të tërë të oportunistëve. Si likuidatori rus Semkovski në gazetën likuidatoriste të Peterburgut, ashtu edhe bundisti Libman dhe socialnacionalisti ukrainas Jurkeviç janë vërsulur në organet e tyre kundër këtij paragrafi, duke e trajtuar me përbuzjen më të madhe. S'ka asnjë dyshim se ky «sulm i përgjithshëm» i oportunitizmit kundër programit tonë marksist lidhet ngushtë me lëkundjet e tanishme nacionaliste në përgjithësi. Prandaj e gjejmë me vend ta analizojmë me hollësi këtë çështje. Po shënojmë vetëm se asnjë nga oportunistët e lartpërmendur s'ka paraqitur as edhe një argument të vetin: të gjithë përsëritin atë që kishte thënë Roza Luksemburgu më 1908-1909 në artikullin e saj të gjatë në gjuhën poloneze: «Çështja kombëtare dhe autonomia».

* Shih këtë përmbledhje f. 62-102. Red. Përkth.

Gjatë parashtrimit tonë ne do të kemi më shumë parasysh pikërisht argumentet «origjinale» të kësaj autoreje.

1. Ç'ËSHTË VETËVENDOSJA E KOMBEVE?

Është e natyrshme se kjo çështje del në plan të parë, kur bëhen përpjekje për ta shqyrtuar nga pikëpamja marksiste të ashtuquajturën vetëvendosje. Ç'duhet kujtuar me këtë? A duhet kërkuar një përgjigje në definicionet (përkufizimet) juridike të nxjerra nga çfarëdo lloj «nacionesh të përgjithshme» të së drejtës? Apo përgjigjja duhet kërkuar në studimin historik dhe ekonomik të lëvizjeve kombëtare?

S'është për t'u çuditur që Semkovskët, Libmanët, Jurkeviçët as që janë kujtuar ta shtrojnë këtë çështje dhe që janë kufizuar me një ngërdheshje për «paqartësinë» e programit marksist, dhe, siç duket, pa ditur, nga naiviteti i tyre, se për vetëvendosjen e kombeve flet jo vetëm programi rus i 1903-së, por edhe rezolucioni i kongresit ndërkombëtar, që u mbajt në Londër më 1896 (për këtë do të flasim me hollësi kur t'i vijë koha). Shumë e çuditshme është se Roza Luksemburgu, që flet aq shumë për karakterin gjoja abstrakt e metafizik të këtij paragrafi, ka rënë vetë në këtë mëkat të abstraksionit dhe të metafizikës. Pikërisht Roza Luksemburgu shket vazhdimisht në arsyetime të përgjithshme (aq sa arrin madje në arsyetime krejt qesharake për mënyrën se si mund të njihet vullneti i një kombi), pa e shtruar qartë dhe sak në asnjë vend problemin nëse thelbi i çështjes është në përkufizimet juridike apo në përvojën e lëvizjeve kombëtare të mbarë botës.

Po të shtrohej sak kjo çështje, që është e domos-

doshme për një marksist, do të binin poshtë menjëherë nëntë të dhjetat e argumenteve të Roza Luksemburgut. Nuk është e para herë që shfaqen në Rusi lëvizje kombëtare, dhe nuk janë karakteristike vetëm për të. Në tërë botën epoka e fitores përfundimtare të kapitalizmit mbi feudalizmin ka qenë e lidhur me lëvizje kombëtare. Baza ekonomike e këtyre lëvizjeve qëndron në atë që për fitoren e plotë të prodhimit të mallrave është i domosdoshëm pushtimi i tregut të brendshëm nga borgjezia, është i domosdoshëm bashkimi shtetëror i vendeve me popullsi që flet të njëjtën gjuhë, duke zhdukur të gjitha pengesat që ndalojnë zhvillimin e kësaj gjuhe dhe filksimin e saj në letërsi. Gjuha është mjeti më i rëndësishëm i komunikimit ndërmjet njerëzve; uniteti i gjuhës, zhvillimi i lirë i saj është një nga kushtet më të rëndësishme për një qarkullim tregtar me të vërtetë të lirë dhe të gjerë, që i përgjigjet kapitalizmit të sotëm, për një grumbullim të lirë dhe të gjerë të popullsisë në klasa të veçanta, më në fund — kusht për një lidhje të ngushtë të tregut me çdo pronar, të madh ose të vogël me çdo shitës ose çdo blerës.

Prandaj tendenca e çdo lëvizjeje kombëtare është formimi i shteteve kombëtare, që i përmbushin më mirë këto nevoja të kapitalizmit të sotëm. Faktorët më të thellë ekonomikë shpjen në këtë drejtim, dhe për tërë Evropën Perëndimore — madje edhe më tepër: për tërë botën e qytetëruar — tipik, normal për periudhën kapitaliste është shteti kombëtar.

Pra, në qoftë se duam të kuptojmë se ç'është vetëvendosja e kombeve, pa luajtur me përkufizime juridike, pa «shpikur» përkufizime abstrakte, por duke analizuar kushtet historiko-ekonomike të lëvizjeve kombëtare, do të arrijmë patjetër në këtë konkluzion: me fjalët vetëvendosje e kombeve kuptohet shpikëputja shtetërore e tyre nga kolektiviteti me kombësi të huaj, kuptohet formimi i një shteti kombëtar të pavarur.

Më poshtë do të shohim edhe shkaqe të tjera pse

do të ishte gabim që me fjalët e drejtë për vetëvendosje të kuptohej diçka tjetër veç së drejtës për të qenë si shtet më vite. Tani duhet të shikojmë se si është orvatur Roza Luksemburgu t'i «shpëtojë» përfundimit të pashmangshëm për shkaqet e thella ekonomike të tendencave drejt një shteti kombëtar.

Roza Luksemburgu e njuh fare mirë broshurën e Kautskit: «Nacionalizmi dhe internacionalizmi» (shtojcë e «Neue Zeit» Nr. 1, 1907-1908; përkthyer rusisht në revistën «Naučnaja Misl», Rigë, 1908). Ajo e di se Kautski, pasi analizoi me hollësi në paragrafin 4 të kësaj broshure çështjen e shtetit kombëtar, arriti në përfundimin se Oto Baueri «e nënvlerëson forcën e tendencës për të formuar një shtet kombëtar» (f. 23 e broshurës në fjalë). Roza Luksemburgu i citon vetë këto fjalë të Kautskit: «Shteti kombëtar është forma e shtetit që u përshtatet më mirë kushteve të sotme» (d.m.th. të kapitalizmit, të qytetërimit, të përparimit ekonomik, që ndryshojnë nga kushtet e mesjetës, të parakapitalizmit etj.), «është forma në të cilën ai mund të përmbushë më lehtë detyrat e tij» (d.m.th. detyrat e zhvillimit më të lirë, më të gjerë e më të shpejtë të kapitalizmit). Kësaj i duhet shtuar vërejtja përfundimtare më e përpiktë e Kautskit se shtetet me përbërje kombëtare të ndryshme (të quajtura shtete shumëkombëshe për t'i dalluar nga shtetet kombëtare) janë «gjithmonë ato shtete, formimi i brendshëm i të cilave ka mbetur, për një arsye ose një tjetër, jonormal ose i pazhvilluar» (i prapambetur). Kuptohet vetiu se Kautski flet për formim jonormal vetëm në kuptimin që shteti nuk i përgjigjet asaj që u përshtatet më mirë kërkesave të kapitalizmit në zhvillim.

Dhe tani mund të pyetet, ç'mendim kishte Roza Luksemburgu për këto përfundime historiko-ekonomike të Kautskit? I quante të drejta apo të gabuara? A ka të drejtë Kautski me teorinë e tij historiko-ekonomike apo Baueri, teoria e të cilit është në thelb psikologjike? Ç'lidhje kanë «oportunizmi kombëtar» i pamohu-

eshëm i Bauerit, mbrojtja e autonomisë kombëtare-kulturore nga ai, prirjet e tij nacionaliste («aty-këtu theksohet faktori kombëtar», siç është shprehur Kautski), «teprimi i madh i faktorit kombëtar nga ai dhe harrimi i plotë i faktorit ndërkombëtar» (Kautski), me nënçmimin e forcës së tendencave për formimin e shtetit kombëtar?

Roza Luksemburgu as që e ka shtruar fare këtë çështje. Ajo nuk e ka vënë re këtë lidhje. Ajo nuk ka menduar për tërësinë e pikëpamjeve teorike të Bauerit. Ajo as që e ka krahasuar fare teorinë historiko-ekonomike me teorinë psikologjike në çështjen kombëtare. Ajo është kufizuar me vërejtjet e mëposhtme kundër Kautskit.

«...Ky shtet kombëtar «më i mirë» është vetëm një abstraksion që mund të zhvillohet dhe të mbrohet lehtë në teori, por që nuk i përgjigjet aspak realitetit» («Przeglad Socjaldemokratyczny»*, 1908, Nr. 6, f. 499).

Dhe si prova të kësaj deklarate të prerë vijnë arsyetime që thonë se zhvillimi i fuqive të mëdha kapitaliste dhe imperializmi e bëjnë «ëndërr» për popujt e vegjël «të drejtën për vetëvendosje». «A mund të flitet seriozisht, — thërret Roza Luksemburgu, — për «vetëvendosje» të malazezëve, bullgarëve, rumunëve, serbëve, grekëve, e pjesërisht edhe të zviceranëve, të cilët janë formalisht të pavarur dhe pavarësia e të cilëve është vetë një produkt i luftës politike dhe i lodrës diplomatike të «koncertit evropian»?!» (f. 500). Shteti që u përgjigjet më mirë kushteve të tanishme «nuk është shteti kombëtar, siç mendon Kautski, por shteti grabitqar». Vijnë pastaj disa dhjetëra shifra për madhësinë e kolonive që ka Anglia, Franca etj.

Kur lexon arsyetime të tilla s'ka si të mos çuditesh me pazotësinë e autorit për të kuptuar se si çën-

* — «Pasqyra Socialdemokrate». Red.

dron puna! T'i mësosh Kautskit me një ton solemn se shtetet e vogla varen ekonomikisht nga më të mëdhatë; se ndër shtetet borgjeze bëhet luftë për të shtypur e grabitur pa mëshirë kombet e tjera; se ka imperializëm dhe koloni — kjo është të shesësh mend në mënyrë qesharake, sepse të gjitha këto s'kanë asnjë lidhje me çështjen. Jo vetëm shtetet e vogla, por edhe Rusia, për shembull, janë krejt të varura ekonomikisht nga fuqia e kapitalit financiar imperialist të vendeve «të pasura» borgjeze. Jo vetëm shtetet në miniauturë të Ballkanit, por edhe Amerika në shekullin XIX ishte ekonomikisht një koloni e Evropës, siç e ka treguar edhe Marksi në «Kapitalin»¹⁶. Sigurisht, të gjitha këto Kautski dhe çdo marksist i di fare mirë, por këto s'hyjnë aspak në çështjen e lëvizjeve kombëtare dhe të shtetit kombëtar.

Problemin e vetëvendosjes politike të kombeve në shoqërinë borgjeze, të pavarësisë së tyre shtetërore, Roza Luksemburgu e ka zëvendësuar me çështjen e autonomisë e të pavarësisë së tyre ekonomike. Kjo është diçka po aq pa mend, sa edhe ajo që do të bënte një njeri që shqyrton kërkesën programatike të epërsisë së parlamentit, domethënë të asamblesë së përfaqësuesve të popullit në shtetin borgjez, sikur të fillonte të parashtronte bindjen e tij plotësisht të drejtë për epërsinë e kapitalit të madh në një vend borgjez, cili do të jetë regjimi i tij.

S'ka asnjë dyshim se pjesa më e madhe e vendeve të Azisë, që është pjesa më e populluar e botës, janë ose koloni të «fuqive të mëdha», ose shtete krejt të varura dhe të shtypura nga pikëpamja kombëtare. Por kjo rrethanë e njohur nga tërë bota a e lëkund sadopak faktin e pamohueshëm se në vetë Azinë kushtet për zhvillimin më të plotë të prodhimit të mallrave, për rritjen sa më të lirë, më të gjerë e më të shpejtë të kapitalizmit janë krijuar vetëm në Japoni, domethënë vetëm në një shtet kombëtar të pavarur? Ky është një shtet borgjez dhe prandaj ka filluar ai vetë

të shtypë kombe të tjera dhe të skllavërojë koloni. Nuk e dimë nëse do të mund Azia para shembjes së kapitalizmit të shndërrohet në një sistem shtetesh kombëtare të pavarura, siç është Evropa. Por nuk mund të mohohet se, duke zgjuar Azinë, kapitalizmi ka shkaktuar edhe atje kudo lëvizje kombëtare, se këto lëvizje synojnë të krijojnë shtete kombëtare në Azi, se pikërisht këto shtete i sigurojnë kapitalizmit kushtet më të mira për zhvillim. Shembulli i Azisë flet në favor të Kautskit, kundër Roza Luksemburgut.

Edhe shembulli i shteteve ballkanike flet kundër saj, sepse gjithkush e sheh sot se kushtet më të mira për zhvillimin e kapitalizmit në Ballkan krijohen pikërisht krahas formimit të shteteve kombëtare të pavarura në këtë gadishull.

Kështu, pra, si shembull i gjithë njerëzimit të qytetëruar më të përparuar, ashtu dhe shembulli i Ballkanit e ai i Azisë, provojnë, në kundërshtim me ato që thotë Roza Luksemburgu, se është krejtësisht e drejtë teza e Kautskit: shteti kombëtar është rregull dhe «norma» e kapitalizmit, shteti me përbërje kombëtare të ndryshme është një fazë e prapambetur ose një përjashtim. Nga pikëpamja e marrëdhënieve kombëtare, shteti kombëtar paraqet, pa dyshim, kushtet më të mira për zhvillimin e kapitalizmit. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë se një shtet i tillë, i bazuar në marrëdhënie borgjeze, përjashton shfrytëzimin dhe shtypjen e kombeve. Kjo do të thotë vetëm se marksistët nuk mund t'i lënë mënjanë faktorët e fuqishëm ekonomikë, të cilët lindin tendencat për krijimin e shteteve kombëtare. Kjo do të thotë se në programin e marksistëve «vetëvendosja e kombeve» s'mund të ketë, nga pikëpamja historiko-ekonomike, tjetër kuptim veç vetëvendosjes politike, pavarësisë shtetërore, formimit të një shteti kombëtar.

Sa për kushtet që vëmë ne nga pikëpamja marksiste, domethënë nga pikëpamja e klasës proletare, për të ndihmuar kërkesën demokratiko-borgjeze të një

«shteti kombëtar», do të flasim më poshtë. Tani për tani po japim vetëm përkufizimin e *nocionit* të «vetëvendosjes» dhe duhet ende vetëm të vëmë në dukje se Roza Luksemburgu e *di* përmbajtjen e këtij nocioni («shtet kombëtar»), kurse përkrahësit e saj oportunistë, Libmanët, Semkovskët, Jurkeviçët *nuk e dinë as këtë!*

2. MËNYRA HISTORIKE KONKRETE SE SI SHTROHET ÇËSHTJA

Kur analizohet çfarëdo çështje shoqërore, teoria marksiste kërkon medoemos që ajo të shtrohet në një kuadër historik të *përcaktuar*, e pastaj, në qoftë se është fjala vetëm për një vend (për shembull, për programin kombëtar të një vendi të caktuar), të merren parasysh veçoritë konkrete që e dallojnë atë vend nga të tjerat në të njëjtën epokë historike.

Ç'do të thotë kjo kërkesë e padiskutueshme e marksizmit, po ta zbatojmë atë në çështjen tonë?

Pikësëpari do të thotë se është e domosdoshme të bëhet një dallim i prerë ndërmjet dy epokave të kapitalizmit, të cilat nga pikëpamja e lëvizjeve kombëtare ndryshojnë rrënjësisht njëra prej tjetrës, nga njëra anë, është epoka e rënies së feudalizmit e të absolutizmit, epoka e formimit të shoqërisë e të shtetit demokratik-borgjez, kur për të parën herë lëvizjet kombëtare bëhen lëvizje masash, tërheqin në politikë në një mënyrë ose një tjetër me anën e shtypit, të pjesëmarrjes në institucionet përfaqësuese etj. të *gjitha* klasat e popullsisë. Nga ana tjetër, kemi epokën kur janë formuar plotësisht shtetet kapitaliste, me një regjim kushtetues të vendosur prej kohe, me një antagonizëm shumë të zhvilluar ndërmjet proletariatit dhe borgjezisë, — epokën që mund të quhet pragu i shembjes së kapitalizmit.

Epokën e parë e karakterizon zgjimi i lëvizjeve kombëtare, pjesëmarrja në to e fshatarësisë, si shtresa e popullsisë më e madhe dhe më «e vështirë për t'u vënë në lëvizje» në lidhje me luftën për lirinë politike përgjithësisht dhe për të drejtat e kombësisë veçanërisht. Epokën e dytë e karakterizon mungesa e lëvizjeve demokratiko-borgjeze në masë, ajo është epoka kur kapitalizmi i zhvilluar, duke i afruar gjithnjë më shumë dhe duke i përzier kombet, që tani janë futur plotësisht në qarkullimin tregtar, vë në plan të parë antagonizmin ndërmjet kapitalit, të shkrirë në shkallë ndërkombëtare, dhe lëvizjes punëtore ndërkombëtare.

Natyrisht, këto epoka nuk janë të ndara njëra nga tjetra me ndonjë mur, por janë të lidhura nga shumë hallka ndërmjetëse. Veç kësaj, vendet e ndryshme dallohen edhe nga shpejtësia e zhvillimit të tyre kombëtar, nga përbërja kombëtare e popullsisë së tyre, nga mënyra e shpërndarjes së saj etj. etj. As që mund të flitet për përpilimin e një programi kombëtar të marksistëve të një vendi të caktuar, pa marrë parasysh të gjitha këto kushte të përgjithshme historike, si dhe kushtet konkrete shtetërore.

Dhe ja këtu ne gjejmë pikën më të dobët të arsyetimeve të Roza Luksemburgut. Ajo me një zell të jashtëzakonshëm e stolis artikullin e saj me një tok shprehjesh «të forta» kundër paragrafit 9 të programit tonë, duke e quajtur atë shumë «të përgjithshëm», «kallëp», «frazheologji metafizike», e kështu me radhë. Do të ishte fare e natyrshme të pritnim që një shkrimtare, e cila dënon aq mirë metafizikën (në kuptimin marksist të fjalës, domethënë antidialektikën) me abstraksionet boshe, të na jepte një model shqyrtimi konkret historik të çështjes. Është fjala për programin kombëtar të marksistëve të një vendi të caktuar, Rusisë, të një epoke të caktuar, të fillimit të shekullit XX. Po a e bën Roza Luksemburgu pyetjen se cila është epoka historike që po kalon Rusia, cilat janë veçoritë

konkrete të çështjes kombëtare dhe të lëvizjeve kombëtare të këtij vendi në këtë epokë.

Për tërë këto Roza Luksemburgu nuk thotë asgjë!
Nuk do të gjeni te ajo as hijen e një analize të çështjes si paraqitet problemi kombëtar në Rusi në këtë epokë historike, cilat janë veçoritë e Rusisë në këtë pikëpamje!

Na thonë se çështja kombëtare ndryshe shtrohet në Ballkan e ndryshe në Irlandë, se Marksi i ka çmuar lëvizjet kombëtare poloneze e çeke në kushtet konkrete të vitit 1848, kështu e kështu (vjen një faqe me citate, nga Marksi), se Engelsi e çmonte luftën e kantoneve pyjore të Zvicrës kundër Austrisë dhe betejën e Morgartenit më 1315 kështu e kështu (faqe me citate të nxjerra nga Engelsi me komentet përkatëse të Kautskit), se Lasali e quante reaksionare luftën e fshatarëve në Gjermani në shekullin XVI etj.

S'mund të thuhet se këto vërejtje e citate na japin ndonjë gjë të re, por, sidoqoftë, për lexuesin është interesant të kujtojë edhe një herë se si i shqyrtonin Marksi, Engelsi e Lasali çështjet historike konkrete të vendeve të ndryshme. Kur i rilexon këto citate mësimdhënëse të Marksit dhe të Engelsit njeriu e sheh fare qartë se në ç'pozitë qesharake e ka vënë veten Roza Luksemburgu. Ajo predikon me gojëtarë e me zemërim nevojën e një analize historike konkrete të çështjes kombëtare në vendet e ndryshme në kohë të ndryshme, — dhe nuk bën as orvatjen më të vogël për të caktuar se cilën fazë historike të zhvillimit të kapitalizmit është duke kaluar Rusia në fillim të shekullit XX, se cilat janë veçoritë e çështjes kombëtare në këtë vend. Roza Luksemburgu paraqet shembuj se si e kanë analizuar të tjerët çështjen në mënyrë marksiste, duke theksuar kështu, si me qëllim, se shpeshherë rruga për në skëterrë është e shtruar me qëllime të mira, se prapa këshillave të mira fshihet shpeshherë mosdashja dhe pazotësia për t'i përdorur këto me të vërtetë.

Ja një nga këto krahasime mësimdhënëse. Duke

u ngritur kundër parullës së pavarësisë së Polonisë, Roza Luksemburgu përmend një vepër të saj të 1898-s, ku ajo shpjegonte «zhvillimin e shpejtë industrial të Polonisë» me shitjen e prodhimeve të saj industriale në Rusi. Është e kotë të themi se nga kjo nuk del asgjë për çështjen e së drejtës për vetëvendosje, se me këtë provohet vetëm zhdukja e Polonisë së vjetër të shlahtës etj. Kurse Roza Luksemburgu arrin gjithmonë pa e kuptuar në përfundimin se gjoja ndër faktorët, që e lidhin Rusinë me Poloninë, mbizotërojnë që tani faktorët thjesht ekonomikë të marrëdhënieve të sotme kapitaliste.

Po ja që Roza jonë kalon në çështjen e autonomisë dhe megjithëse artikulli i saj mban titullin «Çështja kombëtare dhe autonomia» *përgjithësisht* — fillon të provojë të drejtën *ekskluzive* të mbretërisë së Polonisë për autonomi (shih për këtë «Prosveshenien», 1913, Nr. 12*). Për të provuar të drejtën e Polonisë për autonomi Roza Luksemburgu e karakterizon rendin shtetëror të Rusisë, me sa duket, sipas tipareve ekonomike, politike, morale e sociologjike — një tok karakteristikash, të cilat së bashku japin idenë e «despotizmit aziatik» (Nr. 12, «Przeglad», f. 137).

Të gjithë e dinë se një rend i tillë shtetëror është shumë i qëndrueshëm në rastet kur në ekonominë e vendit mbizotërojnë trajta krejt patriarkale, parakapitaliste, kurse ekonomia tregtare dhe diferencimi i klasave janë zhvilluar fare pak. Po në qoftë se në një vend, ku rendi shtetëror shquhet nga një karakter i theksuar parakapitalist, ekziston një krahinë e dalluar nga pikëpamja kombëtare me një zhvillim të shpejtë kapitalist, atëherë sa më i shpejtë të jetë ky zhvillim kapitalist, aq më i fortë është kontrasti ndërmjet tij dhe rendit shtetëror parakapitalist, aq më e mundur është shkëputja e krahinës së përparuar nga e tëra, — e krahinës që është e lidhur me të tërën jo me lidhje

* Shih këtë përmbledhje, f. 94-102. *Red.*

«kapitaliste moderne», por me lidhjet e «despotizmit aziatik».

Kështu, Roza Luksemburgu nuk ka mundur t'ia dalë në krye as me çështjen e strukturës shoqërore të pushtetit në Rusi në lidhje me Poloninë borgjeze, kurse çështjen e veçorive historike konkrete të lëvizjeve kombëtare në Rusi ajo as që e ka shtruar fare.

Pikërisht për këtë çështje duhet të flasim tani.

3. VEÇORITË KONKRETE TË ÇËSHTJES KOMBËTARE NË RUSI DHE TRANSFORMIMI DEMOKRATIK-BORGJEZ I KËTIJ VENDI

... «Me gjithë elasticitetin e parimit të «së drejtës së kombeve për vetëvendosje», që s'është veçse një grumbullim fjalësh të përgjithshme, pasi, pa dyshim, mund të zbatohet njësoj jo vetëm te popujt që banojnë në Rusi, por edhe te kombet që banojnë në Gjermani e Austri, në Zvicër e Suedi, në Amerikë e Australi, ne nuk e gjejmë atë në asnjë program të partive socialiste të sotme»... (Nr. 6, Przeglad, f. 483).

Kështu shkruan Roza Luksemburgu, duke filluar fushatën e saj kundër paragrafit 9 të programit marksist. Duke u orvatur të na e mbushë mendjen se kjo pikë e programit s'është veçse «një grumbullim fjalësh të përgjithshme», Roza Luksemburgu bie vetë pikërisht në këtë mëkat, kur deklaron me një guxim zbavitës se gjoja kjo pikë «mund të zbatohet pa dyshim» njësoj në Rusi, Gjermani etj.

Shihet qartë, — përgjigjemi ne, — se Roza Luksemburgu ka vendosur të na japë në artikullin e saj një përmbledhje gabimesh logjike, që mund të shërbejnë për ushtrimet e gjimnazistëve. Sepse tirada e Roza Luksemburgut është diçka krejt pa kuptim dhe

një tallje me mënyrën historike konkrete se si duhet shtruar kjo çështje.

Po të shikohet programi marksist jo në mënyrë foshnjarake, por në mënyrë marksiste, do të ishte fare lehtë të kuptohet se ai ka parasysh lëvizjet kombëtare demokratiko-borgjeze. Po të jetë kështu, — dhe sigurisht kështu është, — atëherë «është» e qartë se ky program i shikon «në përgjithësi», si «diçka të njëlojtë» etj. të gjitha rastet e lëvizjeve kombëtare demokratiko-borgjeze. Edhe për Roza Luksemburgun, po të mendonte pak, nuk do të ishte më pak i qartë përfundimi se programi ynë ka parasysh *vetëm* rastet kur ka një lëvizje të tillë.

Po të ishte thelluar te gjithë këto mendime të qarta, Roza Luksemburgu do ta kishte kuptuar fare mirë çfarë marrëzie ka thënë. Duke na akuzuar se themi «fjalë të përgjithshme», ajo përdor kundër nesh argumentin se në programin e atyre vendeve ku *nuk ka* lëvizje kombëtare demokratiko-borgjeze nuk flitet për vetëvendosjen e kombeve. Argument shumë i bukur!

Krahasimi i zhvillimit politik dhe ekonomik të vendeve të ndryshme, si edhe i programeve të tyre marksiste, ka rëndësi shumë të madhe nga pikëpamja e marksizmit, sepse nuk mund të vihet në dyshim natyra e përbashkët kapitaliste e shteteve të sotme, si dhe ligji i përbashkët i zhvillimit të tyre. Por një krahasim i tillë duhet të bëhet me mjeshhtëri. Kushti më elementar për këtë është që të sqarohet nëse mund të krahasohen epokat historike të zhvillimit të vendeve që po krahasohen. Kështu, për shembull, vetëm ata që janë fare të paditur (si principi E. Trubeckoi në «*Russkaja Misl*») mund të «krahasojnë» programin agrar të marksistëve rusë me programin e marksistëve të Evropës Perëndimore, sepse programi ynë i përgjigjet çështjes së transformimit agrar *demokratik-borgjez*, për të cilin as që bëhet fjalë në vendet perëndimore.

Po kështu është puna edhe me çështjen kombëtare. Në shumicën e vendeve perëndimore kjo është zgjidhur me kohë. Është qesharake të kërkohet përgjigje në programet e Perëndimit për çështje të pafqena. Këtu Roza Luksemburgut i ka shpëtuar pikërisht thelbi i çështjes: ndryshimi ndërmjet vendeve ku transformimet demokratiko-borgjeze kanë marrë fund me kohë dhe vendeve ku ato nuk janë përfunduar.

Ky ndryshim është kyçi i çështjes. Mospërfillja e plotë e këtij ndryshimi e bën artikullin e gjatë të Roza Luksemburgut një lëshim fjalësh të përgjithshme boshe e pa përmbajtje.

Në Evropën Perëndimore, kontinentale, epoka e revolucioneve demokratiko-borgjeze përfshin një periudhë mjaft të përcaktuar, afërsisht që nga viti 1789 deri më 1871. Kjo ka qenë pikërisht epoka e lëvizjeve kombëtare dhe e krijimit të shteteve kombëtare. Në fund të kësaj epoke Evropa Perëndimore që transformuar në një sistem të formuar shtetesh borgjeze, dhe në përgjithësi shtetesh me një përbërje kombëtare të vetme. Kështu, pra, të kërkoesh sot të drejtën e vetëvendosjes në programet e socialistëve të Evropës Perëndimore do të thotë të mos kuptosh abecën e marksizmit.

Në Evropën Lindore dhe në Azi epoka e revolucioneve demokratiko-borgjeze filloi vetëm më 1905. Revolucionet në Rusi, Persi, Turqi, Kinë, luftërat në Ballkan — ky është vargu i ngjarjeve të përbotshme të kohës sonë «në Lindjen» tonë. Dhe vetëm i verbri nuk sheh në këtë varg ngjarjesh zgjimin e një sërë lëvizjesh kombëtare demokratiko-borgjeze, të një sërë tendencash për të formuar shtete kombëtare të pavarura me një përbërje kombëtare të vetme. Pikërisht dhe vetëm sepse Rusia dhe fqinjët e saj po e jetojnë këtë epokë na lypset në programin tonë një paragraf për të drejtën e kombeve për vetëvendosje.

Por le ta vazhdojmë edhe pak më tej citatin e lartpërmendur nga artikulli i Roza Luksemburgut:

... «Në mënyrë të veçantë — shkruan ajo — programi i një partie, e cila vepron në një shtet me përbërje kombëtare jashtëzakonisht të larme dhe për të cilën çështja kombëtare luan një rol të dorës së parë, — programi i socialdemokracisë austriake nuk e përmban parimin e së drejtës së kombeve për vetëvendosje» (po aty).

Kështu, pra, lexuesin kërkojnë ta bindin «në mënyrë të veçantë» me shembullin e Austrisë. Le të shohim sa logjik është, nga pikëpamja historike konkrete, ky shembull.

Së pari, të shtrojmë çështjen kryesore, çështjen e përfundimit të revolucionit demokratik-borgjez. Në Austri ai filloi më 1848 dhe përfundoi me 1867. Qysh atëherë, pothuajse qysh prej një gjysmë shekulli, atje sundon një kushtetutë me përmbajtje borgjeze, në bazë të së cilës vepron legalisht një parti punëtore legale.

Prandaj, në kushtet e brendshme të zhvillimit të Austrisë (domethënë nga pikëpamja e zhvillimit të kapitalizmit në Austri përgjithësisht dhe në kombësitë e saj të ndryshme veçanërisht) nuk ka faktorë që të shkaktojnë hope, të cilat mund të pasoheshin nga formimi i shteteve kombëtare të pavarura. Duke nënkuptuar me krahasimin e saj se nga kjo pikëpamje Rusia gjendet në kushte të njëjta, Roza Luksemburgu jo vetëm që bën një hipotezë krejt të gabuar, antihistorike, por rrëshqet padashur në likuidatorizëm.

Së dyti, një rëndësi veçanërisht të madhe për çështjen që jemi duke shqyrtuar ka raporti krejt i ndryshëm ndërmjet kombësive në Austri e në Rusi. Austria jo vetëm që ka qenë për një kohë të gjatë një shtet ku kanë mbizotëruar gjermanët, por gjermanët e Austrisë kanë pretenduar të kenë hegjemoninë mbi tërë kombin gjerman. Ky «pretendim», që ndoshta do të pranojë ta sjellë ndër mend Roza Luksemburgu (së cilës nuk i pëlqejnë gjoja aspak fjalët e përgjithshme, shabllonet, abstraksionet...), u hodh poshtë

nga lufta e 1866-s. Kombi sundues në Austri, kombi gjerman, mbeti *jashtë* shtetit gjerman të pavarur, që u formua përfundimisht nga viti 1871. Nga ana tjetër, përpjekja e hungarezëve për të krijuar një shtet kombëtar të pavarur dështoi qysh më 1849 nga goditjet e ushtrisë ruse, që përbëhej nga bujkrobër.

Kështu u krijua një gjendje jashtëzakonisht origjinale: hungarezët, e pastaj çekët, nuk kërkojnë të shkëputen nga Austria, por të ruajnë integritetin e Austrisë pikërisht në interes të pavarësisë kombëtare, që mund të shtypej krejt nga fqinjët më grabitqarë e më të fortë! Për shkak të kësaj gjendjeje origjinale, Austria u bë shtet me dy qendra (dualist) dhe po transformohet sot në një shtet me tri qendra (trilateralist): gjermanët, hungarezët, sllavët).

A ka diçka të tillë në Rusi? A synojnë «njerëzit» tanë «me kombësi tjetër» të bashkohen me rusët, me qëllim që t'i shpëtojnë kërcënimit të një shtypjeje kombëtare *edhe më të keqe*?

Mjafton të bëhet kjo pyetje për të parë se sa pa kuptim, shabllon dhe injorant është krahasimi i Rusisë me Austrinë, për sa i përket çështjes së vetëvendosjes së kombeve.

Kushtet e veçanta të Rusisë për çështjen kombëtare janë pikërisht krejt të kundërta me kushtet që pamë në Austri. Rusia është një shtet me një qendër kombëtare të vetme, ruse. Rusët zënë një territor shumë të madh të pacopëtuar dhe numri i tyre arrin pothuajse 70 milionë. Veçoria e këtij shteti kombëtar është, pikësepari, se «njerëzit me kombësi tjetër» (që përbëjnë në tërësi shumicën e popullsisë — 57⁰/₀) rrojnë pikërisht në periferi; e dyta, se shtypja e këtyre njerëzve me kombësi tjetër është shumë më e fortë se në shtetet fqinje (e madje jo vetëm në shtetet e Evropës); e treta, se në shumë raste kombësitë e shtypura, që rrojnë në periferi, kanë nga ana tjetër e kufirit bashkatdhetarë që gëzojnë një pavarësi kombëtare më të madhe (mjafton të përmendim, për shembull, në

kufirin perëndimor dhe jugor të shtetit, finlandezët, suedezët, polakët, ukrainasit, rumunët); e katërta, se zhvillimi i kapitalizmit dhe niveli i përgjithshëm i kulturës janë shpeshherë më lart në periferinë e «njerrëzve me kombësi tjetër» sesa në qendrën e shtetit; më në fund, ne shohim se pikërisht në shtetet fqinje të Azisë ka filluar një periudhë revolucionesh borgjeze dhe lëvizjesh kombëtare, që përfshijnë pjesërisht edhe kombësi përbrenda Ruisë që janë të afërta me to.

Janë, pra, pikërisht veçoritë historike konkrete të çështjes kombëtare në Rusi që e bëjnë të ne veçanërisht të domosdoshme njohjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje në epokën që po kalojmë.

Veç kësaj, edhe si fakt nuk është e vërtetë thënia e Roza Luksemburgut se në programin e socialdemokratëve austriakë nuk figuron njohja e së drejtës së kombeve për vetëvendosje. Mjafton të hapim procesverbalet e Kongresit të Brynit, që ka miratuar programin kombëtar, e do të shohim atje deklaratat që ka bërë socialdemokrati ukrainas Gankeviç në emër të të gjithë delegacionit ukrainas (ruten) (f. 85 e procesverbaleve) dhe socialdemokrati polonez Reger në emër të të gjithë delegacionit polonez (f. 108), ku thuhet se socialdemokratët austriakë të këtyre dy kombësive në aspiratat e tyre përfshijnë edhe aspiratën për bashkim kombëtar, për lirinë dhe pavarësinë e popujve të tyre. Në këtë mënyrë, megjithëse nuk e ka vënë drejtpërdrejt në programin e saj të drejtën e kombeve për vetëvendosje, socialdemokracia austriake pranon plotësisht që disa pjesë të partisë të parashtrajnë kërkesën e pavarësisë kombëtare. Në të vërtetë kjo do të thotë, natyrisht, njohje e së drejtës së kombeve për vetëvendosje! Në këtë mënyrë shembulli i Austrisë, i cituar nga Roza Luksemburgu, kthehet në të gjitha pikëpamjet kundër saj.

4. «PRAKTICIZMI» NË ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Oportunistët janë kapur me një zell të veçantë pas këtij argumenti të Roza Luksemburgut, që thotë se paragrafi 9 i programit tonë s'përmban asgjë «praktike». Roza Luksemburgu është entuziazmuar aq shumë nga ky argument, sa që këtë «parullë» e gjejnë nganjëherë të përsëritur deri tetë herë në një faqe të artikullit të saj.

Paragrafi 9 «nuk përmban — shkruan ajo — asnjë udhëzim praktik për politikën e përditshme të proletariatit, asnjë zgjidhje praktike të problemeve kombëtare».

Le ta shqyrtojmë këtë argument, i cili formulohet edhe në mënyrë të tillë që paragrafi 9 ose nuk thotë hiçasgjë, ose na detyron të përkrahim të gjitha aspiratat kombëtare.

Ç'do të thotë të kërkohet «prakticitet» në çështjen kombëtare?

Ose të përkrahësh të gjitha aspiratat kombëtare; ose t'i përgjigjesh «po ose jo» kërkesës së çdo kombi për shkaputje; ose përgjithësisht «mundësia për të realizuar» menjëherë kërkesat kombëtare.

Le t'i shqyrtojmë këto tri kuptime të mundshme të kërkesës së «prakticitetit».

Borgjezia, e cila natyrisht në fillim të çdo lëvizjeje kombëtare luan rolin e hegjemones (udhëheqëses), quan veprim praktik përkrahjen e të gjitha aspiratave kombëtare. Por politika e proletariatit në çështjen kombëtare (si edhe në çështjet e tjera) vetëm e përkrah borgjezinë në një drejtim të caktuar, por nuk përputhet kurrë me politikën e saj. Klasa punëtore e përkrah borgjezinë vetëm në interesin e paqes kombëtare (të cilën borgjezia s'mund ta japë krejt dhe që mund të realizohet vetëm me një demokratizim të plotë), në interesin e të drejtave të barabarta, për t'i siguruar luftës klasore kushtet më të favorshme. Prandaj pro-

letarët vënë përballë praktikizmit të borgjezisë një politikë *parimore* në çështjen kombëtare, duke e për-krahur borgjezinë vetëm me kushte. Në çështjen kombëtare çdo borgjezi kërkon ose privilegje për kombin e saj, ose përfitime të jashtëzakonshme për të; ky është kuptimi i fjalës «praktik». Proletariati është kundër çdo privilegji, kundër çdo përjashtimi. Dhe të kër-kosh nga ai «prakticitet» do të thotë të biesh në pozitë e borgjezisë, të biesh në oportunizëm.

T'i përgjigjesh me «po ose jo» çështjes së shkë-putjes së çdo kombi? Kjo duket një kërkesë shumë «praktike». Kurse, në të vërtetë, kjo është absurde, është teorikisht metafizike dhe në praktikë shpie në nënshtrimin e proletariatit ndaj politikës së borgjezisë. Borgjezia vë gjithnjë në plan të parë kërkesat e veta kombëtare. Ajo i shtron ato në mënyrë të prerë, kurse për proletariatin ato u nënshtrohen interesave të luftës së klasave. Teorikisht nuk mund të përcaktohet qysh më parë nëse revolucioni demokratiko-borgjez do të përfundojë me shkëputjen e një kombi apo me njohjen e të drejtave të tij të barabarta me ato të kombeve të tjera; në të dyja rastet për proletariatin ka rëndësi që të sigurojë zhvillimin e klasës së tij; kurse për borgjezinë ka rëndësi që ta pengojë këtë zhvillim, duke ua nënshtruar qëllimet e këtij zhvillimi qëllimeve të kombit «të saj». Prandaj proletariati kufizohet me kërkesën, si të thuash negative, të njohjes së të drejtës për vetëvendosje, pa i garantuar gjë asnjë kombi, pa u zotuar që t'i japë gjë në dëm të një kombi tjetër.

Ndoshta kjo nuk është «praktike», por në vetvete kjo garanton më mirë zgjidhjen më demokratike që është e mundur; proletariatit i lypsen vetëm këto garanci, kurse borgjezisë së çdo kombi i lypsen garanci për përfitimet e saj, pa çarë koka për gjendjen (për dëmet që mund t'u shkaktohen) e kombeve të tjera.

Borgjezisë i intereson kryesisht «mundësia» e realizimit të një kërkesë të caktuar, dhe nga kjo rrjedh politika e përhershme e marrëveshjeve me borgjezinë

e kombeve të tjera në dëm të proletariatit. Kurse për proletariatin ka rëndësi forcimi i klasës së tij kundër borgjezisë, edukimi i masave në frymën e një demokracie konsekuente dhe të socializmit.

Ndoshta kjo nuk është «praktike» për oportunistët, por është e vetmja garanci e vërtetë, garanci për një barazi kombëtare sa më të madhe dhe për paqe, në kundërshtim me feudalët dhe borgjezinë *nacionaliste*.

Tërë detyra e proletarëve në çështjen kombëtare «nuk është praktike» nga pikëpamja e borgjezisë *nacionaliste* të çdo kombi, sepse proletarët, armiq të çdo nacionalizmi, kërkojnë një barazi «abstrakte» të drejtash, kërkojnë zhdukjen në parim edhe të privilegjeve më të vogla. Meqë nuk e kupton këtë, Roza Luksemburgu, duke i thurur lavde pa kuptim praktikizmit ua ka hapur dyert katërsh pikërisht oportunistëve dhe sidomos lëshimeve oportuniste ndaj nacionalizmit rusomadh.

Pse rusomadh? Sepse rusët janë në Rusi kombi shtypës, dhe, natyrisht, nga pikëpamja kombëtare oportunisti do të shfaqet ndryshe në kombet e shtypura dhe ndryshe në kombet shtypëse.

Në emër të «prakticitetit» të kërkesave të saj, borgjezia e kombeve të shtypura do t'i bëjë thirrje proletariatit që t'i përkrahë pa rezerva aspiratat e saj. Gjoja më praktike është të thuash haptazi «po» për shkëputjen e një kombi të caktuar, por jo për të drejtën e shkëputjes së të gjitha kombeve, cilatdo qofshin!

Proletariati është kundër këtij praktikizmi: duke njohur barazinë e të drejtave dhe të drejtën e barabartë për të formuar një shtet kombëtar, ai çmon dhe vë mbi të gjitha aleancën e proletarëve të të gjitha kombeve, duke e çmuar nën prizmin e luftës së klasës së punëtorëve çdo kërkesë kombëtare, çdo shkëputje kombëtare. Në të vërtetë, parulla e praktikizmit është vetëm parullë e huajtjes në mënyrë jokritike të aspiratave borgjeze.

Na thonë: duke përkrahur të drejtën e shkëputjes,

ju përkrahni nacionalizmin borgjez të kombeve të shtypura. Kështu thotë Roza Luksemburgu, këto i përsërit pas saj oportunisti Semkovski — i vetmi përfaqësues, është rasti ta themi, i ideve likuidatoriste për këtë çështje në gazetën e likuidatorëve!

Ne përgjigjemi: jo, pikërisht për borgjezinë ka rëndësi këtu një zgjidhje «praktike», kurse për punëtorët ka rëndësi përcaktimi *parimor* i dy tendencave. Derisa borgjezia e kombit të shtypur lufton kundër borgjezisë së kombit shtypës, ne jemi, kurdoherë dhe në çdo rast, në mënyrë më të vendosur se të gjithë, në favor të kësaj lufte, sepse ne jemi armiqtë më të guximshëm dhe më konsekuentë të shtypjes. Derisa borgjezia e kombit të shtypur mbron nacionalizmin e saj borgjez, ne jemi kundër saj. Luftë kundër privilegjeve dhe dhunës së kombit shtypës, dhe asnjë lëshim tendencës së kombit të shtypur për privilegje.

Po të mos e shtronim dhe të mos bënim agjitacion për parullën e së drejtës për shkëputje, ne do t'i shërbenim jo vetëm borgjezisë, por edhe feudalëve e absolutizmit të kombit shtypës. Këtë argument Kautski e ka ngritur me kohë kundër Roza Luksemburgut, dhe ky argument është i pakundërshtueshëm. Nga frika se mos «ndihmojë» borgjezinë nacionaliste të Polonisë, Roza Luksemburgu, duke mohuar të drejtën e shkëputjes në programin e marksistëve rusë, ndihmon në të vërtetë qindëshet e zeza të rusomëdhenjve. Në të vërtetë ajo ndihmon pajtimin oportunist me privilegjet (dhe me diçka që është edhe më keq se privilegjet) e rusëve.

E rrëmbyer nga lufta kundër nacionalizmit në Poloni, Roza Luksemburgu ka harruar nacionalizmin e rusëve, megjithëse pikërisht ky nacionalizëm është sot për sot më i rrezikshmi, pikërisht ai është më pak borgjez dhe më shumë feudal, pikërisht ai është pengesa kryesore për demokracinë dhe për luftën proletare. Në çdo nacionalizëm borgjez të një kombi të shtypur ka një përmbajtje demokratike të përgjith-

shme të drejtuar kundër shtypjes, dhe pikërisht këtë përmbajtje ne e përkrahim pa rezerva, duke dalluar në mënyrë të prerë tendencën për privilegje të kombit të vet, duke luftuar kundër tendencës së borgjezit polonez për të shtypur çifutit etj., etj.

Kjo nuk është «praktike» nga pikëpamja e borgjezit dhe e mikroborgjezit. Kjo është në çështjen kombëtare e vetmja politikë praktike e parimore që ndihmon me të vërtetë demokracinë, lirinë dhe bashkimin e proletarëve.

Njohja e së drejtës së shkëputjes për të gjithë; vlerësimi i çdo çështjeje konkrete për shkëputjen nga një pikëpamje që nuk pranon asnjë mosbarazi, asnjë privilegj, asnjë përjashtim.

Le të marrim pozitën e kombit shtypës. A mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë? Jo. Interesat e lirisë së popullsisë ruse* kërkojnë që të luftohet një shtypje e tillë. Një histori e gjatë, historia shekullore e shtypjes së lëvizjeve të kombeve të shtypura, propagandimi sistematik i kësaj shtypjeje nga klasat «e larta» kanë bërë që paragjykimet e popullit rus të jenë pengesa shumë të mëdha për vetë çështjen e lirisë së tij etj.

Qëndëshet e zeza të rusomëdhenjve i përkrahin me ndërgjegje këto paragjykime dhe i nxitin ato. Borgjezia ruse ose pajtohet me to ose u përshtatet atyre. Proletariati rus s'mund t'i arrijë qëllimet e tij, s'mund të hapë rrugën drejt lirisë pa i luftuar sistematikisht këto paragjykime.

Formimi i një shteti kombëtar autonom dhe të pavarur mbetet hëpërhë, në Rusi, privilegj vetëm i

* Njëfarë L. VI.17 nga Parisi nuk i duket marksiste kjo fjalë. Ky L. VI. është si për shaka «superklug» (që mund të përkthehet me ironi: «shumë i zgjuar». «Shumë i zgjuari» L. VI. përgatitet, siç duket, të shkruajë një studim për heqjen nga programi ynë minimal (nga pikëpamja e luftës së klasave!) e fjalëve: «popullsi», «popull» etj.

kombit rus. Ne, proletarët rusë, nuk mbrojmë asnjë privilegj, ne nuk mbrojmë as këtë privilegj. Ne luftojmë në truallin e atij shteti që kemi, bashkojmë punëtorët e të gjitha kombeve të këtij shteti, ne s'mund të garantojmë njërën ose tjetrën udhë të zhvillimit kombëtar, ne ecim drejt qëllimit tonë të klasës nëpër të gjitha udhët e mundshme.

Por nuk mund të ecet drejt këtij qëllimi pa luftuar çdo nacionalizëm dhe pa mbrojtur barazinë e kombeve të ndryshme. A do të mund të krijojë, për shembull, Ukraina një shtet të pavarur? Kjo varet nga 1 000 faktorë që nuk mund të parashikohen. Dhe pa humbur kohë me «supozime» të kota, ne qëndrojmë me vendosmëri për atë që është e padiskutueshme: të drejtën e Ukrainës për të formuar një shtet të tillë. Ne e respektojmë këtë të drejtë, ne nuk i mbrojmë privilegjet e rusëve mbi ukrainasit, ne i edukojmë masat me frymën e njohjes së kësaj të drejte, me frymën e mohimit të privilegjeve shtetërore, të cilitdo kombi qoftë.

Në hopet që bëjnë të gjitha vendet në epokën e revolucioneve borgjeze ka mundësi dhe ka të ngjarë të ndodhin konflikte dhe luftë në lidhje me të drejtën për të pasur një shtet kombëtar. Ne, proletarët, e shpallim veten qysh më parë kundërshtarë të privilegjeve të rusëve, dhe në këtë drejtim zhvillojmë tërë propagandën dhe agjitacionin tonë.

Duke vrapuar pas «prakticizmit», Roza Luksemburgu s'ka parë detyrën kryesore praktike si të proletariatit rus, ashtu dhe të proletariatit të kombësive të tjera: detyrën e një agjitacioni dhe propagande të përditshme kundër çdo privilegji shtetëror dhe kombëtar për të drejtën, të drejtën e barabartë të të gjitha kombeve që të formojnë shtetin e tyre kombëtar; kjo detyrë është detyra jonë kryesore (sot për sot) në çështjen kombëtare, sepse vetëm kështu ne mbrojmë interesat e demokracisë dhe të bashkimit me të drejta të barabarta të të gjithë proletarëve të çfarëdo kombi.

Ndoshta kjo propagandë «nuk është praktike» si nga pikëpamja e shtypësve rusomëdhenj, ashtu edhe nga pikëpamja e borgjezisë së kombeve të shtypura (si njëra ashtu dhe tjetra pa ië duan një përgjigje të prerë po ose jo, dhe i akuzojnë socialdemokratët se «s'janë të përpiktë»). Në të vërtetë pikërisht kjo propagandë, dhe vetëm kjo, siguron një edukim me të vërtetë demokratik e me të vërtetë socialist të masave. Vetëm një propagandë e tillë garanton edhe mundësitë më të mëdha për një paqe kombëtare në Rusi, në qoftë se kjo do të mbetet një shtet me kombësi të ndryshme, dhe ndarjen më paqësore (e më të padëmshme për luftën e klasës të proletariatit) në shtete të ndryshme kombëtare, nëse do të ngrihet çështja për një ndarje të tillë.

Për të sqaruar konkretisht këtë politikë, që është e vetmja politikë proletare në çështjen kombëtare, do të shqyrtojmë qëndrimin e liberalizmit rus kundrejt «vetëvendosjes së kombeve» dhe shembullin e shkëputjes së Norvegjisë nga Suedia.

5. BORGJEZIA LIBERALE DHE OPORTUNISTËT SOCIALISTË NË ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Pamë se Roza Luksemburgu quan si një nga «kartat» e saj më të mira në luftën kundër programit të marksistëve rusë këtë argument: njohja e së drejtës për vetëvendosje është baras me përkrahjen e nacionalizmit borgjez të kombeve të shtypura. Nga ana tjetër, thotë Roza Luksemburgu, në qoftë se me këtë të drejtë kuptohet vetëm lufta kundër çdo dhune ndaj kombeve, atëherë s'ishte nevoja të vihej një pikë e posaçme në program, sepse socialdemokratët janë përgjithësisht kundër çdo dhune dhe pabarazie kombëtare.

Argumenti i parë, sikundër e ka treguar në më-

nyrë të padiskutueshme pothuajse 20 vjet më parë Kautski, akuzon për nacionalizëm atë që s'është i tillë: nga frika e nacionalizmit të borgjezisë së kombeve të shtypura, Roza Luksemburgu i shërben në të vërtetë nacionalizmit ultrareaksionar të rusomëdhenjve! Argumenti i dytë është në thelb vetëm një shmangie plot frikë nga pyetja: a e përfshin njohja e barazisë kombëtare njohjen e së drejtës për t'u shkëputur? Në qoftë se po, kjo do të thotë se Roza Luksemburgu e pranon që paragrafi 9 i programit tonë është parimisht i drejtë. Në qoftë se jo, kjo do të thotë se ajo nuk e njeh barazinë kombëtare. Këtu nuk ndihmojnë as shmangiet as dredhitë!

Për mënyra më e mirë për të vënë në provë argumentet e lartpërmendura dhe gjithë argumentet si këto është shqyrtimi i qëndrimit që mbajnë *klasat e ndryshme* të shoqërisë në këtë çështje. Për një marksist një provë e tillë është e domosdoshme. Duhet nisur nga faktet objektive, duhen shqyrtuar marrëdhëniet reciproke të klasave në këtë pikë. Duke mos e bërë këtë, Roza Luksemburgu bie pikërisht në mëkatin e metafizikës, të abstraksionit, të fjalëve të përgjithshme, të shabllonizmit etj., që më kot përpiqet t'ua veshë kundërshtarëve të saj.

Është fjala për programin e marksistëve të *Rusisë*, domethënë të marksistëve të të gjitha kombësive të *Rusisë*. A nuk është e udhës që t'i hedhim një sy qëndrimit të klasave *sunduese* të *Rusisë*?

Të gjithë e dinë qëndrimin e «burokracisë» (kërkohet ndjesë për këtë fjalë jo të përpiktë) dhe të çifligarëve feudalë të tipit të fisnikërisë së bashkuar. Mohim i plotë si i barazisë së të drejtave të kombësive, ashtu edhe i së drejtës për vetëvendosje. Parulla e vjetër e marrë nga koha e bujkrobërisë: autokraci, ortodoksi, nacionalizëm, duke kuptuar me këtë të fundit vetëm nacionalizmin e rusomëdhenjve. Aty edhe ukrainasit i kanë shpallur si «njerëz me kombësi tjetër», aty edhe gjuha e tyre amtare përndiqet!

Le të shohim borgjezinë ruse «të ftuar» për të marrë pjesë— megjithëse në një masë të parëndësishme, por sidoqoftë për të marrë pjesë në pushtet, në sistemin e legjislacionit dhe të qeverisjes së «3 qershorit». S'është nevoja të harxhojmë shumë fjalë për të shpjeguar se oktiabristët në fakt shkojnë pas të djathtëve në këtë çështje. Për fat të keq, disa marksistë i kushtojnë shumë më pak kujdes qëndrimit të borgjezisë liberale ruse, të progresistëve dhe kadetëve. Dhe duhet thënë se ai që nuk e studion këtë qëndrim dhe nuk e analizon atë, bie në mënyrë të pashmangshme në mëkatën e abstraksionit dhe të fjalëve boshe, kur është fjala për të drejtën e kombeve për vetëvendosje.

Vitin e kaluar polemika e «Pravdës» me «Reçin» e detyroi të bënte disa pohime të çmueshme këtë organ kryesor të partisë së kadetëve, që është aq i zoti për t'i bërë bisht në mënyrë diplomatike përgjigjes së qartë pyetjeve «të papëlqyera». Barutit i dha zjarr kongresi i studentëve të Ukrainës, që u mbledh në Lvov në verën e 1913-s. «Ukrainologu» zyrtar ose bashkëpunëtori ukrainas i «Reçit», z. Mogilianski, botoi një artikull me sharje nga më të zgjedhurat («killapi», «aventurizëm» etj.) kundër idesë së shikëputjes së Ukrainës, ide për të cilën luftonte nacional-sociali Doncov dhe që u miratua nga kongresi në fjalë.

Gazeta «Raboçaja Pravda» pa u bashkuar aspak me z. Doncov e pasi tregoi qartë se ky është një nacional-social, se shumë marksistë ukrainas s'pajtohen me mendimin e tij, deklaroi, megjithatë, se toni i «Reçit» ose më mirë të themi mënyra se si e shtron çështjen në parim gazeta «Reç» është krejtësisht e papërshtatshme dhe e palejueshme për një demokrat rus ose për një njeri që dëshiron të hiqet si demokrat*. Le t'i hedhë poshtë haptazi gazeta

* Shih V. I. Lenin. Veprat, bot. shqip, vëll. 19, f. 295-296. Red.

«Reç» pikëpamjet e zotërinjve Doncovë, por *parimisht* nuk është e pranueshme që një organ rus, që përfaqëson gjoja demokracinë, të harrojë *lirinë* e shkëputjes, të drejtën e shkëputjes.

Disa muaj më vonë z. Mogilianski jepte «sqarime» në Nr. 331 të gazetës «Reç», pasi kishte mësuar me anën e gazetës ukrainase «Shlahi» të Lvovit për kundërshtimet e z. Doncov, i cili, ndër të tjera, vinte në dukje se «vetëm shtypi socialdemokrat rus kishte dënuar (damkosur?) siç duhej sulmin shovinist të gazetës «Reç». «Sqarimet» e z. Mogilianski ishin përsëritja tri herë se «kritika e recetave të z. Doncov» «s'ka të bëjë aspak me mohimin e së drejtës së kombeve për vetëvendosje.»

«Duhet thënë, — shkruante z. Mogilianski, — se dhe «e drejta e kombeve për vetëvendosje» nuk është ndonjë fetish (dëgjoni mirë!!) që s'mund të kritikohet: kushtet jo të shëndosha të jetës së kombit mund të lindin tendenca të sëmura në çështjen e vetëvendosjes kombëtare, dhe t'i zbulosh këto tendenca nuk do të thotë të mohosh të drejtën e kombeve për vetëvendosje».

Siç e shikoni, frazat e një liberali për «fetishin» ishin krejt në frymën e frazave të Roza Luksemburgut. Shihet qartë se z. Mogilianski dëshironte t'i shmangej përgjigjes së drejtpërdrejtë të pyetjes: a e njeh ai apo jo të drejtën e vetëvendosjes politike, domethënë të shkëputjes?

Dhe «Proletarskaja Pravda» (Nr. 4, 11 dhjetor 1913) ia bëri në sy këtë pyetje si zotit Mogilianski, ashtu dhe *partisë* së kadetëve*.

Atëherë gazeta «Reç» botoi (Nr. 340) një deklaratë pa nënshkrim, domethënë zyrtare, në emër

* Shih V. I. Lenin. Veprat, bot. shqip, vëll. 19, f. 604-606.
Red.

të redaksisë, që i përgjigjej kësaj pyetjeje. Kjo përgjigje përmbledhet në tri pika:

1) Në paragrafin 11 të programit të partisë së kadetëve flitet drejtpërdrejt, me përpikëri dhe qartë për «të drejtën e vetëvendosjes së lirisë *kulturore*» të kombeve.

2) «Proletarskaja Pravda», siç na siguron «Reçi», «ngatërron plotësisht» vetëvendosjen me separatizmin, me shkëputjen e atij ose këtij kombi.

3) «Në të vërtetë, kadetët nuk janë përpjekur kurrë të mbrojnë të drejtën e «kombeve për shkëputje» nga shteti rus». (Shih artikullin: «Nacional-liberalizmi dhe e drejta e kombeve për vetëvendosje» në «Proletarskaja Pravda» Nr. 12, 20 dhjetor 1913*).

Le ta përqendrojmë më parë vëmendjen në pikën e dytë të deklaratës së gazetës «Reç». Me çfarë qartësie u tregon zotërinjve Semkovskë, Libmanë, Jurkeviçë dhe oportunistëve të tjerë se britmat dhe arsyetimet e tyre se gjoja kuptimi i «vetëvendosjes» është «i paqartë» ose i «papërcaktuar» në të vërtetë, domethënë nga pikëpamja e raportit objektiv të klasave dhe të luftës së klasave në Rusi, s'është veçse një përsëritje e thjeshtë e fjalimeve të borgjezisë monarkiste liberale!

Kur «Proletarskaja Pravda» shtroi përpara z. «konstitucionalistë-demokratë» të ditur të gazetës «Reç» tri pyetje: 1) a e mohojnë ata se në tërë historinë e demokracisë ndërkombëtare, sidomos që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, me fjalët vetëvendosje e kombeve kuptohet pikërisht vetëvendosja politike, e drejta për të formuar një shtet kombëtar të pavarur? 2) a e mohojnë ata se vendimi i njohur i Kongresit Socialist-Ndërkombëtar të Londrës, më 1896, ka po këtë kuptim? dhe 3) se Plehanovi, i cili ka shkruar qysh më 1902 për vetëvendosjen, kuptonte me këtë pikërisht

* Shih veprat, bot. shqip, vëll. 20, f. 49-51. Red.

vetëvendosjen politike? — kur «Proletarskaja Pravda» shtroi këto tri pyetje, *zotërinjtë kadetë heshtën!!*

Ata nuk u përgjigjën me asnjë fjalë, se s'kishin ç'të përgjigjeshin. Ata u detyruan të pranonin në heshtje se «Proletarskaja Pravda» kishte plotësisht të drejtë.

Britmat e liberalëve për paqartësinë e nocionit «vetëvendosje», për «ngatërrimin e plotë» të tij me separatizmin nga socialdemokratët s'janë veçse dëshirë për ta *koklavitur* çështjen dhe për t'u shmangur nga njohja e një parimi që është vendosur nga gjithë demokracia. Po të mos ishin aq injorantë zotërinjtë Semkovskë, Libmanë e Jurkeviçë, ata do t'i kishte vrarë ndërgjegjja të flisnin përpara punëtorëve me një frymë *liberale*.

Po le të vazhdojmë. «Proletarskaja Pravda» e ka detyruar gazetën «Reç» të pranojë se në programin e kadetëve fjalët vetëvendosje «kulturore» kanë pikërisht kuptimin e *mohimit* të vetëvendosjes *politike*.

«Në të vërtetë, kadetët nuk janë përpjekur kurrë të mbrojnë të drejtën e «kombeve për shkëputje» nga shteti rus» — këto fjalë të gazetës «Reç», «Proletarskaja Pravda» ua rekomandonte jo më kot gazetës «Novoje Vremja» dhe «Zemshinës» si një model «lealiteti» të kadetëve tanë. Në Nr. 13563 «Novoje Vremja», pa humbur rastin për t'u lëshuar kundër «çifutit» dhe për t'u futur kadetëve gjithfarë thumbash, megjithatë deklaronte:

«Ajo që për socialdemokratët është një aksiomë urtësie politike» (domethënë njohja e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, për shkëputje) «ka filluar të ngjallë mosmarrëveshje edhe ndër kadetët».

Në parim kadetët kanë marrë një qëndrim krejt të njëjlojtë me gazetën «Novoje Vremja», duke deklaruar se «nuk janë përpjekur kurrë të mbrojnë të drejtën e shkëputjes së kombeve nga shteti rus». Kjo është

një nga bazat e *nacional-liberalizmit* të kadetëve, e afërsisë së tyre me Purishkeviçët, një nga bazat e varësisë së tyre ideopolitike dhe politike praktike prej këtyre të fundit. «Zotërinjtë kadetë e kanë studiuar historinë — shkruante «Proletarskaja Pravda» — dhe e dinë fare mirë se në çfarë veprimesh të «tipit të pogromeve», duke u shprehur butë, ka shpënë shumë herë në praktikë e drejta tradicionale e Purishkeviçëve «kape dhe mos e lësho». Megjithëse e dinë fare mirë burimin dhe natyrën feudale të gjithëfuqisë së Purishkeviçëve, kadetët megjithatë qëndrojnë krejtësisht në terrenin e raporteve dhe të kufijve të krijuar pikërisht prej asaj klase. Megjithëse e dinë fare mirë se ç'karakter joevropian, antievropian (aziatik, do të thoshim ne, po të mos dukej kjo si një përbuzje e pamerituar për japonezët dhe kinezët), kanë raportet dhe kufijtë e krijuar ose të përcaktuar nga ajo klasë, zotërinjtë kadetë i pranojnë si një cak, përtej të cilit nuk mund të kalohet.

Kjo do të thotë t'u përshtatesh Purishkeviçëve, të përulësh para tyre, të kesh frikë se mos lëkundësh pozitën e tyre, t'i mbrosh nga lëvizja popullore, nga demokracia. «Në të vërtetë kjo do të thotë — shkruante «Proletarskaja Pravda» — t'u përshtatesh interesave të bujkrobëruesve dhe paragjykimeve më të këqija nacionaliste të kombit sundues, në vend që t'i luftosh sistematikisht këto paragjykime».

Si njerëz që e njohin historinë dhe pretendojnë se janë demokratë, kadetët nuk bëjnë as përpjekjen më të vogël për të vërtetuar se lëvizja demokratike, që karakterizon sot Evropën Lindore dhe Azinë dhe që përpigjet t'i transformojë të dyja sipas modelit të vendeve të qytetëruara kapitaliste, — se kjo lëvizje është e detyruar t'i lërë krejt të pandryshuar kufijtë e caktuar nga epoka feudale, nga epoka e gjithëfuqisë së Purishkeviçëve dhe e mohimit të çdo të drejte të shtresave të gjera të borgjezisë dhe të borgjezisë së vogël.

Që çështja e ngritur nga polemika e gazetës «Proletarskaja Pravda» me gazetën «Reç» nuk ishte aspak vetëm një çështje letrare, por një çështje e politikës me të vërtetë aktuale, këtë e provoi, përveç së tjerash, konferenca e fundit e partisë së kadetëve, që u mbajt më 23-25 mars 1914. Në njoftimin zyrtar të gazetës «Reç» (Nr. 83, 26 mars 1914) për këtë konferencë lexojmë:

«Edhe çështjet kombëtare u diskutuan me një gjallëri të veçantë. Deputetët e Kievit, me të cilët u bashkuan N. V. Nekrasovi dhe A. M. Koliubakini, theksuan se çështja kombëtare është një faktor me rëndësi që është duke u pjekur dhe që duhet zgjidhur më me vendosmëri se më parë. Porse F. F. Kokoshkini vuri në dukje» (është gjithë ajo «porse», që i përgjigjet «po»-së së Shedrinit — «nuk rriten veshët më lart nga balli, nuk rriten»), «se si programi, ashtu edhe përvoja e mëparshme politike kërkojnë që të përdoren me shumë kujdes «formulat elastike» «të vetëvendosjes politike të kombësive»».

Ky arsyetim me të vërtetë i mrekullueshëm që u bë në konferencën e kadetëve, meriton të shikohet me vëmendjen më të madhe nga gjithë marksistët dhe gjithë demokratët. (Le të shënojmë në kllapa se «Kievskaja Misl», organ me sa duket i informuar shumë mirë e që paraqet pa dyshim me besnikëri mendimet e z. Kokoshkin, ka shtuar se ky theksoi me qëllim, natyrisht në formë paralajmërimi për kundërshtarët e tij, rrezikun e një «shturjeje» të shtetit.)

Njoftimi zyrtar i gazetës «Reç» është shkruar me një diplomaci virtuoze, me qëllim që ta ngrejë sa të jetë e mundur më pak perden për të fshehur sa më shumë. Megjithatë, në vija të përgjithshme shihet qartë se ç'ndodhi në konferencën e kadetëve. Deputetët — borgjezë liberalë, që e dinë gjendjen e Ukrainës, dhe kadetët «e majtë» shtruan pikërisht çështjen e vetëvendosjes politike të kombeve. Përndryshe z. Ko-

koshkin nuk do të kishte arsye të bënte thirrje që kjo «formulë» të përdorej «me kujdes».

Në programin e kadetëve, që, natyrisht, njihej nga delegatët e konferencës së kadetëve, flitet pikërisht për vetëvendosje jo politike, por «kulturore». Pra, z. Kokoshkin mbronte programin nga delegatët e Ukrainës, nga kadetët e majtë, mbronte vetëvendosjen «kulturore» kundër vetëvendosjes «politike». Është më se e qartë se duke u ngritur kundër vetëvendosjes «politike», duke pranuar rrezikun e «shkatërrimit të shtetit», duke e cilësuar si «elastike» (krejt në frymën e Roza Luksemburgut!) formulën e «vetëvendosjes politike», z. Kokoshkin mbronte nacional-liberalizmin rus kundër elementëve më «të majtë», ose më demokratikë të partisë konstitucionale-demokrate dhe kundër borgjezisë ukrainase.

Z. Kokoshkin fitoi në konferencën e kadetëve, siç shihet nga fjalëza tradhtare «porse» në njoftimin e gazetës «Reç». Nacional-liberalizmi rus ka triumfuar te kadetët. A nuk do të ndihmojë kjo fitore për të sqaruar mendjet e disa njerëzve të paarsyeshëm ndër marksistët rusë, që kishin filluar të kishin frikë, si kadetët, nga «formulat elastike të vetëvendosjes politike të kombësive»?

«Porse» le ta shqyrtojmë në thelb rrjedhën e ideve të z. Kokoshkin. Duke përmendur «përvojën politike të mëparshme» (domethënë, me sa duket, përvojën e 1905-s, kur borgjezia ruse u tremb se mos humbte privilegjet e saj kombëtare dhe frikësoi me frikën e saj partinë e kadetëve), duke parashtruar rrezikun e «shthurjes së shtetit», z. Kokoshkin tregoi se e kuptonte fare mirë që vetëvendosja politike nuk mund të ketë asnjë kuptim tjetër përveç së drejtës për shkëputje dhe për formimin e një shteti kombëtar të pavarur. Lind pyetja se si duhet shikuar kjo frikë e z. Kokoshkin nga pikëpamja e demokracisë në përgjithësi dhe nga pikëpamja e luftës së klasës së proletariatit në veçanti.

Z. Kokoshkin kërkon të na bindë se njohja e së drejtës së shkëputjes shton rrezikun e «shturjes së shtetit». Kjo është pikëpamja e xhandarit Mimrecov, me devizën e tij: «kape dhe mos e lësho». Nga pikëpamja e demokracisë në përgjithësi ndodh pikërisht e kundërta: njohja e së drejtës për shkëputje e pakëson rrezikun e «shturjes së shtetit».

Z. Kokoshkin arsyeton krejt të frymën e nacionalistëve. Në kongresin e tyre të fundit ata u vërsulën kundër «mazepistëve» — ukrainas. Lëvizja ukrainase — thirrën z. Savenko e K^o — kërcënon ta dobësojë lidhjen e Ukrainës me Rusinë, sepse Austria, me politikën e saj ukrainofile, po i forcon lidhjet e ukrainasve me Austrinë!! Atëherë nuk kuptohet pse Rusia s'mund të provojë të «forcojë» lidhjen e ukrainasve me Rusinë *po me atë metodë*, për të cilën e akuzojnë Austrinë zotërinjtë Savenko, domethënë duke u dhënë ukrainasve lirinë e përdorimit të gjuhës së tyre amtare, vetëqeverisjen, një sejm autonom, etj.?

Arsyetimet e z. Savenko dhe të z. Kokoshkinë janë krejt të njëjtoja, dhe nga pikëpamja thjesht logjike njësoj qesharake e pa kuptim. A nuk është e qartë se sa më shumë liri të ketë kombësia ukrainase në këtë ose atë vend, aq më e fortë do të jetë lidhja e kësaj kombësie me atë vend? Duket se s'mund të vihet në dyshim kjo e vërtetë elementare, pa shkelur krejt të gjitha premisat e demokratizmit. A mund të ketë për një kombësi liri më të madhe sesa liria e shkëputjes, liria për të formuar një shtet kombëtar të pavarur?

Për ta sqaruar edhe më mirë këtë çështje të ngatërruar nga liberalët (dhe nga ata që, pa e kuptuar, u venë pas), po sjellim një shembull fare të thjeshtë. Le të marrim çështjen e shkurorezimit. Roza Luksemburgu shkruan në artikullin e saj së shteti demokratik i centralizuar, duke u pajtuar plotësisht me autonominë e disa krahinave, duhet të lërë në kompetencën e parlamentit qendror të gjitha degët kryesore të

legjislacionit, ndër të tjera edhe legjislacionin e shkurorëzimit. Ky kujdes për të siguruar nga pushteti qendror i shtetit demokratik lirinë e shkurorëzimit është krejtësisht i kuptueshëm. Reaksionarët janë kundër lirisë së shkurorëzimit, ata kërkojnë që «të përdoret me kujdes» dhe thërrasin se shkurorëzim do të thotë «shkatërrim i familjes». Kurse demokracia mendon se reaksionarët janë hipokritë, se ata në të vërtetë mbrojnë gjithëfuqinë e policisë dhe të burokracisë, privilegjet e një seksi dhe shtypjen më të poshtër të gruas; — se në të vërtetë liri e shkurorëzimit nuk do të thotë aspak «shkatërrim» i lidhjeve familjare, por, përkundrazi, forcim i tyre mbi baza demokratike, që janë të vetmet baza të mundshme dhe të qëndrueshme në një shoqëri të qytetëruar.

Të akuzosh përkrahësit e lirisë së vetëvendosjes, domethënë lirisë së shkëputjes, se inkurajojnë separatizmin është po aq pa kuptim dhe po aq hipokrite si të akuzosh përkrahësit e lirisë së shkurorëzimit se inkurajojnë shkatërrimin e lidhjeve familjare. Ashtu si ngrihen në shoqërinë borgjeze kundër lirisë së shkurorëzimit mbrojtësit e privilegjeve dhe të shitjes së gruas mbi të cilat mbështetet martesja borgjeze, po kështu edhe mohimi që i bëhet në një shtet kapitalist lirisë së vetëvendosjes, domethënë lirisë së shkëputjes së kombeve, s'është veçse mbrojtje e privilegjeve të kombit sundues dhe e metodave policore të qeverisjes në dëm të metodave demokratike.

S'ka dyshim se politikanizmi, që është pjellë e të gjitha marrëdhënieve të shoqërisë kapitaliste, shkakton ngandonjëherë llogotitjet jashtëzakonisht mendjelehta e madje fare pa kuptim të parlamentarëve ose të publicistëve për shkëputjen e këtij ose atij kombi. Por vetëm reaksionarët mund të tremben (ose të bëjnë sikur tremben) nga një llogotitje e tillë. Ai që është me pikëpamjet e demokracisë, domethënë për zgjidhjen e problemeve shtetërore nga masa e popullsisë, e di fare mirë se që nga llogotitja e politikanëve

deri te vendimi i masave «ka në mes një det të tërë»¹⁸. Nga përvoja e tyre e përditshme masat e popullsisë e njohin fare mirë rëndësinë e lidhjeve gjeografike dhe ekonomike, përfitimet e tregut të gjerë dhe të shtetit të madh. Prandaj ato do të vendosin të shkëputen vetëm kur shtypja kombëtare dhe grindjet kombëtare do ta bëjnë krejt të padurueshme jetën e përbashkët dhe do të pengojë çdo marrëdhënie ekonomike. Dhe në këtë rast interesat e zhvillimit kapitalist e të lirisë së luftës së klasave do të jenë pikërisht nga ana e atyre që shkëputen.

Kështu, nga çdo anë që t'i marrim arsyetimet e z. Kokoshkin, ato janë kulmi i absurditetit dhe tallje ndaj parimeve të demokracisë. Po ka edhe njëfarë logjike në këto arsyetime, logjika e interesave të klasës së borgjezisë rusomadhe. Z. Kokoshkin, ashtu si dhe shumica e partisë së kadetëve, është shërbëtor i qeses së kësaj borgjezie. Ai mbron privilegjet e saj përgjithësisht, dhe privilegjet e saj *shtetërore* veçanërisht, i mbron bashkë me Purishkeviçin dhe krahas tij, — vetëm se Purishkeviçi ka më tepër besim në kërbaçin e bujkrobërisë, kurse Kokoshkini e K⁰ e dinë se më 1905 ky kërbaç u dëmtua mjaft, dhe kanë besim më tepër në metodat borgjeze për t'i gënjyer masat, si, për shembull, frikësimi i mikroborgjezëve e i fshatarëve me gogolin e «shturjes së shtetit», mashtrimi i tyre me fraza për një ndërthurje të «lirisë së popullit» me parimet historike etj.

Kuptimi i vërtetë i klasor i kësaj armiqësie të liberalëve ndaj parimit të vetëvendosjes politike të kombeve është një dhe vetëm një: nacional-liberalizëm, mbrojtje e privilegjeve shtetërore të borgjezisë rusomadhe. Edhe ndër marksistët rusë oportunistët, që ngrihen pikërisht sot, në epokën e sistemit të 3 qershorit, kundër së drejtës së kombeve për vetëvendosje, të gjithë: likuidatori Semkovski, bundisti Libman, mikroborgjezi ukrainas Jurkeviç, në të vërtetë hiqen zvarrë prapa qerres së nacional-liberalizmit dhe orva-

ten ta korruptojnë klasën punëtore me ide nacional-liberale.

Interesat e klasës punëtore dhe të luftës së saj kundër kapitalizmit kërkojnë solidarësinë më të plotë dhe unitetin më të ngushtë të punëtorëve të të gjitha kombeve; kërkojnë qëndresë kundër politikës nacionaliste të borgjezisë së cilësdo kombësie qoftë. Prandaj do të ishte shmangie nga qëllimet e politikës proletare dhe nënshtrim i punëtorëve ndaj politikës borgjeze edhe sikur socialdemokratët të fillonin të mohonin të drejtën e vetëvendosjes, domethënë të drejtën e shkëputjes së kombeve të shtypura, edhe sikur ata të fillonin të përkrahnin të gjitha kërkesat kombëtare të borgjezisë së kombeve të shtypura. Për punëtorin me mëditje është njësoj nëse shfrytëzuesi i tij kryesor është borgjezia ruse në vend të borgjezisë së ndonjë kombi tjetër, apo borgjezia poloneze në vend të borgjezisë çifute etj. Punëtori me mëditje, i vetëdijsëm për interesat e klasës së tij, është po aq mospërfillës për privilegjet shtetërore të kapitalistëve rusë, sa edhe për premtimet e kapitalistëve polonezë ose ukrainas se kanë për të vendosur parajsën mbi dhe, kur të kenë siguruar privilegje shtetërore. Sidoqoftë, në një mënyrë ose në një tjetër, zhvillimi i kapitalizmit shkon dhe do të shkojë përpara si në një shtet të vetëm me kombësi të ndryshme, ashtu edhe në shtete të veçanta kombëtare.

Sido që të jetë, punëtori me mëditje do të mbetet objekt shfrytëzimi dhe që lufta kundër këtij shfrytëzimi të ketë sukses duhet që proletariati të jetë i lirë nga nacionalizmi, krejt asnjëherë, si të thuash, në luftën që bën borgjezia e kombeve të ndryshme për supremaci. Përkrahja më e vogël që mund t'u japë proletariati i një kombi privilegjeve të borgjezisë «së tij» kombëtare, do të ngjallë patjetër mosbesimin e proletariatit të një kombi tjetër, do ta dobësojë solidarësinë ndërkombëtare të klasës së punëtorëve, do t'i përçajë ata, duke gëzuar borgjezinë. Mohimi, pra, i së

drejtës për vetëvendosje ose për shkëputje do të thotë, medoemos, në praktikë, përkrahje e privilegjeve të kombit sundues.

Mund të bindemi edhe më mirë për këtë, në qoftë se marrim shembullin konkret të shkëputjes së Norvegjisë nga Suedia.

6. SHKËPUTJA E NORVEGJISË NGA SUEDIA

Roza Luksemburgu sjell pikërisht këtë shembull dhe arsyeton kështu për të:

«Ngjarja e fundit në historinë e marrëdhënieve federative, shkëputja e Norvegjisë nga Suedia, — që u kap me nxitim atëherë nga shtypi social-patriot i Polonisë (shih «Napshudin» e Krakovit) si një shfaqje inkurajuese e fuqisë dhe e karakterit progresist të aspiratave për shkëputje shtetërore, — u shndërrua menjëherë në një provë të dukshme të faktit se federalizmi dhe shkëputja shtetërore, që rrjedh prej tij, nuk janë aspak shprehje përparimi ose demokratizmi. Pas të ashtuquajturit «revolucion» norvegjez, që pati si qëllim rrëzimin dhe largimin nga Norvegjia të mbretit të Suedisë, norvegjezët zgjodhën me qetësinë më të madhe një tjetër, duke hedhur poshtë formalisht me një plebishit projektin për të vendosur republikën. Ajo që gjithë admiruesit e përciptë të çdo lëvizjeje kombëtare e të çdo gjëje që i përngjan pavarësisë e kishin shpallur si «revolucion», s'ishte veçse një shfaqje e zakonshme partikularizmi fshatar e mikroborgjez, një shfaqje e dëshirës për të pasur me paratë e tyre mbretin «e tyre» në vend të atij që u kishte imponuar aristokracisë suedeze; kjo ishte, pra, një lëvizje që s'kishte asnjëfarë lidhjeje me frymën revolucionare. Historia e kësaj prishjeje të unionit suedo-norvegjez provoi njëkohësisht edhe një herë se deri në ç'pikë edhe në këtë rast federata, që kishte ekzistuar deri atëherë, ishte

vetëm një shprehje e interesave thjesht dinastike dhe, si pasojë, një formë monarkizmi dhe reaksioni» («Psheglond»).

Këto janë fjalë për fjalë ato që thotë Roza Luksemburgu për këtë pikë!! Dhe duhet pranuar se do të ishte vështirë ta tregojë më mirë dobësinë e pozitës së saj nga ç'e ka bërë Roza Luksemburgu në këtë shembull.

Problemi ishte dhe është ky: nëse për socialdemokratët e një shteti me përbërje kombëtare të ndryshme duhet një program që pranon të drejtën e vetëvendosjes ose të shkëputjes.

Çna tregon pra për këtë çështje shembulli i Norvegjisë, që ka zgjedhur vetë Roza Luksemburgu?

Autorja jonë silllet e përsillet, shet mend, kapet me «Napshudin», por pyetjes nuk i përgjigjet!! Roza Luksemburgu flet për çdo gjë, që të mos thotë asnjë fjalë për thelbin e çështjes!!

S'ka dyshim se borgjezët e vegjël norvegjezë, që deshën të kenë një mbret të tyre me paratë e tyre dhe hodhën poshtë me plebishit projektin për vendosjen e republikës, treguan cilësi shumë të këqija mikroborgjeze. S'ka dyshim se «Napshudi», që nuk e ka vënë re këtë, ka treguar cilësi po aq të këqija dhe po aq mikroborgjeze.

Po ç'hyjnë të gjitha këto këtu??

Çështja ishte te e drejta e kombeve për vetëvendosje dhe te qëndrimi i proletariatit socialist kundrejt kësaj së drejte! Pse s'i përgjigjet, pra, Roza Luksemburgu çështjes, por i vjen rrotull?

Për miun, thotë një fjalë, s'ka bishë më të fortë se macja. Për Roza Luksemburgun, siç duket, s'ka bishë më të egër se «fraku». Në gjuhën popullore quhen «frakë» anëtarët e «partisë socialiste poloneze», i ashtuquajturit fraksion revolucionar, dhe fletushka «Napshud» e Krakovit përkrah idenë e këtij «fraksioni». Lufta që bën Roza Luksemburgu kundër nacionalizmit të këtij «fraksioni» e verbon aq shumë autoren tonë,

saqë nga horizonti i saj zhduket çdo gjë, përveç «Napshudit».

Në qoftë se «Napshudi» thotë: «po», Roza Luksemburgu e quan si detyrë të saj të shenjtë të thotë menjëherë: «jo», pa menduar aspak se, duke bërë kështu, ajo nuk tregon pavarësinë e saj nga «Napshudi», por, përkundrazi, varësinë e saj qesharake ndaj «frakëve», pazotësinë e saj për t'i shikuar punët nga një pikëpamje pak më e thellë dhe më e gjerë nga ajo e folesë së milingonave të Krakovit. Pa dyshim, «Napshudi», është një organ shumë i keq dhe aspak marksist, por kjo s'duhet të na pengojë që të analizojmë në thelb shembullin e Norvegjisë, meqë e kemi zgjedhur.

Për ta analizuar këtë shembull si marksistë, nuk duhet të ndalemi te cilësitë e këqija të këtyre «frakëve» të tmerrshëm, por, së pari, te veçoritë konkrete historike të shkëputjes së Norvegjisë nga Suedia dhe, së dyti, te detyrat që shtroheshin përpara *proletariatit* të të dyja vendeve për këtë shkëputje.

Lidhjet gjeografike, ekonomike dhe gjuhësore, që e afrojnë Norvegjinë me Suedinë, nuk janë më pak të ngushta se lidhjet e rusëve me shumë kombe të tjera sllave joruse. Mirëpo bashkimi i Norvegjisë me Suedinë s'kishte qenë vullnetar, kështu që Roza Luksemburgu flet më kot për «federatë», vetëm ngaqë s'di ç'të thotë. Qenë monarkët ata që, në kohën e luftërave napoleoniane ia dhanë Norvegjinë Suedisë kundër vullnetit të norvegjezëve, dhe suedezëve iu desh të futnin trupat e tyre në Norvegji për ta nënshtruar atë.

Me gjithë autonominë jashtëzakonisht të gjerë që gëzonte Norvegjia (kishte sejmën e saj etj.), për shumë dhjetëra vjet me radhë pas bashkimit fërkimet ndërmjet Norvegjisë e Suedisë vazhduan dhe norvegjezët u përpoqën me tërë fuqitë e tyre të hidhnin poshtë zgjedhën e aristokracisë suedeze. Më në fund, në gusht 1905 ata e hoqën qafe atë: sejmi norvegjez vendosi se mbreti i Suedisë nuk ishte më mbret i Norvegjisë dhe

referendumi, konsultimi i popullit norvegjez, që u bë pastaj, dha shumicën dërrmuese të votave (afër 200 mijë kundër disa qindrave) për shkëputje të plotë nga Suedia. Pas disa lëkundjesh suedezët u pajtuan me shkëputjen.

Ky shembull na tregon se në çfarë terreni janë të mundshme dhe ndodhin raste shkëputjeje të kombeve në marrëdhëniet ekonomike dhe politike të sotme dhe ç'formë merr disa herë shkëputja në kushtet e lirisë politike dhe të demokratizmit.

Asnjë socialdemokrat nuk mund të mohojë, veç nëse shpreh mosinteresim për çështjet e lirisë politike dhe të demokratizmit (por në këtë rast ai, natyrisht, nuk është më socialdemokrat), se ky shembull tregon në të vërtetë se është detyrë e domosdoshme që punëtorët e ndërgjegjshëm të zhvillojnë propagandë sistematike dhe të përgatiten në mënyrë që konfliktet që mund të shkaktojnë shkëputja e kombeve të zgjidhen vetëm ashtu siç u zgjidhën më 1905 ndërmjet Norvegjisë e Suedisë, dhe jo «në mënyrën ruse». Pikërisht këtë shpreh pika e programit tonë, që kërkon njohjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje. Dhe Roza Luksemburgut iu desh ta hiqte qafe këtë fakt të papëlqyer për teorinë e saj me anë sulmesh të ashpra kundër filisteizmit të mikroborgjezëve norvegjezë dhe kundër «Napshudit» të Krakovit, sepse ajo e kuptonte fare mirë se deri në ç'pikë i hidhte poshtë përgjithnjë ky fakt historik frazat e saj se gjoja e drejta e vetëvendosjes së kombeve është një «utopi», se ajo mund të barazohet me të drejtën «për të ngrënë në pjata të arta» etj. Të tilla fraza shprehin vetëm një besim oportunist e mendjemadh në karakterin e pandryshueshëm të raportit të tanishëm të forcave ndërmjet kombësive të Evropës Lindore.

Le të vazhdojmë. Në çështjen e vetëvendosjes së kombeve, si edhe në çdo çështje tjetër, ajo që na intereson para së gjithash e mbi të gjitha është vetëvendosja e proletariatit brenda kombeve. Roza Luk-

semburgu e ka lënë mënjanë me modesti edhe këtë çështje, duke e ndier se sa e papëlqyer do të ishte për «teorinë» e saj analiza e kësaj çështjeje sipas shembullit të Norvegjisë, që e kishte zgjedhur ajo vetë.

Cili ka qenë dhe cili duhej të ishte qëndrimi i proletariatit norvegjez dhe suedez në konfliktin e shkaktuar nga shkëputja? Punëtorët e ndërgjegjshëm të Norvegjisë, sigurisht, pas shkëputjes do të kishin votuar për republikën*, dhe në qoftë se ka pasur socialistë që kanë votuar ndryshe, kjo tregon vetëm se sa oportuniste të trashë, mikroborgjez ka nganjëherë edhe në socializmin evropian. Në këtë çështje s'mund të ketë dy mendime, dhe ne e prekim këtë vetëm sepse Roza Luksemburgu mundohet ta fshehtë thelbin e çështjes me gjepura jashtë teme. Për sa i përket shkëputjes, nuk e dimë nëse socialdemokratët e Norvegjisë i detyronte programi socialist norvegjez që t'i përmbaheshin një mendimi të caktuar. Le ta zëmë se jo, se socialistët norvegjezë e kishin lënë pezull çështjen se deri në ç'masë mjaftonte autonomia e Norvegjisë për lirinë e luftës së klasave dhe deri në ç'masë do ta pengonin fërkimet dhe konfliktet e vazhdueshme me aristokracinë suedeze lirinë e jetës ekonomike. Por që proletariati norvegjez duhej të shkonte kundër kësaj aristokracie dhe të merrte anën e demokracisë fshatare (me gjithë karakterin e saj të kufizuar mikroborgjez), kjo nuk mund të vihet në dyshim.

Po proletariati suedez? Dihet se çifligarët e mëdhenj suedezë, të përkrahur nga priftërinjtë suedezë, predikonin luftën kundër Norvegjisë, dhe meqë Nor-

* Po të kishte qenë shumica e kombit norvegjez për monarkinë dhe proletariati për republikën, atëherë, po të flasin përgjithësisht, proletariati norvegjez i hapeshin dy rrugë: ose të bënte revolucion, po të ishin pjekur kushtet për këtë, ose t'i nënshtrohej shumicës dhe t'i përvishej një pune të gjatë propagande dhe agjitacioni.

vegjia është shumë më e dobët se Suedia, meqë ajo e kishte provuar pushtimin suedez, meqë aristokracia suedeze peshon shumë në vendin e saj, ky predikim ishte një kërcënim shumë serioz. Mund të vëmë bast se Kokoshkinët suedezë janë përpjekur për shumë kohë dhe me zell të madh të korruptojnë masat e Suedisë, duke i ftuar ato që «të jenë shumë të kujdesshme në përdorimin e formulave elastike të vetëvendosjes politike të kombeve», duke përshtetur rrezikun e «shthurjes së shtetit» dhe duke i siguruar se «diria e popullit» pajtohet me parimet tradicionale të aristokracisë suedeze. S'ka as më të voglin dyshim se socialdemokracia suedeze do ta kishte tradhtuar çështjen e socializmit dhe të demokracisë, po të mos e kishte luftuar me të gjitha fuqitë ideologjine e politikën edhe të çifligarëve të mëdhenj edhe të Kokoshkinëve, po të mos kishte mbrojtur, *përveç* barazisë së kombeve në përgjithësi (që e pranojnë edhe Kokoshkinët), të drejtën e kombeve për vetëvendosje, lirinë e shkëputjes së Norvegjisë.

Aleanca e ngushtë e punëtorëve norvegjezë dhe suedezë, solidarësia e tyre e plotë klasore dhe vëllazërore përfitoi ngaqë punëtorët suedezë e njohën të drejtën e norvegjezëve për shkëputje. Sepse punëtorët norvegjezë u bindën në këtë mënyrë se punëtorët suedezë nuk ishin të molepsur nga nacionalizmi suedez, se ata e vinin vëllazërimin me proletarët norvegjezë mbi privilegjet e borgjezisë dhe të aristokracisë suedeze. Këputja e lidhjeve, që i kishin imponuar Norvegjisë monarkët evropianë dhe aristokratët suedezë, i forcoi lidhjet ndërmjet punëtorëve norvegjezë e suedezë. Punëtorët suedezë treguan se me *gjithë* peripeçitë e politikës borgjeze — një pushtim i ri i norvegjezëve prej suedezëve me anën e forcës është kreyt i mundshëm në terrenin e marrëdhënieve borgjeze! — ata do të dinë ta ruajnë dhe ta mbrojnë barazinë e plotë të të drejtave, si dhe solidarësinë e klasës të punëtorëve të të dyja kombeve në luftë si kundër borgjezisë suedeze, ashtu edhe asaj norvegjeze.

Nga kjo shihet, ndër të tjera, se sa të pathemelta dhe madje joserioze janë orvatjet që bëjnë disa herë «frakët» për të «shfrytëzuar» mosmarrëveshjet tona me Roza Luksemburgun kundër socialdemokracisë poloneze. «Frakët» nuk janë një parti proletare, as socialiste, por një parti nacionaliste mikroborgjeze, njëfarë partie socialistësh revolucionarë polonezë. As është folur as mund të flitej për një bashkim të socialdemokratëve rusë me këtë parti. Kurse s'ka pasur kurrë asnjë socialdemokrat rus që «të jetë penduar» për një afrim ose bashkim me socialdemokratët polonezë. Socialdemokracia poloneze ka meritën shumë të madhe historike që krijoi për herë të parë në Poloni, në atë vend plot tendenca dhe simpati nacionaliste, një parti me të vërtetë marksiste, me të vërtetë proletare. Por kjo meritë e socialdemokratëve polonezë është e madhe jo sepse Roza Luksemburgu tha një varg marrëzish kundër paragrafit 9 të programit marksist të Rosisë, por në kundërshtim me këtë fakt të hidhur.

Për socialdemokratët polonezë, sigurisht, «e drejta e vetëvendosjes» nuk ka po atë rëndësi që ka për socialdemokratët rusë. Është krejt e kuptueshme se lufta kundër borgjezisë së vogël poloneze, që është verbuar nga nacionalizmi, i ka shtrënguar socialdemokratët polonezë «ta kalojnë masën» me një zell të veçantë (ngandonjëherë madje të tepruar). Asnjë marksisti rus s'i ka shkuar kurrë ndonjëherë ndër mend që t'i akuzojë socialdemokratët polonezë se ata janë kundër shkëputjes së Polonisë. Këta socialdemokratë gabojnë vetëm kur përpiqen të mohojnë — siç bën dhe Roza Luksemburgu — nevojën e njohjes së të drejtës për vetëvendosje në programin e marksistëve rusë.

Kjo do të thotë, në thelb, t'i shtrish raportet, të kuptueshme për horizontin e Krakovit, mbi gjithë popujt dhe të gjitha kombet e Rosisë, duke përfshirë edhe vetë rusët. Kjo do të thotë të jesh «nacionalist polonez së prapthi», por jo socialdemokrat rus dhe as internacionalist.

Sepse socialdemokracia ndërkombëtare qëndron pikërisht në terrenin e njohjes së të drejtës së kombeve për vetëvendosje. Le të kalojmë tani në këtë pikë.

7. VENDIMI I KONGRESIT NDËRKOMBËTAR TË LONDRËS I VITIT 1896

Ky vendim thotë:

«Kongresi shpall se është për të drejtën e plotë të vetëvendosjes (Selbstbestimmungsrecht) së të gjitha kombeve dhe shpreh simpatinë e tij për punëtorët e çdo vendi që vuan tani nën zgjedhën e absolutizmit ushtarak, kombëtar ose të çdo absolutizmi tjetër; kongresi i fton punëtorët e gjithë këtyre vendeve që të bashkohen në radhët e punëtorëve të ndërgjegjshëm (Klassenbewusste — të ndërgjegjshëm për interesat e klasës së tyre) të tërë botës, me qëllim që të luftojnë së bashku për përmbyshjen e kapitalizmit ndërkombëtar dhe për realizimin e qëllimeve të socialdemokracisë ndërkombëtare»*.

Sic e kemi thënë edhe më sipër, oportunistët tanë, zz. Semkovski, Libman dhe Jurkeviç, nuk kanë asnjë dizeni për këtë vendim. Por Roza Luksemburgu e di

* Shih procesverbalin zyrtar gjerman të Kongresit të Londrës: «Verhandlungen und Beschlüsse des internationalen sozialistischen Arbeiter-und Gewerkschafts — Kongresses zu London, vom 27. Juli bis 1. August 1896», Berlin, 1897, S. 18 («Procesverbalet dhe vendimet e Kongresit ndërkombëtar të partive punëtoresh socialiste dhe të bashkimeve profesionale, mbajtur në Londër prej 27 korrikut deri më 1 gusht 1896», Berlin, 1897, f. 18, Red.). Ka një broshurë ruse që përmban vendimet e kongreseve ndërkombëtare, ku fjala «vetëvendosje» është përkthyer gabimisht: «autonomi».

dhe citon tekstin e plotë të tij, ku gjendet po ajo shprehje e programit tonë: «vetëvendosje».

Na del pyetja, si e kapërcen Roza Luksemburgu këtë pengesë që i del përpara teorisë së saj «origjinale»?

Oh! Fare thjesht: ...qendra e rëndesës këtu është në pjesën e dytë të rezolucionit... karakteri deklarativ i tij... atij mund t'i referohesh vetëm nga një keqkuptim!!

Është me të vërtetë për t'u çuditur se sa e pazonja dhe sa e hutuar është autorja jonë. Zakonisht vetëm oportunistët, që i shmangen me frikë çdo polemike të hapët kundër pikave konsekuente demokratike dhe socialiste të programeve, flasin për karakterin e tyre deklarativ. Me sa duket, këtë herë Roza Luksemburgu nuk u ndodh më kot në shoqërinë e vajtueshme të Semkovskëve, Libmanit dhe Jurkeviçit. Roza Luksemburgu nuk ka guxim ta thotë haptazi a e quan këtë rezolucion të drejtë apo të gabuar. Ajo vjen rrotull dhe fshihet, sikur shpreson se do të ketë të bëjë me ndonjë lexues të pakujdesshëm dhe të paditur, i cili, kur të ketë arritur në pjesën e dytë të rezolucionit, do ta ketë harruar të parën, ose nuk do të ketë dëgjuar kurrë për debatet që u bënë në shtypin socialist përpara Kongresit të Londrës.

Por Roza Luksemburgu gabon rëndë nëse kujton se mund ta marrë aq lehtë nëpër këmbë përpara punëtorëve të ndërgjegjshëm të Ruisë rezolucionin e Internacionales për një çështje të rëndësishme parimore, pa pranuar as ta analizojë atë në mënyrë kritike.

Gjatë debateve që u bënë para Kongresit të Londrës — kryesisht në faqet e revistës së marksistëve gjermanë «Die Neue Zeit» — u shfaq pikëpamja e Roza Luksemburgut, dhe kjo pikëpamje, në thelb, pësoi disfatë përpara Internacionales! Ja thelbi i çështjes që duhet ta ketë gjithnjë parasysh sidomos lexuesi rus.

Debatet u bënë rreth çështjes së pavarësisë së Polonisë. U shfaqën tri pikëpamje:

1) Pikëpamja e «frakëve», në emër të të cilëve foli Hekeri. Ata donin që Internacionalja të njihte në programin e saj kërkesën e pavarësisë së Polonisë. Ky propozim nuk u pranua. Kjo pikëpamje pësoi disfatë përpara Internacionales.

2) Pikëpamja e Roza Luksemburgut: socialistët polonezë s'duhet të kërkojnë pavarësinë e Polonisë. Sa për shpalljen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, as që mund të bëhej fjalë nga kjo pikëpamje. Edhe kjo pikëpamje pësoi disfatë përpara Internacionales.

3) Pikëpamja që zhvilloi atëherë me shumë hollësi K. Kautski, duke u ngritur kundër Roza Luksemburgut dhe duke provuar karakterin krejt «të njëanshëm» të materializmit të saj. Nga kjo pikëpamje, Internacionalja s'mund të caktojë, tani për tani, si program të saj pavarësinë e Polonisë, por socialistët polonezë — thoshte Kautski — kanë plotësisht të drejtë ta shtrojnë këtë kërkesë. Sipas pikëpamjes së socialistëve është patjetër gabim të mos njohësh detyrat e çlirimit kombëtar në një situatë shtypjeje kombëtare.

Në rezolucionin e Internacionales janë riprodhuar tezat më thelbësore, më themelore të kësaj pikëpamjeje; nga njëra anë, njohja absolute dhe e qartë e së drejtës së plotë të të gjitha kombeve për vetëvendosje; nga ana tjetër, një thirrje po aq e qartë, drejtuar punëtorëve, për unitetin *ndërkombëtar* të luftës së klasës së tyre.

Ne mendojmë se ky rezolucion është plotësisht i drejtë dhe se për vendet e Evropës Lindore dhe të Azisë në fillim të shekullit XX pikërisht ky rezolucion, dhe pikërisht lidhja e pazgjidhshme e të dy pjesëve të tij, jep të vetmen direktivë të drejtë të politikës së klasës proletare në çështjen kombëtare.

Do t'i shqyrtojmë pak më hollësisht këto tri pikëpamje të sipërpërmendura.

Dihet se K. Marksi dhe F. Engelsi e quanin si detyrë të domosdoshme për gjithë demokracinë e Evro-

pës Perëndimore, dhe aq më tepër për socialdemokracinë, që ajo të përkrahte në mënyrë aktive kërkesën e pavarësisë së Polonisë. Për vjetët 1840-1850 dhe 1860-1870, që janë epoka e revolucionit borgjez në Austri dhe në Gjermani dhe epoka e «reformës fshatare» në Rusi, kjo pikëpamje ishte plotësisht e drejtë dhe e vetmja pikëpamje demokratike dhe proletare konsekuente. Sa kohë që masat popullore të Rusisë dhe të shumicës së vendeve sllave ndodheshin ende në një gjumë të thellë, sa kohë që në këto vende s'kishte lëvizje demokratike të pavarura masash, lëvizja çlirimtare e *shlahtës* në Poloni kishte një rëndësi shumë të madhe, një rëndësi të dorës së parë nga pikëpamja e demokracisë jo vetëm të të gjithë Rusisë, jo vetëm të të gjitha vendeve sllave, por edhe të tërë Evropës*.

Por ndërsa kjo pikëpamje e Marksit ishte plotësisht e drejtë për vjetët 1850-1860 ose për çerekun e tretë të shekullit XIX, nuk ishte më e drejtë në shekullin XX. Në shumicën e vendeve sllave, dhe madje në njërin nga vendet sllave më të prapambetura, në Rusi, lindën lëvizje demokratike të pavarura, dhe madje një lëvizje proletare e pavarur. Polonia e *shlahtës* u zhduk dhe ia lëshoi vendin një Polonie kapitaliste. Në

* Do të ishte një punë historike shumë interesante të krahasohej pozita e aristokratit kryengritës polonez të vitit 1863 — pozita e revolucionarit demokrat rus Çernishevski, i cili gjithashtu (si edhe Marksi) dinte ta çmonte rëndësinë e lëvizjes poloneze, me pozitën e mikroborgjezit ukrainas Dragomanov, që doli në skenë shumë më vonë dhe shprehte pikëpamjen e fshatarit, ende aq të pagdhundur e aq të fjetur, aq të lidhur pas togut të plehut, sa që urrejtja e ligjshme që kishte për panin polonez nuk e linte të kuptonte rëndësinë që kishte për demokracinë e tërë Rusisë lufta e këtyre panëve. (Krahaso Dragomanov, «Polonia historike dhe demokracia e Rusisë».) Dragomanovi i meritonte plotësisht përçafimet entuziaste me të cilat e shpërbleu atë më vonë P.B. Struveja, i cili ishte bërë nacional-liberal.

këto kushte Polonia s'kishte si të mos e humbte rëndësinë e saj të *jushtëzakonshme* revolucionare.

Kur PPS («Partia Socialiste Poloneze», «frakët» e sotëm) më 1896 u mundua ta «përjetësonte» pikëpamjen që kishte pasur Marksi në një epokë tjetër, kjo donte të thoshte të përdorej *germa* e marksizmit kundër *frymës* së marksizmit. Prandaj socialdemokratët polonezë kishin plotësisht të drejtë kur u ngritën kundër tendencave nacionaliste të borgjezisë së vogël poloneze; ata treguan se çështja kombëtare për punëtorët polonezë kishte rëndësi të dorës së dytë, krijuan për herë të parë një parti thjesht proletare në Poloni dhe shpallën si një parim me rëndësi shumë të madhe aleancën e ngushtë të punëtorit polonez e rus në luftën e tyre të klasës.

Po a donte të thoshte kjo se në fillim të shekullit XX Internacionalja mund ta quante si të tepërt për Evropën Lindore dhe për Azinë parimin e vetëvendosjes politike të kombeve? të drejtën e tyre për shkaputje? Ky do të kishte qenë budallallëku më i madh, që do të ishte njëlloj (në teori) sikur ta quaje të kryer transformimin demokratik borgjez të shtetit turk, rus, kinez; — që do të ishte (në praktikë) oportunizëm ndaj absolutizmit.

Jo. Në Evropën Lindore dhe në Azi, në një epokë kur kanë filluar revolucionet demokratike borgjeze, në epokën e zgjimit dhe të ashpërsimit të lëvizjeve kombëtare, në epokën e krijimit të partive proletare të pavarura, detyra e këtyre partive në politikën kombëtare duhet të jetë e dyfishtë: njohja e së drejtës së gjithë kombeve për vetëvendosje, sepse transformimi demokratik borgjez nuk ka marrë fund ende, sepse demokracia punëtore mbron në mënyrë konsekuente, seriozisht dhe sinqerisht, e jo si liberalët dhe Kokoshkinët, barazinë e kombeve, dhe bashkimi sa më i ngushtë, më i pazgjidhshëm i luftës së klasës së proletarëve të të gjitha kombeve të një shteti gjatë gjithë peripecive të historisë së tij, gjatë gjithë ndryshimeve

të kufijve të shteteve të ndryshme nga ana e borgjezisë.

Pikërisht kjo detyrë e dyfishtë e proletariatit është formuluar në rezolucionin e Internacionales të 1896-s. Pikërisht në baza të tilla parimore mbështetet rezolucioni i konferencës së marksistëve rusë të verës së 1913-s. Ka njerëz që u duket si «kontradiktë» që ky rezolucion në pikën 4, duke njohur të drejtën e vetëvendosjes dhe të shkëputjes, i «jep» gjoja maksimumin nacionalizmit (në të vërtetë, në njohjen e së drejtës së gjithë kombeve për vetëvendosje ka një maksimum *demokratizmi* dhe një minimum nacionalizmi), — kurse në pikën 5 i porosit punëtorët të ruhen nga partitullat nacionaliste të çdo borgjezie dhe kërkon bashkimin dhe shkrirjen e punëtorëve të të gjitha kombeve në organizata proletare të përbashkëta ndërkombëtare. Por këtu mund të shohin një «kontradiktë» vetëm njerëzit kokështerpë, të paaftë të kuptojnë, për shembull, se pse *përfituan* uniteti dhe solidarësia e klasës proletare suedeze dhe norvegjeze kur punëtorët suedezë mbrojtën lirinë e Norvegjisë për t'u shkëputur dhe për të formuar një shtet të pavarur.

8. UTOPISTI KARL MARKS DHE PRAKTIKJA ROZA LUKSEMBURG

Duke e shpallur «utopi» pavarësinë e Polonisë dhe duke e përsëritur këtë deri në neveri, Roza Luksemburgu pyet me ironi: pse të mos paraqesim kërkesën për pavarësinë e Irlandës?

Siç duket, «praktikja» Roza Luksemburg nuk e di së cili ishte qëndrimi i K. Marksit në çështjen e pavarësisë së Irlandës. E vlen të ndalemi pak këtu që të tregojmë analizën e një kërkesë konkrete për

pavarësi kombëtare nga një pikëpamje me të vërtetë marksiste e jo oportuniste.

Marksit e kishte zakon t'u «provonte dhëmbët», siç thoshte ai, socialistëve që njihë, për të parë ndërgjegjen dhe forcën e bindjes së tyre. Pasi njohu Lopatini, Marksit i shkruan Engelsit më 5 korrik 1870 se e çmonte shumë socialistin e ri rus, por shton:

...«Një pikë e dobët: *Polonia*. Për këtë çështje Lopatini flet krejt si një anglez — të themi si një çartist anglez i shkollës së vjetër — për Irlandën»¹⁹.

Socialistin e një kombi shtypës Marksit e pyet për qëndrimin e tij ndaj kombit të shtypur dhe zbulon menjëherë të metën që kanë të gjithë socialistët e kombeve sunduese (anglez dhe rus): moskuptimin e detyrave të tyre socialiste ndaj kombeve të shtypura, përsëritjen e paragjyqimeve të trashëguara nga borgjezia e «fuqisë së madhe».

Para se të kallojmë në deklaratat pozitive të Marksit për Irlandën, duhet të themi se Marksit dhe Engelsi e shikonin me sy shumë kritik çështjen kombëtare në përgjithësi dhe e vlerësonin rëndësinë e saj sipas kushteve historike. Kështu, më 23 maj 1851, Engelsi i shkruante Marksit se studimi i historisë e shpinte atë në përfundime pesimiste rreth Polonisë, se rëndësia e Polonisë ishte e përkohshme, deri në revolucionin agrar në Rusi. Roli i polonezëve në histori është që të bëjnë «trimëri të marra». «S'mund të supozohet as për një çast që Polonia, goftë edhe vetëm kundrejt Rusisë, të mund të përfaqësojë përparimin ose të ketë një rëndësi historike çfarëdo». Në Rusi ka më shumë elemente qytetërimi, kulture, industrie, borgjezie sesa në «Poloninë e fjetur aristokrate». «Ç'janë Varshava e Krakovi përpara Peterburgut, Moskës, Odesës!»²⁰. Engelsi nuk beson në suksesin e kryengritjeve të aristokratëve polonezë.

Por të gjitha këto mendime, kaq gjeniale dhe të holla, nuk i penguan aspak Engelsin dhe Marksit që 12 vjet më vonë, kur Rusia ndodhej ende në gjumë

dhe Polonia ziente, ta shikonin me simpati më të thellë dhe më të madhe lëvizjen poloneze.

Më 1864, kur përpilonte «Manifestin» e Internacionales, Marksi i shkruan Engelsit (4 nëntor 1864) se duhej luftuar nacionalizmi i Maxinit. «Kur në «Manifestin» bëhet fjalë për politikën ndërkombëtare, unë flas për vendet e jo për kombësitë dhe denoncoj Rusinë e jo fuqitë e dorës së dytë» — shkruan Marksi. Në krahasim me «çështjen punëtore» për Marksian është e padiskutueshme se çështja kombëtare ka rëndësi të dorës së dytë. Por teoria e tij është aq larg mohimit të lëvizjes kombëtare sa qielli nga toka.

Vjen viti 1866. Marksi i shkruan Engelsit për «kllikën prudoniste» në Paris, e cila i «quan kombësitë një absurditet dhe sulmon Bismarkun e Garibaldin. Si polemikë kundër shovinizmit, kjo taktikë është e dobishme dhe mund të shpjegohet. Po kur ata që i besojnë Prudonit (ndër të cilët janë edhe miqtë e mi të mirë këtu, Lafarg dhe Longe) janë të mendimit se tërë Evropa mund dhe duhet të rrijë e të presë pa bërë zë derisa zotërinjtë në Francë të zhdukin padijen dhe mjerimin... atëherë bëhen qesharakë» (letër e 7 qershorit 1866).

«Dje — shkruan Marksi më 20 qershor 1866 — në Këshillin e Internacionales u zhvilluan diskutime rreth luftës së tanishme... Diskutimet u vërtitën siç duhej pritur, rreth çështjes së «kombësive» në përgjithësi dhe qëndrimit tonë ndaj saj... Përfaqësuesit (jopunëtorë) të «Francës së re» shprehnin pikëpamjen se çdo kombësi dhe vetë kombi janë paragykime të vjetruara». Shtirmerizëm prudonist... e gjithë bota duhet të presë derisa francezët të pihen për të bërë revolucionin shoqëror... Anglezët ia shkrepën gazit me të madhe kur unë e fillova diskutimin tim duke thënë se miku ynë Lafarg e të tjerë, që u shprehën për hegjen e kombësive, na flasin «frëngjisht», domethënë në një gjuhë të pakuptueshme për 9/10 e mbledhjes. Më poshtë unë e hodha fjalën tërthorazi që

Lafargu pa e kuptuar as vetë, me mohim të kombësive duket se kupton asimilimin e tyre nga kombi shembullor francez»²¹.

Konkluzioni që del nga të gjitha këto vërejtje kritike të Marksit është i qartë: klasa punëtore është ajo që më pak se kushdo tjetër mund ta kthejë gësh-tjen kombëtare në një fetish, sepse zhvillimi i kapitalizmit nuk i zgjon medoemos të gjitha kombet për një jetë të pavarur. Por të mos i përfillësh lëvizjet kombëtare të masave meqë ato kanë filluar, të mos pranosh të përkrahësh atë që është përparimtare në to — do të thotë t'u nënshtrohesh paragjykimëve *nacionaliste*, dhe pikërisht: ta quash kombin «tënd» «komb shembullor» (ose, do të shtojmë nga ana jonë, si kombin që ka privilegjin «ekskluziv të ndërtimit të shtetit»*).

Po le të kthehemi te çështja e Irlandës.

Qëndrimi i Marksit në këtë çështje është shprehur me qartësinë më të madhe në këto fragmente, të nxjerrra nga letrat e tij:

«Unë bëra çmos që të shpërthente një manifestim i punëtorëve anglezë në dobi të fenianizmit... Më parë mendoja se shkëputja e Irlandës nga Anglia ishte e pamundur. Tani e quaj të pashmangshme, edhe sikur pas shkëputjes të arrihet në federatë». Kështu shkruante Marksi në një letër që i dërgoi Engelsit më 2 nëntor 1867.

Në një letër, shkruar më 30 nëntor po të atij viti, ai shtonte:

«Çfarë duhet t'u këshillojmë ne punëtorëve *anglezë*? Sipas mendimit tim, ata duhet të shënojnë në

* Krahasoni edhe letrën që Marksi i dërgoi Engelsit më 3 qershor 1867... «Me kënaqësi të vërtetë nga korrespondenca që «Tajmsi» botoi nga Parisi mësova për brohoritjet polonofile të parizianëve kundër Ruisë... Z. Prudon dhe klika e tij e vogël prej doktrinarësh nuk janë populli francez»²².

programin e tyre si një pikë të veçantë *heqjen e unionit*» (të Irlandës me Anglinë, domethënë shkëputjen e Irlandës nga Anglia) — «me pak fjalë, kërkesën e vitit 1783, vetëm se të demokratizuar dhe të përshtatur pas kushteve të sotme. Kjo është e vetmja formë *legale* e çlirimit të Irlandës dhe prandaj e vetmja formë e mundshme për t'u pranuar në programin e partisë *angleze*. Përvoja e mëvonshme ka për të treguar nëse mund të ekzistojë për një kohë të gjatë unioni i thjeshtë personal midis të dyja këtyre vendeve...

Për irlandezët është e domosdoshme sa vijon:

1. Vetëqeverisja dhe pavarësia nga Anglia.

2. Revolucioni agrar»...

Duke i dhënë një rëndësi shumë të madhe çështjes irlandeze. Marksi mbante në bashkimin e punëtorëve gjermanë për këtë temë konferenca që zgjasnin një orë e gjysmë (letër e 17 dhjetorit 1867).

Në një letër të 20 nëntorit 1868 Engelsi vë në dukje «urrejtjen që kanë punëtorët anglezë për irlandezët»; dhe pothuaj një vit më vonë (24 tetor 1869), duke u kthyer te kjo çështje, ai shkruan:

«Nga Irlanda në Rusi il n'y a qu'un pas (s'ka veçse një hap)... Shembulli i historisë së Irlandës na tregon se ç'fatkeqësi është për një popull robërimi i një populli tjetër. Të gjitha poshtërsitë angleze e kanë prejardhjen në sferën irlandeze. Unë duhet ta studioj ende epokën e Kromuellit, por, sidoqoftë, për mua s'ka dyshim se edhe në Angli punët do të kishin marrë një rrugë tjetër, po të mos kishte qenë nevoja e sundimit ushtarak në Irlandë dhe e krijimit të një aristokracie të re».

Le të përmendim kalimthi letrën që Marksi i dërgoi Engelsit më 18 gusht 1869:

«Në Poznan punëtorët polonezë bënë një grevë që fitoi në saje të ndihmës së shokëve të tyre berlinezë. Kjo luftë kundër «Zotit Kapital» — edhe në formën e saj më të ulët, në formën e grevës — do t'u japë fund paragjyqimeve kombëtare më seriozisht sesa fjalët

e bukura për paqe që dalin nga goja e zotërinjve bor-
gjezë»²³.

Politika e ndjekur prej Marksit në gjirin e Inter-
nacionales për çështjen irlandeze shihet nga sa vijon:

Më 18 nëntor 1869 Marksit i shkruan Engelsit se
kishte mbajtur një fjalim prej një ore e një çerek në
Këshillin e Internacionales për qëndrimin e qeverisë
britanike në çështjen e amnistisë për irlandezët, dhe
se kishte propozuar këtë rezolucion:

«U vendos,

se në përgjigjen që u jep kërkesave irlandeze për të
liruar patriotët irlandezë, z. Gladston fyen me qëllim
kombin irlandez;

se ai e lidh amnistinë politike me kushte që janë
njëlloj poshtëruese si për viktimat e një qeverie të ke-
qe, ashtu dhe për popullin që ato përfaqësojnë;

se Gladstoni, megjithëse i lidhur nga pozita e tij
zyrtare, ka përshëndetur publikisht dhe solemnisht
kryengritjen e skllavopronarëve amerikanë, kurse tani
kërkon t'i predikojë popullit irlandez doktrinën e nën-
shtrimit pasiv;

se e tërë politika e tij kundrejt amnistisë për ir-
landezët është shprehja më e qartë e asaj «politike
pushtimesh», me demaskimin e së cilës z. Gladston
rrëzoi qeverinë e kundërshtarëve të tij tori;

se Këshilli i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare
të Punëtorëve shpreh admirimin e tij për guxi-
min, vendosmërinë dhe fisnikërinë me të cilat populli
irlandez zhvillon fushatën për amnisti;

se ky rezolucion duhet t'u njoftohet të gjitha sek-
sioneve të Shoqatës Ndërkombëtare të Punëtorëve dhe
të gjitha organizatave punëtore të Evropës dhe të
Amerikës, që janë të lidhura me të»²⁴.

Më 10 dhjetor 1869 Marksit shkruan se raporti i
tij për çështjen irlandeze në Këshillin e Internacio-
nales do të përpilohet si vijon:

...«në mënyrë krejt të pavarur nga çfarëdo frazë
«internacionale» dhe «humanitare» për «drejtësi ndaj

Irlandës» — sepse kjo gjë kuptohet vetvetiu në *Këshillin e Internacionales* — *interesi absolut i drejtpërdrejtë i klasës punëtore angleze kërkon prerjen e lidhjeve të saj të tanishme me Irlandën.* Kjo është bindja ime më e thellë e mbështetur në arsye, të cilat në pjesërisht nuk mund t'ua dëftej vetë punëtorëve anglezë. Për një kohë të gjatë kisha menduar se regjimi irlandez mund të përmysej me ngritjen e klasës punëtore angleze. Këtë mendim unë e kam mbrojtur gjithnjë në «Nju-Jork Tribune» (gazetë amerikane, ku Marksi ka bashkëpunuar për një kohë të gjatë). Një studim më i thellë i çështjes tani më ka bindur për të kundërtën. Klasa punëtore angleze *s'bën dot asgjë* gjersa të mos ketë shpëtuar nga Irlanda... reaksioni anglez në Angli (sikurse edhe në kohën e Kromuellit) i kishte rrënjët në skllavërimin e Irlandës» (kursivi është i Marksit)²⁵.

Tani politika e Marksit në çështjen irlandeze duhet të jetë plotësisht e qartë për lexuesit.

«Utopisti» Marks është aq «jopraktik», saqë shprehet për shkëputjen e Irlandës, e cila nuk është realizuar ende as pas gjysmë shekulli.

Nga rridhte, pra, kjo politikë e Marksit dhe a mos ishte e gabuar?

Në fillim Marksi kishte menduar se Irlanda nuk do të çlirohej nga lëvizja kombëtare e kombit të shtypur, por nga lëvizja punëtore në gjirin e kombit shtypës. Për Marksit lëvizjet kombëtare nuk janë diçka absolute, pasi e di se vetëm fitorja e klasës punëtore mund t'i çlirojë plotësisht të gjitha kombësitë. Është e pamundur të parashikosh të gjitha raportet e mundshme ndërmjet lëvizjeve çlirimtare borgjeze të kombeve të shtypura dhe lëvizjeve çlirimtare proletare të kombit shtypës (dhe pikërisht ky problem e bën aq të vështirë çështjen kombëtare në Rusinë e sotme).

Por rrethanat e kanë bërë klasën punëtore angleze të bjerë për një kohë mjaft të gjatë nën ndiki-

min e liberalëve, të zvarritet pas qerres së tyre dhe të trulloset nga politika punëtore liberale. Lëvizja çlirimtare borgjeze në Irlandë forcohet dhe merr forma revolucionare. Marksi e rishikon pikëpamjen e tij dhe e ndreq atë. «Është fatkeqësi për një popull robërimi i një populli tjetër». Klasa punëtore e Anglisë nuk do të çlirohet derisa të mos jetë çliruar Irlanda nga zgjedha angleze. Robërimi i Irlandës e forcon dhe e ushqen reaksionin në Angli (ashtu sikundër robërimi i një vargu kombesh ushqen reaksionin në Rusi!).

Dhe Marksi, duke bërë që Internacionalja të votojë një rezolucion që shpreh simpatinë ndaj «kombit irlandez», ndaj «popullit irlandez» (mendjeholli L. VI. sigurisht do ta kishte bërë për pesë para Marksit e gjorë për harrimin e luftës së klasave!), predikon *shkëputjen* e Irlandës nga Anglia «edhe sikur pas shkëputjes të arrihet në federatë».

Cilat janë premisat teorike të këtij konkluzioni të Marksit? Në përgjithësi, revolucioni borgjez në Angli ka marrë fund prej kohësh. Por në Irlandë ai s'ka marrë fund; atij po i japin fund vetëm sot, pas gjysmë shekulli, reformat e liberalëve anglezë. Po të ishte përmbysur kapitalizmi në Angli aq shpejt sa ç'e kishte shpresuar Marksi në fillim, atëherë në Irlandë nuk do të kishte vend për një lëvizje demokratike borgjeze, kombëtare. Por përderisa kjo lëvizje lindi, Marksi i këshillon punëtorët anglezë ta përkrahin atë, t'i japin një shtytje revolucionare dhe ta shpien deri në fund në interes të lirisë së tyre.

Marrëdhëniet ekonomike të Irlandës me Anglinë rreth vjetëve 1860-1870 ishin, sigurisht, më të ngushta se ato të Rusisë me Poloninë, Ukrainën etj. Karakteri «jopraktik» dhe «i perealizueshëm» i shkëputjes së Irlandës (qoftë edhe për shkak të kushteve gjeografike, si edhe të fuqisë koloniale shumë të madhe të Anglisë) dukej fare qartë. Duke qenë në parim armik i federalizmit, Marksi pranon në këtë rast edhe fede-

ratën*, *vetëm e vetëm* që çlirimi i Irlandës të bëhet me rrugë revolucionare e jo reformiste, në saje të lëvizjes së masave popullore të Irlandës, të përkrahura nga klasa punëtore e Anglisë. S'ka dyshim se vetëm një zgjidhje e tillë e kësaj detyre historike do të ishte më e favorshme për interesat e proletariatit dhe do ta shpejtonte zhvillimin shoqëror.

Por doji ndryshe. Si populli irlandez, ashtu edhe proletariati anglez qenë të dobët. Vetëm tani, me pazarllëqet e vajtueshme të liberalëve anglezë me borgjezinë irlandeze, *po zgjidhet* (shembulli i Olsferit tregon se me sa vështirësi) çështja irlandeze me një reformë agrare (me shpërblim) dhe me një vetëqeverisje (të përealizuar ende). Ç'do të thotë kjo? A del nga kjo se Marksi dhe Engelsi kanë qenë «utopistë», sepse shtronin kërkesa kombëtare «të përealizueshme», se ishin ndikuar nga nacionalistët mikroborgjezë të Irlandës (karakterit mikroborgjez i lëvizjes së «fenive» nuk mund të vihet në dyshim) etj?

Jo. Edhe në çështjen irlandeze Marksi dhe En-

* Duhet thënë se nuk është zor të shihet se pse me të drejtën e kombeve për «vetëvendosje» s'mund të kuptohet, nga pikëpamja socialdemokrate, as federata as vetëqeverisja (megjithëse, po ta marrim në mënyrë abstrakte, si njëra ashtu dhe tjetra hyjnë në nocionin e «vetëvendosjes»). E drejta për federatë është në përgjithësi një absurditet, sepse federata është një kontratë e dyanshme. Marksistët s'mund të futin kurrsesi në programin e tyre mbrojtjen e federalizmit në përgjithësi, për këtë është e kotë edhe të flitet. Sa për vetëqeverisjen, marksistët nuk mbrojnë «të drejtën për» vetëqeverisje, por vetë vetëqeverisjen, si një parim i përgjithshëm, universal, i një shteti demokratik me kombësi të ndryshme, me ndryshime të theksuara të kushteve gjeografike e të tjera. Prandaj njohja e «së drejtës së kombeve për vetëvendosje» do të ishte aq pa kuptim, sa edhe njohja e «së drejtës së kombeve për federatë».

gelsi kanë bërë një politikë proletare konsekuente, që i edukonte me të vërtetë masat në frymën e demokrazizmit dhe të socializmit. Vetëm kjo politikë mund ta shpëtonte si Irlandën, ashtu edhe Anglinë nga të zgjaturit për një gjysmë shekulli të reformave të domosdoshme, si edhe nga shtrembërimi i tyre prej liberalëve në dobi të reaksionit.

Politika e Marksit dhe e Engelsit në çështjen irlandeze ka dhënë shembullin më të madh që ka edhe sot një rëndësi *praktike* të pashoqe për mënyrën se si duhet të silllet proletariati i kombeve shtypëse kundrejt lëvizjeve kombëtare, — ka dhënë paralajmërimin kundër «zellit servil», me të cilin mikroborgjezët e të gjitha vendeve, të të gjitha ngjyrave dhe të gjitha gjuhëve shpejtojnë ta cilësojnë si «utopik» çdo ndryshim të kufijve të shteteve që janë krijuar me forcë dhe me privilegjet e çifligarëve të mëdhenj dhe të borgjezisë së një kombi.

Sikur proletariati i Irlandës dhe i Anglisë të mos kishin pranuar politikën e Marksit, të mos e kishin bërë parullë të vetën shpëputjen e Irlandës, kjo do të kishte qenë oportunizmi më i keq i tyre, do të kishte qenë harresë e detyrave të demokrazit dhe të socialistit, do të kishte qenë një lëshim ndaj reaksionit dhe borgjezisë *angleze*.

9. PROGRAMI I VITIT 1903 DHE LIKUIDATORËT E TIJ

Procesverbalet e kongresit të vitit 1903, që adoptoi programin e marksistëve të Ruisë, janë bërë tani një gjë shumë e rrallë dhe shumica e madhe e militantëve të tanishëm të lëvizjes punëtore nuk i dinë motivacionet e pikave të ndryshme të këtij programi (aq më tepër se shumë nga këto shkrime nuk gëzojnë

të mirat e legalitetit. . .). Prandaj është e domosdoshme të shqyrtojmë se si u trajtua kjo çështje që na intereson në kongresin e vitit 1903.

Pikësëpari le të vëmë në dukje se nga letërsia socialdemokrate ruse mbi «të drejtën e kombeve për vetëvendosje», megjithëse e varfër, shihet fare qartë se kjo e drejtë është kuptuar gjithmonë si e drejtë për shkëputje. Zotërinjtë Semkovskë, Libmanë dhe Jurkeviçë, që e vënë në dyshim këtë dhe thonë se paragrafi 9 «nuk është i qartë» etj., flasin për këtë «mungesë qartësie» vetëm nga padija e tyre e jashtëzakonshme ose nga mendjehetësia. Qysh më 1902, duke mbrojtur «të drejtën e vetëvendosjes» në projektprogramin, Plehanovi shkruante në «Zarja» se kjo kërkesë, që nuk është e detyrueshme për demokratët borjëzë, «është e detyrueshme për socialdemokratët». «Po ta harronim ose po të mos vendosnim ta shtronim atë, — shkruante Plehanovi, — nga frika se mos cenonim paragjykimet kombëtare të bashkatdhetarëve tanë të fisit rus, atëherë thirrja...: «proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!» do të ishte një gënjeshtër e turpshme në gojën tonë».

Kjo është një karakteristikë shumë e hollë e argumentit kryesor në favor të pikës që po shqyrtojmë; ajo është aq e hollë, saqë kritikuesit e programit tonë «që harrojnë farefisnin e tyre» e kanë lënë dhe e lënë me frikë mënjanë, dhe jo pa arsye. Mospranimi i kësaj pike, me çfarëdo arsyesh që të mundohen ta përlligjin, është në të vërtetë një lëshim «i turpshëm» që i bëhet nacionalizmit rusomadh. Pse rusomadh, kur bëhet fjalë për të drejtën e të gjitha kombeve për vetëvendosje? Sepse është fjala për shkëputjen nga rusët. Interesi i bashkimit të proletarëve, interesi i solidarësisë së tyre klasore kërkojnë njohjen e së drejtës së kombeve për shkëputje — ja ç'pranonte Plehanovi 12 vjet më parë me fjalët që përmendëm. Sikur oportunistët tanë ta kishin menduar mirë këtë, ata me siguri nuk do të thoshin aq gjepura për vetëvendosjen.

Në kongresin e vitit 1903, ku u miratua ky projektprogram që u përkrah nga Plehanovi, puna kryesore që përqendruar në *komisionin e programit*. Për fat të keq, aty nuk janë mbajtur procesverbale. Dhe pikërisht në këtë pikë do të kishin qenë shumë interesante procesverbale, sepse *vetëm* në komision përfaqësuesit e socialdemokratëve polonezë, Varshavski dhe Hanecki, u përpoqën të mbronin konceptin e tyre dhe të kundërshtonin «njohjen e së drejtës për vetëvendosje». Lexuesi që do të dëshironte të krahasonte argumentet e tyre (të parashtruara në fjalimin e Varshavskit, si edhe në deklaratën që ai kishte bërë me Haneckin, ff. 134-136 e 388-390 e procesverbaleve) me ato të Roza Luksemburgut në artikullin e saj polonisht, që analizuam, do të shihte se këto argumente janë krejt të njëllojta.

Po cili ishte qëndrimi ndaj këtyre argumenteve i komisionit të programit të Kongresit II, ku sidomos Plehanovi u ngrit kundër marksistëve polonezë? Me këto argumente u tallën keq! Absurditeti i propozimit që u bëhej marksistëve rusë për ta hequr njohjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje ishte aq i qartë dhe i dukshëm, sa që marksistët polonezë *nuk guxuan as t'i përsëritnin argumentet e tyre në mbledhjen plenare të kongresit!!* Ata ikën nga kongresi, të bindur se pozita e tyre në instancën më të lartë të marksistëve, si rusë, çifutë, gjeorgjianë dhe armenë ishte e pashpresë.

Kuptohet vetiu se ky episod historik ka një rëndësi shumë të madhe për cilindo që interesohet seriozisht për programin e *vet*. Dërrmimi i plotë i argumenteve të marksistëve polonezë në komisionin e programit të kongresit, heqja dorë nga çdo orvatje për të mbrojtur pikëpamjet e tyre në seancën e kongresit, është jashtëzakonisht kuptimplot. Roza Luksemburgu kishte arsye ta linte «me modesti» në heshtje këtë fakt në artikullin e saj të vitit 1908: siç duket, kujtimi i kongresit ishte shumë i papëlqyer për të! Ajo la në

heshtje edhe propozimin, që dështoi dhe u bë qesharak, «për të ndryshuar» paragrafin 9 të programit, që bënë më 1903 Varshavski dhe Hanecki në emër të gjithë marksistëve polonezë dhe që nuk guxuan (e nuk do të guxojnë) ta përsëritin as Roza Luksemburgu, as socialdemokratë të tjerë polonezë.

Por nëse Roza Luksemburgu, për të mbuluar disfatën e saj të vitit 1903, i la në heshtje këto fakte, ata që interesohen për historinë e partisë së tyre do të kujdesen t'i njohin ato dhe të studiojnë rëndësinë e tyre.

...«Ne propozojmë — i shkruanin kongresit të vitit 1903 miqtë e Roza Luksemburgut, duke u larguar nga ai, — që të formulohet si vijon paragrafi i shtatë (tani i nënti) i projektprogramit: Parag. 7. *Institucione që garantojnë lirinë e plotë të zhvillimit kulturor për të gjitha kombet që bëjnë pjesë në shtet*» (f. 390 e procesverbaleve).

Kështu, pra, marksistët polonezë mbronin atëherë pikëpamje aq të papërcaktuara për çështjen kombëtare, sa që në vend të vetëvendosjes propozonin në thelb të famshmen «autonomi kombëtaro-kulturor», por nën një emër tjetër!

Kjo duket gati e pabesueshme, por mjerisht është fakt. Në vetë kongresin, megjithëse ndodheshin 5 bundistë që kishin 5 vota dhe 3 kaukazianë që kishin 6 vota, pa llogaritur një votë konsultative, atë të Kostrovit, nuk pati asnjë votë për heqjen e pikës mbi vetëvendosjen. Për t'i shtuar kësaj pike fjalët «autonomi kombëtaro-kulturor» pati tri vota (për formulën e Goldblatit: «të krijohen institucione që u garantojnë kombeve lirinë e plotë për zhvillimin kulturor») dhe katër vota për formulën e Läberit («të drejtë lirie për zhvillimin kulturor të tyre — të kombeve»).

Tani që ka dalë një parti liberale ruse, partia e kadetëve, ne e dimë se në programin e saj vetëvendosja politike e kombeve është zëvendësuar me «vetëven-

dosjen kulturore». Kështu që miqtë polonezë të Roza Luksemburgut, që «luftonin» kundër nacionalizmit të PPS-së, patën aq sukses, saqë propozuan të zëvendësohej programi marksist me një program *liberal!* E megjithëkëtë ata e akuzonin programin tonë për oportunizëm. Nuk është për t'u çuditur që në komisionin e programit të Kongresit II kjo akuzë u prit vetëm me të qeshura!

Si e kishin kuptuar «vetëvendosjen» delegatët e Kongresit II, nga të cilët, siç e pamë, asnjë nuk u shfaq kundër «vetëvendosjes së kombeve»?

Këtë na e thonë këto tri pjesë të nxjerra nga procesverbalet:

«*Martinovi* thotë se fjalës «vetëvendosje» s'mund t'i jepet një kuptim i gjerë; ajo shpreh vetëm të drejtën e kombeve që të formojnë një tërësi politike më vete dhe aspak një vetëqeverisje krahinore» (f. 171). *Martinovi* ishte anëtar i komisionit të programit, ku u hodhën poshtë dhe u bënë objekt talljesh argumentet e miqve të Roza Luksemburgut. Nga pikëpamjet e tij *Martinovi* ishte në atë kohë ekonomist, kundërshtar i tërbuar i «*Iskrës*», dhe sikur të kishte shfaqur ndonjë mendim të ndryshëm nga ai i shumicës së komisionit të programit, sigurisht do t'ia kishin hedhur poshtë.

Bundisti *Goldblat* mori fjalën i pari kur, pas punimeve të komisionit, kongresi kaloi në shqyrtimin e paragrafit 8 (tani 9) të programit.

«Kundër «së drejtës për vetëvendosje» — tha *Goldblati*, — s'mund të bëhet asnjë vërejtje. Në qoftë se ndonjë komb lufton për pavarësinë e vet, kjo nuk mund të kundërshtohet. Në qoftë se Polonia nuk dëshiron të bëjë një martesë të ligjshme me Rusinë, ajo nuk duhet penguar, siç u shpreh shoku *Plehanov*. Brenda këtyre kufijve, unë pajtohem me këtë pikëpamje» (ff. 175-176).

Plehanovi nuk foli fare për këtë çështje në sean-

cën plenare të kongresit. Goldblati përmend fjalët e Plehanovit në komisionin e programit, ku «e drejta e vetëvendosjes» u shpjegua gjerësisht e qartë si e drejtë për shkëputje. Liberi, që foli pas Goldblatit, vuri në dukje:

«Sigurisht, në qoftë se ndonjë kombësi nuk mund të rrojë brenda kufijve të Rusisë, partia nuk do ta pengojë» (f. 176).

Lexuesi e sheh se në Kongresin II të partisë, që pranoi programin, të gjithë qenë të një mendimi se vetëvendosje do të thotë «vetëm e vetëm» e drejtë për shkëputje. Edhe bundistët vetë e kishin kuptuar atëherë këtë të vërtetë, e vetëm në epokën tonë të vajtueshme të kundërrivolucionit që po vazhdon dhe të «mohimeve» të çdo lloji u gjetën njerëz që, guximtarë nga padija e tyre, thonë se programi «nuk është i qartë». Por para se të merremi me këta «gjithashtu socialdemokratë» të vajtueshëm, le të mbarojmë me qëndrimin e polonezëve kundrejt programit.

Ata erdhën në Kongresin e dytë (1903) duke deklaruar se bashkimi ishte i domosdoshëm dhe i ngutshëm. Por pas «dështimit» të tyre në komisionin e programit ata u larguan nga kongresi, dhe *fjala* e tyre e *fundit* qe një deklaratë e shkruar, e botuar në procesverbalet e kongresit, që përmbante propozimin e përmendur më lart, për ta *zëvendësuar* vetëvendosjen me autonominë kombëtareo-kulturore.

Më 1906 marksistët polonezë hynë në parti; por as në çastin e hyrjes as më vonë (as në kongresin e 1907-s, as në konferencat e vjetëve 1907 e 1908, as në mbledhjen plenare të 1910-s) ata *nuk bënë asnjëherë* asnjë propozim për ta ndryshuar paragrafin 9 të programit rus!!

Ky është fakt.

Dhe ky fakt tregon qartë, në kundërshtim me frazat dhe sigurimet, se miqtë e Roza Luksemburgut e quanin të përfunduar çështjen me debatet që u bënë

në komisionin e programit gjatë Kongresit II dhe me vendimin që mori kongresi, se ata e kishin pranuar në heshtje gabimin e tyre dhe e kishin ndrequr atë, duke hyrë më 1906 në parti, pasi ishin larguar nga kongresi më 1903, pa u mundur kurrë të shtrojnë në parti çështjen e rishikimit të paragrafit 9 të programit.

Artikulli i Roza Luksemburgut doli me nënshkrimin e saj më 1908 — natyrisht, askujt s'i shkoi ndër mend që t'ua mohonte publicistëve të partisë të drejtën për të kritikuar programin — dhe pas këtij artikulli asnjë institucion zyrtar i marksistëve polonezë nuk e ka ngritur çështjen e rishikimit të paragrafit 9.

Prandaj Trocki u bën me të vërtetë një shërbim të keq disa admiruesve të Roza Luksemburgut kur shkruan në emër të redaksisë së «Borbës» Nr. 2 (mars 1914):

...«Marksistët polonezë janë të mendimit se «e drejta për vetëvendosje kombëtare» nuk ka asnjë përmbajtje politike dhe duhet hequr nga programi» (f. 25).

Bamirësi Trocki është më i rrezikshëm se një armik! Ky s'ka mundur të gjejë gjëkund, veçse në «bashkëfjalimë private» (domethënë vetëm në thasetheme, me të cilat rron gjithmonë Trocki), argumente për të provuar se «marksistët polonezë» janë përgjithësisht përkrahës të çdo artikulli të Roza Luksemburgut. Trocki i paraqet «marksistët polonezë» si njerëz pa nder e pa ndërgjegje, që nuk dinë të respektojnë as bindjet e tyre as programin e partisë së tyre. Bamirësi Trocki!

Kur më 1903 përfaqësuesit e marksistëve polonezë u larguan nga Kongresi II për shkak të mosmarrëveshjes mbi të drejtën e vetëvendosjes, atëherë Trocki mund të thoshte se ata e quanin këtë të drejtë pa kurrfarë përmbajtjeje dhe mendonin se duhej hequr nga programi.

Por pastaj marksistët polonezë hynë në partinë

që kishte këtë program, dhe kurrë nuk propozuan që ai të rishikohej*.

Pse ua fshehu Trocki këto fakte lexuesve të revistët së tij? Vetëm sepse atij i intereson që të spekulojë mbi ashpërsimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet kundërshtarëve polonezë e rusë të likuidatorizmit dhe të gënjejë punëtorët rusë për çështjen e programit.

Kurrë ndonjëherë, për asnjë çështje serioze të marksizmit, Trocki s'ka pasur një mendim të prerë, ai «është futur» gjithmonë «nëpër të çarat» e kësaj ose asaj mosmarrëveshjeje dhe ka kaluar nga një kamp në tjetrin. Tani ai është me bundistët dhe me likuidatorët. Dhe këta zotërinj nuk pyesin shumë për partinë.

Ja ç'thotë bundisti Libman:

«Kur socialdemokracia ruse» — shkruan ky xhentëlmen — «vuri para 15 vjetëve në programin e saj një paragraf për të drejtën e çdo kombësie për «vetëvendosje», secili (!!) tha me vete: ç'do të thotë në të vërtetë kjo shprehje e modës (!!)? Asnjë përgjigje nuk u dha (!!). Kjo fjalë mbeti (!!) e mbuluar me mjegull. Në të vërtetë ishte vështirë në atë kohë ta shpërndaje këtë mjegull. Atëherë thoshin: s'ka ardhur ende koha për ta konkretizuar këtë pikë, tani ajo le të rrijë e mbuluar me mjegull (!!), vetë jeta do të na mësojë se ç'përmbajtje i duhet dhënë kësaj pike».

A nuk është i mrekullueshëm ky «fëmijë ende në pelena»²⁶, që tallet me programin e partisë?

* Na njoftojnë se në konferencën e marksistëve rusë në verë 1913 marksistët polonezë merrnin pjesë *vetëm* me votë konsultative dhe se ata nuk votuan fare për çështjen e së drejtës për vetëvendosje (për shkëputje), duke u shprehur kundër kësaj së drejte në përgjithësi. Nënkuptohej se ata gëzonin plotësisht të drejtën të vepronin kështu dhe si më parë të bënin agjitacion në Poloni kundër shkëputjes së saj. Por kjo s'është pikërisht ajo që thotë Trocki, sepse marksistët polonezë nuk kanë kërkuar «të hiqet nga programi» paragrafi 9.

E pse tallet?

Tallet sepse është krejt i paditur që s'ka mësuar hiçasgjë, e madje as ka lexuar gjë për historinë e partisë, por ka rënë në një rreth likuidatorësh, ku «është modë» të mos e çash kokën shumë për gështje të partisë dhe të parimeve të partisë.

Te Pomialovski një seminarist mburret se «ka pështyrë në kaden e lakrave». Zotërinjtë bundistë kanë bërë edhe më tepër. Ata nxjerrin xhentëlmenë si Libmanët që të pështyjnë publikisht në kaden e tyre. Ç'u intereson zotërinjve Libmanë se ka pasur një vendim të kongresit ndërkombëtar, se në kongresin e partisë së tyre dy përfaqësues të vetë Bundit u treguan (e pra ishin kritikë «të rreptë» dhe armiq të vendosur të «Iskrës»!) plotësisht të aftë që të kuptonin se ç'do të thotë «vetëvendosje» dhe madje u solidarizuan me të? A nuk do të jetë më lehtë të likuidohet partia, kur «gazetarë të partisë» (pa shaka!) fillojnë të trajtojnë si seminaristë historinë dhe programin e partisë?

Ja një tjetër «fëmijë ende në pelena», z. Jurkeviç i «Dzvinës», Z. Jurkeviç, siç duket, ka pasur në dorë procesverbalet e Kongresit II, sepse përmend fjalët e Plehanovit, të riprodhuara prej Goldblatit, dhe tregon se e di që vetëvendosja mund të ketë vetëm kuptimin e së drejtës për shkëputje. Por kjo nuk e pengon atë që të përhapë në bongjezinë e vogël ukrainase shpifje kundër marksistëve rusë, duke thënë se gjoja këta janë për «integritetin shtetëror» të Rusisë (1913, Nr. 7-8, f. 83 e të tjera). Sigurisht, zotërinjtë Jurkeviçë s'mund të gjenin mjet më të mirë se këtë shpifje për ta larguar demokracinë ukrainase nga demokracia ruse. Dhe kjo shkëputje është baza e tërë vijës politike të grupit të letrarëve të «Dzvinës» që predikojnë *ndarjen* e punëtorëve ukrainas në një organizatë kombëtare të *veçantë!**

* Të shikohet sidomos parathënia e z. Jurkeviç për librin e z. Levinski «Sllicë e zhvillimit të lëvizjes punëtoare ukrainase në Galici», Kiev, 1914, *Red.*

Sigurisht, një grupi mikroborgjezësh nacionalistë, që po përçajné proletariatin, — dhe ky është pikërisht roli objektiv i «Dzvinës» — i ka shumë hije të përhapë një pështjellim të tmerrshëm në çështjen kombëtare. Kuptohet vetiu se Jurkeviçët dhe Libmanët, — që fyhen «pa masë» kur i quajnë elementë «pranë partisë», — s'thanë asnjë fjalë, asnjë fjalëz, për mënyrën se si do të donin *ata* ta zgjidhnin në program çështjen e së drejtës për shkëputje.

Ja edhe «fëmija» i tretë dhe kryesori «ende në pelena», z. Semkovski, i cili në shtyllat e organit të likuidatorëve e «shan» përpara publikut rus paragrafin 9 të programit dhe njëkohësisht deklarom se «për disa arsye nuk është për propozimin» që të hiqet ky paragraf!!

Është e pabesueshme, por është fakt.

Në gusht 1912 konferenca e likuidatorëve shtroi zyrtarisht çështjen kombëtare. Gjatë një viti e gjysmë nuk pati asnjë artikull, përveç artikullit të z. Semkovski, për çështjen e paragrafit 9. Dhe në atë artikull autori i hedh *poshtë* programin, «pa genë, për disa arsye (ndoshta ndonjë sëmundje e fshehtë?)», për propozimin që ai të ndryshohet!! Mund të vëmë bast se do të ishte vështirë të gjenden në tërë botën shembuj të një oportunizmi të tillë, dhe madje më keq se oportunizmi, shembuj të mohimit të partisë, të likuidimit të saj.

Mjafton një shembull për të dhënë një ide për argumentet e Semkovskit:

«Si të bëjmë, — shkruan ai, — po qe se proletariati polonez do të donte të bënte, në kuadrin e një shteti të vetëm, një luftë të përbashkët me tërë proletariatin rus, kurse klasat reaktionare të shoqërisë poloneze do të donin, përkundrazi, ta ndanin Poloninë nga Rusia dhe do të fitonin me një referendum (konsultim i tërë popullsisë) shumicën e votave për shkëputje: a duhet të votonim ne, socialdemokratët rusë, në parlamentin qendror bashkë me shokët tanë polonezë *kun-*

dër shkëputjes, apo duhet, nga frika se mos shkelnim «të drejtën për vetëvendosje», të votonim për shkëputje?» («No-vaja Raboçaja Gazeta», Nr. 71).

Këtu duket se z. Semkovski as që e kupton se *ku qëndron puna!* Atij nuk i ka shkuar ndër mend se e drejta e shkëputjes nënkupton pikërisht që çështja të zgjidhet *jo* nga parlamenti qendror, por vetëm nga parlamenti (nga sejmi, me anë referendumi etj.) i vendit që do të shkëputet.

Me pyetjen fëmijërore, «si të bëjmë», nëse në një regjim demokratik shumica voton për reaksionin, maskohet çështja e politikës së vërtetë, të gjallë, kur *edhe* Purishkeviçët *edhe* Kokoshkinët quajnë krim edhe vetë mendimin për t'u shkëputur! Siç duket, proletarët e tërë Rusisë duhet të luftojnë sot jo kundër Purishkeviçëve dhe Kokoshkinëve, por, duke i lënë mënjanë këta, të luftojnë kundër klasave reaksionare të Polonisë!!

Dhe të tilla gjepura të pabesueshme botohen nga organi i likuidatorëve, një nga drejtuesit ideologjikë të të cilit është z. L. Martov, ai L. Martov që redaktoi projektprogramin dhe e mbrojti më 1903; ai Martov që edhe më vonë ka shkruar në favor të lirisë për shkëputje. Siç duket, L. Martovi arsyeton tani sipas këtij rregulli:

Aty nuk duhen njerëz të zgjuar,
Dërgoni, pra, Readin,
E unë do të mendohem²⁷.

Ai dërgon Read-Semkovskin dhe lejon që në një gazetë të përditshme të shtrembërohet dhe të ngatërrrohet pa masë programi ynë përpara lexuesve të rinj që nuk e dinë atë!

Po, po, rryma e likuidatorizmit ka hyrë thellë, — në shumë ish-socialdemokratë, madje të përmendur, si ka mbetur as gjurma më e vogël e partishmërisë.

Natyrisht, Roza Luksemburgu s'mund të vihet në një radhë me Libmanët, Jurkeviçët dhe Semkovskët; por ngaqë pikërisht njerëz si ata u kapën pas gabimit të saj provon fare qartë se në ç'opportunitizëm ka rënë ajo.

10. KONKLuzion

Le të bëjmë bilancin.

Nga pikëpamja e teorisë së marksizmit në përgjithësi, çështja e së drejtës për vetëvendosje nuk paraqet asnjë vështirësi. S'mund të mendohet seriozisht që të kundërshtohet vendimi i Londrës i 1896-s, as se me fjalën vetëvendosje kuptohet vetëm e drejta për shikëputje dhe se formimi i shteteve kombëtare të pavarura është një tendencë e të gjitha revolucioneve demokratiko-borgjeze.

Deri në njëfarë pike vështirësia lind ngaqë në Rusi luftojnë dhe duhet të luftojnë krah për krah proletariati i kombeve të shtypura dhe proletariati i kombit shtypës. Të mbrohet uniteti i luftës klasore të proletariatit për socializmin, të goditet çdo influencë borgjeze e ultrareaksionare të nacionalizmit — kjo është detyra jonë. Në kombet e shtypura grumbullimi i proletariatit në një parti më vete sjell ngandonjëherë një luftë taq të tërbuar kundër nacionalizmit të kombit përkatës, saqë shtrembërohet perspektiva dhe harrohet nacionalizmi i kombit shtypës.

Por ky shndërrim i perspektivës mund të zgjatë vetëm pak kohë. Përvoja e luftës së përbashkët të proletarëve të kombësive të ndryshme tregon shumë qartë se nuk duhet t'i shtrojmë çështjet politike nga pikëpamja e «Krakovit», por nga një pikëpamje që të përfshijë krejt Rusinë. Por në politikën e përgjithshme

ruse sundojnë Purishkeviçët dhe Kokoshkinët. Idetë e tyre mbretërojnë, përndjekja e tyre ndaj njerëzve të kombësive të tjera që ata i akuzojnë për «separatizëm», se *mendojnë* të shkëputen, predikohet dhe zbatohet në Dumë, në shkollë, në kisha, në kazerma, në qindra e mijëra gazeta. Pikërisht ky helm i nacionalizmit rusomadh helmatis atmosferën politike të tërë Rusisë. Është fatkeqësia e një populli që, duke robëruar popuj të tjerë, forcon reaksionin në tërë Rusinë. Kujtimet e vjetëve 1849 dhe 1863 janë një traditë e gjallë politike që, po të mos vijnë stuhi shumë të mëdha, rrezikon të pengojë edhe për shumë dhjetëra vjet çdo lëvizje demokratike, e sidomos lëvizjen socialdemokrate.

S'ka dyshim se, sado e natyrshme që duket nganjëherë pikëpamja e disa marksistëve të kombeve të shtypura («fatkeqësia» e të cilëve është se masat e popullsisë verbohen nganjëherë nga ideja e çlirimit «të tyre» (kombëtar), në të vërtetë, duke marrë parasysh raportin objektiv të forcave të klasave në Rusi, dorëheqja e tyre nga mbrojtja e së drejtës për vetëvendosje është baras me oportunizmin më të keq, me infektimin e proletariatit me idetë e Kokoshkinëve. Dhe këto ide janë, në thelb, ide dhe politikë e Purishkeviçëve.

Prandaj, në qoftë se në fillim pikëpamja e Roza Luksemburgut mund të përlligjej si një pikëpamje e ngushtë specifike për Poloninë, për «Krakovinë»*, sot, kur nacionalizmi, e sidomos nacionalizmi qeveritar,

* Nuk është zor të kuptohet se pranimi i së drejtës së kombeve për shkëputje nga ana e marksistëve të gjithë Rusisë, e kryesisht nga marksistët rusë, nuk përjashton aspak për marksistët e njërit apo të tjetrit komb të shtypur agjitacionin kundër shkëputjes, ashtu si njohja e së drejtës së shkurorëzimit nuk përjashton në këtë ose atë rast agjitacionin kundër shkurorëzimit. Prandaj mendojmë se do të rritet patjetër numri i marksistëve polonezë që do të tallen me «kontradiktën» e paqenë që po «ngjallin» sot Semkovski e Trocki.

rusomadh, po forcohet kudo, kur ai po drejton politikën, — një ngushtësi e tillë bëhet e pafalshme. Në të vërtetë, pas kësaj politike kapen oportunistët e të gjitha kombeve që nuk pranojnë idenë e «stuhive» dhe të «hopeve», që kujtojnë se revolucioni demokratikoborgjez ka marrë fund dhe shkojnë pas liberalizmit të Kokoshkinëve.

Ashtu si çdo nacionalizëm tjetër, edhe nacionalizmi rusomadh do të kalojë faza të ndryshme, sipas mbizotërimit të kësaj ose asaj klase në vendet borgjeze. Përpara vitit 1905 ne dinim pothuajse vetëm nacional-reaksionarët. Pas revolucionit të ne lindën *nacional-liberalët*.

Në këto pozita qëndrojnë te ne në fakt edhe oktjabristët dhe kadetët (Kokoshkin), domethënë tërë borgjezia e sotme.

Më vonë do të dilnin *patjetër* nacional-demokratë rusë. Një nga themeluesit e partisë «socialiste popullore», z. Pesheonov, e ka shfaqur me kohë këtë pikëpamje, kur këshillonte (në botimin e gushtit 1906 të «Russkoe Bogatstvo») që të tregohet kujdes për paragjykimet nacionaliste të muzhikut. Sado që të shpifin kundër mesh bolshevikëve dhe të na akuzojnë se gjoja e «idealizojmë» muzhikun, por ne kemi bërë dhe do të bëjmë gjithmonë një dallim të prerë midis gjyqimit të muzhikut dhe paragjyqimit të muzhikut, midis demokratizmit të muzhikut që është drejtuar kundër purishkeviçit dhe tendencës së muzhikut që të pajtohet me priftin e çifligarin.

Qysh tani, dhe ka të ngjarë edhe për shumë kohë ende*, demokracia proletare duhet të marrë parasysh

* Do të ishte interesante të ndiqnim se si ndryshon, p.sh., nacionalizmi në Poloni, i cili nga nacionalizëm aristokratësh është bërë nacionalizëm borgjez, e pastaj nacionalizëm fshatar. Në librin e tij «Das polnische Gemeinwesen im preussischen Staat» («Polonezët në Prusi»; është përkthyer rusisht), Ludvig Bernhardi, që vetë mban qëndrimin e një Kokoshki-

nacionalizmin e fshatarëve rusë (jo për t'i bërë atij lëshime, por për ta luftuar). Zgjidhimi i nacionalizmit në kombet e shtypura, që u shfaq me aq forcë pas vitit 1905 (le të përmendim qoftë edhe vetëm grupin e «autonomistëve-federalistë» në Dumën I, hovin e lëvizjes ukrainase, të lëvizjes myslimane etj.), — do të shpjerë patjetër në forcimin e nacionalizmit të borgjezisë së vogël ruse në qytete dhe fshatra. Sa më i ngadalshëm të jetë transformimi demokratik i Rusisë, aq më këmbëngulëse, të egra e mizore do të jenë ndjekjet kombëtare dhe grindjet në borgjezinë e kombeve të ndryshme. Fryma veçanërisht reaksionare e Purishkeviçëve rusë do të ngjallë (dhe do t'i forcojë) aspiratat «separatiste» në këto ose ato kombe të shtypura, të cilat gëzojnë ngandonjëherë një liri shumë më të madhe në shtetet fqinje.

Kjo gjendje i ngarkon proletariatit të Rusisë një barrë të dyfishtë, ose, më mirë, të dyanshme: luftën kundër çdo nacionalizmi, e në radhë të parë kundër nacionalizmit rusomadh; njohjen e barazisë së plotë të të drejtave të të gjitha kombeve në përgjithësi, por edhe të së drejtës së tyre të barabartë për të ngritur një shtet, domethënë njohjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, për shikëputje. Veç kësaj, dhe pikërisht në interes të një lufte me sukses kundër çdo lloj

ni gjerman, përshkruan një dukuri shumë karakteristike: krijimin e njëfarë «republike fshatare» të polonezëve në Gjermani në formën e një bashkimi të ngushtë të gjithfarë kooperativash dhe shoqatash të tjera të fshatarëve polonezë që luftojnë për kombësinë e tyre, për fenë e tyre, për tokën «poloneze». Zgjedha gjermane i ka bashkuar polonezët, i ka veçuar, ka zgjuar në ta më parë nacionalizmin e aristokratëve, pastaj të borgjezisë, e më në fund të masës fshatare sidomos pas fushatës së filluar prej gjermanëve më 1873 kundër përdorimit të gjuhës poloneze në shkollë). Këtë rrugë kanë marrë punët edhe në Rusi dhe jo vetëm për sa i përket Polonisë.

nacionalizmi të të gjitha kombeve, mbrojtjen e unitetit të luftës së proletariatit dhe të organizatave proletare, shkrirjen e tyre sa më të plotë në një bashkësi ndërkombëtare në kundërshtim me tendencat borgjeze për një partikularizëm kombëtar.

Barazi e plotë e të drejtave të kombeve; e drejtë e kombeve për vetëvendosje; shkrirje e punëtorëve të të gjitha kombeve — ky është programi kombëtar që u mëson punëtorëve marksizmi, që u mëson përvoja e tërë botës dhe përvoja e Rusisë.

*Shkruar në shkurt-maj
1914*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 20,
f. 449-521*

PËR KRENARINË KOMBËTARE TË RUSËVE

Sa shumë flasin, diskutojnë dhe çirren sot për kombësinë, për atdheun! Ministrat liberalë dhe radikalë të Anglisë, turma e pambaruar e publicistëve «përparimtarë» të Francës (të cilët u treguan plotësisht të një mendimi me publicistët e reaksionit), kalemxhinjtë e shumë zyrtarë, kadetë e përparimtarë të Rosisë (duke përfshirë edhe disa kalemxhinj narodnikë dhe «marksistë») — të gjithë këta me një mijë mënyra i thurin lavde lirisë dhe pavarësisë së «atdheut», madhësisë së parimit të pavarësisë kombëtare. Nuk mund të dallosh se ku mbaron lëvduesi i shitur i xhelatit Nikollai Romanov ose i vrasësve të zezakëve e të banorëve të Indisë dhe ku fillon mikroborgjezi i zakonshëm, i cili nga marrëzia ose mungesa e karakterit ecën «pas rrymës». Por as që ka rëndësi ta analizojmë këtë. Ne ndodhemi përpara një rryme ideologjike shumë të gjërë dhe shumë të thellë, rrënjët e së cilës janë të lidhura shumë fort me interesat e zotërinjve çifligarë dhe kapitalistë të kombeve sunduese. Për propagandimin e ideve që u leverdisin këtyre klasave shpenzohen dhjetëra dhe qindra milionë në vit: një mulli i madh që merr ujë nga të katër anët, duke filluar që nga shovinisti i bindur Menshikov deri te shovinistët opor-

tunistë ose pa karakter Plehanov e Maslov, Rubanoviç e Smirnov, Kropotkin e Burcevi.

Le të provojmë edhe ne, socialdemokratët rusë, ta përcaktojmë qëndrimin tonë ndaj kësaj rryme ideologjike. Do të ishte diçka e shëmtuar që ne, përfaqësuesit e kombit sundues në lindjen e largët të Evropës dhe të një pjese të mirë të Azisë, të harronim rëndësinë e madhe të çështjes kombëtare; — aq më tepër në një vend të tillë, të cilin me të drejtë e quajmë «burg popujsh»; — në një kohë të tillë, kur pikërisht në lindjen e largme të Evropës dhe në Azi kapitalizmi po zgjon dhe po bën të ndërgjegjshme një varg të tërë kombesh «të reja», të mëdha e të vogla; — në një çast të tillë, kur monarkia cariste ka thirrur nën armë miliona rusë dhe «njerëz të kombësive të tjera» për të «zgjidhur» një sërë çështjes kombëtare në përputhje me interesat e këshillit të fisnikërisë së bashkuar dhe të Guçkovëve me Krestovnikovët, Dolgorukovët, Kutlerët, Rodiçevët.

A është e huaj për ne, proletarët e ndërgjegjshëm rusë, ndjenja e krenarisë kombëtare? Sigurisht, jo! Ne e duam gjuhën tonë dhe atdheun tonë, ne më tepër se për çdo gjë punojmë që t'i ngremë masat e tij punonjëse (d.m.th. 9/10 e popullsisë së tij) në lartësinë e një jete të ndërgjegjshme prej demokratësh dhe socialistësh. Na copëtohet zemra kur shohim dhe ndiejmë se si e shtypin, e mendojnë dhe tallen me atdheun tonë të bukur xhelatët caristë, fisnikët dhe kapitalistët. Ne mburremi me qëndresën që kanë hasur këto dhuna në rrethin tonë, në rrethin e rusëve, që ky rreth nxori Radishevin, dekabristët, raznoçinçët revolucionarë të vjetëve 1870-80, që klasa punëtore ruse krijoi më 1905 partinë e fuqishme revolucionare të masave, që muzhiku rus filloi po në këtë kohë të bëhej demokrat, filloi të përmbyste priftin dhe cifligarin.

Ne e mbajmë mend se si një gjysmë shekulli më parë demokracia rus Çernishevski, i cili ia kushtoi jetën

e vet çështjes së revolucionit, tha: «komb i mjerë, komb skllëvërish, nga i pari te i fundit — të gjithë skllëvër janë»²⁸. Skllëvërve të hapët dhe të mbuluar rusë (skllëvër të monarkisë cariste) nuk u pëlqen t'i kujtojnë këto fjalë. Kurse, sipas mendimit tonë, këto ishin fjalë të një dashurie të vërtetë për atdheun, fjalë që shprehin dhimbje ngaqë masave të popullsisë ruse u mungonte fryma revolucionare. Në atë kohë ajo mungonte. Tani ka pak, por, sidoqoftë, ka. Ne ndiejmë një krenari të madhe kombëtare që edhe kombi rus krijoi një klasë revolucionare, që edhe ai provoi se di t'i japë njerëzimit shembuj të lartë luftime për liri dhe socializëm, dhe jo vetëm pogrome të mëdha, trekëmbështa të panumërt, biruca torturash, uri në masë dhe servilizëm të madh përpara priftërinjve, carëve, çifligarëve e kapitalistëve.

Ne ndiejmë një krenari të madhe kombëtare, dhe pikërisht për këtë arsye e urrejmë në mënyrë të veçantë të kaluarën tonë prej skllavi (kur çifligarët fisnikë çonin muzhikët në luftë për të mbytur lirinë e Hungarisë, Polonisë, Persisë, Kinës) dhe të sotmen tonë prej skllavi, kur po ata çifligarë, të ndihmuar nga kapitalistët, na çojnë në luftë për të mbytur Poloninë e Ukrainën, për të shtypur lëvizjen demokratike në Persi e në Kinë, për ta forcuar bandën e Romanovëve, Bobrinskëve dhe Purishkeviçëve, që poshtëron dignitetin tonë kombëtar rus. Skllavi nuk ka faj që është lindur skllav; por skllavi që jo vetëm nuk përpiqet të fitojë lirinë, por e përligj dhe e lustron skllavërinë e vet (për shembull, robërimin e Polonisë, të Ukrainës etj. e quan «mbrojtje të atdheut» të rusëve), një skllav i tillë është një hipokrit i poshtër që ngjall me plot të drejtë ndjenjën e zemërimit, të përbuzjes e të neverisë.

«Nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë»²⁹, kështu thoshin përfaqësuesit më të mëdhenj të demokracisë konsekuente të shekullit XIX, Marksi dhe Engelsi, që u bënë mësuesit e proletariatit

revolucionar. Dhe ne, punëtorët rusë, të pushtuar nga ndjenja e krenarisë kombëtare, duam me çdo kusht një Rusi të lirë dhe të pavarur, autonome, demokratike, republikane dhe krenare, një Rusi që t'i mbështetë marrëdhëniet e veta me fqinjët mbi parimin njerëzor të barazisë dhe jo mbi parimin bujkrobëror të privilegjeve, që e poshtëron një komb të madh. Përkërisht sepse e duam Rusinë të tillë, ne themi: në shekullin XX në Evropë (qoftë edhe në Lindjen e Largme të Evropës) nuk mund «të mbrohet atdheu» ndryshe veçse duke luftuar me të gjitha mjetet revolucionare kundër monarkisë, çifligarëve e kapitalistëve të atdheut *tënd*, d.m.th. kundër armiqtë më të këqij të atdheut, — rusët nuk mund «ta mbrojnë atdheun» ndryshe veçse duke i uruar carizmit disfatën në çdo luftë, si të keqen më të vogël për 9/10 e popullsisë së Rusisë, sepse carizmi jo vetëm i shtyp ekonomikisht dhe politikisht këto 9/10 e popullsisë, por edhe i demoralizon, i poshtëron, i çnderon, i përdhos ato, duke i mësuar që të shtypin popuj të tjerë, duke i mësuar që ta fshehin turpin e vet me fraza hipokrite, gjoja patriotike.

Mund të na thonë, ndoshta, se sot përveç carizmit dhe nën hijen e tij ka lindur dhe është forcuar një fuqi tjetër historike, kapitalizmi rus, i cili bën një punë përparimtare duke centralizuar ekonomikisht dhe duke bashkuar krahina shumë të mëdha. Por kjo vërejtje nuk i shfaqëson, përkundrazi, i akuzon edhe më rëndë socialshovinizistët tanë, të cilët do të duhej të quheshin socialistë të carit dhe të Purishkeviçit (siç i quajti Marksi lasalianët — socialistë të mbretit dhe të Prusisë). Le ta zëmë se historia do ta zgjidhë çështjen në dobi të kapitalizmit imperialist rus kundër njëqind e një kombeve të vogla. Kjo nuk është e pamundur, sepse gjithë historia e kapitalit është një histori dhune dhe grabitjeje, gjaku dhe llumi. Dhe ne nuk jemi aspak përkrahës të kombeve medoemos të vogla; ne jemi patjetër, *duke mbetur kushtet e tjera të pan-*

dryshuara, për centralizimin dhe kundër idealit mikroborgjez të marrëdhënieve federative. Por edhe në këtë rast, pikësëpari, nuk është puna jonë, nuk është puna e demokratëve (e jo pastaj e socialistëve) të ndihmojnë Romanovin-Bobrinskiin-Purishkeviçin që të mbytin Ukrainën etj. Bismarku bëri sipas mënyrës së tij, me metodat e tij junkeriane, një vepër historike përparimtare, por çfarë «marksisti» do të ishte ai që, duke u nisur nga kjo, do ta quante të drejtë që socialistët ta ndihmojnë Bismarkun! Dhe duhet theksuar se Bismarku e ndihmoi zhvillimin ekonomik, duke i bashkuar gjermanët e përndarë që ishin të shtypur nga popuj të tjerë. Kurse lulëzimi ekonomik dhe zhvillimi i shpejtë i Rusisë kërkojnë që të qlirohet vendi nga dhuna e rusëve mbi popujt e tjerë — ky është ndryshimi që e harrojnë admiruesit tanë të gati-Bismarkëve rusë të vërtetë.

Së dyti, në qoftë se historia e zgjidh çështjen në dobi të kapitalizmit imperialist rus, atëherë nga kjo del se roli *socialist* i proletariatit rus, si forcë kryesore lëvizëse e revolucionit komunist, të lindur nga kapitalizmi, do të jetë edhe më i madh. Dhe për revolucionin e proletariatit duhet bërë një punë e gjatë për t'i edukuar punëtorët në frymën e barazisë kombëtare dhe të vëllazërimit *më të plotë*. Pra, nga pikëpamja e interesave pikërisht të proletariatit rus duhet bërë një punë e madh për edukimin e masave duke mbrojtur në mënyrën më të vendosur, më konsekuente, më të guximshme dhe revolucionare barazinë e plotë dhe të drejtën e vetëvendosjes së të gjitha kombeve të shtypura nga rusët. Interesat e krenarisë kombëtare (po të mos kuptohen në mënyrë servile) të rusëve përputhen me interesat *socialiste* të proletarëve rusë (dhe gjithë të tjerëve). Shembull për ne do të mbetet Marksi, i cili, pasi jetoi me dhjetëra vjet në Angli, u bë gjysmë anglez dhe kërkonte lirinë e pavarësinë kombëtare të Irlandës në emër të interesave të lëvizjes socialiste të punëtorëve anglezë.

Kurse socialistët tanë shovinistë, Plehanovi e të tjerë, në rastin e fundit që shqyrtuam, do të dalin tradhtarë jo vetëm të atdheut të tyre, të Ruisë së lirë dhe demokratike, por edhe tradhtarë të vëllazërimi-proletar të të gjithë popujve të Ruisë, d.m.th. të çështjes së socializmit.

«Social-Demokrat», Nr. 35,
12 dhjetor 1914

Veprat, bot. shqip, vëll. 21,
f. 98-102

Nga artikulli:

«ÇËSHITJA E PAQES»

A mund të bashkohen socialistët e vendeve të ndryshme në bazë kushtesh të caktuara paqeje? Në qoftë se po, atëherë ndër këto kushte duhet patjetër të jetë njohja e së drejtës për vetëvendosje për të gjitha kombet dhe heqja dorë nga çdo «aneksim», d.m.th. nga shkelja e kësaj së drejte. Por po ta pranosh këtë të drejtë vetëm për disa kombe, kjo do të thotë të mbrohen privilegjet e disa kombeve, d.m.th. të jesh nacionalist dhe imperialist, dhe jo socialist. Kurse po ta njohësh këtë të drejtë për të gjitha kombet, atëherë nuk mund të ndahet, për shembull, vetëm Belgjika, por duhen marrë gjithë popujt e shtypur edhe në Evropë (irlandezët në Angli, italianët në Nicë, danezët etj. në Gjermani, 57% të popullsisë së Rusisë etj.) edhe jashtë Evropës, d.m.th. të gjitha kolonitë. Shoku A. P. i përmendi ato shumë me vend. Anglia, Franca dhe Gjermania kanë së bashku rreth 150 milionë banorë, kurse ato shtypin në kolonitë një popullsi prej 400 milionë banorësh!! Thelbi i luftës imperialiste, d.m.th. i luftës për hir të interesave të ka-

pitalistëve, nuk është vetëm se lufta bëhet për të shtypur kombe të reja, për të ndarë kolonitë, por edhe se luftën e bëjnë, kryesisht, kombet e përparuara, që shtypin një varg popujsh të tjerë, që shtypin pjesën më të madhe të popullsisë së botës.

Socialdemokratët gjermanë, që e përligjin pushimin e Belgjikës ose pajtohen me të, në të vërtetë nuk janë socialdemokratë, por imperialistë dhe nacionalistë, sepse ata mbrojnë «të drejtën» e borgjezisë gjermane (dhe pjesërisht edhe të punëtorëve gjermanë) për të shtypur belgët, alzasasit, danezët, polakët, zezakët në Afrikë etj. Ata nuk janë socialistë, por shërbëtorë të borgjezisë gjermane, që e ndihmojnë atë të grabitë kombe të tjera. Por edhe socialistët belgë, që shtrojnë vetëm një kërkesë: të çlirohet dhe t'i jepet dëmshpërblim Belgjikës, në të vërtetë mbrojnë kërkesën e borgjezisë belge, e cila kërkon të shtypë si më parë 15 milionë banorë në Kongo dhe të marrë koncesione dhe privilegje në vende të tjera. Borgjezët belgë kanë investuar jashtë shtetit rreth 3 miliardë franga; të mbrohen me gjithfarë mashtrimesh e dallaveresh fitimet që japin këta miliarda — ja cili është në të vërtetë «interesi kombëtar» i «Belgjikës heroike». E njëjta gjë mund të thuhet — dhe madje më me forcë — edhe për Rusinë, Anglinë, Francën e Japoninë.

Pra, në qoftë se kërkesa e lirisë së kombeve nuk është një frazë e gënjeshtërt, me të cilën maskohet imperializmi e nacionalizmi i disa vendeve të veçanta, atëherë ajo duhet të shtrihet mbi të gjithë popujt dhe të gjitha kolonitë. Por kjo kërkesë është krejt e zbrazët pa një varg revolucionesh në të gjitha vendet e përparuara. Për më tepër. Ajo është e parralizueshme pa revolucionin socialist të përfunduar me sukses.

A do të thotë kjo se socialistët mund të qëndrojnë indiferentë ndaj kërkesës së paqes nga masat përherë e më të gjera? Në asnjë mënyrë. Parullat e pararojës së ndërgjegjshme të punëtorëve janë një gjë,

tërkesat spontane të masave janë një gjë tjetër. Dëshira e paqes është një nga shenjat më të rëndësishme të zhgënjimit që ka filluar të shfaqet ndaj gënjeshtërs borgjeze për qëllimet «çlirimtare» të luftës, për «mbrojtjen e atdheut» dhe për gënjeshttrat e tjera me të cilat klasa e kapitalistëve mashtron popullin e thjeshtë. Kësaj shenje socialistët duhet t'i kushtojnë vëmendje shumë të madhe. Të gjitha përpjekjet duhet të drejtohen për ta shfrytëzuar gjendjen shpirtërore të masave në dobi të paqes. Po si të shfrytëzohet? Të pranohet parulla e paqes dhe të përsëritet ajo do të ishte përkrahje për «mburrjet e liafazanëve të pafuqishëm (e shpesh edhe më keq: hipokritë)». Kjo do të ishte mashtrim i popullit me zhgënjimin se gjoja qeveritë e tanishme, klasat drejtuese të tanishme, janë të rfta, «pa u dhënë mësim» (ose, më sak, pa i mënjarruar) me një varg revolucionesh, të përfundojnë një paqe që të kënaqë pak a shumë demokracinë dhe klasën punëtore. Nuk ka gjë më të dëmshme se ky mashtrim. Nuk ka gjë që t'u hedhë punëtorëve më shumë hi syve, t'u ngulitë atyre idenë mashtruese se kontradikta ndërmjet kapitalizmit dhe socializmit nuk është e thellë, nuk ka gjë që ta lustrojë më shumë skllavërinë kapitaliste. Jo, ne duhet ta shfrytëzojmë gjendjen shpirtërore në dobi të paqes për t'ua shpjeguar masave se të mirat që ata presin nga paqja nuk janë të mundshme pa një varg revolucionesh.

Ideali ynë është pikërisht mbarimi i luftës, paqja ndërmjet popujve, ndalimi i grabitjeve dhe i dhunës, por vetëm sofistët borgjezë mund t'i gënjejnë masat me to, duke e shkëputur këtë ideal nga predikimi i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i veprimeve revolucionare. Baza për këtë predikim është; për ta bërë atë, duhet vetëm shkëputja nga aleatët e borgjezisë, nga oportunistët, të cilët e pengojnë si drejtpërdrejt (duke përfshirë edhe kallëzimet), ashtu edhe tërthorazi veprimtarinë revolucionare.

Parulla e vetëvendosjes së kombeve duhet të vi-

het edhe ajo në lidhje me epokën imperialiste të kapitalizmit. Ne nuk jemi për status quo*-në, për utopinë mikroborgjeze të *mospjesëmarrjes* në luftërat e mëdha. Ne jemi për luftën revolucionare kundër imperializmit, d.m.th. kapitalizmit. Imperializmi është pikërisht tendenca e kombeve, që shtypin një varg kombesh të tjera, për ta zgjeruar dhe forcuar këtë shtypje, për të bërë një ndarje të re të kolonive. Prandaj *kyçi* i çështjes së vetëvendosjes së kombeve në epokën tonë është pikërisht qëndrimi i socialistëve të kombeve *shtypëse*. Socialisti i kombit shtypës (Anglisë, Francës, Gjermanisë, Japonisë, Ruisë, Shteteve të Bashkuara etj.), që nuk e njeh dhe nuk e mbron të drejtën e kombeve të shtypura për vetëvendosje (d.m.th. për shkëputjen e lirë), në të vërtetë nuk është socialist, por shovinist.

Vetëm kjo pikëpamje të çon në luftë të sinqertë e konsekuente kundër imperializmit, në një trajtim (në epokën tonë) proletar dhe jo mikroborgjez të çështjes kombëtare. Vetëm kjo pikëpamje të çon në zbatimin konsekuent të parimit të luftës kundër çdo shtypjeje të kombeve, zhduk mosbesimin ndër proletarët e kombeve shtypëse dhe të shtypura, të çon në luftën solidare, ndërkombëtare për revolucionin socialist (d.m.th. për të vetmin regjim të realizueshëm të barazisë së plotë kombëtare), dhe jo për utopinë mikroborgjeze të lirisë së të gjitha shteteve të vogla në përgjithësi në kushtet e kapitalizmit.

Pikërisht kjo është pikëpamja e partisë sonë, d.m.th. e socialdemokratëve të Ruisë që janë bashkuar me KQ. Pikërisht këtë pikëpamje kishte edhe Marksi, që e mësonte proletariatin se «nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë». Marksi kërkonte shkëputjen e Irlandës nga Anglia pikërisht duke u nisur nga kjo pikëpamje, nga pikëpamja e interesave

* — gjendjen e mëparshme. Red.

ë lëvizjes çlirimtare të punëtorëve anglezë (jo vetëm irlandezë).

Në qoftë se socialistët e Anglisë nuk e njohin dhe nuk e mbrojnë të drejtën e shkëputjes së Irlandës, francezët — të Nicës italiane, gjermanët — të Alzas-Lorenës, Shlezvigut danez, Polonisë, rusët — të Polonisë, Finlandës, Ukrainës etj., polakët — të Ukrainës, në qoftë se të gjithë socialistët e fuqive «të mëdha», d.m.th. që kryejnë grabitje të mëdha, nuk mbrojnë po këtë të drejtë për sa u përket kolonive, kjo ndodh pikërisht dhe vetëm sepse ata në të vërtetë janë imperialistë e jo socialistë. Dhe është qesharake të ushqesh iluzionin se njerëzit që *nuk* mbrojnë «të drejtën për vetëvendosje» të kombeve të shtypura, duke bërë pjesë ata vetë në kombet shtypëse, mund të bëjnë një politikë socialiste.

Në vend që t'i lënë llafazanët hipokritë të mashtrojnë popullin me fraza dhe premtime për mundësinë e një paqeje demokratike, socialistët duhet t'u shpjegojnë masave pamundësinë e një paqeje pak a shumë demokratike pa një varg revolucionesh dhe pa luftë revolucionare në çdo vend kundër qeverisë së vet. Në vend që të lejojnë politikanët borgjezë të mashtrojnë popujt me fraza për lirinë e kombeve, socialistët duhet t'u shpjegojnë masave të kombeve shtypëse se për ato nuk ka asnjë shpresë çlirimi, në qoftë se do të ndihmojnë shtypjen e kombeve të tjera, në qoftë se nuk do të njohin dhe nuk do të mbrojnë të drejtën e këtyre kombeve për vetëvendosje, d.m.th. për t'u shkëputur lirisht. Ja politika socialiste e jo imperialiste për të gjitha vendet në çështjen e paqes dhe në çështjen kombëtare. Është e vërtetë se kjo politikë, në pjesën më të madhe, nuk pajtohet me ligjet që dënojnë tradhtinë e lartë, — por me këto ligje nuk pajtohet as rezolucioni i Bazelit, të cilin e tradhtuan në mënyrë aq të turpshme gjithë socialistët e kombeve shtypëse.

***Nga* «PROJEKTREZOLUCIONI I SË MAJTËS SË CIMERVALDIT»**

Kuptimi i vërtetë i parullës së «mbrojtjes së atdheut» në këtë luftë është mbrojtja e «së drejtës» së borgjezisë «së vet» kombëtare për të shtypur kombe të tjera, është politikë punëtore nacional-liberale, është aleancë e një pjese shumë të vogël punëtorësh të privilegjuar me borgjezinë «e vet» kombëtare kundër masës së proletarëve dhe të të shfrytëzuarve. Socialistët që bëjnë një politikë të tillë në të vërtetë janë shovinistë, socialshovinistë. Politika e votimit për kreditë e luftës, e hyrjes në qeveri, e Burgfrieden*-it etj., është tradhti kundrejt socializmit. Oportunizmi, i rritur në kushtet e epokës së kaluar «paqësore», është pjekur tani sa për t'u shpëputur plotësisht nga socializmi dhe është bërë armik i hapur i lëvizjes çlirimtare të proletariatit. Klasa punëtore nuk mund t'ua arrijë qëllimeve të veta historike botërore pa luftën më të vendosur kundër oportunizmit dhe socialshovinizmit të hapur (shumica e partive socialdemokrate të Francës, Gjermanisë, Austrisë, Hajndmani, fabianët dhe tredunionistët në Angli, Rubanoviçi, Plehanovi dhe «Nasha

* — paqes civile. *Red.*

Zarja» në Rusi etj.), si dhe kundër së ashtuquajturës «qendër», e cila u dorëzoi shovinistëve pozitën e marksizmit.

Manifesti i Bazelit i 1912-s që u miratua njëzëri nga socialistët e gjithë botës, duke pasur parasysh pikërisht një luftë të tillë ndërmjet fuqive të mëdha, si kjo që ka shpërthyer tani, e njohu qartë karakterin imperialist, reaksionar të kësaj lufte, deklaroi se do të ishte krim që punëtorët e një vendi të qëllonin punëtorët e një vendi tjetër dhe shpalli afrimin e *revolucionit proletar* pikërisht në lidhje me këtë luftë. Dhe me të vërtetë, lufta krijon një gjendje revolucionare, lind synime revolucionare dhe trazira në masat, ngjall kudo në pjesën më të mirë të proletariatit vetëdijen se oportunizmi i ka ditët të shkurtra dhe e ashpëron luftën kundër tij. Dëshira e masave punonjëse për paqe, që sa vete rritet, tregon se ato e kanë humbur shpresën, se gënjeshtërs borgjeze për mbrojtjen e atdheut i ka dalë boja, se vetëdija revolucionare e masave ka filluar të kthjellohet. Duke e shfrytëzuar këtë gjendje shpirtërore për agjitacionin e vet revolucionar, pa u stepur në agjitacionin e vet revolucionar para mendimit të disfatës së atdheut «të vet», socialistët nuk do ta gënjejnë popullin me shpresën se mund të ketë një paqe të shpejtë, pak a shumë të qëndrueshme, demokratike, që përjashton shtypjen e kombeve, se mund të bëhet çarmatimi etj. pa përmbyshjen revolucionare të qeverive të tanishme. Vetëm revolucioni shoqëror i proletariatit hap rrugën e paqes dhe të lirisë së kombeve.

Lufta imperialiste çel epokën e revolucionit shoqëror. Të gjitha kushtet objektive të epokës sonë vënë në rendin e ditës luftën revolucionare në masë të proletariatit. Detyra e socialistëve është që, pa hequr dorë nga asnjë mjet i luftës legale të klasës punëtoresh, t'i përdorin të gjitha këto mjete për këtë detyrë më të ngutshme e më kryesore, të zhvillojnë ndërgjegjen revolucionare të punëtorëve, t'i bashkojnë ata në luf-

tën revolucionare ndërkombëtare, të përkrahin dhe të çojnë përpara çdo veprim revolucionar, të përpiqen që lufta imperialiste ndër popujt të shndërrohet në luftë civile të klasave të shtypura kundër shtypësve të tyre, në luftë për shpronësimin e klasës së kapitalistëve, për marrjen e pushtetit politik nga proletariati, për vendosjen e socializmit.

*Shkruar para 20 gushtit
(2 shtatorit) 1915*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 21,
f. 276-378*

PROLETARIATI REVOLUCIONAR DHE E DREJTA E KOMBEVE PËR VETËVENDOSJE

Manifesti i Cimervaldit, si dhe shumica e programeve ose rezolucioneve taktike të partive socialdemokrate, shpall «të drejtën e kombeve për vetëvendosje». Në Nr. 252 dhe 253 të gazetës «Berner Tagwacht»*, Parabellumi³⁰ e quan «iluzore» «luftën për të drejtën e vetëvendosjes»; që nuk ekziston, dhe *vë përballë* saj «luftën revolucionare në masë të proletariatit kundër kapitalizmit», *duke na siguruar* me këtë rast se «ne jemi kundër aneksimeve» (ky sigurim është përsëritur pesë herë në artikullin e Parabellumit) dhe jemi kundër çdo dhune mbi kombet.

Pozitën e vet Parabellumi e arsyeton kështu: tani të gjitha çështjet kombëtare, çështja e Alzas-Lorenës, Armenisë etj., janë çështje të imperializmit, — kapitaii, i ka kaluar caqet e shteteve kombëtare, — nuk është e mundur «ta kthesh prapë në historinë e historisë prapa» në idealin e vjetruar të shteteve kombëtare, etj.

Të shohim nëse janë të drejta arsyetimet e Parabellumit.

* — «Rojë e Bernës». Red.

Së pari, pikërisht Parabellumi shikon prapa, dhe jo përpara, kur duke u hedhur në sulm kundër pranimin nga klasa punëtore të «idealit të shtetit kombëtar» i drejton sytë nga Anglia, Franca, Italia, Gjermania, d.m.th. nga vendet ku lëvizja nacionalçlirimtare i përket së kaluarës, dhe jo nga Lindja, Azia, Afrika, nga kolonitë, ku kjo lëvizje i përket së tashmes dhe së ardhmes. Mjafton të përmendim Indinë, Kinën, Persinë, Egjiptin.

Më tej. Imperializëm do të thotë se kapitali i kalon caqet e shteteve kombëtare, se ai e zgjeron dhe e ashpëson shtypjen kombëtare mbi një bazë historike të re. Nga kjo rrjedh, në kundërshtim me mendimin e Parabellumit, pikërisht se ne duhet ta lidhim luftën revolucionare për socializëm me një program revolucionar në çështjen kombëtare.

Sipas Parabeliumit del se në emër të revolucionit socialist ai hedh poshtë me përbuzje programin konsekuent revolucionar në lëmin demokratik. Kjo nuk është e drejtë. Proletariati nuk mund të fitojë ndryshe veçse nëpërmjet demokracisë, d.m.th. duke e vënë në jetë demokracinë plotësisht dhe duke lidhur me çdo hap të luftës së tij kërkesat demokratike në formulimin e tyre më të vendosur. Është marrëzi ta vësh revolucionin socialist dhe luftën revolucionare kundër kapitalizmit përballë njëres nga çështjet e demokracisë, në këtë rast përballë çështjes kombëtare. Ne duhet ta bashkojmë luftën revolucionare kundër kapitalizmit me një program dhe taktikë revolucionare për të gjitha kërkesat demokratike: edhe të republikës, edhe të milicisë, edhe të zgjedhjes së funksionarëve nga populli, edhe të barazisë së të drejtave të grave, edhe të vetëvendosjes së kombeve etj. Sa kohë që të jetë kapitalizmi, të gjitha këto kërkesa nuk mund të plotësohen veçse si përjashtim, dhe, përveç kësaj, në një formë gjysmake, të shtrembëruar. Duke u mbështetur në atë demokratizëm që tashmë është arritur, duke demaskuar karakterin e tij gjysmak në

kushtet e kapitalizmit, ne kërkojnë përmbyesjen e kapitalizmit, shpronësimin e borgjezisë, si bazë e domosdoshme edhe për zhdukjen e mjerimit të masave, edhe për zbatimin e *plotë dhe të gjithanshëm të të gjitha* transformimeve demokratike. Disa nga këto transformime do të fillojnë para përmbyesjes së borgjezisë, disa të tjera *gjatë* kësaj përmbyesjeje, të tjerat pas saj. Revolucionari shoqëror nuk është një betejë e vetme, por epoka e një vargu të tërë betejash për të gjitha çështjet e transformimeve ekonomike dhe demokratike që përfundojnë vetëm me shpronësimin e borgjezisë. Pikërisht në emër të këtij qëllimi të fundit ne duhet t'i japim një formulim revolucionar konsekuent *secilës* prej kërkesave tona demokratike. Është plotësisht e mundshme që punëtorët e ndonjë vendi ta përmbysin borgjezinë *para* se të kryhet plotësisht qoftë edhe një transformim demokratik rrënjësor. Por nuk është aspak e mundur që proletariati, si klasë historike, të jetë në gjendje ta mundë borgjezinë, në qoftë se ai nuk do të jetë i përgatitur për këtë duke u edukuar në frymën e demokracizmit më konsekuent, më të vendosur dhe revolucionar.

Imperializmi është shtypja përherë më e madhe e kombeve të botës nga një grusht fuqish të mëdha, është epoka e luftërave midis tyre për zgjerimin dhe përforcimin e shtypjes mbi kombet, epoka e mashtrimit të masave popullore nga socialpatriotët me dy faqe, d.m.th. nga njerëz që *nën pretekstin* e «lirisë së kombeve», të «së drejtës së kombeve për vetëvendosje» dhe të «mbrojtjes së atdheut» përligjin dhe mbrojnë shtypjen e shumicës së kombeve të botës nga fuqitë e mëdha.

Prandaj në programin e socialdemokracisë pika kryesore duhet të jetë pikërisht ajo ndarje e kombeve në kombe shtypëse dhe në kombe të shtypura që përbën *thelbin* e imperializmit dhe së cilës i bëjnë bisht *me gënjeshtër* socialshovinistët dhe Kautski. Kjo ndarje nuk është thelbësore nga pikëpamja e pacifizmit

borgjez ose e utopisë mikroborgjeze të konkurrencës paqësore ndërmjet kombeve të pavarura në kushtet e kapitalizmit, por ajo është thelbësore nga pikëpamja e luftës revolucionare kundër imperializmit. Nga kjo ndarje duhet të rrjedhë përcaktimi *ynë* i «së drejtës së kombeve për vetëvendosje», përcaktim demokratik konsekuent, revolucionar, që i përgjigjet detyrës së përgjithshme të luftës së menjëhershme për socializëm. Duke luftuar për njohjen e sinqertë të kësaj së drejte, socialdemokratët e kombeve shtypëse duhet të kërkojnë në emër të saj lirinë e shpërndarjes së kombeve të shtypura, — sepse në rast të kundërt njohja e barazisë së të drejtave të kombeve dhe e solidarësisë internacionale të punëtorëve në të vërtetë nuk do të ishte veçse fjalë boshe, hipokrizi. Kurse socialdemokratët e kombeve të shtypura në vendin e parë duhet të vënë unitetin dhe shkrirjen e punëtorëve të kombeve të shtypura me punëtorët e kombeve shtypëse, — sepse në rast të kundërt këta socialdemokratë do të bëhen padashur aleatë të kësaj ose asaj borgjezie kombëtare që tradhëton gjithmonë interesat e popullit dhe të demokracisë, që është gjithmonë e gatshme, nga ana e vet, për të bërë aneksime dhe për të shtypur kombe të tjera.

Një shembull mësimdhënës mund të jetë mënyra se si shtrohej çështja kombëtare në fund të dhjetëvjetëshit të shtatë të shekullit të kaluar. Demokratët mikroborgjezë, për të cilët çdo mendim për luftën e klasave dhe për revolucionin socialist ishte i huaj, trilluan utopinë e konkurrencës paqësore ndërmjet kombesh të lira dhe të barabarta në kushtet e kapitalizmit. Prudonistët e «mohonin» fare çështjen kombëtare dhe të drejtën e kombeve për vetëvendosje nga pikëpamja e detyrave të ngutshme të revolucionit shoqëror. Marksia tallej me prudonizmin francez dhe tregon-te afrinë e tij me shovinizmin francez («gjithë Evropa mund dhe duhet të rrijë urtë e të mos bëjë zë derisa zotërinjtë e Francës të zhdukim mjerimin»... «me

mohimin e kombësive, pa e ndier as ata vetë, me sa duket, ata kuptojnë gilabërimin e tyre nga kombi shembullor francez»). Marksi kërkonte *shkëputjen e Irlandës nga Anglia*, — «edhe sikur pas shkëputjes të arrihet në federatë» — dhe e kërkonte këtë jo nga pikëpamja e utopisë mikroborgjeze të kapitalizmit paqësor, jo për «të genë i drejtë ndaj Irlandës»,* por nga pikëpamja e interesave të luftës revolucionare të proletariatit të *kombit shtypës, d.m.th. të atij anglez*, kundër kapitalizmit. Liria e *këtij kombi ka genë e kufizuar dhe e gjymtuar për shkak se ai shtypte një komb tjetër. Internacionalizmi i proletariatit anglez do të kishte mbetur frazë hipokrite, sikur ai të mos kërkonte shkëputjen e Irlandës. Duke mos pas genë asnjëherë përkrahës as i shteteve të vogla, as i copëtimit të shteteve në përgjithësi, as i parimit të federatës, Marksi e shikonte shkëputjen e një kombi të shtypur si hap drejt federatës dhe, rrjedhimisht, jo drejt copëtimit, por drejt koncentrimit edhe politik edhe ekonomik, vetëm se drejt një koncentrimi mbi bazën e demokratizmit. Nga pikëpamja e Parabellumit, Marksi bënte, si duket, një «luftë iluzore» kur kërkonte shkëputjen e Irlandës. Kurse në të vërtetë *vetëm* kjo kërkesë ishte një program revolucionar konsekuent, vetëm ajo i përgjigjej internacionalizmit, vetëm ajo mbronte koncentrimin në *mënyrë jo imperialiste*.*

Imperializmi i ditëve tona ka bërë që shtypja e kombeve nga fuqitë e mëdha të jetë një dukuri e përgjithshme. Pikërisht pikëpamja e luftës kundër socialshovinizmit të fuqive të mëdha, që po bëjnë tani një luftë imperialiste për ta shtuar shtypjen e kombeve dhe që shtypin shumicën e kombeve të botës dhe shumicën e popullsisë së botës, pikërisht kjo pikëpamje duhet të jetë vendimtare, kryesore, themelore në programin kombëtar të socialdemokracisë.

* Shih këtë përmbledhje, f. 104. Red. Përkth.

Shikoni drejtimet e sotme të mendimit socialdemokrat në këtë çështje. Utopistët mikroborgjezë, që ëndërrojnë për barazinë dhe paqen ndërmjet kombeve në kushtet e kapitalizmit, ua kanë lënë vendin socialimperialistëve. Duke luftuar kundër të parëve, Parbellumi lufton kundër mullinjve me erë dhe ndihmon padashur të dytët. Cili është programi i socialshovinistëve në çështjen kombëtare?

Ata ose e mohojnë fare të drejtën për vetëvendosje, duke sjellë argumente si ato të Parbellumit (Kunovi, Parvusi, oportunistët rusë: Semkovski, Libmani etj.). Ose e njohin këtë të drejtë në mënyrë krejt hipokrite, duke mos e zbatuar pikërisht për ato kombe që janë të shtypura nga kombi i vet ose nga aleati ushtarak i kombit të vet (Plehanovi, Hajndmani, gjithë patriotët frankofilë, pastaj Shejdemani etj. etj.). Formulimin më të bukur, dhe prandaj më të rrezikshëm për proletariatin, të gënjeshtres socialshoviniste na e jep Kautski. Me fjalë ai është për vetëvendosjen e kombeve, me fjalë ai kërkon që partia socialdemokrate «die Selbständigkeit der Nationen allseitig (!) und rückhaltlos (??) achtet und fordert» («Neue Zeit», 33, II S. 241; 21 V 1915). Kurse në të vërtetë ai ia përshtat programin kombëtar socialshovinizmit sundues, e shtrembëron dhe e cungon atë, nuk i përcakton me saktësi detyrat e socialistëve të kombeve shtypëse dhe madje e falsifikon hapur parimin demokratik kur thotë se të kërkosh «pavarësinë shtetërore» (staatliche Selbständigkeit) për çdo komb, do të thoshte të kërkosh diçka «të tapruar» («zu viel», «Neue Zeit», 33, II 77; 16 IV 1915). Mjafton, vini re këtë, «autonomia kombëtare»!! Çështjen kryesore, të cilën borgjezia imperialiste nuk e lejon të preket, çështjen e *kufijve të shtetit*, që bazohet në shtypjen e kombeve, pikërisht këtë çështje Kautski e lë mënjanë, duke flakur

* — «të respektojë dhe të mbrojë nga të gjitha pikëpamjet (!) dhe pa kushte (??) pavarësinë e kombeve». *Red.*

nga programi gjënë më kryesore në interes të kësaj borgjezie. Borgjezia është gati të premtojë çfarëdo «barazi të të drejtave të kombeve» dhe çfarëdo «vetë-qeverisje kombëtare», vetëm e vetëm që proletariati të përmbahet brenda caqeve të legalitetit dhe t'i nënshtrohet asaj «pa bërë zë» në çështjen e kufijve të shtetit! Kautski e formulon programin kombëtar të socialdemokracisë në mënyrë reformiste, dhe jo revolucionare.

Programin kombëtar të Parabellumit, më mirë të themi, *sigurimet* e tij se «ne jemi kundër aneksimeve», Parteivorstand*-i, Kautski, Plehanovi e K° e nënshkruajnë me të dyja duart, pikërisht sepse ky program nuk i demaskon socialpatriotët sundues. Këtë program kanë për ta nënshkruar edhe borgjezët pacifistë. Programi i *përgjithshëm* e i bukur i Parabellumit («lufta revolucionare në masë kundër kapitalizmit») nuk i shërben atij, — ashtu si edhe prudonistëve të vjetëve 1860-1870, — që të përpunojë në përputhje me të dhe në frymën e tij një program të papajtueshëm dhe po aq revolucionar në çështjen kombëtare, por që t'ua pastrojë rrugën socialpatriotëve. Në epokën tonë imperialiste shumica e socialistëve të botës u përket kombeve që shtypin kombe të tjera dhe që synojnë ta zgjerojnë këtë shtypje. Prandaj «lufta kundër aneksimeve», që bëjmë ne, do të mbetet pa përmbajtje, nuk do t'i trembë aspak socialpatriotët, në qoftë se ne nuk do të deklarojmë: një socialist që bën pjesë në një komb shtypës dhe që nuk propagandon si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë lufte lirinë e shpëputjes së kombeve të shtypura nuk është socialist, nuk është as internacionalist, por shovinist! Një socialist që bën pjesë në një komb shtypës dhe që nuk e bën këtë propagandë pa marrë parasysht ndalimet e qeverive, d.m.th. në shtypin e lirë, d.m.th. në shty-

* — Udhëheqja e partisë socialdemokrate gjermane. Red.

pin ilegal, mbetet përkrahës hipokrit i barazisë së të drejtave të kombeve!

Për Rusinë, që nuk e ka përfunduar ende revolucionin e saj demokratiko-borgjez, Parabellumi ka thënë *vetëm* një frazë:

«Selbst das wirtschaftlich sehr zurückgebliebene Russland hat in der Haltung der Polnischen, Lettischen, Armenischen Bourgeoisie gezeigt, dass nicht nur die militärische Bewachung es ist, die Völker in diesem «Zuchthaus der Völker» zusammenhält, sondern Bedürfnisse der kapitalistischen Expansion, für die das ungeheure Territorium ein glänzender Boden der Entwicklung ist»*.

Kjo nuk është «një pikëpamje socialdemokrate», por borgjezo-liberale, ajo nuk është pikëpamje internacionaliste, por shoviniste-rusomadhe. Me sa duket, Parabellumi, që lufton aq bukur kundër socialpatriotëve gjermanë, e njeh shumë pak shovinizmin rusomadh. Për të nxjerrë nga kjo frazë e Parabellumit një tezë socialdemokrate dhe konkluzione socialdemokrate, ajo duhet të ndryshohet dhe të plotësohet në këtë mënyrë:

Rusia është një burg popujsh jo vetëm për arsye të karakterit ushtarak-feudal të carizmit, jo vetëm sepse borgjezia rusomadhe përkrah carizmin, por edhe sepse borgjezia poloneze etj. lirinë e kombeve si dhe demokratizmin në përgjithësi ua ka bërë fli intereseve të ekspansionit kapitalist. Proletariati i Rusisë nuk mund as të ecë në krye të popullit drejt një revolucionit demokratik ngadhënjimtar (kjo është detyra e tij imediate), as të luftojë së bashku me vëllezërit e tij proletarë të Evropës, për revolucionin socialist,

* — «Edhe Rusia, ky vend shumë i prapambetur nga pikëpamja ekonomike, tregoi me qëndrimin e borgjezisë poloneze, letone dhe armene se popujt në këtë «burg popujsh» nuk i mban vetëm roja ushtarake, por edhe nevoja e ekspansionit kapitalist, për të cilin territori i saj shumë i gjerë përbën një bazë të shkëlqyer për zhvillimin e vet». Red.

në qoftë se nuk kërkon që tani plotësisht dhe «rückhaltlos»* lirinë e shkëputjes nga Rusia të të gjitha kombeve të shtypura prej caizizmit. Ne e kërkojmë këtë jo pavarësisht nga lufta jonë revolucionare për socializëm, por sepse kjo luftë e fundit do të mbetet një fjalë boshe, po të mos lidhet me formulimin revolucionar të të gjitha çështjeve demokratike, duke përfshirë edhe çështjen kombëtare. Ne kërkojmë lirinë e vetëvendosjes, *d.m.th.* pavarësinë, *d.m.th.* lirinë e shkëputjes së kombeve të shtypura jo sepse ëndërrojmë për copëtimin ekonomik ose për idealin e shteteve të vogla, por, përkundrazi, sepse ne dëshirojmë shtete të mëdha dhe afrimin, madje shkrirjen e kombeve; por mbi një bazë me të vërtetë demokratike, me të vërtetë internacionaliste, që nuk mund të kuptohet pa lirinë e shkëputjes. Sikundër Marksi më 1869 kërkonte shkëputjen e Irlandës jo për copëtimin, por për bashkimin e mëtejshëm të lirë të Irlandës me Anglinë, jo për «të qenë i drejtë ndaj Irlandës», por për hir të interesit të luftës revolucionare të proletariatit anglez, kështu edhe ne mendojmë se socialistët e Rusisë, po të mos kërkojmë lirinë e vetëvendosjes së kombeve, në kuptimin që treguam, do të bëjnë një tradhti të hapur kundrejt demokracisë, internacionalizmit dhe socializmit.

*Shkruar gjermanisht jo më
parë se 16(29) tetor 1915*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 21,
f. 443-451*

* — «pa kushte». *Red.*

REVOLUCIONI SOCIALIST DHE E DREJTA E KOMBEVE PËR VETËVENDOSJE

(TEZA)

1. IMPERIALIZMI, SOCIALIZMI DHE ÇLIRIMI I KOMBEVE TË SHTYPURA

Imperializmi është faza më e lartë e zhvillimit të kapitalizmit. Kapitali në vendet e përparuara ka dalë përtej kufijve të shteteve kombëtare, e ka zëvendësuar konkurrencën me monopolin dhe ka krijuar të gjitha kushtet objektive që e bëjnë të realizueshëm socializmin. Prandaj në rendin e ditës në Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara është vënë lufta revolucionare e proletariatit për përmbysjen e qeverive kapitaliste, për shpronësimin e borgjezisë. Imperializmi i shtyn masat drejt kësaj lufte, duke i ashpërsuar në përpjesëtime vigane kontradiktat klasore, duke e keqësuar gjendjen e masave edhe nga pikëpamja ekonomike — trustet, shtrenjtësia — edhe nga pikëpamja politike: rritja e militarizmit, dendësimi i luftërave, forcimi i reaksionit.

konsolidimi dhe zgjerimi i shtypjes kombëtare dhe i grabitjes koloniale. Socializmi ngadhënjimtar duhet meoemos të zbatojë një demokraci të plotë, dhe, si pasojë, jo vetëm të vërë në jetë barazinë e plotë të komebeve, por edhe të realizojë të drejtën e komebeve të shtypura për vetëvendosje, d.m.th. të drejtë për shkëputje politike të lirë. Partitë socialiste, të cilat nuk do ta provonin me tërë veprimtarinë e tyre edhe sot, edhe gjatë revolucionit, edhe pas fitores së tij, se ato do t'i çlirojnë kombet e skllavëruara dhe do t'i ndërtojnë marrëdhëniet me to mbi bazën e një bashkimi të lirë — dhe bashkimi i lirë është frazë e rreme pa lirinë e shkëputjes, — këto parti do të bënin një tradhti ndaj socializmit.

Sigurisht, edhe demokracia është një formë e shtetit, e cila duhet të zhduket kur do të zhduket shteti, por kjo do të ndodhë vetëm kur të bëhet kalimi nga socializmi, që do të ketë fituar dhe do të jetë konsoliduar përfundimisht, në komunizmin e plotë.

2. REVOLUCIONI SOCIALIST DHE LUFTA PËR DEMOKRACINË

Revolucioni socialist nuk është vetëm një akt, nuk është vetëm një betejë në një front të vetëm, por një epokë e tërë konfliktesh të ashpra klasore, një varg i gjatë betejash në të gjitha frontet, d.m.th. në të gjitha çështjet e ekonomisë dhe të politikës, betejash që mund të përfundojnë vetëm me shpronësimin e borgjezisë. Do të ishte gabim i rëndë të mendosh se lufta për demokracinë mund ta largojë proletariatin nga revolucioni socialist, ose ta mbulojë, ta errësojë atë etj. Përkundrazi, ashtu siç nuk mund të ketë so-

cializëm ngadhënjimtar pa realizimin e plotë të demokracisë, po ashtu proletariati nuk mund të përgatitet për fitoren mbi borgjezinë pa një luftë të gjithanshme, konsekuente dhe revolucionare për demokracinë.

Do të ishte gabim jo më i vogël, të heqësh një nga pikat e programit demokratik, p.sh., atë mbi vetëvendosjen e kombeve, duke thënë gjoja se në kushtet e imperializmit ajo «nuk mund të realizohet» ose është një «shpresë e kotë». Teza se e drejta e kombeve për vetëvendosje nuk mund të realizohet në kuadrin e kapitalizmit mund të merret ose në kuptimin absolut, ekonomik, ose në kuptimin konvencional, politik.

Në rastin e parë ajo është rrënjësisht e gabuar nga pikëpamja teorike. Së pari, në këtë kuptim në kushtet e kapitalizmit nuk mund të realizohet, p.sh., para-ja-punë ose zhdukja e krizave etj. Është krejt e gabuar të thuash se *po kështu* nuk mund të realizohet vetëvendosja e kombeve. Së dyti, edhe vetëm shembulli i shkëputjes së Norvegjisë nga Suedia më 1905 mjafton për ta hedhur poshtë tezën se «nuk mund të realizohet» në këtë kuptim. Së treti, do të ishte qesharake të mohosh se me ndonjë ndryshim të vogël në marrëdhëniet politike dhe strategjike, p.sh., ndërmjet Gjermanisë dhe Anglisë sot a nesër, mund të «realizohet» fare mirë krijimi i shtetit të ri të Polonisë, të Indisë etj. Së katërti, kapitali financiar me tendencën e tij për ekspansion mund ta blerë dhe ta korruptojë «lirisht» qeverinë më të lirë demokratike dhe republikane dhe funksionarët e zgjedhur të çfarëdo vendi, goftë edhe «të pavarur». Sundimi i kapitalit financiar, ashtu si edhe i kapitalit në përgjithësi, nuk mund të zhduket *me asnjë* transformim në fushën e demokracisë politike; dhe vetëvendosja hyn e tëra në këtë fushë dhe vetëm e vetëm në këtë fushë. Por ky sundim i kapitalit financiar nuk e zhduk aspak rëndësinë e demokracisë politike, si *forma* më e lirë,

më e gjerë dhe më e qartë e shtypjes së klasës dhe e luftës së klasës. Prandaj të gjitha arsyetimet se «nuk është e realizueshme», në kuptimin ekonomik, njëra nga kërkesat e demokracisë politike në kushtet e kapitalizmit përmbliidhen në një përkufizim teorikisht të gabuar të marrëdhënieve të përgjithshme dhe themelore të kapitalizmit dhe të demokracisë politike në përgjithësi.

Në rastin e dytë kjo tezë nuk është e plotë dhe nuk është e saktë. Sepse jo vetëm e drejta e kombeve për vetëvendosje, por të gjitha kërkesat themelore të demokracisë politike «mund të realizohen» në kushtet e imperializmit vetëm në mënyrë jo të plotë, të cunguar dhe si një përjashtim i rrallë (p.sh. shkëputja e Norvegjisë nga Suedia më 1905). Kërkesa për çlirim e menjëhershëm të kolonive, që formulohet nga gjithë socialdemokratët revolucionarë, është gjithashtu «e porealizueshme» në kushtet e kapitalizmit pa një varg revolucionesh. Por nga kjo nuk buron aspak mohimi i luftës së menjëhershme dhe i luftës më të vendosur për të gjitha këto kërkesa nga ana e socialdemokracisë — nga një mohim i tillë do të përfitonin vetëm borgjezia dhe reaksioni — po pikërisht e kundërta, buron domosdoshmëria që të gjitha këto kërkesa të formulohen dhe të vihen në jetë jo në mënyrë reformiste, por revolucionare; jo duke u kufizuar me caqet e legalitetit borgjez, por duke i dërrmuar ato; jo duke u kënaqur me veprimtarinë parlamentare dhe me protesta me fjalë, por duke tërhequr në veprimin aktiv masat, duke zgjeruar dhe duke e ndezur luftën për çdo kërkesë rrënjësore demokratike deri te sulmi i drejtpërdrejtë i proletaariatit kundër borgjezisë, d.m.th. deri te revolucioni socialist që e shpronëson borgjezinë. Revolucioni socialist mund të ndizet jo vetëm nga një grevë e madhe ose një demonstratë e madhe në rrugë, ose një kryengritje e shkaktuar nga zia e bukës, ose një kryengri-

tje në ushtri, ose një revoltë koloniale, por edhe nga çdo krizë politike si ajo që shkaktoi çështja Drejfus³¹ ose incidenti i Cebernit³², ose për një referendum mbi shkëputjen e një kombi të shtypur etj.

Forcimi i shtypjes kombëtare në kushtet e imperializmit nuk do të thotë që socialdemokracia të heqë dorë nga ajo që borgjezia quan luftë «utopike» për lirinë e shkëputjes së kombeve, përkundrazi, ai kërkon që ajo t'i shfrytëzojë edhe më shumë konfliktet që lindin edhe mbi këtë bazë, si shkak për veprime në masë dhe për veprime revolucionare kundër borgjezisë.

3. KUPTIMI I SË DREJTËS PËR VETËVENDOSJE DHE RAPORTI I SAJ ME FEDERATËN

E drejta e kombeve për vetëvendosje është e drejta absolute për pavarësi në kuptimin politik, për shkëputje politike të lirë nga kombi shtypës. Konkretisht, kjo kërkesë e demokracisë politike është liria e plotë e agjitacionit për shkëputje dhe për zgjidhjen e çështjes së shkëputjes me anë të një referendumi nga kombi që dëshiron të shkëputet. Kështu kjo kërkesë nuk është aspak e barabartë me kërkesën për shkëputjen, copëtimin dhe formimin e shteteve të vogla. Ajo është vetëm një shprehje konsekuente e luftës kundër çdo shtypjeje kombëtare. Sa më shumë i afrohet rendi demokratik i një shteti lirisë së plotë të shkëputjes, aq më e rrallë dhe më e dobët do të jetë në praktikë tendenca për t'u shkëputur, sepse përfitimet e shteteve të mëdha si nga pikëpamja e përparimit ekonomik, ashtu edhe nga pikëpamja e interesave të masës janë të padiskutueshme dhe me

zhvillimin e kapitalizmit ato shtohen vazhdimisht. Njohja e parimit të vetëvendosjes nuk është e barabartë me njohjen e federatës, si parim. Mund të jesh kundërshtar i vendosur i këtij parimi dhe për-krahës i centralizmit demokratik, por prapë në vend të pabarazisë kombëtare të parapëlqesh federatën, si e vetmja rrugë që çon në një centralizëm demokratik të plotë. Pikërisht nga kjo pikëpamje Marks, megjithëse ishte centralist, ishte qoftë edhe për një federatë të Irlandës me Anglinë sesa për nënshtrimin e Irlandës me dhunë anglezeve.

Qëllimi i socializmit nuk është vetëm zhdukja e copëtimit të njerëzimit në shtete të vogla dhe zhdukja e çdo veçimi të kombeve, nuk është vetëm afrimi i kombeve, por edhe shkrirja e tyre. Dhe pikërisht që t'ia arrijmë këtij qëllimi ne duhet, nga njëra anë, t'u shpjegojmë masave karakterin reaksionar të idesë së Renerit dhe O. Bauerit për të ashtuquajturën «autonomi kombëtareo-kulturorë»³³ e, nga ana tjetër, të kërkojmë çlirimin e kombeve të shtypura jo me fraza të përgjithshme dhe të mjegullta, jo me deklaramë të zbrazëta, jo duke e «shtyrë» zgjidhjen e kësaj çështjeje derisa të vendoset socializmi, por me një program politik të qartë dhe të formuluar sak, i cili ta vërë në dukje në mënyrë të veçantë hipokrizinë dhe burracakësinë e socialistëve në kombet shtypëse. Po ashtu sikundër njerëzimi mund të arrijë në zhdukjen e klasave vetëm nëpërmjet periudhës kalimtare të diktaturës së klasës së shtypur, po kështu edhe në shkrirjen e pashmangshme të kombeve njerëzimi mund të arrijë vetëm nëpërmjet periudhës kalimtare të çlirimit të plotë të të gjitha kombeve të shtypura, d.m.th. të lirisë së tyre për t'u shkëputur.

4. MËNYRA REVOLUCIONARE-PROLETARE E SHTRUARJES SË ÇËSHTJES SË VETËVENDOSJES SË KOMBEVE

Jo vetëm kërkesa për vetëvendosjen e kombeve, por të gjitha pikat e programit tonë minimum demokratik kanë qenë formuluar *qysh më parë*, qysh në shekujt XVII dhe XVIII, nga borgjezia e vogël. Dhe borgjezia e vogël vazhdon t'i shtrojë të gjitha këto kërkesa në mënyrë utopike edhe sot, pa e parë luftën e klasave dhe ashpërsimin e saj në kushtet e demokracisë, duke pasur besim në kapitalizmin «paqësor». Pikërisht e tillë është utopia e bashkimit paqësor të kombeve të barabarta në kushtet e imperializmit, utopi që gënjen popullin dhe mbrohet nga kautskianët. Përballë kësaj utopie oportuniste dhe mikroborgjeze programi i socialdemokracisë duhet të mbrojë tezën e ndarjes së kombeve në kombe shtypëse dhe kombe të shtypura, si ndarje themelore, si ndarje kryesore dhe e pashmangshme në kushtet e imperializmit.

Proletariati i kombeve shtypëse nuk mund të kufizohet me frazat e përgjithshme, shabllone, të përsëritura nga çdo borgjez pacifist kundër aneksimeve dhe për barazinë e kombeve në përgjithësi. Proletariati nuk mund ta lërë në heshtje çështjen e *kufijve* të një shteti që mbështetet në shtypjen kombëtare, çështje veçanërisht «e papëlqyer» për borgjezinë imperialiste. Proletariati nuk mund të mos luftojë kundër mbajtjes me dhunë të kombeve të shtypura brenda kufijve të një shteti, e kjo do të thotë pikërisht të luftosh për të drejtën e vetëvendosjes. Proletariati duhet të kërkojë lirinë e shkëputjes politike për kolonitë dhe kombet e shtypura nga kombi «i tij». Në rastin

e kundërt internacionalizmi i proletariatit do të mbetet fjalë e zbrazët dhe e kotë; në këtë rast nuk mund të ketë as besim as solidarësi klase ndërmjet punëtorëve të kombit të shtypur dhe punëtorëve të kombit shtypës; hipokrizia e mbrojtësve reformistë dhe kautskianë të vetëvendosjes, që nuk flasin për kombet e shtypura nga kombi «i tyre» dhe që mbahen me dhunë brenda kufijve të shtetit «të tyre», mbetet e pademaskuar.

Nga ana tjetër, socialistët e kombeve të shtypura duhet në mënyrë të veçantë të mbrojnë dhe të vënë në jetë bashkimin e plotë dhe pa kushte, duke përfshirë edhe bashkimin organizativ të punëtorëve të kombit të shtypur me punëtorët e kombit shtypës. Pa këtë është e pamundur të mbrohet politika e pavarur e proletariatit dhe solidarësia e tij e klasës me proletariatin e vendeve të tjera në të gjitha dallaveret, tradhtitë dhe batakëllëqet e borgjezisë. Sepse borgjezia e kombeve të shtypura i shndërron vazhdimisht parullat e çlirimit kombëtar në mjet për t'i mashtruar punëtorët: në politikën e brendshme ajo i përdor këto parulla për të përfunduar marrëveshje reaksionare me borgjezinë e kombeve sunduese (p.sh. polakët në Austri dhe në Rusi, që hyjnë në marrëveshje me reaksionin për të shtypur çifutët dhe ukrainasit); në politikën e jashtme ajo përpiqet të përfundojë marrëveshje me njërin nga shtetet imperialiste konkurruese për të vënë në jetë qëllimet e veta grabitqare (politika e shteteve të vogla në Ballkan etj.).

Fakti se lufta për lirinë kombëtare kundër një shteti imperialist mund të shfrytëzohet, në disa kushte të caktuara, nga një shtet tjetër «i madh» po për qëllimet e veta imperialiste, — gjithashtu nuk mund ta detyrojë aspak socialdemokracinë që të heqë dorë nga njohja e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, po ashtu sikundër rastet e shumta të shfrytëzimit të

parullave republikane nga ana e borgjezisë me qëllim mashtrimi politik dhe grabitjeje financiare, p.sh., në vendet romane nuk mund t'i detyrojnë socialdemokratët që të heqin dorë nga republikanizmi i tyre*.

5. MARKSIZMI DHE PRUDONIZMI NË ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Në kundërshtim me demokratët mikroborgjezë, në të gjitha kërkësat demokratike pa përjashtim Marksi nuk shihte diçka absolute, por shprehjen historike të luftës së masave popullore të udhëhequra nga borgjezia kundër feudalizmit. Nuk ka asnjë nga këto kërkesa që të mos mund të shërbejë dhe të mos ketë shërbyer, në disa rrethana të caktuara, si vegël e borgjezisë për t'i gënjyer punëtorët. Të shkëputësh në këtë kuptim një nga kërkesat e demokracisë politike, pikërisht vetëvendosjen e kombeve, dhe ta vësh

* Është e tepërt ta thëmi se ta hedhësh poshtë të drejtën për vetëvendosje për të vetmen arsye se gjoja nga kjo kërkesë lind «mbrojtja e atdheut», do të ishte me të vërtetë gesharake. Po në këtë mënyrë — d.m.th. në mënyrë po kaq joserioze — socialshovinistët e vjetëve 1914-1916 i referohen çdo kërkesë të demokracisë (p.sh., republikanizmit të saj) dhe çdo formulimi të luftës kundër shtypjes kombëtare për të përlligjur «mbrojtjen e atdheut». Njohjen e mbrojtjes së atdheut në luftë, p.sh., në Revolucionin e madh francez ose në luftërat e Garibaldit, në Evropë, si dhe mohimin e mbrojtjes së atdheut në luftën imperialiste të vjetëve 1914-1916 marksizmi e nxjerr nga analiza e veçorive historike konkrete të çdo lufte të veçantë, dhe në asnjë mënyrë nuk e nxjerr nga ndonjë «parim i përgjithshëm», nga ndonjë pikë e veçantë e programit.

atë përballë kërkesave të tjera është rrënjësisht e gabuar nga pikëpamja teorike. Në praktikë proletariati mund ta ruajë pavarësinë e tij vetëm duke ia nënshtruar luftën e tij për të gjitha kërkesat demokratike, pa përjashtuar edhe republikën, luftës së tij revolucionare për përmbysjen e borgjezisë.

Nga ana tjetër, përballë prudonistëve, të cilët e «mohonin» çështjen kombëtare «në emër të revolucionit shoqëror», Marksi nxirrte në plan të parë, duke pasur parasysh para së gjithash interesat e luftës së klasës të proletariatit në vendet e përparuara, parimin themelor të internacionalizmit dhe të socializmit: nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë. Pikërisht nga pikëpamja e interesave të lëvizjes revolucionare të punëtorëve gjermanë Marksi pati kërkuar më 1848 që demokracia ngadhënjimtare e Gjermanisë të shpallte dhe të vinte në jetë lirinë e popujve, të shtypur nga gjermanët³⁴. Pikërisht nga pikëpamja e luftës revolucionare të punëtorëve anglezë Marksi kërkonte më 1869 shkëputjen e Irlandës nga Anglia dhe me këtë rast ai shtonte: «edhe sikur pas shkëputjes të arrihet në federatë». Vetëm duke formuluar këtë kërkesë Marksi i edukonte punëtorët anglezë me të vërtetë në frymën internacionaliste. Vetëm në këtë mënyrë ai mundi të vinte përballë oportunizmit dhe reformizmit borgjez, i cili edhe sot e kësaj dite, pasi kaloi gjysmë shekulli, nuk e zbatoi «reformën» në Irlandë, zgjidhjen revolucionare të kësaj detyre historike. Vetëm kështu Marksi mundi, në kundërshtim me mbrojtësit e kapitalit që ulërinin për utopinë dhe pamundësinë e realizimit të lirisë së shkëputjes së kombeve të vogla dhe për karakterin përparimtar jo vetëm të koncentrimit ekonomik, por edhe të koncentrimit politik, të mbronte karakterin përparimtar të këtij koncentrimi jo sipas mënyrës imperialiste, të mbronte afrimin e kombeve jo mbi bazën e dhunës, por të bashkimit të lirë të proletarë-

ve të të gjitha vendeve. Vetëm kështu Marksii mundi të vinte përballë njohjes me fjalë, dhe shumë herë hipokrite të barazisë dhe të vetëvendosjes së kombeve, veprimin revolucionar të masave edhe në fushën e zgjidhjes së çështjeve kombëtare. Lufta imperialiste e vjetëve 1914-1916 dhe stallat e Augiasit të hipokrizisë së oportunistëve dhe kautskianëve, që ajo zbuloi, vërtetuan konkretisht drejtësinë e kësaj politike të Marksit, e cila duhet të bëhet shembull për të gjitha vendet e përparuara, sepse sot secili prej tyre shtyp kombe të tjera*.

6. TRI TIPE VENDESH NË LIDHJE ME VETËVENDOSJEN E KOMBEVE

Duhet të dallojmë tri tipe kryesore vendesh nga kjo pikëpamje:

Së pari, vendet e përparuara kapitaliste të Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara. Lëvizjet kombëtare përparimtare-borgjeze këtu kanë mbaruar

* Disa njerëz shumë herë i referohen faktit, — p.sh., këto kohët e fundit shovinisti gjerman Lenç në Nr. 8 dhe 9 të revistës «Die Glocke» — se qëndrimi negativ që ka mbajtur Marksii ndaj lëvizjes kombëtare të disa popujve, p.sh. të çekëve më 1846, e hedh poshtë domosdoshmërinë e njohjes së vetëvendosjes së kombeve nga pikëpamja e marksizmit. Por kjo nuk është e vërtetë, sepse më 1848 ka pasur arsye historike dhe politike për të bërë një dallim midis kombeve «reaksiönare» dhe kombeve demokratiko-revolucionare. Marksii kishte të drejtë që i dënonte të parat dhe përkrahte të dytat³⁵. E drejta për vetëvendosje është një nga kërkesat e demokracisë,

prej kohësh. Secili nga këto kombe «të mëdha» shtyp kombe të tjera në kolonitë dhe në vendin e vet. Detyrat e proletariatit të kombeve sunduese këtu janë pikërisht po ato që ishin edhe në shekullin XIX në Angli për sa i përket Irlandës*.

Së dyti, lindja e Evropës: Austria, vendet ballkanike dhe sidomos Rusia. Pikërisht këtu shekulli XX i zhvilloi në mënyrë të veçantë lëvizjet kombëtare demokratiko-borgjeze dhe e ashpërsoi luftën kombëtare. Detyrat e proletariatit të këtyre vendeve, si në çështjen e përfundimit të transformimit të tyre demokratik-borgjez, ashtu edhe në çështjen e ndihmës që ai duhet t'i japë revolucionit socialist në vendet e tjera,

e cila, natyrisht, duhet t'u nënshtrohet interesave të përgjithshme të demokracisë. Më 1848 dhe në vjetët e mëvonshëm këto interesa të përgjithshme përbëheshin në radhë të parë nga lufta kundër carizmit.

* Në disa shtete të vogla, që nuk morën pjesë në luftën e vjetëve 1914-1916, p.sh., në Holandë, në Zvicër, borgjezia e shfrytëzon me zell parullën e «vetëvendosjes së kombeve» për ta përlligjur pjesëmarrjen në luftën imperialiste. Ky është një nga faktorët që i shtyn socialdemokratët e këtyre vendeve ta mohojnë vetëvendosjen. Politika proletare e drejtë, konkretisht: mohimi i «mbrojtjes së atdheut» në luftën imperialiste, mbrohet me argumente të gabuara. Në teori kemi një shtrembërim të marksizmit e në praktikë shfaqjen e njëfarë fryme ngushtësie të kombit të vogël, harrimin e *qindra milionë* njerëzve të kombeve të skllavëruara nga kombët «imperialiste». Shoku Gorter në broshurën e tij shumë të mirë: «Imperializmi, lufta dhe socialdemokracia» e mohon në mënyrë të gabuar parimin e vetëvendosjes së kombeve, por e zbaton drejt atë kur kërkon menjëherë «pavarësinë politike dhe kombëtare» të Indisë holandeze dhe demaskon oportunistët holandezë, të cilët nuk pranojnë të formulojnë një kërkesë të tillë dhe të luftojnë për të.

nuk mund të plotësohen pa e mbrojtur të drejtën e kombeve për vetëvendosje. Këtu veçanërisht e vësh-tirë dhe veçanërisht e rëndësishme është detyra e shkrirjes së luftës së klasës të punëtorëve të kombeve shtypëse dhe të punëtorëve të kombeve të shtypura.

Së treti, vendet gjysmëkoloniale, si Kina, Persia, Turqia dhe të gjitha kolonitë, së bashku kanë afër një miliard popullsi. Këtu lëvizjet demokratiko-bor-gjeze pjesërisht sapo fillojnë, pjesërisht janë ende larg nga përfundimi i tyre. Socialistët duhet jo vetëm të kërkojnë çlirimin e menjëhershëm pa kushte dhe pa shpërblim të kolonive, — dhe kjo kërkesë në shprehjen e saj politike nuk do të thotë tjetër veçse pikërisht njohje e së drejtës për vetëvendosje; socia-listët duhet t'i përkrahin me vendosmërinë më të madhe elementët më revolucionarë të lëvizjeve na-cional-çlirimtare demokratiko-borgjeze në këto vende dhe të ndihmojnë kryengritjen e tyre, — dhe në rast nevojë edhe luftën e tyre revolucionare — kundër shteteve imperialiste që i shtypin.

7. SOCIALSHOVINIZMI DHE VETËVENDOSJA E KOMBEVE

Epoka imperialiste dhe lufta e vjetëve 1914-1916 e shtruan në mënyrë të veçantë detyrën e luftës kun-dër shovinizmit dhe nacionalizmit në vendet e përpa-ruara. Për gështjen e vetëvendosjes së kombeve ka dy nuanca kryesore midis socialshovinistëve, d.m.th. opor-tunistëve dhe kautskianëve, të cilët mundohen ta lus-trojnë luftën reaksionare, imperialiste, duke zbatuar për të nocionin e «mbrojtjes së atdheut».

Nga njëra anë kemi të bëjmë me shërbëtorë mjaft të sinqertë të borgjezisë, që mbrojnë aneksimet në

mër të tezës se imperializmi dhe koncentrimi politik kanë karakter përparimtar, dhe mohojnë të drejtën e gjoja utopike, iluzore, mikroborgjeze etj. për vetëvendosje. Këtu hyjnë: Kunovi, Parvusi dhe oportunistët ekstremë në Gjermani, një pjesë e fabianëve dhe e adhéheqësve të tredunioneve në Angli, oportunistët në Rusi: Semkovski, Libmani, Jurkeviçi etj.

Nga ana tjetër shohim kautskianët, në radhët e të cilëve bëjnë pjesë gjithashtu Vanderveleja, Renoueli dhe shumë pacifistë të Anglisë e të Francës etj. Ata kërkojnë unitetin me të parët dhe në praktikë përputhen plotësisht me ta duke e mbrojtur të drejtën për vetëvendosje vetëm me fjalë dhe në mënyrë hipokrite; ata e quajnë «të tepruar» («zu viel verlangt»: Kautsky në «Neue Zeit»* të 21-majit 1915) kërkesën e lirisë së shkëputjes politike, ata nuk mbrojnë domosdoshmërinë e një taktike revolucionare për socialistët pikërisht të kombeve shtypëse, por, përkundrazi, i errësojnë detyrat e tyre revolucionare, e përlligjin oportunizmin e tyre, ua lehtësojnë mashtrimin e popullit, lënë në heshtje pikërisht çështjen e kufijve, të shtetit, i cili mban me dhunë në përbërjen e vet kombe që nuk gëzojnë të drejta të barabarta, etj.

Si të parët ashtu edhe të dytët janë njëloj oportunistë, të cilët e prostituojnë marksizmin dhe kanë humbur çdo aftësi për ta kuptuar vlerën teorike dhe rëndësinë praktike të taktikës së Marksit, të cilën ai e shpjegoi duke marrë si shembull Irlandën.

Për sa u përket në mënyrë të veçantë aneksimeve, kjo çështje është bërë veçanërisht aktuale në lidhje me luftën. Por ç'është aneksimi? Mund të bindemi me lehtësi se protestat kundër aneksimeve ose kufizohen me njohjen e vetëvendosjes së kombeve, ose mbështeten në frazeologjinë pacifiste, që mbron status quo-në dhe që është armike e çdo dhune, edhe

* — Kautski në «Kohët e reja». Red.

e dhunës revolucionare. Një frazeologji e tillë është fund e krye e rreme dhe e papajtueshme me marksizmin.

8. DETYRAT KONKRETE TË PROLETARIATIT NË TË ARDHMEN MË TË AFËRT

Revolucioni socialist mund të fillojë në një të ardhme fare të afërt. Në këtë rast përpara proletariatit do të shtrohet detyra imediate e marrjes së pushtetit, e shpronësimit të bankave dhe e zbatimit të masave të tjera të diktaturës. Borgjezia — dhe sidomos inteligjencia e tipit të fabianëve dhe kautskianëve — do të mundohet në këtë rast ta copëtojë dhe ta pengojë revolucionin, duke i imponuar qëllime të kufizuara, demokratike. Në qoftë se të gjitha kërkesat thjesht demokratike mund të bëhen, me kusht që të ketë filluar sulmi i proletarëve kundër bazave të pushtetit të borgjezisë, deri diku pengesë për revolucionin, atëherë domosdoshmëria për ta shpallur dhe për ta vënë në jetë lirinë e gjithë popujve të shtypur (d.m.th. të drejtën e tyre për vetëvendosje) do të jetë po aq jetësore në revolucionin socialist, siç ka qenë jetësore për fitoren e revolucionit demokratiko-borgjez, p.sh. më 1848 në Gjermani ose më 1905 në Rusi.

Por ka mundësi që para se të fillojë revolucionin socialist të kalojnë 5, 10 e më shumë vjet. Në rendin e ditës do të vihet edukimi revolucionar i masave në një frymë të tillë që të bëhet e pamundur që shovinistët dhe oportunistët socialistë të bëjnë pjesë në partinë punëtore dhe që të fitojnë, ashtu siç fituan më 1914-1916. Socialistët duhet t'u shpjegojnë masave

se socialistët anglezë, që nuk kërkojnë lirinë e shkëputjes për kolonitë dhe për Irlandën, — socialistët gjermanë, që nuk kërkojnë lirinë e shkëputjes për kolonitë, për banorët e Alzasës, për danezët, për polakët, që nuk e shtrijnë drejtpërsëdrejti propagandën revolucionare dhe veprimin revolucionar në masë edhe mbi fushën e luftës kundër shtypjes kombëtare, që nuk i shfrytëzojnë të tilla incidente si ai i Cabernit për të bërë një propagandë sa më të gjerë ilegale në radhët e proletariatit të kombit shtypës, për të organizuar demonstrata në rrugë dhe veprime revolucionare masive, — socialistët rusë, që nuk kërkojnë lirinë e shkëputjes për Finlandën, Poloninë, Ukrainën, etj. etj., — se këta socialistë veprojnë si shovinistë, si shërbëtorë të monarkive imperialiste dhe të borgjezisë imperia-
liste që e kanë mbuluar veten me gjak e me llum.

9. QËNDRIMI I SOCIALDEMOKRACISË RUSE E POLONEZË DHE I INTERNACIONALES II NDAJ VETËVENDOSJES

Mosmarrëveshjet ndërmjet socialdemokratëve revolucionarë të Ruisë dhe socialdemokratëve polonezë për çështjen e vetëvendosjes dolën në shesh qysh më 1903, në kongresin që pranoi programin e PPSDR-së dhe që, pa marrë parasysh protestën e delegacionit të socialdemokratëve polonezë, përfshiu në këtë program § 9, i cili njeh të drejtën e kombeve për vetëvendosje. Qysh atëherë socialdemokratët polonezë nuk i kanë përsëritur asnjëherë, në emër të partisë së tyre, propozimet për ta hequr nga programi i partisë sonë § 9 ose për ta zëvendësuar atë me ndonjë formulë tjetër.

Në Rusi, ku kombet e shtypura përbëjnë jo më pak se 57% të popullsisë, më shumë se 100 milionë njerëz, — ku këto kombe banojnë kryesisht në krahina periferike, — ku një pjesë e këtyre kombeve është më e kulturuar se rusomëdhenjtë, — ku rendi politik dallohet për karakterin e tij veçanërisht barbar dhe mesjetar, — ku nuk është përfunduar ende revolucioni demokratiko-borgjez, — në Rusi njohja e së drejtës për t'u shkëputur lirisht nga Rusia për kombet e shtypura nga carizmi është patjetër e domosdoshme për socialdemokratët në emër të detyrave të tyre demokratike dhe socialiste. Partia jonë, e rimëkëmbur në janar 1912, më 1913 pranoi një rezolucion,* i cili konfirmon të drejtën për vetëvendosje dhe e shpjegon atë pikërisht në atë kuptim konkret që treguam më sipër. Bakanalja e shovinizmit rusomadh në vjetët 1914-1916 si në radhët e borgjezisë, ashtu edhe në radhët e socialistëve oportunistë (Rubanoviç, Plehanov, «Nashe Djello», etj.) na nxit edhe më tepër që të ngulim këmbë te kjo kërkesë dhe të pranojmë se ata që mohojnë atë në praktikë përkrahin shovinizmin rusomadh dhe carizmin. Partia jonë deklaroi se ajo hedh poshtë me vendosmërinë më të madhe çdo përgjegjësi për një veprim të tillë kundër së drejtës së vetëvendosjes.

Në formulimin më të ri të qëndrimit të socialdemokracisë poloneze për çështjen kombëtare (deklarata e socialdemokracisë poloneze në Konferencën e Cimervaldit) gjejmë këto ide:

Deklarata damkos qeverinë gjermane dhe qeveritë e tjera, të cilat i shikojnë «krahinat poloneze» si një garanci në lojën e ardhshme të kompensimeve, «duke ia mohuar popullit polonez mundësinë që të vendosë vetë fatin e tij». «Socialdemokracia poloneze

* Rezolucioni është botuar në Veprat, bot. shqip, vëll. 19, f. 489-491. Red.

proteston me vendosmëri dhe në mënyrë solemne kundër ndarjes së re dhe copëtimit në pjesë të një vendi të tërë». . . Ajo i dënon socialistët, të cilët e lanë në duart e Hohencolernëve. . . «çështjen e çlirimit të popujve të shtypur». Ajo shpreh bindjen se vetëm pjesëmarrja e proletariatit revolucionar ndërkombëtar në këtë luftë të ardhshme, në luftën për socializmin, «do t'i këputë vargonjtë e shtypjes kombëtare dhe do të zhdukë çdo formë sundimi të huaj, do t'i sigurojë popullit polonez mundësinë e një zhvillimi të lirë e të gjithanshëm si pjesëtar me të drejta të barabarta i aleancës së popujve». Deklarata e cilëson luftën «për polonezët» «dy herë vëllavrasëse». (Buletini i Komisionit Socialist Internacional, Nr. 2, 27.IX.1915, f. 15; përkthyer rusisht në përmbledhjen e materialeve «Internacionalja dhe lufta», f. 97.)

Këto teza, në thelb, nuk kanë asnjë ndryshim me njohjen e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, vetëm se janë formula politike edhe më të mjeçullta dhe gjysmakte sesa shumica e programeve dhe rezolucioneve të Internacionales II. Çdo orvatje për t'i shprehur këto ide në formula politike të sakta dhe për ta përcaktuar mundësinë e zbatimit të tyre në rendin kapitalist ose vetëm në rendin socialist do të tregojë edhe më qartë se sa i gabuar është mohimi i vetëvendosjes së kombeve nga socialdemokratët polonezë.

Vendimi i Kongresit Ndërkombëtar të Londrës të 1896-s, që njeh vetëvendosjen e kombeve, duhet të plotësohet, mbi bazën e tezave të paraqitura më lart, duke vënë në dukje 1) rëndësinë e veçantë që ka kjo kërkesë në kushtet e imperializmit, 2) karakterin politik konvencional dhe përmbajtjen klasore të të gjitha kërkesave të demokracisë politike, duke përfshirë edhe kërkesën në fjalë, 3) domosdoshmërinë që të bëhet një dallim midis detyrave konkrete të socialdemokratëve të kombeve shtypëse dhe të so-

cialdemokratëve të kombeve të shtypura, 4) njohjen jokonsekuente të vetëvendosjes vetëm me fjalë dhe, për këtë arsye, hipokrite për sa i përket vlerës së saj politike, nga oportunistët dhe kautskianët, 5) faktin se pozita e socialdemokratëve, sidomos e shteteve imperialiste (rusomëdhenjtë, anglo-amerikanët, gjermanët, francezët, italianët, japonezët etj.), të cilët nuk e mbrojnë lirinë e shkëputjes së kolonive dhe të kombeve të shtypura nga kombet «e tyre», praktikisht përputhet me atë të shovinistëve, 6) domosdoshmërinë që lufta për këtë kërkesë, ashtu si edhe për të gjitha kërkesat rrënjësore të demokracisë politike, t'i nënshtrohet luftës së drejtpërdrejtë revolucionare të masave për përmbysjen e qeverive borgjeze dhe për vendosjen e socializmit.

Zbatimi në Internacionale i pikëpamjes së disa kombeve të vogla e veçanërisht i socialdemokratëve polonezë, lufta e të cilëve kundër borgjezisë poloneze, që e mashtron popullin me parulla nacionaliste, i ka bërë ata sa të mohojnë pa të drejtë vetëvendosjen, do të ishte një gabim teorik, një zëvendësim i marksizmit me prudonizmin, dhe në praktikë do të thoshte të përkrahje padashur shovinizmin dhe oportunizmin më të rrezikshëm të kombeve imperialiste.

*Redaksia e «Social-Demokratit»,
Organ Qendror i PPSDR-së*

*Shkruar në janar-shkurt
1916*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 22,
f. 170-187*

Nga artikulli:

«PËR BROSHURËN E JUNIUSIT»

I pari nga propozimet e gabuara të Juniusit përmbledhet në tezën 5 të grupit «Internacional»:... «Në epokën (erën) e këtij imperializmi të shfrenuar nuk mund të ketë asnjë luftë kombëtare. Interesat kombëtare shërbejnë vetëm si mjet mashtrimi për t'i vënë masat punonjëse të popullit në shërbim të armikut të tyre për vdekje: imperializmit...» Fillimi i tezës 5, që mbaron me këto fjalë, i kushtohet përkufizimit të luftës së *sotme*, si luftë imperialiste. Ka të ngjarë që mohimi i luftërave kombëtare në përgjithësi të jetë shkaktuar ose nga një pakujdesi ose të jetë një teprim i rastit, megjithëse nënvizohet mendimi shumë i drejtë se lufta e *sotme* është luftë imperialiste, e jo kombëtare. Por pasi mund të jetë edhe e kundërta, derisa gabimin e mohimit të çdo lufte kombëtare në lidhje me paraqitjen e gabuar të luftës së *sotme*, si luftë kombëtare, e bëjnë shumë socialdemokratë, nuk mund të mos ndalemi mbi këtë gabim.

Juniusi ka plotësisht të drejtë kur nënvizon ndi-

kimin vendimtar të «kushteve imperialiste» në luftën e sotme, kur thotë se prapa Serbisë qëndron Rusia, «prapa nacionalizmit serb qëndron imperializmi rus», se, p.sh., pjesëmarrja e Holandës në luftë do të kishte qenë gjithashtu imperialiste, sepse ajo, së pari, do të mbronte në këtë mënyrë kolonitë e veta, dhe, së dyti, do të bëhej aleate e njërit nga koalicionet imperialiste. Kjo është e padiskutueshme për luftën e sotme. Dhe kur Juniusi nënvizon me këtë rast në mënyrë të veçantë atë që ka rëndësi në radhë të parë për të: luftën kundër «fantazmës së luftës kombëtare», «e cila sundon sot mbi politikën socialdemokrate» (f. 81), nuk mund të mos themi se arsyetimet e tij janë të drejta dhe krejt me vend.

Veçse do të ishte gabim teprimi i kësaj së vërtete, largimi nga kërkesa marksiste për të qenë konkret, shtrirja e vlerësimit të luftës së sotme mbi të gjitha luftërat që mund të ekzistojnë në kohën e imperializmit, harrimi i lëvizjeve kombëtare kundër imperializmit. I vetmi argument në mbrojtje të tezës që thotë se «luftëra kombëtare nuk mund të ketë më» është argumenti se bota është ndarë ndërmjet një grushti shtetesh imperialiste «të mëdha», se për këtë arsye çdo luftë, edhe sikur në fillim të jetë kombëtare, shndërrohet në luftë imperialiste, duke prekur interesat e njërit nga shtetet imperialiste ose koalicionet (f. 81 e broshurës së Juniusit).

Menjëherë duket se sa i gabuar është ky argument. Sigurisht, teza themelore e dialektikës marksiste është se çdo kufi në natyrë dhe në shoqëri është konvencional dhe mund të ndryshojë, se nuk ka asnjë dukuri që, në kushte të caktuara, të mos mund të shndërrohet në të kundërtën e saj. Lufta kombëtare mund të shndërrohet në luftë imperialiste dhe anasjelltas. Shembull: luftërat e Revolucionit të madh francez filluan si luftëra kombëtare dhe ishin të tilla. Këto luftëra ishin revolucionare: mbrojtja e Revolu-

cionit të madh kundër koalicionit të monarkive kundërrevolucionare. Por kur Napoleoni krijoi Perandorinë Franceze dhe skllavëroi një varg të tërë shtetesh kombëtare të mëdha, me vitalitet dhe të formuara prej kohësh të Evropës, atëherë luftërat kombëtare franceze u shndërruan në luftëra imperialiste, të cilat çuan nga ana tjetër në luftërat nacionalçlirimtare kundër imperializmit të Napoleonit.

Vetëm një sofist do të mund ta mohonte ndryshimin ndërmjet luftës imperialiste dhe luftës kombëtare duke u mbështetur në faktin se ajo mund të shndërrohet nga imperialiste në kombëtare ose anasjelltas. Dialektika ka shërbyer shumë herë — edhe në historinë e filozofisë greke — si urëz për të kaluar në sofistikë. Mirëpo në mbetemi dialektikë dhe luftojmë kundër sofizmave jo duke mohuar mundësinë e çdo shndërrimi në përgjithësi, por duke analizuar konkretisht atë që është dhënë në kushtet dhe në zhvillimin e saj.

Që lufta e sotme imperialiste, lufta e vjetëve 1914-1916, do të shndërrohet në luftë kombëtare, për këtë ka shumë pak mundësi, sepse klasa që përfaqëson procesin e zhvillimit që shkon përpara është proletariati, i cili objektivisht synon ta shndërrojë atë në luftë civile kundër borgjezisë, e pastaj edhe sepse forcat e të dy koalicioneve nuk kanë ndonjë ndryshim të madh midis tyre dhe kapitali financiar ndërkombëtar ka krijuar kudo një borgjezi reaksionare. Por nuk mund ta shpallim të pamundur këtë shndërrim sikur proletariati i Evropës të tregohet për nja 20 vjet i pafuqishëm; sikur lufta e sotme të përfundonte me fitore si ato të Napoleonit dhe me skllavërimin e një vargu shtetesh kombëtare me vitalitet; sikur imperializmi joevropian (japonez dhe amerikan në radhë të parë) të vazhonte edhe ai për nja 20 vjet, pa u shndërruar në socializëm, p.sh., për shkak të një lufte japono-amerikane, atëherë do të ishte e

mundur një luftë e madhe kombëtare në Evropë. Ky do të ishte një zhvillim që do ta çonte Evropën disa dhjetëra vjet prapa. Kjo është e pabesueshme. Por *nuk* është e pamundur, sepse nuk është dialektike, nuk është shkencore dhe nuk është teorikisht e drejtë ta përfytyrosh historinë botërore si një proces që shkon përpara në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa, pa bërë ndonjëherë kërcime të mëdha prapa.

Më tej. Në kohën e imperializmit luftërat kombëtare të kolonive dhe gjysmëkolonive janë jo vetëm të mundshme, por edhe të *pashmangshme*. Në kolonitë dhe gjysmëkolonitë (Kinë, Turqi, Persi) jetojnë rreth 1 miliard njerëz, d.m.th. *më shumë se gjysma* e popullsisë së botës. Lëvizjet nacionalçlirimtare atje ose janë qysh tani shumë të forta, ose po rriten dhe po pihen. Çdo luftë është vazhdimi i politikës me mjete të tjera. Vazhdimi i politikës nacionalçlirimtare në kolonitë do të jenë *patjetër* luftërat kombëtare të tyre kundër imperializmit. Këto luftëra mund të çojnë në një luftë imperialiste midis shteteve imperialiste «të mëdha» të sotme, por mund edhe të mos çojnë, kjo varet nga shumë rrethana.

Shembull: Anglia dhe Franca bënë luftën shtatëvjeçare për shkak të kolonive, d.m.th. bënë një luftë imperialiste (e cila është e mundshme edhe mbi bazën e skllavërisë edhe mbi bazën e kapitalizmit primitiv, ashtu si edhe mbi bazën e sotme të kapitalizmit, që ka arritur një shkallë të lartë zhvillimi). Franca u mund dhe humbi një pjesë të kolonive të saj. Pas disa vjetësh fillon lufta nacionalçlirimtare e Shteteve të Amerikës Veriore kundër Anglisë. Franca dhe Spanja, të cilat vazhdojnë të zotërojnë disa pjesë të Shteteve të Bashkuara të sotme, të shtyra nga armiqësia me Anglinë, d.m.th. nga interesat e tyre imperialiste, përfundojnë një traktat miqësie me Shtetet e Bashkuara që janë ngritur kundër Anglisë. Trupat franceze bashkë me trupat amerikane luf-

tojnë kundër anglezëve. Këtu kemi të bëjmë me një luftë nacionalçlirimtare, në të cilën gara ndërmjet shteteve imperialiste është element i dorës së dytë e që nuk ka ndonjë rëndësi serioze, — është e kundërta e asaj që shohim në luftën e vjetëve 1914-1916 (elementi kombëtar në luftën austro-serbe nuk ka rëndësi serioze në krahasim me garën ndërmjet shteteve imperialiste, e cila është ajo që përcakton çdo gjë). Së këtejmi shihet sa pa kuptim do të ishte po ta zbatonim nocionin e imperializmit në mënyrë stereotipike, duke nxjerrë prej tij përfundimin se luftërat kombëtare «janë të pamundura». Një luftë nacionalçlirimtare, p.sh., e bashkimit të Persisë, Indisë dhe Kinës kundër këtyre ose atyre shteteve imperialiste, është krejt e mundshme, sepse ajo buron nga lëvizja nacionalçlirimtare e këtyre vendeve dhe shndërrimi i një lufte të tillë në luftë imperialiste ndërmjet shteteve imperialiste të sotme do të varej nga shumë rrethana konkrete, dhe do të ishte qesharake të siguronin se këto rrethana do të vërtetoheshin.

Së treti, as në Evropë nuk mund të themi se luftërat kombëtare në epokën e imperializmit janë të pamundura. «Epoka e imperializmit» luftën e sotme e bëri imperialiste, ajo lind në mënyrë të pashmangshme (derisa të mos vijë socializmi) luftëra të reja imperialiste, ajo e bëri fund e krye imperialiste politiken e shteteve të mëdha të sotme, por kjo «epokë» nuk i përjashton aspak luftërat kombëtare, p.sh., të shteteve të vogla (ta zëmë, të aneksuara ose që vuajnë nga shtypja kombëtare) kundër shteteve imperialiste, po ashtu sikundër ajo nuk i përjashton as lëvizjet kombëtare në shkallë të gjerë në lindje të Evropës. Për Austrinë, p.sh., Juniusi arsyeton shumë drejt, duke pasur parasysh jo vetëm anën «ekonomike», por edhe anën specifike politike, duke vënë në dukje «mungesën e vitalitetit të brendshëm të Austrisë», duke vërejtur se «monarkia e Habsburgëve

nuk është një organizatë politike e një shteti borgjez, por vetëm një sindikat me lidhje të dobëta i disa klikave parazitësh shoqërorë», dhe se «likuidimi i Austro-Hungarisë historikisht nuk është veçse vazhdimi i shpërbërjes së Turqisë dhe bashkë me të një kërkesë e procesit historik të zhvillimit». Nuk është më e mirë as gjendja e disa shteteve ballkanike dhe ajo e Rusisë. Dhe në qoftë se shtetet «e mëdha» rraskapiten shumë në luftën e sotme ose në qoftë se në Rusi fiton revolucioni, luftërat kombëtare janë krejt të mundshme, dhe madje mund edhe të fitojnë. Jo në të gjitha kushtet është praktikisht e realizueshme ndërhyrja e shteteve imperialiste, kjo nga njëra anë. E nga ana tjetër, kur arsyetojnë «në tym» se lufta e një shteti të vogël kundër një shteti vigan është e pashpresë, për këtë duhet të vërejmë se edhe lufta e pashpresë është gjithashtu luftë; veç asaj, disa dukuri në këto shtete «vigate» — p.sh., fillimi i revolucionit — luftën «e pashpresë» — mund ta bëjnë shumë «me shpresë».

U ndalëm me hollësi te karakteri i gabuar i tezës se gjoja «nuk mund të ketë më luftëra kombëtare» jo vetëm sepse ajo është krejt e gabuar nga pikëpamja teorike. Sigurisht, do të ishte shumë e vajtueshme sikur «të majtët» të tregoheshin mospërfillës për teorinë e marksizmit në një kohë kur Internacionalja III mund të krijohet vetëm mbi bazën e një marksizmi të pavulgarizuar. Por ky gabim është shumë i dëmshëm edhe nga pikëpamja politike praktike: nga kjo tezë e gabuar nxirret propaganda pa kuptim e «çarmatimit», sepse gjoja tani, përveç luftërave reaksionare, nuk mund të ketë më asnjë luftë tjetër, së këtejmi nxjerrin edhe mospërfilljen edhe më pa kuptim dhe krejt reaksionare për lëvizjet kombëtare. Kjo mospërfillje bëhet shovinizëm kur pjesëtarët e kombeve «të mëdha» evropiane, d.m.th. të kombeve që shtypin një shumicë popujsh të vegjël

dhe koloniale, deklarojnë me një pamje gjoja shkencore: «luftëra kombëtare nuk mund të ketë më»! Luftërat kombëtare kundër shteteve imperialiste jo vetëm që janë të mundshme, por janë edhe të pashmangshme dhe përparimtare, revolucionare, megjithëse, sigurisht, që ato të kenë sukses, duhet ose të bashkohen përpjekjet e një numri të madh banorësh të vendeve të shtypura (qindra milionë njerëzve në rastin e Indisë dhe të Kinës që përmendëm më sipër), ose të ketë një gërshetim veçanërisht të favorshëm të kushteve të gjendjes ndërkombëtare (p.sh., të jetë paralizuar mundësia e ndërhyrjes së shteteve imperialiste për shkak të dobësimit të tyre, të luftës ndërmjet tyre, të antagonizmit ndërmjet tyre etj.), ose të shpërthejë në të njëjtën kohë kryengritja e proletariatit të njerit nga shtetet e mëdha kundër borgjezisë (ky rast, të cilin ne e kemi vënë si të fundit, është i pari nga pikëpamja e asaj që duhet për fitoren e proletariatit).

Por duhet të vërejmë se do të ishte e padrejtë po ta akuzonim Juniusin për mospërfillje ndaj lëvizjeve kombëtare. Të paktën, në vargun e mëkateve të fraksionit socialdemokrat ai përmend heshtjen e tij për dënimin me vdekje për «tradhti» (sigurisht, për një orvatje kryengritjeje në lidhje me luftën) të një udhëheqësi të vendasve të Kamerunit, duke nënvizuar në një vend tjetër në mënyrë të veçantë (për zotërinjtë Leginë, Lençë dhe maskarenjtë e tjerë që e quajnë veten «socialdemokratë») se edhe kombet koloniale janë kombe. Ai deklaroi me vendosmërinë më të madhe: «socializmi i njeh çdo popull të drejtën për të qenë i pavarur dhe i lirë, për ta vendosur vetë fatin e tij»; «socializmi ndërkombëtar njeh të drejtën e kombeve të lira, të pavarura dhe të barabarta, por vetëm ai mund t'i krijojë këto kombe, vetëm ai mund ta vërë në jetë të drejtën e kombeve për vetëvendosje. Dhe kjo parullë e socializmit —

vëren me të drejtë autori — shërben, ashtu si edhe të gjitha parullat e tjera, jo për të përligjur gjendjen ekzistuese, por si udhërrëfyes, si nxitje për një politikë revolucionare, transformuese dhe aktive të proletariatit» (f. 77 dhe 78). Si pasojë, do të gabonin rëndë ata që do të mendonin se gjithë socialdemokratët e majtë gjermanë kanë rënë në atë ngushtësi dhe karikaturë të marksizmit, në të cilën kanë rënë disa socialdemokratë holandezë dhe polonezë duke mohuar vetëvendosjen e kombeve edhe në socializëm. Por për burimet *posaçërisht* holandeze dhe poloneze të *këtij* gabimi do të flasim në një vend tjetër.

Arsyetimi tjetër i gabuar i Juniusit është për çështjen e mbrojtjes së atdheut. Kjo është një çështje politike kardinale në kohën e luftës imperialiste. Dhe Juniusi e përforcoi bindjen tonë se partia jonë dha të vetmin formulim të drejtë të kësaj çështjeje: proletariati është kundër mbrojtjes së atdheut në këtë luftë imperialiste *për shkak* të karakterit të saj grabitqar, *skllavërues* dhe reaksionar, *për shkak* të mundësisë dhe të domosdoshmërisë që përballë saj të vihet lufta civile për socializmin (dhe të bëhen përpjekje për ta shndërruar atë në luftë të tillë). Mirëpo Juniusi, ndërsa nga njëra anë e zbuloi shumë mirë karakterin imperialist të luftës së sotme ndryshe nga lufta kombëtare, nga ana tjetër, ra në një gabim jashtëzakonisht të çuditshëm, duke u munduar ta zbatojë me zor programin kombëtar në lidhje me luftën e sotme, jo kombëtare! Duket pothuajse e pabesueshme, por është fakt.

Shkruar në korrik 1916

Veprat, bot. shqip, vëll. 22,
f. 375-382

Nga artikulli:

«PËR KARIKATURËN E MARKSIZMIT DHE PËR «EKONOMIZMIN IMPERIALIST»»

... Në luftën e sotme imperialiste, që është lindur nga të gjitha kushtet e epokës imperialiste, d.m.th. që nuk shpërtheu rastësisht, që nuk është një përjash-tim, që nuk është një largim nga e përgjithshmja dhe tipikja, frazat për mbrojtjen e atdheut janë mashtrim i popullit, sepse kjo luftë *nuk është kombëtare*. Në luftën *me të vërtetë kombëtare* fjalët «mbrojtja e atdheut» nuk janë *aspak* gënjeshtër dhe *ne nuk jemi aspak kundër saj*. Të tilla luftëra (me të vërtetë komi-bëtare) ka pasur «sidomos» në vjetët 1789-1871, dhe rezolucioni, pa thënë asnjë fjalë për ta mohuar mundësinë e tyre edhe sot, shpjegon se si duhet dalluar lufta me të vërtetë kombëtare nga lufta imperialiste, e maskuar me parulla kombëtare të rreme. Dhe për ta bërë këtë dallim duhet parë nëse «baza» e saj përbëhet nga «një proces i gjatë lëvizjesh kombëtare në masë», «përmbysjeje të shtypjes kombëtare». Në rezolucionin për «pacifizmin» thuhet qartë: «socialde-mokratët nuk mund ta mohojnë rëndësinë pozitive të

luftërave revolucionare, d.m.th. joimperialiste, por të atyre që janë bërë, për shembull» (vini re këtë: «për shembull»), «prej 1789-s gjer më 1871 për përmbysjen e zgjedhës kombëtare»...» A është e mundur që rezolucioni i partisë sonë të fliste më 1915-për luftërat kombëtare, shembuj të të cilave kemi pasur në vjetët 1789-1871, dhe të thoshte se ne nuk e mohojmë rolin pozitiv të këtyre luftërave, sikur këto luftëra të mos quheshin të mundshme edhe sot? Është e qartë se jo.

Një koment për rezolucionet e partisë sonë, d.m.th. një shpjegim popullor i tyre, është broshura e Leninit dhe Zinovievit: «Socializmi dhe lufta». Në këtë broshurë në f. 5 është shkruar troç dhe qartë se «socialistët e kanë njohur dhe e njohin edhe sot karakterin e ligjshëm, përparimtar dhe të drejtën e mbrojtjes së atdheut ose të luftës mbrojtëse» *vetëm* kur është fjala për «përmbysjen e një zgjedhe kombëtare të huaj». Jepet një shembull, Persia kundër Rusisë «*et j.*» dhe thuhet: «Këto do të ishin luftëra të drejta, mbrojtëse pavarësisht se kush sulmoi i pari, dhe çdo socialist do ta simpatizonte fitoren e shteteve të shtypura, të varura, të pabarabarta kundër fuqive «të mëdha» shtypëse, skllavopronare, grabitqare»**.

Kjo broshurë doli në gusht 1915 gjermanisht dhe frëngjisht. P. Kievski e njeh fare mirë atë. As P. Kievski as ndokush tjetër në përgjithësi nuk na kanë kundërshtuar asnjëherë as për rezolucionin mbi mbrojtjen e atdheut, as për rezolucionin mbi pacifizmin, as për shpjegimin e këtyre rezolucioneve në këtë broshurë, asnjëherë! Lind pyetja, a shpifim ne kundër P. Kievskit kur themi se ai nuk e ka kuptuar fare marksizmin, në qoftë se ky shkrimtar, i cili që prej marsit 1915 nuk ka bërë asnjë vërejtje kundër pikëpamjeve të partisë sonë në lidhje me luftën, —

* Shih Veprat, bot. shqip, vëll. 21, f. 166. Red.

** Shih Veprat, bot. shqip, vëll. 21, f. 325. Red.

sot, në gusht të vitit 1916, në një artikull për vetëvendosjen, d.m.th. në një artikull që trajton gjoja një çështje të veçantë, tregon një moskuptim të çuditshëm të çështjes së *përgjithshme*?

P. Kievski parullën e mbrojtjes së atdheut e quan «tradhtare». Ne mund ta sigurojmë atë pa frikë se çdo parullë është dhe do të jetë gjithnjë «tradhtare» për ata që do ta përsëritin atë në mënyrë mekanike, pa e kuptuar thelbin e saj, pa u thelluar në çështjen, duke u kufizuar vetëm të mësojnë disa fjalë përmendsh pa bërë një analizë të kuptimit të tyre.

Ç'është «mbrojtja e atdheut» në përgjithësi? A është ky ndonjë nocion shkencor nga fusha e ekonomisë ose e politikës etj.? Jo. Kjo është vetëm e vetëm një shprehje shumë e përhapur, e zakonshme, disa herë thjesht filistine për të *përligjur luftën*. Asgjë më shumë, asnjë fije më shumë! «Tradhtia» mund të hyjë këtu vetëm në atë kuptim se filistinët mund të përligjin çdo luftë duke thënë: «ne mbrojmë atdheun», kurse marksizmi, i cili nuk e ul veten deri te filisteizmi, kërkon një analizë historike të çdo lufte të veçantë për ta gjetur nëse *kjo* luftë mund të quhet përparimtare, nëse ajo u shërben interesave të demokracisë ose të proletariatit dhe nëse ajo është *në këtë kuptim* e ligjshme, e drejtë etj.

Parulla e mbrojtjes së atdheut është një përligje fund e krye filistine dhe e pandërgjegjshme e luftës dhe tregon pazotësinë për të bërë një analizë historike të rolit dhe të kuptimit të çdo lufte të veçantë.

Marksizmi e bën këtë analizë dhe thotë: *në goftë* se «thelbi i vërtetë» i luftës është, për shembull, përmbysja e një shtypjeje kombëtare të huaj (që është *veçanërisht* tipike për Evropën e vjetërve 1789-1871), atëherë lufta është përparimtare nga ana e shtetit ose e kombit të shtypur. Në *goftë* se «thelbi i vërtetë» i luftës është ndarja e re e kolonive, ndarja e plaçkës, grabitja e tokave të huaja (e tillë është

lufta e vjetëve 1914-1916), — atëherë fraza për mbrojtjen e atdheut është «fund e krye një mashtrim i popullit».

Si mund të gjendet «thelbi i vërtetë» i luftës, si mund të përcaktohet ai? Lufta është vazhdim i politikës. Duhet studiuar politika e paraluftës, politikë që çon dhe ka çuar në luftë. Në qoftë se kjo politikë ka qenë imperialiste, d.m.th. në qoftë se ajo ka mbrojtur interesat e kapitalit financiar, ka grabitur dhe shtypur kolonitë dhe vendet e huaja, atëherë edhe lufta që lindi nga kjo politikë është luftë imperialiste. Në qoftë se kjo politikë ka qenë nacionalçlirimtare, d.m.th. në qoftë se ajo ka qenë një shprehje e lëvizjes së masave kundër shtypjes kombëtare, atëherë edhe lufta që lindi nga kjo politikë është luftë nacionalçlirimtare.

Filistini nuk e kupton se lufta është «vazhdim i politikës» dhe prandaj kufizohet të thotë se «armiku sulmoi», «armiku shkeli kufijtë e vendit tim», pa e analizuar se për ç'shkak bëhet lufta, nga cilat klasa, për cilin qëllim politik. P. Kievski e ul veten në nivelin e këtij filistini kur thotë se Belgjikën e pushtuan gjermanët, pra, nga pikëpamja e vetëvendosjes, «socialpatriotët belgjianë kanë të drejtë», ose: gjermanët kanë pushtuar një pjesë të Francës, pra «Gedi mund të jetë i kënaqur», sepse «në këtë rast është fjala për një territor të banuar nga ky komb» (e jo për territorin e një kombi tjetër).

Për filistinin ka rëndësi se ku ndodhen ushtritë, kush është në fitim tani. Për marksistin ka rëndësi se për ç'shkak bëhet kjo luftë, gjatë së cilës mund të fitojnë herë këto, herë ato ushtri.

Për ç'shkak bëhet lufta e sotme? Kjo thuhet në rezolucionin tonë (i cili merr parasysh politikën e fuqive ndërluftuese, politikën që ato kanë ndjekur për dhjetëra vjet para luftës). Anglia, Franca dhe Rusia luftojnë për ruajtjen e kolonive të grabitura dhe për

grabitjen e Turqisë etj. Gjermania lufton për të marrë kolonitë e të tjerëve dhe për ta grabitur ajo vetë Turqinë etj. Ta zëmë se gjermanët do të marrin edhe Parisin edhe Peterburgun. A do të ndryshojë nga kjo karakteri i luftës së sotme? Aspak. Qëllimi i gjermanëve, dhe — kjo është më e rëndësishmja: politika që do të ndiqet në rast se fitojnë gjermanët — do të jetë atëherë marrja e kolonive të huaja, sundimi në Turqi, marrja e krahinave të kombeve të huaja, për shembull, pushtimi i Polonisë etj., por nuk do të jetë aspak vendosja e një shtypjeje kombëtare të huaj mbi francezët ose rusët. Thelbi i vërtetë i luftës së sotme nuk është kombëtar, por imperialist. Me fjalë të tjera: lufta bëhet ngaqë njëra palë do që ta përmbysë shtypjen kombëtare, pala tjetër e mbron atë. Lufta bëhet ndërmjet dy grupeve shtypësish, ndërmjet dy kusarëve për të vendosur se si ta ndajnë plaçkën, kush të grabitë Turqinë dhe kolonitë.

Shkurt: lufta *ndërmjet* fuqive të mëdha imperialiste (d.m.th. që shtypin një varg të tërë popujsh të huaj, që i mbërthejnë ata me prangat e varësisë nga kapitali financiar etj.) ose në *aleancë* me to është luftë imperialiste. E tillë është lufta e vjetëve 1914-1916. «Mbrojtja e atdheut» është mashtrim në *këtë* luftë, është një përligje e saj.

Lufta *kundër* fuqive imperialiste, d.m.th. fuqive shtypëse nga ana e të shtypurve (p.sh. nga ana e popujve kolonialë) është luftë me të vërtetë kombëtare. Ajo është e mundshme edhe sot. «Mbrojtja e atdheut» nga ana e një vendi që vuan nga shtypja kombëtare kundër një vendi tjetër, që e ushtron këtë shtypje kombëtare, nuk është gënjeshtër, dhe socialistët *nuk janë aspak kundër* «mbrojtjes së atdheut» në një luftë të tillë.

Vetëvendosja e kombeve është e njëjta gjë me luftën për çlirimin e plotë kombëtar, për pavarësinë e plotë, kundër aneksimeve, dhe nga kjo luftë —

cilado goftë forma e saj, deri te kryengritja ose deri te lufta me armë — socialistët *nuk mund* të heqin dorë, në goftë se duan të mbeten socialistë.

... Vetëvendosje e kombeve quhet pavarësia e tyre politike. Imperializmi synon ta shkelë atë, sepse në kushtet e aneksimit politik aneksimi ekonomik shumë herë është më i lehtë, më pak i kushtueshëm (funktionarët korruptohen më lehtë, është më e lehtë marrja e koncesioneve, mund të sigurohet më lehtë miratimi i një ligji të leverdishëm etj.), shkakton më pak telashe dhe është më i qetë, — pikërisht ashtu sikundër imperializmi synon ta zëvendësojë demokracinë në përgjithësi me oligarkinë. Por të thuash se në kushtet e imperializmit vetëvendosja është «e parealizueshme» nga pikëpamja *ekonomike*, kjo është marrëzi.

... Lufta kombëtare, kryengritja kombëtare, shkaputja kombëtare janë plotësisht «të realizueshme» dhe praktikisht vihen re në kushtet e imperializmit, madje forcohen, sepse imperializmi nuk e ndal zhvillimin e kapitalizmit dhe rritjen e tendencave demokratike në masën e popullsisë, por e *ashpëron* antagonizmin midis këtyre aspiratave demokratike dhe tendencës antidemokratike të trusteve.

Vetëm nga pikëpamja e «ekonomizmit imperialist», d.m.th. e kësaj karikature të marksizmit, mund të mos përfillet, p.sh., kjo dukuri specifike e politikës imperialiste; nga njëra anë, lufta e sotme imperialiste na tregon se mund të tërhiqet një shtet i vogël dhe politikisht i pavarur, në saje të lidhjeve financiare dhe të interesave ekonomike, në luftën ndërmjet shteteve të mëdha (Anglia dhe Portugalia). Nga ana tjetër, shkelja e demokratizmit për sa u përket kombeve të vogla, shumë më të pafuqishme (edhe ekonomikisht edhe politikisht) kundrejt «përkrahësve» të tyre imperialistë, shkakton ose kryengritjen (Irlanda) ose bën që regjimente të veçanta të hidhen në anën e armi-

kut (çekët). Duke qenë kështu, nga pikëpamja e kapitalit financiar jo vetëm që është «e realizueshme», por *disa herë* është drejtpërdrejt në interes të trusteve, të politikës së tyre imperialiste, të luftës së tyre imperialiste t'u japin sa më shumë liri demokratike, deri te pavarësia shtetërore, *disa* kombeve të vogla, që të mos rrezikojnë t'i prishin operacionet «e tyre» të luftës. Të harrosh veçorinë e raporteve politike dhe strategjike dhe të përsëritësh, me vend e pa vend, vetëm një fjalë të mësuar përmendsh: «imperializëm», nuk është aspak marksizëm.

.. Nuk mund të kritikosh një autor, nuk mund t'i përgjigjesh, po të mos i citosh të plota qoftë edhe vetëm *disa* nga pjesët më të rëndësishme të artikullit të tij. Dhe sa herë që citon të plotë qoftë edhe një pjesë të artikullit të P. Kievskit, del gjithnjë se në çdo frazë ai ka 2-3 gabime ose gjëra të pamenduara që e shtrembërojnë marksizmin.

1) P. Kievski nuk e vuri re se kryengritja kombëtare është *gjithashtu* «mbrojtje e atdheut»! Kurse mjafton një thërrime arsyeje për të bindur çdo njeri se është pikërisht kështu, sepse çdo «komb kryengritës» «mbron» veten nga kombi që e shtyp, mbron gjuhën e vet, tokën e vet, atdheun e vet.

Çdo shtypje kombëtare shkakton qëndresën e *masave të gjera* të popullit, dhe *tendenca* për çdo qëndresë nga një popullsi që vuan nga shtypja kombëtare është kryengritje kombëtare. Në qoftë se ne shohim shumë herë (sidomos në Austri dhe në Rusi) se borgjezia e kombeve të shtypura *vetëm* lllomotit për kryengritje kombëtare, kurse në të vërtetë përfundon lloj-lloj marrëveshjesh reaksionare me borgjezinë e kombit shtypës prapa shpinës dhe *kundër* popullit të vet, në këto raste kritika e marksistëve revolucionarë duhet të drejtohet jo kundër lëvizjes kombëtare, por kundër degjenerimit dhe banalizimit të saj, kundër shndërrimit të saj në një grindje të parëndësishme.

Megë ra fjala, shumë socialdemokratë austriakë dhe rusë e harrojnë këtë dhe urrejtjen e tyre të ligjshme kundër grindjeve të vogla banale dhe të vajtueshme kombëtare, si diskutimet dhe grindjet për të vendosur se në çfarë gjuhe duhet të shkruhet emri i rrugës në krye të tabelës dhe në çfarë gjuhe duhet të shkruhet e shndërrojne në një mohim të përkrahjes së luftës kombëtare. Ne nuk do të «përkrahim» lojën komike me republikën në ndonjë principatë të Monakos, ose aventurat «republikane» të «gjeneralëve» në shtetet e vogla të Amerikës Jugore ose të ndonjë ishulli të Oqeanit Paqësor, por nga kjo nuk del se është e lejueshme të harrojmë parullën e republikës kur kemi të bëjmë me lëvizjet demokratike dhe socialiste serioze. Ne tallemi dhe duhet të tallemi me grindjet kombëtare qesharake dhe pazarllëqet kombëtare të kombeve të ndryshme në Rusi dhe në Austri, por nga kjo nuk del se është e lejueshme t'ia mohojmë përkrahjen tonë kryengritjes kombëtare ose çdo luftë serioze të të gjithë popullit kundër shtypjes kombëtare.

*Shkruar në gusht-tetor
1916*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 23,
f. 25-29, 43, 51, 64-65*

Nga artikulli:

«PACIFIZMI BORGJEZ DHE PACIFIZMI SOCIALIST»

A nuk është qesharake të flasësh për «lirinë ekonomike të të gjitha kombeve, të vogla dhe të mëdha». duke e lënë në heshtje faktin se, derisa të mos jenë përmbytur qeveritë borgjeze dhe derisa të mos jetë shpronësuar borgjezia, kjo «liri ekonomike» është po ashtu *mashtim* i popullit, sic janë frazat për «lirinë ekonomike» të qytetarëve në përgjithësi, të fshatarëve të vegjël dhe të të pasurve, të punëtorëve dhe të kapitalistëve në shoqërinë e sotme?

Rezolucioni, për të cilin votuan njëzëri Zhuoi dhe Merhajmi, është mbujtur i tëri me idetë e «nacionalizmit borgjez», të cilin «Avanti!» me të drejtë e vëren te Zhuoi, por të cilin «Avanti!» për çudi nuk e sheh te Merhajmi.

Nacionalistët borgjezë janë mburrur gjithnjë dhe kudo me fraza «të përgjithshme» për «federatën e kombeve» në përgjithësi, për «lirinë ekonomike të të gjitha kombeve, të mëdha e të vogla». Socialistët, ndryshe nga nacionalistët borgjezë, kanë thënë dhe

thonë: të thuash fjalë të mëdha për «lirinë ekonomike të kombeve të mëdha e të vogla» është hipokrizi e shëmtuar, përderisa disa kombe (p.sh Anglia dhe Franca) investojnë jashtë shtetit, d.m.th. u japin kredi me fajde kombeve të vogla e të prapambetura, dhjetëra e dhjetëra miliardë franga kapital, kurse kombet e vogla e të dobëta mbeten të skllavëruara prej tyre.

*Shkruar më
1 janar 1917*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 23,
f. 225-226*

**Nga «KONFERENCA E SHTATË E PËRGJITHSHME
(E PRILLIT) E PPSDR(b) TË RUSISË»**

24-29 prill 1917

FJALIM PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Duke filluar nga viti 1903, kur partia jonë pranoi programin e saj, ne kemi hasur gjithnjë në një opozitë të tërbuar nga shokët polonezë. Po të studioni protokollet e Kongresit II do të shihni se qysh atëherë ata paraqitnin po ato argumente që hasim sot, dhe socialdemokratët polonezë u larguan nga ky kongres duke kujtuar se njohja e së drejtës së kombeve për vetëvendosje është e papranueshme për ta. Dhe që prej asaj kohe ne ndeshemi gjithmonë në të njëjtën çështje. Imperializmi ekzistonte edhe më 1903, por atëherë ai nuk u përmend si një argument; edhe sot, si atëherë, pozita e socialdemokracisë poloneze mbetet një gabim i habitshëm, i përbindshëm: këta njerëz duan ta bëjnë pozitën e partisë sonë një pozitë shovinistësh.

Politika e Polonisë, si pasojë e shtypjes së gjatë të saj nga Rusia, është plotësisht kombëtare, dhe i

gjithë populli polonez është pushtuar nga e vetmja dëshirë si e si të hakmerret kundër moskovit. Askush nuk i ka shtypur polakët sa populli rus. Populli rus ka shërbyer në duart e carëve si xhelat i lirisë së Polonisë. Nuk ka popull që të ushqejë aq urrejtje për Rusinë, nuk ka popull që të urrejë aq shumë Rusinë sa polakët, dhe nga kjo na del një dukuri e çuditshme. Polonia është pengesë për lëvizjen socialiste për shkak të borgjezisë poloneze. Le t'i bjerë flaka gjithë botës, — mjafton që Polonia të jetë e lirë. Natyrisht, ta shtrosh çështjen në këtë mënyrë, do të thotë të tallesh me internacionalizmin. Natyrisht, tani mbi Poloninë sundon dhuna, por që nacionalistët polonezë të shpresojnë se ajo do të çlirohet nga Rusia, kjo është një tradhti ndaj Internacionales. Dhe nacionalistët polonezë kanë bërë që idetë e tyre të rrënjosen aq thellë në shpirtin e popullit polonez, sa që atje kështu mendojnë.

Një meritë historike shumë e madhe e shokëve socialdemokratë polonezë është se ata hodhën parullën e internacionalizmit dhe thanë: aleanca vëllazërore me proletariatin e të gjitha vendeve të tjera është më e rëndësishmja për ne, prandaj ne nuk do të luftojmë kurrë për çlirimin e Polonisë. Këtu qëndron merita e tyre, dhe prandaj ne gjithnjë vetëm këta shokë socialdemokratë polonezë i kemi quajtur socialistë. Të tjerët janë nacionalistë, Plehanovë polonezë. Por nga kjo pozitë origjinale, ku njerëzit, për të shpëtuar socializmin, detyroheshin të luftonin kundër nacionalizmit të tërbuar, të sëmurë, doli një dukuri e habitshme: shokët na vijnë e na thonë se ne duhet të heqim dorë nga liria e Polonisë, nga shkëputja e saj.

Përse ne, rusët, që shtypim më shumë kombe sesa çdo popull tjetër, u dashka të heqim dorë nga njohja e së drejtës së Polonisë, Ukrainës, Finlandës për t'u shkëputur? Na propozojnë të bëhemi shovinistë, sepse në këtë mënyrë do të lehtësojmë pozitën e socialdemokratëve në Poloni. Ne nuk pretendojmë, thonë, për

çlirimin e Polonisë, sepse populli polonez jeton midis dy shtetesh të afta për të luftuar. Por në vend që të thonë se punëtorët polonezë duhen të arsyetojnë kështu: demokratë janë vetëm ata socialdemokratë që mendojnë se populli polonez duhet të jetë i lirë, sepse shovinistët nuk kanë vend në radhët e partisë socialiste, socialdemokratët polonezë thonë: pikërisht sepse ne mendojmë se aleanca me punëtorët rusë është e leverdishme, ne jemi kundër shkëputjes së Polonisë. Kjo është e drejta e tyre e plotë. Mirëpo njerëzit nuk duan ta kuptojnë se për forcimin e internacionalizmit nuk duhet të përsëriten të njëjtat fjalë, por në Rusi duhet të ngulim këmbë për lirinë e shkëputjes së kombeve të shtypura, kurse në Poloni të theksojmë nevojën e lirisë së bashkimit. Liria e bashkimit parakupton lirinë e shkëputjes. Ne, rusët, duhet të theksojmë lirinë e shkëputjes, kurse në Poloni duhet të ngulet këmbë për lirinë e bashkimit.

Ne kemi këtu një sërë sofizmash që të çojnë në largimin e plotë nga marksizmi. Pikëpamja e shokut Piatakov është përsëritje e pikëpamjes së Roza Luksemburgut...* (shembulli i Holandës). Kështu arsyeton shoku Piatakov, dhe kështu ai hedh poshtë tezën e vet, sepse në teori ai është për mohimin e lirisë së shkëputjes, kurse popullit i thotë: kush e mohon lirinë e shkëputjes, ai nuk është socialist. Ajo që tha këtu shoku Piatakov është një çorbë që s'merret vesh. Në Evropën Perëndimore mbizotërojnë vendet ku çështja kombëtare është zgjidhur prej kohësh. Kur thonë se çështja kombëtare është zgjidhur, kanë parasysh Evropën Perëndimore. Shoku Piatakov këtë e zhvendos atje ku nuk hyn, në Evropën Lindore, e kështu bëhemi qesharakë.

Pa mendoni se çfarë çorbe e tmerrshme na del! Finlanda është shumë afër. Sh. Piatakov nuk jep

* Pjesë e paplotësuar në tekstin e protokollit. Red.

një përgjigje konkrete për të, dhe ai u ngatërrua fare. Dje në «Raboçaja Gazeta» lexuat se në Finlandë po rritet separatizmi. Finlandezët vijnë e na thonë se separatizmi ndër ta rritet, sepse kadetët nuk i japin Finlandës autonomi të plotë. Atje po ashpërsohet kriza. pakënaqësia nga guvernatori i përgjithshëm, Rodiçevi, kurse «Raboçaja Gazeta» shkruan se finlandezët duhet të presin Asamblenë Kushtetuese, sepse atje do të arrihet një marrëveshje ndërmjet Finlandës dhe Rusisë. Ç'marrëveshje? Finlandezët duhet të thonë se ata mund të kenë të drejtë ta zgjidhin si të duan fatin e tyre, dhe ai rus që do ta mohonte këtë të drejtë do të ishte shovinist. Ndryshe është puna, në qoftë se ne do t'i thoshim punëtorit finlandez: si të leverdis ty, ta zgjidhësh...*

Shoku Piatakov nuk bën tjetër veçse e mohon parullën tonë kur thotë se kjo nuk është një parullë e revolucionit socialist. Por ai vetë nuk ka dhënë një parullë të përshtatshme. Metoda e revolucionit socialist nën parullën: «poshtë kufijtë» është një ngatërresë e plotë. Ne nuk mundëm ta botonim artikullin, në të cilin këtë pikëpamje unë e kam quajtur «ekonomizëm imperialist»**. Ç'do të thotë «metodë» e revolucionit socialist nën parullën «poshtë kufijtë»? Ne themi se shteti është i domosdoshëm, dhe shteti parakupton kufij. Natyrisht, shteti mund të ketë një qeveri borgjeze, kurse neve na duhen Sovjetët. Por çështja e kufijve shtrohet edhe për ta. Ç'do të thotë «poshtë kufijtë»? Këtu fillon anarkia... «Metoda» e revolucionit socialist nën parullën «poshtë kufijtë» është me të vërtetë një çorbë. Kur të piqet revolucioni socialist, kur të kryhet, ai do të shtrihet në vendet e tjera, dhe ne do t'i ndihmojmë atij, por në ç'mënyrë, këtë s'e dimë. «Metoda e revolucionit socialist» është një

* Pjesë e paplotësuar në tekstin e protokollit. *Red.*

** Shih Veprat, bot. shqip, vëll. 23, f. 21-85, *Red.*

frazë boshe. Përderisa ka mbeturina të çështjeve të pazgjidhura nga revolucioni borgjez, ne jemi për zgjidhjen e tyre. Ndaj lëvizjes separatiste ne jemi indiferentë, asnjans. Nëse Finlanda, Polonia, Ukraina shkëputen nga Rusia, këtu nuk ka asgjë të keqe. Ç'të keqe ka këtu? Ai që thotë këtë, është shovinist. Duhet të jesh i çmendur që të vazhdosh politikën e car Nikollës. A nuk u shkëput Norvegjia nga Suedia?... Dikur Aleksandri I dhe Napoleoni këmbenin popujt, dikur carët e përdornin Poloninë si mjet këmbimi. Do të vazhdojmë edhe ne këtë taktikë të carëve? Kjo do të thotë të heqësh dorë nga taktika e internacionalizmit, ky është shovinizmi më i keq. Ç'të keqe ka nëse do të shkëputet Finlanda? Në të dy popujt, në proletariatin e Norvegjisë dhe të Suedisë, pas shkëputjes u forcua besimi ndaj njëri-tjetrit. Çifligarët suedezë deshën të hidheshin në luftë, por punëtorët suedezë e kundërshtuan këtë dhe thanë: ne nuk do të shkojmë në këtë luftë.

Finlandezët tani duan vetëm autonomi. Ne mendojmë se Finlandës duhet t'i jepet liri e plotë, kur të vihet në jetë kjo, atëherë do të forcohet besimi ndaj demokracisë ruse, pikërisht atëherë ata nuk kanë për t'u shkëputur. Kur z. Rodiçev shkoi te ata dhe bëri tregti me çështjen e autonomisë, te ne vijnë shokët finlandezë dhe na thonë: ne duam autonomi. Mirëpo kundër tyre qëllojnë me të gjitha armët, duke u thënë: «prisni Asamblenë Kushtetuese». Kurse ne themi: «ai socialist rus që mohon lirinë e Finlandës është shovinist».

Ne themi se kufijtë përcaktohen nga vullneti i popullsisë. Rusia të mos guxojë të luftojë për Kurlandën! Gjermania të heqë trupat nga Kurlanda! Ja, kështu e zgjidhim ne çështjen e shkëputjes. Proletariati nuk mund të përdorë forcë, sepse ai nuk duhet ta pengojë lirinë e popujve. Parulla «poshtë kufijtë» do të jetë e drejtë vetëm kur revolucioni socialist do të bëhet realitet e jo metodë, dhe ne atëherë do të themi: shokë, e jani te ne...

Krejt ndryshe është çështja e luftës. Po të jetë nevoja, ne nuk do të heqim dorë nga lufta revolucionare. Ne nuk jemi pacifistë... Kur Miliukovi, që ka pushtetin në dorë të ne, dërgon në Finlandë Rodicevin, i cili bën pazarllëqe pa turp me popullin finlandez, ne themi: jo, populli rus të mos guxojë të dhunojë Finlandën; nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë. Në rezolucionin për Borgbiergun ne themi: largoni trupat dhe lërin kombet ta zgjidhin vetë çështjen. Në qoftë se nesër Sovjeti do të marrë pushtetin në dorë, kjo nuk do të jetë «metodë e revolucionit socialist», ne atëherë do të themi: Gjermania, të largojë trupat nga Polonia, Rusia të largojë trupat nga Armenia, — përndryshe ky do të jetë mashtrim.

Për Poloninë e tij të shtypur sh. Xherzhinski na thotë se atje të gjithë janë shovinistë. Po përse asnjë nga polakët nuk ka thënë asnjë fjalë se ç'duhet të bëhet me Finlandën, ç'duhet të bëhet me Ukrainën? Ne qysh nga viti 1903 kemi diskutuar aq shumë për këtë çështje, sa që po bëhet e vështirë të flasësh për të. Shko ku të duash... Kush nuk ka këtë pikëpamje, ai është aneksionist, ai është shovinist. Ne dëshirojmë një aleancë vëllazërore të të gjithë popujve. Në qoftë se do të ketë Republikë të Ukrainës dhe Republikë të Ruisë, ndërmyet tyre do të ketë më tepër lidhje, më tepër besim. Në qoftë se ukrainasit do të shohin se ne kemi një republikë të Sovjetëve, ata nuk kanë për t'u shpëputur, por në qoftë se te ne do të ketë një republikë të Miliukovit, ata do të shpëputen. Kur sh. Piatakov, krejt në kundërshtim me pikëpamjet e tij, tha: ne jemi kundër mbajtjes së një populli me forcë brenda kufijve të Ruisë, — kjo do të thotë pikërisht njohje e së drejtës së kombeve për vetëvendosje. Ne nuk duam aspak që muzhiku i Hivës të jetojë nën zgjedhën e hanit hivian. Zhvillimi i revolucionit tonë do të ndikojë mbi masat e shtypura.

Vetëm në këtë mënyrë duhet të shtrohet agjitacioni në gjirin e masës së shtypur.

Mirëpo çdo socialist rus që nuk pranon lirinë e Finlandës dhe të Ukrainës, do të zhytet në shovinizëm. Dhe asnjë sofizëm e referim i «metodës» së vet nuk ka për t'i shfajësuar kurrë ata.

REZOLUCION PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Politika e shtypjes kombëtare, trashëgim i lënë nga autokracia dhe monarkia, përkrahet nga çifligarët, kapitalistët dhe bongjezia e vogël për të mbrojtur privilegjet e tyre të klasës dhe përçarjen e punëtorëve të kombësive të ndryshme. Imperializmi i sotëm, duke e bërë më të theksuar prirjen për nënshtrimin e popujve të dobët, është një faktor i ri i ashpërsimit të shtypjes kombëtare.

Zhdukja e shtypjes kombëtare, në atë masë që kjo mund të realizohet në shoqërinë kapitaliste, është e mundshme vetëm në kushtet e një organizimi republikan demokratik konsekuent dhe të qeverisjes demokratike konsekuente të shtetit, që të sigurojë barazinë e plotë të të drejtave të të gjitha kombeve dhe gjuhëve.

Gjithë kombeve, nga të cilat përbëhet Rusia, duhet t'u njihet e drejta që të shkëputen lirisht dhe të formojnë një shtet të pavarur. Mohimi i kësaj së drejte dhe mosmarrja e masave që të garantojnë zbatimin e saj në praktikë do të thotë përkrahje e politikës së pushtimeve dhe të aneksimeve. Vetëm njohja nga proletariati e së drejtës së kombeve për shkëputje siguron solidarësinë e plotë të punëtorëve të kombeve të ndryshme dhe ndihmon për një afrim me të vërtetë demokratik të kombeve.

Konflikti që ka lindur sot ndërmjet Finlandës dhe Qeverisë së Përkohshme ruse tregon veçanërisht qartë se mohimi i së drejtës për t'u shkëputur lirisht çon në vazhdimin e drejtpërdrejtë të politikës së carizmit.

Çështja e së drejtës së kombeve për t'u shkëputur lirisht nuk lejohet të ngatërrohet me çështjen e dobisë së shkëputjes së këtij ose atij kombi në këtë ose atë çast. Këtë çështjen e fundit partia e proletariatit në çdo rast të veçantë duhet ta zgjidhë në mënyrë krejt të pavarur, duke pasur parasysh interesat e gjithë zhvillimit shoqëror dhe interesat e luftës së klasës të proletariatit për socializëm.

Partia kërkon një autonomi të gjerë krahinore, kërkon heqjen e mbikëqyrjes nga lart, heqjen e gjuhës zyrtare të detyrueshme dhe caktimin e kufijve të krahinave autonome dhe të atyre që vetëqeverisen në bazë të vullnetit të shprehur nga vetë popullsia vendase, e cila do të ketë parasysh kushtet ekonomike dhe të jetesës, përbërjen kombëtare të popullsisë etj.

Partia e proletariatit e hedh poshtë vendosmërisht të ashtuquajturën «autonomi kombëtaro-kulturore», d.m.th. heqjen e shkollave nga kompetencat e shtetit dhe lënien e tyre në duart e disa sejmëve kombëtare. Autonomia kombëtaro-kulturore i ndan në mënyrë artificiale punëtorët që jetojnë në të njëjtin vend, madje edhe ata që punojnë në të njëjtën ndërmarrje, sipas «kulturës kombëtare» së cilës ata i përkasin, d.m.th. forcon lidhjet e punëtorëve me kulturën borgjeze të kombeve të ndryshme, kurse detyra e socialdemokracisë është që të forcojë lidhjet e kulturës internacionale të proletariatit botëror.

Partia kërkon që në kushtetutë të futet një ligj themelor, i cili të heqë çfarëdo privilegji të ndonjë kombi dhe të ndalojë të gjitha shkeljet e të drejtave të pakicave kombëtare.

Interesat e klasës punëtoze kërkojnë bashkimin

e punëtorëve të të gjitha kombësive të Rusisë në organizata proletare unike — politike, profesionale, kooperativiste, kulturore etj. Vetëm ky bashkim në organizatat unike të punëtorëve të kombësive të ndryshme do t'i japë proletariatit mundësinë të bëjë një luftë fitimtare kundër kapitalit ndërkombëtar dhe kundër nacionalizmit borgjez.

Veprat, bot. shqip, vëll. 24.

f. 315-323

Nga lëksionit:

«LUFTA DHE REVOLUCIONI»

14 Maj 1917

Nga pikëpamja e marksizmit, d.m.th. e socializmit shkencor të sotëm, çështja themelore që shtrohet kur socialistët diskutojnë se si duhet vlerësuar një luftë dhe ç'qëndrim duhet mbajtur kundrejt saj është kjo: përse bëhet kjo luftë, cilat klasa e kanë përgatitur dhe e kanë drejtuar atë. Ne, marksistët, nuk bëjmë pjesë në numrin e kundërshtarëve absolutë të çdo luftë. Ne themi: qëllimi ynë është arritja e regjimit shoqëror socialist, i cili, pasi të zhdukë ndarjen e njerëzimit në klasa, pasi të heqë çfarëdo shfrytëzimi të njeriut prej njeriut dhe të një kombi prej kombeve të tjera, do të zhdukë patjetër çfarëdo mundësie të luftërave në përgjithësi. Mirëpo në luftën që bëhet për këtë rend shoqëror socialist ne do të hasim patjetër kushte kur lufta e klasave brenda secilit komb të veçantë mund të ndeshet me këtë luftë klasash, që është pjellë e saj, me luftën ndërmjet kombeve të ndryshme, prandaj ne nuk mund të mohojmë mundësinë e luftërave

revolucionare, d.m.th. të luftërave që kanë rrjedhur nga lufta e klasave, që bëhen nga klasat revolucionare dhe kanë një rëndësi revolucionare të drejtpërdrejtë dhe imediate.

...Lufta është vazhdim i politikës me mjete të tjera. Çdo luftë është e lidhur pazgjidhshmërisht me regjimin politik, nga i cili ajo buron. Atë politikë që një shtet, një klasë e caktuar brenda këtij shteti ka ndjekur për një kohë të gjatë para luftës, po kjo klasë e vazhdon në mënyrë të pashmangshme dhe të paevitueshme edhe gjatë luftës, duke ndërruar vetëm formën e veprimit.

...Kjo luftë është vazhdim i politikës së zaptimeve, të shfarosjes së kombësive të tëra, të mizorive të padëgjuaara, të cilat janë bërë nga gjermanët dhe anglezët në Afrikë, nga anglezët dhe rusët në Persi, — nuk di kush prej tyre më shumë, — dhe për shkak të të cilave kapitalistët gjermanë i shikonin si armiq. A, ju jeni të fortë se jeni të pasur? Por ne jemi më të fortë se ju, prandaj edhe ne e kemi po atë të drejtë «të shenjtë» që të grabitim. Ja në çka përmblihet historia e vërtetë e kapitalit financiar anglez dhe e atij gjerman për dhjetëra vjet me radhë para luftës. Ja në çka përmblihet historia e marrëdhënieve ruso-gjermane, ruso-angleze dhe gjermano-angleze.

...Ata që interesohen për lëvizjen socialiste le të lexojnë Manifestin e Bazelit të vitit 1912, pranuar njëzëri nga të gjitha partitë socialiste të botës, manifest që ne e kemi botuar në gazetën tonë «Pravda», manifest që tani nuk mund të botohet në asnjë vend që merr pjesë në luftë, as në Anglinë «e lirë», as në Francën republikane, sepse atje qysh përpara luftës ishte thënë e vërteta për luftën. Në manifest është thënë: lufta do të bëhet ndërmjet Anglisë dhe Gjermanisë për shkak të rivalitetit të kapitalistëve. Në manifest është thënë: barut është grumbulluar aq shumë, sa që pushkët do të shtien vetë. Në manifest

është shkruar përse do të bëhet kjo luftë dhe është thënë se lufta do të çojë në revolucionin proletar. Prandaj ne u themi atyre socialistëve, të cilët, pasi e nënshkruan këtë manifest, morën anën e qeverive kapitaliste të tyre, se ata e kanë tradhtuar socializmin. Socialistët janë përçarë në gjithë botën. Disa janë bërë ministra, të tjerët janë futur nëpër burgje. Në gjithë botën një pjesë e socialistëve predikon përgatitjen për luftë, një tjetër, si Bebeli amerikan — Eug. Debsi, i cili gëzon një respekt shumë të madh ndër punëtorët amerikanë, — thotë: «Le të më pushkatojnë kur të duan, por unë nuk jap as edhe një cent për këtë luftë. Unë jam gati të marr pjesë vetëm në luftën e proletariatit kundër kapitalistëve të të gjithë botës». Ja si janë përçarë socialistët në gjithë botën. Socialpatriotët e gjithë botës mendojnë se mbrojnë atdheun. Ata gabojnë, — ata mbrojnë interesat e një grushti kapitalistësh kundër një tjetri. Ne predikojmë revolucionin proletar — të vetmen çështje të drejtë, për të cilën dhjetëra njerëz janë ekzekutuar me gjyotinë, qindra dhe mijëra janë mbyllur nëpër burgjet. Këta socialistë që gjenden nëpër burgje janë një pakicë, por me ta është klasa punëtore, me ta është gjithë zhvillimi ekonomik. Të gjitha këto na tregojnë se nuk ka tjetër rrugëdalje. Kësaj lufte mund t'i jepet fund vetëm me anën e revolucionit punëtor në disa vende. Kurse tani për tani ne duhet ta përgatitim këtë revolucion, ta ndihmojmë atë...

*Veprat, bot. shqip, vëll. 24,
f. 437-438, 439, 447, 463-464*

**Nga «KONGRESI I DYTË I SOVJETËVE TË
DEPUTETËVE PUNËTORË DHE USHTARË
TË RUSISË»**

25—26 tetor 1917

Me fjalët aneksim ose pushtim tokash të huaja qeveria kupton, në përputhje me ndërgjegjen juridike të demokracisë në përgjithësi dhe të klasave punonjëse në mënyrë të veçantë, çdo aneksim të një kombësie të vogël ose të dobët nga një shtet i madh ose i fuqishëm pa pëlqimin dhe dëshirën e shprehur në mënyrë të prerë, të qartë dhe vullnetare nga kjo kombësi, pavarësisht se kur është bërë ky aneksim me dhunë dhe pavarësisht se sa i zhvilluar ose i prapambetur është kombi i aneksuar me dhunë ose që mbahet me dhunë brenda kufijve të një shteti të dhënë. Më në fund, pavarësisht nëse ky komb jeton në Evropë apo në vendet e largme përtej oqeanit.

Në qoftë se çfarëdo kombi mbahet me dhunë brenda kufijve të një shteti të caktuar, në qoftë se atij, në kundërshtim me dëshirën e shfaqur prej tij — pavarësisht nëse kjo dëshirë është shfaqur në shtyp, në mbledhjet popullore, në vendimet e partive ose në lëvizjet dhe kryengritjet kundër shtypjes kombëta-

re, — nuk i jepet e drejta që të vendosë me anë votimesh të lira, duke i tërhequr plotësisht trupat e kombit pushtues ose përgjithësisht të kombit më të fortë, pa më të voglin detyrim, çështjen në lidhje me formën e ekzistencës shtetërore të këtij kombi, bashkimi i tij është aneksim, d.m.th. pushtim me dhunë.

Qeveria e quan si krimin më të madh kundër njerëzimit vazhdimin e kësaj lufte që bëhet për të vendosur se si do të ndahen ndërmjet kombeve të forta dhe të pasura kombësitë e dobëta të pushtuara prej tyre dhe shpall solemnisht vendosmërinë për të nënshkruar menjëherë kushtet e një paqeje, e cila t'i japë fund kësaj lufte në bazë të kushteve të lartpërmendura, njëlloj të drejta për të gjitha kombësitë pa përjashtim.

*Veprat, bot. shqip, vëll. 26,
f. 272-273*

***N g a* «DEKLARATA E TË DREJTAVE TË POPULLIT PUNONJËS DHE TË SHFRYTËZUAR»**

1. Asambleja Kushtetuese, duke shprehur vendosmërinë e patundur për ta shkëputur njerëzimin nga kthetrat e kapitalit financiar dhe të imperializmit, të cilët e kanë mbytur bobën në gjak në këtë luftë, që është më kriminalja e të gjitha luftërave, bashkohet plotësisht me politikën e zbatuar nga Pushteti Sovjetik për prishjen e traktateve të fshehta, për organizimin e një vëllazërimi sa më të gjerë me punëtorët dhe fshatarët e ushtrive që luftojnë sot kundër njërë-tjetrës, për të arritur me çdo kusht, me masa revolucionare, një paqe demokratike ndërmjet popujve, pa aneksime dhe pa kontribucione, në bazë të vetëvendosjes së lirë të kombeve.

2. Po për këtë qëllim Asambleja Kushtetuese ngul këmbë për shkëputjen e plotë nga politika barbare e qytetërimit borgjez, e cila e bazonte mirëqenien e shfrytëzuesve të një grushti kombesh të zgjedhura mbi skllavërimin e qindra miliona punonjësve të popullsisë së Azisë, të vendeve koloniale në përgjithësi dhe të vendeve të vogla.

Asambleja Kushtetuese përshëndet politikën e Këshillit të Komisarëve të Popullit, që ka shpallur

pavarësinë e plotë të Finlandës, ka filluar tërheqjen e trupave nga Persia dhe ka shpallur lirinë e vetëvendosjes së Armenisë.

Shkruar në fillim të janarit 1918

*Veprat, bot. shqip, vëll. 26,
f. 472*

**Nga «RAPORTI PËR POLITIKËN E JASHTME NË
MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË KQË TË RUSISË
DHE TË SOVJETIT TË MOSKËS»**

14 maj 1918

Ne jemi oboronistë qysh prej 25 tetorit të 1917-s, ne kemi fituar të drejtën të mbrojmë atdheun. Ne nuk mbrojmë traktatet e fshehta, ato ne i anuluan dhe i zbuluam përpara gjithë botës, ne mbrojmë atdheun nga imperialistët. Ne mbrojmë, ne do të fitojmë. Ne nuk mbrojmë fuqinë e madhe të Ruisë, nga ajo s'ka mbetur më asgjë përveç vetë Ruisë, ne nuk mbrojmë as interesat kombëtare, ne themi se interesat e socializmit, interesat e socializmit botëror qëndrojnë mbi interesat kombëtare, mbi interesat e shtetit. Ne jemi mbrojtësit e atdheut socialist.

Kjo nuk arrihet me deklarata, por vetëm me përmbyshjen e borgjezisë së vendit, me një luftë të pamëshirshme, për jetë a vdekje, të filluar në këtë vend, dhe ne e dimë se do të fitojmë. Ky është një ishull i vogël në mes të botës imperialiste të luftës që e rrethon, por në këtë ishull të vogël ne kemi treguar dhe provuar çka mund të bëjë klasa punëtore. Këtë e dinë dhe e kanë pranuar të gjithë. Ne pro-

vuam se kemi të drejtë ta mbrojmë atdheun, ne jemi oboronistë, dhe këtë mbrojtje e shohim me tërë seriozitetin që na e mësoi lufta katërvjeçare, e shikojmë me tërë seriozitetin dhe kujdesin që e kupton çdo punëtor, çdo fshatar që e ka parë ushtarin dhe ka dëgjuar se ç'ka hequr ai në këta katër vjet lufte, — me atë kujdes, që mund të mos e kuptojnë, me të cilin mund të zgërdhihen dhe të cilin mund ta shohin me mendjelehtësi vetëm ata që janë revolucionarë me fjalë e jo me vepra. Pikërisht sepse ne jemi përkrahës të mbrojtjes së atdheut ne i themi vetes: për mbrojtjen nevojitet një ushtri e vendosur dhe e fortë, një prapavijë e fortë, dhe për një ushtri të vendosur dhe të fortë duhet në radhë të parë një organizim i shëndoshë i sektorit të ushqimeve. Për këtë duhet që diktatura e proletariatit të shprehet jo vetëm në pushtetin qendror, që është hapi i parë dhe vetëm hapi i parë, por diktatura duhet të jetë në të gjithë Rusinë, ky është hapi i dytë dhe vetëm i dyti, — këtë hap ne ende nuk e kemi bërë në mënyrë të mjaftueshme. Neve na duhet, për ne është e domosdoshme disiplina proletare, diktatura e vërtetë proletare, kur pushteti i fortë dhe i çeliktë i punëtorëve të ndër-gjegjshëm të ndihet në çdo kënd të largët të vendit tonë, kur asnjë kulak, asnjë pasanik dhe kundërshtar i monopolit të drithërave të mos mbetet pa u dënuar, por të gjendet dhe të ndëshkohet nga dora e pamëshirshme dhe e hekurt e diktatorëve të disiplinuar të klases punëtore, e diktatorëve proletarë.

*Veprat, bot. shqip, vëll. 27,
f. 429-431*

Nga «**PROJEKTPROGRAMI I PK(b) TË RUSISË**»

Në çështjen kombëtare politika e proletariatit, që ka marrë pushtetin shtetëror, ndryshe nga shpallja formale demokratiko-borgjeze e barazisë së kombeve, që është e porealizueshme në kushtet e imperializmit, është realizimi sistematik dhe në fakt i afrimit e i shkrirjes së punëtorëve dhe fshatarëve të të gjitha kombeve në luftën e tyre revolucionare për përmbyshjen e borgjezisë. Realizimi i këtij qëllimi kërkon çlirim e plotë të kombeve koloniale dhe kombeve tjera të shtypura ose të pabarabarta duke u dhënë lirinë që të ndahen më vete, si garanci që mosbesimi i masave punonjëse të kombeve të ndryshme, i trashëguar nga kapitalizmi, dhe zemërimi i punëtorëve të kombeve të shtypura kundër punëtorëve të kombeve shtypëse të zhduken plotësisht dhe të zëvendësohen me një aleancë të ndërjegjshme dhe vullnetare. Nga punëtorët e atyre kombeve që kanë qenë shtypëse gjatë kapitalizmit kërkohet kujdes i veçantë për ndjenjën kombëtare të kombeve të shtypura (për shembull, nga rusët, ukrainasit, polakët ndaj çifutëve, nga tatarët ndaj bashkirëve etj.), kërkohet që ata të ndihmojnë jo vetëm për të siguruar barazinë në fakt, por edhe për zhvillimin e gjuhës e të letërsisë të masave

punonjëse të kombeve dikur të shtypura për të zhdukur çdo gjurmë të mosbesimit dhe të përçarjes së trashëguar nga epoka e kapitalizmit.

*Botuar për herë të parë
më 1930*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 29,
f. 129*

Nga «KONGRESI VIII I PK(b) TË RUSISË»

18-23 mars 1919

...Të hedhësh poshtë vetëvendosjen e kombeve dhe të vësh në vend të saj vetëvendosjen e punonjësve nuk është aspak e drejtë, sepse ta shtrosh çështjen kështu do të thotë të mos shohësh se sa e vështirë dhe gjarpëruese është rruga që ndjek diferencimi në gjirin e kombeve. Në Gjermani ai bëhet ndryshe nga ç'bëhet ndër ne. Nga disa pikëpamje më shpejt, kurse nga disa të tjera ai po bëhet me një ritëm më të ngadalshëm dhe po ndjek një rrugë më të përgjakshme. Ndër ne asnjë parti nuk e kishte pranuar një ide kaq të përbindshme, siç është bashkërendimi i Sovjetëve me Asamblenë Kushtetuese. Por ne jemi të detyruar të jetojmë krah për krah me këto kombe.

...Programi ynë nuk duhet të flasë për vetëvendosjen e punonjësve, sepse kjo është gabim. Ai duhet të thotë atë që është. Përderisa kombet gjenden në etapa të ndryshme të rrugës nga mesjeta në demokracinë borgjeze dhe nga demokracia borgjeze në demokracinë proletare, kjo tezë e programit tonë është krejtësisht e drejtë. Në këtë rrugë ne kemi pasur shumë zigzage. Çdo komb duhet të fitojë të drejtën e

vetëvendosjes, dhe kjo do të ndihmojë vetëvendosjen e punonjësve. Në Finlandë procesi i veçimit të proletariatit nga borgjezia po zhvillohet me një qartësi të madhe, me forcë dhe në mënyrë të thellë. Sidoqoftë, atje të gjitha punët do të zhvillohen ndryshe nga ç'u zhvilluan te ne. Po të themi se nuk njohim asnjë komb finlandez, por vetëm masat punonjëse, kjo do të ishte gjëja më pa kuptim. Nuk është e mundur të mos njohësh atë që është: ajo të detyron vetë ta njohësh. Në vendet e ndryshme veçimi i proletariatit nga borgjezia bëhet në rrugë të ndryshme të veçanta. Këtu ne duhet të veprojmë në një mënyrë shumë të matur. Duhet të tregohemi të matur sidomos kundrejt kombeve të ndryshme, sepse s'ka gjë më të keqe sesa mosbesimi ndaj një kombi. Ndër polonezët po bëhet vetëvendosja e proletariatit. Ja shifrat e fundit për përbërjen e Sovjetit të deputetëve punëtorë të Varshavës: socialtrudhtarë polonezë — 333, komunistë — 297. Kjo tregon se atje, sipas kalendarit tonë revolucionar, nuk është larg Tetori. Është ose gushti ose shtatori i 1917-s. Por, së pari, ende nuk është botuar një dekret ku të thuhet se të gjitha vendet duhet të jetojnë sipas kalendarit revolucionar bolshevik, por edhe sikur të ishte botuar, nuk do të zbatohet. Dhe, së dyti, tani punët qëndrojnë në mënyrë të tillë që shumica e punëtorëve polonezë, më të përparuar se tanët, më të kulturuar, qëndron në pikëpamjen e socialboronizmit, e socialpatriotizmit. Duhet të presim. Këtu nuk mund të flitet për vetëvendosjen e masave punonjëse. Ne duhet të bëjmë propagandë për këtë diferencim. Këtë ne po e bëjmë, por nuk ka asnjë pikë dyshimi se nuk mund të mos i njihet sot kombit polonez e drejta e vetëvendosjes. Kjo është e qartë. Lëvizja proletare poloneze ndjek po atë rrugë si edhe lëvizja jonë, po ecën drejt diktaturës së proletariatit, po jo ashtu si në Rusi. Dhe atje i frikësojnë punëtorët duke u thënë se moskalët, rusët, të cilët i kanë shtypur gjithmonë polonezët, duan të sjellin në Poloni shovinizmin e tyre

rusomadh, të fshehur nën emrin e komunizmit. Komunizmi nuk mund të futet në një vend me anën e dhunës. Një nga shokët më të mirë komunistë polonezë kur i thashë: «Ju do të veproni ndryshe», m'u përgjigj: «Jo, ne do të bëjmë të njëjtën gjë, por do ta bëjmë më mirë se ju». Unë s'munda të thosha asgjë kundër një argumenti të tillë. Duhet t'u lihet mundësia njerëzve të realizojnë dëshirën modeste: ta bëjnë Pushtetin Sovjetik më mirë se ne. Nuk mund të mos kemi parasysh se atje ndiqet një rrugë deri diku origjinale, dhe nuk mund të themi: «Poshtë e drejta e kombeve për vetëvendosje! Ne u japim të drejtën e vetëvendosjes vetëm masave punonjëse». Kjo vetëvendosje ndjek një rrugë shumë të ndërlikuar dhe të vështirë. Ajo nuk ekziston asgjëkundi përveç Rusisë, prandaj duhet që, duke parashikuar të gjitha fazat e zhvillimit në vendet e tjera, asgjë të mos bëhet me dekret nga Moska. Ja pse ky propozim parimisht është i papranueshëm.

...Më tej duhet të ndalem te çështja e vetëvendosjes së kombeve. Kësaj çështjeje në kritikën tonë iu dha një rëndësi e tepruar. Këtu u duk dobësia e kritikës sonë, sepse një çështjeje të tillë, e cila në thelb luan një rol më pak se të dorës së dytë në strukturën e përgjithshme të programit, në shumën e përgjithshme të kërkesave të programit, — kësaj çështjeje në kritikën tonë iu dha një rëndësi e posaçme.

Kur shoku Piatakov fliste, unë mbeta i habitur; ç'është kjo: një arsytim për programin apo një diskutim ndërmjet dy byrosh organizative. Kur shoku Piatakov thoshte se komunistët ukrainas veprojnë në përputhje me direktivat e KQ të PK(b) të Rusisë, unë nuk e kuptova se me ç'ton e thoshte ai këtë. Me ton keqardhjeje? Për këtë nuk kam dyshime për shokun Piatakov, por kuptimi i fjalimit të tij ishte i tillë: pse të gjitha këto vetëvendosje, kur në Moskë kemi një Komitet Qendror shumë të mirë! Kjo është një pikëpamje fëmijërore. Ukraina ka qenë e ndarë nga

Rusia për shkak kushtesh të jashtëzakonshme dhe lëvizja kombëtare atje nuk zuri rrënjë të thella. Kur ajo u shfaq, gjermanët e çrrënjosën atë. Ky është fakt, por fakt i jashtëzakonshëm. Atje edhe me gjuhën puna ukrainase është gjuhë masash apo jo. Masat punonjëse të kombeve të tjera ishin plot mosbesim ndaj rusëve, si komb kulak dhe shtypës. Ky është fakt. Përfaqësuesi i Finlandës më tregonte se në borgjezinë finlandeze, që i urrente rusët, dëgjohej zëra: «Gjermanët u treguan bisha më të mëdha, Antanta u tregua bishë më e madhe, më mirë le të vijnë bolshevikët». Ja fitorja më e madhe që ne korrëm mbi borgjezinë finlandeze në çështjen kombëtare. Kjo nuk do të na pengojë aspak që ta luftojmë atë si armike të klasës, duke zgjedhur për këtë mjetet e përshtatshme. Republika Sovjetike, që u krijua në vendin, carizmi i të cilit e ka shtypur Finlandën, duhet të thotë se ajo e respekton të drejtën e kombeve për pavarësi. Me qeverinë e kuqe finlandeze, që ekzistoi për një kohë të shkurtër, ne lidhëm një marrëveshje, bëmë disa lëshime territoriale, për shkak të të cilave kam dëgjuar mjaft vërejtje thjesht shoviniste: «Atje, thoshin ata, ka ndër marrje të mira peshku, dhe ju i dorëzuat ato». Këto janë vërejtje për të cilat unë thosha: hiqja pak cipën ndonjë komunisti të tillë dhe do të gjesh shovinistin rus.

Unë mendoj se ky shembull për Finlandën, ashtu si edhe për bashkirët, tregon se në çështjen kombëtare nuk duhet arsyetuar sikur medoemos duhet të ketë unitet ekonomik. Sigurisht, uniteti duhet! Por ne duhet ta arrijmë atë me anë të propagandës, të agjitacionit, me anë të një bashkimi vullnetar. Bashkirët ushqejnë mosbesim ndaj rusëve, sepse rusët janë më të kulturuar dhe e shfrytëzuan kulturën e tyre për t'i grabitur bashkirët. Prandaj në këto vende të largëta fjala rus për bashkirët do të thotë «shtypës», «batakçi». Duhet pasur parasysh kjo, duhet të luftohet kjo. Por kjo është diçka që do kohë. Kjo nuk mund të

zhduket me asnjë dekret. Në këtë punë ne duhet të jemi shumë të matur. Maturia është veçanërisht e nevojshme për një komb të tillë si kombi rus, i cili ka ngjallur në të gjitha kombet e tjera një urrejtje të tërbuar, dhe vetëm sot ne u mësuam ta ndreqim këtë, por edhe këtë e bëjmë keq. Për shembull, në Komisarriatin e Arsimit ose pranë tij ne kemi komunistë që thonë: shkolla është unike, prandaj është e ndaluar të jepni mësim në gjuhë tjetër veç rusishtes! Një komunist i tillë është shovinist rusomadh. Të tillë ka shumë ndër ne dhe duhet të luftojmë kundër tyre.

Ja pse ne duhet t'u themi kombeve të tjera se jemi internacionalistë deri në fund dhe duam bashkimin vullnetar të punëtorëve dhe fshatarëve të të gjitha kombeve. Kjo nuk i përjashton aspak luftërat. Lufta është çështje tjetër, që lind nga thelbi i imperializmit. Në qoftë se ne luftojmë kundër Uilsonit, dhe Uilsoni e kthen një komb të vogël në vegël të tij, ne themi: ne luftojmë kundër kësaj vegle. Ne nuk jemi shprehur kurrë kundër një gjëje të tillë. Ne nuk kemi thënë kurrë se republika socialiste mund të ekzistojë pa fuqinë ushtarake. Në kushte të caktuara lufta mund të paraqitet e domosdoshme. Kurse tani në çështjen e vetëvendosjes së kombeve thelbi i çështjes është se kombet e ndryshme ndjekin një rrugë historike të një-llojtë, por me zigzage dhe shtigje jashtëzakonisht të ndryshme, dhe se kombet më të kulturuara ndjekin një rrugë që ndryshon shumë nga ajo e kombeve më pak të kulturuara. Finlanda ka ndjekur tjetër rrugë. Gjermania po ndjek tjetër rrugë. Shoku Piatakov ka një mijë herë të drejtë kur thotë se kemi nevojë për bashkim. Por për këtë bashkim duhet të luftojmë me anë të propagandës, me anë të ndikimit të partisë, me anë të krijimit të bashkimeve profesionale unike. Por edhe këtu nuk mund të veprosh sipas një shablloni të vetëm. Sikur ta hiqnim këtë pikë ose ta redaktuonim ndryshe, ne do ta fshinin çështjen kombëtare nga programi. Kjo do të mund të bëhej sikur të kishte

njerëz pa veçori kombëtare. Por njerëz të tillë nuk ka dhe shoqërinë socialiste ne nuk mund ta ndërtojmë në asnjë mënyrë tjetër.

*Veprat, bot. shqip, vëll. 29,
f. 184, 185-187, 209-211*

Nga fjalimi:

«PËR DETYRAT E INTERNACIONALES III»

...Nuk mund të pajtohemi me ata që me fjalë e dënojnë imperializmin, por në të vërtetë nuk bëjnë një luftë revolucionare për çlirimin e kolonive (dhe të kombeve të varura) nga borgjezia imperialiste e vendit *të vet*. Kjo është hipokrizi. Kjo është politika e agjentëve të borgjezisë në lëvizjen punëtore (labor lieutenants of the capitalist class). Ajo parti angleze, franceze, holandeze, belgjiane etj., që me fjalë tregohet armike e imperializmit, kurse në të vërtetë nuk bën një luftë revolucionare brenda kolonive «të veta» për përmbysjen e borgjezisë «së vet», nuk e ndihmon sistematikisht punën *revolucionare* që ka filluar kudo në kolonitë, nuk çon atje armë dhe letërsi për partitë revolucionare të kolonive, është parti maskarenjsh dhe tradhtarësh.

Shkruar më 14 korrik
1919

Veprat, bot: shqip, vëll. 29,
f. 568

Nga vepra:

**«SËMUNDJA FOSHJORE E «MAJTIZMIT»
NË KOMUNIZËM»**

...Derisa ka dallime kombëtare dhe shtetërore ndërmjet popujve dhe vendeve — dhe këto dallime do të jenë edhe për shumë e shumë kohë, madje edhe pas vendosjes së diktaturës së proletariatit në shkallë botërore — uniteti i taktikës internacionale të lëvizjes komuniste punëtore të të gjitha vendeve nuk kërkon zhdukjen e këtyre dallimeve, asgjësimin e dallimeve kombëtare (kjo është një ëndërr pa kuptim për çastin e tanishëm), por një zbatim të tillë të parimeve *themelore* të komunizmit (Pushteti Sovjetik dhe diktatura e proletariatit), i cili *t'i modifikojë drejt* këto parime *në hollësitë*, t'i përshtatë drejt, t'i zbatojë në përputhje me dallimet kombëtare dhe kombëtaroshtetërore. Të analizohen, të studiohen, të zbulohen, të gjenden, të kapen veçoritë specifike kombëtare në trajtimin *konkret* që duhet të bëjë çdo vend për zgjidhjen e detyrës internacionale *unike*, për arritjen e fitores mbi oportunizmin dhe doktrinarizmin e majtë në gjirin e lëvizjes punëtore, për përmbysjen e bor-

gjezisë, për vendosjen e republikës sovjetike dhe të diktaturës proletare — ja cila është detyra kryesore e çastit historik që po kalojnë të gjitha vendet e përparuara (dhe jo vetëm të përparuara).

Shkruar në prill—maj
1920

Veprat, bot. shqip, vëll. 31,
f. 91-92

Nga «SKICA E PARË E TEZAVE PËR ÇËSHTJEN
KOMBËTARE DHE KOLONIALE»

2. Në përputhje me detyrën e saj themelore të luftës kundër demokracisë borgjeze dhe të demaskimit të gënjeshtërs dhe hipokrizisë së kësaj demokracie, partia komuniste, si shprehëse e ndërgjegjshme e luftës së proletariatit për përmbysjen e zgjedhës së borgjezisë, duhet edhe në çështjen kombëtare të vërë në krye të vendit jo parime abstrakte dhe formale, por, së pari, vlerësimin e saktë të gjendjes konkrete historike dhe, para së gjithash, të gjendjes ekonomike; së dyti, ndarjen e qartë të interesave të klasave të shtypura, punonjëse, të shfrytëzuara, nga kuptimi i përgjithshëm i interesave popullorë në përgjithësi, kuptim që shpreh interesat e klasave sunduese; së treti, një ndarje po aq të dalluar të kombeve të shtypura, të varura, pa të drejta të barabarta, nga kombet që i kanë të gjitha të drejtat, që shtypin dhe shfrytëzojnë kombe të tjera, në kundërshtim me gënjeshtërat e demokracisë borgjeze, e cila mundohet ta fshehë skllavërimin kolonial dhe financiar të shumicës dërrmuese të popullsisë së botës prej një pakice të vogël vendesh kapitaliste shumë të pasura dhe të përparuara, karakteristik për epokën e kapitalit financiar dhe të imperializmit.

3. Lufta imperialiste e vjetëve 1914-1918 ka zbuluar veçanërisht qartë përpara të gjitha kombeve dhe klasave të shtypura të mbarë botës gënjeshtrenë e frazave të demokracisë borgjeze, duke e provuar me vepra se Traktati i Versajës i «demokracive» famëkeqe «perëndimore» është, kundrejt kombeve të dobëta, një dhunë edhe më egër dhe më e poshtër se Traktati i Brest-Litovskut i junkerëve gjermanë dhe i kajzerit. Lidhja e Kombeve dhe gjithë politika e Antantës pas luftës e zbulojnë këtë të vërtetë edhe më qartë dhe me forcë edhe më të madhe, duke e forcuar kudo luftën revolucionare si të proletariatit të vendeve të përparuara, ashtu edhe të të gjitha masave punonjëse të vendeve koloniale dhe të varura, duke e shpejtuar shembjen e iluzioneve kombëtare mikroborgjeze për mundësinë e bashkëjetesës paqësore dhe të barazisë së kombeve në kapitalizëm.

4. Nga tezat themelore, që përmendëm më lart, del se në krye të gjithë politikës së Kominternit për çështjen kombëtare dhe koloniale duhet vënë afrimi i proletarëve dhe masave punonjëse të të gjitha kombeve dhe vendeve në luftën e përbashkët revolucionare për përmbysjen e çifligarëve dhe të borgjezisë. Sepse vetëm një afrim i tillë siguron fitoren mbi kapitalizmin, pa të cilën nuk mund të zhduket shtypja kombëtare dhe pabarazia.

5. Gjendja politike botërore ka vënë sot në rend të ditës diktaturën e proletariatit, dhe të gjitha ngjarjet e politikës botërore përqendrohen në mënyrë të pashmangshme rreth një pike të vetme qendrore, pikërisht: rreth luftës së borgjezisë botërore kundër Republikës Sovjetike të Rusisë, e cila grumbullon patjetër rreth vetes, nga njëra anë, lëvizjet sovjetike të punëtorëve përparimtarë të të gjitha vendeve, nga ana tjetër, të gjitha lëvizjet nacionalçlirimtare të kolonive dhe kombeve të shtypura, që po binden nga përvoja e tyre e hidhur se për ta nuk ka shpëtim përveç fitores së Pushtetit Sovjetik mbi imperializmin botëror.

6. Si rrjedhim, sot nuk mund të kufizohemi vetëm me njohjen ose shpalljen e thjeshtë të afrimit të punonjësve të kombeve të ndryshme, por duhet të ndjekim politikën e realizimit të aleancës më të ngushtë të të gjitha lëvizjeve nacionalçlirimtare dhe kolonialçlirimtare me Rusinë Sovjetike, duke i përcaktuar format e kësaj aleance në përputhje me shkallën e zhvillimit të lëvizjes komuniste në proletariatin e çdo vendi ose në lëvizjen çlirimtare demokratiko-borgjeze të punëtorëve dhe të fshatarëve në vendet e prapambetura ose ndër kombësitë e prapambetura.

...9. Në fushën e marrëdhënieve të brendshme të shteteve të ndryshme politika kombëtare e Kominternit nuk mund të kufizohet duke njohur barazinë e të drejtave të kombeve sa për sy e faqe, në mënyrë formale, thjesht deklarative dhe pa marrë asnjë detyrim konkret, siç bëjnë demokratët borgjezë — qoftë ata që e quajnë veten haptazi si të tillë, ose ata që fshihen prapa emrit socialist, siç janë socialistët e Internacionales II.

Shkeljet e vazhdueshme të barazisë së kombeve dhe të garancive të të drejtave të pakicave kombëtare në të gjitha shtetet kapitaliste, me gjithë kushtetutat e tyre «demokratike», duhet të demaskohen vazhdimisht jo vetëm në gjithë propagandën dhe agjitacionin e partive komuniste — si nga tribuna parlamentare, ashtu edhe jashtë saj — por duhet gjithashtu, së pari, të shpjegohet sistematikisht se vetëm rendi sovjetik është në gjendje të sigurojë praktikisht barazinë e kombeve, duke bashkuar në fillim proletarët, pastaj gjithë masën e punonjësve në luftën kundër borgjezisë; së dyti, duhet që të gjitha partitë komuniste të ndihmojnë drejtpërdrejt lëvizjet revolucionare në kombet e varura ose që nuk gëzojnë të drejta të barabarta (për shembull, në Irlandë, ndër zezakët e Amerikës etj.) dhe në kolonitë.

Pa këtë kusht të fundit, veçanërisht të rëndësishëm, lufta kundër shtypjes së kombeve të varura

dhe të kolonive, si dhe njohja e të drejtave të tyre për t'u veçuar si shtet më vete mbeten si një tabelë e rreme, siç e shohim në partitë e Internacionales II.

10. Pranimi i internacionalizmit me fjalë dhe zëvendësimi praktik i tij, në gjithë propagandën, agjitacionin dhe punën praktike, me nacionalizmin dhe pacifizmin mikroborgjez është dukuria më e zakonshme jo vetëm te partitë e Internacionales II, por edhe te ato që kanë dalë nga kjo Internationale, dhe madje disa herë edhe te ato që sot e quajnë veten parti komuniste. Lufta kundër kësaj së keqeje, kundër paragjyqimeve kombëtare mikroborgjeze më të vjetra, bëhet aq më e rëndësishme, sa më aktuale bëhet detyra e shndërrimit të diktaturës së proletariatit nga diktaturë kombëtare (d.m.th. që ekziston në një vend të vetëm dhe nuk është e aftë të përcaktojë politikën botërore) në diktaturë ndërkombëtare (d.m.th. në diktaturë të proletariatit të paktën të disa vendeve të përparuara, që është e aftë të ushtrojë një ndikim vendimtar mbi gjithë politikën botërore). Nacionalizmi mikroborgjez shpall si internacionalizëm vetëm njohjen e barazisë së kombeve, duke e lënë (pa folur pastaj se kjo njohje bëhet vetëm me fjalë) të paprekur egoizmin kombëtar, kurse internacionalizmi proletar kërkon, së pari, që interesat e luftës proletare në një vend t'u nënshtrohen interesave të kësaj lufte në gjithë botën; së dyti, kërkon që kombi, i cili po korr fitoren mbi borgjezinë, të jetë i aftë dhe i gatshëm të bëjë sakrificat më të mëdha kombëtare për përmbysjen e kapitalit ndërkombëtar.

Kështu në shtetet që janë plotësisht kapitaliste, ku ka parti punëtore që janë me të vërtetë pararoja e proletariatit, lufta kundër shtrembërimeve oportuniste dhe paciste mikroborgjeze të nocionit dhe të politikës së internacionalizmit është detyra e parë dhe më e rëndësishmja.

11. Për sa u përket shteteve dhe kombeve më të prapambetura, ku mbizotërojnë marrëdhëniet feudale

ose patriarkale dhe patriarkale-fshatare, duhet pasur sidomos parasysh:

së pari, se është e domosdoshme që të gjitha partitë komuniste të ndihmojnë lëvizjen çlirimtare demokratiko-borgjeze në këto vende; detyra për të dhënë ndihmën më aktive u takon, në radhë të parë, punëtorëve të atij vendi prej të cilit varet vendi i prapambetur nga pikëpamja koloniale ose financiare;

së dyti, se është e domosdoshme të luftohen kleri dhe elementët e tjerë reaksionarë dhe mesjetarë, që kanë influencë në vendet e prapambetura;

së treti, se është e domosdoshme të luftohen panislamizmi dhe rrymat e këtij lloji, që orvaten ta lidhin lëvizjen çlirimtare kundër imperializmit evropian dhe amerikan me forcimin e pozitave të hanëve, çifligarëve, mullahëve etj.;

së katërti, se është e domosdoshme të përkrahet posaçërisht lëvizja fshatare në vendet e prapambetura kundër çifligarëve, kundër pronës së madhe të tokës, kundër çdo shfaqjeje ose mbeturine të feudalizmit, dhe të bëhen përpjekje për t'i dhënë lëvizjes fshatare një karakter sa më revolucionar, duke siguruar një aleancë sa më të ngushtë të proletariatit komunist të Evropës Perëndimore me lëvizjen revolucionare të fshatarëve në Lindje, në kolonitë dhe vendet e prapambetura në përgjithësi; në mënyrë të veçantë duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për t'i zbatuar parimet themelore të rendit sovjetik në vendet ku sundojnë marrëdhëniet parakapitaliste, duke krijuar «Sovjetët e punonjësve» etj.;

së pesti, se është e domosdoshme një luftë e vendosur kundër orvatjeve për t'u dhënë rrymave çlirimtare demokratiko-borgjeze në vendet e prapambetura ngjyrën e komunizmit; Internacionalja Komuniste duhet të përkrahë lëvizjet demokratiko-borgjeze kombëtare në kolonitë dhe në vendet e prapambetura vetëm me kusht që elementet e partive të ardhshme proletare, komuniste jo vetëm me emër,

në të gjitha vendet e prapambetura të mbliidhen dhe të edukohen me ndërgjegjen e detyrave të tyre të posaçme, të detyrave të luftës kundër lëvizjeve demokratiko-borgjeze në gjirin e kombit të tyre; Internacionalja Komuniste duhet të marshojë përkohësisht në aleancë me demokracinë borgjeze të kolonive dhe të vendeve të prapambetura, por të mos shkrihet me të dhe ta ruajë medoemos pavarësinë e lëvizjes proletare edhe në formën e saj më embrionale;

së gjashti, se është e domosdoshme të demaskohet dhe t'u shpjegohet vazhdimisht masave më të gjera punonjëse të të gjitha vendeve, sidomos të vendeve të prapambetura, gënjeshta që përdorin sistematikisht fuqitë imperialiste, të cilat, duke bërë sikur krijojnë shtete politikisht të pavarura, krijojnë në të vërtetë shtete plotësisht të varura prej tyre si nga pikëpamja ekonomike, ashtu edhe nga pikëpamja financiare dhe ushtarake; në rrethanat e sotme ndërkombëtare për kombet e varura dhe të dobëta nuk ka shpëtim veçse të bashkohen në republika sovjetike.

12. Shtypja shekullore e popujve kolonialë dhe të dobët nga fuqitë imperialiste ka lënë ndër masat punonjëse të vendeve të shtypura jo vetëm zemërim, por edhe mosbesim ndaj kombeve shtypëse në përgjithësi, duke përfshirë edhe proletariatin e këtyre kombeve. Tradhtia e poshtër që i ka bërë socializmit shumica e udhëheqësve zyrtarë të këtij proletariati në vjetët 1914-1919, kur prapa «mbrojtjes së atdheut» fshihej në mënyrë socialshoviniste mbrojtja e «së drejtës» të borgjezisë «së vet» për të shtypur kolonitë dhe për të grabitur vendet e varura nga pikëpamja financiare, nuk mund të mos e shtonte këtë mosbesim krejt të ligjshëm. Nga ana tjetër, sa më i prapambetur është një vend, aq më i fortë është në këtë vend prodhimi i vogël bujqësor, aq më të forta janë marrëdhëniet patriarkale dhe zakonet lokale, që patjetër u japin një forcë dhe qëndrueshmëri të veçantë paragjytimeve më të thella mikroborgjeze, pikërisht: pa-

ragjykimeve të egoizmit kombëtar, të ngushtësisë kombëtare. Pasi këto paragjykime mund të zhduken vetëm pas zhdukjes së imperializmit dhe kapitalizmit në vendet e përparuara dhe pas ndryshimit rrënjësor të të gjithë bazës së jetës ekonomike të vendeve të prapambetura, zhdukja e këtyre paragjykimeve nuk mund të mos jetë shumë e ngadalshme. Nga kjo lind detyra e domosdoshme për proletariatin komunist të ndërgjegjshëm të të gjitha vendeve të tregojë urtësi dhe kujdes të veçantë për mbeturinat e ndjenjave kombëtare në vendet dhe popujt që kanë qenë të shtypur për një kohë shumë të gjatë, dhe gjithashtu detyra e domosdoshme për të bërë disa lëshime, me qëllim që të zhduken sa më shpejt ky mosbesim dhe këto paragjykime. Pa vullnetin e proletariatit, dhe pastaj të të gjitha masave punonjëse të të gjitha vendeve dhe kombeve të mbarë botës për t'u lidhur dhe për t'u bashkuar, çështja e fitores mbi kapitalizmin nuk mund të kurorëzohet me sukses.

Botuar në qershor 1920

*Veprat, bot. shqip, vëll. 31,
f. 153-155, 156-160*

Nga «KUSHTET PËR PRANIMIN NË INTERNACIONALEN KOMUNISTE»

Në çështjen e kolonive dhe të kombësive të shtypura duhet ndjekur vija veçanërisht e saktë dhe e qartë e partive të atyre vendeve, borgjezia e të cilave i zotëron këto koloni dhe shtyp kombe të tjera. Çdo parti që dëshiron të bëjë pjesë në Internacionalen III ka për detyrë të demaskojë pa mëshirë dallaveret e imperialistëve «të vet» në kolonitë, të përkrahë jo me fjalë por me vepra çdo lëvizje çlirimtare në koloni, të kërkojë dëbimin e imperialistëve të vendit të vet nga këto koloni, të edukojë në zemrat e punëtorëve të vendit të vet një qëndrim më të vërtetë vëllazëror për popullsinë punonjëse të kolonive dhe të kombësive të shtypura dhe të zhvillojë një agjitacion sistematik në ushtrinë e vendit të vet kundër çfarëdo shtypjeje të popujve kolonialë.

Botuar në korrik 1920

*Veprat, bot. shqip, vëll. 31,
f. 228*

**Nga «RAPORTI I KOMISIONIT PËR ÇËSHTJEN
KOMBËTARE DHE KOLONIALE NË KONGRESIN II
TË INTERNACIONALES KOMUNISTE»**

26 korrik 1920

Së pari, cila është ideja më e rëndësishme, ideja themelore e tezave tona? Dallimi ndërmjet popujve të shtypur dhe popujve shtypës. Ne e theksojmë këtë dallim — ndryshe nga Internacionalja II dhe demokracia borgjeze. Në epokën e imperializmit për proletaria-tin dhe Internacionalen Komuniste është veçanërisht e rëndësishme të vërehen faktet ekonomike konkrete, dhe në zgjidhjen e të gjitha çështjeve koloniale dhe kombëtare ato të mos nisen nga teza abstrakte, por nga të vërteta konkrete.

Një tipar karakteristik i imperializmit është se gjithë bota, siç e shohim, ndahet sot në një numër të madh popujsh të shtypur dhe në një numër fare të vogël popujsh shtypës, të cilët zotërojnë pasuri kolosale dhe një forcë ushtarake të madhe. Shumica dërrmuese, që përbëhet nga më shumë se një miliard, ndoshta një miliard e një çerek frymë, po ta marrim numrin e gjithë popullsisë së botës 1 miliard e 750 milionë frymë, d.m.th. rreth 70% e popullsisë së

botës, bën pjesë ndër popujt e shtypur, të cilët ose gjenden nën një varësi koloniale të drejtpërdrejtë, ose janë shtete gjysmëkoloniale, si, për shembull, Persia, Turqia, Kina, ose, pasi u mundën nga ushtria e një fuqie të madhe imperialiste, në bazë të traktateve të paqes u gjendën nën një varësi të madhe të kësaj fuqie. Kjo ide e dallimit, e ndarjes së popujve në shtypës dhe të shtypur përshkon të gjitha tezat, jo vetëm tezat e para që dolën me nënshkrimin tim dhe që ishin botuar më parë, por edhe tezat e shokut Roi. Këto të fundit janë shkruar kryesisht nga pikëpamja e gjendjes së Indisë dhe të popujve të tjerë të mëdhenj aziatikë, të shtypur nga Anglia, dhe këtu qëndron rëndësia e tyre shumë e madhe për ne.

Mendimi i dytë udhëheqës i tezave tona është se në gjendjen e sotme të botës, pas luftës imperialiste, marrëdhëniet ndërmjet popujve dhe gjithë sistemi botëror i shteteve përcaktohen nga lufta e grupit të vogël të kombeve imperialiste kundër lëvizjes sovjetike dhe shteteve sovjetike, në krye të të cilave është Rusia Sovjetike. Po të mos e kemi këtë parasysh, ne nuk do të mund të shtrojmë drejt asnjë çështje kombëtare ose koloniale, edhe sikur të jetë fjala për këndin më të largët të botës. Vetëm duke u nisur nga kjo pikëpamje, çështjet politike mund të shtrohen dhe të zgjidhen drejt nga partitë komuniste si në vendet e qytetëruara, ashtu edhe në vendet e prapambetura.

Së treti, unë do të dëshiroja të nënvizoja veçanërisht çështjen e lëvizjes demokratiko-borgjeze në vendet e prapambetura. Pikërisht kjo çështje ngjalli disa divergjenca. Diskutimi bëhej nëse është e drejtë parimisht dhe teorikisht të thuhet se Internacionalja Komuniste dhe partitë komuniste duhet ta përkrahin apo jo lëvizjen demokratiko-borgjeze në vendet e prapambetura; si rrjedhojë e këtij diskutimi ne arritëm njëzëri në vendimin që në vend të lëvizjes «demokratiko-borgjeze» të flitet për lëvizje kombëtare-revolucionare. S'ka as më të voglin dyshim se çdo lëvizje kombë-

tare mund të jetë vetëm demokratiko-borgjeze, sepse masa kryesore e popullsisë në vendet e prapambetura përbëhet nga fshatarësia; që është përfaqësuese e marrëdhënieve kapitaliste-borgjeze. Do të ishte utopi të mendohej se partitë proletare, në qoftë se ato përgjithësisht mund të lindin në vende të tilla, do të mundën, pa hyrë në marrëdhënie të caktuara me lëvizjen fshatare dhe pa e përkrahur atë në fakt, të zbatojnë taktikën komuniste dhe politikën komuniste në këto vende të prapambetura. Por këtu u bënë vërejtje se po të flasim për lëvizje demokratiko-borgjeze, atëherë do të zhduket çdo dallim ndërmjet lëvizjes reformiste dhe asaj revolucionare. Mirëpo ky dallim këto kohët e fundit është shfaqur në mënyrë fare të qartë në vendet e prapambetura dhe koloniale, sepse borgjezia imperialiste përpiqet me të gjitha forcat ta rrënojë lëvizjen reformiste edhe ndër popujt e shtypur. Ndërmjet borgjezisë së vendeve shfrytëzuese dhe asaj koloniale ka pasur njëfarë afrimi, kështu që shumë shpesh — ndoshta, edhe në shumicën e rasteve — borgjezia e vendeve të shtypura, ndonëse përkrah lëvizjet kombëtare, në të njëjtën kohë në marrëveshje me borgjezinë imperialiste, d.m.th. së bashku me të, lufton kundër të gjitha lëvizjeve revolucionare dhe klasave revolucionare. Në komision kjo u provua në mënyrë të pakundërshtueshme, dhe ne arritëm në mendimin se e vetmja gjë e drejtë është që të kihet parasysh ky dallim dhe të zëvendësohet pothuajse kudo shprehja «demokratiko-borgjeze» me shprehjen «kombëtare-revolucionare». Kuptimi i këtij zëvendësimi është se ne, si komunistë, duhet t'i përkrahim dhe do t'i përkrahim lëvizjet çlirimtare borgjeze në vendet koloniale vetëm në rastet kur këto lëvizje janë me të vërtetë revolucionare. kur përfaqësuesit e tyre nuk do të na pengojnë që ne të edukojmë dhe të organizojmë në frymën revolucionare fshatarësinë dhe masat e gjera të të shfrytëzuarve. Dhe në qoftë se mungojnë edhe këto kushte, atëherë komunistët në këto

vende duhet të luftojnë kundër borgjezisë reformiste, së cilës i përkasin edhe heronjtë e Internacionales II. Partitë reformiste ekzistojnë tashmë në vendet koloniale dhe nganjëherë përfaqësuesit e tyre e quajnë veten socialdemokratë dhe socialistë. Dallimi i sipërpërmendur tani është bërë në të gjitha tezat, dhe unë mendoj se me këtë pikëpamja jonë tani është formuluar shumë më sak.

*Veprat, bot. shqip, vëll. 31,
f. 264-267*

NGA LETRA DËRGUAR G. ZINOVIEVIT

Nuk mund të kuptohet lufta e sotme, pa kuptuar epokën.

Kur flitet kështu për epokën, kjo nuk është një frazë boshe. Kjo është e drejtë. Edhe citatet që nxirrni ju nga artikujt e mi të vjetër nuk tregojnë veçse këtë. *Ato janë të drejta...*

Por kur fillohet të nxirret përfundimi: «në epokën e imperializmit nuk mund të ketë luftëra kombëtare», kjo është krejt pa kuptim. Ky është një gabim që duket sheshit, një gabim edhe historik edhe politik edhe *logjik* (sepse epoka është një shumë dukurish të shumëllojshme, në të cilën përveç tipikes ka gjithnjë edhe gjëra të tjera).

Dhe ju e përsëritni këtë gabim kur shkruani në shënimet:

||| «në epokën e tanishme vendet e vogla nuk mund ta mbrojnë atdheun»

[= vulgarizuesit]

Nuk është e vërtetë!! Ky është pikërisht gabimi i Juniusit, Radekut, «çarmatuesve» dhe japonezëve!!

Duhet thënë: «Edhe vendet e vogla në luftërat imperialiste, sidomos në luftërat tipike për epokën e sotme imperialiste, nuk mund ta mbrojnë atdheun».

Ka ndryshim.

Gjithë thelbi i këtij ndryshimi është kundër *vulgarizuesve*. Kurse ju nuk e keni vënë re pikërisht këtë *thelb*.

Grimi përsërit gabimin e *vulgarizuesve*, kurse ju e *nxitni* atë, duke i dhënë një formulim të gabuar Përkundrazi, pikërisht tani (si në bisedimet, ashtu edhe në artikujt) duhen përgënjeshtruar përpara Grimin *vulgarizuesit*.

Ne nuk jemi aspak kundër «mbrojtjes së atdheut» *në përgjithësi*, nuk jemi kundër «luftërave mbrojtëse» *në përgjithësi*. Këto marrëzira *nuk* mund t'i gjeni kurrë në asnjë rezolucion (dhe në asnjë artikull tim). Ne jemi kundër mbrojtjes së atdheut dhe mbrojtjes *në luftën imperialiste* të vjetëve 1914-1916 dhe në luftërat e tjera *imperialiste*, të cilat janë tipike për *epokën imperialiste*. Por në *epokën imperialiste* **mund** të ketë edhe luftëra «të drejta», «mbrojtëse», revolucionare [pikërisht: 1) kombëtare; 2) civile; 3) socialiste *etj*].

Shkruar në gusht 1916

Veprat, bot. shqip, vëll. 35,
f. 220-221

J. V. STALIN

SI E KUPTON SOCIALDEMOKRACIA ÇËSHTJEN KOMBËTARE?

I

Çdo gjë ndryshon. . . Ndryshon jeta shoqërore dhe bashkë me të ndryshon edhe «çështja kombëtare». Në kohë të ndryshme dalin klasa të ndryshme në arenën e luftës, dhe çdo klasë e kupton «çështjen kombëtare» pas mënyrës së vet. Pra, «çështja kombëtare» në kohë të ndryshme *u shërben interesave të ndryshme*, merr forma të ndryshme sipas klasës, *e cila e shtron këtë çështje dhe kur e shtron.*

Këtu te ne kemi pasur, për shembull, të ashtuquajturën «çështje kombëtare» të fisnikëve, kur pas «Bashkimit të Gjeorgjisë me Rusinë» fisnikët e Gjeorgjisë e ndienin se sa keq ishte për ta humbja e privilegjeve të vjetra dhe e fuqisë që kishin në kohën e carëve gjeorgjianë, dhe duke e quajtur «shtetësinë e thjeshtë» një cenim të dinjitetit të tyre dëshironin «çlirimin e Gjeorgjisë». Me këtë ata donin të vinin në krye të «Gjeorgjisë» mbretërit gjeorgjianë dhe fisnikët dhe t'u jepnin, në këtë mënyrë, në dorë fatin e popullit gjeorgjian! Ky ishte një nacionalizëm monarkik-feudal. Kjo «lëvizje» nuk la asnjë gjurmë të dukshme në

jetën e gjeorgjianëve, nuk fitoi lavdi me asnjë fakt, përveç disa kompleteve të fisnikëve gjeorgjianë kundër sundimtarëve rusë në Kaukaz. Dhe sapo ngjarjet e jetës shoqërore e prekën pak këtë «lëvizje» që ishte vetiu e dobët, menjëherë ajo u zhduk krejt. Dhe me të vërtetë zhvillimi i prodhimit të mallrave, heqja e bujkrobërisë, themelimi i bankës së fisnikëve, shtimi i antagonizmit të klasave në qytet e në fshat, forcimi i lëvizjes së fshatarësisë së varfër etj., të gjitha këto u dhanë një grusht për vdekje fisnikëve gjeorgjianë dhe bashkë me ta edhe «nacionalizmit monarkik-feudal». Fisnikët gjeorgjianë u ndanë në dy grupe. Një pjesë hoqi dorë nga çdo «nacionalizëm» dhe i shtriu dorën autokracisë ruse për të marrë si shpërblim prej saj pozita të mira, kredi të lirë dhe vegla bujqësore, në mënyrë që qeveria ta siguronte nga «kryengritësit» fshatarë etj. Grupi tjetër, grupi më i dobët i fisnikëve gjeorgjianë, zuri miqësi me peshkopët dhe arkimandridët gjeorgjianë, dhe në këtë mënyrë «nacionalizmin» e ndjekur nga jeta e futi në krahët e klerikalizmit. Ky grup me zell të madh i ka hyrë rindërtimit të kishave të prishura të Gjeorgjisë (ky është neni kryesor i «programit» të tij!), të «monumenteve të madhështisë së shkuar» dhe pret duarkryq mrekullinë që do të realizojë «dëshirat» e tij *monarkike — feudale*.

Pra, nacionalizmi monarkik-feudal mori formë klerikale në minutat e fundit të jetës së tij.

Krahas kësaj jeta shoqërore ndër ne ngriti në vendin tonë çështjen kombëtare të borgjezisë. Kur e ndjeu borgjezia e re gjeorgjiane se sa e vështirë ishte për të konkurrenca e lirë me kapitalistët e «huaj», atëherë me gojën e nacionaldemokratëve gjeorgjianë filloi të pëshpëriste për *Gjeorgjinë e pavarur*. Borgjezia gjeorgjiane donte ta mbronte tregun gjeorgjian me një kordon doganor, të dëbonte me forcë nga tregu i Gjeorgjisë borgjezinë e «huaj», të ngrinte artificialisht çmimin e mallrave dhe me këto manovra «patriotike» të korrite suksese në fushën e pasurimit.

Ky ka qenë dhe mbetet qëllimi i nacionalizmit të borgjezisë gjeorgjiane. Është e tepërt të themi se për të arritur këtë qëllim duhej një forcë, dhe forca ishte te proletariati. Vetëm proletariati mund t'i jepte jetë «patriotizmit» të kalbur të borgjezisë. Duhej bërë me vetë proletariati, dhe kështu dolën në skenë «nacionaldemokratët». Ata zbrazën shumë fishekë për të përgënjeshtuar socializmin shkencor, i shanë shumë socialdemokratët dhe u këshilluan proletarëve gjeorgjiane që të largoheshin prej tyre; ata lavdëronin proletariatin gjeorgjian dhe mundoheshin ta bindnin atë «për interesat e vetë punëtorëve» që të forcohej deri diku borgjezia gjeorgjiane. Ata u luteshin me këmbëngulje proletarëve të Gjeorgjisë: mos e merrni më qafë «Gjeorgjinë» (apo borgjezinë gjeorgjiane?), harroni «mosmarrëveshjet e brendshme», miqësohuni me borgjezinë gjeorgjiane etj. Por më kot! Parullat bajate të publicistëve borgjezë nuk e vunë dot në gjumë proletariatin gjeorgjian! Sulmet e pamëshirshme të marksistëve gjeorgjiane, sidomos aksionet e fuqishme të klasës duke u shkrirë në një ushtri të vetme socialiste të rusëve, ermenëve, gjeorgjianeve e proletarëve të tjerë, u dhanë një grusht dërrmues *nacionalistëve tanë borgjezë* dhe i dëbuan nga sheshi i luftës.

«Për të vënë në vend prapë emrin e njollosur» patriotët tanë të arratisur duhej të ndërronin të paktën bojën, të paktën të visheshin me një robe socialiste, në qoftë se nuk mund t'i përvetësonin pikëpamjet socialiste. Dhe me të vërtetë doli në skenë «*Sakartveloja*», një organ nationalist borgjez ilegal... me nder të themi «socialist». Kështu donin t'i mashtronin punëtorët gjeorgjiane! Po ishte vonë! Punëtorët gjeorgjiane mësuan të ndanin të zezën nga e bardha, ata e kuptuan shpejt se nationalistët borgjezë «kishin ndërruar vetëm bojën», por jo thelbin e pikëpamjeve të tyre, se «*Sakartveloja*» ishte *socialist vetëm me emër*. Ata e kuptuan këtë dhe u tallën me «shpëtimtarët» e

Gjeorgjisë! Nuk u vërtetuan shpresat e donkishotëve të «Sakartvelos»!

Nga ana tjetër, zhvillimi ynë ekonomik hedh pak nga pak një urë në mes të rretheve përparimtare të borgjezisë gjeorgjiane dhe të «Rusisë», i lidh ekonomisht dhe politikisht këto rrethe me «Rusinë» dhe kështu shkallmon terrenin e lëkundur me kohë të nacionalizmit borgjez. Ky është grushti i dytë për nacionalizmin borgjez!

Doli në shesh të luftës një klasë e re, «proletaria-ti», dhe bashkë me të lindi «çështja kombëtare» e re, «çështja kombëtare» e proletariatit. Sa ndryshon proletariati nga fisnikëria dhe borgjezia, aq ndryshon edhe «çështja kombëtare» e ngritur prej proletariatit nga «çështja kombëtare» e fisnikërisë dhe e borgjezisë.

Tani po flasim për këtë «nacionalizëm».

Si e kupton socialdemokracia «çështjen kombëtare»?

Proletariati i Rusisë ka kohë që po flet për luftë. Siç dihet qëllimi i çdo lufte është fitorja. Por për fitoren e proletariatit duhet bashkimi i gjithë punëtorëve pa ndryshim kombësie. Është e qartë se shembja e barrierave kombëtare dhe bashkimi i ngushtë i proletarëve rusë, gjeorgjianë, armenë, polonezë, çifutë e të tjerë është kusht i domosdoshëm për fitoren e proletariatit të Rusisë.

Këto janë interesat e proletariatit të Rusisë.

Por autokracia e Rusisë, si armiku më i egër i proletariatit të Rusisë, e kundërshton gjithnjë çështjen e bashkimit të proletarëve. Kjo ndjek pa mëshirë kulturën kombëtare, gjuhën, zakonet dhe institucionet e kombësive të «huaja» të Rusisë. Autokracia u heq të drejtat civile të domosdoshme, i shtyp nga çdo pikëpamje, mbjell me hipokrizi ndër ta mosbesimin dhe armiqësinë, i shtyn në përleshje të përgjakshme, duke treguar kështu se i vetmi qëllim i autokracisë ruse është të përçajë kombet që përbëjnë Rusinë, të thellojë midis tyre grindjen kombëtare, të forcojë ba-

rrierat kombëtare dhe në këtë mënyrë të përçajë më mirë proletariatin, ta ndajë më mirë proletariatin e Ruisë në grupe të vogla kombëtare dhe të varrosë kështu ndërgegjen e punëtorëve si klasë, bashkimin e tyre si klasë.

Këto janë interesat e reaksionit rus, kjo është politika e autokracisë ruse.

Është e qartë se interesat e proletariatit të Ruisë shpejt a vonë do të ndeshin patjetër me politikën reaksionare të autokracisë cariste. Kështu ndodhi dhe pikërisht në këtë terren lind në socialdemokracinë «çështja kombëtare».

Si të shemben barrierat kombëtare që janë ngritur midis kombeve, si të zhduket izolimi kombëtar, që kështu të afrohen më mirë dhe të lidhen më ngushtë proletarët e Ruisë?

Kjo është përmbajtja e «çështjes kombëtare» në socialdemokracinë.

Të ndahen në parti kombëtare më vete dhe të formojnë prej tyre një «bashkim të lirë», përgjigjen socialdemokratët-federalistë.

Po këtë gjë thotë dhe «Organizata punëtore social-demokrate armene».

Siç e shihni, na këshillojnë të mos bashkohemi në një parti të vetme të Ruisë me një qendër të përbashkët në krye, por të ndahemi në disa parti, me disa qendra drejtuese, për të forcuar kështu unitetin e klasës! «Ne duam t'i afrojmë proletarët e kombeve të ndryshme. Ç'duhet të bëjmë? I largoni proletarët nga njëri-tjetri dhe do t'ia arrini qëllimit! — përgjigjen socialdemokratët-federalistë. Ne duam t'i bashkojmë proletarët në një parti. Ç'duhet të bëjmë? E ndani proletariatin e Ruisë në parti më vete dhe do t'ia arrini qëllimit! — përgjigjen socialdemokratët-federalistë. Ne duam të zhdukim barrierat kombëtare. Ç'masa të marrim? Përforconi barrierat kombëtare me barrierat organizative dhe do t'ia arrini qëllimit! — përgjigjen ata. Dhe të gjitha këto na i këshillojnë neve,

proletarëve të Ruisë, që luftojmë po në ato kushte politike, që kemi të njëjtin armik të përbashkët! Me një fjalë, na thonë: veproni sipas qejfit të armiqve dhe varroseni me duart tuaja qëllimin tuaj të përbashkët.

Po le të pranojmë për një çast ato që thonë socialdemokratët-federalistë dhe të shkojmë pas tyre, të shohim ku do të na shpien! Si thotë fjala: ndiqe gënjeshtarin gjer në prag të gënjeshtërs.

Ta zëmë se ne i dëgjuam federalistët tanë dhe formuam parti kombëtare të veçanta. Ç'rezultate do të kemi?

Është lehtë të kuptohet. Në qoftë se gjer më sot, gjersa ishim *centralistë*, vëmendjen kryesore e drejtonim te kushtet e *përbashkëta* të gjendjes së proletarëve, te *uniteti* i interesave të tyre dhe për «ndryshimet» e tyre «kombëtare» flisnim vetëm aq sa për të mos qenë në kundërshtim me interesat e tyre të *përbashkëta*, në qoftë se gjer më sot çështja kryesore për ne ishte çështja se ç'i afron proletarët e kombësive të Ruisë, ç'kanë të përbashkët ata, në mënyrë që në bazë të këtyre interesave të përbashkëta të ndërtohet një parti e centralizuar e punëtorëve të të gjithë Ruisë, tani që «ne» u bëmë federalistë na tërheq vëmendjen një çështje e re më kryesore: ç'i dallon proletarët e kombësive të Ruisë, cili është ndryshimi ndërmjet tyre, që kështu në bazë të «ndryshimit kombëtar» të ndërtohen parti kombëtare të veçara. Në këtë mënyrë, «ndryshimet kombëtare» që për centralistin janë të dorës së dytë, për federalistin bëhen themeli i partive kombëtare.

Po të ndjekim edhe më tutje këtë rrugë, do të shtrëngohejmë shpejt a vonë të themi se «ndryshimet kombëtare» «ndryshime» të tjera, p.sh. të proletarit armen, janë po ato të borgjezisë armene, se proletari armen dhe borgjezia armene kanë zakone dhe karakter të njëjtë, se ata përbëjnë një popull, «një komb» të pandarë. Kështu nuk jemi larg nga «terreni

i njëjtë i veprimit të përbashkët», ku duhet të qëndrojnë edhe borgjezët edhe proletarët dhe t'i zgjatin dorën njëri-tjetrit miqësisht si anëtarë të po atij «kombi». Dhe politika hipokrite e carit autokrat mund të duket një provë e «re» e kësaj miqësie, kurse bisedimet për antagonizmin e klasave do të duken një «doktrinari-zëm pa vend». Pa mund të dalë pastaj dhe një dorë poetike që të prekë «më me guxim» telat fare kombëtare që janë ende ndër proletarët e kombësive të Rusisë dhe t'i bëjë të tingëllojnë sipas avazit që duhet. Sharlatanizmi shovinist do të fitojë kredi (besim), miqtë do të duken armiq, armiqtë do të duken miq, do të lindë pështjellimi, do të thërrmohet ndërgjegjja e klasës së proletariatit të Rusisë.

Në këtë mënyrë, në vend që të zhdukim barrierat kombëtare, për hir të federalistëve do t'i forcojmë edhe më tepër me barrierë organizative; në vend që të shpiem përpara ndërgjegjen e klasës së proletariatit, do ta hedhim prapa dhe do ta vëmë në prova të rrezikshme. «Do të gëzohet zemra» e carit autokrat, se kurrë nuk do të kishte mundur të gjente ndihmë të tillë falas si ne.

Për këtë qen kemi përpjekur?

Dhe më në fund, në një kohë kur neve na duhet një parti e bashkuar, e shkathët, e centralizuar, Komiteti Qendror i së cilës të mund të ngrejë më këmbë përnjëherë punëtorët e gjithë Rusisë dhe t'i shpjerë në sulm vendimtar kundër autokracisë dhe borgjezisë, ata na japin në dorë «bashkimin federalist» të shëmtuar, të copëtuar në parti të veçuara! Në vend të armës të mprehtë na japin një armë të ndryshkur dhe na thonë: me këtë, gjoja, do t'i zhdukni shpejt armiqtë tuaj për vdekje.

Ja ku na shpien socialdemokratët-federalistë!

Por meqenëse ne nuk duam «t'i forcojmë barrierat kombëtare», por t'i zhdukim, meqenëse nuk na duhet një armë e ndryshkur, por një armë e mprehtë për të shkukur nga rrënja padrejtësinë e sotme, me-

qenëse nuk duam t'i shkaktojmë armikut gaz, por helm dhe ta zhdukim nga faqja e dheut, pra, është e qartë se detyra jonë është t'u kthejmë shpinën federalistëve dhe të gjejmë një përgjigje më të mirë për zgjidhjen e «çështjes kombëtare».

II

Gjer tani thamë se si nuk duhet zgjidhur «çështja kombëtare». Tani do të themi se si duhet zgjidhur kjo çështje, domethënë si e ka zgjidhur partia punëtore socialdemokrate*.

Pikësëpari duhet të kujtojmë se partia socialdemokrate që punon në Rusi e ka quajtur veten të Rusisë (dhe jo *ruse*). Duket sheshit se me këtë ajo ka dashur të na tregojë se kërkon të grumbullojë nën flamurin e saj jo vetëm proletarët rusë, por edhe proletarët e *gjithë kombësive* të Rusisë, dhe për rrjedhojë ajo do të marrë gjithë masat për të zhdukur *barrierat kombëtare* që janë ngritur në mes të tyre.

Pastaj partia jonë e spastroi «çështjen kombëtare» nga mjegulla që e mbulonte, që i jepte një pamje misterioze, e ndau këtë çështje në elementet e saj të ndryshme, i dha secilës prej tyre karakterin e kërkesës së klasës dhe i paraqiti në program si artikuj më vete. Në këtë mënyrë na tregoi qartë se të ashtuquajturat «interesa kombëtare» dhe «kërkesa kombëtare» të *marra më vete* nuk kanë një vlerë të veçantë, se këto «interesa» dhe «kërkesa» meritojnë vëmendjen vetëm kur shprien përpara ose mund të shprien

* Nuk është e tepërt të përmendim se ato që do të themi më poshtë janë një koment i artikujve të programit të partisë sonë për çështjen kombëtare.

përpara ndërgjegjen e klasës së proletariatit, zhvillimin e tij si klasë.

Kështu Partia Punëtore Socialdemokrate e Rusisë caktoi qartë rrugën që ndjek dhe qëndrimin që ka marrë në zgjidhjen e «çështjes kombëtare».

Cilat janë pjesët që përbëjnë «çështjen kombëtare»?

Ç'kërkojnë zotërinjtë socialdemokratë-federalistë?

1) «Barazinë civile për kombësitë e Rusisë»?

Ju shqetëson juve pabarazia civile në Rusi? Doni ju t'u ktheni kombësive të Rusisë të drejtat civile që ua ka hequr qeveria dhe prandaj kërkoni barazi civile për këto kombësi? Po mos jemi ne vallë kundër *kësaj* kërkese? Ne e kuptojmë fare mirë ç'rëndësi të madhe kanë të drejtat civile për proletarët. Të drejtat civile janë një armë lufte; t'u heqësh këto të drejta do të thotë t'u heqësh armën, dhe kush nuk e di se proletarët pa armë nuk mund të luftojnë mirë? Për proletariatin e Rusisë është e domosdoshme që proletarët e të gjitha kombësive të Rusisë të luftojnë mirë, se sa më mirë të luftojnë këta proletarë, aq më tepër do të zhvillohet ndërgjegjja e klasës dhe sa më tepër të zhvillohet ndërgjegjja e klasës, aq më i fortë do të jetë uniteti i klasës së proletariatit të Rusisë. Po, të gjitha këto i dimë dhe prandaj luftojmë dhe do të luftojmë me gjithë forcat tona për barazinë civile të kombësive të Rusisë! Lexoni nenin 7 të programit të partisë sonë, ku partia flet për «barazi të plotë të drejtash për gjithë qytetarët pavarësisht nga seksi, feja, raca e kombësia» dhe do të shihni se Partia Punëtore Socialdemokrate e Rusisë merr përsipër realizimin e këtyre kërkesave.

Ç'kërkojnë tjetër socialdemokratët-federalistë?

2) «Liri gjuhe për kombësitë e Rusisë»?

Ju shqetëson juve që proletarëve të kombësive «të huaja» të Rusisë u është pothuajse ndaluar të mësojnë në gjuhën amtare, të flasin gjuhën amtare në institucionet shoqërore, shtetërore e të tjera? Me të

vërtetë ka përse të shqetësohet njeriu! Gjuha është një mjet zhvillimi dhe lufte. Kombet e ndryshme kanë gjuhë të ndryshme. Interesat e proletariatit të Rusisë kërkojnë që proletarët e kombësive të Rusisë të kenë të drejtë të plotë të përdorin atë gjuhë me të cilën mund të luftojnë më mirë kundër armiqve në mbledhje, në institucione shoqërore, shtetërore e të tjera. Kjo gjuhë është *gjuha amtare*. Proletarëve të kombësive të «hua-ja» u hiqet gjuha amtare, dhe a mundet që ne të heshtim — thonë ata. E mirë pra; si i përgjigjet për këtë çështje proletariatit të Rusisë programi i partisë sonë? Lexoni nenin 8 të programit të partisë sonë, ku partia jonë kërkon: «Të drejtën e popullsisë të mësojë në gjuhën amtare, duke e siguruar këtë me çeljen e shkollave të nevojshme me shpenzimet e shtetit dhe të organeve autonome, të drejtën për çdo qytetar që të flasë në gjuhën amtare në mbledhjet, të futet gjuha amtare baras me gjuhën e shtetit në gjithë institucionet shoqërore dhe shtetërore lokale», lexoni gjithë këtë dhe do të bindeni se Partia Punëtore Socialdemokrate e Rusisë merr përsipër edhe realizimin e kësaj kërke.

Çkërkojnë tjetër socialdemokratët-federalistë?

3) «Autonomi për kombësitë e Rusisë»?

Mos doni të thoni me këtë se po ato ligje nuk mund të zbatohen njësoj në vende të ndryshme të shtetit të Rusisë, në vende që ndryshojnë prej njëri-tjetrit nga kushtet e veçanta të jetës dhe nga përbërja e popullsisë? Doni që këtyre vendeve t'u jepet e drejta t'i përshtatin ligjet e përgjithshme shtetërore sipas kushteve të tyre të veçanta? Në është kështu, në është kjo brendia e kërkesës suaj, atëherë duhet t'i jepet edhe forma e duhur, duhet zhdukur pështjellimi, mjegulla nacionaliste dhe sendet të thirren me emrin e tyre. Dhe po të ndiqni këtë këshillë, do të bindeni se ne nuk jemi aspak kundër kësaj kërke. Nuk kemi asnjë dyshim se vendet e ndryshme të shtet-

tit të Ruisisë, që ndryshojnë prej njëri-tjetrit nga kushtet e veçanta të jetës dhe nga përbërja e popullsisë, nuk mund ta zbatojnë njësoj kushtetutën e shtetit, se këtyre vendeve u duhet dhënë e drejta të zbatojnë kushtetutën e përgjithshme shtetërore, në atë formë që u sjell dobinë më të madhe, në atë formë me të cilën mund të zhvillohen në mënyrë më të plotë forcat politike që ka populli. Këtë kërkojnë interesat e klasës së proletariatit të Ruisisë. Dhe po të lexoni nenin 3 të programit të partisë sonë, ku partia jonë «kërkon autonomi të gjerë lokale, autonomi krahinore për ato vende që kanë kushte të veçanta jete dhe që ndryshojnë nga përbërja e popullsisë», atëherë do të shihni se Partia Punëtore Socialdemokrate e Ruisisë e ka spastruar që në fillim këtë kërkesë nga mjeçulla nacionaliste dhe pastaj ka marrë përsipër realizimin e saj.

4) Ju na tregoni autokracinë cariste që ndjek egërsisht «kulturën kombëtare» të kombësive të «huaja» të Ruisisë, që ndërhyjnë egërsisht në jetën e brendshme të tyre dhe i shtyp nga çdo pikëpamje, që ka prishur (dhe vazhdon të prishë) barbarisht institucionet kulturore të finlandezëve, që ka rrëmbyer në mënyrë grabitqare pasurinë kombëtare armene e të tjera? Ju kërkonin garanci nga dhunimet grabitqare të autokracisë? Po ne vallë nuk i shohim dhunimet e autokracisë cariste dhe nuk kemi luftuar vallë kurdoherë kundër këtyre dhunimeve? Sot të gjithë e dinë se si qeveria e sotme e Ruisisë po i shtyp dhe po i mbyt kombësitë e «huaja» të Ruisisë. Gjithashtu nuk ka dyshim se një politikë e tillë e qeverisë çdo ditë e prish dhe e vë përpara një prove të rrezikshme ndërgjegjen e klasës së proletariatit të Ruisisë. Pra, ne kudo dhe kurdoherë do të luftojmë kundër politikës korruptuese të qeverisë cariste. Pra, ne kudo dhe kurdoherë do të mbrojmë nga dhunimet policore të autokracisë jo vetëm institucionet e dobishme të këtyre kombësive, por edhe ato që nuk janë të dobishme, sepse interesat e

proletariatit të Rusisë na tregojnë se vetëm vetë kombësitë kanë të drejtë të asgjësojnë ose të zhvillojnë këtë ose atë anë të kulturës së tyre kombëtare. Por lexoni nenin 9 të programit tonë. Vallë nuk bëhet fjalë për këtë në nenin 9 të programit të partisë sonë, që shkaktoi, si të thuash, shumë thashetheme si ndër armiqtë tanë, ashtu edhe ndër miqtë?

Por këtu na presin fjalën dhe na këshillojnë të mos flasim për nenin 9. Pse? — pyesim ne. «Sepse», përgjigjen ata, ky nen i programit tonë «është në kundërshtim flagrant» me nenet 3, 7 dhe 8 të këtij programi, sepse, në qoftë se kombësive u jepet e drejta të rregullojnë punët e tyre kombëtare sipas vullnetit të tyre (shih nenin 9), atëherë në këtë program nuk do të ketë vend për nenet 3, 7 dhe 8, dhe përkundrazi, në qoftë se këto nene mbeten në program, atëherë pa dyshim duhet hequr nga programi neni 9. Diçka të tillë thotë sigurisht «Sakartveloja»* kur me mendjelehtësinë që e dallon pyet: «ç'logjikë është kjo t'i thuash një kombi unë të jap autonomi krahinore dhe njëkohësisht t'i përmendësh se ai ka të drejtë t'i rregullojë gjithë punët e veta kombëtare sipas vullnetit të tij?» (Shih «Sakartvelo» Nr. 9). «Duket» në program ka hyrë një kontradiktë logjike, «duket» për ta zhdukur këtë kontradiktë duhen hequr prej programit një ose disa nene! Po, «patjetër» duhen hequr, sepse, siç e shihni, vetë logjika proteston me gojën e të palogjikshmit «Sakartvelo».

Më kujtohet një legjendë e vjetër. Ishte një herë një «anatomist i ditur». Ai kishte «çdo gjë» që i duhet një anatomisti të «vërtetë»: diplomën, lokalin, instrumentet, pretendime të mëdha. I mungonte vetëm një

* Përmendim këtu «Sakartvelon» vetëm për të sqaruar më mirë brendinë e nenit 9. Qëllimi i këtij neni është të kritikojë socialdemokratët-federalistë dhe jo «Sakartvelistët» që ndryshojnë rrënjësisht prej të parëve (shih kapitullin 1).

gjë e vogël: njohuria për anatominë. Një herë iu lutën të shpjegonte se si lidheshin me njëra-tjetrën pjesët e skeletit që kishte hedhur e shpërndarë mbi tryezën anatomike. Kështu «dijetarit tonë të dëgjuar» i erdhi rasti për t'u shquar. «Dijetari» me bujë të madhe dhe në mënyrë solemne nisi nga «puna». Po ç'fatkeqësi! «Dijetari» nuk merrte vesh fare nga anatomia dhe nuk dinte se si t'i bashkonte pjesët për të formuar skeletin! I shkreti u mundua për një kohë të gjatë djersiu shumë, por më kot! Më në fund kur u ngatërrua fare dhe nuk nxori asgjë në shesh rrëmbeu disa pjesë të skeletit, i flaku tej dhe i shau në mënyrë filozofike njerëzit «që kishin qëllime të këqija» e që gjoja i kishin vënë mbi tryezë pjesë të rreme të skeletit. Natyrisht spektatorët qeshën me të madhe me «anatomistin e ditur».

Një «aventurë» e tillë i ndodhi edhe «Sakartvelos». Këtij iu tek të analizonte programin e partisë sonë, po si duket nuk diti ç'është programi ynë dhe si duhet studiuar, nuk kuptoi lidhjen ndërmjet neneve të ndryshme të këtij programi, nuk diti kuptimin e çdo neni veç e veç dhe kështu na këshillon «në mënyrë filozofike»: meqenëse unë nuk i kuptova dot akësh artikuj të programit tuaj, prandaj (!) duhet t'i hiqni nga programi.

Po unë nuk dua të tallem me «Sakartvelon» qesharak. Thonë: i shtriri përtokë nuk goditet! Përkundrazi unë jam gati që edhe të ndihmoj për të shpjeguar programin tonë, po me kusht që «Sakartveloja» 1) të pranojë me gojën e vet padijen e vet, 2) të më dëgjojë me vëmendje dhe 3) të jetë në harmoni me logjikën*.

* E quaj të domosdoshme të lajmëroj lexuesit se «Sakartveloja» qysh në numrat e parë i ka shpallur luftë logjikës, si prangave kundër të cilave duhet luftuar. Mos vini re që «Sakartveloja» shpesh flet në emër të logjikës, këtë e bën nga mendjehhtësia dhe mungesa e kujtesës që e karakterizojnë.

Ja si është puna. Nenet 3, 7 dhe 8 të programit tonë dolën në terrenin e *centralizmit politik*. Kur Partia Punëtore Socialdemokrate e Rusisë i vuri këto nene në program të saj, ajo udhëhoqej nga pikëpamja se e ashtuquajtura zgjidhje «përfundimtare» e «gështjes kombëtare», domethënë «çlirimi» i kombësive të «huaja» të Rusisë, po të flasim në përgjithësi, nuk mund të bëhet gjersa sundimi politik është në duart e borgjezisë. Kjo ka dy shkaqe: e para, zhvillimi i sotëm ekonomik po hedh një urë në mes të «kombësive të huaja» dhe «Rusisë», po vendos lidhje gjithnjë e më të mëdha në mes tyre dhe në këtë mënyrë ngjall ndjenja miqësie në rrethet drejtuese të borgjezisë së këtyre kombësive, gjë që minon bazën e ndjenjave të tyre «nacionalçlirimtare», dhe e dyta, duke folur përgjithësisht, proletariati, nuk do të përkrahë të ashtuquajturën lëvizje «nacionalçlirimtare», pasi gjer më sot çdo lëvizje e tillë është bërë në dobi të borgjezisë, ka prishur dhe gjymtuar ndërgjegjen e klasës së proletariatit. Këto pikëpamje lindën idenë e *centralizmit politik* dhe nenet 3, 7 dhe 8 të programit të partisë sonë që kushtëzohen prej saj.

Porse kjo, siç është thënë më sipër, është pikëpamje e përgjithshme.

Por kjo nuk përjashton që mund të krijohet kushte ekonomike dhe politike të tilla, kur rrethet përparimtare të borgjezisë së kombësive të «huaja» të duan «çlirim kombëtar».

Mund të ndodhë edhe që kjo lëvizje të jetë e dobishme për zhvillimin e ndërgjegjes së klasës së proletariatit.

Si duhet të veprojë atëherë partia jonë?

Pikërisht për raste të tilla të mundshme është vënë në programin tonë neni 9, pikërisht duke parashikuar rrethana të tilla të mundshme u jepet kombësive e drejta të përpiqen t'i rregullojnë punët e tyre kombëtare sipas dëshirës së tyre (për shembull, «të çlirohen» fare, të ndahen).

Partia jonë, një parti që ka për qëllim të drejtojë proletariatin që lufton në tërë Rusinë, duhet të jetë e përgatitur për raste të tilla të mundshme në jetën e proletariatit dhe pikërisht për këto arsye ajo duhet të fuste një nen të tillë në programin e saj.

Kështu duhet të veprojë çdo parti parashikuese dhe largpamëse.

Mirëpo, si duket, «dijetarët» e «Sakartvelos» dhe disa socialdemokratë-federalistë nuk janë të kënaqur nga ky kuptim i nenit 9. Ata kërkojnë një përgjigje «të prerë», «të drejtpërdrejtë» për këtë pyetje: është e dobishme apo e padobishme për proletariatin «pavarësia kombëtare»?

Më kujtohen metafizikët rusë nga gjysma e shekullit XIX, të cilët i mërzitnin duke i pyetur dialektikët e asaj kohe nëse shiu ishte i dobishëm apo i dëmshëm për të korurat dhe kërkonin prej tyre një përgjigje të «prerë». Për dialektikët nuk ishte zor të provonin se mënyra e të shtruarit të problemit nuk ishte aspak shkencore, në kohë të ndryshme duhet t'i jepet përgjigje e ndryshme kësaj pyetjeje, se kur ka thatësi shiu është i dobishëm, dhe kur kemi një mot me shi shumë, shiu jo vetëm që nuk është i dobishëm por madje i dëmshëm, pra, kuptohet, të kërkojë një përgjigje «të prerë» për këtë pyetje është sheshit marrëzi.

Po gazeta «Sakartvelo» nuk ka përfituar aspak nga këta shembuj.

Një përgjigje të tillë, të «prerë», kërkonin prej marksistëve përkrahësit e Bernshtajnit për pyetjen: nëse janë të dobishme apo të dëmshme për proletariatin kooperativat (domethënë shoqëritë e konsumit dhe të prodhimit). Për marksistët nuk ishte zor të provonin se mënyra si ishte shtruar problemi nuk kishte asnjë kuptim. Ata shpjeguan në mënyrë shumë të thjeshtë se çdo gjë varet nga koha dhe vendi, se atje ku ndërgjegjja e klasës së proletariatit ka arritur nivelin e duhur të zhvillimit, ku proletariati është

bashkuar në një parti të fortë politike, atje kooperativat mund t'i sjellin proletariatis një dobi të madhe, po të merret vetë partia me krijimin dhe drejtimin e tyre; kurse atje ku nuk janë këto kushte, atje kooperativat janë të dëmshme për proletariatin, sepse ngjallin ndër punëtorët prirje bakalli dhe një frymë të ngushtë esnafi, duke e prishur në këtë mënyrë ndër-gjegjen e tyre të klasës.

Po edhe ky shembull nuk u sollli dobi «Dakartvelistëve». Ata pyesin gjithnjë me më shumë këmbëngulje: a është e dobishme apo e dëmshme për proletariatin pavarësia kombëtare? Jepni një përgjigje të prerë!

Ne shohim se rrethana që mund të lindin dhe të zhvillojnë një lëvizje «nacionalçlirimtare» në borgjezinë e kombësive të «huaaja» sot për sot nuk ka dhe nuk janë aq të pashmangshme në të ardhmen, ne i kemi pranuar vetëm si rrethana të mundshme. Përveç kësaj, sot për sot nuk është e mundur të dihet në ç'shkallë zhvillimi do të jetë atëherë ndër-gjegjja e klasës së proletariatis, sa e dobishme ose e dëmshme do të jetë për proletariatin kjo lëvizje! Bëhet pyetja: në ç'bazë të ndërtohet* përgjigjja e «prerë» për këtë pyetje, nga ta nxjerrim këtë? Nuk është vallë marrëzi të kërkosh një përgjigje të «prerë» kur çështjet janë kështu?

Është e qartë se zgjidhja e kësaj çështjeje duhet t'u libet vetë kombësive të «huaaja», kurse ne duhet të fitojmë për ta të drejtën e zgjidhjes së kësaj çështjeje. Le të vendosin vetë kombësitë kur të kërkohet prej tyre kjo gjë: a është e dobishme apo e dëmshme për ta «pavarësia kombëtare» dhe, në është e dobishme,

* Zotërinjtë «Sakartvelistë» kërkesat e tyre i ndërtojnë kurdoherë mbi rërë dhe nuk e marrin dot me mend se ka njerëz që mund të gjejnë një bazë më të shëndoshë për kërkesat e tyre.

në ç'forma duhet realizuar ajo? Vetëm ata mund ta zgjidhin këtë çështje!

Kështu, në bazë të nenit 9, kombësive «të huaja» u lihet e drejta t'i rregullojnë punët e tyre kombëtare sipas dëshirës së vet. Dhe ne, në bazë të këtij neni, kemi për detyrë të përpiqemi që dëshirat e këtyre kombësive të jenë me të vërtetë socialdemokrate, që këto dëshira të bazohen në interesat e klasës së proletariatit. Për këtë qëllim proletarët e gjithë kombësive duhet të edukohen me frymën socialdemokrate, disa zakone, doke dhe institucione «kombëtare» reacionare t'i shtrohen kritikës së ashpër socialdemokrate, çka nuk na pengon aspak t'i mbrojmë këto zakone, doke dhe institucione nga dhunimet policore.

Kjo është ideja kryesore e nenit 9.

Është lehtë të vërë re njeriu lidhjen e thellë logjike që ka ky nen i programit tonë me parimet e luftës së klasës së proletariatit. Dhe meqë gjithë programi ynë është ngritur mbi këtë parim, vetvetiu kuptohet lidhja logjike e nenit 9 me nenet e tjera të programit të partisë sonë.

Kokëtrashi «Sakartvelo», prandaj quhet një organ shtypi «i ditur», se nuk i tret dot këto mendime të thjeshta.

Ç'na mbetet tjetër prej «çështjes kombëtare»?

5) «Mbrotjtja e frymës kombëtare dhe vetive të saj.»?

Po ç'janë «fryma kombëtare dhe vetitë e saj»?

Shkenca me materializmin dialektik e ka provuar se nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë «frymë kombëtare». A e ka përgënjeshtuar njeri këtë tezë të materializmit dialektik? Historia na thotë se nuk e ka përgënjeshtuar njeri. Pra, ne e kemi për detyrë ta pranojmë këtë tezë të shkencës, e kemi për detyrë të përsëritim bashkë me shkencën se nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë «frymë kombëtare». Dhe në qoftë se është kështu, në qoftë se nuk ka asnjë «frymë kombëtare», atëherë kuptohet vetiu se çdo mbrotjtje e diçkaje që nuk ekziston është absurditet logjik, që sjell

me vete patjetër pasojat përkatëse historike (të padëshiruara). Absurditete të tilla «filozofike» i kanë hije ndoshta vetëm «Sakartvelos», organit të partisë revolucionare të social-federalistëve gjeorgjianë (shih «Sakartvelo» Nr. 9)*.

* Ç'është kjo «parti» me një emër kaq të çuditshëm? «Sakartveloja» tregon (shih shtojcën e parë të Nr. 10 të «Sakartvelos») se «në pranverë të këtij viti u mblodhën në mërgim revolucionarët gjeorgjianë: anarkistët gjeorgjianë, përkrahësit e «Sakartvelos», social-revolucionarët gjeorgjianë dhe... u bashkuan... në «partinë» e social-federalistëve gjeorgjianë». Po, pikërisht anarkistët, të cilët përkrahin me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt çdo politikë, social-revolucionarët që adhurjnë politikën, «Sakartvelistët», të cilët mohojnë çdo masë terroriste dhe anarkiste, — ja ç'laraganë, që mohojnë njëri-tjetrin, janë bashkuar... si duket, në një «parti»! Një lesh e li idesh, që njeriu s'mund ta kuptojë! Ja ku nuk mërzhitesh! Gabohen ata organizatorë që pohojnë se për të bashkuar njerëzit në parti duhet unitet parimesh! Jo unitet parimesh, na thonë këta laraganë, por mungesa e parimeve është baza mbi të cilën duhet të ngrihet «partia»! Qoftë larg nga ne «teoria», parimet — këto pranga robërie! Sa më shpejt të shpëtojmë prej tyre, aq më mirë — flozofojnë këta laraganë. Dhe në të vërtetë sapo që këta njerëz shpëtuan nga parimet, menjëherë ndërjuan... një kështjellë karte — më ndjeni — «partinë e social-federalistëve gjeorgjianë». Si duket, «shtatë vetë e gjysmë» po të mblidhen bashkë mund të formojnë në çdo kohë «partinë»! Dhe si të mos qeshë njeriu kur këta të paditur, «oficerë» pa ushtri, nisin e flozofojnë: Partia Punëtore Socialdemokrate e Rusisë «është antisocialiste, reaksionare» e të tjera. Socialdemokratët rusë janë «shovinistë»; Bashkimi i Kaukazit i partisë sonë i nënshfrohët si «skllav» Komitetit Qendror të Partisë e të tjera (shih rezolucionet e konferencës së parë të revolucionarëve gjeorgjianë). Më tepër nuk mund të pritej nga mbeturinat arkeologjike të kohës së Bakuninit.

Kështu qëndron puna në çështjen kombëtare.

Siç e shihni partia jonë e ndau këtë çështje në pjesë të ndryshme, nxori prej saj lëngun, e derdhi nëpër dejt e programit të saj dhe në këtë mënyrë tregoi se si duhet zgjidhur «çështja kombëtare» në socialdemokracinë, që kështu të përmbysen nga themeli barrierat kombëtare, pa u larguar asnjë çast nga parimet tona.

Pyetjet, pse duhen partitë kombëtare të veçanta? Ose ku është ajo «bazë» socialdemokrate, mbi të cilën duhet të ndërtohen pikëpamjet organizative dhe politike të socialdemokratëve federalistë? Një «bazë» e tillë nuk duket gjëkund, nuk ekziston. Socialdemokratët federalistë qëndrojnë pezull në erë.

Ata kanë dy rrugë për të dalë nga kjo gjendje e papëlqyer. Ose duhet të heqin dorë një herë e mirë nga pikëpamja e proletariatit revolucionar dhe të pranojnë parimin e forcimit të barrierave kombëtare (oportunizëm në formën federaliste); ose duhet të heqin dorë nga çdo federalizëm në organizimin e partisë, të ngrenë me guxim flamurin e zhdukjes së barrierave kombëtare dhe të bashkohen me kampin e për-bashkët të Partisë Punëtore Socialdemokrate të Rusisë.

«Proletariatis Brzolla» Nr. 7,
1 shtator 1904

Veprat, bot. shqip, vëll. 1,
f. 32-55

Si janë drurët ashtu janë edhe pemët, si janë fabrikat ashtu janë edhe mallrat.*

* Duhet theksuar se veprimet e bashkërenduara të pjesëve të veçanta të partisë sonë, disa «individëve» jonormalë u janë dukur si «nënshtrim prej skllavi» Tërë kjo vjen nga dobësia e nervave, thonë mjekët.

PËR HEQJEN E KUFIZIMEVË KOMBËTARE

Një nga plagët e Rusisë së vjetër, që e kishin mbuluar me turp, është plaga e shtypjes kombëtare.

Ndjekjet fetare dhe kombëtare, rusifikimi me forcë i «të huajve», shtypja e institucioneve kulturore-kombëtare, mungesa e të drejtave elektorale, mungesa e lirisë së lëvizjes prej një vendi në një tjetër, ndërsimi i kombësive kundër njëra-tjetrës, pogromet dhe vrasjet,

kjo është shtypja famëkeqe kombëtare.

Si mund të çlirohemi nga shtypja kombëtare?

Baza shoqërore e shtypjes kombëtare, forca që e mban gjallë këtë, është aristokracia agrare, e cila po jeton ditët e saj të fundit. Sa më afër pushtetit të qëndrojë ajo, sa më fort ta mbajë atë në duart e veta, aq më e fuqishme është shtypja kombëtare, aq më të shëmtuara janë format e saj.

Në Rusinë e vjetër, kur ishte në fuqi aristokracia feudale agrare, shtypja kombëtare kishte arritur kulmin dhe kthehej shpeshherë në pogrome (pogromet kundër izraelitëve) dhe në vrasje (vrasjet ndërmjet armenëve dhe tatarëve).

Në Angli, ku aristokracia agrare (lendlordët) e ndanë pushtetin me borgjezinë, ku prej kohësh është zhdukur sundimi absolut i kësaj aristokracie, — shtypja kombëtare është më e butë, më pak çnjerëzore,

sigurisht, në qoftë se nuk merret parasysh se gjatë luftës, kur pushteti kaloi në duart e lendlordëve, shtypja kombëtare u bë shumë më e theksuar (ndjekjet e irlandezëve, indusve).

Kurse në Zvicër dhe në Amerikën Veriore, ku nuk ka dhe nuk ka pasur lendlordizëm, ku tërë pushtetin e ka në dorë borgjezia, — kombësitë zhvillohen pak a shumë lirisht dhe, në përgjithësi, pothuajse nuk ka shtypje kombëtare.

Të gjitha këto shpjegohen kryesisht ngaqë aristokracia agrare nga vetë pozita e saj është (nuk mund të mos jetë!) armiku më i vendosur dhe i papajtueshëm i çdo lloj lirie, duke përfshirë edhe lirinë kombëtare, se liria, përgjithësisht, dhe liria kombëtare, veçanërisht, minon (nuk mund të mos minojë) vetë themelet e sundimit politik të aristokracisë agrare.

Ta heqësh nga skena politike aristokracinë feudale, t'ia shkëputësh nga duart pushtetin, — kjo do të thotë pikërisht të zhdukësh shtypjen kombëtare, të krijosh në fakt kushtet e nevojshme për lirinë kombëtare.

Me fitoren e vet revolucioni rus i ka krijuar në fakt këto kushte, duke përmbysur pushtetin feudal dhe duke vendosur liritë.

Tani është e nevojshme:

1) të përcaktohen të drejtat e kombësive të çliruara nga shtypja dhe

2) të vendosen ato me ligj.

Pikërisht në këtë bazë lindi dekreti i Qeverisë së Përkohshme për heqjen e kufizimeve fetare dhe kombëtare.

E shtyrë nga revolucionimi që po rritet, Qeveria e Përkohshme duhej ta bënte këtë hap të parë drejt çlirimit të popujve të Rusisë, dhe ajo e bëri.

Në përgjithësi dekreti s'bën tjetër veçse heq kufizimet e të drejtave të qytetarëve me kombësi joruse dhe me besim joortodoks: 1) për t'u vendosur në mënyrë të përhershme, për të zgjedhur vendbanimin dhe

për të lëvizur nga një vend në një tjetër; 2) për të fituar të drejtën e pronësisë etj; 3) për të ushtruar zejet dhe tregtinë e çdo lloji etj; 4) për të marrë pjesë në shoqëritë aksionare dhe në shoqëritë e tjera; 5) për të marrë nëpunësi shtetërore etj; 6) për të ndjekur mësimet në shkollat; 7) për të përdorur gjuhët dhe dialektet e tjera përveç rusishtes në mbajtjen e letërkëmbimit me shoqëritë private, në shkollat private të çdo lloji dhe në mbajtjen e librave tregtarë.

Ky është dekreti i Qeverisë së Përkohshme.

Popujt e Rusisë që deri më sot kanë qenë mbajtur nën vërejtje, tani mund të marrin frymë lirisht, mund ta ndiejnë veten qytetarë të Rusisë.

Kjo është shumë e mirë.

Por do të ishte gabim i pafalshëm të mendohej se ky dekret është i mjaftueshëm për të siguruar lirinë kombëtare dhe se çështja e çlirimit nga shtypja kombëtare është çuar deri në fund.

Para së gjithash, dekreti nuk vendos barazinë kombëtare për sa i përket gjuhës. Në paragrafin e fundit të dekretit flitet për të drejtën e përdorimit të gjuhëve të tjera, përveç rusishtes në mbajtjen e letërkëmbimit me shoqëritë private dhe në shkollat private. Po si duhet vepruar me krahinat ku shumicën kompakte nuk e përbëjnë qytetarët rusë, por qytetarët që nuk flasin rusisht (Transkaukazia, Turkestan, Ukraina, Lituania etj.)? S'ka dyshim se ato do të kenë (duhet të kenë!) kuvendet e tyre, pra edhe «letërkëmbim» (aspak «privat»!), si dhe shkolla (jo vetëm «private»!) — të gjitha këto, sigurisht, jo vetëm në rusisht, por edhe në gjuhët lokale. A mendon Qeveria e Përkohshme ta shpallë rusishten si gjuhë shtetërore, duke ua hequr krahinave të sipërpërmendura të drejtën të mbajnë «letërkëmbimin» dhe të «bëjnë mësimin» në shkollat e tyre aspak «private» në gjuhën amtare? Është e qartë se po. Po kush, përveç naivëve, mund të besojë se kjo është barazia e plotë kombë-

tare, barazi për të cilën çirren e bërtasin nëpër të gjitha udhëkryqet ndrikullat borgjeze të «Rjeçit» dhe «Djenjit»? Kush nuk e kupton se kjo do të thotë legalizim i pabarazisë kombëtare për sa i përket gjuhës?

Më tej. Ai që do të vendosë barazinë e vërtetë kombëtare nuk mund të kufizohet vetëm me masën negative duke hequr kufizimet, por nga kjo anasë ai duhet të kalojë në një plan pozitiv, i cili të sigurojë zhdukjen e shtypjes kombëtare.

Prandaj duhet shpallur:

1) autonomia politike (jo federata!) e krahinave që formojnë tërësinë ekonomike territoriale me përbërje etnike dhe me një mënyrë jetese të veçantë, me «letërkëmbimin» dhe me «shkollat» në gjuhën amtare;

2) e drejta e vetëvendosjes për ato kombe që për arsye të ndryshme nuk mund të mbeten brenda kufijve të një shteti të vetëm.

Kjo është rruga që shpie në zhdukjen e vërtetë të shtypjes kombëtare dhe që u siguron kombësive maksimumin e lirisë së mundshme në regjimin kapitalist.

«Pravda» Nr. 17,
25 mars 1917

Veprat, bot. shqip, vëll. 3,
f. 16-19

PER PAVARËSINË E FINLANDËS

Referat i mbajtur më 22 dhjetor 1917 në mbledhjen e KQE të Rusisë

Këto ditë përfaqësuesit e Finlandës na u drejtuan duke kërkuar që ne të njohim menjëherë pavarësinë e plotë të Finlandës dhe të miratojmë shkëputjen e saj nga Rusia. Si përgjigje Këshilli i Komisarëve të Popullit vendosi ta pranonte këtë kërkesë dhe të nxjerrë një dekret për pavarësinë e plotë të Finlandës, dekret që është botuar në gazetën.

Ja teksti i vendimit të Këshillit të Komisarëve të Popullit:

«Duke iu përgjigjur kërkesës së qeverisë finlandeze për njohjen e pavarësisë së Republikës Finlandeze, Këshilli i Komisarëve të Popullit, në përputhje të plotë me parimet e së drejtës së kombeve për vetëvendosje, vendos t'i parashtojë Komitetit Qendror Ekzekutiv këto propozime: a) të njihet pavarësia shtetërore e Republikës Finlandeze dhe b) të organizohet, në marrëveshje me qeverinë finlandeze, një komision i posaçëm (i përbërë nga përfaqësuesit e të dyja palëve) për hartimin e masave praktike që kërkon shkëputja e Finlandës nga Rusia».

Kuptohet se Këshilli i Komisarëve të Popullit

nuk mund të vepronte ndryshe, sepse kur një popull, nëpërmjet përfaqësuesve të vet, kërkon njohjen e pavarësisë së tij, një qeveri proletare, duke u bazuar në parimin e së drejtës së popujve për vetëvendosje, duhet ta plotësojë këtë kërkesë.

Shtypi borgjez deklaroi se ne e kemi çuar vendin drejt shkatërrimit të plotë dhe se kemi humbur një varg vendesh, duke përfshirë edhe Finlandën. Por ne, shokë, nuk kishim si ta humbnim atë, sepse ajo nuk ka qenë kurrë prona jonë. Po ta mbanim Finlandën me forcë, kjo nuk do të thoshte aspak se ne e kishim fituar atë.

Ne e dimë fare mirë se si Vilhelmi, me anën e forcës dhe të arbitraritetit, «fiton» shtete të tëra dhe ç'atmosferë marrëdhëniesh krijohet në këtë mënyrë ndërmjet popullit dhe shtypësve të tij.

Parimet e socialdemokracisë, parullat dhe aspiratat e saj kërkojnë që të krijohet një atmosferë besimi ndërmjet popujve, atmosferë e pritur prej kohësh; vetëm në këto kushte mund të realizohet parulla «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Kjo është diçka e vjetër dhe dihet prej të gjithëve.

Po t'i shqyrtojmë më me kujdes kushtet në të cilat e fitoi pavarësinë e saj Finlanda, do të shohim se në fakt Këshilli i Komisarëve të Popullit, kundër vullnetit të tij, nuk ia dha lirinë as popullit as përfaqësuesve të proletariatit të Finlandës, por borgjezisë finlandeze, e cila, në saje të një gërshetimi të çuditshëm rrethanash, e rrëmbeu pushtetin dhe mori pavarësinë nga duart e socialistëve të Ruisë. Punëtorët dhe socialdemokratët finlandezë u ndodhën në një pozitë të tillë që duhej ta merrnin lirinë jo drejtpërdrejt nga duart e socialistëve të Ruisë, por me anën e borgjezisë finlandeze. Duke e parë këtë si një tragjedi të proletariatit finlandez, ne nuk mund të mos vëmë në dukje se socialdemokratët finlandezë, vetëm për shkak të pavendosmërisë dhe frikës së pakuptu-

eshme, nuk bënë ndonjë hap vendimtar për ta marrë vetë pushtetin dhe për t'ia rrëmbyer nga duart pavarësinë e tyre borgjezisë finlandeze.

Mund të qortohet Këshilli i Komisarëve të Popullit, mund të kritikohet ai, por nuk ka njerëz që të mund të thonë se Këshilli i Komisarëve të Popullit nuk i përmbush premtimet e veta, sepse s'ka forcë në botë që ta detyrojë Këshillin e Komisarëve të Popullit të heqë dorë nga premtimet e tij. Këtë ne e treguam duke mbajtur një qëndrim krejt të paanshëm ndaj kërkesave të borgjezisë finlandeze për t'i dhënë pavarësinë Finlandës, dhe menjëherë nxorëm dekretin për pavarësinë e Finlandës.

Pavarësia e Finlandës le të lehtësojë, pra, çështjen e çlirimit të punëtorëve dhe fshatarëve të Finlandës dhe le të krijojë një bazë të shëndoshë për miqësinë ndërmjet popujve tanë.

*Veprat, bot. shqip, vëll. 4,
f. 21-23*

REVOLUCIONI I TETORIT DHE ÇËSHTJA KOMBËTARE

Çështja kombëtare nuk duhet quajtur si diçka e vetëmjaftueshme, e dhënë një herë e përgjithmonë. Duke qenë vetëm një pjesë e çështjes së përgjithshme të transformimit të rendit ekzistues, çështja kombëtare përcaktohet krejtësisht nga kushtet e gjendjes shoqërore, nga karakteri i pushtetit të vendit dhe, në përgjithësi, nga gjithë procesi i zhvillimit shoqëror. Kjo duket me qartësi të veçantë në periudhën e revolucionit në Rusi, kur çështja kombëtare dhe lëvizja kombëtare në krahinat periferike të Rusisë ndryshojnë përmbajtjen e tyre me shpejtësi dhe haptazi, sipas zhvillimit dhe përfundimit të revolucionit.

I

REVOLUCIONI I SHKURTIT DHE ÇËSHTJA KOMBËTARE

Në epokën e revolucionit borgjez në Rusi (shkurt 1917) lëvizja kombëtare në krahinat periferike kishte karakterin e një lëvizjeje çlirimtare borgjeze. Kombë-

sitë e Rosisë, prej shekujsh të shtypura dhe të shfrytëzuara nga «regjimi i vjetër», për herë të parë e ndjenë veten të forta dhe u vërsulën në betejën kundër shtypësve. «Të zhduket shtypja kombëtare» — kjo ishte parulla e lëvizjes. Krahinat periferike të Rosisë u mbushën përnjëherësh me institucione «kombëtare». Në krye të lëvizjes marshuan inteligjencia vendase demokratiko-borgjeze. «Sovjetët kombëtarë» në Letoni, në krahinën estone, Lituani, Gjeorgji, Armeni, Azerbajxhan, në Kaukazin Verior, në Kirgizi dhe në Vollgën e Mesme; «Rada» në Ukrainë dhe në Bjellorusi; «Stafull-Cerii» në Besarabi; «Kurulltai» në Krime dhe në Bashkiri; «qeveria autonome» në Turkestan, — këto ishin institucionet «kombëtare», rreth të cilave grumbulloi forcat borgjezia kombëtare. Qëllimi ishte çlirimi nga carizmi, si «shkak kryesor» i shtypjes kombëtare, dhe formimi i shteteve borgjeze kombëtare. E drejta e kombeve për vetëvendosje interpretohet si një e drejtë që i takonte borgjezisë kombëtare në krahinat periferike për të marrë pushtetin në duart e saj dhe për ta shfrytëzuar revolucionin e shkurtit për formimin e shtetit «të saj» kombëtar. Zhvillimi i mëtejshëm i revolucionit nuk hynte dhe nuk mund të hynte në planet e institucioneve të lartpërmendura borgjeze. Nga ana tjetër, harrohej se vendin e carizmit po e zinte imperializmi lakuriq dhe pa maskë, se ky imperializëm ishte një armik më i fortë dhe më i rrezikshëm për kombësitë, se ai ishte baza e një shtypjeje të re nacionale.

Por rrëzimi i carizmit dhe ardhja e borgjezisë në fuqi nuk sollën zhdukjen e shtypjes kombëtare. Forma e vjetër brutale e shtypjes kombëtare u zëvendësua me një formë të re shtypjeje, më të rafinuar, por edhe më të rrezikshme. Qeveria e Lvov-Miliukov-Kerenskit jo vetëm që nuk hoqi dorë nga politika e shtypjes kombëtare, por organizoi edhe një fushatë të re kundër Finlandës (shpërndarja e Sejmit në verë të

1917-s) dhe kundër Ukrainës (shkatërrimi i institucioneve kulturore të Ukrainës). Përveç kësaj, kjo qeveri, nga natyra e saj imperialiste, i bëri thirrje popullsisë të vazhdonte luftën për pushtimin e tokave të reja, kolonive dhe kombësive të reja. Në këtë drejtim atë e shtynte jo vetëm natyra e brendshme imperialiste, por edhe ekzistenca në Perëndim e shteteve të vjetra imperialiste, të cilat synonin të nënshtronin me çdo kusht toka dhe kombësi të reja dhe kërcënonin t'i ngushtonin asaj sferën e influencës. Lufta e shteteve imperialiste për nënshtrimin e kombësive të vogla, si kusht për ekzistencën e këtyre shteteve, — kjo që tabloja që doli në shesh gjatë luftës imperialiste. Zhdukja e carizmit dhe dalja në skenë e qeverisë së Miliukov-Kerenskit nuk i bënë asnjë përmirësim kësaj tabloje të shëmtuar. Natyrisht, kur institucionet «kombëtare» të krahinave periferike shfaqnin tendencën për një autonomi shtetërore, ato ndeshnin në qëndresën e pakapërcyeshme të qeverisë imperialiste të Rusisë. Dhe kur ato, duke ligjësuar pushtetin e borgjezisë kombëtare, e bënin veshin të shurdhër përpara interesave jetësore të punëtorëve dhe fshatarëve «të tyre», ato shkakttonin ankime dhe pakënaqësi ndër këta të fundit. Të ashtuquajturat «regjimente kombëtare» nuk bënin tjetër veçse hidhnin vaj në zjarr: kundër rrezikut që vinte nga lart ato ishin të pafuqishme, kurse rrezikun që vinte nga poshtë ato e shtonin dhe e ashpëronin. Institucionet «kombëtare» mbeteshin pa mbrojtje si përballë goditjeve nga jashtë, ashtu edhe përballë shpërthimeve nga brenda. Shtetet kombëtare borgjeze, që filluan atëherë të lindnin, veniteshin, pa lulëzuar ende.

Në këtë mënyrë, interpretimi i vjetër demokratiko-borgjez i parimit të vetëvendosjes kthehej në një fikcion, humbte kuptimin e tij revolucionar. Ishte e qartë se në kushte të tilla as që mund të flitej për zhdukjen e shtypjes kombëtare dhe për vendosjen

e pavarësisë së shteteve të vogla kombëtare. Bëhej gjithmonë më e qartë se çlirimi i masave punonjëse të kombësive të shtypura dhe asgjësimi i zgjedhës kombëtare as që mund të mendoheshin pa u shkëputur nga imperializmi, pa rrëzuar borgjezinë «e vet» kombëtare dhe pa u marrë pushteti nga vetë masat punonjëse.

Kjo u pa veçanërisht qartë pas Revolucionit të Tetorit.

II

REVOLUCIONI I TETORIT DHE ÇËSHTJA KOMBËTARE

Revolucioni i shkurtit fshihnte në vetvete kontradikta të brendshme të papajtueshme. Revolucionin u bë nga punëtorët dhe fshatarët (ushtarët), mirëpo pas revolucionit pushteti nuk kaloi në duart e punëtorëve dhe fshatarëve, por në duart e borgjezisë. Duke bërë revolucionin, punëtorët dhe fshatarët donin t'i jepnin fund luftës dhe të siguronin vendosjen e paqes. Mirëpo, pasi mori pushtetin në dorë borgjezia u përpoq ta shfrytëzonte entuziazmin revolucionar të masave për vazhdimin e luftës, kundër paqes. Rrënimi ekonomik i vendit dhe kriza ushqimore kërkonin shpronësimin e kapitaleve dhe të ndërhyrjeve industriale në dobi të punëtorëve, konfiskimin e tokave të çifligarëve në dobi të fshatarëve; mirëpo qeveria borgjeze e Miliukov-Kerenskit mbronte interesat e çifligarëve dhe kapitalistëve dhe i ruante vendosmërisht këta të fundit nga goditjet e punëtorëve dhe fshatarëve. Ky ishte një revolucion borgjez, që u krye me duart e punëtorëve dhe fshatarëve në dobi të shfrytëzuesve.

Ndërkaq, vendi vazhdonte të rënkonte nën peshën e luftës imperialiste, të shkatërrimit ekonomik dhe kaosit në furnizimet. Fronti po shembej dhe po shturej. Fabrikat dhe uzinat pushonin punën. Vendin po e pllakoste zia e bukës. Revolucioni i shkurtit, me kontradiktat e tij të brendshme, u tregua krejt i pamjaftueshëm për «shpëtimin e vendit». Qeveria e Miliukov-Kerenskit u tregua krejt e paaftë për të zgjidhur çështjet kryesore të revolucionit.

Duhej një revolucion i ri, *socialist*, për ta nxjerrë vendin nga qorrrokaku i luftës imperialiste dhe i shkatërrimit ekonomik.

Një revolucion i tillë që Revolucioni i Tetorit.

Pasi rrëzoi pushtetin e çifligarëve dhe të borgjezisë dhe pasi vuri në vend të tij qeverinë e punëtorëve dhe fshatarëve, Revolucioni i Tetorit i zgjidhi menjëherë kontradiktat e revolucionit të shkurtit. Zhdukja e gjithëfuqisë së çifligarëve dhe kulakëve dhe kalimi i tokës në duart e masave punonjëse të fshatit; shpronësimi i fabrikave dhe uzinave dhe kalimi i tyre në duart e punëtorëve; shkapëputja nga imperializmi dhe likuidimi i luftës grabitqare; botimi i traktateve të fshehta dhe demaskimi i politikës së pushtimit të territoreve të huaja; më së fundi, shpallja e vetëvendosjes së masave punonjëse të popujve të shtypur dhe njohja e pavarësisë së Finlandës, — këto qenë masat kryesore që mori Pushteti Sovjetik në fillim të revolucionit sovjetik.

Ky ishte një revolucion me të vërtetë *socialist*.

Revolucioni, që filloi në qendër, nuk mund të kufizohet për një kohë të gjatë brenda territorit të tij të ngushtë. Pasi fitoi në qendër, ai duhej të përhapej patjetër edhe në krahinat periferike. Dhe me të vërtetë, që në ditët e para të revolucionit vala e tij u përhap nga veriu në gjithë Rusinë, duke i përfshirë krahinat periferike njëherë pas tjetrës. Por këtu ajo ndeshi në një digë, në «Sovjetët kombëtarë» dhe në

«qeveritë» krahinore që ishin formuar përpara Tetorit (Don, Kuban, Siberi). Puna është se këto «qeveri kombëtare» nuk donin t'i dëgjonin as emrin revolucionit socialist. Borgjeze nga natyra e tyre, ato nuk donin aspak të shkatërronin rendin e vjetër borgjez, — përkundrazi, e quanin si detyrë ta mbanin dhe ta forconin atë me të gjitha mjetet. Imperialiste në thelbin e tyre, ato nuk donin aspak t'i pritnin marrëdhëniet me imperializmin, — përkundrazi, ato ishin kurdoherë gati të pushtonin dhe të nënshtonin pjesë të vogla e të mëdha të territoreve të kombësive «të huaja», po t'u paraqitej rasti. Nuk është për t'u guditur, në qoftë se «qeveritë kombëtare» të krahinave periferike i shpallën luftë qeverisë socialiste të qendrës. Dhe pasi i shpallën luftë, ato u bënë, natyrisht, vatra të reaksionit dhe grumbulluan rreth vetes të gjitha forcat kundërrevolucionare të Rusisë. Nuk është sekret për asnjëri se atje, në këto vatra, u drejtuan gjithë kundërrevolucionarët e dëbuar nga Rusia dhe se atje, rreth këtyre vatrave, ata organizuan regjimentet «kombëtare» bjellogardiste.

Por përveç «qeverive kombëtare», në krahinat periferike ka edhe punëtorë e fshatarë vendas. Duke qenë të organizuar qysh para Revolucionit të Tetorit në Sovjetët e deputetëve revolucionarë, sipas shembullit të Sovjetëve të deputetëve në qendër të Rusisë, ata nuk i këputën kurrë lidhjet me vëllezërit e tyre në veri. Edhe ata luftonin për të siguruar fitoren mbi borgjezinë, edhe ata luftonin për triumfin e socializmit. Nuk është për t'u guditur nëse konflikti i tyre me qeveritë «e veta» kombëtare vinte duke u ashpërsuar çdo ditë. Revolucionit i Tetorit nuk bëri tjetër veçse e përforcoi aleancën e punëtorëve dhe fshatarëve të krahinave periferike me punëtorët dhe fshatarët e Rusisë, duke u futur atyre besimin në triumfin e socializmit. Lufta e «qeverive kombëtare» kundër Pushtetit Sovjetik bëri që konflikti ndërmjet

masave kombëtare dhe këtyre «qeverive» të arrinte në një shkëputje të plotë prej tyre, në një kryengritje të hapët kundër tyre.

Kështu u krijua aleanca socialiste e punëtorëve dhe fshatarëve të të gjithë Ruisë përballë aleancës kundërrevolucionare të «qeverive» kombëtare-borgjeze të krahinave periferike të Ruisë.

Disa e paraqesin luftën e «qeverive» të krahinave periferike si një luftë për glirimin kombëtar kundër «centralizmit të pamëshirshëm» të Pushtetit Sovjetik. Por kjo nuk është aspak e vërtetë. Asnjë pushtet në botë nuk ka lejuar një decentralizëm kaq të gjerë, asnjë qeveri në botë nuk u ka dhënë popujve një liri kombëtare kaq të plotë sa Pushteti Sovjetik në Rusi. Lufta e «qeverive» të krahinave periferike ka qenë dhe mbetet një luftë e kundërrevolucionit borgjez kundër socializmit. Flamuri kombëtar përdoret vetëm për të mashtruar masat, si një flamur që gëzon popullaritet dhe që është i përshtatshëm për të maskuar planet kundërrevolucionare të borgjezisë kombëtare.

Por lufta e «qeverive kombëtare» dhe krahinore ishte një luftë e palbarabartë. Të sulmuara nga dy anë: nga jashtë — prej Pushtetit Sovjetik të Ruisë, dhe nga brenda — prej punëtorëve dhe fshatarëve «të vet», — «qeveritë kombëtarë» u shtrënguan të tërhiqeshin qysh në betejat e para. Kryengritja e punëtorëve dhe torparëve³⁶ finlandezë dhe ikja e «Senatit» borgjez; kryengritja e punëtorëve dhe fshatarëve ukrainas dhe ikja e «Radës» borgjeze; kryengritja e punëtorëve dhe fshatarëve në Don, Kuban, Siberi, si dhe falimentimi i Kaledinit, Kornilovit dhe i «qeverisë» siberiane; kryengritja e fshatarëve të varfër të Turkestanit dhe ikja e «qeverisë autonome»; revolucioni agrar në Kaukaz dhe dobësia e plotë e «Sovjetëve kombëtarë» të Gjeorgjisë, Armenisë dhe Azerbajxhanit, — këto janë fakte që njihen nga të gjithë dhe që provojnë shkë-

putjen e plotë të «qeverive» krahinore nga masat «e tyre» punonjëse. «Qeveritë kombëtare», të shpartalluara keqas, «u shtrënguan» t'u kërkonin ndihmë imperialistëve të Perëndimit, shtypësve dhe shfrytëzuesve shekullorë të kombësive të të gjithë botës, kundër punëtorëve dhe fshatarëve «të tyre».

Kështu filloi faza e ndërhyrjes dhe e okupacionit të huaj në krahinat periferike, — fazë që demaskoi edhe një herë karakterin kundërevolucionar të «qeverive kombëtare» dhe krahinore.

Vetëm tani u bë e qartë për të gjithë se borgjezia kombëtare nuk synon të çlirojë «popullin e saj» nga shtypja kombëtare, por synon të jetë e lirë për të nxjerrë fitime dhe për të ruajtur privilegjet dhe kapitalet e saj.

Vetëm tani u bë e qartë se çlirimi i kombësive të shtypura nuk mund të mendohet pa shkëputjen nga imperializmi, pa rrëzimin e borgjezisë së kombësive të shtypura, pa kalimin e pushtetit në duart e masave punonjëse të këtyre kombësive.

Në këtë mënyrë, kuptimi i vjetër borgjez i parimit të vetëvendosjes me parullën «Gjithë pushtetin borgjezisë kombëtare» u demaskua dhe u hodh poshtë nga vetë zhvillimi i revolucionit. Kuptimi socialist i parimit të vetëvendosjes me parullën «Gjithë pushtetin masave punonjëse të kombësive të shtypura» fitoi të gjitha të drejtat dhe mundësitë për t'u vënë në zbatim.

Në këtë mënyrë, Revolucionit i Tetorit, pasi i dha fund lëvizjes së vjetër borgjeze të çlirimit kombëtar, hapi epokën e lëvizjes së re socialiste të punëtorëve dhe fshatarëve të kombësive të shtypura, të drejtuar kundër çdo shtypjeje, duke përfshirë edhe atë kombëtare, kundër pushtetit të borgjezisë «së vet» dhe të huaj, kundër imperializmit në përgjithësi.

III

RËNDËSIA BOTËRORE E REVOLUCIONIT TË TETORIT

Pasi fitoi në qendër të Rusisë dhe pasi u përhap në një varg krahinash periferike, Revolucioni i Tetorit nuk mund të mbetet vetëm brenda kufijve tokësorë të Rusisë. Në atmosferën e luftës imperialiste botërore dhe të pakënaqësisë së përgjithshme të shtresave të ulëta, ai nuk mund të mos shtrihej në vendet fqinje. Shkëputja nga imperializmi dhe largimi i Rusisë nga lufta grabitqare; botimi i traktateve të fshehta dhe heqja dorë solemnisht nga politika e pushtimit të tokave të huaja; shpallja e lirisë kombëtare dhe njohja e pavarësisë së Finlandës; shpallja e Rusisë si «federatë e republikave kombëtare sovjetike» dhe thirrja që Pushteti Sovjetik i bëri botës për t'u hedhur në luftë të vendosur kundër imperializmit, — të gjitha këto nuk mund të mos ushtronin një ndikim serioz në Lindjen e skllavëruar dhe në Perëndimin e përgjakur.

Dhe me të vërtetë, Revolucioni i Tetorit është i pari revolucion në botë që i zgjoi nga gjumi shekullor masat punonjëse të popujve të shtypur të Lindjes dhe i hodhi ato në luftën kundër imperializmit botëror. Formimi i Sovjetëve të punëtorëve dhe fshatarëve në Persi, Kinë dhe Indi, sipas shembullit të Sovjetëve të Rusisë, e vërteton në mënyrë bindëse këtë.

Revolucioni i Tetorit është i pari revolucion në botë që u bë për punëtorët dhe ushtarët e Perëndimit një shembull i gjallë shpëtimi dhe i shtyu ata në rrugën e lirisë të vërtetë nga zgjedha e luftës dhe e imperializmit. Kryengritja e punëtorëve dhe ushtarëve në Austro-Hungari dhe Gjermani, formimi i Sovjetëve të deputetëve punëtorë e ushtarë dhe lufta

revolucionare e popujve të nënshtruar të Austro-Hungarisë kundër shtypjes kombëtare, — e provon mjaft qartë këtë.

Nuk ka rëndësi nëse lufta në Lindje, madje edhe në Perëndim, nuk ka mundur të çlirohet ende nga disa karakteristika nacionaliste-borgjeze, — rëndësi ka se lufta kundër imperializmit ka filluar, se ajo po vazhdon dhe duhet patjetër të arrijë fundin e saj logjik.

Ndërhyrja e huaj dhe politika pushtuese e imperialistëve «të jashtëm» nuk bëjnë tjetër veçse e ashpërsojnë krizën revolucionare, duke tërhequr në luftë popuj të tjerë dhe duke e zgjeruar arenën e përleshjeve revolucionare me imperializmin.

Kështu, Revolucioni i Tetorit, duke vendosur lidhje ndërmjet popujve të Lindjes së prapambetur dhe Perëndimit të përparuar, i bashkon ata në një kamp të vetëm, në kampin e luftës kundër imperializmit.

Kështu, çështja kombëtare nga një çështje e veçantë e luftës kundër shtypjes kombëtare shndërrohet në një çështje të përgjithshme të çlirimit të kombeve, kolonive dhe gjysmëkolonive nga zgjedha e imperializmit.

Mëkati mortar i Internacionales II dhe i kryetarit të saj, Kautskit, është, ndër së tjera, se ata anonin vazhdimisht nga kuptimi borgjez i çështjes së vetëvendosjes kombëtare, nuk e kuptonin brendinë revolucionare të kësaj të fundit, nuk dinin ose nuk donin ta shtronin çështjen kombëtare mbi një bazë revolucionare, mbi bazën e luftës së hapët kundër imperializmit, nuk dinin ose nuk donin ta lidhnin çështjen kombëtare me çështjen e çlirimit të kolonive.

Mendjelehtësia e socialdemokratëve austriakë të tipit të Bauerit e Renerit është pikërisht se ata nuk e kuptonin lidhjen e pazgjidhshme midis çështjes kombëtare dhe çështjes së pushtetit dhe përpiqeshin ta ndanin çështjen kombëtare nga politika, ta mbyllnin atë

në kuadrin e çështjeve kulturore-arsimore, duke lënë në harresë «vogëlsi» të tilla si imperializmi dhe kolonitë e skllavëruara prej tij.

Thonë se parimet e vetëvendosjes dhe të «mbrojtjes së atdheut» janë zhdukur nga vetë zhvillimi i ngjarjeve në kushtet e rritjes së revolucionit socialist. Në të vërtetë nuk janë zhdukur parimet e vetëvendosjes dhe të «mbrojtjes së atdheut», por interpretimi i tyre (borgjez. Mjafton t'u hedhim një sy krahinave të pushtuara, që rënkojnë nën zgjedhën e imperializmit dhe që janë të etura për liri; mjafton t'i hedhim një sy Rusisë, që po bën një luftë revolucionare për mbrojtjen e atdheut socialist nga grabitqarët e imperializmit; mjafton të shikojmë ngjarjet që po zhvillohen tani në Austro-Hungari; mjafton t'u hedhim një sy kolonive dhe gjysmëkolonive të skllavëruara, që kanë organizuar Sovjetët e tyre (India, Persia, Kina), — mjafton t'u hedhim një sy të gjitha këtyre që të kuptojmë gjithë rëndësinë revolucionare të parimit të vetëvendosjes në interpretimin e tij socialist.

Rëndësia e madhe botërore e Revolucionit të Tetorit është kryesisht se ai:

1) zgjeroi kufijtë e çështjes kombëtare, duke e kthyer atë nga një çështje e veçantë e luftës kundër shtypjes kombëtare në Evropë në një çështje të përgjithshme, në çështjen e çlirimit të popujve të shtypur, të kolonive dhe gjysmëkolonive nga zgjedha e imperializmit;

2) hapi mundësi të mëdha dhe rrugë të vërteta për arritjen e këtij çlirimi, dhe me këtë ua lehtësoi shumë popujve të shtypur të Perëndimit dhe të Lindjes çlirimin e tyre, duke i futur ata në rrymën e përgjithshme të luftës ngadhënjimtare kundër imperializmit;

3) hodhi, në këtë mënyrë, një urë midis Perëndimit socialist dhe Lindjes së skllavëruar, duke krijuar

kundër imperializmit botëror një front të ri të revolucionit, që zë fill te proletarët e Perëndimit dhe, nëpërmjet revolucionit rus, arrin deri te popujt e shtypur të Lindjes.

Pikërisht kjo është arsyeja e entuziazmit të papërshtatshëm që shfaqin tani për proletariatin e Ruisë masat punonjëse dhe të shfrytëzuara të Lindjes dhe të Perëndimit.

Pikërisht kjo është arsyeja kryesore e tërbimit, me të cilin po i vërsulen tani Ruisë Sovjetike grabitqarët imperialistë të mbarë botës.

«Pravda» Nr. Nr. 241 dhe 250
6 dhe 19 nëntor 1918

Veprat, bot. shqip. vëll. 4,
f. 151-162

Nga tezat:

«PËR DETYRAT IMEDIATE TË PARTISË NË ÇËSHTJEN KOMBËTARE»

1. Kombet e sotme janë fryt i një epoke të caktuar — i epokës së kapitalizmit në fazën e ngritjes. Procesi i zhdukjes së feudalizmit dhe i zhvillimit të kapitalizmit është njëkohësisht edhe procesi i bashimit të njerëzve në kombe. Anglezët, francezët, gjermanët dhe italianët janë formuar si kombe në kohën e rritjes së kapitalizmit, që triumfoi në luftën e copëtimit feudal.

2. Atje ku formimi i kombeve, nga pikëpamja e historisë, përkoi krejtësisht me formimin e shteteve të centralizuara, natyrisht kombet morën një formë shtetërore dhe u zhvilluan në shtete kombëtare borjeze të pavarura. Kështu ndodhi në Angli (pa Irlandën), Francë, Itali. Në lindje të Evropës, përkundrazi, formimi i shteteve të centralizuara, i shpejtuar nga evolucionet e vetëmbrojtjes (invadimi i turqve, mongolëve etj.), ndodhi përpara zhdukjes së feudalizmit, domethënë përpara formimit të kombeve. Për këtë arsye kombet këtu nuk u zhvilluan dhe nuk mund të zhvilloheshin në shtete kombëtare, por formuan disa shtete

borgjeze të përziera, shumëkombëshe, që përbëheshin zakonisht prej një kombi të fortë, sundues dhe prej disa kombesh të dobëta, të nënshtuara. Të tilla ishin Austria, Hungaria, Rusia.

3. Shtetet kombëtare si Franca dhe Italia, të cilat në fillim mbështeteshin kryesisht në forcat e veta kombëtare, përgjithësisht nuk e kanë njohur shtypjen kombëtare. Përkundrazi, shtetet shumëkombëshe, të ngritura mbi bazën e sundimit të një kombi të vetëm, ose më mirë — të klasës së tij sunduese, mbi kombet e tjera, janë vatra fillestare dhe arena kryesore e shtypjes kombëtare dhe e lëvizjes kombëtare. Kontradiktat ndërmjet interesave të kombit sundues dhe interesave të kombeve të nënshtuara janë kontradikta të tilla, të cilat, në qoftë se nuk zgjidhen, e bëjnë të pamundur ekzistencën e qëndrueshme të një shteti shumëkombësh. Tragjedia e shtetit shumëkombësh borgjez është se ai nuk është në gjendje t'i zgjidhë këto kontradikta dhe se çdo orvatje e tij për të vendosur «barazinë» ndërmjet kombeve dhe për të «mbrojtur» pakicat kombëtare, duke ruajtur pronën private dhe pabarazinë ndërmjet klasave, përfundon zakonisht me një dështim tjetër dhe me një ashpërsim të ri të konflikteve kombëtare.

4. Zhvillimi i mëtejshëm i kapitalizmit në Evropë, nevoja për të siguruar tregje të reja shitjeje, kërkimi i lëndëve të para dhe i lëndëve djegëse dhe, më në fund, zhvillimi i imperializmit, eksportimi i kapitalit dhe nevoja për të siguruar rrugë të mëdha detare dhe hekurudhore, shkaktuan, nga njëra anë, zaptimin e tokave të reja prej shteteve të vjetra kombëtare dhe shndërrimin e këtyre të fundit në shtete shumëkombëshe (koloniale), me shtypjen dhe konfliktet kombëtare që i karakterizojnë këto shtete (Anglia, Franca, Gjermania, Italia) dhe, nga ana tjetër — përforcuan dëshirën e kombeve sunduese të shteteve të vjetra shumëkombëshe jo vetëm për të ruajtur

kufijtë e vjetër shtetërorë, por edhe për t'i zgjeruar këta dhe për të nënshtuar kombësi të reja (të dobëta) në kurriz të shteteve fqinje. Në këtë mënyrë, çështja kombëtare u zgjerua dhe, më në fund, u shkri, nga vetë zhvillimi i ngjarjeve, me çështjen e përgjithshme të kolonive, kurse shtypja kombëtare u shndërrua nga një çështje e brendshme shtetërore në një çështje ndërshtetërore, në një çështje përpjekjesh (dhe lufte) ndërmjet fuqive «të mëdha» imperialiste për nënshtimin e kombësive të dobëta, pa të drejta të plota.

5. Lufta imperialiste, e cila zbuloi deri në fund kontradiktat e papajtueshme kombëtare dhe mungesën e stabilitetit të brendshëm të shteteve borgjeze shumëkombëshe, shkaktoi një ashpërsim jashtëzakonisht të madh të konflikteve kombëtare brenda shteteve koloniale fitimtare (Anglia, Franca, Italia), një rrënim të plotë të shteteve të vjetra shumëkombëshe të mundura (Austria, Hungaria, Rusia e vitit 1917) dhe, më së fundi, — si një zgjidhje më «rrënjësore» e çështjes kombëtare nga ana e borgjezisë, — formimin e shteteve të reja kombëtare borgjeze (Polonia, Çekosllovakia, Jugosllavia, Finlanda, Gjeorgjia, Armenia etj.). Por formimi i shteteve të reja kombëtare të pavarura nuk vendosi dhe nuk mund të vendoste një bashkëjetesë paqësore ndërmjet kombësive, nuk zhdukte dhe nuk mund të zhdukte as pabarazinë kombëtare as shtypjen kombëtare, sepse shtetet e reja kombëtare, të bazuara në pronën private dhe në pabarazinë e klasave, nuk mund të ekzistojnë:

a) pa shtypur pakicat e tyre kombëtare (Polonia shtyp bjellorusët, izraelitët, lituanët, ukrainasit; Gjeorgjia shtyp osetinasit, abhazianët, armenët; Jugosllavia shtyp kroatët, boshnjakët etj.);

b) pa zgjeruar territorin e vet në kurriz të fqinjve, gjë që shkaktonte konflikte dhe luftëra (Polonia kundër Lituanisë, Ukrainës, Rusisë; Jugosllavia kundër Bullgarisë; Gjeorgjia kundër Armenisë, Turqisë etj.);

c) pa iu nënshtruar fuqive «të mëdha» imperialiste nga pikëpamja financiare, ekonomike dhe ushtarake.

6. Në këtë mënyrë, periudha e pasluftës na jep një tablo të vajtueshme armiqësish kombëtare; pabara-
zie, shtypjeje, konfliktesh, luftërash, mizorish impe-
rialiste nga kombet e vendeve të qytetëruara si kund-
drejt njëri-tjetrit, ashtu edhe kundrejt popujve të nën-
shtruar. Nga njëra anë, disa fuqi «të mëdha», që
shtypin dhe shfrytëzojnë gjithë masën e shteteve kom-
bëtare të varura dhe «të pavarura» (në fakt krejt të
varura), dhe lufta e këtyre fuqive ndërmjet tyre për
vendosjen e monopolit mbi shfrytëzimin e shteteve
kombëtare. Nga ana tjetër, lufta e shteteve kombëtare,
të varura dhe «të pavarura», kundër shtypjes së pa-
durueshme të fuqive «të mëdha»; lufta e shteteve kom-
bëtare ndërmjet tyre për zgjerimin e territorit të tyre
kombëtar; lufta e çdo shteti kombëtar kundër pakicave
kombëtare të shtypura; më në fund, forcimi i lëvizjes
çlirimtare të kolonive kundër fuqive «të mëdha» dhe
ashpërsimi i konflikteve kombëtare si brenda këtyre
fuqive, ashtu edhe brenda shteteve kombëtare, që kanë
në gjirin e tyre, zakonisht, një varg pakicash kom-
bëtare.

Kjo është «tabloja e paqes» që na la trashëgim
lufta imperialiste.

Shoqëria borgjeze dështoi plotësisht për sa i për-
ket zgjidhjes së çështjes kombëtare.

N g a «KONGRESI XII I PK(b) TË RUSISË»

17—25 prill 1923

REFERAT PËR MOMENTET KOMBËTARE NË
NDËRTIMIN E PARTISË DHE TË SHITETIT

Shokë! Qysh nga Revolucioni i Tetorit është e treta herë që ne po shqyrtojmë çështjen kombëtare: herën e parë — në Kongresin VIII, të dytën — në Kongresin X dhe të tretën — në Kongresin XII. Mos vallë kjo tregon se në pikëpamjet tona për çështjen kombëtare kanë ndodhur ndryshime parimore? Jo, pikëpamja jonë në çështjen kombëtare ka mbetur në parim e pandryshuar edhe pas Tetorit. Por që nga Kongresi X ka ndryshuar gjendja ndërkombëtare: pesha specifike e rezervave të mëdha të revolucionit, siç janë tani vendet e Lindjes, është shtuar. Kjo, në radhë të parë. Së dyti, qysh nga Kongresi X i partisë edhe gjendja e brendshme ka pësuar disa ndryshime, për shkak të nepit. Të gjithë këta faktorë të rinj duhen pasur parasysh dhe duhen nxjerrë përfundimet e rastit. Pikërisht në këtë kuptim mund të flitet për

formën e re të shtruarjes së çështjes kombëtare në Kongresin XII.

Rëndësia ndërkombëtare e çështjes kombëtare. Ju e dini, shokë, se ne, si një federatë sovjetike, me vullnetin e fateve historike, përbëjmë repartin pararojë të revolucionit botëror. Ju e dini se ne qemë të parët që thyem frontin e përgjithshëm të kapitalizmit; fati e desh që ne të ndodhemi në ballë të të gjithëve. Ju e dini se gjatë përparimit tonë ne arritëm deri në Varshavë, pastaj u tërhoqëm duke u përforcuar në pozitën që na dukeshin më të sigurt. Qysh atëherë ne kaluam në politikën e re ekonomike dhe qysh atëherë, duke marrë parasysh ngadalësimin e ritmit të lëvizjes revolucionare ndërkombëtare, politika jonë u bë mbrojtëse dhe jo sulmuese. Pas disfatës që pësuan në Varshavë (nuk do ta fshehim të vërtetën), ne nuk kishim mundësi të shkonim përpara, sepse ishim në rrezik të shkëputeshim nga prapavijat, të cilat te ne përbëhen nga fshatarë, dhe, më në fund, ishim në rrezik të largoheshim shumë nga rezervat e revolucionit, që na dha zhvillimi historik, nga rezervat e Perëndimit dhe të Lindjes. Ja pse ne filluam një kthesë brenda vendit — drejt nepit, dhe jashtë vendit — drejt ngadalësimit të përparimit tonë, sepse duhej bërë një pushim, duheshin shëruar plagët tona, — plagët e repartit pararojë, të proletariatit, duhej vendosur kontakt me prapavijat fshatare, duhej bërë një punë e mëtejshme me rezervat që kishin mbetur prapa nesh, — me rezervat e Perëndimit dhe me rezervat e Lindjes, rezerva këto të mëdha, që përbëjnë prapavijat kryesore të kapitalizmit botëror. Kur shqyrtojmë çështjen kombëtare ne kemi parasysh pikërisht këto rezerva, — rezervat e mëdha, që përbëjnë njëkohësisht prapavijat e imperializmit botëror.

Njëra nga të dyja: ose ne do të vëmë në lëvizje prapavijat e thella të imperializmit — vendet koloniale dhe gjysmëkoloniale të Lindjes — duke zhvi-

lluar atje shpirtin revolucionar dhe duke shpejtuar kështu rënien e imperializmit, ose do të dështojmë në këtë punë, dhe atëherë do të forcojmë imperializmin, kurse forcën e lëvizjes sonë do ta dobësojmë. Kështu shtrohet çështja.

Puna është se gjithë Lindja e quan Bashkimin tonë të Republikave një fushë eksperimentale. Ose ne do ta zgjidhim drejt, në praktikë, çështjen kombëtare në kuadrin e këtij Bashkimi, do të vendosim marrëdhënie me të vërtetë vëllazërore ndërmjet popujve, një bashkëpunim të vërtetë, — dhe atëherë gjithë Lindja do ta shikojë Federatën tonë si flamurtaren e çlirimit të saj, si repartin pararojë, në gjurmën e të cilit ajo duhet të shkojë, dhe kjo do të jetë fillimi i fallimentimit të imperializmit botëror, — ose ne këtu do të gabohemi, do të bëjmë që popujt dikur të shtypur të humbin besimin e tyre ndaj proletariatit të Rusisë dhe Bashkimi i Republikave të humbë forcën tërheqëse që ka në Lindje, — dhe atëherë do të fitojë imperializmi, kurse ne do të humbim.

Këtu qëndron rëndësia ndërkombëtare e çështjes kombëtare.

Çështja kombëtare ka rëndësi për ne edhe nga pikëpamja e brendshme, jo vetëm sepse, si numër, kombi dikur sundues përfaqëson rreth 75 milionë, kurse kombet e tjera — 65 (sidogoftë, nuk janë pak), dhe jo vetëm sepse kombësitë dikur të shtypura banojnë në krahinat më të nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe në pikat më të rëndësishme nga pikëpamja e strategjisë ushtarake, por, në radhë të parë, sepse gjatë këtyre dy vjetëve ne kemi zbatuar të ashtuquajturin nep, dhe, si rrjedhim, nacionalizmi rusomadh ka filluar të rritet e të forcohet, ka lindur ideja e smenovehizmit dhe po vërehet tendenca për të realizuar në mënyrë paqësore atë që nuk mundi ta realizonte Denikini, d.m.th. krijimin e të ashtuquajturit komb «unik dhe të pandarë».

Në këtë mënyrë, për shkak të nepit, në jetën tonë të brendshme po lind një forcë e re — shovinizmi rusomadh, që po bën fole në institucionet tona, po depërton jo vetëm në institucionet e pushtetit, por edhe në ato të partisë, po endet në të gjitha anët e federatës sonë dhe po na shpie në një gjendje, në të cilën, në qoftë se nuk do t'i bëjmë ballë vendosmërisht kësaj force të re dhe në qoftë se nuk do ta shkullim nga rrënjët, — dhe kushtet e nepit e ushqejnë atë, — ne rrezikojmë të ndodhemi përballë shkëputjes së proletariatit të kombit dikur sundues nga fshatarët e kombeve dikur të shtypura, gjë që mund të çojë në falimentimin e diktaturës së proletariatit.

Por nepi nuk ushqen vetëm shovinizmin rusomadh, — ai ushqen edhe shovinizmin lokal, sidomos në republikat që kanë në gjirin e tyre disa kombësi. E kam fjalën për Gjeorgjinë, Azerbajxhanin, Buharanë, pjesërisht për Turkestanin, ku kemi disa kombësi, elementët përparimtarë të të cilave ndoshta do të fillojnë së shpejti të vihen në garë ndërmjet tyre për të fituar vendin e parë. Ky shovinizëm lokal, nga përkëpamja e forcës që ka, sigurisht nuk paraqet një rrezik si ai që paraqet shovinizmi rusomadh. Por, megjithatë, ai është një rrezik, sepse kërcënon t'i shndërrojë disa republika në një arenë grindjesh kombëtare dhe të shkallmojë atje lidhjet e internacionalizmit.

Këto janë arsytet me karakter ndërkombëtar dhe të brendshëm që tregojnë rëndësinë e madhe, rëndësinë e dorës së parë, që ka çështja kombëtare, përgjithësisht, në çastin e tanishëm, veçanërisht.

Ku qëndron thelbi klasor i çështjes kombëtare? Thelbi klasor i çështjes kombëtare, në kushtet e zhvillimit të tanishëm sovjetik, është në vendosjen e marrëdhënieve të drejta ndërmjet proletariatit të kombit dikur sundues dhe fshatarësisë së kombeve dikur të

shtypura. Çështja e aleancës u diskutua këtu mjaft, por gjatë diskutimit të kësaj çështjeje shokët Kame-niev, Kalinin, Sokolnikov, Rikov dhe Trocki në refe-ratet e tyre bënë fjalë kryesisht për qëndrimin e pro-letariatit rus ndaj fshatarësisë ruse. Këtu, në fushën kombëtare, kemi të bëjmë me një mekanizëm më të ndërlikuar. Këtu kemi të bëjmë me çështjen e vendosjes së marrëdhënieve të drejta ndërmjet proletariatit të kombit dikur sundues, që përbën shtresën më të kulturuar të proletariatit në gjithë federatën tonë, dhe fshatarësisë, kryesisht fshatarësisë së kombësive dikur të shtypura. Ky është thelbi klasor i çështjes kombëtare. Në qoftë se proletariati do të arrijë të vendosë me fshatarësinë e kombësive të tjera marrë-dhënie, të cilat të mund të zhdukin të gjitha mbetu-rinat e mosbesimit kundrejt çdo gjëje që është ruse, të atij mosbesimi që është mbjellë dhe ushqyer për dhjetëra vjet nga politika e carizmit, në qoftë se, përveç kësaj, proletariati rus do të arrijë të vendosë një mirëkuptim dhe një besim reciprok të plotë, një aleancë të vërtetë, jo vetëm ndërmjet proletariatit dhe fshatarësisë ruse, por edhe ndërmjet proletariatit dhe fshatarësisë së kombësive dikur të shtypura, atë-herë problemi do të zgjidhet. Që të arrihet ky qëllim duhet që pushteti i proletariatit të jetë për fshatarë-sinë e kombësive të tjera po aq i afërt sa edhe për fshatarësinë ruse. Që Pushteti Sovjetik të bëhet i afërt edhe për fshatarësinë e kombësive të tjera duhet që ky pushtet të jetë i kuptueshëm për të, që ai të funksionojë në gjuhën amtare, që shkollat dhe orga-net e pushtetit të organizohen me njerëz të vendit, që e njohin gjuhën, zakonet, doket dhe mënyrën e jetesës të kombësive joruse. Pushteti Sovjetik, që deri kohët e fundit ka qenë një pushtet rus, do të bëhet një pushtet jo vetëm rus, por edhe një pushtet i të gjitha kombësive, i afërt për fshatarët e kombësive dikur të shtypura, vetëm atëherë kur institucionet dhe orga-

net e pushtetit në republikat e këtyre vendeve do të flasin dhe do të punojnë në gjuhën amtare.

Kjo është një nga bazat e çështjes kombëtare përgjithësisht, në rrethanat sovjetike, veçanërisht.

Cili është tipari karakteristik i zgjidhjes së çështjes kombëtare në çastin e tanishëm, më 1923? Çfarë forme kanë marrë më 1923 problemet që kërkojnë një zgjidhje në fushën kombëtare? Formën e vendosjes së bashkëpunimit ndërmjet popujve të federatës sonë në fushën ekonomike, ushtarake dhe politike. E kam fjalën për marrëdhëniet ndërmjet kombeve. Çështja kombëtare, që ka si detyrë kryesore të vendosë marrëdhënie të drejta ndërmjet proletariatit të kombit dikur sundues dhe fshatarësisë së kombësive të tjera, në çastin e tanishëm po merr një formë të veçantë: atë të vendosjes së bashkëpunimit dhe bashkëjetesës vëllazërore ndërmjet popujve që më parë kanë qenë të ndarë dhe që tani po bashkohen në kuadrin e një shteti të vetëm.

Ky është thelbi i çështjes kombëtare në formën që ka marrë kjo çështje më 1923.

Forma konkrete e këtij bashkimi shtetëror është Bashkimi i Republikave, për të cilin folëm që në fund të vitit të kaluar në Kongresin e Sovjetëve dhe të cilin ne e krijuam atëherë.

Baza e këtij Bashkimi është vullnetarizmi dhe barazia juridike e anëtarëve të Bashkimit. Vullnetarizmi dhe barazia — sepse pikënisja e programit tonë kombëtar është e drejta e kombeve për të ekzistuar si shtet më vete, ajo që më parë quhej e drejta e vetëvendosjes. Duke u nisur nga kjo, ne duhet ta themi qartë se asnjë bashkim popujsh dhe asnjë shtet unik, i formuar nga bashkimi i disa popujve, nuk mund të jetë i qëndrueshëm, në qoftë se nuk bazohet në vullnetarizmin e plotë, në qoftë se vetë popujt nuk duan të bashkohen. Baza e dytë është barazia juridike e popujve që janë pjesëtarë të Bashkimit. Dhe kjo

është e qartë. Nuk e kam fjalën për barazinë reale, për të cilën do të flas më vonë, sepse vendosja e barazisë reale ndërmjet kombeve të përparuara dhe kombeve të prapambetura është një çështje shumë e ndërlikuar dhe e vështirë, që kërkon disa vjet punë. Unë e kam fjalën këtu për barazinë juridike. Kjo barazi shprehët në faktin se të gjitha republikat, në rastin konkret katër republikat që përbëjnë Bashkimin: Transkaukazia, Bjellorusia, Ukraina dhe RSFSR-ja, gëzojnë të njëjtat të mira dhe njëkohësisht heqjen dorë, në dobi të Bashkimit, nga disa të drejta që u jep pavarësia e tyre. Në qoftë se RSFSR-ja, Ukraina, Bjellorusia dhe Republika Transkaukaziane nuk do të kenë komisariate të popullit për punët e jashtme, është e qartë se, me heqjen e këtyre komisariateve dhe me krijimin e një komisaritati të përbashkët për punët e jashtme në kuadrin e Bashkimit të Republikave, do të kufizohet deri diku pavarësia që kanë pasur këto republika, pavarësi që është kufizuar njëllor për të gjitha republikat e Bashkimit. Është e qartë se, në qoftë se më parë këto republika kishin organet e tyre të tregtisë së jashtme, kurse tani këto organe po hiqen si në RSFSR, ashtu edhe në republikat e tjera, me qëllim që të krijohet, në kuadrin e Bashkimit të Republikave, një organ i përbashkët për tregtinë e jashtme, edhe në këtë rast kemi njëfarë kufizimi të pavarësisë, e cila më parë ishte e plotë, kurse tani është pakësuar në dobi të Bashkimit, etj. etj. Disa bëjnë një pyetje thjesht skollastike: a do të mbeten të pavarura republikat pas bashkimit? Kjo është një pyetje skollastike. Pavarësia e tyre kufizohet, sepse çdo bashkim sjell njëfarë kufizimi të të drejtave që kanë pasur më parë ata që janë bashkuar. Por çdo republikë ruan, pa dyshim, elementet kryesore të pavarësisë, qoftë edhe sepse çdo republikë ka të drejtë të dalë nga Bashkimi, me vendim të njëanshëm.

Kështu, pra, në çastin e tanishëm forma konkrete e çështjes kombëtare në gjendjen tonë është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet popujve: në fushën e ekonomisë, të politikës së jashtme dhe të çështjeve ushtarake. Ne duhet t'i bashkojmë këto republika në këto fusha në një bashkim të vetëm, të quajtur BRSS. Këto janë format konkrete të çështjes kombëtare në çastin e tanishëm.

Por është më lehtë ta thuash një gjë sesa ta bësh. Puna është se në rrethanat tona ne kemi një varg të tërë faktorësh, që jo vetëm e ndihmojnë bashkimin e popujve në një shtet të vetëm, por edhe e pengojnë këtë bashkim.

Faktorët që ndihmojnë bashkimin ju i dini: para së gjithash, kemi afrimin ekonomik të popujve, që ka qenë vendosur qysh përpara Pushtetit Sovjetik dhe që është përforcuar nga Pushteti Sovjetik; njëfarë ndarjeje e punës ndërmjet popujve, që ka qenë vendosur përpara nesh dhe që është përforcuar nga ne, nga Pushteti Sovjetik, — ky është faktori kryesor që ndihmon formimin e Bashkimit të Republikave. Si faktor i dytë, që ndihmon bashkimin, duhet quajtur natyra e Pushtetit Sovjetik. Kjo kuptohet vetvetiu. Pushteti Sovjetik është pushteti i punëtorëve, diktatura e proletariatit, e cila nga vetë natyra e saj bën që elementët punonjës të republikave dhe të popujve, që përbëjnë Bashkimin, të vendosin lidhje miqësore ndërmjet tyre. Kjo kuptohet vetvetiu. Dhe faktori i tretë, që ndihmon bashkimin, është rrethimi imperialist, në kushtet e të cilit është i shtrënguar të veprojë Bashkimi i Republikave.

Por ka edhe faktorë që e pengojnë këtë bashkim, që e frenojnë atë. Forca kryesore, që pengon formimin e një bashkimi të vetëm të republikave, është forca që po zhvillohet ndër ne, siç e thashë më lart, në kushtet e nepit: kjo forcë është shovinizmi rusomadh. Nuk është aspak e rastit, shokë, që smenove-

histët kanë gjetur shumë përkrahës në radhët e funksionarëve sovjetikë. Kjo nuk është aspak e rastit. Nuk është e rastit as edhe se zotërinjtë smenovehistë po i lëvdojnë komunistët bolshevikë, sikur të donin t'u thoshim: flisni sa të doni për bolshevizmin, llomitni sa të doni për tendencat tuaja internacionaliste, por ne e dimë fare mirë se ju do të organizoni atë që nuk organizoi dot Denikini, se ju, bolshevikët, keni ringjallur, ose, sidoqoftë, do ta ringjallni idenë e Ruzisë së madhe. Të gjitha këto nuk janë të rastit. Nuk është i rastit as se kjo ide ka depërtuar në disa nga institucionet tona të partisë. Në plenumin e shkurtit, ku u shtrua për herë të parë çështja e dhomës së dytë, unë kam dëgjuar me veshët e mi nga shokë të KQ fjalime që nuk pajtohen me komunizmin dhe që nuk kanë asgjë të përbashkët me internacionalizmin. Të gjitha këto janë gjurmët e kohëve dhe një epidemi. Rreziku kryesor që rrjedh së këtejmi është se, për shkak të nepit, ndër ne po rritet jo me ditë por me orë një shovinizëm imperialist, i cili përpiqet të fshijë çdo gjë që nuk është ruse, të përqendrojë të gjithë frenat e drejtimit në duart e elementit rus dhe të shtypë atë që nuk është ruse. Rreziku kryesor është se me një politikë të tillë ne mund të humbim besimin që kanë popujt dikur të shtypur ndaj proletarëve rusë, besim që këta e fituan gjatë ditëve të Tetorit, kur proletarët rusë përmbyshën çifligarët dhe kapitalistët rusë, kur zhdukën shtypjen kombëtare në Rusi, kur tërhoqën trupat nga Persia dhe Mongolia, kur shpallën pavarësinë e Finlandës e të Armenisë dhe, përgjithësisht, kur e shtruan çështjen kombëtare në baza kreytësisht të reja. Besimin që fituam atëherë ne mund ta humbim kreytësisht, në qoftë se ne të gjithë nuk do të armatosemi kundër këtij shovinizmi të ri, po e përsëris, rusomadh, i cili po hidhet në sulm dhe po përhapet, duke depërtuar pak nga pak në trurin e militantëve tanë dhe duke i shthurur atë

pak nga pak. Pikërisht këtë rrezik, shokë, ne duhet ta mposhtim me çdo kusht. Përndryshe na kanoset perspektiva e humbjes së besimit të punëtorëve dhe fshatarëve të popujve dikur të shtypur, na kanoset perspektiva e këputjes së lidhjeve ndërmjet këtyre popujve dhe proletariatit rus, pra, na kanoset rreziku i hapjes së një hendeku në sistemin e diktaturës sonë.

Mos harroni, shokë, se në qoftë se ne marshuam fitimtarë kundër Kerenskit dhe përmbysëm Qeverinë e Përkohshme, kjo ndodhi, ndër të tjera, sepse gëzonim besimin e popujve të shtypur, që prisnin çlirimin nga proletarët rusë. Mos harroni rezervat, d.m.th. popujt e shtypur, që qëndrojnë në heshtje, por që me heshtjen e tyre peshojnë dhe vendosin për shumë gjëra. Shpeshherë kjo gjë nuk ndihet, por ata, këta popuj, jetojnë, ekzistojnë dhe nuk mund të lihen në harresë. Mos harroni se, po të mos kishim në prapavijat e Kolçakut, Denikinit, Vrangelit dhe Judenicit të ashtuquajturit «alogjenë», po të mos kishim popujt dikur të shtypur, të cilët i minonin prapavijat e këtyre gjeneralëve me simpatinë e tyre të heshtur për proletarët rusë, — ky, shokë, është një faktor me rëndësi të veçantë në zhvillimin tonë: simpatinë e heshtur askush nuk e shikon dhe e dëgjon, por ajo vendos mbi çdo gjë, — po të mos kishim, pra, këtë simpatë, ne nuk do të kishim thyer asnjë nga këta gjeneralë. Ndërsa ne marshonim kundër tyre, në prapavijat e tyre kishte filluar shturja. Pse? Sepse këta gjeneralë mbështeteshin në elementët kolonizues kozakë dhe dilnin përpara popujve të shtypur me perspektivën e shtypjes së tyre të mëtejshme, gjë që i detyronte këta popuj të hidheshin në prehrin tonë, ndërsa ne kishim shpalosur flamurin e çlirimit të këtyre popujve të shtypur. Ja ç'e vendosi fatin e këtyre gjeneralëve, ja shumica e faktorëve që errësuan sukseset e trupave tona, por që, në fund të fundit, vendosën mbi çdo gjë. Kjo nuk duhet harruar. Ja pse ne duhet

të bëjmë një kthesë energjike, duke luftuar kundër tendencave të reja shoviniste dhe duke goditur të gjithë ata funksionarë të institucioneve tona dhe ata shokë partie që e lënë në harresë atë që ne kemi fituar në Tetor, dhe pikërisht besimin e popujve dikur të shtypur, të cilin duhet ta ruajmë si sytë e ballit.

Duhet kuptuar se, në qoftë se një forcë e tillë, si shovinizmi rusomadh, do të lulëzojë dhe do të gjejë fushë të lirë, atëherë nuk do të kemi asnjë besim nga popujt dikur të shtypur, nuk do të krijojmë asnjë bashkëpunim në gjirin e një bashkimi të vetëm dhe nuk do të kemi asnjë Bashkim të Republikave.

Ky është faktori i parë dhe më i rrezikshmi, që pengon formimin e një bashkimi të vetëm të popujve dhe republikave.

Faktori i dytë, shokë, që pengon gjithashtu bashkimin e popujve dikur të shtypur rreth proletariatit rus, është pabarazia reale e kombeve, që ne kemi trashëguar nga periudha e carizmit.

Ne kemi shpallur dhe po zbatojmë barazinë juridike, por kjo barazi juridike, që në vetvete ka një rëndësi shumë të madhe në historinë e zhvillimit të republikave sovjetike, është larg barazisë reale. Të gjitha kombësitë e prapambetura dhe të gjithë popujt kanë formalisht të njëjtat të drejta që kanë edhe kombet e tjera të përparuara të federatës sonë. Por e keqja është se disa kombësi nuk kanë proletarët e tyre, nuk kanë kaluar, dhe madje nuk e kanë filluar zhvillimin industrial, janë shumë prapa nga pikëpamje kulturore dhe nuk janë aspak në gjendje të përdorin të drejtat që u ka dhënë revolucioni. Ky, shokë, është një problem më i rëndësishëm nga ai i shkollave. Disa nga shokët tanë mendojnë se po të vëmë në plan të parë çështjen e shkollave dhe të gjuhës, ne mund ta zgjidhim problemin. Kjo nuk është e vërtetë, shokë; me shkollat, në këtë rast, nuk mund të shkohet larg. Këto shkolla po zhvillohen dhe bash-

kë me to po zhvillohet edhe gjuha, por pabarazia reale mbetet baza e të gjitha pakënaqësive dhe grindjeve. Nuk duhet të mjaftohemi vetëm me shkollat dhe me gjuhën; këtu duhet që ne t'u japim një ndihmë proletare të vërtetë, të vazhdueshme, të sigurtë dhe konkrete masave punonjëse të kombësive të prapambetura nga pikëpamja kulturore dhe ekonomike. Duhet që, përveç shkollave dhe gjuhës, proletariati rus të marrë të gjitha masat, me qëllim që në krahinat periferike, në republikat e prapambetura nga pikëpamja kulturore, — dhe ato kanë mbetur prapa jo për faj të tyre, por sepse më parë ato quheshin si burime lëndësh të para, — në këto republika të krijojnë vatra industriale. Në këtë drejtim janë bërë disa orvatje. Gjeorgjia ka marrë një fabrikë nga Moska dhe, sigurisht, së shpejti kjo fabrikë do të fillojë nga prodhimi. Buharaja ka marrë një fabrikë, por mund të merrte katër fabrika. Turkestani po merr një fabrikë të madhe. Pra, janë të gjitha kushtet që këto republika të prapambetura nga pikëpamja ekonomike dhe pa një proletariat të tyre, të krijojnë me ndihmën e proletariatit rus vatra industriale, qofshin këto edhe të vogla, në mënyrë që në këto vatra të formohen grupe proletarësh vendas, të cilët të mund të shërbejnë si një urë ndërlidhëse midis proletarëve e fshatarëve rusë, nga njëra anë, dhe masave punonjëse të republikave, nga ana tjetër. Pikërisht në këtë fushë ne duhet të punojmë seriozisht, dhe nuk duhet të mjaftohemi vetëm me shkollat.

Por ka edhe një faktor të tretë, që pengon formimin e një bashkimi të vetëm të republikave: ky është nacionalizmi i republikave të ndryshme. Nepi ushtron ndikim jo vetëm mbi popullsinë ruse, por edhe mbi atë joruse. Nepi zhvillon tregtinë dhe industrinë private jo vetëm në qendër të Rusisë, por edhe në republikat e veçanta. Pikërisht ky nep dhe kapitali privat, që është i lidhur me të, ushqejnë dhe

zhvillojnë nacionalizmin gjeorgjian, azerbajxhanas, uzbek, etj. Sigurisht, po të mos ishte shovinizmi rusomadh, i cili është një shovinizëm sulmues, sepse ai është i fortë, sepse ai ka qenë i fortë edhe më parë dhe ka ruajtur zakonet e shtypjes dhe të nënshtrimit, —po të mos ishte shovinizmi rusomadh, ndoshta edhe shovinizmi lokal, si përgjigje shovinizmit rusomadh, do të ekzistonte, si të thuash, në miniaturë dhe në minimum, sepse, në fund të fundit, nacionalizmi antirus është një formë mbrojtëse, njëfarë forme e bastarduar mbrojtjeje kundër nacionalizmit rusomadh, kundër shovinizmit rusomadh. Sikur ky nacionalizëm të ishte vetëm mbrojtës, mund të mos bënim shumë fjalë për të. Mund të përqendronim gjithë forcën e veprimeve tona dhe luftën tonë kundër shovinizmit rusomadh, me shpresë se, porsa të përmbysesh ky armik i fuqishëm, bashkë me të do të përmbysesh edhe nacionalizmi antirus, sepse, e përsëris, ky nacionalizëm, në fund të fundit, është një reaksion kundër nacionalizmit rusomadh, një përgjigje dhe njëfarë mbrojtjeje kundër tij. Po, kështu do të ndodhte, sikur nacionalizmi antirus i republikave të mos i kalonte kufijtë e reaksionit kundër nacionalizmit rusomadh. Por e keqja është se në disa republika ky nacionalizëm mbrojtës po shndërrohet në një nacionalizëm sulmues.

Le të marrim Gjeorgjinë. Këtu më tepër se 30% të popullsisë nuk janë gjeorgjianë. Ndër ta ka armenë, abhazë, axharë, osetinas dhe tatarë. Në krye të të gjithëve qëndrojnë gjeorgjianët. Te disa komunistë gjeorgjianë ka lindur dhe po zhvillohet ideja se nuk duhet të bëhemi fort merak për këto kombësi të vogla: ato janë më pak të kulturuar, më pak të zhvilluara, thonë ata, prandaj mund edhe të mos bëhemi fort merak për to. Ky është një shovinizëm, një shovinizëm i dëmshëm dhe i rrezikshëm, sepse mund ta kthejë republikën e vogël të Gjeorgjisë në një arenë

grindjesh. Madje ajo është kthyer në një arenë grindjesh.

Azerbajxhani. Kombësia kryesore është kombësia azerbajxhanase, por atje ka edhe armenë. Në një pjesë të azerbajxhanasve ka gjithashtu një prirje, nganjëherë shumë të hapët, që mund të karakterizohet si vijon: ne, azerbajxhanasit, thonë ata, jemi autoktonë, kurse ata, armenët, janë të ardhur; për këtë arsye, thonë ata, duhet t'u tregojmë vendin atyre dhe të mos e çajmë kokën për interesat e tyre. Edhe ky është shovinizëm. Kjo e minon barazinë e kombësive, mbi të cilën mbështetet Pushteti Sovjetik.

Buharaja. Atje, në Buhara, ka tri kombësi: uzbekët, që janë kombësia kryesore, turkmenët, një kombësi «më pak e rëndësishme» nga pikëpamja e shovinizmit të Buharasë, dhe kirgizët. Këta të fundit janë të paktë dhe, me sa duket, janë «në pak të rëndësishëm».

Në Horezëm paraqitet e njëjta gjendje: turkmenët dhe uzbekët. Uzbekët janë kombësia kryesore dhe turkmenët janë kombësia «më pak e rëndësishme».

Të gjitha këto shkaktojnë konflikte dhe e dobsojnë Pushtetin Sovjetik. Edhe kjo prirje drejt shovinizmit lokal duhet të shkulet nga rrënjët. Sigurisht, në krahasim me shovinizmin rusomadh, që përbën tri të katërtat e tërë sistemit të përgjithshëm të çështjes kombëtare, shovinizmi lokal nuk është aq i rëndësishëm, por për punën lokale, për kuadrot vendase, për zhvillimin paqësor të vetë republikave kombëtare, ky shovinizëm ka një rëndësi të dorës së parë.

Ky shovinizëm fillon nganjëherë të pësojë një evolucion shumë të çuditshëm. E kam fjalën për Transkaukazinë. Ju e dini se Transkaukazia përbëhet nga tri republika, që kanë në gjirin e tyre dhjetë kombësi. Transkaukazia qysh prej shumë kohësh ka qenë një arenë masakrash dhe grindjesh, kurse më vonë, në kohën e menshevikëve dhe të dashnakëve, ajo

u bë një arenë luftërash. Ju e dini luftën armene-gjeorgjiane. Ju i dini, gjithashtu, masakrat që u bënë në Azerbajxhan nga fillimi dhe nga fundi i vitit 1905. Mund të përmend një varg të tërë krahinash, ku shumica armene ka therur gjithë pjesën tjetër të popullsisë, të përbërë nga tatarë, — për shembull në Zangezuri. Mund të përmend edhe një krahinë tjetër — Nahicjevanin. Atje tatarët ishin më të shumtë dhe therrën të gjithë armenët. Kjo ndodhi pikërisht përpara çlirimit të Armenisë dhe të Gjeorgjisë nga zgjedha e imperializmit. (Një zë nga salla: «Ata e zgjidhën çështjen kombëtare sipas mënyrës së tyre».) Sigurisht, edhe kjo është një formë për të zgjidhur çështjen kombëtare. Por kjo nuk është forma sovjetike e zgjidhjes. Me një gjendje të tillë armiqësie kombëtare reciproke punëtorët rusë, sigurisht, nuk kanë të bëjnë fare, sepse ata që luftojnë me njëri-tjetrin janë tatarët dhe armenët, jo rusët. Ja pse Transkaukazia ka nevojë për një organ të posaçëm, i cili të mund të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet kombësive.

Mund të themi pa frikë se marrëdhëniet ndërmjet proletariatit të kombit dikur sundues dhe punonjësve të të gjitha kombësive të tjera përfaqësojnë tri të katërtat e gjithë çështjes kombëtare. Por një e katërta e kësaj çështjeje u përket marrëdhënieve ndërmjet vetë kombësive dikur të shtypura.

Në një gjendje të tillë mosbesimi reciprok, sikur Pushteti Sovjetik të mos ishte treguar i aftë të organizonte në Transkaukazi një organ paqeje kombëtare për të rregulluar mosmarrëveshjet dhe konfliktet, ne do të ishim kthyer në epokën e carizmit ose në epokën e dashnakëve, musavatistëve dhe menshevikëve, kur njerëzit digjnin dhe therrnin njëri-tjetrin. Ja pse Komiteti Qendror ka theksuar tri herë me radhë nevojën për të ruajtur Federatën Transkaukaziane, si një organ paqeje kombëtare.

Ndër ne ka qenë dhe është ende një grup komu-

nistësh gjeorgjianë, të cilët nuk kanë kundërshtim që Gjeorgjia të futet në Bashkimin e Republikave, por nuk duan që ky bashkim të realizohet nëpërmjet Federatës Transkaukaziane. Ata duan, gjoja, të jenë më afër Bashkimit dhe thonë se nuk duhej që Federata e Transkaukazit të qëndrojë si në gardh midis nesh, gjeorgjianëve, dhe Bashkimit të Republikave; federata, thonë ata, nuk është e nevojshme. Kjo duket sikur është shumë revolucionare.

Por prapa kësaj fshihet një qëllim tjetër. Së pari, këto deklarata vërtetojnë se në fushën e çështjes kombëtare në Gjeorgji qëndrimi kundrejt rusëve ka një rëndësi të dorës së dytë, sepse këta shokë devijues (kështu i quajnë) nuk kanë aspak kundërshtim që Gjeorgjia të futet drejtpërdrejt në Bashkimin, d.m.th. nuk kanë frikë nga shovinizmi rusomadh, duke menduar se në një mënyrë ose në një tjetër ai është shkullur nga rrënjët ose nuk ka një rëndësi vendimtare. Ata, me sa duket, kanë më tepër frikë nga Federata e Transkaukazit. Pse? Pse tre popujt kryesorë që jetojnë në Transkaukazi, që janë kacafytur me njëri-tjetrin për një kohë të gjatë, që kanë therur njëri-tjetrin, që kanë luftuar kundër njëri-tjetrit, — pse këta popuj tani që, më në fund, Pushteti Sovjetik ka vendosur lidhje të një aleance vëllazërore midis tyre nëpërmjet federatës, tani që kjo federatë ka dhënë rezultate pozitive, pse t'i prishin tani këto lidhje të federatës? Cili është shkak, shokë?

Shkak është se lidhjet e Federatës së Transkaukazit ia heqin Gjeorgjisë atë pozitë të privilegjuar që ajo mund të zinte në saje të pozitës së vet gjeografike. Gjykojeni vetë. Gjeorgjia ka një port të vetin — Batumin, prej ku hyjnë mallrat që vijnë nga Perëndimi; Gjeorgjia ka një nyje hekurudhore, Tbilisin, pa të cilin s'bëjnë dot armenët dhe Azerbajxhani, i cili i merr mallrat e tij nga Batumi. Po të ishte një republikë më vete dhe po të mos bënte pjesë në Fede-

ratën e Transkaukazitë, Gjeorgjia mund t'i jepte një ultimatum të vogël edhe Armenisë, që s'bën dot pa Tbilisin, edhe Azerbajxhanit, që s'bën dot pa Batumin. Në këtë mes Gjeorgjia do të kishte disa përfitime. Nuk është diçka e rastit që dekreti aq i egër i kordoneve kufitare, të cilin e dinë të gjithë, u përpunua pikërisht në Gjeorgji. Tani ky faj i ngarkohet Serebrjakovit. Po e zëmë se është kështu. Por, siç dihet, ky dekret doli në Gjeorgji, dhe jo në Azerbajxhan ose Armeni.

Pastaj, ka edhe një shkak tjetër. Tbilisi është kryeqyteti i Gjeorgjisë, por aty gjeorgjianët nuk përbëjnë më tepër se 30% dhe armenët nuk përbëjnë më pak se 35%, pastaj vijnë të gjitha kombësitë e tjera. Ja cili është kryeqyteti i Gjeorgjisë. Sikur Gjeorgjia të ishte një republikë më vete, atëherë mund të bëhej njëfarë shpërnguljeje e popullsisë, — për shembull, popullsia armene mund të shpërngulej nga Tbilisi. Dhe në Gjeorgji ishte miratuar një dekret për «sistemimin» e popullsisë së Tbilisit, për të cilin shoku Maharaxe tha se nuk drejtohej kundër armenëve. Me këtë dekret synohej të bëhej njëfarë shpërnguljeje e popullsisë, në mënyrë që në Tbilis armenët të pakësoheshin çdo vit në krahasim me gjeorgjianët, për ta bërë kështu Tbilisin një kryeqytet të vërtetë gjeorgjian. Unë e pranoj se dekretin për shpërnguljen ata e hoqën. Por ata kanë ende mundësi të shumta dhe forma të shumta elastike, — për shembull «rrallimi i popullsisë», — me të cilat, duke ruajtur gjithmonë dukjen e internacionalizmit, mund të organizohej puna në mënyrë që armenët në Tbilis të pakësoheshin.

Pikërisht këto përfitime, që rrjedhin nga pozita gjeografike dhe që devijuesit gjeorgjianë nuk duan t'i humbin, pikërisht kjo pozitë e pafavorshme e gjeorgjianëve brenda në Tbilis, ku gjeorgjianët janë më të paktë se armenët, i detyrojnë devijuesit tanë të luftojnë kundër federatës. Menshevikët, i shpërngulnin

armenët dhe tatarët nga Tbilisi si pa të keq. Por tani, në Pushtetin Sovjetik, kjo nuk mund të bëhet, prandaj duhet dalë nga federata, dhe atëherë do të krijohen mundësitë juridike për të kryer më vete disa veprime, të cilat të lejojnë që pozita e favorshme e gjeorgjianëve të shfrytëzohet plotësisht kundër Azerbajxhanit dhe Armenisë. Dhe si pasojë e gjithë këtyre do të krijohej një pozitë e privilegjuar për gjeorgjianët në Transkaukazi. Këtu është gjithë rreziku.

A mund t'i hedhim ne poshtë interesat e paqes kombëtare në Transkaukazi, dhe a mund të krijojmë kushte të tilla, në të cilat gjeorgjianët të kenë pozita të privileguara ndaj republikave të Armenisë dhe të Azerbajxhanit? Jo, ne këtë nuk mund ta lejojmë.

Ka një sistem të vjetër, një sistem të posaçëm për qeverisjen e kombeve: pushteti borgjez i favorizon disa kombësi, u jep atyre privilegje, kurse kombet e tjera i poshtëron dhe nuk ua vë veshin. Në këtë mënyrë ai favorizon një kombësi dhe shtyp nëpërmjet saj gjithë të tjerat. Kështu bëhej, për shembull, në Austri. Të gjithëve u kujtohet deklarata e ministrit austriak Bejst, kur ai thirri një ministër hungarez dhe i tha: «ti qeveris hordhitë e tua dhe unë do t'i dal punës në krye me të miat». Domethënë, ti shkelmo dhe shtyp kombësitë e tua në Hungari, kurse unë po shtyp të miat në Austri. Ti dhe unë jemi kombe të privileguara, kombet e tjera t'i shtypim.

E njëjta gjë ndodhte me polonezët në gjirin e Austrisë. Austriakët i favorizonin polonezët dhe u jepnin atyre privilegje, me qëllim që polonezët të ndihmonin austriakët për të forcuar pozitën e tyre në Poloni, prandaj austriakët u jepnin mundësi polonezëve të shtypnin Galicinë.

Ky është një sistem i posaçëm, thjesht austriak: të bësh dallime për disa kombësi dhe t'u japësh atyre privilegje, me qëllim që të mposhtësh të tjerat. Nga pikëpamja e burokracisë kjo është një mënyrë qeveri-

sjeje «ekonomike», sepse ke të bësh vetëm me një kombësi, por nga pikëpamja politike kjo është një vdekje e sigurt për një shtet, sepse të shkelësh parimet e barazisë së kombësive dhe t'i japësh privilegje të ndryshme një kombësie do të thotë ta dënosh me vdekje politikën tënde kombëtare.

Pikërisht kështu po e qeveris tani edhe Anglia Indinë. Për ta bërë punën më lehtë nga pikëpamja burokratike me kombësitë dhe tributë e Indisë, Anglia e ndau Indinë në Indi britanike (240 000 000 banorë) dhe në Indi indigjene (72 000 000). Për ç'arsye? Për arsye se Anglia mendoi të favorizonte një grup kombesh dhe t'u jepte atyre privilegje për të qeverisur më lehtë kombësitë e tjera. Në Indi ka disa qindra kombësi, dhe Anglia vendosi: pse të sillim zot me këto kombësi, më mirë të favorizoj disa kombe, t'u jap atyre disa privilegje dhe, nëpërmjet tyre, të qeveris të tjerat, sepse, së pari, pakënaqësia e kombeve të tjera do të drejtohet në këtë rast kundër këtyre kombeve të privilegjuara e jo kundër Anglisë, dhe, së dyti, po të kem të bëj me dy-tri kombe do të më kushtojë më pak.

Edhe ky sistem anglez është një sistem qeverisjeje. Çfarë sjell me vete ky sistem? Sjell «lirësimin» e aparatit, — kjo është e vërtetë. Por, shokë, po të lëmë mënjanë lehtësitë burokratike, ky sistem përmban në vetvete vdekjen e sigurt të sundimit anglez në Indi; ky sistem sjell me vete vdekjen e pashmangshme, si dy e dy bëjnë katër, vdekjen e qeverisjes angleze dhe të sundimit anglez.

Në këtë rrugë të rrezikshme na shtyjnë shokët tanë, devijuesit gjeorgjianë, përderisa ata luftojnë kundër federatës, duke shkelur të gjitha ligjet e partisë, përderisa ata duan të ndahen nga federata për të ruajtur pozitën e tyre të favorshme. Ata na shtyjnë në rrugën që u siguron atyre disa privilegje në kurriz të republikave të Armenisë dhe të Azerbajxha-

nit. Ne nuk mund të ndjekim këtë rrugë, sepse kjo është një vdekje e sigurt për gjithë politikën tonë dhe për Pushtetin Sovjëtik në Kaukaz.

Nuk është e rastit që këtë rrezik e kuptuan shokët tanë në Gjeorgji. Ky shovinizëm gjeorgjian, që është hedhur në sulm kundër armenëve dhe azerbajxhanasve, e shqetësoi së tepërmi Partinë Komuniste të Gjeorgjisë. Prandaj Partia Komuniste e Gjeorgjisë, në të dy kongreset që ka bërë gjatë ekzistencës së saj legale, e dënoi njëzëri pozitën e shokëve devijues, sepse, në kushtet e tanishme, nuk mund të ruhet paqja në Kaukaz pa Federatën Transkaukaziane, nuk mund të vendoset barazia. Nuk mund të lejohet që një komb të jetë më i privilegjuar se një tjetër. Këtë e kuptuan shokët tanë. Ja pse, pas dy vjet lufte, grupi i Mdivanit është katandisur në një grusht të vogël, që është shkëlmuar vazhdimisht nga vetë partia e Gjeorgjisë.

Nuk është gjithashtu e rastit që shoku Lenin u nxitua aq shumë dhe nguli këmbë aq shumë që federata të krijohej menjëherë. Nuk është e rastit edhe që Komiteti ynë Qendror theksoi tri herë me radhë nevojën e një federate në Transkaukazi me një KQE të saj dhe me një pushtet ekzekutiv të saj, vendimet e të cilit duhet të jenë të detyrueshme për republikat. Nuk është e rastit edhe se të dyja komisionet — si ai i shokut Xherzhinski ashtu edhe ai i Kamenievit me Kuibishevin, — pasi u kthyen në Moskë thanë se nuk mund të bëhet pa federatë.

Më në fund, nuk është e rastit edhe se menshevikët e «Socialisticheski Vjestnikut» i lavdërojnë shokët tanë devijues për luftën që ata bëjnë kundër federatës dhe i mbajnë në pëllëmbë të dorës: korbi korbit s'ia nxjerr sytë.

Po kaloj tani në shqyrtimin e mjeteve dhe të mënyrave, me të cilat ne duhet të zhdukim këta tre faktorë kryesorë që pengojnë bashkimin: shovinizmin

usomadh, pabarazinë reale ndërmjet kombeve dhe nacionalizmin lokal, sidomos kur ky kthehet në shovinizëm. Unë do të tregoj tri nga mjetet që mund të a ndihmojnë për të zhdukur më lehtë këtë trashëgim ë vjetër, që pengon afrimin e popujve.

Mjeti i parë: të marrim të gjitha masat me qëllim ë Pushteti Sovjetik në republikat të bëhet i kuptueshëm dhe i afërt, me qëllim që Pushteti Sovjetik të etë ndër ne jo vetëm një pushtet rus, por edhe i të gjitha kombësive. Për këtë duhet të kombëtarizohen o vetëm shkollat, por edhe të gjitha institucionet, të gjitha organet e partisë dhe të pushtetit, në mënyrë të ato të funksionojnë në gjuhën e kuptueshme për masat, në mënyrë që ato të funksionojnë në kushte ë u përgjigjen zakoneve të çdo populli. Vetëm me këtë usht ne do të kemi mundësi ta kthejmë Pushtetin Sovjetik nga një pushtet rus në një pushtet të të gjitha kombësive, ta bëjmë atë të afërt dhe të kuptueshëm për masat punonjëse të të gjitha republikave dhe sidomos të atyre që kanë mbetur prapa nga pikëpamja ekonomike dhe kulturore.

Mjeti i dytë, që mund të na lejojë të zhdukim më ehtë trashëgimin që na ka lënë carizmi dhe borgjeria, është organizimi i komisariateve pranë Bashkimit ë Republikave, në mënyrë që t'u jepet mundësi, të paktën kombësive kryesore, të kenë njerëzit e tyre të kolegjiunet drejtuese dhe të krijohet një gjendje, në të cilën nevojat dhe kërkesat e republikave të veçanta të plotësohen patjetër.

Mjeti i tretë: duhet që te organet tona qendrore në të larta të krijohet edhe një organ që të pasqyrojë nevojat dhe kërkesat e të gjitha republikave dhe kombësive pa përjashtim.

Për pikën e fundit dua të tërheq vëmendjen tuaj në mënyrë të posaçme.

Po të kishim mundësi të krijojmë në gjirin e KQE të Bashkimit dy dhoma me të drejta të barabarta, nga

të cilat e para të zgjidhej prej Kongresit të Sovjetëve të Bashkimit, pavarësisht nga kombësitë, dhe e dyta të zgjidhej prej republikave dhe krahinave kombëtare (me një numër të barabartë përfaqësuesish, si nga republikat ashtu edhe nga krahinat kombëtare) dhe të miratohej përsëri prej Kongresit të Sovjetëve të Bashkimit të Republikave, mendoj se atëherë në institucionet tona më të larta do të gjenin pasqyrimin e tyre jo vetëm interesat klasore të të gjithë punonjësve pa përjashtim, por edhe kërkesat thjesht kombëtare. Ne do të kishim kështu një organ që do të pasqyronte interesat e veçanta të kombësive, të popujve dhe tribuve që banojnë në territorin e Bashkimit të Republikave. Në kushtet tona, shokë, kur Bashkimi përfshin jo më pak se 140 milionë njerëz, nga të cilët 65 milionë nuk janë rusë, — një shtet i tillë nuk mund të qeveriset pa pasur këtu, në Moskë, në organin më të lartë, të deleguarit e këtyre kombësive, të cilët të pasqyrojnë jo vetëm interesat e përgjithshme të proletariatit, por edhe interesat kombëtare të veçanta, të posaçme, specifike. Pa këtë, shokë, nuk mund të qeveriset. Pa pasur në duart tona këtë barometër dhe pa pasur njerëz që të dinë ti formulojnë këto nevoja të posaçme të kombësive të veçanta nuk mund të qeverisim.

Ka dy mënyra për qeverisjen e një vendi: njëra mënyrë, kur aparati «është thjeshtuar» dhe në krye të tij qëndron, të themi, një grup ose një njeri, i cili vepron dhe kontrollon bazën me anën e guvernatorëve. Kjo është një formë shumë e thjeshtë qeverisjeje; këtu kryetari, duke qeveritur vendin, merr informatat që mund të mbledhin guvernatorët dhe ngushëllon vetën me shpresën se qeveris ndershmërisht dhe drejt. Pastaj lindin mosmarrëveshje, mosmarrëveshjet kthehen në konflikte, konfliktet — në kryengritje. Pastaj kryengritjet shtypen. Ky sistem qeverisjeje nuk është sistemi ynë; përveç kësaj, ky sistem është tepër i kushtueshëm, megjithëse i thjeshtë. Por ka edhe një

sistem tjetër qeverisjeje, sistemi sovjetik. Në, në Vendlin e Sovjetëve, zbatojmë një sistem tjetër qeverisjeje, një sistem që na jep mundësi të parashikojmë me saktësinë më të madhe të gjitha ndryshimet dhe rrethanat, si në gjirin e fshatarëve, ashtu edhe në gjirin e elementëve të kombësive të ndryshme, si në gjirin e të ashtuquajturve «alogjenë», ashtu edhe në gjirin e rusëve, — me qëllim që në sistemin e organeve të larta të ketë një varg barometrash që të parashikojnë çdo ndryshim, që të regjistrojnë dhe të paralajmërojnë qoftë lëvizjen e basmaçëve³⁷, qoftë lëvizjen e banditëve, qoftë Kronshtadtin, si dhe çdo furtunë e fatkeqësi tjetër. Ky është sistemi sovjetik i qeverisjes. Ai quhet Pushtet Sovjetik, pushtet popullor, sepse duke u mbështetur në shtresat më të ulëta dikton më parë se kushdo tjetër çdo ndryshim, merr masat përkatëse dhe ndreq vijën në kohën e duhur, në qoftë se ajo është shtrembëruar, — ai kritikon vetveten dhe ndreq vijën. Ky sistem qeverisjeje është sistemi sovjetik, dhe ai kërkon që në sistemin e organeve tona më të larta të ketë edhe organe që të pasqyrojnë plotësisht nevojat dhe kërkesat kombëtare.

Thonë se ky sistem do ta ndërlikojë administrimin dhe do ta rëndojë atë me një grumbull organesh të reja. Kjo është e vërtetë. Deri tani ne kemi pasur KQE të RSFSR-së, pastaj krijuam KQE të Bashkimit, dhe tani do të na duhet ta ndajmë këtë në dy pjesë. S'ke ç'i bën. Unë e thashë se sistemi më i thjeshtë i qeverisjes është të vësh një njeri të vetëm dhe t'i japësh atij guvernatorë. Por pas Tetorit ne nuk mund të bëjmë eksperimente të tilla. Sistemi është ndërlikuar, por ai lehtëson qeverisjen dhe e bën gjithë administratën thellësisht sovjetike. Ja pse mendoj se kongresi duhet ta miratojë krijimin e një organi të posaçëm — të një dhome të dytë në gjirin e KQE të Bashkimit, si një organ krejtësisht të nevojshëm.

Nuk them se kjo është forma më e përsosur e organizimit të bashkëpunimit ndërmjet popujve të Bashkimit; nuk them se kjo është fjala e fundit e shkencës. Çështjen kombëtare ne do ta shtrojmë edhe herë të tjera, sepse kushtet (kombëtare dhe ndërkombëtare po ndryshojnë dhe mund të ndryshojnë ende. Unë nuk mund të zotohem se më vonë nuk do të detyrohemi, ndoshta, t'i ndajmë përsëri disa nga komisarariat që po shkrijmë tani në përbërjen e Bashkimit të Republikave, në qoftë se përvoja do të na tregojë se disa komisariate kanë dhënë rezultate negative pas shkrirjes së tyre. Por një gjë është e qartë: në kushtet dhe në gjendjen e tanishme ne nuk kemi mënyrë tjetër më të mirë dhe organ tjetër më të përshtatshëm. Tani për tani për krijimin e një organi që të pasqyrojë të gjitha lëkundjet dhe të gjitha ndryshimet në gjirin e republikave të veçanta ne nuk kemi mjet më të mirë dhe rrugë tjetër përveç krijimit të një dhome të dytë.

Kuptohet vetiu se në dhomën e dytë duhet të përfaqësohen jo vetëm këto katër republika që janë bashkuar, por të gjithë popujt, sepse nuk është fjala vetëm për republikat që janë bashkuar formalisht (ato janë katër), por edhe për të gjithë popujt dhe kombësitë e Bashkimit të Republikave. Prandaj ne na duhet një formë e tillë që të pasqyrojë kërkesat e të gjitha kombësive dhe republikave, pa përjashtim.

Po bëj përmbledhjen, shokë.

Pra, rëndësia e çështjes kombëtare përcaktohet nga gjendja e re në fushën ndërkombëtare dhe nga që ne, këtu në Rusi, në federatën tonë, duhet ta zgjidhim drejt dhe në mënyrë shembullore çështjen kombëtare, në mënyrë që të bëhemi shembull për Lindjen, e cila është një rezervë shumë e madhe për revolucionin, dhe të shtojmë kështu besimin e kësaj rezerve ndaj federatës sonë, të rritim forcën tërheqëse të kësaj federate.

Nga pikëpamja e gjendjes së brendshme, kushtet e nepit, rritja e shovinizmit rusomadh dhe shovinizmit lokal na detyrojnë, gjithashtu, ta theksojmë në mënyrë të veçantë rëndësinë e çështjes kombëtare.

Thashë, pastaj, se thelbi i çështjes kombëtare është vendosja e marrëdhënieve të drejta ndërmjet proletariatit të kombit dikur sundues dhe fshatarësisë së kombeve dikur të sunduara, se, nga kjo pikëpamje, forma konkrete e çështjes kombëtare në çastin e tanishëm është kërkimi i mënyrave dhe i mjeteve për organizimin e bashkëpunimit të popujve në gjirin e Bashkimit të Republikave, në gjirin e një shteti të vetëm.

Fola, pastaj, për faktorët që e lehtësojnë këtë afrim të popujve. Fola për faktorët që e pengojnë këtë bashkim. U ndala veçanërisht në shovinizmin rusomadh, si një forcë që është duke u konsoliduar. Kjo forcë përfaqëson rrezikun kryesor, që mund ta minojë besimin e popujve dikur të shtypur ndaj proletariatit rus. Kjo forcë është armiku ynë më i rrezikshëm, të cilin ne duhet ta përmbysim, sepse po e përmbysëm atë kemi përmbysur në 9/10 edhe nacionalizmin, që ka mbetur dhe që po zhvillohet nëpër republikat e ndryshme.

Më tej. Ne ndodhemi tani përpara rrezikut që disa grupe shokësh të na shtyjnë t'u japim privilegje disa kombësive, në dëm të të tjerave. Unë deklarova se ne nuk mund të ndjekim këtë rrugë, sepse kjo mund të prishë paqen kombëtare dhe të zhdukë besimin e masave të kombësive të tjera ndaj Pushtetit Sovjetik.

Thashë, pastaj, se mjete kryesor që mund të na lejojë t'i zhdukim më lehtë këta faktorë, që pengojnë bashkimin, është krijimi i një dhome të dytë në gjirin e KQE; për këtë çështje fola më gjerë në plenumin e shkurtit të KQ, kurse në tezat flitej në mënyrë më të përmbledhur, për t'u dhënë mundësi shokëve të gjejnë ndoshta një formë tjetër më elastike, një organ

tjetër më të përshtatshëm, që të pasqyrojë interesat e kombësive.

Këto janë konkluzionet.

Unë mendoj se vetëm dukje ndjekur këtë rrugë ne do ta zgjidhim drejt çështjen kombëtare, do të arrijmë ta ngremë lart flamurin e revolucionit proletar dhe do t'i sigurojmë atij simpatinë dhe besimin e vendeve të Lindjes, që janë rezerva shumë të rëndësishme për revolucionin dhe që mund të luajnë një rol vendimtar në përlëshjet e ardhshme të proletariatit me imperializmin.

FJALA E MBYLLJES RRETH REFERATIT PËR MOMENTET KOMBËTARE NË NDËRTIMIN E PARTISË DHE TË SHITETIT

Shokë! Para se t'ju njoftoj për punimet e komisionit të çështjes kombëtare, më lejoni t'u përgjigjem për dy pikë kryesore oratorëve që diskutuan në lidhje me referatin tim. Për këtë do të duhen gjithsej rreth 20 minuta, jo më tepër.

Çështja e parë është se një grup shokësh, të kryesuar nga Buharini dhe Rakovski, e frynë jashtë masës rëndësinë e çështjes kombëtare, e zmadhuan atë dhe, për shkak të saj, lanë mënjanë çështjen shoqërore, — çështjen e pushtetit të klasës punëtore.

Për ne, komunistët, është e qartë se baza e gjithë punës sonë është veprimtaria për forcimin e pushtetit të punëtorëve, dhe vetëm pas kësaj del përpara nesh çështja tjetër, një çështje shumë e rëndësishme, por e varur nga e para, — çështja kombëtare. Na thonë se nuk duhen fyer kombet joruse. Kjo është shumë e drejtë, unë jam dakord me këtë, — ato nuk duhen fyer. Por të nxjerrësh nga kjo një teori të re

dhe të thuash se proletariati rus duhet të vihet në kushte pabarazie, në krahasim me kombet dikur të shtypura, — do të thotë të flasësh gjepura. Atë që shoku Lenin e ka përdorur si një mënyrë shprehjeje në artikullin e tij të njohur, Buharini e ka kthyer në një parullë të vërtetë. Mirëpo është e qartë se baza politike e diktaturës proletare janë, para së gjithash dhe kryesisht, krahinat qendrore industriale dhe jo krahinat periferike, të cilat janë vende fshatare. Po t'u japim rëndësi krahinave periferike fshatare më tepër sesa duhet, në dëm të krahinave proletare, mund të hapet një plasë në sistemin e diktaturës së proletariatit. Kjo është e rrezikshme, shokë. Në politikë duhet bërë çdo gjë me masë.

Duhet pasur parasysh se, përveç të drejtës së popujve për vetëvendosje, është edhe e drejta e klasës punëtore për të forcuar pushtetin e saj, dhe kësaj së drejte të fundit i nënshtrohet e drejta për vetëvendosje. Ka raste kur e drejta për vetëvendosje bie në kundërshtim me një të drejtë tjetër më të lartë, — me të drejtën e klasës punëtore, që ka fuqinë në dorë, për ta forcuar pushtetin e vet. Në raste të tilla. — duhet ta themi haptazi, — e drejta për vetëvendosje nuk mund dhe nuk duhet të bëhet pengesë për të drejtën që ka klasa punëtore të ushtrojë diktaturën e saj. E para duhet t'i lëshojë vendin së dytës. Kështu ndodhi, për shembull, më 1920, kur ne u detyruam të marshonim drejt Varshavës për të mbrojtur pushtetin e klasës punëtore.

Prandaj nuk duhet harruar se duke u dhënë kombeve gjithfarë premtimesh dhe duke u përlulur me nderim përpara përfaqësuesve të kombësive, sikurse vepruan disa shokë në këtë kongres, duhet të kemi parasysh se sfera e veprimit të çështjes kombëtare dhe caqet, si të thuash, e kompetencës së tij kufizohen, në kushtet tona të jashtme dhe të brendshme, nga sfera e veprimit dhe e kompetencës së

«çështjes punëtore», që është çështja kryesore ndër të gjitha të tjerat.

Shumë folës përmendën shënimet dhe artikujt e Vladimir Iličit. Unë nuk dua të citoj mësuesin tim, shokun Lenin, meqenëse ai nuk është këtu dhe kam frikë se mos e citoj, ndoshta, gabim dhe pa vend. Megjithatë, jam i shtrënguar të citoj një frazë aksiomatike, që nuk lë vend për asnjë keqkuptim; këtë po e bëj me qëllim që shokët të mos kenë asnjë dyshim për peshën specifike të çështjes kombëtare. Duke analizuar një letër të Marksit për çështjen kombëtare, shoku Lenin në një artikull të tij për vetëvendosjen nxjerr këtë përfundim:

«Në krahasim me «çështjen punëtore» për Marks-in është e padiskutueshme se çështja kombëtare ka rëndësi të dorës së dytë»^{*}.

Këtu kemi vënë dy radhë, por ato kanë rëndësi vendimtare. Këtë duhet ta mbajnë mend mirë disa shokë që tregojnë zell të tepruar.

Çështja e dytë është shovinizmi rusomadh dhe shovinizmi lokal. Për këtë pikë diskutoi Rakovski dhe sidomos Buharini, i cili propozoi të hiqet pika që flet për dëmin e shovinizmit lokal. S'është nevoja të merremi me një krimb të tillë si shovinizmi lokal, thotë ai, kur kemi një «Goliath», si shovinizmi rusomadh. Në përgjithësi, te Buharini u duk tendenca e pendimit. Dhe kjo kuptohet: vite me radhë ai ka bërë mëkate kundër kombësive duke u mohuar atyre të drejtën e vetëvendosjes; më në fund, erdhi koha që ai të pendohet. Por duke u penduar ai kaloi në ekstremin tjetër. Është për t'u çuditur që Buharini i bën thirrje partisë të ndjekë shembullin e tij dhe të pendohet edhe ajo, megjithëse bota e di se partia

* Shih këtë përmbledhje, f. 164. Red. Përkth.

nuk hyn fare në këtë mes, sepse qysh në fillim të ekzistencës së saj (1898) ajo e ka njohur të drejtën e vetëvendosjes, prandaj nuk ka për çfarë të pendohet. Puna është se Buharini nuk e ka kuptuar thelbin e çështjes kombëtare. Kur themi se kryesorja në çështjen kombëtare është lufta kundër shovinizmit rusomadh, me këtë duam të theksojmë detyrat e komunistit rus, me këtë duam të themi se detyra e komunistit rus është që ai vetë të luftojë kundër shovinizmit rus. Sikur luftën kundër shovinizmit rus të mos e bënin komunistët rusë, por komunistët turkmenë ose gjeorgjianë, atëherë kjo luftë mund të merrej si një shovinizëm antirus. Kjo do ta ngatërronte gjithë punën dhe do ta forconte shovinizmin rusomadh. Vetëm komunistët rusë mund ta marrin përsipër detyrën e luftës kundër shovinizmit rusomadh dhe ta çojnë atë deri në fund.

Po ç'duam të themi kur flasim për luftën kundër shovinizmit lokal? Me këtë duam të theksojmë detyrën e komunistëve vendas, detyrën që kanë komunistët jorusë për të luftuar kundër shovinizmit të tyre. A mund të mohohet ekzistenca e deviacioneve drejt shovinizmit antirus? Gjithë kongresi e pa qartë se ka një shovinizëm lokal gjeorgjian, bashkir etj. dhe se ai duhet luftuar. Komunistët rusë nuk mund të luftojnë kundër shovinizmit tatar, gjeorgjian, bashkir, sepse sikur komunisti rus të merrte përsipër detyrën e vështirë të luftës kundër shovinizmit tatar ose gjeorgjian, kjo luftë e tij do të quhej si luftë e një shovinisti rusomadh kundër tatarëve dhe gjeorgjianëve. Kjo do ta ngatërronte gjithë punën. Vetëm komunistët tatarë, gjeorgjianë etj. mund të luftojnë kundër shovinizmit tatar, gjeorgjian etj., vetëm komunistët gjeorgjianë mund të luftojnë me sukses kundër nacionalizmit ose shovinizmit të tyre gjeorgjian. Kjo është detyra e komunistëve jorusë. Ja pse në tezat duhet vënë në dukje kjo detyrë e dyfishtë e komunistëve rusë

(e kam fjalën për luftën kundër shovinizmit rusomadh) dhe e komunistëve jorusë (e kam fjalën për luftën kundër shovinizmit antiarmen, antitatar, antirus). Përndryshe tezat do të dalin të njëanshme dhe nuk do të kemi asnjë internacionalizëm as në ndërtimin e shtetit as në atë të partisë.

Po qe se ne bëjmë luftë vetëm kundër shovinizmit rusomadh, kjo luftë mund ta mbulojë luftën e shovinistëve tatarë etj., që po zhvillohet nëpër rrethet dhe që është veçanërisht e rrezikshme tani, në kushtet e nepit. Ne nuk mund të mos luftojmë në dy fronte, sepse vetëm duke luftuar në dy fronte, — nga njëra anë, kundër shovinizmit rusomadh, që është rreziku kryesor në punën tonë ndërtimore, dhe, nga ana tjetër, kundër shovinizmit lokal, — mund të kemi sukses, sepse pa një luftë të tillë të dyanshme nuk do të kemi asnjë bashkim të punëtorëve dhe fshatarëve rusë me punëtorët dhe fshatarët e kombësive të tjera. Përndryshe shovinizmi lokal mund të marrë hov dhe ne mund të biem në politikën e nxitjes së shovinizmit lokal, që është e palejueshme.

Më lejoni t'i referohem edhe në këtë pikë shokut Lenin. Unë nuk do ta bëja këtë, por meqenëse në kongresin tonë ka shumë shokë që e citojnë shokun Lenin mbarë e prapë, duke i shtrembëruar mendimet e tij, më lejoni të lexoj disa fjalë nga një artikull i shokut Lenin që e dinë të gjithë:

«Proletariati duhet të kërkojë lirinë e shkëputjes politike për kolonitë dhe kombet e shtypura nga kombi «i tij». Në rastin e kundërt internacionalizmi i proletariatit do të mbetet fjalë e zbrazët dhe e kotë; në këtë rast nuk mund të ketë as besim as solidarësi klase ndërmjet punëtorëve të kombit të shtypur dhe punëtorëve të kombit shtypës» (Veprat, bot. shqip, vëll. 22, f. 176).

Këto janë, si të thuash, detyrat e proletarëve të kombit sundues ose dikur sundues. Më poshtë ai

flet për detyrën e proletarëve ose komunistëve të kombeve dikur të shtypura.

«Nga ana tjetër, socialistët e kombeve të shtypura duhet në mënyrë të veçantë të mbrojnë dhe të vënë në jetë bashkimin e plotë dhe pa kushte, duke përfshirë edhe bashkimin organizativ, të punëtorëve të kombit të shtypur me punëtorët e kombit shtypës. Pa këtë është e pamundur të mbrohet politika e pavarur e proletariatit dhe solidarësia e tij e klasës me proletariatin e vendeve të tjera në të gjitha dallaveret, tradhtitë dhe bataqçillëqet e borgjezisë. Sepse borgjezia e kombeve të shtypura i shndërron vazhdimisht parullat e çlirimit kombëtar në mjet për t'i mashtruar punëtorët» (po aty, f. 176).

Siç e shihni, po të ndjekim gjurmët e shokut Lenin, — dhe këtu disa shokë u betuan për emrin e tij, — atëherë duhet që në rezolucion të vihen të dyja tezat, qoftë teza për luftën kundër shovinizmit rusomadh, qoftë teza për luftën kundër shovinizmit lokal, si dy anë të një dukurie të vetme, si teza për luftën kundër shovinizmit në përgjithësi.

Me kaq po i përfundoj vërejtjet e mia kundër oratorëve që folën këtu.

Tani më lejoni t'ju bëj një komunikim për punimet e komisionit të çështjes kombëtare. Komisioni mori për bazë tezat e KQ. Komisioni nuk u bëri asnjë ndryshim gjashtë pikave të këtyre tezave: pikave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6. Në gjirin e komisionit u zhvillua një luftë sidomos rreth çështjes: duhet apo jo që republikat autonome të dalin më parë nga RSFSR-ja, pastaj të dalin nga Federata Transkaukaziane edhe republikat e pavarura të Kaukazit, me qëllim që ato të futen secila më vete në Bashkimin e Republikave, apo duhet vepruar ndryshe? Ky ishte propozimi i një pjesë të shokëve gjeorgjianë, propozim që, sikurse dihet, nuk pritet me simpati nga delegacionet e Gjeorgjisë,

Armenisë dhe Azerbaixhanit. Komisioni e mori në shqyrtim këtë çështje dhe me shumicë dërrmuese shfaq mendimin që të mbahet parimi i zhvilluar në tezat, d.m.th. RSFSR-ja mbetet si një formacion unik. Federata Transkaukaziane mbetet gjithashtu si një formacion unik, dhe që të dyja hyjnë në Bashkimin e Republikave ashtu siç janë. Propozimet e kësaj pjese të shokëve gjeorgjianë nuk u vunë të gjitha në votë, sepse autorët e këtyre propozimeve, duke parë se propozimet e tyre nuk gjetën përkrahje, i tërhoqën. Lufta që u zhvillua për këtë çështje ka qenë e ashpër.

Çështja e dytë, për të cilën pati luftë, ishte çështja se si duhet organizuar dhoma e dytë. Një pjesë e shokëve (pakica) propozoi që dhoma e dytë të mos përfshijë përfaqësuesit e të gjitha republikave, kombësive dhe krahinave, por të krijohet me përfaqësuesit e katër republikave: të RSFSR-së, Federatës Transkaukaziane, Bjellorusisë dhe Ukrainës. Shumica nuk e pranoi këtë propozim dhe komisioni u shpreh kundër tij duke vendosur se është më mirë që dhoma e dytë të organizohet në mënyrë që atje të përfaqësohen, sipas parimit të barazisë, të gjitha republikat (si të pavarurat, ashtu edhe autonomet) dhe të gjitha krahinat kombëtare. Unë nuk do t'i them arsyet, sepse përfaqësuesi i pakicës, Rakovski, do të flasë këtu për të argumentuar propozimin e tij, i cili u hodh poshtë nga komisioni. Pasi të flasë ai, atëherë edhe unë do të shfaq pikëpamjet e mia.

Një luftë, më pak e ashpër, u zhvillua edhe për çështjen nëse duhet t'u shtohet tezave ndonjë pikë, ku të theksohet nevoja që gjatë zgjidhjes së çështjes kombëtare ne të orientohemi jo vetëm nga Lindja, por edhe nga Perëndimi. Komisioni e vuri në votë këtë propozim. Ky propozim u bë nga pakica, nga Rakovski. Komisioni e hodhi poshtë. Edhe unë do të flas përsëri për këtë çështje, pasi të ketë folur Rakovski.

Po ju lexoj vërejtjet që u pranuan nga komisioni.

U pranuan pa kundërshtim gjashtë pika. Në rreshtin e tretë të paragrafit të dytë të pikës 7 përpara fjalëve: «Prandaj lufta e vendosur», do të vihet sa vijon:

«Gjendja në një vang republikash kombëtare (Ukrainë, Bjellorusi, Azerbaixhan, Turkestan) po ndërlikohet ngaqë një pjesë e konsiderueshme e klasës punëtore, e cila është mbështetja kryesore e Pushtetit Sovjetik, i përket kombësisë ruse. Në këto krahina aleanca ndërmjet qytetit dhe fshatit, ndërmjet klasës punëtore dhe fshatarësisë, ndesh në një pengesë mjaft të fortë, në mbeturinat e shovinizmit rusomadh, si në organet e partisë ashtu edhe në ato të pushtetit. Në këto kushte diskutimet për epërsitë e kulturës ruse dhe teza për pashmangësinë e fitores së kulturës ruse, që është një kulturë më e lartë ndër kulturat e popujve më të prapambetur (kulturën ukrainase, azerbaixhanase, uzbeke, kirgize etj.), nuk janë tjetër veçse një orvatje për të përforcuar sundimin e kombësisë ruse».

Këtë propozim unë e pranova, sepse ai i përmi-
rëson tezat.

Edhe vërejtja e dytë ka të bëjë me pikën 7. Përpara frazës: «pa këtë nuk ka arsye të shpresohet» do të shtohet sa vijon:

«Kjo ndihmë duhet të shprehet, para së gjithash, në marrjen e një vargu masash praktike për krijimin e vatrave industriale në republikat e kombësive dikur të shtypura, duke aktivizuar në maksimum popullsinë vendase. Më në fund, kjo ndihmë, sipas rezolucionit të Kongresit X, duhet të shkojë paralelisht me luftën e masave punonjëse për forcimin e pozitave të tyre shoqërore kundër shtresave të pasura shfrytëzuese vendase dhe të ardhura, që janë duke u përforcuar si pasojë e nepit. Meqenëse këto republika janë kryesisht krahina bujqësore, masat e brendshme shoqërore duhet të synojnë, në radhë të parë, që ma-

sat punonjëse të sigurohen me tokë, duke u shpërndarë tokat e lira shtetërore».

Përsëri në pikën 7, paragrafi 2, në mes, ku flitet për shovinizmin gjeorgjian, azerbajxhanas etj., do të shtohet: «shovinizmi armen etj.». Shokët armenë deshën të mos fyheshin armenët, deshën që të flitet edhe për shovinizmin e tyre.

Më poshtë, në pikën 8 të tezave, pas fjalëve «një dhe e pandarë» do të shtohet:

«Si pasojë e trashëgimit të së kaluarës duhet të merret edhe tendenca e disa dikastereve të RSFSR-së për të nënshtuar komisariatet e pavarura të republikave autonome dhe për të hapur rrugën drejt likuidimit të këtyre të fundit».

Përsëri në pikën 8 do të shtohet:

«dhe duke shpallur domosdoshmërinë e ekzistencës dhe të zhvillimit të mëtejshëm të republikave kombëtare».

Pika 9 të fillohet kështu si po e lexoj:

«Bashkimi i Republikave, i krijuar mbi parimin e barazisë dhe të vullnetarizmit të punëtorëve dhe fshatarëve të republikave të veçanta, është eksperimenti i parë i proletariatit në fushën e rregullimit të marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet vendeve të pavarura dhe hapi i parë drejt krijimit të Republikës Sovjetike Botërore të punës në të ardhmen».

Në vend të nënpikës «a» të pikës 10, do të vihet një nënpikë tjetër «a», e formuluar në këtë mënyrë:

«a) gjatë organizimit të organeve qendrore të Bashkimit t'u sigurohen të drejta dhe detyra të barabarta republikave të veçanta, si në marrëdhëniet ndërmjet tyre, ashtu edhe në marrëdhëniet me pushtetin qendror të Bashkimit».

Pastaj do të vijë nënpika «b», që është nënpika e mëparshme «a»:

«b) në sistemin e organeve të larta të Bashkimit të krijohet një organ i posaçëm ku të përfaqësohen,

pa përjashtim, të gjitha republikat dhe krahinat kombëtare sipas parimit të barazisë, duke pasur parasysh që të përfaqësohen mundësisht të gjitha kombësitë që përfshihen në këto republika».

Pastaj do të vijë nënpika «c», që është nënpika e mëparshme «b»:

«c) organet ekzekutive të Bashkimit të organizohen në mënyrë që të sigurojnë pjesëmarrjen reale të përfaqësuesve të republikave dhe plotësimin e nevojave dhe kërkesave të popujve të Bashkimit».

Pastaj do të shtohet një nënpikë tjetër, nënpika «ç»:

«ç) republikave t'u jepen të drejta mjaft të gjera financiare dhe veçanërisht buxhetore, të drejta që t'u sigurojnë atyre mundësinë për të treguar iniciativë në fushën e administrimit të tyre shtetëror, të kulturës dhe ekonomisë».

Pastaj do të vijë nënpika «d», që është nënpika e mëparshme «ç»:

«d) organet e republikave dhe krahinave kombëtare të organizohen kryesisht me njerëz vendas, që dinë gjuhën, zakonet, doket dhe mënyrën e jetesës së popujve përkatës».

Pastaj do të shtohet një nënpikë tjetër: nënpika «dh»:

«dh) të miratohen ligje të posaçme, që të sigurojnë përdorimin e gjuhës amtare në të gjitha organet shtetërore dhe në të gjitha institucionet që i shërbejnë popullsisë vendase dhe kombëtare, si dhe pakicave kombëtare; këto ligje të ndjekin dhe të ndëshkojnë me gjithë rreptësinë e tyre revolucionare të gjithë ata që shkelin të drejtat kombëtare dhe veçanërisht të drejtat e pakicave kombëtare».

Më në fund, do të shtohet nënpika «e»:

«e) të forcohet puna edukative në radhët e Ushtrisë së Kuqe, për të rrënjosur atje idetë e vëllazërimit dhe të solidarësisë ndërmjet popujve të Bash-

kimit; të merren masa praktike për të organizuar njësi ushtarake kombëtare, duke zbatuar të gjitha masat që janë të nevojshme për sigurimin e aftësisë së plotë mbrojtëse të republikave».

Këto janë të gjitha shtesat që u miratuan nga komisioni dhe kundër të cilave unë nuk kam asnjë vërejtje, sepse ato i bëjnë më konkrete tezat.

Për sa i përket pjesës së dytë të tezave, këtu nuk u bënë ndryshime të rëndësishme. U bënë disa propozime të vogla, të cilat komiteti, që u zgjodh nga komisioni i çështjes kombëtare, vendosi t'ia kalojë për shqyrtim KQ të ardhshëm.

Në këtë mënyrë, pjesa e dytë mbetet ashtu siç ishte në materialet e shtypura që u shpërndanë më parë.

*Veprat, bot. shqip, vëll. 5,
f. 230-267*

Nga vepra:

«**MBI BAZAT E LENINIZMIT**»

ÇËSHTJA KOMBËTARE

Nga kjo temë po marr dy çështje kryesore:

a) shtruarja e çështjes.

b) lëvizja çlirimtare e popujve të shtypur dhe revolucioni proletar.

1) *Shtruarja e çështjes.* Këta njëzet vjetët e fundit çështja kombëtare ka pësuar një sërë ndryshimesh tepër serioze. Çështja kombëtare në periudhën e Internacionales II dhe çështja kombëtare në periudhën e leninizmit nuk janë aspak e njëjta gjë. Ato ndryshojnë mjaft njëra me tjetrën jo vetëm nga gjerësia, por edhe nga karakteri i tyre i brendshëm.

Më parë çështja kombëtare zakonisht kufizohej brenda rrethit të ngushtë të çështjeve që kishin të bënin kryesisht me kombësitë «e qytetëruara». Irlandezët, hungarezët, polonezët, finlandezët, serbët dhe disa kombësi të tjera të Evropës — ky ishte rrethi i popujve pa të drejta të plota, për fatin e të cilëve interesoheshin kërret e Internacionales II. Popujt e Azisë dhe të Afrikës prej dhjetëra qindra milionë fry-

mësh që ndodheshin nën shtypjen kombëtare në formën më brutale dhe më të egër zakonisht liheshin pas dore. Nuk guxonin t'i vinin në një plan të bardhët me të zehtë, «të qytetëruarit» me «të paqytetëruarit». Dy-tri rezolucione majhoshe dhe pa asnjë kuptim, që e kalonin me kujdes në heshtje çështjen e çlirimit të kolonive — kjo ishte e gjithë ajo me të cilën mund të mburreshin njerëzit e Internacionales II. Tani ky dualizëm dhe ky qëndrim gjysmak në çështjen kombëtare duhet të quhen si të zhdukur. Leninizmi nxori në shesh këtë mospërputhje flagrante, e shkatërroi murin midis të bardhëve dhe të zezve, midis evropianëve dhe aziatikëve, midis sklllevërve «të qytetëruar» dhe «të paqytetëruar» të imperializmit, dhe e lidhi kështu çështjen kombëtare me çështjen e kolonive. Në këtë mënyrë çështja kombëtare nga një çështje e pjesshme dhe e brendshme e një shteti u bë një çështje e përgjithshme dhe ndërkombëtare, u bë çështja e përbotshme e çlirimit të popujve të shtypur të vendeve të varura dhe të kolonive nga zgjedha e imperializmit.

Më parë parimi i vetëvendosjes së kombeve zakonisht nuk interpretohej drejt, duke u kufizuar shpesh me të drejtën e kombeve për autonomi. Disa krerë të Internacionales II kishin shkuar madje aq larg, saqë të drejtën për vetëvendosje e kishin shndërruar në të drejtë për autonomi kulturore, d.m.th. në të drejtën e kombeve të shtypura për të pasur institucionet e veta kulturore, duke e lënë gjithë pushtetin politik në duart e kombit sundues. Si pasojë, ideja e vetëvendosjes ishte në rrezik të shndërrohej nga një armë lufte kundër aneksimeve në një vegël për të përlligjur aneksimet. Tani këtë pështjellim duhet ta quajmë si të zhdukur. Leninizmi e zgjeroi konceptin e vetëvendosjes, duke e interpretuar atë si të drejtë të popujve të shtypur të vendeve të varura dhe të kolonive për shkëputje të plotë, si të drejtë të kombe-

ve për të qenë shtete të pavarura. Në këtë mënyrë u përjashtua mundësia e përligjjes së aneksimeve me anën e interpretimit të së drejtës për vetëvendosje, si e drejtë për autonomi. Dhe vetë parimi i vetëvendosjes, në këtë mënyrë, nga një mjet për mashtrimin e masave, siç ishte pa dyshim në duart e socialshovinistëve në kohën e luftës imperialiste, u shndërrua në një mjet për të demaskuar të gjitha lakmitë imperialiste dhe makinacionet shoviniste, në një mjet për edukimin politik të masave në frymën e internacionalizmit.

Më parë çështja e kombeve të shtypura zakonisht quhej si një çështje thjesht juridike. Shpallja solemne e «barazisë kombëtare», deklaratat e panumërta për «barazinë e kombeve» — ja me se kënaqeshin partitë e Internacionales II, të cilat e mbulonin faktin se të flasësh për «barazinë e kombeve» në imperializëm; kur një grup kombesh (pakica) rron me shfrytëzimin e një grupi tjetër kombesh, do të thotë të tallësh me popujt e shtypur. Tani kjo pikëpamje juridike borgjeze në çështjen kombëtare duhet quajtur si e demaskuar. Nga lartësitë e deklaratave bombastike leninizmi e zbriti çështjen kombëtare në tokë, duke treguar se pa përkrahjen e drejtpërdrejtë të luftës çlirimtare të popujve të shtypur nga partitë proletare deklaratat për «barazinë e kombeve» janë deklarata boshe dhe hipokrite. Kështu çështja e kombeve të shtypura u bë çështja e përkrahjes, e ndihmës, e një ndihme të vërtetë dhe të vazhdueshme që u duhet dhënë kombeve të shtypura në luftën e tyre kundër imperializmit, për barazinë e vërtetë të kombeve, për ekzistencën e tyre si shtet i pavarur.

Më parë çështja kombëtare shtrohej në mënyrë reformiste, si një çështje më vete, e pavarur, e palidhur me çështjen e përgjithshme të pushtetit të kapitalit, me çështjen e përmbysjes së imperializmit dhe me atë të revolucionit proletar. Në heshtje mendohej se fitorja e proletariatit në Evropë kishte mun-

dësi të arrihej pa një aleancë të drejtpërdrejtë me lëvizjen çlirimtare të kolonive, se çështja kombëtare-koloniale mund të zgjidhet në heshtje, «vetvetiu», jashtë rrugës së madhe të revolucionit proletar, pa një luftë revolucionare kundër imperializmit. Tani kjo pikëpamje antirevolucionare duhet quajtur si e demaskuar. Leninizmi provoi, dhe lufta imperialiste e revolucionit në Rusi e vërtetuan, se çështja kombëtare mund të zgjidhet vetëm në lidhje me revolucionin proletar dhe mbi bazën e tij, se rruga e fitores së revolucionit në Perëndim kalon përmes aleancës revolucionare me lëvizjen çlirimtare të kolonive dhe të vendeve të varura kundër imperializmit. Çështja kombëtare është një pjesë e çështjes së përgjithshme të revolucionit proletar, një pjesë e çështjes së diktaturës së proletariatit.

Çështja shtrohet kështu: *a kanë shteruar apo jo mundësitë revolucionare që gjenden në gjirin e lëvizjes revolucionare çlirimtare të popujve të shtypur, dhe në qoftë se nuk kanë shteruar — a ka shpresë dhe arsye që këto mundësi të shfrytëzohen për revolucionin proletar, për t'i shndërruar vendet e varura dhe koloniale nga një rezervë e borgjezisë imperialiste në një rezervë të proletariatit revolucionar, në aleatë të këtij të fundit?*

Leninizmi i përgjigjet pozitivisht kësaj pyetjeje, d.m.th. pranon që në gjirin e lëvizjes nacionalçlirimtare të vendeve të shtypura ka aftësi revolucionare dhe se këto aftësi mund të shfrytëzohen për të përmbysur armikun e përbashkët, për të përmbysur imperializmin. Mekanizmi i zhvillimit të imperializmit, lufta imperialiste dhe revolucionit në Rusi i vërtetojnë plotësisht konkluzionet e leninizmit në këtë pikë.

Këtej rrjedh domosdoshmëria e përkrahjes, e një përkrahjeje të vendosur dhe aktive që duhet t'i japë proletariati i kombeve «sunduese» lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve të shtypur dhe të varur.

Sigurisht, kjo nuk do të thotë se proletariati duhet të përkrahë çfarëdo lëvizje kombëtare, kudo e kurdoherë, në të gjitha rastet e veçanta dhe konkrete. Është fjala për të përkrahur ato lëvizje kombëtare që synojnë në dobësimin, në përmbysjen e imperia- lizmit, dhe jo në forcimin e në ruajtjen e tij. Ka raste kur lëvizjet kombëtare të disa vendeve të shty- pura hyjnë në konflikt me interesat e zhvillimit të lëvizjes proletare. Vetvetiu kuptohet se në të tilla raste as që mund të bëhet fjalë për përkrahje. Çështja e të drejtave të kombeve nuk është një çështje më vete, por një pjesë e çështjes së përgjithshme të re- volucionit proletar, që i nënshtrohet së tërës dhe që duhet shqyrtuar nën prizmin e së tërës. Marksi në vjetët 1840-1850 ishte për lëvizjen kombëtare të po- lakëve dhe të hungarezëve, kundër lëvizjes kombëtare të çekëve dhe të sllavëve të Jugut. Pse? Sepse çekët dhe sllavët e Jugut atëherë ishin «popuj reaksionarë», «avanpostet ruse» në Evropë, avanpostet e absolutiz- mit, kurse polakët dhe hungarezët ishin «popuj revo- lucionarë», që luftonin kundër absolutizmit. Sepse të përkrahje lëvizjen kombëtare të çekëve dhe të sllavëve të Jugut në atë kohë donte të thoshte të përkrahje tërthorazi carizmin, armikun më të rrezikshëm të lëvizjes revolucionare në Evropë.

«Kërkesat e ndryshme të demokracisë, — thotë Lenini, — duke përfshirë edhe vetëvendosjen, nuk janë diçka absolute, por një pjesëz e lëvizjes së përgjithshme demokratike (sot: socialiste) botërore. Ka mundësi që në disa raste konkrete pjesëza të bjerë në kundërshtim me të përgjithshmen, atëherë ajo duhet të hidhet poshtë» (Veprat, bot. shqip, vëll. 22, f. 418).

Kështu qëndron puna me çështjen e lëvizjeve të ndryshme kombëtare dhe të karakterit reaksionar të mundshëm të këtyre lëvizjeve, në qoftë se, natyrisht, nuk i shohim ato nga pikëpamja formale, nga pikë-

pamja e të drejtave abstrakte, por konkretisht, nga pikëpamja e interesave të lëvizjes revolucionare.

E njëjta gjë duhet thënë për karakterin revolucionar të lëvizjeve kombëtare në përgjithësi. Karakteri pa dyshim revolucionar i shumicës dërrmuese të lëvizjeve kombëtare është po aq relativ dhe origjinal, sa ç'është relativ dhe origjinal karakteri reaksionar i mundshëm i disa lëvizjeve kombëtare të tjera. Karakteri revolucionar i lëvizjes kombëtare në kushtet e shtypjes imperialiste nuk supozon medoemos ekzistencën e elementeve proletare në lëvizje, ekzistencën e një programi revolucionar ose republikan të lëvizjes, ekzistencën e një baze demokratike të lëvizjes. Lufta e emirit të Afganistanit për pavarësinë e Afganistanit objektivisht është një luftë *revolucionare*, ndonëse pikëpamjet e emirit dhe të përkrahësve të tij janë monarkiste, sepse ajo dobëson, prish dhe shkallmon imperializmin, kurse lufta e demokratëve «të dëshpëruar» dhe e «socialistëve», e «revolucionarëve» dhe e republikanëve të tillë si, të themi, Kerenski dhe Cereveli. Renodeli dhe Shejdemani, Çernovi dhe Dani, Hendersoni dhe Klainsi, gjatë luftës imperialiste ka qenë një luftë *reaktionare*, pse ajo pati si rrjedhojë zbulimin, forcimin dhe fitoren e imperializmit. Lufta e tregtarëve të Egjiptit dhe e intelektualëve borgjezë për pavarësinë e Egjiptit, për të njëjtat arsye, objektivisht është një luftë *revolucionare*, ndonëse krerët e lëvizjes kombëtare të Egjiptit janë borgjezë nga origjina dhe nga gjendja shoqërore, ndonëse ata janë kundër socializmit, kurse lufta e qeverisë «punëtore» angleze për të mbajtur Egjiptin në gjendje varësie është, për të njëjtat arsye, një luftë *reaktionare*, ndonëse anëtarët e kësaj qeverie janë proletarë nga origjina, dhe nga gjendja shoqërore, ndonëse ata janë «për» socializmin. Nuk po flas këtu për lëvizjen kombëtare të vendeve të tjera, më të mëdha, koloniale dhe të varura, si India dhe Kina, çdo hap i të

cilave në rrugën e çlirimit, edhe në rast se ai shkel kërkesat e demokracisë formale, është një goditje e rëndë kundër imperializmit, d.m.th. një hap, pa dyshim, *revolucionar*.

Lenini ka të drejtë kur thotë se lëvizja kombëtare e vendeve të shtypura duhet çmuar jo nga pikëpamja e demokracisë formale, por nga pikëpamja e rezultateve reale në balancën e përgjithshme të luftës kundër imperializmit, d.m.th. «në shkallë botërore e jo në mënyrë të veçuar» (Veprat, bot. shqip, vëll. 22, f. 417).

2) *Lëvizja çlirimtare e popujve të shtypur dhe revolucioni proletar*. Në zgjidhjen e çështjes kombëtare leninizmi nisat nga këto teza:

a) bota është ndarë në dy kampe: në kampin e një grushti të vogël kombesh të qytetëruara, që zotërojnë kapitalin financiar dhe shfrytëzojnë shumicën dërrmuese të popullsisë së rruzullit tokësor, dhe në kampin e popujve të shtypur e të shfrytëzuar të kolonive dhe të vendeve të varura, që përbëjnë këtë shumicë;

b) kolonitë dhe vendet e varura, të shtypura dhe të shfrytëzuara nga kapitali financiar, përbëjnë një rezervë shumë të madhe dhe një burim shumë të rëndësishëm forcash për imperializmin;

c) lufta revolucionare e popujve të shtypur të vendeve të varura dhe koloniale kundër imperializmit është e vetmia rrugë për çlirimin e tyre nga shtypja dhe shfrytëzimi;

ç) vendet më të rëndësishme koloniale dhe të varura tani kanë marrë rrugën e lëvizjes nacionalçlirimtare, e cila nuk mund të mos shpjerë në krizën e kapitalizmit botëror;

d) interesat e lëvizjes proletare në vendet e zhvilluara dhe të lëvizjes nacionalçlirimtare në kolonitë kërkojnë bashkimin e këtyre dy aspekteve të lëvizjes revolucionare në një front të përbashkët kundër armikut të përbashkët, kundër imperializmit;

dh) fitorja e klasës punëtore në vendet e zhvilluara dhe çlirimi i popujve të shtypur nga zgjedha e imperializmit janë të pamundshme pa formimin dhe forcimin e një fronti revolucionar të përbashkët;

e) formimi i një fronti revolucionar të përbashkët është i pamundshëm, në qoftë se proletariati i kombeve shtypëse nuk përkrah drejtpërdrejt dhe në mënyrë të vendosur lëvizjen çlirimtare të popujve të shtypur kundër imperializmit të «atdheut» të vet, sepse «nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë» (*Engels*);

ë) kjo përkrahje do të thotë të ruash, të mbrosh, të vësh në jetë parullën: e drejta e kombeve për t'u shkëputur dhe për të ekzistuar si shtet i pavarur;

f) pa vënien në jetë të kësaj parulle nuk mund të organizohet bashkimi dhe bashkëpunimi i kombeve në një ekonomi të vetme botërore, që përbën bazën materiale të fitores së socializmit botëror;

g) ky bashkim nuk mund të jetë veçse një bashkim vullnetar i lindur mbi bazën e mirëbesimit reciprok dhe të marrëdhënieve vëllazërore të popujve.

Së këtejmi dalin dy aspekte, dy tendënca në çështjen kombëtare: tendenca për çlirimin politik nga zinxhirët e imperializmit dhe për formimin e një shteti kombëtar të pavarur, e lindur mbi bazën e shtypjes imperialiste dhe të shfrytëzimit kolonial, dhe tendenca për afrimin ekonomik të kombeve, e lindur nga formimi i tregut botëror dhe të ekonomisë botërore.

«Kapitalizmi në zhvillim e sipër — thotë Lenini — njeh dy tendenca historike në çështjen kombëtare. E para: zgjimi i jetës kombëtare dhe i lëvizjeve kombëtare, lufta kundër çdo shtypjeje kombëtare, krijimi i shteteve kombëtare. E dyta: zhvillimi dhe dendësimi i marrëdhënieve të çdo lloji midis kombeve, heqja e ndarjeve të vjetra kombëtare, krijimi i unitetit ndërkombëtar të kapitalit, të jetës ekonomike në përgjithësi, të politikës, të shkencës etj.

Të dyja këto tendenca janë një ligj botëror i kapitalizmit. E para mbizotëron në fillim të zhvillimit të tij, e dyta karakterizon kapitalizmin e pjekur që është vënë në rrugën e shndërrimit të tij në shoqëri socialiste» (Veprat, bot. shqip, vëll. 20, f. 13).

Për imperializmin këto dy tendenca janë kontradikta të papajtueshme, sepse imperializmi nuk mund të rrojë pa i shfrytëzuar, pa i mbajtur me forcë kolonitë brenda kuadrit të një «të tërë të vetme», sepse imperializmi nuk mund t'i afrojë kombet ndryshe veçse me anën e aneksimeve dhe të pushtimeve koloniale, pa të cilat ai, përgjithësisht, nuk mund të kuptohet.

Për komunizmin, përkundrazi, këto dy tendenca janë vetëm dy anë të së njëjtës çështje, të çështjes së çlirimit të popujve të shtypur nga zgjedha e imperializmit, sepse komunizmi e di se bashkimi i popujve në një ekonomi të vetme botërore është i mundur vetëm mbi bazën e mirëbesimit reciprok dhe të një marrëveshjeje vullnetare, se rruga e formimit të një bashkimi vullnetar popujsh kalon përmes shkëputjes së kolonive nga «e tëra e vetme» imperialiste, përmes shndërrimit të tyre në shtete të pavarura.

Së këtejmi del nevoja e një lufte të ashpër, të paprerë, të vendosur, kundër shovinizmit prej fuqie të madhe të «socialistëve» të kombeve sunduese (Angli, Francë, Amerikë, Itali, Japoni etj.), që nuk duan të luftojnë kundër qeverive të tyre imperialiste, që nuk duan të përkrahin luftën e popujve të shtypur të kolonive «të tyre», për çlirimin nga zgjedha, për shkëputjen e tyre si shtet.

Pa një luftë të tillë nuk mund të mendohet edukimi i klasës punëtore të kombeve sunduese në frymën e internacionalizmit të vërtetë, në frymën e afrimit me masat punonjëse të vendeve të varura dhe të kolonive, në frymën e përgatitjes së vërtetë

të revolucionit proletar. Revolucionin në Rusi nuk do të kishte fituar dhe Kolçaku me Denikinin nuk do të ishin mundur, sikur proletariati rus të mos kishte gëzuar simpatinë dhe përkrahjen e popujve të shtypur të ish-Perandorisë ruse. Por për të fituar simpatinë dhe përkrahjen e këtyre popujve, ai duhej para së gjithash të këpuste zinxhirët e imperializmit rus dhe t'i çlironte këta popuj nga shtypja kombëtare.

Pa këtë do të kishte qenë e pamundur të konsolidohej pushteti sovjetik, të rrënohej internacionalizmi i vërtetë dhe të krijoheshin ajo organizatë e mrekullueshme bashkëpunimi popujsh që quhet Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike dhe që është një model i gjallë i bashkimit të ardhshëm të popujve në një ekonomi botërore të vetme.

Së këtëjmi del nevoja e luftës kundër tendencës për t'u mbyllur brenda kuadrit kombëtar, kundër frymës së ngushtë kombëtare dhe kundër tendencës për t'u veçuar të socialistëve të vendeve të shtypura që nuk dëshirojnë të ngjiten më lart këmbanarës së tyre kombëtare dhe nuk e kuptojnë lidhjen e lëvizjes çlirimtare të vendit të tyre me lëvizjen proletare të vendeve sunduese.

Pa një luftë të tillë nuk mund të mbrohet politika e pavarur e proletariatit të kombeve të shtypura dhe solidarësia e tij si klasë me proletariatin e vendeve sunduese në luftën për përmbysjen e armikut të përbashkët, në luftën për përmbysjen e imperializmit.

Pa një luftë të tillë internacionalizmi do të ishte i pamundshëm.

Kjo është rruga që duhet ndjekur për edukimin e masave punonjëse të kombeve sunduese dhe të shtypura në frymën e internacionalizmit revolucionar.

Ja se ç'thotë Lenini për këtë punë të dyanshme të komunizmit lidhur me edukimin e punëtorëve në frymën e internacionalizmit:

«A mund të jetë ky edukim... konkretisht i njëlojtë në kombet e mëdha dhe shtypëse dhe në kombet e vogla, të shtypura? në kombet aneksuese dhe në kombet e aneksuara?

Sigurisht, jo. Rruga drejt një qëllimi të vetëm: drejt barazisë së plotë, afrimit sa më të ngushtë dhe *shkrirjes* së mëtejshme të të gjitha kombeve, me sa duket, këtu ndjek rrugë konkrete të ndryshme, — po ashtu sikundër për të arritur në një pikë, e cila ndodhet në mes të një faqeje, rru--ga kalon nga e majta, po të nisemi nga njëra anë e faqes, ose nga e djathta, po të nisemi nga ana e kundërt e faqes. Në qoftë se socialdemokrati i një kombi të madh, shtypës, aneksues, duke propaganduar në përgjithësi shkrirjen e kombeve do të harrojë qoftë edhe për një çast se Nikollai II «i tij», Vilhelmi «i tij», George, Puankareja etj. janë edhe ata për shkrirjen me kombet e vogla (me anë të aneksimeve) — Nikollai II për «shkrirjen» me Galicinë, Vilhelmi II për shkrirjen me Belgjikën etj. — ky socialdemokrat do të jetë një doktrinar qesharak në teori, një përkrahës i imperializmit në praktikë.

Pika qendrore e edukimit internacionalist të punëtorëve në vendet shtypëse duhet patjetër të jetë propaganda dhe mbrojtja prej tyre e lirisë së shkëputjes së kombeve të shtypura. Pa këtë nuk ka internacionalizëm. Ne kemi të drejtë dhe duhet ta trajtojmë çdo socialdemokrat të një kombi shtypës, i cili nuk e bën këtë propagandë, si imperialist dhe si maskara. Kjo është një kërkesë e domosdoshme, edhe në qoftë se rasti i shkëputjes është i mundshëm dhe «i realizueshëm» para socializmit vetëm i në 1 000 raste...

Përkundrazi. Socialdemokrati i një kombi të vogël agjitacionin e vet duhet ta përqendrojë te fjala e parë e formulës sonë të përgjithshme: «bashkim vullnetar» i kombeve. Pa i shkelur detyrat e veta si internacionalist, ai mund të jetë edhe për pavarësinë politike të kombit të vet, edhe për përfshirjen e tij në shtetin fqinjë X, Y, Z etj. Por në çdo rast ai duhet të luftojë kundër frymës së ngushtë të kombit të vogël, kundër tendencës për t'u izoluar dhe për t'u veçuar, duhet të luftojë që të merret parasysh e tëra dhe e për-

gjithshmja, që t'u nënshtrohen interesat e veçanta interesave të përgjithshme.

Atyre që nuk e thellojnë këtë gështje u dukat «kontra-diktore» që socialdemokratët e kombeve shtypëse të ngulin këmbë për «lirinë e shkëputjes», kurse socialdemokratët e kombeve të shtypura — për «lirinë e bashkimit». Por po të mendohen pak ata do të shohin se tjetër rrugë drejt internacionalizmit dhe shkrirjes së kombeve, tjetër rrugë drejt këtij qëllimi duke u nisur nga gjendja e dhënë nuk ka dhe nuk mund të ketë (Veprat, bot. shqip, vëll. 22, f. 423-424, 425).

Botuar në «Pravda» prill
dhe maj 1924

Veprat, bot. shqip, vëll 6,
f. 141-153

RRETH ÇËSHTJES KOMBËTARE NË JUGOSLLAVI

*Fjalim i mbajtur në komisionin jugosllav të KEIK
30 mars 1925*

Shokë! Jam i mendimit se Semiçi nuk e ka plotësisht të qartë thelbin kryesor të shtruarjes së çështjes kombëtare nga bolshevikët. Bolshevikët asnjëherë nuk e kanë shkëptur çështjen kombëtare nga çështja e përgjithshme e revolucionit, as përpara Tetorit as pas Tetorit. Thelbi kryesor i trajtimit bolshevik të çështjes kombëtare është se bolshevikët çështjen kombëtare e kanë parë kurdoherë në lidhje të ngushtë me perspektivën revolucionare.

Semiçi citoi Leninin, duke thënë se Lenini ishte për vendosjen në kushtetutë të një zgjidhjeje të caktuar të çështjes kombëtare. Me këtë ai, Semiçi, si duket, dëshoi të thoshte se gjoja Lenini e quante çështjen kombëtare si një çështje konstitucionale, d.m.th. jo si një çështje të revolucionit, por si një çështje reforme. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Lenini kurrë nuk vuante dhe nuk mund të vuante nga iluzione konstitucionale. Mjafton t'u hidhet një sy veprave të tij për t'u bindur për këtë gjë. Në qoftë se Lenini fliste për kushtetutën, ai kishte parasysh jo rrugën

konstitucionale të zgjidhjes së çështjes kombëtare, por rrugën revolucionare, d.m.th. ai e shikonte kushtetutën si një rrjedhojë të fitores së revolucionit. Edhe në BRSS kemi një kushtetutë, dhe ajo pasqyron një zgjidhje të caktuar të çështjes kombëtare. Por kjo kushtetutë doli në dritë jo si rrjedhojë e marrëveshjes me borgjezinë, por si rrjedhojë e revolucionit ngadhënjimtar.

Më tutje, Semiçi i referohet broshurës së njohur të Stalinit për çështjen kombëtare, broshurë e shkruar më 1912, duke u përpjekur të gjejë atje të paktën një vërtetim të tërthortë për të provuar se ka të drejtë. Por ky referim nuk pati rezultat, sepse ai nuk gjeti dhe nuk mund të gjente jo vetëm citate, por as ndonjë aluzion të largët që të përligjte pak a shumë trajtimin «konstitucional» të çështjes kombëtare. Për të vërtetuar këtë unë do të mund t'i përmendja Semiçit një pjesë të njohur nga broshura e Stalinit, ku mënyra austriake e zgjidhjes së çështjes kombëtare (mënyra konstitucionale) vihet përballë mënyrës së marksistëve rusë (mënyrës revolucionare).

Ja ajo:

«Austriakët mendojnë ta realizojnë «lirinë e kombësive» me anën e reformave të vogla, me një hap të ngadalshëm. Duke propozuar autonominë kulturore-kombëtare, si një masë praktike, ata nuk mendojnë aspak për një ndryshim rrënjësor, për një lëvizje demokratike çlirimtare, e cila nuk ekziston për ta në perspektivë. Ndërsa marksistët rusë e lidhin çështjen e «lirisë së kombësive» me një ndryshim të mundshëm rrënjësor, me lëvizjen demokratike çlirimtare, pa i varur shpresat te reformat. Dhe kjo gjë e ndryshon punën në thelb për sa i përket fatit të ardhshëm të kombeve në Rusi».

Më duket se është e qartë.

Dhe kjo nuk është pikëpamje vetëm e Stalinit, por pikëpamja e të gjithë marksistëve rusë, të cilët e

kanë parë dhe e shohin çështjen kombëtare në lidhje të ngushtë me çështjen e përgjithshme të revolucionit.

Mund të themi fare lehtë se shtruarja e çështjes kombëtare në historinë e marksizmit rus ka pasur dy faza: fazën e parë, d.m.th. fazën përpara Tetorit, dhe fazën e dytë, d.m.th. fazën e Tetorit. Në fazën e parë çështja kombëtare shikohej si një pjesë e çështjes së përgjithshme të revolucionit demokratiko-borgjez, d.m.th. si një pjesë e çështjes së diktaturës së proletariatit dhe të fshatarësisë. Në fazën e dytë, kur çështja kombëtare u zgjerua dhe u bë çështje e kolonive, kur çështja kombëtare u shndërrua nga çështje e brendshme e një shteti në një çështje botërore, — çështja kombëtare tani filloi të shikohej si një pjesë e çështjes së përgjithshme të revolucionit proletar, si një pjesë e çështjes së diktaturës së proletariatit. Si atje edhe këtu trajtimi i kësaj çështjeje, siç e shihni, ka qenë një trajtim krejt revolucionar.

Unë mendoj se Semiçi nuk i ka ende plotësisht të qarta të gjitha këto gjëra. Këtu e kanë burimin orvatjet e tij për ta zbritur çështjen kombëtare në terrenin konstitucional, d.m.th. për ta parë atë si një çështje reforme.

Nga ky gabim rrjedh gabimi tjetër i tij, ai nuk do që ta shohë çështjen kombëtare si një çështje në thelb fshatare. Jo agrare, por fshatare, sepse këto janë dy gjëra të ndryshme. Është shumë e vërtetë se çështja kombëtare nuk duhet identifikuar me çështjen fshatare, sepse, përveç çështjeve fshatare, çështja kombëtare përfshin në vetvete edhe çështjen e kulturës kombëtare, të shtetit kombëtar etj. Po s'ka dyshim gjithashtu se bazën e çështjes kombëtare, thelbin e saj të brendshëm, megjithatë, e përbën çështja fshatare. Pikërisht kështu shpjegohet pse fshatarësia përfaqëson armatën kryesore të lëvizjes kombëtare, që pa armatën fshatare s'ka dhe s'mund të ketë një lëvizje të fuqishme kombëtare. Pikërisht këtë kemi parasysh

kur themi se çështja kombëtare është në thelb çështje fshatare. Unë mendoj se në mosdashjen e Semiçit për ta pranuar këtë formulë fshihet nënvleftësimi i fuqisë së brendshme të lëvizjes kombëtare dhe moskuptimi i karakterit thellësisht popullor dhe thellësisht revolucionar të lëvizjes kombëtare. Ky moskuptim dhe ky nënvleftësim paraqesin një rrezik të madh, sepse në praktikë ata tregojnë nënvleftësimin e fuqisë së brendshme potenciale, që fshihet, të themi, në lëvizjen e kroatëve për lirinë kombëtare, nënvleftësim i mbushur plot ndërlikime serioze për gjithë partinë komuniste jugosllave.

Ky është gabimi i dytë i Semiçit.

Pa dyshim e gabuar duhet quajtur, gjithashtu, orvatja e Semiçit për ta trajtuar çështjen kombëtare në Jugosllavi të shkëputur nga gjendja ndërkombëtare dhe nga perspektivat që mund të ketë Evropa. Semiçi, duke u nisur nga fakti që në çastin e tanishëm nuk ka një lëvizje popullore serioze për pavarësi ndër kroatët dhe sllovenët, arrin në përfundimin se çështja e së drejtës së kombeve për t'u shkëputur është një çështje akademike dhe, sidoqoftë, jo aktuale. Natyrisht, kjo nuk është e vërtetë. Edhe sikur të pranojmë se kjo çështje në çastin e tanishëm nuk është një çështje aktuale, ajo mund të bëhet plotësisht aktuale *po të fillojë lufta ose kur të fillojë lufta, po të shpërthejë revolucioni në Evropë ose kur ai të shpërthejë*. Por që lufta do të fillojë patjetër dhe që ata atje patjetër do të përleshën, për këtë nuk mund të ketë dyshim, po të kemi parasysh natyrën dhe zhvillimin e imperializmit.

Më 1912, kur ne, marksistët rusë, përpiluum projektin e parë të programit kombëtar, ne nuk kishim në asnjë krahinë të Perandorisë së Rusisë një lëvizje serioze për pavarësi. Por ne e quajtëm të nevojshme që në programin tonë të përfshihej pika për të drejtën e kombeve për vetëvendosje, d.m.th. për të drejtën e çdo kombësie për t'u shkëputur dhe për të ek-

zistuar si shtet i pavarur. Pse? Sepse ne niveshim jo vetëm nga çka kishim përpara në atë kohë, por edhe nga çka po zhvillohej dhe po avitej në sistemin e përgjithshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, d.m.th. në atë kohë ne merrnim parasysh jo vetëm të tashmen, por edhe të ardhmen. Dhe ne e dinim se në rast se ndonjë kombësi do të kërkonte të shkëputej, marksistët rusë do të luftonin që e drejta e shkëputjes t'i garantohej çdo kombësie të tillë. Semçi në fjalimin e tij shumë herë i referua broshurës së Stalinit për çështjen kombëtare. Por ja çfarë thuhet në këtë broshurë të Stalinit në lidhje me vetëvendosjen dhe pavarësinë:

«Rritja e imperializmit në Evropë nuk është një gjë e rastit. Evropa nuk e nxë më kapitalin, prandaj ai vërsulet në vende të tjera, duke kërkuar tregje të reja, krahë pune me çmim të lirë, fusha të reja aktiviteti. Por kjo të çon në ndërlikime të jashtme, në luftë... Është plotësisht i mundshëm një kombinim i tillë rrethanash të brendshme dhe të jashtme, në të cilin kjo apo ajo kombësi e Rosisë ta quajë të nevojshme të shtrojë dhe të zgjidhë çështjen e pavarësisë së saj. Dhe, sigurisht, në kësi rastesh nuk u takon marksistëve të nxjerrin pengesa».

Kjo është shkruar qysh më 1912. Ju e dini se kjo tezë u vërtetua plotësisht më vonë, si gjatë luftës, ashtu edhe pas luftës, sidomos pas fitores së diktaturës së proletariatit në Rusi.

Aq më tepër duhet të merren parasysh të tilla mundësi në Evropë përgjithësisht dhe veçanërisht në Jugosllavi, sidomos tani, pas thellimit të lëvizjes nacionale revolucionare në vendet e shtypura dhe pas fitores së revolucionit në Rusi. Duhet pasur gjithashtu parasysh fakti se Jugosllavia nuk është një vend krejt i pavarur, se ajo është e lidhur me grupe të caktuara imperialiste, dhe se, si rrjedhim, ajo nuk mund të largohet nga ajo lojë e madhe forcash që zhvillohet jash-

të Jugosllavisë. Në qoftë se ju hartoni programin kombëtar për partinë jugosllave, — dhe në rastin tonë bëhet fjalë pikërisht për këtë, — atëherë duhet të keni parasysh se programi nuk duhet të nisët vetëm nga çka ekziston në çastin e tanishëm, por edhe nga çka po zhvillohet dhe do të ngjasë patjetër, si pasojë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ja pse unë mendoj se çështja e së drejtës së kombeve për vetëvendosje duhet quajtur si një çështje aktuale dhe e ngutshme.

Tani për programin kombëtar. Pikënisja e programit kombëtar duhet të jetë teza për revolucionin sovjetik në Jugosllavi, teza që thotë se pa përmbysjen e borgjezisë dhe pa fitoren e revolucionit çështja kombëtare nuk mund të zgjidhet në një mënyrë pak a shumë të kënaqshme. Sigurisht, mund të ketë edhe përjashtime. Një përjashtim i tillë është bërë, për shembull, para luftës, me rastin e shkëputjes së Norvegjisë nga Suedia, për të cilin flet me hollësi Lenini në një nga artikujt e tij*. Por kjo pati ndodhur para luftës dhe në rrethana jashtëzakonisht të favorshme. Pas luftës, dhe sidomos pas fitores së revolucionit sovjetik në Rusi, zor që të jenë të mundshme raste të tilla. Sidoqoftë, shanset për mundësi të tilla tani janë aq të pakta, saqë mund të barazohen me zero. Por nëse është kështu, atëherë është e qartë se ne nuk mund ta hartojmë programin mbi madhësi me vlerë zero. Ja pse teza për revolucionin duhet të jetë pikënisja e programit kombëtar.

Më tutje në programin kombëtar duhet të futet medoemos pika e posaçme mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje deri në shkëputjen e tyre si shtet. Fola më sipër se për ç'arsye nuk mund të bëhet pa këtë pikë në kushtet e sotme të brendshme dhe ndërkombëtare.

Më në fund, në programin duhet të jetë gjithashtu pika e posaçme mbi autonominë kombëtare te-

* Shih këtë përmbledhje, f. 114-186. *Red. Përkth.*

rritoriale për ato kombësi të Jugosllavisë, të cilat nuk e quajnë të nevojshme të shkëputen nga Jugosllavia. Nuk kanë të drejtë ata që mendojnë se duhet përfshirë një kombinim i tillë. Kjo nuk është e drejtë. Në kushte të caktuara, në rast fitoreje të revolucionit sovjetik në Jugosllavi, ka plotësisht mundësi që disa kombësi të mos duan të shkëputen, ashtu sikurse ndodhi ndër ne në Rusi. Kuptohet se për një rast të tillë në program duhet të ketë patjetër një pikë mbi autonominë, duke pasur parasysh transformimin e shtetit jugosllav në një federatë shtetesh autonome kombëtare mbi bazën e sistemit sovjetik.

Pra, duhet të njihet e drejta e shkëputjes për ato kombësi që do të dëshirojnë të shkëputen, dhe e drejta e autonomisë për ato kombësi që do të dëshirojnë të mbeten në kuadrin e shtetit jugosllav.

Për t'iu shmangur keqkuptimeve jam i detyruar të them se e drejta e shkëputjes nuk duhet kuptuar si një gjë e detyrueshme, si një detyrë për t'u shkëputur. Kombi mund ta përdorë këtë të drejtë duke u shkëputur, por mund edhe të mos e përdorë atë, dhe në qoftë se ai nuk e përdor, — kjo është punë për të, dhe kjo nuk mund të mos merret parasysh. Disa shokë të drejtën e shkëputjes e shndërrojnë në një detyrë, duke kërkuar, për shembull, prej kroatëve shkëputjen me çdo kusht. Ky është një qëndrim i gabuar, prandaj duhet hedhur poshtë. Nuk duhet ngatërruar e drejta me detyrën.

Veprat, bot. shqip, vëll. 7,
f. 69-76

Nga fjalimi:

**«PËR DETYRAT POLITIKE TË UNIVERSITETIT
TË POPUJVE TË LINDJES»**

18 maj 1925

Fola për ngritjen e kulturës kombëtare në republikat sovjetike të Lindjes. Po ç'është kultura kombëtare? Si mund të pajtohet ajo me kulturën proletare? A nuk ka thënë Lenini, qysh para luftës, se ne kemi dy kultura — kulturën borgjeze dhe kulturën socialiste, se parulla e kulturës kombëtare është një parullë reaksionare e borgjezisë, që përpiqet të prishë ndërgjegjen e punonjësve me helmin e nacionalizmit? Si mund të pajtohet ndërtimi i kulturës kombëtare, zhvillimi i shkollave dhe kurseve në gjuhë amtare dhe përgatitja e kuadrove vendas me ndërtimin e socializmit, me ndërtimin e kulturës proletare? Mos ka këtu ndonjë kontradiktë të pakapërcyeshme? Sigurisht, jo! Ne ndërtojmë kulturën proletare. Kjo është fare e vërtetë. Por është gjithashtu e vërtetë se kultura proletare, socialiste nga përmbajtja e vet, merr forma dhe mënyra të ndryshme shprehjeje në popujt

e ndryshëm, që marrin pjesë në ndërtimin socialist, sipas gjuhës, mënyrës së jetesës etj. Proletare nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma, — kjo është ajo kulturë e përgjithshme njerëzore, drejt së cilës ecën socializmi. Kultura proletare nuk e zhduk kulturën kombëtare, por i jep asaj përmbajtjen. Dhe anasjelltas, kultura kombëtare nuk e zhduk kulturën proletare, por i jep asaj formën. Parulla e kulturës kombëtare ka qenë një parullë borgjeze, përderisa në fuqi ndodhej borgjezia dhe përderisa konsolidimi i kombeve bëhej nën udhëheqjen e regjimit borgjez. Parulla e kulturës kombëtare u bë një parullë proletare kur erdhi në fuqi proletariati dhe konsolidimi i kombeve filloi të bëhej nën udhëheqjen, e Pushtetit Sovjetik. Kush nuk e ka kuptuar këtë ndryshim parimor ndërmjet këtyre dy situatave të ndryshme, ai nuk do të kuptojë kurrë as leninizmin as thelbin e çështjes kombëtare.

Llomotiti (për shembull, Kautski) se në periudhën e socializmit do të krijohet një gjuhë e vetme për gjithë njerëzimin dhe se të gjitha gjuhët e tjera do të zhduken. Unë pak i besoj teorisë së një gjuhe të vetme për të gjithë. Sidoqoftë, përvoja flet jo në favor, por kundër kësaj teorie. Deri më sot ka ngjarë kështu: revolucioni socialist nuk e ka pakësuar numrin e gjuhëve, por e ka shtuar, sepse ai, duke shkundur shtresat më të ulëta të njerëzimit dhe duke i nxjerrë ato në skenën politike, fut në një jetë të re një varg të tërë kombësish të reja, që më parë nuk njiheshin ose njiheshin pak. Kujt i shkonte ndër mend se Rusia e vjetër cariste ka jo më pak se 50 kombe dhe grupe kombëtare? Megjithatë, revolucioni i Tetorit, pasi këputi zinxhirët e vjetër dhe nxori në skenë një varg të tërë popujsh dhe kombësish të prapambetura, u dha atyre një jetë të re dhe një zhvillim të ri. Sot për Indinë flasim si për një të tërë të vetme. Po s'ka dyshim se kur në Indi të shpërthejë revolucioni, në skenë kanë për të dalë me dhjetëra kombësi të pa-

njohura më parë, të cilat kanë gjuhën e tyre të veçantë dhe kulturën e tyre të veçantë. Dhe sa për përvetësimin e kulturës proletare nga kombësitë e ndryshme, s'ka dyshim se ky përvetësim do të bëhet në format që përputhen me gjuhën dhe me mënyrën e jetesës së këtyre kombësive.

Pak kohë më parë mora një letër nga disa shokë burjatas, të cilët më luteshin t'u sqaroja çështjet serioze dhe të vështira të raporteve midis kulturës së përgjithshme njerëzore dhe kulturës kombëtare. Ja letra:

«Ju lutem shumë të na sqaroni çështjet e mëposhtme, të cilat për ne paraqiten tepër të vështira dhe kanë rëndësi të madhe. Qëllimi i fundit i partisë komuniste është kultura unike për të gjithë njerëzimin. Në ç'mënyrë mendohet kalimi nëpërmjet kulturave kombëtare, që zhvillohen brenda kufijve të republikave tona të veçania autonome, në kulturën unike të të gjithë njerëzimit? Si duhet të bëhet asimilimi i veçorive të kulturave të ndryshme kombëtare (gjuha etj.)?».

Mendoj se ato që thashë më sipër do të mund të shërbenin si përgjigje për pyetjen alarmuese të shokëve burjatas.

Shokët burjatas ngrenë çështjen e asimilimit të kombësive të veçanta gjatë ndërtimit të kulturës proletare të të gjithë njerëzimit. S'ka dyshim se disa kombësi mund t'i nënshtrohen dhe, me sa duket, do t'i nënshtrohen me siguri procesit të asimilimit. Procesi të tilla ka pasur edhe më parë. Por puna është se procesi i asimilimit të disa kombësive nuk e përjashton, por e parakupton procesin e kundërt të forcimit dhe të zhvillimit të një vargu të tërë kombesh të gjalla dhe që zhvillohen, sepse procesi i pjesshëm i asimilimit të disa kombësive është rrjedhojë e procesit të përgjithshëm të zhvillimit të kombeve. Pikërisht për këtë arsye asimilimi i mundshëm i disa kombësive të veçanta nuk e dobëson, por e vërteton tezën fare

të drejtë që thotë se kultura proletare e gjithë njerëzimit nuk e përjashton, por e parakupton dhe e ushqen kulturën kombëtare të popujve, po ashtu sikurse kultura kombëtare e popujve nuk e zhduk, por e plotëson dhe e pasuron kulturën proletare të të gjithë njerëzimit.

*Veprat, bot. shqip, vëll. 7
f. 140-142*

Nga artikulli:

«KARAKTERI NDËRKOMBËTAR I REVOLUCIONIT TË TETORIT»

Revolucioni i Tetorit e tronditi imperializmin jo vetëm në qendrat e sundimit të tij, jo vetëm në «metropolet». Ai e goditi imperializmin edhe në prapavijat, në periferinë e tij, duke mënauar sundimin e imperializmit në vendet koloniale dhe të varura.

Pasi përmbysi çifligarët dhe kapitalistët, Revolucioni i Tetorit këputi vargonjtë e zgjedhës nacional-koloniale dhe çliroi prej saj pa përjashtim të gjithë popujt e shtypur të një shteti të madh. Proletariati nuk mund ta çlirojë veten pa çliruar popujt e shtypur. Tipar karakteristik i Revolucionit të Tetorit është se ai i bëri këto revolucione nacionalkoloniale në BRSS jo nën flamurin e armiqësisë kombëtare dhe të përleshjeve ndërkombëtare, por nën flamurin e mirëbesimit dhe të afrimit vëllazëror të punëtorëve dhe të fshatarëve të popujve të BRSS-së, jo në emër të *nacionalizmit*, por në emër të *internacionalizmit*.

Pikërisht sepse revolucionet nacionalkoloniale ndër ne u bënë nën udhëheqjen e proletariatit dhe nën fla-

murin e internacionalizmit, pikërisht për këtë arsye popujt-rajà, popujt-skillever, për herë të parë në historinë e njerëzimit, u ngritën e u bënë popuj me të vërtetë të lirë dhe me të vërtetë të barabartë, duke frymëzuar me shembullin e vet popujt e shtypur të mbarë botës.

Kjo do të thotë se Revolucioni i Tetorit hapi një epokë të re, epokën e revolucioneve koloniale që bëhen në vendet e shtypura të botës në aleancë me proletariatin, nën udhëheqjen e proletariatit.

Më parë «ishte zakon» të mendohej se bota gjithmonë është ndarë në raca të ulëta dhe të larta, në të zinj dhe të bardhë, nga të cilët të parët janë të paafte për qytetërim dhe janë të dënuar të jenë objekt shfrytëzimi, kurse të dytët janë të vetmit bartës të qytetërimit, të zgjedhur nga fati për të shfrytëzuar të parët.

Tani kjo legjendë duhet quajtur si e dërrmuar dhe e hedhur poshtë. Një nga rrjedhojat më të rëndësishme të Revolucionit të Tetorit është se ai e goditi për vdekje këtë legjendë, duke provuar me vepra se popujt e çliruar joevropianë, që u vunë në rrugën e zhvillimit sovjetik, janë të aftë ta çojnë përpara kulturën me të vërtetë përparimtare dhe qytetërimin me të vërtetë përparimtar jo më pak se popujt evropianë.

Më parë «ishte zakon» të mendohej se e vetmja mënyrë për çlirimin e popujve të shtypur është metoda e nacionalizmit borgjez, metoda e shkëputjes së kombeve nga njëri-tjetri, metoda e përçarjes së tyre, metoda e shtimit të armiqësisë ndërmjet kombeve, ndër masat punonjëse të kombeve të ndryshme.

Tani kjo legjendë duhet quajtur si e përgënjeshtruar. Një nga rrjedhojat më të rëndësishme të Revolucionit të Tetorit është se ai e goditi për vdekje këtë legjendë, duke provuar me vepra mundësinë dhe dobinë e metodës proletare, internacionale, për çlirimin e popujve të shtypur, si e vetmja metodë e drejtë, duke provuar me vepra mundësinë dhe dobinë e bashkimit vëllazëror të punëtorëve dhe të fshatarëve të

popujve të ndryshëm në bazën e *vullnetarizmit* dhe të *internacionalizmit*. Ekzistenca e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, që është prototipi i bashkimit të ardhshëm të punonjësve të të gjitha vendeve në një ekonomi të vetme botërore, nuk mund të mos shërbejë si një provë e drejtpërdrejtë për këtë gjë.

Është e kotë të thuhet se këto rezultate të Revolucionit të Tetorit dhe të tjera si këto nuk mund të mbeteshin dhe nuk mund të mbeten pa ushtruar një ndikim serioz në lëvizjen revolucionare të vendeve koloniale dhe të varura. Të tilla fakte, si rritja e lëvizjes revolucionare të popujve të shtypur në Kinë, në Indonezi, në Indi etj. dhe shtimi i simpatisë së këtyre popujve për BRSS-në, — e dëshmojnë qartë këtë.

Epoka e shtypjes dhe e shfrytëzimit në qetësi të kolonive dhe të vendeve të varura *kaloi*.

Filloi epoka e revolucioneve çlirimtare në kolonitë dhe në vendet e varura, epoka e zgjimit të *proletariatit* të këtyre vendeve, epoka e *hegjemonisë* së tij në revolucion.

«Pravda» Nr. 255, 6—7
nëntor 1927

Veprat, bot. shqip, vëll. 10,
f. 235-238

ÇESHTJA KOMBËTARE DHE LENINIZMI

Përgjigje shokëve Meshkov, Kovalçuk dhe të tjerëve

Letrat tuaja i mora. Ato janë të njëllajta me një varg letrash për të njëjtën temë që unë kam marrë këta muajt e fundit nga disa shokë të tjerë. Megjithatë, vendosa t'ju përgjigjem pikërisht juve, sepse ju i shtroni çështjet më troç dhe kështu ndihmoni që ato të bëhen të qarta. Është e vërtetë se në letrat tuaja ju jepni një zgjidhje të gabuar të çështjeve që shtroni, por kjo është tjetër punë, — për këtë do të flasim më poshtë.

Të fillojmë nga puna.

1. NOCIONI «KOMB»

Marksistët rusë prej kohe e kanë teorinë e tyre për kombin. Sipas kësaj teorie, kombi është një bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht, që ka lindur në bazë të bashkësisë së katër tipareve themelore, dhe pikërisht: në bazë të bashkësisë së gjuhës, bashkësisë së territorit, bashkësisë së jetës eko-

nomike dhe bashkësisë së formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e veçorive specifike të kulturës kombëtare. Siç dihet, kjo teori në partinë tonë është pranuar nga të gjithë.

Siç shihet nga letrat tuaja, këtë teori ju e quani të pamjaftueshme. Prandaj propozoni që katër tipareve të kombit t'u shtohet një tipar i pestë, dhe pikërisht: ekzistenca e shtetit të vet të veçuar kombëtar. Ju jeni të mendimit se pa këtë tipar të pestë nuk ka dhe nuk mund të ketë komb.

Unë mendoj se skema e propozuar prej jush me tiparin e saj të ri, me tiparin e pestë të nocionit «komb», është thellësisht e gabuar dhe nuk mund të përlligjet as nga pikëpamja teorike, as nga pikëpamja praktike-politike.

Sipas skemës suaj duhet të pranojmë si kombe vetëm ato kombe që kanë shtetin e vet, të veçuar nga të tjerët, kurse të gjitha kombet e shtypura, që nuk kanë një shtet më vete, duhen hequr nga kategoria e kombeve, dhe lufta e kombeve të shtypura kundër zgjedhës kombëtare, lufta e popujve kolonialë kundër imperializmit duhet përjashtuar nga nocioni «lëvizje kombëtare», «lëvizje nacionalçlirimtare».

Për më tepër, sipas skemës suaj duhet të pohojmë se:

a) irlandezët u bënë komb vetëm pas formimit të «Shtetit të lirë të Irlandës», dhe se para kësaj kohe ata nuk ishin komb;

b) norvegjezët nuk ishin komb para shkëputjes së Norvegjisë nga Suedia, por u bënë komb vetëm pas kësaj shkëputjeje;

c) ukrainasit nuk ishin komb kur Ukraina bënte pjesë në Rusinë cariste, ata u bënë komb vetëm pas shkëputjes nga Rusia Sovjetike në kohën e Radës Qendrore dhe të hetmanit Skoropadski, por pushuan përsëri së qeni komb kur e bashkuan Republikën e tyre Sovjetike të Ukrainës me Republikat e tjera Sovjetike në Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike.

Shembuj të tillë mund të sillen me shumicë.

Duket sheshit se një skemë që shpie në konkluzione kaq absurde nuk mund të quhet skemë shkencore.

Nga pikëpamja praktike-politike, skema juaj çon patjetër në përligjen e zgjedhës kombëtare, imperia-liste, bartësit e së cilës nuk i pranojnë në asnjë mënyrë si kombe të vërteta kombet e shtypura dhe pa të drejta të plota, që nuk kanë shtete të tyre të veçanta kombëtare, dhe mendojnë se kjo rrethanë u jep të drejtë t'i shtypin këto kombe.

Është e tepërt të theksoj, pastaj, se skema juaj çon në përligjen e nacionalistëve borgjezë në Republikat tona Sovjetike, të cilët mundohen të provojnë se kombet sovjetike pushuan së qeni kombe kur pranuan t'i bashkonin Republikat e tyre Sovjetike kombëtare në Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike.

Kështu qëndron puna me çështjen e «plotësimit» dhe «korrigjimit» të teorisë marksiste ruse për kombin.

Mbetet një gjë: të pranojmë se teoria marksiste ruse për kombin është e vetmja teori e drejtë.

2. LINDJA DHE ZHVILLIMI I KOMBEVE

Një nga gabimet tuaja serioze është se ju i futni në një kailëp të gjitha kombet që ekzistojnë sot dhe nuk e shihni ndryshimin parimor ndërmjet tyre.

Ka kombe dhe kombe në botë. Ka kombe që u formuan në epokën kur kapitalizmi ishte në rritje e sipër, kur borgjezia, duke shkatërruar feudalizmin dhe copëtimin feudal, e bashkoi kombin në një trup të vetëm dhe e çimentoj atë. Këto janë të ashtuquajturat kombe «moderne».

Ju thoni se kombet kanë lindur dhe kanë ekzistuar qysh para kapitalizmit. Po si mund të lindnin kombet dhe të ekzistonin para kapitalizmit, në periudhën e feudalizmit, kur vendet ishin të copëtuara në principata të ndryshme më vete, të cilat jo vetëm që nuk kishin ndërmjet tyre lidhje kombëtare, por e mohonin kategorikisht nevojën e lidhjeve të tilla? Në kundërshtim me pohimet tuaja të gabuara, në periudhën parakapitaliste nuk ka pasur dhe nuk mund të kishte kombe, pasi ende nuk kishte tregje kombëtare, nuk kishte as qendra ekonomike kombëtare, as qendra kulturore kombëtare, nuk ekzistonin, pra, faktorët që zhdukën copëtimin ekonomik të një populli dhe që bashkojnë pjesët e këtij populli, më parë të copëtuara, në një tërësi kombëtare.

Sigurisht, elementet e kombit, — gjuha, territori, bashkësia kulturore etj. — nuk kanë rënë nga qielli, por janë krijuar dalngadalë qysh në periudhën parakapitaliste. Por këto elemente ndodheshin në gjendje embrionale dhe, në rastin më të mirë, përfaqësonin vetëm një potencë nga pikëpamja e mundësisë së formimit të kombit në të ardhmen, në disa kushte të favorshme. Potencia u bë realitet vetëm në periudhën kur kapitalizmi ishte në nritje e sipër, kishte tregun e tij kombëtar, qendrat e tij ekonomike dhe kulturore.

Këtu duhen përmendur fjalët me vend të Leninit në lidhje me lindjen e kombeve, fjalë të thëna prej tij në broshurën «Ç'janë «miqtë e popullit» dhe si luftojnë ata kundër socialdemokratëve?». Duke polemizuar me narodnikun Mihajlovski, i cili lindjen e lidhjeve kombëtare dhe të unitetit kombëtar e nxjerr nga zhvillimi i lidhjeve fisnore, Lenini thotë:

«Pra, lidhjet kombëtare janë vazhdimi dhe përgjithësimi i lidhjeve gjinore! Sigurisht, z. Mihajlovski, e merr hua idenë e vet për historinë e shoqërisë nga ato përralla fëmijësh që u mësohen nxënësve të gjimnazit. Historia e shoqërisë — thotë

kjo doktrinë skolastike — qëndron në faktin se në fillim ka qenë familja, që është bërthamë e çdo shoqërie, pastaj — thuhet — familja u zhvillua derisa u bë fis dhe fisi u zhvillua derisa u bë shtet. Nëse z. Mihajlovski e përsërit seriozisht këtë marrëzi fëmijësh, kjo tregon — përveç së tjerash — vetëm se ai nuk ka as idenë më të vogël qoftë edhe për zhvillimin e historisë ruse. Në qoftë se mund të flitej për një jetë në bazë gjinish në Rusinë e vjetër, s'ka dyshim se qysh në kohën e mesjetës, në epokën e mbretërisë së Moskës, këto lidhje gjinore nuk ekzistonin më, d.m.th. se shteti nuk mbështetej aspak në bashkime gjinore, por në bashkime tokësore: çifligarët e mëdhenj dhe manastiret mbledhnin fshatarë nga vende të ndryshme, dhe komunat e krijuara në këtë mënyrë ishin bashkime thjesht tokësore. Megjithatë, në atë kohë mezi mund të flitej për lidhje kombëtare në kuptimin e vërtetë të fjalës: shteti ndahej në «toka» të veçanta, shpeshherë edhe në principata, që ruanin gjurmë të gjalla të autonomisë së mëparshme, veçori administrative dhe që nganjëherë kishin ushtri të veta (fisnikët lokalë shkonin në luftë me regjimentet e veta), kufij doganorë të veçantë etj. Vetëm periudha e re e historisë ruse (afërsisht qysh nga shekulli XVII) karakterizohet me të vërtetë nga një shkrirje efektive e të gjitha këtyre krahinave, tokave dhe principatave në një tërësi të vetme. Kjo shkrirje, o shumë i nderuar z. Mihaljovski, nuk u shkaktua nga lidhje gjinore, e as nga vazhdimi e përgjithësimi i tyre: kjo u shkaktua nga shtimi i këmbimit ndërmjet krahinave, nga rritja graduale e qarkullimit të mallrave, nga përqendrimi i tregjeve të vogla lokale në një treg të vetëm të të gjithë Rosisë. Meqë drejtuesit dhe zotërit e këtij procesi ishin tregtarët kapitalistë, krijimi i këtyre lidhjeve kombëtare s'ishte tjetër veçse krijimi i lidhjeve borgjeze» (Veprat, bot. shqip, vëll. 1, f. 163-164).

«Kështu qëndron puna me lindjen e të ashtuquajturave kombe «moderne».

Borgjezia dhe partitë e saj nacionaliste ishin dhe

mbeten në këtë periudhë forca kryesore udhëheqëse e këtyre kombeve. Paqja ndërmjet klasave brenda kombit për hir të «unitetit të kombit»; zgjerimi i territorit të kombit me anë të zaptimit të tokave të kombeve të tjera; mosbesimi dhe urrejtja kundrejt kombeve të tjera; shtypja e pakicave kombëtare; fronti unik me imperializmin, — ky është bagazhi ideologjik dhe shoqëror-politik i këtyre kombeve.

Këto kombe duhen cilësuar si kombe borgjeze. I tillë është, për shembull, kombi francez, ai anglez, italian, kombi i Amerikës Veriore si dhe kombe të tjera si këto. Kombi i tillë borgjez ishte edhe kombi rus, ai ukrainas, tatar, armen, gjeorgjian dhe kombe të tjera të Rusisë para vendosjes së diktaturës së proletariatit dhe të rendit sovjetik në vendin tonë.

Kuptohet vetvetiu se fati i kombeve të tilla është i lidhur me fatin e kapitalizmit, se me zhdukjen e kapitalizmit duhet të zhduken nga skena edhe këto kombe.

Pikërisht për kombe të tilla borgjeze bëhet fjalë në broshurën e Stalinit «Marksizmi dhe çështja kombëtare», ku thuhet se «kombi nuk është vetëm një kategori historike, por një kategori historike e një epoke të caktuar, e epokës së kapitalizmit në rritje e sipër», se «fatet e lëvizjes kombëtare, që në thelb është një lëvizje borgjeze, janë të lidhura vetvetiu me fatin e borgjezisë», se «lëvizja kombëtare mund të zhduket përfundimisht vetëm kur të zhduket borgjezia», se «vetëm në socializëm mund të vendoset një paqe e plotë»³⁸.

Kështu qëndron puna me kombet borgjeze.

Por në botë ka edhe kombe të tjera. Këto janë kombet e reja, sovjetike, që lindën dhe u formuan mbi bazën e kombeve të vjetra borgjeze pas përmbysjes së kapitalizmit në Rusi, pas likuidimit të borgjezisë dhe të partive të saj nacionaliste, pas konsolidimit të rendit sovjetik.

Klasa punëtore dhe partia e saj internacionaliste

janë forca që i çimenton këto kombe të reja dhe i udhëheq ato. Aleanca e klasës punëtore dhe e fshatarësisë punonjëse brenda kombit, aleancë që ka për qëllim zhdukjen e mbeturinave të kapitalizmit për të ndërtuar me sukses socializmin; zhdukja e mbeturinave të shtypjes kombëtare për të siguruar barazinë e të drejtave dhe zhvillimin e lirë të kombeve dhe të pakicave kombëtare; zhdukja e mbeturinave të nacionalizmit për të vendosur miqësinë ndërmjet popujve dhe për të siguruar triumfin e internacionalizmit; fronti unik me të gjitha kombet e shtypura dhe pa të drejta të plota në luftën kundër politikës së pushtimeve dhe luftërave grabitqare, në luftën kundër imperializmit, — kjo është fizionomia shpirtërore dhe shoqërore-politike e këtyre kombeve.

Këto kombe duhen cilësuar si kombe socialiste.

Këto kombe të reja lindën dhe u zhvilluan mbi bazën e kombeve të vjetra, borgjeze, si pasojë e likuidimit të kapitalizmit, — duke u transformuar rrënjësisht në frymën e socializmit. Askush nuk mund ta mohojë se kombet e sotme socialiste në Bashkimin Sovjetik — kombi rus, ukrainas, bjellorus, tatar, bashkiras, uzbek, kazak, azerbajxhanas, gjeorgjian, armen dhe kombe të tjera — dallohen rrënjësisht nga kombet e vjetra, borgjeze përkatëse të Rusisë së vjetër si nga pikëpamja e klasave që e përbëjnë dhe e fizionomisë së tyre shpirtërore, ashtu edhe nga pikëpamja e interesave dhe aspiratave të tyre shoqërore-politike.

Këto janë dy tipet e kombeve që njeh historia.

Ju nuk pranoni ta lidhni fatin e kombeve, në këtë rast fatin e kombeve të vjetra, borgjeze, me fatin e kapitalizmit. Ju nuk e pranoni tezën që thotë se me likuidimin e kapitalizmit do të likuidohen edhe kombet e vjetra, borgjeze. Por atëherë me se mund të lidhet fati i këtyre kombeve, në qoftë se nuk lidhet me fatin e kapitalizmit? A është vështirë të kuptohet se me zhdukjen e kapitalizmit duhet të zhduken edhe kombet borgjeze të lindura prej tij? Mos vallë mendoni

ju se kombet e vjetra, borgjeze, mund të ekzistojnë dhe të zhvillohen në kushtet e rendit sovjetik, në kushtet e diktaturës së proletariatit? Edhe kjo na duhej...

Ju keni frikë se mos likuidimi i kombeve që ekzistojnë në kapitalizëm do të thotë likuidim i kombeve në përgjithësi, likuidim i çdo kombi. Pse? Për ç'arsye? Mos vallë nuk e dini se përveç kombeve borgjeze ka edhe kombe të tjera, kombet socialiste, që janë shumë më të bashkuara e të gjalla se çdo komb borgjez?

Gabimi juaj është pikërisht se ju nuk shihni kombe të tjera, përveç kombeve borgjeze, — si rrjedhim ju lini mënjanë një epokë të tërë, epokën e formimit të kombeve socialiste në Bashkimin Sovjetik, të cilat lindën mbi gërmadhat e kombeve të vjetra, borgjeze.

Puna këtu është pikërisht se likuidim i kombeve borgjeze nuk do të thotë likuidim i kombeve në përgjithësi, por vetëm likuidim i kombeve borgjeze. Mbi gërmadhat e kombeve të vjetra, borgjeze, lindin dhe zhvillohen kombet e reja, socialiste, që janë shumë më të bashkuara se çdo komb borgjez, sepse nuk i kanë kontradiktat e papajtueshme të klasave, që brejnë kombet borgjeze, dhe përfaqësojnë popullin shumë më tepër se çdo komb borgjez.

3. E ARDHMJA E KOMBEVE DHE E GJUHËVE KOMBËTARE

Ju bëni një gabim të rëndë kur vini shenjën e barazimit midis periudhës së fitores së socializmit në një vend të vetëm dhe periudhës së fitores së socializmit në shkallë botërore, duke thënë se jo vetëm në kushtet e fitores së socializmit në shkallë botërore,

por edhe në kushtet e fitores së socializmit në një vend të vetëm ka mundësi dhe duhet të zhduken dallimet kombëtare dhe gjuhët kombëtare, të shkrihen kombet dhe të formohet një gjuhë e vetme e përbashkët. Këtu ju përziemi gjëra krejt të ndryshme: «zhdukjen e shtypjes kombëtare» me «zhdukjen e dallimeve kombëtare», «zhdukjen e barrierave shtetërore kombëtare» me «shuarjen e kombeve», me «shkrirjen e kombeve».

Nuk mund të mos vihet në dukje se marksistëve nuk u lejohet aspak t'i përziejnë këto nocione krejt të ndryshme. Te ne, në vendin tonë, ka kohë që është zhdukur shtypja kombëtare, por nga kjo nuk del aspak se dallimet kombëtare janë zhdukur dhe se kombet e vendit tonë janë likuiduar. Te ne, në vendin tonë, ka kohë që janë hequr barrierat shtetërore kombëtare me rojat e kufirit, me doganat, por nga kjo nuk del aspak se kombet tashmë janë shkrirë dhe gjuhët kombëtare janë zhdukur, se këto gjuhë janë zëvendësuar me ndonjë gjuhë të vetme të përbashkët për të gjitha kombet tona.

Ju nuk jeni të kënaqur nga fjalimi im i mbajtur në Universitetin Komunist të popujve të Lindjes (1925), ku unë nuk e quaja të drejtë tezën që thotë se gjoja me fitoren e socializmit në një vend të vetëm, për shembull në vendin tonë, gjuhët kombëtare do të zhduken, kombet do të shkrihen dhe në vend të gjuhëve kombëtare do të dalë një gjuhë e përbashkët.

Ju jeni të mendimit se kjo deklaratë imja është në kundërshtim me tezën e njohur të Leninit, që thotë se qëllimi i socializmit është jo vetëm zhdukja e ndarjes së njerëzimit në shtete të vogla dhe e çdo vecimi të kombeve, jo vetëm afrimi i kombeve, por edhe shkrirja e tyre.

Ju jeni të mendimit, pastaj, se ajo është në kundërshtim edhe me një tezë tjetër të Leninit, që thotë se me fitoren e socializmit në shkallë botërore do të fillojnë të zhduken dallimet kombëtare dhe gjuhët kombëtare, se pas kësaj fitoreje gjuhët kombëtare do

të fillojnë të zëvendësohen me një gjuhë të përbashkët.

Kjo nuk është aspak e vërtetë, shokë. Ky është një gabim i rëndë.

Më sipër thashë se nuk i lejohet një marksisti të ngatërrojë dhe të futë në një kallëp dukuri të tilla të ndryshme, si «fitorja e socializmit në një vend të vetëm» dhe «fitorja e socializmit në shkallë botërore». Nuk duhet harruar se këto dukuri të ndryshme pasqyrojnë dy epoka krejt të ndryshme, që ndryshojnë prej njëra-tjetrës jo vetëm nga koha (që është tepër e rëndësishme), por edhe nga vetë thelbi i tyre.

Mosbesimi kombëtar, veçimi kombëtar, armiqësia kombëtare, konfliktet kombëtare nxiten dhe përkrahen, sigurisht, jo nga ndonjë ndjenjë «e lindur» e urrejtjes kombëtare, por nga tendenca që ka imperializmi për të nënshtruar kombet e tjera dhe nga frika që ngjall te këto kombe rreziku i skllavërimit kombëtar. S'ka dyshim se, derisa të ekzistojë imperializmi botëror, do të ekzistojnë edhe kjo tendencë dhe kjo frikë, — pra, do të ekzistojnë në shumicën dërrmuese të vendeve edhe mosbesimi kombëtar, edhe veçimi kombëtar, edhe armiqësia kombëtare, edhe konfliktet kombëtare. A mund të thuhet se fitorja e socializmit dhe likuidimi i imperializmit në një vend do të thotë likuidim i imperializmit dhe i shtypjes kombëtare në shumicën e vendeve? Është e qartë se jo. Por nga kjo del se fitorja e socializmit në një vend të vetëm, megjithëse e dobëson seriozisht imperializmin botëror, prapëseprapë nuk krijon dhe nuk mund të krijojë kushtet e nevojshme për shkrirjen e kombeve dhe të gjuhëve kombëtare të botës në një tërësi të vetme.

Periodha e fitores së socializmit në shkallë botërore dallohet nga periodha e fitores së socializmit në një vend të vetëm, para së gjithash, sepse ajo likuidon imperializmin në të gjitha vendet, zhduk si tendencën për nënshtrimin e kombeve të tjera, ashtu edhe frikën që ngjall te ato rreziku i skllavërimit kombëtar, zhduk nga rrënjët mosbesimin kombëtar

dhe armiqësinë kombëtare, i bashkon kombet në sistemin unik të ekonomisë socialiste botërore dhe krijon kështu kushtet reale që nevojiten për shkrirjen graduale të të gjitha kombeve në një tërësi të vetme.

Ky është ndryshimi rrënjësor midis këtyre dy periudhave.

Por nga kjo del se të ngatërrosh këto dy periudha të ndryshme dhe t'i futësh ato në një kallëp, — do të thotë të blesh në një gabim të pafalshëm. Të marrim fjalimin tim në UKPL. Atje thuhet:

«Llomotitin (për shembull, Kautski) se në periudhën e socializmit do të krijohet një gjuhë e vetme për gjithë njerëzimin dhe se të gjitha gjuhët e tjera do të zhduken. Unë pak i besoj teorisë së një gjuhe të vetme për të gjithë. Sidoqoftë, përvoja nuk flet në dobi, por kundër kësaj teorie. Deri më sot puna ka ngjarë kështu: revolucioni socialist nuk e ka pakësuar numrin e gjuhëve, por e ka shtuar, sepse ai, duke shkundur shtresat më të ulëta të njerëzimit dhe duke i nxjerrë ato në skenën politike, fut në një jetë të re një varg të tërë kombësish të reja, që më parë nuk njiheshin ose njiheshin pak. Kujt i shkonte ndër mend se Rusia e vjetër cariste ka jo më pak se 50 kombe dhe grupe kombëtare? Megjithatë, Revolucioni i Tetorit, pasi këputi zinxhirët e vjetër dhe nxori në skenë një varg të tërë popujsh dhe kombësish të prapambetura, u dha atyre një jetë të re dhe një zhvillim të ri»⁸⁹.

Nga ky citat shihet se unë jam shprehur kundër njerëzve të tipit Kautski, i cili (domethënë Kautski) kurdoherë ka qenë dhe mbeti diletant në çështjen kombëtare, i cili nuk e kupton mekanizmin e zhvillimit të kombeve dhe nuk ka një ide për forcën kolosale të qëndrueshmërisë së kombeve, i cili e quan të mundshme shkrirjen e kombeve shumë kohë para fitores së socializmit, qysh në regjimin demokratikoborgjez, i cili, duke ngritur në qiell në mënyrë ser-

vile «punën» asimiluese të gjermanëve në Çeki, pohon me mendjehetësi se çekët pothuajse janë gjermanizuar, se çekët si komb nuk kanë të ardhme.

Nga ky citat shihet, pastaj, se në fjalimin tim unë e kam pasur fjalën jo për periudhën e fitores së socializmit në *shkallë botërore*, por vetëm e vetëm për periudhën e fitores së socializmit në *një vend të vetëm*. Unë kam thënë (dhe vazhdoj të them) se periudha e fitores së socializmit në një vend të vetëm nuk krijon kushtet e nevojshme për shkrirjen e kombeve dhe të gjuhëve kombëtare, se — përkundrazi, kjo periudhë krijon një situatë të favorshme për rilindjen dhe lulëzimin e kombeve, që më parë ishin të shtypura nga imperializmi carist dhe që sot janë qiruar nga shtypja kombëtare në sajë të revolucionit sovjetik.

Nga ky citat shihet, më në fund, se juve ju ka shpëtuar nga syri ndryshimi shumë i madh midis dy periudhave të ndryshme historike, dhe për këtë arsye nuk e kenë kuptuar përmbajtjen e fjalimit të Stalinit dhe, si rrjedhojë e gjithë kësaj, jeni ngatërruar në labirintin e gabimeve tuaja.

Po kalojmë në tezat e Leninit për zhdukjen dhe shkrirjen e kombeve pas fitores së socializmit në shkallë botërore.

Ja një nga tezat e Leninit, që është nxjerrë nga artikulli i Leninit «Revolucioni socialist dhe e drejta e kombeve për vetëvendosje», botuar më 1916, tezë që s'di se për ç'arsye nuk citohet e plotë në letrat tuaja:

«Qëllimi i socializmit nuk është vetëm zhdukja e copëtimit të njerëzimit në shtete të vogla dhe zhdukja e çdo veçimi të kombeve, nuk është vetëm afrimi i kombeve, por edhe shkrirja e tyre... Po ashtu sikundër njerëzimi mund të arrijë në zhdukjen e klasave vetëm nëpërmjet periudhës kalimtare të diktaturës së klasës së shtypur, po kështu edhe në shkrirjen e pashmangshme të kombeve njerëzimi mund

të arrijë vetëm nëpërmjet periudhës kalimtare të glirimit të plotë të të gjitha kombeve të shtypura, d.m.th. të lirisë së tyre për t'u shkëputur» (Veprat, bot. shqip, vëll. 22, f. 174, 175).

Ja edhe një tezë tjetër e Leninit, e cila gjithashtu nuk citohet e plotë prej jush:

«Derisa ekzistojnë dallimet kombëtare dhe shtetërore midis popujve dhe vendeve — dhe këto dallime do të ekzistojnë edhe për shumë e shumë kohë, madje edhe pas vendosjes së diktaturës së proletariatit në shkallë botërore — uniteti i taktikës internacionale të lëvizjes punëtore komuniste të të gjitha vendeve kërkon jo zhdukjen e këtyre dallimeve, jo asgjësimin e dallimeve kombëtare (kjo është një ëndërr absurde për çastin e sotëm), por një zbatim të tillë të parimeve themelore të komunizmit (Pushteti Sovjetik dhe diktatura e proletariatit), i cili *t'i modifikojë drejt* këto parime në hollësitë, *t'i përshtatë drejt*, *t'i zbatojë* në përputhje me dallimet kombëtare dhe kombëtaro-shtetërore» (Veprat, bot. shqip, vëll. 31, f. 91).

Duhet theksuar se ky citat është marrë nga broshura e Leninit «Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm», botuar më 1920, domethënë — pas fitores së revolucionit socialist në një vend të vetëm, pas fitores së socializmit në vendin tonë.

Nga këto citate shihet se procesin e shuarjes së dallimeve kombëtare dhe të shkrirjes së kombeve Lenini nuk e lidh me periudhën e fitores së socializmit në një vend të vetëm, por vetëm e vetëm me periudhën pas vendosjes së diktaturës së proletariatit në shkallë botërore, domethënë me periudhën e fitores së socializmit në të gjitha vendet, kur të jenë hedhur themelet e ekonomisë socialiste botërore.

Nga këto citate shihet pastaj, se orvatjen për ta lidhur procesin e shuarjes së dallimeve kombëtare me periudhën e fitores së socializmit në një vend

të vetëm, në vendin tonë, Lenini e cilëson si një «ëndërr absurde».

Nga këto citate shihet, përveç kësaj, se Stalini pa dyshim kishte të drejtë kur në fjalimin e tij në UKPL mohoi mundësinë e shuarjes së dallimeve kombëtare dhe të gjuhëve kombëtare në periudhën e fitores së socializmit në një vend të vetëm, në vendin tonë, kurse ju pa dyshim nuk keni të drejtë kur mbronni diçka krejt të kundërt me tezën e Stalinit.

Nga këto citate shihet, më në fund, se duke ngatërruar dy periudha të ndryshme të fitores së socializmit ju nuk e keni kuptuar Leninin, keni shtrembëruar vijën e Leninit në çështjen kombëtare dhe për këtë arsye, kundër vullnetit tuaj, jeni vënë në rrugën që të largon nga leninizmi.

Do të ishte gabim të mendohej se zhdukja e dallimeve kombëtare dhe shuarja e gjuhëve kombëtare do të bëhet menjëherë pas disfatës së imperializmit botëror, me një goditje të vetme, si të thuash, me dekrete nga lart. S'ka asgjë më të gabuar sesa një pikëpamje e tillë. Të orvatesh ta bësh shkrijen e kombeve me anë të dekretëve nga lart, me anë të detyrimit. — do të thotë të bësh lojën e imperialistëve, të minosh çështjen e çlirimit të kombeve, të prishësh punën e organizimit për bashkëpunimin dhe vëllazërimin e kombeve. Një politikë e tillë do të ishte e barabartë me politikën e asimilimit.

Ju, sigurisht, e dini se politika e asimilimit përjashtohet krejtësisht nga arsenali i marksizëm-leninizmit si një politikë antipopullore, kundërrevolucionare, si një politikë vdekjeprurëse.

Përveç kësaj, dihet se kombet dhe gjuhët kombëtare shquhen për qëndrueshmërinë e tyre të jashtëzakonshme dhe fuqinë e madhe kundër politikës së asimilimit. Asimiluesit turq, — më të egrit ndër të gjithë asimiluesit, — me qindra vjet i munduan dhe i gjymtuan kombet ballkanike, e megjithatë jo vetëm që nuk mundën t'i zhduknin, por qenë të shtrënguar

të kapitullonin. Rusifikuesit e Ruisë cariste dhe gjermanizuesit gjermano-prusianë, të cilët nga egërsia nuk ishin fort prapa asimiluesve turq, për më se njëqind vjet e copëtuan dhe e munduan kombin polonez, po ashtu sikurse asimiluesit persianë dhe turq copëtuan, munduan dhe shfarosën qindra vjet me radhë kombin armen dhe atë gjeorgjian, e megjithatë jo vetëm që nuk arritën t'i zhduknin këto kombe, por — përkundrazi — qenë të shtrënguar gjithashtu të kapitullonin.

Duhet pasur parasysh të gjitha këto rrethana për të parashikuar drejt rrjedhën e mundshme të ngjarjeve nga pikëpamja e zhvillimit të kombit menjëherë pas disfatës së imperializmit botëror.

Do të ishte gabim të mendohej se etapa e parë e periudhës së diktaturës botërore të proletariatit do të jetë fillimi i shuarjes së kombeve dhe gjuhëve kombëtare, fillimi i formimit të një gjuhe të vetme të përbashkët. Përkundrazi, etapa e parë gjatë së cilës do të zhduket përgjithmonë shtypja kombëtare, — do të jetë etapa e zhvillimit dhe e lulëzimit të kombeve dhe gjuhëve kombëtare që kanë qenë të shtypura, etapa e vendosjes së barazisë së kombeve, etapa e zhdukjes së mosbesimit kombëtar të ndërsjellë, etapa e vendosjes dhe e forcimit të lidhjeve internacionale ndërmjet kombeve.

Vetëm në etapën e dytë të periudhës së diktaturës botërore të proletariatit, krahas formimit të një ekonomie të vetme socialiste botërore, — në vend të ekonomisë kapitaliste botërore, — vetëm në këtë etapë do të fillojë të formohet diçka e përngjashme me një gjuhë të përbashkët, sepse vetëm në këtë etapë kombet do të ndiejnë nevojën të kenë, krahas gjuhëve të tyre kombëtare, një gjuhë të përbashkët ndërkombëtare, — për të lehtësuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ekonomik, kulturor e politik. Pra, në këtë etapë gjuhët kombëtare dhe gjuha e përbashkët ndërkombëtare do të ekzistojnë paralelisht. Ka mundësi

që në fillim të krijohet jo një qendër ekonomike botërore e përbashkët për të gjitha kombet, me një gjuhë të përbashkët, por disa qendra ekonomike zonale për grupe të ndryshme kombesh me një gjuhë të veçantë të përbashkët për secilin grup kombesh, dhe vetëm më vonë këto qendra do të bashkohen në një qendër botërore të përgjithshme të ekonomisë socialiste me një gjuhë të përbashkët për të gjitha kombet.

Në etapën e mëvonshme të periudhës së diktaturës botërore të proletariatit, kur sistemi socialist botëror i ekonomisë të forcohet në mënyrë të mjaftueshme dhe socializmi të futet në jetën e popujve, kur kombet të binden në praktikë për përfitimet që sjell gjuha e përbashkët në krahasim me gjuhët kombëtare, — dallimet kombëtare dhe gjuhët kombëtare do të fillojnë të shuhen, duke i lëshuar vendin një gjuhe botërore të përbashkët për të gjithë.

Kështu, sipas mendimit tim, mund të përfytyrohet për afërsisht e ardhmja e kombeve, zhvillimi i kombeve në rrugën që shpie drejt shkrirjes së tyre në të ardhmen.

4. POLITIKA E PARTISË NË ÇËSHTJEN KOMBËTARE

Një nga gabimet tuaja është se ju nuk e merrni çështjen kombëtare si një pjesë të çështjes së përgjithshme të zhvillimit shoqëror-politik të shoqërisë, si një pjesë që varet pikërisht nga kjo çështje e përgjithshme, por si diçka më vete dhe të përhershme, që në përgjithësi nuk e ndryshon drejtimin dhe karakterin e vet gjatë historisë. Prandaj ju nuk e shihni atë që sheh çdo marksist, dhe pikërisht se çështja kombëtare nuk ka kurdoherë karakter të njëlojtë,

se karakteri dhe detyrat e lëvizjes kombëtare ndryshojnë sipas periudhave të ndryshme të zhvillimit të revolucionit.

Logjikisht kështu shpjegohet pikërisht fakti i trishtueshëm se ju i ngatërroni aq lehtë dhe i futni në një kallëp periudhat e ndryshme të zhvillimit të revolucionit, duke mos e kuptuar se ndryshimi i karakterit dhe i detyrave të revolucionit në etapat e ndryshme të zhvillimit shkakton ndryshimet përkatëse në karakterin dhe detyrat e çështjes kombëtare, se në përputhje me këtë ndryshon edhe politika e partisë në çështjen kombëtare dhe se, si rrjedhim, politika e partisë në çështjen kombëtare, e lidhur me një periudhë të caktuar të zhvillimit të revolucionit, nuk mund të shkëputet me forcë nga kjo periudhë dhe të kalohet arbitrarisht në një periudhë tjetër.

Marksistët rusë janë nisur kurdoherë nga parimi se çështja kombëtare është një pjesë e çështjes së përgjithshme të zhvillimit të revolucionit, se në etapat e ndryshme të revolucionit çështja kombëtare ka detyra të ndryshme, të cilat i përgjigjen karakterit të revolucionit në çdo çast historik të dhënë, dhe se në përputhje me këtë ndryshon edhe politika e partisë në çështjen kombëtare.

Në periudhën para luftës së parë botërore, kur historia e shtroi si një detyrë të ngutshme revolucionin *demokratiko-borgjez* në Rusi, marksistët rusë zgjidhjen e çështjes kombëtare e lidhnin me fatin e revolucionit demokratik në Rusi. Partia jonë ishte e mendimit se përmbysja e carizmit, zhdukja e mbeturinave të feudalizmit dhe demokratizimi i plotë i vendit janë zgjidhja më e mirë e çështjes kombëtare. që mund të arrihet në kuadrin e kapitalizmit.

Ja politika e partisë në këtë periudhë.

Në këtë periudhë dolën artikujt e njohur të Leninit për çështjen kombëtare, ndër të cilët edhe artikulli «Shënime kritike për çështjen kombëtare», ku Lenini thotë:

«... Unë them se ka vetëm një zgjidhje të çështjes kombëtare, në atë masë që përgjithësisht një gjë e tillë është e mundur në botën e kapitalizmit, dhe kjo zgjidhje është demokratizmi konsekuent. Për të provuar këtë, midis së tjerash, unë sjell si shembull Zvicrën»*.

Po në këtë periudhë doli broshura e Stalinit «Marksizmi dhe çështja kombëtare», ku, ndër të tjera, thuhet:

«Lëvizja kombëtare mund të zhduket përfundimisht vetëm me zhdukjen e borgjezisë. Vetëm në regjimin socialist mund të vendoset një paqe e plotë. Por edhe në kuadrin e kapitalizmit lufta kombëtare mund të reduktohet në minimum, të minohet nga rrënjët dhe të bëhet sa më pak e dëmshme për proletariatin. Këtë e tregojnë qoftë edhe shembujt e Zvicrës dhe të Amerikës. Për këtë duhet demokratizuar vendi dhe u duhet dhënë kombeve mundësia për t'u zhvilluar lirish» (Veprat, bot. shqip, vëll. 2, f. 2).

Në periudhën e mëvonshme, në periudhën e Luftës së Parë Botërore, kur lufta e gjatë ndërmjet dy koalicioneve imperialiste e shkakllmoi fuqinë e imperializmit botëror, kur kriza e sistemit botëror të kapitalizmit arriti kulmin, kur krahas klasës punëtore të «metropoleve» u hodhën në lëvizjen çlirimtare edhe vendet koloniale dhe të varura, kur çështja kombëtare u kthye në çështje kombëtare-koloniale, kur fronti unik i klasës punëtore të vendeve të përparuara kapitaliste dhe të popujve të shtypur të kolonive dhe vendeve të varura filloi të bëhej një forcë reale, kur revolucioni socialist u bë, pra, një çështje e ditës, — marksistët rusë nuk mund të kënaqeshin më me politikën e periudhës së mëparshme, prandaj ata e quaj-

* Shih këtë përmbledhje, f. 88. Red. Përkth.

tën të nevojshme ta lidhnin zgjidhjen e çështjes kombëtare-koloniale me fatin e revolucionit socialist.

Partia ishte e mendimit se përmbysja e pushtetit të kapitalit dhe organizimi i diktaturës së proletariatit, dëbimi i ushtrive imperialiste jashtë kufijve të vendeve koloniale e të varura dhe sigurimi për këto vende i së drejtës për t'u shkëputur dhe për të organizuar shtetet e tyre kombëtare, zhdukja e armiqësisë kombëtare dhe i nacionalizmit dhe forcimi i lidhjeve internacionale midis popujve, organizimi i një ekonomie popullore socialiste unike dhe vendosja e një bashkëpunimi vëllazëror ndërmjet popujve mbi këtë bazë, — janë zgjidhja më e mirë e çështjes kombëtare-koloniale në këto kushte.

Ja politika e partisë në këtë periudhë.

Kjo periudhë ende nuk ka dhënë aq sa duhej të jepte, sepse ajo porsa ka filluar, po s'ka dyshim se ajo ka për ta thënë fjalën e saj vendimtare...

Ndryshe qëndron puna me periudhën e sotme të zhvillimit të revolucionit në vendin tonë dhe me politikën e sotme të partisë.

Duhet theksuar se vendi ynë deri më sot është i vetmi vend që u tregua i gatshëm të përmbyste kapitalizmin. Dhe me të vërtetë ai e përmbysi kapitalizmin, organizoi diktaturën e proletariatit.

Pra, sot për sot jemi ende larg nga dita e vendosjes së diktaturës së proletariatit *në shkallë botërore* dhe aq më tepër — nga dita e fitores së socializmit *në të gjitha vendet*.

Pastaj, duhet theksuar se pasi i dhamë fund pushtetit të borgjezisë, i cili kishte kohë që kishte hequr dorë nga traditat e tij të vjetra demokratike, në kalim e sipër ne zgjidhëm detyrën e «demokratizimit të plotë të vendit», zhdukëm sistemin e shtypjes kombëtare dhe realizuam barazinë e kombeve në vendin tonë.

Siç dihet, këto masa qenë mjeti më i mirë për zhdukjen e nacionalizmit dhe të armiqësisë kombëtare, për vendosjen e besimit ndër popujt.

Duhet theksuar, më në fund, se zhdukja e shtypjes kombëtare solli rilindjen kombëtare të kombeve të vendit tonë, që ishin më parë të shtypura, solli zhvillimin e kulturës së tyre kombëtare, forcimin e lidhjeve miqësore internacionale ndër popujt e vendit tonë dhe vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet tyre në ndërtimin socialist.

Duhet të mos harrojmë se këto kombe të rilindura nuk janë më kombet e vjetra, borgjeze, të udhëhequra prej borgjezisë, por kombe të reja, socialiste, që lindën mbi gërmadhat e kombeve të vjetra dhe që udhëhiqen nga partia internacionaliste e masave punonjëse.

Në lidhje me këtë partia e quajti të nevojshme t'i ndihmojë kombet e rilindura të vendit tonë të ngrihen në këmbë ashtu si duhet, t'i japin gjallëri kulturës së tyre kombëtare dhe ta zhvillojnë atë, të ndërtojnë shkollë, teatro dhe institucione të tjera kulturore në gjuhën amtare, të kombëtarizojnë, d.m.th. t'i bëjnë kombëtare nga përbërja, aparatet e partisë, të bashkimeve profesionale, të kooperativave, të shtetit dhe të ekonomisë, të krijojnë kuadro të tyre kombëtarë të partisë dhe të shtetit dhe t'u vënë fre gjithë atyre elementëve, — megjithëse të paktë, — që orvaten të pengojnë këtë politikë të partisë.

Kjo do të thotë se partia përkrah dhe do të përkrahë zhvillimin dhe lulëzimin e kulturave kombëtare të popujve të vendit tonë, se ajo do të nxitë forcimin e kombeve tona të reja, socialiste, se ajo do ta marrë këtë çështje nën mbrojtjen dhe kujdesin e vet kundër gjithë elementëve antileninistë.

Nga letrat tuaja shihet se ju nuk e miratoni këtë politikë të partisë sonë. Kjo ngjet sepse, së pari, ju ngatërroni kombet e reja, socialiste me kombet e vjetra, borgjeze, dhe nuk e kuptoni se kulturat kombëtare të kombeve tona të reja sovjetike, nga përmbajtja e tyre, janë kultura socialiste. Së dyti, sepse ju — më falni për shprehjen e ashpër, — çaloni fort

në çështjet e leninizmit dhe nuk merrni shumë vesh nga çështja kombëtare.

Shikoni me vëmendje të paktën këtë gjë elementare. Ne të gjithë flasim për domosdoshmërinë e revolucionit kulturor në vendin tonë. Po ta trajtojmë seriozisht këtë çështje dhe të mos lliomotitim më kot, duhet të bëjmë të paktën hapin e parë në këtë drejtim: para së gjithash, të bëjmë të detyrueshëm për të gjithë qytetarët e vendit, pa dallim kombësie, arsimin fillor, dhe më vonë edhe arsimin e mesëm. Është e qartë se pa këtë nuk mund të ketë asnjë zhvillim kulturor në vendin tonë, dhe aq më tepër nuk mund të ketë revolucion kulturor. Për më tepër: pa këtë ne nuk do të kemi asnjë zhvillim të vërtetë të industrisë dhe të bujqësisë, asnjë mbrojtje të sigurt të vendit tonë.

Po si mund të bëhet kjo, po të kemi parasysh se përqindja e analfabetëve në vendin tonë është ende tepër e madhe, se në një varg të tërë kombesh të vendit tonë analfabetët përbëjnë 80-90 për qind?

Për këtë është e nevojshme që vendi të mbulohet me një rrjet të pasur shkollash në gjuhën amtare, duke i furnizuar këto me kuadro arsimtarësh, të cilët të zotërojnë gjuhën amtare.

Për këtë duhen kombëtarizuar, d.m.th. duhen bërë kombëtare nga përbërja të gjitha aparatet e drejtimit që nga ato të partisë dhe të bashkimeve profesionale, deri te aparatet shtetërore dhe ekonomike.

Për këtë duhen zhvilluar shtypi, teatrot, kinematë dhe institucionet e tjera kulturore në gjuhën amtare.

Del pyetja: pse në gjuhën amtare? Sepse masat milionëshe të popullit mund të shkojnë përpara në fushën e zhvillimit kulturor, politik dhe ekonomik vetëm në gjuhën amtare, në gjuhën kombëtare.

Pas gjithë sa u tha, mua më duket se nuk është aq e vështirë të kuptohet se leninistët, sigurisht në qoftë se duan të mbeten leninistë, nuk mund të ndje-

kin. asnjë politikë tjetër në gështjen kombëtare vec
asaj që ndiqet sot në vendin tonë.

Kështu apo jo?

Prandaj le t'i japim fund me kaq.

Mendoj se u jam përgjigjur të gjitha pyetjeve
dhe dyshimeve tuaja.

Përsëritje komuniste *J. STALIN*

*Shkruar më 18 mars
1929*

*Veprat, bot. shqip, vëll. 11,
f. 329-350*

Nga vepra:

«MARKSIZMI DHE ÇËSHTJET E GJUHËSISË»

... Gjuha nuk ka lindur nga kjo apo ajo bazë, nga baza e vjetër apo nga e reja, në gjirin e një shoqërie të dhënë, por ka lindur nga tërë rrjedha e historisë së shoqërisë dhe e historisë së bazave gjatë shekujve. Gjuha nuk është krijuar nga një klasë çfarëdo, por nga gjithë shoqëria, nga të gjitha klasat e shoqërisë, me përpjekjet e qindra brezave. Ajo nuk është krijuar për të plotësuar nevojat vetëm të njëjës klasë, por nevojat e gjithë shoqërisë, e të gjitha klasave të shoqërisë. Pikërisht për këtë arsye ajo është krijuar si gjuhë e gjithë popullit, një e vetme për gjithë shoqërinë dhe e përbashkët për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Prandaj roli që luan gjuha, si mjet komunikimi midis njerëzve, nuk është që t'i shërbejë një klase në dëm të klasave të tjera, por që t'i shërbejë njëlloj gjithë shoqërisë, gjithë klasave të shoqërisë. Pikërisht kështu shpjegohet që gjuha mund t'i shërbejë njëlloj si rendit të vjetër, që është duke vdekur, ashtu edhe të riut, që shkon përpara, si bazës së vjetër, ashtu edhe së resë, si shfrytëzuesve, ashtu edhe të shfrytëzuarve.

...Gjuha është, përkundrazi, produkti i një vargu të tërë epokash, gjatë të cilave ajo formohet, pasurohet, zhvillohet dhe lëmohet. Prandaj jeta e një gjuhe është shumë më e gjatë se jeta e çdo baze dhe e çdo superstrukture. Madje kështu shpjegohet përse lindja dhe zhdukja jo vetëm e një baze dhe e superstrukturës së saj, por edhe e shumë bazave dhe superstrukturave që u përgjigjen atyre, nuk çojnë gjatë historisë në zhdukjen e një gjuhe të dhënë, në zhdukjen e strukturës së saj dhe në lindjen e një gjuhe të re me një fond të ri leksiku dhe me një sistem gramatikor të ri.

... Sa për zhvillimin e mëtejshëm, nga gjuhët e gjinive deri te gjuhët e fiseve, nga gjuhët e fiseve deri te gjuhët e kombësive dhe nga gjuhët e kombësive deri te gjuhët e kombeve, kudo në të gjitha etapat e zhvillimit gjuha, si mjet komunikimi midis njerëzve në shoqëri, ka qenë një e vetme dhe e përbashkët për shoqërinë, u ka shërbyer njësoj anëtarëve të shoqërisë pavarësisht nga gjendja e tyre shoqërore.

Nuk po flas këtu për perandoritë e kohës së skllavërisë dhe të mesjetës si, për shembull, për perandorinë e Kirit dhe atë të Aleksandrit të Madh ose për perandorinë e Cezarit dhe atë të Karlit të Madh, të cilat nuk kishin një bazë ekonomike të vetën, por ishin formacione ushtarake dhe administrative të përkohshme e të paqëndrueshme. Këto perandori jo vetëm që nuk kishin, por edhe nuk mund të kishin një gjuhë të vetme për perandorinë dhe të kuptueshme për të gjithë anëtarët e perandorisë. Ato ishin një konglomerat fisesh dhe kombësish, që bënin një jetë të vetën dhe që kishin gjuhët e veta. Pra, nuk e kam fjalën për këto perandori dhe për të tjera si këto, por për ato fise dhe kombësi që bënin pjesë në perandori, që kishin një bazë ekonomike të vetën dhe gjuhët e veta të formuara prej shumë kohe. Historia na mëson se gjuhët e këtyre fiseve dhe kombësive nuk ishin

gjuhë klase, por gjuhë të të gjithë popullit, të përbashkëta për fiset dhe kombësitë dhe të kuptueshme për to.

Natyrisht, kishte krahas tyre dialekte, të folme lokale, por gjuha e vetme dhe e përbashkët e fisit ose e kombësisë mbizotëronte dhe i nënshtrohte ato.

Më vonë, me daljen e kapitalizmit, me zhdukjen e copëtimit feudal dhe me formimin e tregut kombëtar, kombësitë u zhvilluan në kombe dhe gjuhët e kombësive — në gjuhë kombëtare. Historia na mëson se gjuhët kombëtare nuk janë gjuhë klase, por gjuhë të të gjithë popullit, të përbashkëta për anëtarët e kombeve dhe një të vetme për kombin.

... Përmendin pastaj Leninin dhe thonë se Lenini pranonte ekzistencën e dy kulturave në rendin kapitalist, të kulturës borgjeze e të asaj proletare, se parulla e kulturës kombëtare në kapitalizëm është një parullë nacionaliste. Kjo është e vërtetë dhe Lenini këtu ka plotësisht të drejtë. Po ç'hyn këtu «karakteri klasor» i gjuhës? Duke përmendur fjalët e Leninin mbi dy kulturat në rendin kapitalist, këta shokë, si duket, duan t'i japin të kuptojë lexuesit se ekzistenca në shoqëri e dy kulturave, e kulturës borgjeze dhe e asaj proletare, do të thotë se duhet të ketë edhe dy gjuhë, sepse gjuha është e lidhur me kulturën; pra, Lenini e mohon nevojën e një gjuhe kombëtare të vetme; pra, Lenini është për gjuhët «klasore». Gabimi i këtyre shokëve këtu është se ata identifikojnë dhe ngatërrojnë gjuhën me kulturën. Mirëpo kultura dhe gjuha janë dy gjëra të ndryshme. Kultura mund të jetë edhe borgjeze edhe socialiste, kurse gjuha, si mjet komunikimi, është kurdoherë një gjuhë e përbashkët për gjithë popullin dhe mund t'i shërbejë edhe kulturës borgjeze edhe kulturës socialiste. Nuk është vallë një fakt se rusishtja, ukrainishtja dhe uzbekishtja i shërbejnë sot kulturës socialiste të këtyre kombeve po aq mirë sa ç'u shërbenin kulturave të tyre borgjeze para Revolucionit të Tetorit? Pra, gabojnë rëndë këta shokë kur thonë se ekzistenca e dy kulturave të ndryshme

shpie në formimin e dy gjuhëve të ndryshme dhe në mohimin e nevojës së një gjuhe të vetme.

Duke folur për dy kulturat, Lenini nisej pikërisht nga teza se ekzistenca e dy kulturave nuk mund të shpjerë në mohimin e një gjuhe të vetme dhe në formimin e dy gjuhëve, se gjuha duhet të jetë një. Kur bundistët e akuzuan Leninin duke thënë se ai e mohonte nevojën e gjuhës kombëtare dhe e quante kulturën «pa kombësi», Lenini, siç dihet, protestoi energjikisht kundër kësaj akuze dhe tha se ai luftonte kundër kulturës borgjeze, e jo kundër gjuhës kombëtare, nevojën e së cilës ai e shikonte si të domosdoshme. Është për t'u çudatur që disa shokë tanë kanë ecur në gjurmët e bundistëve.

...Historia na thotë se gjuha tregon një stabilitet të madh dhe një qëndresë të fortë kundër asimilimit me përdhunë. Disa historianë, në vend që ta shpjegojnë këtë dukuri, kufizohen vetëm duke shfaqur habinë e tyre. Por këtu s'ka asnjë arsye për t'u habitur. Stabiliteti i gjuhës shpjegohet me stabilitetin e sistemit të saj gramatikor dhe të fondit themelor të leksikut. Me qindra vjet asimilatorët turq u munduan t'i gjymtonin, t'i shkatërronin dhe t'i asgjësonin gjuhët e popujve ballkanikë. Gjatë kësaj periudhe leksiku i gjuhëve ballkanike pësoi ndryshime të mëdha, u morën shumë fjalë dhe shprehje turke, pati «konvergjencë» dhe «divergjencë», por gjuhët ballkanike qëndruan dhe mbijetuan. Pse? Sepse sistemi gramatikor dhe fondit themelor i leksikut të këtyre gjuhëve në vija të përgjithshme mbetën ashtu si ishin.

... Puna është se broshura e Stalinit «Në lidhje me marksizmin në gjuhësi» dhe fjalimi i Stalinit në Kongresin XVI të partisë kanë parasysh dy epoka krejt të ndryshme, prandaj edhe formulat janë të ndryshme.

Formula që jep Stalini në broshurën e vet, në atë pjesë ku bëhet fjalë për kryqëzimin e gjuhëve, ka parasysh epokën *para fitores së socia-*

lizmit në shkallë botërore, kur klasat shfrytëzuese janë forca sunduese e botës, kur mbetet zgjedha kombëtare dhe koloniale, kur veçimi kombëtar dhe mosbesimi ndërmjet kombeve përforcohen nga ndryshimet e shteteve, kur nuk ka ende barazi në të drejtat e kombeve, kur kryqëzimi i gjuhëve bëhet gjatë luftës për sundimin e njëres prej gjuhëve, kur nuk janë ende kushtet për një bashkëpunim paqësor dhe miqësor të kombeve dhe të gjuhëve, kur nuk janë në rend të ditës bashkëpunimi ndërmjet gjuhëve dhe pasurimi i ndërsjellë i tyre, por asimilimi i disa gjuhëve dhe fitorja e disa të tjerave. Kuptohet se në këto kushte mund të ketë vetëm gjuhë fituese dhe gjuhë të mundura. Pikërisht këto kushte ka parasysh formula e Stalinit që thotë se kryqëzimi, për shembull, i dy gjuhëve nuk çon në formimin e një gjuhe të re, por në fitoren e njëres prej gjuhëve dhe në humbjen e tjetrës.

Për sa i përket formulës tjetër të Stalinit, që është marrë nga fjalimi i tij në Kongresin XVI të partisë dhe që flet për shkrirjen e gjuhëve në një gjuhë të vetme të përbashkët, ajo ka parasysh një epokë tjetër, pikërisht epokën *pas fitores së socializmit* në shkallë botërore, kur imperializmi botëror nuk do të jetë më, kur klasat shfrytëzuese do të jenë përmbysur, kur do të jetë zhdukur shtypja kombëtare dhe koloniale, kur veçimi kombëtar dhe mungesa e besimit ndërmjet kombeve do të jenë zëvendësuar nga besimi dhe afrimi ndërmjet kombeve, kur të drejtat e barabarta të kombeve do të bëhen një realitet, kur politika e shtypjes dhe e asimilimit të gjuhëve do të jetë zhdukur, kur do të jetë rregulluar bashkëpunimi ndërmjet kombeve dhe gjuhët kombëtare do të kenë liri të plotë për të pasuruar njëra-tjetrën në bashkëpunimin e tyre. Kuptohet se në këto kushte as që mund të bëhet fjalë për shtypjen dhe disfatën e disa gjuhëve dhe për fitoren e disa të tjerave. Këtu ne nuk do të kemi të bëjmë me dy gjuhë, prej të cilave njëra

mundet, kurse tjetra del fituese nga lufta, por me qindra gjuhë kombëtare, prej të cilave, si rrjedhojë e një bashkëpunimi të gjatë ekonomik, politik dhe kulturor të kombeve, do të shkëputen në fillim gjuhët zonale të vetme më të pasuruara; pastaj gjuhët zonale do të shkrihen në një gjuhë të përbashkët ndërkombëtare, që nuk do të jetë, natyrisht, as gjermanishtja as rusishtja as anglishtja, por një gjuhë e re, që do të ketë thithur elementet më të mira të gjuhëve kombëtare dhe zonale.

*Shkruar më 28 korrik
1950*

*Vepra të zgjedhura, bot. shqip,
f. 514-515, 516, 518-519, 523-524,
528, 549-550*

SHËNIME

- 1 *Partia Socialiste Poloneze (PSP)* — parti nacionaliste mikroborgjeze e themeluar më 1893. — 12.
- 2 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. i 2-të rus., vëll. 5, f. 379, 353. — 15.
- 3 *Dombrovski J. dhe Vrubleuski V.* — militantë të shquar të lëvizjes revolucionare poloneze të vjetëve 1863-1864. Pas shtypjes së kryengritjes poloneze mërguan në Francë. Më 1871 u bënë gjeneralë të Komunës së Parisit. — 16.
- 4 *Traktati i Berlinit* — marrëveshja që u miratua më 13 korrik (sipas kalendarit të ri) 1878 nga kongresi i përfaqësuesve të qeverive të Rosisë, Anglisë, Austro-Hungarisë, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Turqisë pas luftës ruso-turke të vjetëve 1877-1878. — 27.
- 5 *Bundi* — «Bashkimi i përgjithshëm i punëtorëve çifutë të Lituanisë, Polonisë dhe Rosisë» — u organizua më 1897, bashkonte kryesisht zejtarët çifutë të krahinave perëndimore të Rosisë. — 53.
- 6 «*Federatë e tipit më të keq*» — kështu janë cilësuar në vendimet e Konferencës së Pragës të 1912-s marrëdhëniet me organizatat socialdemokrate kombëtare që ekzistonin në PPSDR qysh prej 1907-s gjer më 1911. Megjithëse organizatat socialdemokrate të Polonisë dhe Lituanisë, të krahinës së Letonisë dhe Bundi hynin në PPSDR, praktikisht ato qëndronin të veçara. Përfaqësuesit e tyre nuk merrnin pjesë në drejtimin e punës së partisë për gjithë Rusinë;

drejtpërdrejt ose tërthorazi ata ndihmonin veprimtarinë antiparti të likuidatorëve. — 54.

- 7 *Narodova demokratija* (nacionaldemokracia, narodovasi, demokratët popullorë) — parti reaksionare, shoviniste e borgjezisë poloneze; u formua në 1897. Kërkesën e tyre fillestare për pavarësinë e Polonisë narodovasi, të trembur nga hovi i lëvizjes revolucionare, e zëvendësuan me kërkesën e një autonomie të cunguar në kuadrin e autokracisë. Në kohën e revolucionit të vjetëve 1905-1907 narodovasi u bënë partia kryesore e kundërrivolucionit polonez, u bënë qindëshet e zeza të Polonisë, siç i quante Lenini. Në Dumën e Shtetit ata përkrahnin oktjabristët. — 54.
- 8 Është fjala për ndarjen e shkollës sipas kombësive, që ishte kërkesa kryesore e programit nationalist-borgjez të «autonomisë kombëtare-kulturore». — 55.
- 9 *SERP* (Partia Punëtore Socialiste Çifute) — organizatë nacionaliste mikroborgjeze; u formua më 1906. Baza e programit të SERP-it ishte kërkesa e autonomisë kombëtare për çifutët, kërkesa për krijimin e parlamenteve (sejmeve) eksterritoriale çifute, të plotfuqishme në zgjidhjen e çështjeve të organizimit politik të çifutëve në Rusi. SERP-i qëndronte afër eserëve dhe luftonte bashkë me ta kundër PPSDR-së. — 83.
- 10 *Çështja Bejlis* — proces gjyqësor provokues, i organizuar më 1913 në Kiev nga qeveria cariste kundër çifutit Bejlis që u akuzua padrejtësisht për vrasje me qëllime rituale të Jushinskit, një djalë i krishterë (në të vërtetë kjo vrasje u organizua nga qindëshet e zeza). Duke kurdisur këtë proces qeveria cariste donte të ndizte antisemitizmin dhe të shkaktonte pogrome kundër çifutëve me qëllim që t'i largonte masat nga lëvizja revolucionare, e cila po merrte hov në gjithë vendin. Procesi ngjalli një zemërim të madh shoqëror; në shumë qytete u zhvilluan demonstrata proteste të punëtorëve. Gjyqi e deklaroi Bejlisin të pafajshëm. — 85.

- 11 *Partia Socialiste Poloneze* (Polska partia socjalistyczna) — parti nacionaliste mikroborgjeze, e themeluar më 1892. Duke vënë në bazë të programit të saj luftën për një Poloni të pavarur, PPS-ja zhvillonte një propagandë separatiste, nacionaliste ndër punëtorët polonezë dhe përpigjej t'i largonte ata nga lufta e përbashkët me punëtorët rusë kundër autokracisë dhe kapitalizmit. Më 1906 PPS-ja u nda në dy pjesë: «levica» dhe «pravica». — 85.
- 12 Lenini i referohet artikullit të J. V. Stalinit «*Marksizmi dhe çështja kombëtare*», ku në kapitullin e katërt jepet teksti i programit kombëtar që u pranua në kongresin e Partisë Socialdemokrate Austriake të Bërnos (shih J. V. Stalin. «*Marksizmi dhe çështja kombëtare*», bot. shqip, 1979, f. 36). Artikulli i J. V. Stalinit u botua në revistën «*Prosveshenie*» Nr. Nr. 3, 4, 5 të vitit 1913 me titull «*Çështja kombëtare dhe socialdemokracia*» të nënshkruar K. Stalin. Më 1914 ky artikull u botua si broshurë më vete me titullin «*Çështja kombëtare dhe marksizmi*». — 87.
- 13 Dragomanov, M. P. (1841-1895) — historian dhe publicist ukrainas, shprehës i ideologjisë së nacional-liberalizmit borgjez ukrainas. — 96.
- 14 «*Przeгляд Socialdemokratyczny*» («*Revista socialdemokrate*») — revistë; botohej nga socialdemokratët polonezë me pjesëmarrjen aktive të R. Luksemburgut në Krakovi qysh prej 1902-shit gjer më 1904 dhe qysh prej 1908-s gjer më 1910. — 96.
- 15 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. i 2-të rus., vëll. 31, f. 318 dhe K. Marks e F. Engels. Letra të zgjedhura, bot. shqip, 1981, f. 283. — 105.
- 16 K. Marks, «*Kapitali*», bot. shqip, vëll. I, libri i 3-të, f. 275. — 119.
- 17 L. VI — L. Vladimirov (pseudonim i M. K. Shejnfinkelit). — 135.
- 18 Lenini citon një shprehje nga komedia e A. S. Gribojedovit

- «Mjerë kush ka mend» (shih A. S. Gribojedov. Veprat, 1945, f. 39). — 148.
- 19 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1931, vëll. XXIV, f. 348. — 163.
- 20 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1932, vëll. XXI, f. 210-211. — 163.
- 21 K. Marks e F. Engels. Letra të zgjedhura, bot. shqip, 1981, f. 254-255. — 165.
- 22 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1932, vëll. XXIII, f. 413-414. — 165.
- 23 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1931, vëll. XXIV, f. 133, 240-241 dhe 233. — 167.
- 24 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1931, vëll. XXIV, f. 250. — 167.
- 25 K. Marks e F. Engels. Letra të zgjedhura, bot. shqip, 1981, f. 336-337, 338. — 168.
- 26 Shprehja është marrë nga dorëshkrimet e N. Shedrinit «Në dhe të huaj» (shih M. E. Saltikov-Shedrin. Vepra të zgjedhura, 1947, f. 344-350). — 178.
- 27 Lenini citon vargje të L. N. Tolstoit. — 181.
- 28 Lenini citon një pjesë nga romani i Çernishevskit «Prologu» (shih N. G. Çernishevski. Vepra të zgjedhura, bot. rus., vëll. V, 1932, f. 488). — 189.
- 29 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1935, vëll. XV, f. 223. — 189.
- 30 *Parabellum* — K. Radeku. — 201.
- 31 Çështja Drejfus — proces provokues i organizuar më 1894 nga qarqet monarkiste reaksionare të militaristëve francezë kundër oficerit të shtabit madhor çifut Drejfus, për të cilin u kurdis akuza e rreme për spiunazh dhe tradhti të lartë:

Gjyqi ushtarak e dënoi Drejfsin me burgim të përjetshëm. Lëvizja shoqërore që shpërtheu në Francë për rishikimin e çështjes Drejfus u zhvillua në kushtet e një lufte të ashpër ndërmjet republikanëve e monarkistëve dhe në fund të fundit bëri që Drejfsit më 1906 t'i njihej pafajësia.

Çështjen Drejfus Lenini e quajti «një nga mijëra dhe mijëra dallaveret e poshtra të militarizmit reaksionar».
— 214.

- 32 *Incidenti i Cabernit* — ndodhi në qytetin Cabern (Alzasë) në nëntor 1913. Si shkak shërbyen tailjet e një oficeri prusian me banorët e Alzasës. Kjo shkaktoi një shpërthim zemërimi në popullsinë vendase, kryesisht franceze, kundër shtypjes së militaristëve prusianë. Për incidentin e Cabernit shih artikullin e Leninit «Cabern» (Veprat, bot. shqip, vëll. 19, f. 501-593). — 214.
- 33 Shih kritikën e idesë reaksionare të Renerit dhe Bauerit për të ashtuquajturën «autonomi kombëtaro-kulturore» në Veprat e V. I. Leninit «Mbi autonominë «kombëtaro-kulturore»» (Veprat, bot. shqip, vëll. 19, f. 580-584). «Shënime kritike për çështjen kombëtare» (shih këtë përmbledhje, f. 62-102), si dhe në veprën e J. V. Stalinit «Marksizmi dhe çështja kombëtare» (J. V. Stalin. Veprat, bot. shqip, vëll. 2, f. 288-364) etj. — 215.
- 34 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1930, vëll. VI, f. 185.
— 219.
- 35 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., 1930, vëll. VII, f. 201-220. — 220.
- 36 Torparë — fshatarë në Finlandë pa tokë, që e merrnin atë me qira nga çifligarët me kushte skllavëruese. — 325.
- 37 Lëvizja e basmaçëve — lëvizje nacionaliste kundërrevolucionare në Azinë e Mesme (Turkestan, Buhara dhe Horezëm) në vjetët 1918-1924; shfaqej në formën e një banditizmi të hapët politik; kryesohej nga bejlerët dhe mullahët; kishte për qëllim t'i shkëpuste republikat e Azisë së Mesme nga

Rusia Sovjetike dhe të rivendoste sundimin e klasave shfrytëzuese. Lëvizjen e basmaçëve e përkrahnin aktivisht imperialistët anglezë, të cilët orvateshin ta shndërronin Azinë e Mesme në një koloni të tyre. — 357.

38 J. V. Stalin. Veprat, bot. shqip, vëll. 2, f. 303, 311-312. — 402.

39 J. V. Stalin. Veprat, bot. shqip, vëll. 7, f. 141. — 407.

LËNDA

<i>Parathënie</i>	3—7
-------------------------	-----

V. I. LENIN

ÇËSHËTJA KOMBËTARE NË PROGRAMIN TONË	11—22
<i>Nga</i> «NGJARJET NË BALLKAN DHE NË RUSI»	23—35
NJË LOJË KUMARI	36—37
NJË KAPITULL I RI NË HISTORINË BOTËRORE	38—39
LUFTA BALLKANIKE DHE SHOVINIZMI BORGJEZ	40—41
KLASA PUNËTORE DHE ÇËSHËTJA KOMBËTARE	42—44
EVROPA E PRAPAMBETUR DHE AZIA E PËRPA- RUAR	45—47
<i>Nga</i> «TEZAT PËR ÇËSHËTJEN KOMBËTARE»	48—55
<i>Nga artikulli:</i> «PËR PROGRAMIN KOMBËTAR TË PPSDR-së»	56—61
SHËNIME KRITIKE PËR ÇËSHËTJEN KOMBËTARE	62—102
1. Liberalët dhe demokratët për çështjen e gjuhëve	63
2. Kultura kombëtare	67
3. Gogoli nacionalist i «asimilimit»	72
4. «Autonomia kombëtareo-kulturore»	80
5. Barazia e kombeve dhe të drejtat e pakicës	

kombëtare	88
6. Centralizimi dhe autonomia	94
LIBERALËT ANGLEZË DHE IRLANDA	103—106
BARAZIA KOMBËTARE	107—109
KORRUPTIMI I PUNËTOREËVE ME ANË TË NA- CIONALIZMIT TË STËRHOLLUAR	110—113
<i>Nga artikulli: «PËR TË DREJTËN E KOMBEVE PËR VETËVENDOSJE»</i>	114—186
1. Ç'është vetëvendosja e kombeve?	115
2. Mënyra historike konkrete se si shtrohet çështja	121
3. Veçoritë konkrete të çështjes kombëtare në Rusi dhe transformimi demokratik-borgjez i këtij vendi	125
4. «Prakticizmi» në çështjen kombëtare	131
5. Borgjezia liberale dhe oportunistët socialistë në çështjen kombëtare	137
6. Shkëputja e Norvegjisë nga Suedia	150
7. Vendimi i Kongresit Ndërkombëtar të Londrës i vitit 1896	157
8. Utopisti Kari Marks dhe praktikja Roza Luk- semburg	162
9. Programi i vitit 1903 dhe likuidatorët e tij	171
10. Konkluzion	182
PËR KRENARINË KOMBËTARE TË RUSËVE	187—192
<i>Nga artikulli: «ÇËSHTJA E PAQES»</i>	193—197
<i>Nga «PROJEKTRIZOLUCIONI I SË MAJTËS SË CI- MERVALDIT»</i>	198—200
PROLETARIATI REVOLUCIONAR DHE E DREJTA E KOMBEVE PËR VETËVENDOSJE	201—209
REVOLUCIONI SOCIALIST DHE E DREJTA E KOMBEVE PËR VETËVENDOSJE (Teza)	210—228
1. Imperializmi, socializmi dhe çlirimi i kombeve	

të shtypura	210
2. Revolucioni socialist dhe lufta për demokracinë	211
3. Kuptimi i së drejtës për vetëvendosje dhe raporti i saj me federatën	214
4. Mënyra revolucionare-proletare e shtruarjes së çështjes së vetëvendosjes së kombeve	216
5. Marksizmi dhe prudonizmi në çëshijen kombëtare	218
6. Tri tipe vendesh në lidhje me vetëvendosjen e kombeve	220
7. Socialshovinizmi dhe vetëvendosja e kombeve	222
8. Detyrat konkrete të proletariatit në të ardhmen më të afërt	224
9. Qëndrimi i socialdemokracisë ruse e poloneze dhe i Internacionales II ndaj vetëvendosjes	225
<i>Nga artikulli: «PËR BROSHURËN E JUNIUSIT»</i>	229—236
<i>Nga artikulli: «PËR KARIKATURËN E MARKSIZMIT DHE PËR «EKONOMIZMIN IMPERIALIST»»</i>	237—244
<i>Nga artikulli: «PACIFIZMI BORGJEZ DHE PACIFIZMI SOCIALIST»</i>	245—246
<i>Nga «KONFERENCA E SHTATË E PËRGJITHSHME (E PRILLIT) E PPSDR(b) TË RUSISË», 24-29 prill 1917</i>	247—255
Rezolucion për çështjen kombëtare	253
<i>Nga leksioni: «LUFTA DHE REVOLUCIONI», 14(27) maj 1917</i>	256—258
<i>Nga «KONGRESI I DYTË I SOVJETËVE TË DEPUTETËVE PUNËTORË DHE USHTARË TË RUSISË», 25-26 tetor 1917</i>	259—260
<i>Nga «DEKLARATA E TË DREJTAVE TË POPULLIT PUNONJËS DHE TË SHFRYTËZUAR»</i>	261—262
<i>Nga «RAPORTI PËR POLITIKËN E JASHTME NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË KQE TË RUSISË</i>	

DHE TË SOVJETËVE TË MOSKËS», 14 maj 1918	263—264
Nga «PROJEKTPROGRAMI I PK(b) TË RUSISË»	265—266
NGA RAPORTI I MBAJTUR NË KONGRESIN VIII TË PK(b) TË RUSISË, 18-23 mars 1919	267—272
Nga fjalimi: «PËR DETYRAT E INTERNACIONA- LES III»	273
Nga vepra: «SËMUNDJA FOSHNJORE E «MAJTIZ- MIT» NË KOMUNIZËM»	274—275
Nga «SKICA E PARË E TEZAVE PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE DHE KOLONIALE»	276—282
Nga «KUSHTET PËR PRANIMIN NË INTERNA- CIONALEN KOMUNISTE»	283
Nga «RAPORTI I KOMISIONIT PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE» DHE KOLONIALE NË KONGRESIN II TË INTERNACIONALES KOMUNISTE»; 26 ko- rrik 1920	284—287
NGA LETRA DËRGUAR G. ZINOVIEVIT	288—289

J. V. STALIN

SI E KUPTON SOCIALDEMOKRACIA ÇËSHTJEN KOMBËTARE?	293—311
PËR HEQJEN E KUFIZIMEVE KOMBËTARE	312—315
PËR PAVARËSINË E FINLANDËS. Referat i mbaj- tur më 22 dhjetor 1917 në mbledhjen e KQE të Rusisë	316—318
REVOLUCIONI I TETORIT DHE ÇËSHTJA KOM- BËTARE	319—330
I. Revolucioni i shkurtit dhe çështja kombëtare	319

II. Revolucioni i tetorit dhe çështja kombëtare	322
III. Rëndësia botërore e revolucionit të tetorit	327
<i>Nga tezat: «PËR DETYRAT IMEDIATE TË PARTISË NË ÇËSHTJEN KOMBËTARE»</i>	331—334
<i>Nga «KONGRESI XII I PK(b) TË RUSISË», 17-25 prill 1923</i>	335—370
Referat për momentet kombëtare në ndërtimin e partisë dhe të shtetit	335
Fjala e mbylljes rreth referatit për momentet kombëtare në ndërtimin e partisë dhe të shtetit	360
<i>Nga vepra: «MBI BAZAT E LENINIZMIT»</i>	371—382
Çështja kombëtare	371
RRETH ÇËSHTJES KOMBËTARE NË JUGOSLLA-	
VI. Fjalim i mbajtur në komisionin jugosllav të KEIK, 30 mars 1925	383—389
<i>Nga fjalimi: «PËR DETYRAT POLITIKE TË UNIVERSITETIT TË POPUJVE TË LINDJES», 18 maj 1925</i>	390—393
<i>Nga artikulli: «KARAKTERI NDËRKOMBËTAR I REVOLUCIONIT TË TETORIT»</i>	394—396
ÇËSHTJA KOMBËTARE DHE LENINIZMI. Përgjigje shokëve Meshkov, Kovalçuk dhe të tjerëve	397—412
1. Nocioni komb	397
2. Lindja dhe zhvillimi i kombeve	399
3. E ardhmja e kombeve dhe e gjuhëve kombëtare	404
4. Politika e partisë në çështjen kombëtare	412
<i>Nga vepra: «MARKSIZMI DHE ÇËSHTJET E GJUHËSISË»</i>	419—424
<i>Shënime</i>	425—430

Lenin, V. I. dhe Stalin, J. V.

Për çështjen kombëtare. T., «8 Nëntori», 1984.

... f.

(B. m.) dhe

(B. v.): 300.123 +

+ 300.133 +

+ 947.323.1.

P 59

Tirazhi 5000 kopje

Formati 56x84/16

Stash: 2204-82

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1984

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Radha	Është	Duhet të jetë
91	1	kombësve	kombësive
208	4	demokrtike	demokratike
283	13	më të vërtetë	me të vërtetë
310	23	filozofjnë	filozofojnë
311	9	Pyetjet	Pyetet
372	2 nga fundi	popjuve	popujve